

# DORACAKU MBI SHËRBIMET POLICORE ME NDJESHMERI GJINORE NE TRAJTIMIN E RASTEVE

të dhunës ndaj vajzave dhe grave





## FALËNDERIMET

Zhvillimi i këtij mjete nuk do të ishte i mundur pa:

Guximin e shumë grave që kanë përjetuar dhunë dhe kanë folur për përvojat e tyre dhe aktivisteve, veçanërisht nga organizatat e grave në tërë globin, të cilat kanë avokuar në ofrimin e shërbimeve dhe mbështetjen e duhur për gratë që kanë përjetuar dhunë.

Përpjekjet e qeverive që po ndërmarrin veprime për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe vajzave ('DHGV') përmes reformave legjislative, nismave të politikave dhe zbatimit të programeve të parandalimit dhe reagimit.

Qeverinë e Australisë, një nga donatorët kryesorë për Programin e Përbashkët të OKB-së për Shërbimet Thelbësore për Gratë dhe Vajzat që i nënshtrohen Dhunës.

Angazhimin e vazhdueshëm të sistemit të OKB-së, për të zhvilluar programe dhe veprime në reagim ndaj DHGV-së. Agjencitë e OKB-së të angazhuara në mbështetjen e zhvillimit të këtij mjete kanë ndarë kohën dhe njohuritë e tyre për të siguruar që ne të vazhdojmë të përmirësojmë ofrimin e shërbimeve cilësore dhe thelbësore për gratë dhe vajzat që kanë përjetuar dhunë. Përfaqësuesit e agjencive në vijim falënderohen për angazhimin dhe kontributin e tyre: Kalliope Mingeirou, Caroline Meenagh, Charlotte Hemmestad Ludt Lea Biason, Beatrice Duncan, Sadiq Syed, Melissa Alvarado, AH Monjurul Kabir, Bridget Hancock dhe Alejandro Sanchez (UN Women); Shruti Majumdar (Fondi i Mirëbesimit i OKB-së për t'i dhënë fund dhunës kundër grave); Valerie Lebaux, Claudia Baroni dhe Sven Pfeiffer (UNODC); Sofiene Bacha (UNDP); dhe Cameron Sigley (Departamenti i OKB-së për Operacione Paqësore - Divizioni i Policisë).

Anëtarët e mëposhtëm të Grupit Këshillëdhënës, të cilët gjithashtu janë falënderuar sinqerisht për mbështetjen e tyre teknike: Alessandra Aresu (Humanity & Inclusion); Cheryl Thomas, Melissa Scaia, Laura Wilson dhe Helen Rubenstein (Të Drejtat Globale për Gratë); Jennifer Long (AEquitas); Marai Larasi (Koalicioni Jepi Fund dhunës ndaj Grave); Maureen Curtis and Kimberlina Kavern (Safe Horizon); Eileen Skinnider and Ruth Montgomery (Qendra Ndërkombëtare për Reformën e së Drejtës Penale dhe Politikën e Drejtësisë Penale, Vankuver, Kanada); Maria Victoria 'Mavic' Cabrera Balleza and Agnieszka Fal-Dutra Santos (Rrjeti Global i Grave Ndërtuese të Paqes); Raluca Popa dhe Rea Abada Chiongson (Organizata Ndërkombëtare për Zhvillimin e Ligji); Cassandra Altagracia Martha, Sarah Louise Neil and Shamima Begum (Shoqata Ndërkombëtare e Grave Police); dhe Deborah Friedl (Kryetare e Shoqatës Ndërkombëtare të Grave Police).

Ky Manual nuk do të kishte qenë i mundur pa kontributet e rëndësishme nga [Graham Goulden](#), [Gerry Campbell](#) dhe [Neelam Sarkaria](#), të cilët falënderohen sinqerisht për përkushtimin dhe mbështetjen e konsiderueshme teknike, si për drejtimin ashtu edhe për zhvillimin e Manualit.

Autorët: Mirko Fernandez, Konsulent Kryesor dhe [Jane Townsley](#), Këshilltare e Lartë e Policisë dhe Drejtoreshë Ekzekutive e Shoqatës Ndërkombëtare të Grave Police.

## LISTA E AKRONIMEVE DHE SHKURTESAVE

<b>PPF</b>	Përvojat e Pafavorshme të Fëmijërisë(MB)	<b>SVE</b>	Sëmundja e Virusit Ebola
<b>SHPT</b>	Shoqata për Parandalimin e Torturës	<b>FDHF</b>	Familja dhe Dhuna në Familje (Australi)
<b>SHBGP</b>	Shoqata Britanike për Gratë në Polici	<b>GJ/PGJF</b>	Gjymtimi/Prerja Gjenitaleve të Femrës
<b>BiH</b>	Bosnja dhe Hercegovina	<b>ZNF</b>	Zyrtarët Ndërlidhëse me Familjen
<b>ZPE</b>	Zezaqët dhe Pakicat Etnike (MB)	<b>NJBF</b>	Njësia për Mbështetjen e Familjes e Policisë së Sierra Leones
<b>KEGJFDG</b>	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (	<b>DHBGJ</b>	Dhuna me bazë gjinore (DHBGJ)
<b>MFHD</b>	Martesa e Fëmijëve, e Hershme dhe e Detyruar (MFHD)	<b>RRGGNP</b>	Rrjeti Global i Grave Ndërtuese të Paqes
<b>QKS</b>	Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (SHBA)	<b>MS</b>	Qeveria e Madhërisë së Saj(MB)
<b>KDF</b>	Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve	<b>IPMS</b>	Inspektorati Policor i Madhërisë së Saj (MB)
<b>TVQM</b>	Televizor me qark të mbyllur	<b>IPSHZSHMS</b>	Inspektorati Policor dhe Shërbimet e Zjarrikjes dhe Shpëtimit i Madhërisë së Saj (MB)
<b>KVSPD</b>	Këshillat Vendorë të Sigurisë për Parandalimin e Delikuencës	<b>SHNSHP</b>	Shoqata Ndërkombëtare e Shefave të Policisë
<b>DHKGV</b>	Dhuna e ndërlidhur me Konfliktin ndaj Grave dhe Vajzave	<b>SHNGP</b>	Shoqata Ndërkombëtare e Grave Police
<b>HVN</b>	Hetimi i Vendit të Ngjarjes	<b>ASBI</b>	Abuzimi seksual i bazuar në imazhe
<b>OSHC</b>	Organizata e shoqërisë civile	<b>GJPN</b>	Gjykata Penale Ndërkombëtare
<b>SHPK</b>	Shërbimi i Prokurorisë së Kurorës (MB)	<b>TIK</b>	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
<b>KKV</b>	Korniza e Kompetencës dhe Vlerave (MB)	<b>ANVK</b>	Anketa Ndërkombëtare e Viktimave të Krimet
<b>AFPN</b>	Mjeti për Abuzimin në Familje, Përndjekjen, Ngacmimin dhe Dhunën e bazuar në Nderë (MB)	<b>ID</b>	Identiteti
<b>DCAF</b>	Qendra e Gjenevës për Qeverisjen e Sektorit të Sigurisë	<b>KPDHF</b>	Këshilltar i Pavarur i Dhunës në Familje (MB)
<b>GAKA</b>	Gratë me Aftësi të Kufizuara në Afrikë	<b>DNDNJ</b>	E Drejta Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut (DNDNJ)
<b>ADN</b>	Acidi dezoksiribonukleik	<b>DHN</b>	E Drejta Humanitare Ndërkombëtare
<b>DPVT</b>	Divizioni i Politikave, Vlerësimit dhe Trajnimit – Dep. i OKB-së për Operacione Paqësore	<b>KKDHF</b>	Këshillat Koordinuese kundër Dhunës në Familje të Illinois (SHBA)
<b>RDK</b>	Republika Demokratike e Kongos	<b>ONP</b>	Organizata Ndërkombëtare e Punës
<b>DHF</b>	Dhuna në Familje	<b>DHPI</b>	Dhuna nga Partneri Intim
<b>NJMDHF</b>	Njoftimet për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje (MB)	<b>MSHI</b>	Marrëveshjet për shkëmbimin e informacionit
<b>UMDHF</b>	Urdhrat për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (MB)	<b>OSHI</b>	Ofruesi i shërbimit të internetit
<b>IEBGJ</b>	Instituti Evropian për Barazi Gjinore (IEBGJ)	<b>KRPA</b>	Koalicioni për Hapësirë Publike të Sigurt (Indonezi)
<b>PSHTH</b>	Paketa e Shërbimit Thelbësor për Gratë dhe Vajzat që i Nënshtrohen Dhunës PSHTH: Elementet Themelore dhe Udhëzimet për Cilësinë	<b>LGBTI</b>	Lezbike, Gej, Biseksuale, Transgjinore dhe Interseksuale
<b>SHPGE</b>	Shoqata e Policeve Gra të Emirateve	<b>KLS</b>	Këshilli Lokal i Sigurisë
		<b>M&amp;VE</b>	Monitorimi dhe Vlerësimi
		<b>KVRRSHA</b>	Konferenca e Vlerësimit të Rrezikut me Shumë Agjenci (MB)

<b>MINUSCA</b>	Misioni i Stabilizimit të Integruar Shumëdimensional i Kombeve të Bashkuara në Republikën Qendrore Afrikane	<b>UNAMID</b>	Operacioni Hibrid i Kombeve të Bashkuara në Darfur
<b>MINUSMA</b>	Misioni i Stabilizimit të Integruar Shumëdimensional i Kombeve të Bashkuara në Mali (	<b>UNICEF</b>	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
<b>MINUSTAH</b>	Misioni i Kombeve të Bashkuara për Stabilizim në Haiti	<b>DOKËÇES</b>	Departamenti i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Çështje Ekonomike dhe Sociale
<b>MPB</b>	Ministria e Punëve të Brendshme	<b>DOP</b>	Departamenti i Kombeve të Bashkuara për Operacionet Paqeruajtëse
<b>MONUSCO</b>	Misioni i Stabilizimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara në RD të Kongos	<b>KESOKB</b>	Këshilli Ekonomik dhe Social i Organizatës së Kombeve të Bashkuara
<b>SHPM</b>	Shërbimi Policor i Malavi (SHPM)	<b>UNFPA</b>	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë
<b>KKS</b>	Këshilli Komunal për Siguri	<b>UNHCHR</b>	Zyra e Komisionerit të Lartë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut
<b>MSCJ</b>	Mesa de Seguridad de Cd. (MSCJ) Juarez (Meksikë)	<b>UNHCR</b>	Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (ZKLBKBR)
<b>KHGP</b>	Komisioni Hetimor për Gra të Pagjetura (British Columbia, Kanadë)	<b>UNIFIL</b>	Forca e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara në Liban
<b>OJQ</b>	Organizata Joqeveritare	<b>UNMEER</b>	Misioni i Kombeve të Bashkuara për Reagimin Emergjent ndaj Ebolas
<b>SKRKNK</b>	Standardet Kombëtare të Rezultateve për Ndërhyrjet ndaj Kryerësve (Australi)	<b>UNMIL</b>	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Liberi
<b>KSHPN</b>	Këshilli i Shefave të Policisë Nacionale (MB)	<b>UNMIS</b>	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Sudan
<b>ZIDDNJ</b>	Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut e OSBE-së	<b>UNMIT</b>	Misioni i Integruar i Kombeve të Bashkuara në Timorin Lindor
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë	<b>UN OCHA</b>	Zyra e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Koordinimin e Çështjeve Humanitare
<b>PPM</b>	Pajisje Personale Mbrojtëse	<b>UNODC</b>	Zyra e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (ZOKBDK)
<b>JVSP</b>	Java e Vizitorëve të Stacionit Polico	<b>UN OHCHR</b>	Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut
<b>PMK</b>	Policia Mbretërore Kanadeze	<b>UN OROLSI</b>	Zyra e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Sundimin e Ligjit dhe Institucionet e Sigurisë
<b>RS</b>	Republika Srpska (Bosnjë dhe Hercegovinë)	<b>RKSOKB</b>	Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara
<b>AVAL</b>	Armë të Vogla dhe Armë të Lehta	<b>SHBA</b>	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
<b>QRSS</b>	Qendra e Referimit për Sulme Seksuale	<b>DHGV</b>	Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave
<b>ZQEJLKAV</b>	Zyra Qendrore e Evropës Juglindore dhe Lindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe Armëve të Lehta	<b>NJKD</b>	Njësia e Kujdesit të Dëshmitarëve
<b>DHSBGJ</b>	Dhuna Seksuale me Bazë Gjinore	<b>OBSH</b>	Organizata Botërore e Shëndetësisë
<b>KSU</b>	Korniza Strategjike e Udhëzimit për Paqeruajtjen Policore Ndërkombëtare (OKB)	<b>BLG</b>	Byroja Ligjore dhe e të Drejtave të Njeriut të Grave (BLG)
<b>PSL</b>	Policia e Sierra Leones	<b>RRGPEJ</b>	Rrjeti i Grave Police në Evropën Juglindore
<b>PSV</b>	Procedura Standarde e Veprimit		
<b>RSS</b>	Reforma në Sektorin e Sigurisë		
<b>IKDHS</b>	Iniciativa Kërkimore për Dhunë Seksuale		
<b>MB</b>	Mbretëria e Bashkuar		
<b>OKB</b>	Organizata e Kombeve të Bashkuara		




# TABELA E PËRMBAJTJES

<b>Falënderimet</b>	<b>3</b>
<b>Lista e akronimeve dhe shkurtesave</b>	<b>4</b>
<b>Tabela e përmbajtjes</b>	<b>7</b>
<b>Kapitulli 1: Hyrje</b>	<b>9</b>
<b>Kapitulli 2: Bërja e Ndryshimit si Drejtues dhe Udhëheqës i Ekipit</b>	<b>15</b>
<b>Kapitulli 3: Parandalimi</b>	<b>49</b>
<b>Kapitulli 4: Kontakti Fillestar</b>	<b>79</b>
<b>Kapitulli 5: Hetimi</b>	<b>105</b>
<b>Kapitulli 6: Siguria dhe Mbrojtja</b>	<b>151</b>
<b>Kapitulli 7: Mbështetja dhe Asistenca</b>	<b>179</b>
<b>Kapitulli 8: Koordinimi ndërmjet Agjencive të Drejtësisë</b>	<b>209</b>
<b>Kapitulli 9: Komunikimi</b>	<b>231</b>
<b>Kapitulli 10: Ndërtimi i institucioneve për një përgjigje efektive dhe të përgjegjshme të policisë ndaj DHGV-së</b>	<b>261</b>
<b>Kapitulli 11: Sfidat dhe strategjitë për zbatimin e policimit të përgjegjshëm gjinor</b>	<b>319</b>
<b>Kapitulli 12: Vazhdimësia e Drejtësisë</b>	<b>347</b>
<b>Kapitulli 13: Çështje të reja në hetimin e DHGV</b>	<b>387</b>
<b>Kapitulli 14: Emergjencat e Shëndetit Publik dhe Krizat Humanitare Jo-Konfliktuale</b>	<b>429</b>
<b>Kapitulli 14: Fjalori &amp; BIBLIOGRAFIA</b>	<b>477</b>
Fjalori	478
BIBLIOGRAFIA	482





**HYRJE**



Dhuna ndaj grave dhe vajzave ('DHGV') ka qenë prej kohësh një çështje e përhapur dhe universale e të drejtave të njeriut, e rrënjësor në marrëdhëniet e pabarabarta të pushtetit, pabarazitë strukturore dhe diskriminim. Është vlerësuar se pak më shumë se një në tri gra në mbarë botën (35 përqind) përjetojnë dhunë fizike ose seksuale, të kryer kryesisht nga një partner intim,<sup>1</sup> dhe kjo statistikë nuk përfshin ngacmimet seksuale. Forma të tjera të DHGV-së përfshijnë vrasjet e ndërlidhura me gjininë (të referuara edhe si 'vrasje të femrave'), dhunën seksuale jo nga partneri; trafikimin për qëllime të shfrytëzimit seksual dhe format e tjera të punës së detyruar; gjymtimin/prerjen e organeve gjinitale femërore dhe praktika të tjera të dëmshme, siç janë martesat në fëmijëri, e hershme dhe e detyruara, dhe të ashtuquajturat 'vrasje për nder'. Gratë dhe vajzat shpesh përjetojnë forma të shumta të dhunës si pjesë e një vazhdimësie - në kohë paqeje ose konflikti, ose pas konfliktit - dhe në mjedise të shumta, përfshirë brenda familjes, në punë, në shkollë, në komunitet, në internet, dhe në hapësira publike.<sup>2</sup>

Ka dëshmi se një sërë faktorësh dhe kushtesh individuale, të komunitetit dhe shoqërore shoqërohen me një rrezik më të lartë të përjetimit ose kryerjes së DHGV-së. Kjo përfshin besimet dhe normat individuale dhe kolektive rreth maskulinitetit dhe feminitetit, dhe rolet e pabarabarta dhe të ngurta gjinore në hapësirat publike dhe private që u japin burrave më shumë fuqi rreth aspekteve të ndryshme të jetës. Faktorë të tjerë të rrezikut mund të përfshijnë pranimin shoqëror të dhunës në familje, pasigurinë ekonomike, përdorimin e dëmshëm të alkoolit dhe substancave të tjera, mungesën e qasjes në shërbimet thelbësore dhe cilësore për të mbijetuarat, dhe politika diskriminuese gjinore dhe kornizat ligjore të rrënjësura në normat patriarkale.<sup>3</sup> Ekzistojnë gjithashtu dëshmi të fuqishme se ekspozimi

ndaj dhunës dhe normave të dëmshme gjinore në fëmijëri dhe adoleshencë rrit gjasat për të kryer ose përjetuar dhunë më vonë në jetë.

Edhe pse kostot e dhunës ndaj viktimave/të mbijetuarave të dhunës janë të mëdha, ky nuk është vetëm një problem për gratë dhe vajzat; pabarazia me bazë gjinore dhe DHGV ka shumë pasoja negative për familjet, komunitetet dhe shoqëritë. Për shembull, kostoja globale e dhunës ndaj grave u vlerësua në 1.5 trilion dollarë në vitin 2016.<sup>4</sup> Pabarazia gjinore është gjithashtu e ndërlidhur me racizmin, ksenofobinë, padrejtësinë ekonomike, padrejtësinë klimatike dhe sistemet e tjera të shtypjes. Prandaj është e qartë se përfundimi i DHGV-së nuk është vetëm një objektiv në vetvete dhe një aspekt i arritjes së barazisë gjinore - një nga Qëllimet e Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm - por është gjithashtu vendimtar për arritjen e Qëllimeve të tjera të Zhvillimit të Qëndrueshëm, siç është çrrënjësia e varfërisë, qasja në kujdesin dhe edukimin shëndetësor, punën e denjë dhe ndërtimin e një shoqërie të drejtë dhe paqësore.<sup>5</sup>

## DHGV DHE PANDEMIA COVID-19

Shpërthimi i sëmundjes së koronavirusit (COVID-19) ka përqësuar shumë nga faktorët e rrezikut që lidhen me DHGV-në.<sup>6</sup> Të dhënat e nxjerra tregojnë se që nga shpërthimi i COVID-19, DHGV, veçanërisht dhuna në familje, është intensifikuar, në atë që është përshkruar si një **'pandemi në hije.'**<sup>7</sup> Gratë dhe vajzat e kanë gjetur veten të mbyllur në shtëpi me abuzuesit, në pamundësi

1 Organizata Botërore e Shëndetësisë (2013), Vlerësimet globale dhe rajonale të dhunës ndaj grave, në: <https://www.who.int/publications/i/item/9789241564625>.  
2 UN Women (2020), COVID-19 dhe dhënia fund e dhunës kundër grave dhe vajzave, në: <https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/04/issue-brief-covid-19-and-ending-violence-against-women-and-girls>.  
3 UN Women (2020), Parandalimi: Dhuna ndaj grave dhe vajzave dhe COVID-19, në: <https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/05/brief-prevention-violence-against-women-and-girls-and-covid-19>.

4 UN Women (2016), 'Kostot Ekonomike të Dhunës ndaj Grave', Vërejtje nga Ndihmës Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së dhe Zëvendës Drejtori Ekzekutiv i UN Women, Lakshmi Puri, në diskutimin e nivelit të lartë mbi 'Koston Ekonomike të Dhunës ndaj Grave' në: <https://www.unwomen.org/en/news/stories/2016/9/speech-by-lakshmi-puri-on-economic-costs-of-violence-against-women>.

5 Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm për Intensifikimin e përpjekjeve për të eliminuar të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave (2020), në: <https://undocs.org/en/A/75/274>

6 Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm për Intensifikimin e përpjekjeve për të eliminuar të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave (2020), <https://undocs.org/en/A/75/274>.

7 Shih, për shembull, vërejtjet e Sekretarit të Përgjithshëm Antonio Guterres në Ditën Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave (2020), në: <https://www.un.org/sg/en/content/sg/speeches/2020-11-25/remarks-international-day-for-elimination-of-violence-against-women>.

për të raportuar dhunën dhe pa mjetet e mbështetjes së zakonshme. Në prill të vitit 2020, ekspertët parashikuan që për çdo tre muaj që masat e bllokimit do të vazhdonin në tërë botën, 15 milionë gra dhe vajza shtesë do të ekspozoheshin ndaj dhunës.<sup>8</sup> Në disa vende, thirrjet për linjat e ndihmës u rritën pesë herë.<sup>9</sup>

Edhe para pandemisë, shumë gra dhe vajza nuk kishin qasje në shërbimet më themelore falas për sigurinë, mbrojtjen dhe shërimin e tyre, siç janë linjat e ndihmës emergjente, reagimi me kohë i policisë dhe sektorit të drejtësisë, kujdesi shëndetësor, strehimi i sigurt, strehimi dhe këshillimi psiko-social. Aty ku ekzistonin këto shërbime, ato zakonisht ishin të pafinancuara, me staf të pakualifikuar, të pakoordinuara ose jo të një cilësie të mjaftueshme. Dëshmitë tregojnë se vetëm 40 përqind e grave që përjetojnë dhunë kërkojnë ndihmë të çfarëdo lloji, dhe akoma më pak, 1 në 10 gra, kërkojnë ndihmë nga policia.<sup>10</sup> Shumë nuk i raportojnë përvojat e tyre tek mekanizmat zyrtarë për shkak të turpit, frikës nga hakmarrjet ose mungesës së njohurive se si të kenë ndihmë në dispozicion. Gratë dhe vajzat që vuajnë nga forma të shumta dhe ndërlihdhëse të diskriminimit, siç janë gratë migrante, gratë që jetojnë me aftësi të kufizuara ose ato që jetojnë në zona rurale dhe të largëta janë në rrezik të shtuar të përjetojnë dhunë dhe ka më pak të ngjarë të marrin mbështetjen për të cilën kanë nevojë.

Ndërsa ofruesit e shërbimeve shëndetësore, policore dhe të drejtësisë janë të mbingarkuar me rastet e COVID-19 dhe pasojat e ndërlihdhura me të, menaxhimi klinik i përdhunimit, vlerësimi i shëndetit mendor dhe kujdesi për të mbijetuarat e dhunës, si dhe qasja në drejtësi, janë ndërprerë. Kjo pandemi gjithashtu i ka ekspozuar miliona punonjës të sektorit social dhe shëndetësor të grave në rrezik të shtuar të infektimit me COVID-19; ka rritur pasigurinë ekonomike për gratë, përfshirë ato që punojnë në ekonominë joformale me pak ose aspak mbrojtje

8 UNFPA (2020), Ndikimi i Pandemisë COVID-19 në Planifikimin Familjar dhe Përfundimi i Dhunës me Bazë Gjinore, Gjymtimi Gjenital Femëror dhe Martesa e Fëmijëve, në: <https://www.unfpa.org/resources/impact-covid-19-pandemic-family-planning-and-ending-gender-based-violence-female-genital>

9 UN Women (2020), Fakte dhe Shifra: Përfundimi i Dhunës ndaj Grave, në: <https://www.unwomen.org/en/what-we-do/ending-violence-against-women/facts-and-figures#notes>.

10 Shih: [https://unstats.un.org/unsd/gender/downloads/WorldsWomen2015\\_report.pdf](https://unstats.un.org/unsd/gender/downloads/WorldsWomen2015_report.pdf)

sociale ose opsione zëvendësuese; dhe ka ekspozuar miliona vajza ndaj shkollimit të ndërprerë dhe rrezikut të martesës së hershme. Është vlerësuar se pandemia do të shtyjë 47 milionë gra dhe vajza të tjera nën kufirin e varfërisë.<sup>11</sup> E gjithë kjo thekson nevojën për veprime urgjente për të mbajtur progresin, adresuar mosndëshkimin, si dhe nevojat e viktimave/të mbijetuarave. Kjo gjithashtu thekson nevojën për investime më të mëdha në përpjekjet parandaluese. Ka më shumë dëshmi se kurrë më parë se DHGV është e parandalueshme.<sup>12</sup>

## PROGRAMI I PËRBASHKËT GLOBAL I OKB-SË PËR SHËRBIMET THELBËSORE

Për të eliminuar format e ndryshme të dhunës kërkohet një qasje shumëdisiplinare me koordinim efektiv ndërmjet akterëve të ndryshëm. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë strategji gjithëpërfshirëse parandaluese shumësektoriale dhe reciprokisht të përforcuara që adresojnë shkaqet rrënjësore të dhunës. Sigurimi i qasjes në një sërë shërbimesh shëndetësore cilësore, drejtësi dhe shërbime policore dhe psiko-sociale mund t'u mundësojë grave dhe vajzave të thyejnë ciklet e përsëritura të dhunës dhe të zbusin pasojat e saj. Programi i Përbashkët Global i OKB-së për Shërbimet Thelbësore për Gratë dhe Vajzat që i nënshtrohen Dhunës, një partneritet ndërmjet UN Women, ZOKBDK, UNFPA, OBSH dhe UNDP, ka për qëllim të reagojë ndaj këtyre boshllëqeve dhe sfidave kritike. Ai siguron udhëzime se si të zbatohen normat globale për shërbimet dhe përgjigjet shumë sektoriale, me fokus në shërbimet shëndetësore, policore, gjyqësore dhe sociale, si dhe mekanizmat koordinues që lidhin këta sektorë.

11 UN Women (2020), Nga Zbulimi në Veprim: Barazia Gjinore Menjëherë pas COVID-19, në: <https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/09/gender-equality-in-the-wake-of-covid-19>.

12 Për informacion të detajuar, shih RESPEKTONI GRATË: Parandalimi i dhunës kundër grave (2019) dhe paketa shoqëruese e zbatimit (2020), të dyja të disponueshme në: <https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/07/respect-women-implementation-package>. Shih më tej, UN Women (2020), Parandalimi: Dhuna ndaj grave dhe vajzave & COVID-19, në: <https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/05/brief-prevention-violence-against-women-and-girls-and-covid-19>.

Faza I e Programit të Përbashkët (2013-2017) u përqendrua në arritjen e konsensusit mbi shërbimet thelbësore dhe standardet dhe mjetet përkatëse të cilësisë për ofrimin e shërbimeve në mjedise të ndryshme. [Paketa e Shërbimeve Thelbësore për Gratë dhe Vajzat që i nënshtrohen Dhunës: Elementet Themelore dhe Udhëzimet për Cilësinë](#) ('PSHTH') u lansua në fund të vitit 2015. Këto u zhvilluan me mbështetjen e konsulentëve ekspertë përmes një sërë konsultimesh teknike globale dhe rajonale me ekspertë kryesorë nga Qeveria, shoqëria civile, të mbijetuarat, akademia, si dhe praktikues nga secili sektor përkatës, me qëllim të mbështetjes së përhapjes së tyre globale. Në fillim të vitit 2021, Paketa e Shërbimeve Thelbësore u përdorë nga mbi 50 vende të botës, duke mbështetur zbatimin e tyre të normave dhe standardeve globale mbi shërbimet dhe reagimet shumësektoriale.

Në fillim të vitit 2019, si pjesë e përpjekjeve për të adresuar sfidat e identifikuar nga vendet pilot gjatë vitit të parë të zbatimit të Programit të Përbashkët në sektorin e drejtësisë, UN Women kërkoi të zhvillonte udhëzime për policimin gjinor, me një fokus të veçantë në forcimin e shërbimeve policore për gratë dhe vajzat që kanë përjetuar dhunë.

Përkundër përpjekjeve për të vënë në funksionim PSHTH-në, në shumë vende, ende ka mungesë të rregulloreve efektive dhe procedurave të qarta që përfshijnë rastet e DHGV-së, me disa vende që gjithashtu nuk kanë trajnim gjithëpërfshirës të hetimeve të DHGV-së për zbatimin e ligjit. Moduli 3 Drejtësia dhe Policimi i PSHTH-së u raportua nga përdoruesit si komponenti më i vështirë për tu funksionalizuar.

Më 18-19 qershor 2019, UN Women thirri një **Takimi të Grupit të Ekspertëve** në selinë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Nju Jork, për t'u ofruar partnerëve kryesorë dhe palëve të interesit (shoqëria civile, organizatat e grave dhe të mbijetuarave, forcat policore dypalëshe, institutet e drejtësisë penale dhe subjektet e OKB-së) një mundësi për të dhënë kontribut në një projekt-kornizë për zhvillimin të Manualit, përfshirë çështjet e reja për policinë në hetimin e krimeve të DHGV-së; adresimin e paragjykimeve institucionale dhe stereotipizimin gjinor dhe sigurimin e "qasjes" institucionale të nivelit të lartë, si dhe vlerësimin e përdorimit të Manualit si një mjet potencial reference jo

vetëm për policinë dhe sektorin e drejtësisë, por edhe partnerët më të gjerë të shërbimeve shëndetësore dhe sociale dhe koordinimin të këtyre sektorëve.

## METODOLOGJIA E MANUALIT

### Qëllimi i Manualit është i dyfishtë:

- Të sigurojë udhëzime praktike për policinë (audiencia kryesore) për të mundësuar një reagim efektive dhe të ndjeshme në aspektin gjinor ndaj dhunës ndaj grave dhe vajzave duke ndarë mësimin që promovon një kulturë reflektimi dhe të mësuarit, që çon në transformim institucional;
- Të promovojë një shërbim policor që kërkon të balancojë efektivitetin me llogaridhënien në reagimin e tyre ndaj dhunës ndaj grave dhe vajzave përmes rishikimit, vlerësimit dhe monitorimit të mjeteve hetimore, strategjive, politikave dhe qasjeve, me mbështetjen e akterëve të jashtëm të shoqërisë civile, organizatave të grave dhe të mbijetuarave dhe akademisë.

### Teoria e ndryshimit

Manuali kërkon të frymëzojë ndryshimin e sjelljes drejt policimit të orientuar kah parandalimi **i përgjegjshëm ndaj gjinisë, i informuar ndaj traumave dhe i fokusuar tek kryerësit.**

Për të arritur në këtë ndryshim të dëshiruar të sjelljes, Manuali do të kërkojë të ofrojë udhëzime transformuese drejt tri rezultateve:

- Modernizimi i organizatës policore është i përgjegjshëm në aspektin gjinor dhe konsultohet gjerësisht;
- Policia siguron mirëqenien dhe pjesëmarrjen kuptimplotë të viktimave/të mbijetuarave kur koordinon reagimin e tyre ndaj DHGV-së në vazhdimësinë e drejtësisë;
- Hetimet për dhunën ndaj grave dhe vajzave janë të standardizuara dhe me mbikëqyrje të brendshme, në

mënyrë që ato të jenë të fokusuar tek kryerësit dhe të informuara për traumat.

Manuali propozon tri strategji policore për të ndihmuar në arritjen e këtyre rezultateve. Këto strategji synojnë të vendosin drejtuesit e mesëm të policisë në një pozicion më të fuqishëm të agjencisë ndryshuese. Ato përfshijnë si në vijim:

- Angazhimin proaktiv me palët e jashtme të interesit siç janë organizatat e shoqërisë civile, akademia, grupet e prekura dhe akterët mbështetës ndërkombëtarë për reagim të informuara ndaj DHGV-së;
- Standardizimin dhe kontrollin e brendshëm, në mënyrë transparente, të kompetencave dhe aftësive për hetim në mënyrë që ato të jenë të përqendruara në viktima dhe të bazuara në të drejta;
- Aftësimin dhe arsimin për parandalimin dhe hetimin e DHGV-së në mënyrë që përgjigjet të jenë të bazuara në të drejta, të përgjegjshme ndaj gjinisë dhe të informuara për traumat.

Duke synuar kryesisht drejtuesit e mesëm të policisë,<sup>13</sup> Manuali do të synojë të arrijë një grup modelesh që do të frymëzojnë ndryshimin nga vartësit, duke u mbështetur në studimet e fundit të asaj që funksionon nga modelet e shkencës së ndryshimit të sjelljes. Manuali mund të përdoret në mënyrë të njëjtë për të angazhuar drejtuesit e lartë dhe ata që reagojnë në vijën e parë dhe mund të përdoret në akademitë e policisë për të plotësuar plan-programet e vazhdueshme të trajnimit. Audienca dytësore do të përfshijë shoqërinë civile dhe organizatat e grave dhe mekanizmat mbikëqyrës kombëtarë, siç janë institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut, si dhe subjektet e OKB-së.

Siç është cekur në PSHTH, një reagim i cilësisë së lartë nga policia dhe drejtësia duhet të jetë në dispozicion dhe i arritshëm për të gjitha gratë dhe vajzat, veçanërisht ato që janë më të marginalizuara dhe janë në rrezik më të madh të përjetojnë dhunë. Ofruesit e këtyre shër-

bimeve duhet të demonstrojnë se ata, dhe sistemet në të cilat ata veprojnë, janë të përkushtuar për të siguruar që ankesa e një gruaje apo vaje të merret seriozisht dhe se ajo mbështetet ndërsa përipiqet të lundrojë në një sistem drejtësie shpesh kompleks.

Kapitujt e mëposhtëm në këtë Manual synojnë t'u japin drejtuesve të policisë udhëzime nga kolegët për ofrimin e reagimeve cilësore hetimore. Për ta bërë këtë, Manuali do të imitojë kornizën e PSHTH-së të propozuar në Modulin e tij 3 për *Drejtësinë dhe Policimin* duke paraqitur udhëzime operacionale për zyrtarët policor në këto fusha: strategjitë e parandalimit; kontaktin fillestar me policinë; një hetim të përgjegjshëm gjinor; konsideratat e sigurisë dhe mbrojtjes; kërkohet mbështetje dhe ndihmë; strategjitë e komunikimit dhe zgjidhjet e bazuara në koordinim. Duke pasur parasysh kontekstin e pandemisë COVID-19, Manuali përfshin gjithashtu udhëzime mbi reagimin ndaj dhunës ndaj grave dhe vajzave gjatë krizave, përfshirë pandemitë.

Çdo kapitull i Manualit do të përfshijë nënseksione që do të ofrojnë qartësi në përkufizime dhe korniza të punës dhe do të propozojnë kompetencat e drejtuesve të policisë të nevojshme për një shërbim efektiv dhe efikas policor, si dhe rekomandime mbi treguesit kryesorë të performancës dhe identifikimin e boshllëqeve të kapaciteteve. Manuali është unik në fokusin e tij në udhëzimet konkrete si për zbatim ashtu edhe për vlerësim.

Udhëzimet operacionale nga kolegët do të ofrohen gjithashtu në të gjithë kapitujt për policinë në pozita udhëheqëse. Ky udhëzim do të përqendrohet në atë që një zyrtar policor mund dhe duhet të kontrollojë në pozitën e tij/saj udhëheqëse ose mbikëqyrëse kur zyrtarët policor që reagojnë ballafaqohen me një incident të DHGV-së.

Raste studimore do të përdoren gjithashtu për të ndihmuar në ilustrimin e inovacionit të policisë, praktikave të mira dhe përkushtimit për të siguruar llogaridhënie për krimet e DHGV-së dhe sigurinë dhe mbrojtjen e viktimave/të mbijetuarave. Së fundi, çdo kapitull do të sigurojë referenca për të informuar lexuesin për tendencat, hulumtimet dhe praktikat aktuale.

<sup>13</sup> Publiku i synuar janë drejtuesit e mesëm të policisë dhe Kapitujt 2 deri në 9 të Manualit janë zhvilluar duke pasur parasysh komandantët e stacioneve policore ose njësite.

Në përputhje me kornizën e PSHTH-së, Manuali njih shtrirjen dhe kompleksitetin e formave të dhunës të përjetuara nga gratë dhe vajzat, si dhe nevojën për një reagim dinamik të tërë qeverisë për parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e saj penale efektive.

Manuali gjithashtu njih kornizat e ndryshme ligjore kombëtare që diktojnë kërkesat në lidhje me mbledhjen e provave dhe larminë e konteksteve sociale, kulturore dhe ekonomike brenda këtyre juridiksioneve të njëjta që ndikojnë si në sjelljen e policisë, ashtu edhe në pozicionet e ndjeshmërisë së grave dhe vajzave ndaj dhunës dhe krimit.

Si një mjet për të përfshirë këtë kompleksitet dhe diversitet, kapitujt e mëposhtëm synojnë të përforcojnë standardet dhe normat ndërkombëtare që mbështesin standardet minimale të zbatueshme për të gjitha teknikat e hetimit policor në rastet që përfshijnë DHGV-në.<sup>14</sup> Manuali gjithashtu do t'i referojë lexuesit në procedurat kombëtare të hetimit, përfshirë protokollet e sigurisë së viktimave/të mbijetuarave, si dhe protokollet e njohura ndërkombëtarisht dhe praktikën më të mira për udhëzime të specializuara dhe më gjithëpërfshirëse të policisë.

Udhëzimet e ofruara në këtë Manual duhet të shihen dhe zbatohen në një *mënyrë plotësuese* në mbështetje të plotë të udhëzimeve, protokolleve dhe manualeve kombëtare për të gjithë akterët qeveritarë përgjegjës për vazhdimësinë e drejtësisë.

---

<sup>14</sup> Ndonëse disa aspekte të policimit të ndjeshëm ndaj gjinisë në lidhje me fëmijët trajtohen në tërë këtë Manual, është e rëndësishme të theksohet se korniza ligjore ndërkombëtare e zbatueshme për fëmijët është e ndryshme nga ajo për gratë dhe të rriturit në përgjithësi. Prandaj, një qasje e ndjeshme ndaj fëmijës dhe gjinisë dhe rrjedhimisht trajtimi i diferencuar duhet të drejtohet vetëm tek fëmijët, të definuar nga *Konventa për të Drejtat e Fëmijëve* si çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeçare. Djemtë dhe vajzat duhet të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga mbrojtja e veçantë e siguruar nga e drejta ndërkombëtare, në përputhje me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) 16.2 për t'i dhënë fund të gjitha formave të dhunës kundër fëmijëve. Për udhëzime të mëtejshme për të drejtat e fëmijëve që mund të shërbejnë si referenca shtesë për profesionistët në këtë fushë (p.sh *Strategjitë Model të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe Masat Praktike për Eliminimin e Dhunës ndaj Fëmijëve në Kontekstin e Parandalimit të Krimit dhe Drejtësisë Penale, 2015, Programi i Trajnimit i UNO-DC-UNICEF për Trajtimin e Viktimave Fëmijë dhe Dëshmitarëve Fëmijë të Krimit për Zyrtarët e Zbatimit të Ligjit*).



# BËRJA E NDRYSHIMIT SI DREJTUES DHE UDHËHEQËS I EKIPIT

*“Ekziston një e vërtetë e përgjithshme, e zbatueshme për të gjitha vendet,  
kulturat dhe komunitetet:  
Dhuna ndaj grave nuk është asnjëherë e pranueshme, asnjëherë e falshme,  
asnjëherë e tolerueshme.”*

**Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara Ban Ki-Moon (2008)**

---

# QËLLIMI I KAPITULLIT

---

**Të përforcojë perspektivën strategjike të policisë për të vënë në funksion kornizën e PSHTH-së në mënyrë që të sigurohet që të gjitha viktimat/të mbijetuarit e DHGV-së të kenë qasje cilësore në shërbime thelbësore dhe të koordinuara.**

---

## Mesazhet kryesore dhe pikat mësimore

- Kuptimi i asaj që është në zemër të një reagimi efektiv ndaj DHGV-së;
- Parimet e Kornizës së PSHTH-së dhe karakteristikat e përbashkëta përbëjnë thelbin e pjesëmarrjes kuptimplotë të viktimës/të mbijetuarit në hetimin e DHGV-së;
- Policimi i përgjegjshëm në aspektin gjinor do të thotë që fokusi hetimor mbetet në veprimet e kryerësit të dyshuar të dhunës, jo në karakterin, sjelljen ose besueshmërinë e viktimës/të mbijetuarës;
- Aktet e DHGV-së janë veçanërisht të prira për paragjykime gjinore të policisë, të cilat mund të minojnë përpjekjet e ekipit për të reaguar në mënyrë efektive ndaj saj;
- Reaguesit e parë të policisë dhe zyrtarët ndërlidhës me komunitetin duhet të mbështeten me mesazhe të qëndrueshme nga drejtuesit se aktet e DHGV-së nuk do të tolerohen dhe do të merren seriozisht;
- Planifikimi operacional duke përfshirë analizën e përgjegjshme dhe ndërlidhëse në aspektin gjinor do të ndihmojë në luftimin e përforcimit të praktikave diskriminuese të së kaluarës;
- Mbledhja e të dhënave dhe treguesit e ndarë sipas gjinisë janë kritike për të reaguar ndaj DHGV-së;
- Angazhimi për një qasje të përqendruar te viktimat do të krijojë më shumë besim dhe bashkëpunim me viktimat/të mbijetuarat e DHGV-së.





# HYRJE

Objektivi i këtij kapitulli është të sigurojë një kontekst për udhëzimet e përcaktuara në Manual që synon drejtuesit e mesëm të policisë me përgjegjësi komanduese operacionale mbi zyrtarët policor që reagojnë në rastet e DHGV-së. Si pjesë e qëllimit të përcaktimit të kontekstit, kapitulli do të synojë të përforcojë pikëpamjen strategjike të drejtuesit të mesëm për të ndihmuar në zbatimin ose operacionalizimin e kornizës së ofruar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara Paketa e Shërbimit Thelbësor për Gratë dhe Vajzat që i nënshtrohen Dhunës - Elementet Themelore dhe Udhëzimet për Cilësinë ('PSHTH'). Korniza e PSHTH-së synon t'u sigurojë të gjithë viktimave/të mbijetuarave të DHGV-së qasje më të madhe në shërbimet thelbësore dhe të koordinuara të policisë, drejtësisë dhe mbështetjes.

Foto kurtuazie nga MINUSTAH/Logan Abassi (Haiti)

Ky udhëzim synon të jetë transformues në natyrë, që do të thotë se kërkon të frymëzojë drejtuesit e mesëm të policisë që të jenë nxitës të proceseve që do t'i kthejnë marrëdhëniet e pabarabarta gjinore në kultura të pushtetit të përbashkët, kontroll të burimeve, vendimmarrje dhe mbështetje për fuqizimin e grave në policimin e përditshëm.

Për të arritur këtë, kapitulli do të prezantojë dhe përcaktojë shumë kushte kryesore dhe do të diskutojë sesi këto kushte, kur aplikohen, kontribuojnë ose pakësojnë transformimin drejt policimit të përgjegjshëm në aspektin gjinor dhe përpjekjeve të përgjithshme drejt formimit të një organizate policore moderne. Këto kushte janë të përfshira në tërë Manualin në mënyrë që të sigurojnë kontekst për drejtuesit e mesëm.

Kapitulli gjithashtu do të prezantojë parimet dhe karakteristikat e përbashkëta të kornizës së PSHTH-së, të cilat formojnë thelbin e udhëzimit të dhënë. Këto parime dhe karakteristika të përbashkëta do të përfshijnë kom-

petencat kryesore dhe grupet e shkathtësive të buta që do të promovohen në tërë Manualin, pasi ato janë të përgjegjshme ndaj gjinisë dhe të bazuara në të drejta. Gjithashtu do të jepen udhëzime nga kolegët policë dhe shembuj të treguesve për të ndihmuar në zbatimin dhe monitorimin e kompetencave të propozuara dhe grupeve të shkathtësive të buta.


Kompetencat kryesore dhe grupet e shkathtësive të buta të promovuara në Manual rezultojnë nga një studim me përmasa globale, në të cilin u anketuan ose intervistuan policë të shumtë në shërbim dhe që nuk shërbejnë, së bashku me ekspertë në fushën e gjinisë, përfshirë dhunën me bazë gjinore/dhunën kundër

*Liderët përcaktohen sipas ndjekësve tyre. Drejtuesit kompetenca teknike dhe njerëzore që të tjerët i respektojnë dhe admirojnë*



grave dhe vajzave që punojnë në polici. Informacioni i mbledhur u vlerësuar kundrejt rekomandimeve të performancës të marra nga organizatat policore që rishikojnë dhe vlerësojnë strategjitë, qasjet dhe mjetet e tyre për të reaguar ndaj DHGV-së.

Rastet studimore të rishikimeve dhe vlerësimeve të tilla policore u përzgjedhën posaçërisht për Manualin në kapitujt në vijim sepse ato demonstrojnë një angazhim për llogaridhënie duke përfshirë palët e jashtme të interesit, siç janë organizatat e shoqërisë civile, organizatat e grave, si dhe akademienë dhe/ose grupet minoritare në këto procese. Këto raste studimore u përzgjedhën edhe për transparencën e tyre, pasi ato ishin të disponueshme në internet me burim të hapur.



## UDHËZIMET NGA KOLEGËT

Ju mund të jeni përgjegjës për një stacion policor, departament ose rajon të policisë, që do të thotë se ju keni përgjegjësinë e përgjithshme dhe jeni përgjegjës për reagimin policor të stafit tuaj ndaj grave dhe vajzave që kanë përjetuar DHGV. Pse është e rëndësishme të trajtohen krimet e tilla? Ju do të keni një numër prioritetesh konkurruese për burimet tuaja të kufizuara, prandaj është e rëndësishme që shërbimi që ju ofroni për komunitetet lokale të jetë sa më efektiv që të jetë e mundur. Pa besimin dhe mirëbesimin e komuniteteve lokale, puna juaj si zyrtar policor bëhet më e vështirë dhe rezultatet e suksesshme janë më sfiduese për t'u arritur.

**“Grave refugjate u mohohet në mënyrë rutinore trajtimi mjekësor, shpesh poshtërohen kur hyjnë në spitale dhe injorohen nga policia nëse ankohen.”**

Rasti studimor: Mbështetja e të mbijetuarave aziatike, zezake, të pakicave, etnike dhe refugjate (Imkaan, MB)

Shumica e studimeve nacionale mbi shtrirjen e dhunës ndaj grave dhe vajzave tregojnë se shumica e grave nuk i raportojnë përvojat e tyre tek shërbimet zyrtare. Vetëm një pakicë e rasteve të DHGV-së raportohen ndonjëherë në polici. Vetëm një përqindje e vogël e këtyre rasteve rezu-



Foto kurtuazie nga Force International (Bangladesh)

ltojnë në ngritjen e akuzave kundër kryerësve të dhunës dhe akoma më pak raste rezultojnë në dënime. Sipas një raporti të vitit 2015 të publikuar nga DOKBÇES<sup>1</sup>, në shumicën e vendeve me të dhëna në dispozicion, vetëm 40 % e grave kërkojnë ndihmë të çfarëdo lloji pasi përjetojnë dhunë. Në mesin e atyre që e bëjnë këtë, shumica shikojnë kah familja dhe miqtë, dhe jo kah institucionet dhe mekanizmat zyrtarë për të siguruar këtë mbështetje. Më pak se 10 % e atyre grave që kërkojnë ndihmë pasi kanë përjetuar dhunë, kërkojnë ndihmë nga policia.

Ngurrimi për të raportuar incidentet dhe për të kërkuar ndihmë mund të jetë për shkak të pranueshmërisë së gjerë të DHGV-së, e lidhur edhe me ‘fajësimin dhe turpërimin’ që përjetojnë shumë të mbijetuara që i nënshtrohen një dhune të tillë dhe mungesës së besimit se ankesa e tyre nuk do të merret seriozisht. Mund të jetë gjithashtu për shkak të mungesës së njohurive për shërbimet dhe/ose të drejtat në dispozicion nga ana e grave dhe vajzave.

Nën-raportimi është veçanërisht i theksuar në mesin e grupeve të caktuara që përballen me pengesa dhe diskriminim shoqëror, duke i vënë ato në rrezik më të lartë për të përjetuar dhunë. Për shembull, barrierat e komunikimit të përjetuara nga gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara të caktuara që mund të ndikojnë në shikimin, dëgjimin apo edhe kuptimin e tyre, i bëjnë ato veçanërisht të ndjeshme ndaj atyre që besojnë se nuk do të jenë në gjendje të ankohen.<sup>2</sup>

1 Shih [https://unstats.un.org/unsd/gender/downloads/World-Women2015\\_report.pdf](https://unstats.un.org/unsd/gender/downloads/World-Women2015_report.pdf)

2 Shih ‘Studim tematik për çështjen e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe aftësisë së kufizuar. Raporti i Komisionit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut’ (A/HRC/20/5)

Figura 1:

Përkufizimi i dhunës ndaj grave<sup>3</sup>

### DHUNA ME BAZE GJINORE

Dhuna ndaj gruas është e bazuar në gjini për shkak se është krijuar nga mos bilanci i fuqisë mes gruas dhe meshkujve dhe besimit të ngushtë së si duhet të sillet një femer dhe një mashkull.

### VUAJTJA E GRUAS

Shumica dërmuese e dhunës së bazuar në gjini kryhet nga meshkujt kundrejt gruas. Ka mundësi që dhuna gjithashtu të ndjehet nga meshkujt nga gjinia femërore por rastet janë shumë të rralla.

## Çka është dhuna kundër gruas ?

“ Dhuna ndaj grave është:

çdo akt dhune me bazë gjinore që rezulton ose ka të ngjarë të rezultojë në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale ose psikologjike për gratë... qoftë në publik apo private ”

Kuvendi Përgjithshëm Kombeve të Bashkuara 1993

### DËMTIMI FIZIK, SEKSUAL APO PSIKOLOGJIK

Dhuna kundrejt grave mund të jetë në shumë forma, përfshirë abuzimin fizik, abuzimin seksual dhe psikologjik ose abuzimin emocional.

### NDODH NË PUBLIK APO NË JETËN PRIVATE

Çdo lloj dhunës kundrejt gruas është i papranueshëm dhe duhet të ndalet, pa marrë parasysh se ku ka të ngjarë të ndodh ajo në një vend publik ose në vend privat.

Policimi ka të bëjë me ofrimin e sigurisë për komunitetet lokale. Kjo arrihet duke punuar me dhe për komunitetet, duke ndërtuar besimin, respektuar ligjin, parandaluar krimet, reagu ndaj emergjencave, ofruar shërbime mbështetëse dhe duke ruajtur shoqëritë paqësore. Për të qenë vërtet efektive, policia ka nevojë për mbështetjen e komuniteteve lokale, duke u mundësuar atyre që të marrin informacion dhe inteligjencë kritike për hetimin dhe parandalimin e suksesshëm të të gjitha krimeve.

Gratë dhe vajzat janë shtylla kryesore e shumë komuniteteve. Nëse nuk keni besimin dhe besueshmërinë e gjithë popullsisë tuaj lokale, sa informacione dhe inteligjencë potenciale ju mungojnë dhe sa efektiv mund të jeni në rezultat? Informacioni dhe inteligjenca me kohë, e saktë, e qasshme dhe e besueshme do t'ju ndihmojë në luftën tuaj kundër të gjitha krimeve, përfshirë format e shumta të krimit të organizuar dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm. Prandaj, përfi-

timet e stafit tuaj për të reagu ndaj krimeve të DHGV-së nuk duhet të nënvlerësohen.

Zyrtarët policor kanë detyrë etike për të mbrojtur të drejtat e të gjitha viktimave/të mbijetuarave, pavarësisht nga prejardhja e tyre. Duke pasur parasysh që komunitetet shpesh janë shumë të ndryshme, është e rëndësishme që qasja e policimit të jetë e ndjeshme dhe e përgjegjshme ndaj këtij diversiteti. Kjo përfshin të kuptuarit se, brenda komuniteteve ka shumë individë

*Drejtuesit mund të frymëzojnë ndjekësit e tyre. Ata kanë kompetenca teknike dhe njerëzore që të tjerët t'i respektojnë dhe admirojnë.*

<sup>3</sup> Deklarata për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave (Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 48/104 e 20 dhjetorit 1993), Nenet 1-2.

të cilët përjashtohen dhe marginalizohen në mënyra të shumëfishta dhe ndërlydhura dhe për këtë arsye, siç u cek më lart, janë në rrezik të shtuar për të përjetuar dhunë.

Për shembull, individët dhe grupet mund të marginalizohen në bazë të faktorëve të ndryshëm, siç janë gjinia, mosha, përkatësia etnike, orientimi seksual, origjina kombëtare dhe/ose aftësia e kufizuar dhe kjo mund të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në qasjen e tyre në mbrojtje, siguri dhe drejtësi. Në mënyrë që të sigurohet respektimi i dinjitetit dhe privatësisë së të gjithë viktimeve/të mbijetuarve dhe mbrojtja dhe siguria e tyre fizike dhe emocionale, zyrtarët policor duhet të jenë të kujdesshëm dhe të ndjeshëm ndaj përvojave dhe rrethanave të ndryshme të një individi.<sup>4</sup>

Prandaj, është e rëndësishme që ju dhe stafi juaj të kuptoni përbërjen komplekse të komuniteteve tuaja lokale, në mënyrë që të kuptoni faktorët e ndryshëm që mund të kontribuojnë në DHGV.

Sa vende të ndryshme të origjinës përfaqësohen në rajonin tuaj të policisë? A keni një kuptim pune se si marrëdhënia e një viktime/të mbijetuarve me traditat, besimin dhe/ose kulturën mund të ndikojë në të gjitha aspektet e jetës së tyre, përfshirë nëse ato kërkojnë ndihmë? Nëse jo, si mund të siguroheni që stafi juaj po ofron një shërbim efektiv policor? A e kuptoni profilin e

viktimeve/të mbijetuarve të krimit? A mund të ndahen të dhënat e viktimeve/të mbijetuarve sipas llojit të krimit, gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, aftësisë së kufizuar, fesë, përkatësisë dhe lokalitetit? Për shembull, do t'ju duhen të dhëna të qëndrueshme për të përcaktuar nëse ekziston një çekuilibrë ndërmjet nevojave të mundshme të viktimeve/të mbijetuarve dhe disponueshmërisë së zyrtarëve të trajnuar sa duhet.

Manuali nje ndikimin pozitiv që lidhshipi cilësor mund të ketë te viktimat/të mbijetuarat përmes koordinimit efektiv të shërbimeve shumë-sektoriale. Ky kapitull siguron një bazë për të kuptuar më mirë qasjet, aftësitë dhe kompetencat kryesore që janë njohur nga organizatat policore dhe ekspertët e tjerë që punojnë në këtë fushë si pjesë integrale e transformimit drejt një shërbimi policor më efektiv dhe më të përgjegjshëm ndaj gjinisë si rezultat i reflektimit institucional dhe të mësuarit.

Në të njëjtën kohë, qasjet, grupet e aftësive dhe kompetencat e propozuara në këtë kapitull, dhe në tërë Manualin, do të pasqyrojnë **parimet** e kornizës së PSHTH-së që mbështesin të gjitha shërbimet thelbësore të policisë dhe drejtësisë (shih Figurën 2). Udhëzimet e dhëna nga Manuali do t'i referohen gjithashtu **karakteristikave të përbashkëta** (shih gjithashtu Figurën 2), të cilën PSHTH e përshkruan si bazë për të gjitha aktivitetet dhe qasjet në të gjitha fushat e funksionimit dhe ofrimit të shërbimeve thelbësore.

**Figura 2.**

**Paketa e Shërbimeve Thelbësore: Diagrami i Përgjithshëm i Kornizës**

<b>Parimet</b>	një përjasje e bazuar në te drejtë	avancimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave	E ndjeshme nga ana kulturore dhe e përshtatshme për moshën
	Qasja me në qendër të viktimeve/të mbijetuarit	siguria është parësore	përgjegjësia e autorit
<b>Karakteristikat e përbashkëta</b>	disponueshmëri / vlefshmëri	aksesueshmërisë	
	përshtatshmëria	përshtatshmërisë	
	jepni prioritet sigurisë	miratim i informuar dhe konfidencialiteti	
	mbledhjen e të dhënave dhe menaxhimin e informacionit	Komunikim efektiv	
	lidhjen me sektorë dhe agjenci të tjera nëpërmjet referimit dhe koordinimit		

[Essential Services Package: Overall Framework Diagram](#)

4 Shih shënimin 2.

Respektimi i parimeve të kornizë së PSHTH-së dhe karakteristikave të përbashkëta do të jenë në qendër të sigurimit të **pjesëmarrjes kuptimplotë** të viktimës/të mbijetuarës në hetimin e krimeve të DHGV-së. Nuk do të jetë vetëm një faktor përcaktues në vetë hetimin, por gjithashtu do të dërgojë një mesazh kritik për komunitetet se policia po merr seriozisht raportet e viktimave/të mbijetuarave duke përdorur një qasje të përqendruar në viktimën/të mbijetuarën kur shfaqen pretendimet për DHGV. Si rezultat, viktimat/të mbijetuarat, komunitetet e tyre dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve thelbësore do ta shikojnë organizatën tuaj me një legjitimitet më të madh, në drejtim të ndërtimit të besimit dhe nxitjes së partneriteteve në reagimin ndaj krimeve në përgjithësi.

Është e rëndësishme që policia të bëhet pjesë e zgjidhjes ku viktimat/të mbijetuarat dhe komunitetet e tyre të ndihen të fuqishëm për të komunikuar pritshmëritë dhe nevojat e tyre në lidhje me qasjen në drejtësi në rastet që përfshijnë DHGV-në. Rritja e besimit përmes fuqizimit do të nënkuptonte, për shembull, që viktimat/të mbijetuarat e dhunës nga partneri intim ('DHPI') do të kishin më shumë gjasa të raportonin raste dhe të paraqisnin prova në gjykatë.<sup>5</sup>

Për qëllimet e Manualit, *reagimi ndaj DHGV-së* dhe krimeve të tjera përfshin veprimet parandaluese dhe hetimore të ndërmarra nga policia.

## SFIDAT E PËRBASHKËTA TË BRENDSHME PËR POLICINË KUR REAGOJNË NDAJ DHGV-SË

*"Një nga shkaqet themelore të përhapura të dështimeve kritike të policisë në hetimet e grave të zhdurka ishte mungesa e një përkrahësi institucional. Unë përdor frazën një 'dëshirë' të lidhshme, për të theksuar pikën: hetimet kërkojnë lidhshme; lidhshmi donte. Ndërsa unë gjithashtu përdor frazën "mungesa e lidhshmit" sepse rrjedh më lehtë, nuk ka të njëjtën fuqi. Problemi ishte aq i përhapur*

5 Nathan Birdsall, Stuart Kirby dhe Michelle McManus (2017), 'Policia – angazhimi i viktimës në ndërtimin një qasje të fuqizimit të viktimës në rastet e dhunës nga partneri intim' (Praktika dhe Hulumtimi Policor, 18:1, 75-86) dhe Roberts, J., dhe Hough, M. (2005), 'Të kuptuarit e qasjeve publike ndaj drejtësisë penale', (Maidenhead: Open University Press).

*sa nuk ishte thjesht një çështje kompetence; kishte mungesë të lidhshmit."*<sup>6</sup>

I nderuari Wally T. Oppal, QC, Komisioner, nga raporti i tij 'TË HARRUARA - Raporti i Komisionit Hetimor për Gratë e Pagjetura.

**"Kur [një grua] shkon në polici, ata së pari i kërkojnë asaj letërnjoftimin dhe i bëjnë pyetje: si, pse, çfarë ... Në fillim, ata sillen sikur ajo është përgjegjëse për atë që i ndodhi. "**

Femër, e moshës 38-55 vjeçare, e prekur nga konflikti, urbane, Republika Srpska, Bosnjë dhe Hercegovinë

Burimi: Sondazhi i drejtuar nga OSBE për dhunën ndaj grave: Raporti kryesor (OSBE, Vjenë, 2019).

Reagimi i joadekuat nga organet e zbatimit të ligjit është ende një nga sfidat kryesore për eliminimin e DHGV-së, duke çuar në nivele të larta të mosndëshkimit të kryerësve të dhunës, shpërndarje të pamjaftueshme të burimeve për t'iu përgjigjur në mënyrë të duhur nevojave të viktimave/të mbijetuarave, dhe monitorim dhe koordinim të dobët të iniciativave të përcaktuara për të trajtuar këtë çështje.

Një përvojë e keqe për një viktimë/të mbijetuar mund të rrezikojë rëndë besimin dhe besueshmërinë e një komuniteti të tërë në polici dhe mund ta bëjë reagimin ndaj DHGV-së më të vështirë.

Mbretëria e Bashkuar ('MB') ofron përvoja të kuptueshme të të mësuarit bazuar në praktikën e tyre të rishikimit të efektivitetit të qasjeve të tyre ndaj DHGV-së.

Në vitin 2013, Sekretari i Brendshëm i Mbretërisë së Bashkuar urdhëroi Inspektoratin Policor të Madhërisë së Saj (IPMS)<sup>7</sup> për të kryer një inspektim mbi reagimin e policisë ndaj dhunës në familje ('DHF') pas një sërë rastesh të profilit të lartë ku mbrojtja për viktimat kishte rënë nën standardet e pritura. Lista e mëposhtme, e frymëzuar nga

6 VOLUME IIB, 'Askush: Si dhe pse kemi dështuar me gratë e pagjetura dhe të vrara, pjesa 3, 4 dhe 5' (British Columbia, Kanada, 2012).

7 Në verën e vitit 2017, IPMS ndërmori inspektime të shërbimeve të zjarrfikjes dhe shpëtimit të Anglisë, duke vlerësuar dhe raportuar mbi efikasitetin, efektivitetin dhe lidhshmit e tyre. Për të pasqyruar këtë rol të ri, IPMS iu nënshtrua një ndryshimi të emrit në Inspektorati Policor dhe Shërbimeve të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit i Madhërisë së Saj ('IPSHZSHMS').

**“Unë mendoj se [gratë] nuk i drejtohen institucioneve sepse nuk u besojnë atyre. Unë kurrë nuk kam dëgjuar për një rezultat pozitiv; kurrë nuk kam dëgjuar për një grua që të ndihmohet nga një institucion. Unë nuk kam besim tek ata.”**

Femër, e moshës 30-50 vjeçare, rurale, Mali i Zi

Burimi: Sondazhi i udhëhequr nga OSBE për dhunën ndaj grave: Raporti kryesor (OSBE, Vjenë, 2019).

gjetjet e raportit përfundimtar të IPMS-së për vitin 2014,<sup>8</sup> nxjerr në pah disa nga dështimet emblematike organizative që, kur lihen të pa adresuara nga drejtuesit e policisë, janë tregues të një reagimi joefektive ndaj DHF-së dhe formave të tjera të DHGV-së:

- Ekipet e larta drejtuese nuk ishin në gjendje të artikulonin një strategji gjithëpërfshirëse për trajtimin e DHGV-së dhe, si rezultat, ofruan objektiva të paarrtshme për drejtuesit e mesëm dhe burime të pamjaftueshme për të vepruar në mënyrë të pavarur dhe më efektive;



***Lidershipi fokusohet në të qenit proaktiv dhe ndërtimin e partneriteteve për të adresuar mungesën e burimeve.***

- Ekipet drejtuese, edhe pse të vetëdijshëm për çështje të veçanta ose boshllëqe në strategjitë e tyre ekzistuese, nuk ndërmorën veprime për t'i adresuar ato. Kjo përfshin tolerimin e komenteve nënçmuese të bëra nga zyrtarët për njerëz ose grupe njerëzish të caktuar;<sup>9</sup>
- Zyrtarët komandues të nivelit të lartë dhe të mesëm nuk ishin të trajnuar në mënyrë adekuate për ligjet e reja që ndikojnë drejtpërdrejt në strategjitë dhe procedurat e hetimit të policisë për parandalimin e DH-

8 Shihni ‘Çështja e të gjithëve: Përmirësimi i reagimit të policisë ndaj abuzimit në familje’ (IPMS, 2014).

9 Komenteve nënçmuese, veçanërisht për gratë, priren të bëhen më të përhapura kur ligjet kombëtare që mbështesin barazinë gjinore bëhen pjesë e debatit më të gjerë publik. Pikërisht gjatë kësaj periudhe drejtuesit e policisë duhet të reagojnë ndaj komenteve të tilla të bëra brenda radhëve të tyre dhe të jenë më proaktiv, duke shpjeguar sesi legjislacioni i ri synohet të zbatohet dhe mbrojtë gratë dhe vajzat.

GV-së. U bë e domosdoshme që drejtuesit e policisë të trajnohen se si ata dhe stafi i tyre pritet të zbatojnë ligjet e reja që adresojnë barazinë gjinore dhe të promovojnë hetimet e fokusuara tek kryerësit e dhunës;

- Ndonëse ishte e qartë se vëllim i krimit është me prioritet, pak komandantë të policisë ishin në gjendje të jepnin një mesazh të qartë strategjik se si duhet trajtuar DHGV-në dhe standardet minimale të cilësisë së nevojshme për një reagim efektiv ndaj viktimave/të mbijetuarave të DHGV-së;
- Dëshmia që DHGV nuk ishte me prioritet zbulohet në mënyrën se si zyrtarët policor të vijës së parë (ose reaguese) ishin informuar dhe u ishin caktuar detyrat;
- Strukturat organizative të fragmentuara dhe të kuptuara dobët, njësitë dhe departamentet lanë stafin e vijës së parë me njohuri të kufizuara se kush në organizatë është përgjegjës dhe llogaridhënëse për hetimet efektive të DHGV-së, ndjekjen penale dhe sigurinë e viktimave/të mbijetuarave;
- Edhe atje ku jepen mesazhe dhe caktohen prioritetet të fuqishme në krye të organizatës, kultura e rrënjësor e menaxhimit të performancës nënkuptonte se zyrtarët policor të të gjitha gradave fokusoheshin në vëllimin e krimit e jo në abuzimin në familje, siç është dhuna ndërpersonale;
- Një shkallë e ‘vizionit të tunelit’ u shfaq nga komandantët e policisë, të cilët u përqendruan më shumë në krimin e vetëm dhe menaxhimin e autorëve të krimit se sa në ndërlidhjen e krimeve të DHGV-së me aktivitete të tjera të mundshme kriminale dhe të mbanin viktimën/të mbijetuarën të sigurt;
- Mungesa e mbikëqyrjes mbi mënyrën se si policia i drejtoi referimet e tyre ka parandaluar një kuptim më të thellë se pse policia referon në mënyrë disproporcionale viktimat/të mbijetuarit tek shërbimeve sociale në vend që të lehtësojë qasjen e tyre në mjetet juridike;

Një nga mesazhet kryesore nga raporti i IPMS-së për vitin 2014 për drejtuesit e policisë është të sigurojnë, si për krimet e tjera, që **fokusi të mbetet në veprimet e**



**Zbatimi i ligjit në mënyrë të qëndrueshme dhe të paanshme është strategjia më efektive e parandalimit të krimit që mund të ofrojë policia.**

**kryerësit të dyshuar, jo në karakterin, sjelljen ose kredibilitetin e viktimës.<sup>10</sup>**

Raporti shton se ndonëse theksi hetimor është fokusuar historikisht në sjelljen e viktimës/të mbijetuarës, realiteti i krimeve që përfshijnë DHGV-në është se kryerësi i dyshuar është shpesh i njohur për viktimën/të mbijetuarën dhe kështu mund të identifikohet lehtë nga policia. Kjo, në teori, duhet t'i lejojë policisë të bazojë hetimin në veprimet e kryerësit të dyshuar, i cili duhet të jetë po aq i arritshëm për policinë hetuese sa vetë viktimat/e mbijetuara.

Në pjesën më të madhe, dhe duke përjashtuar shpërndarjen e gjerë të burimeve, sfidat e brendshme me të cilat përballen organizatat policore, siç janë ato të përmendura më sipër, mund të ndikohen pozitivisht nga drejtuesit e mesëm brenda organizatës. Duke qenë në një pozitë të tillë të përgjegjësisë dhe udhëheqjes komanduese, drejtuesit e mesëm në thelb lidhin politikën organizative me praktikën operacionale dhe kështu janë përgjegjës si për hetuesit ashtu edhe për hetimet.

Zbutja e ndikimeve të zakonshme që rrjedhin nga sfida të tilla të brendshme kur reagohej ndaj krimeve të DHGV-së, mund të gjurmohet në pjesën më të madhe në drejtuesit e policisë, përfshirë ata në menaxhmentin e mesëm. Shembuj të veprimeve zbutëse përfshijnë, por nuk kufizohen si në vijim:

- ➔ Bazimi i veprimeve kolektive në një kuptim të qartë të natyrës së dhunës, shkaqeve dhe pasojave të saj dhe se si ajo ndikon tek gratë dhe vajzat në mënyrë të ndryshme dhe në mënyrë disproporcionale;
- ➔ Të qenit aktiv në sigurimin e llogaridhënies për pjesëmarrjen kuptimplotë të viktimës/të mbijetuarës në hetim kur pretendohet se ka ndodhur DHGV;

<sup>10</sup> Shih shënimin 9.

- ➔ Sigurimi që ndërhyrjet e paanshme dhe vigjilente nga zyrtarët policor që reagojnë fuqizohen nga mësimi i vazhdueshëm dhe konsultimi me grupet e prekura.

Siç u tha në raportin e IPMS-së të vitit 2014, pasojat e mos adresimit të këtyre dështimeve institucionale ose sfidave të brendshme përfundimisht do të rezultojnë në pretendime për shkelje të të drejtave civile ose të njeriut, një mungesë besimi në vetë organizatën policore dhe një mungesë të perceptuar të kredibilitetit të policisë, veçanërisht nga gratë dhe vajzat.

Mungesa e besimit dhe besueshmërisë në organizatën tuaj policore do të ndikojë në aftësinë e ekipit tuaj për të mbledhur informacionin që i nevojitet për të qenë vërtet i udhëhequr nga inteligjenca.

Zgjidhjet e bazuara në komunitet për ndërhyrjet kundër krimit, për shembull, do të dobësohen nga brishtësia e partneriteteve tuaja, veçanërisht me organizatat që përfaqësojnë persona ose grupe që ndihen të mbikëqyrtur tej mase nga policia dhe të pambrojtur.

**“Zyrtarët policor nuk i kanë vetë të gjitha njohuritë e specializuara; ata duhet të dinë se ku ta drejtojnë viktimën. Për shembull, shërbimet e specializuara për mbështetjen kundër abuzimit në familje shpesh drejtohen nga grupe e komunitetit për ZPE (Zezakët dhe Pakicat Etnike), meshkujt, dhe viktimat e LGBT-së.”**

Çështje e të gjithëve: Përmirësimi i reagimit të policisë ndaj abuzimit në familje '(IPMS, 2014).

**Shembuj të zgjidhjeve të bazuara në komunitet do të shfaqen më vonë në këtë Manual, veçanërisht në Kapitullin 3: ‘Parandalimi’, Kapitullin 5: ‘Hetimet’, Kapitullin 8: ‘Koordinimi mes agjencive të drejtësisë’ dhe Kapitullin 12: ‘Vazhdimësia e drejtësisë’.**

Si përmbledhje, sfidat e brendshme me të cilat përballen organizatat policore kur reagojnë ndaj krimeve të DHGV-së mund të zbuten në mënyrë të konsiderueshme nga lidhshmëria efektive e policisë që kupton shkaqet rrënjësore të DHGV-së dhe është i përgatitur të ‘zotërojë problemin’ dhe ta trajtojë këtë drejtpërdrejt.

duke siguruar dhe mësuar nga pjesëmarrja kuptimplotë e viktimave/të mbijetuarave në një hetim.

Lidershipi efektiv i policisë në rastet e DHGV-së gjithashtu siguron që hetimi të përqendrohet në përgjegjësinë e kryerësit<sup>11</sup> duke mbledhur sa më shumë që të jetë e mundur prova mbi kryerësin e dyshuar, ndërsa duke siguruar në të njëjtën kohë që mirëqenia e viktimës/të mbijetuarit të jetë në thelb të hetimit. Një lidhshmëri e fortë e policisë është në përputhje me parimin e rënë dakord ndërkom-bëtarisht për promovimin e sigurisë dhe fuqizimin e viktimave ndërsa sigurohet përgjegjësia e shkelësit.<sup>12</sup>

Çelësi për këtë është aftësia e drejtuesve të policisë për të krijuar dhe promovuar një kulturë dhe/ose etikë ekipore që krenohet me kompetencat kryesore dhe grupet e aftësive profesionale që dallojnë një shërbim policor të përgjegjshëm ndaj gjinisë, duke adresuar menjëherë qëndrimet negative dhe paragjykimet e pavetëdijshme që minojnë përpjekjet kolektive.

## PARAGJYKIMI GJINOR: SI MUND T’I PENGOJË PËRPJEKJET E POLICISË

**Paragjykimi gjinor** mund të përkufizohet si prirje ose paragjykim ndaj një gjinie kundrejt gjinisë tjetër.<sup>13</sup>

Paragjykimi gjinor, qoftë i nënkuptuar (i pavetëdijshëm) apo i qartë (i vetëdijshëm), formohet dhe informohet nga stereotipet dhe qëndrimet e bazuara në gjini që i caktojnë karakteristika, role dhe sjellje të ndryshme meshkujve kundrejt femrave - dhe kjo përfshin rolet dhe sjelljet seksuale.<sup>14</sup>

11 PSHTH i referohet përgjegjësisë së kryesit siç është shqiptimi i sanksioneve të përshtatshme për t’i mbajtur kryesit përgjegjës për veprimet e tyre dhe për të siguruar mjete juridike të drejta dhe efektive për viktimat/të mbijetuarit për dëmin ose humbjen e pësuar.

12 Strategjitë Model të Përditësuar dhe Masat Praktike për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave në Fushën e Parandalimit të Krimit dhe Drejtësisë Penale (Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së 65/228 (2010), shtojca, para. 13(a)).

13 Huhtanen, H., Lonsway, K.A., Archambault, J. (2017), ‘Paragjykimi Gjinor në Reagimin dhe Hetimin e Sulmeve Seksuale, Seritë e Buletinit të Trajnimit: Pjesa 1’ Koalicioni Jepi Fund Dhunës ndaj Grave

14 Po aty

*Gjinia i referohet roleve, sjelljeve, aktiviteteve dhetributeve që një shoqëri e caktuar në një kohë të caktuar i konsideron të përshtatshme për meshkujt dhe femrat.*



Aktet e sulmeve seksuale dhe dhunës ndërpersonale janë veçanërisht të prira për paragjykimin gjinor të policisë. Kjo mund të shkojë nga dështimet e thjeshta në regjistrimin e rasteve sipas procedurave gjatë kontaktit fillestar, deri te turpërimi dhe fajësimi, madje edhe akuzimi i viktimës/të mbijetuarës për raportim të rremë.<sup>15</sup> Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara kanë më shumë gjasa që besueshmëria e tyre të vihet në dyshim, si rezultat i stereotipeve të dëmshme gjinore dhe të aftësisë së kufizuar.<sup>16</sup>

**“Eliminimi i paragjytimeve gjinore në praktikat e policimit është një komponent integral i luftimit të sulmit seksual dhe dhunës në familje dhe mund të ketë një efekt të vërtetë dhe të menjëhershëm në sigurinë e viktimave individuale.”**

Departamenti Amerikan i Drejtësisë (2015)

Sipas Departamentit Amerikan të Drejtësisë, paragjykimet gjinore të qarta dhe të nënkuptuara janë ngulitur në kulturën tonë. Kur bëhet fjalë për policimin, Departamenti Amerikan i Drejtësisë e përshkruan paragjykimin gjinor si një formë diskriminimi që mund të rezultojë në ofrimin e më pak mbrojtjeje nga policia për viktimat/të mbijetuar të caktuar në bazë të gjinisë, duke mos reaguar ndaj krimeve që dëmtojnë në mënyrë disproporcionale njerëzit e një gjinie të veçantë, ose ofruar shërbime të reduktuara ose më pak të fuqishme për

15 Të dhënat në dispozicion tregojnë një rrezik shumë më të madh që një raport i sulmit seksual të klasifikohet gabimisht si i rremë, në krahasim me një raport vërtetë të rremë. Shih Jordan, J. (2004), ‘Përtej besimit: Policia, përdhunimi dhe kredibiliteti i grave’, Drejtësia Penale 4(1), 29-59 në Huhtanen, H., Lonsway, K.A., Archambault, J. (2017), ‘Paragjykimi Gjinor në Reagimin dhe Hetimin e Sulmeve Seksuale, Seritë e Buletinit të Trajnimit: Pjesa 3’ Koalicioni Jepi Fund Dhunës ndaj Grave

16 Paraqitjet nga Organizata Ndërkombëtare e Grave për Raportuesin Special për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara: Praktikrat e Mira për Ngritjen e Qasjes Efektive në Drejtësi për Gratë dhe Vajzat me Aftësi të Kufizuara (9 gusht 2019).



shkak të mbështetjes në stereotipet gjinore.<sup>17</sup>

Paragjykimet gjinore gjithashtu mund të kombinohen ose ndërpriten me paragjykimet e tjera, siç janë ato që mund të formohen në bazë të përkatësisë etnike, aftësisë së kufizuar, seksualitetit, moshës dhe fesë. Në praktikë, kjo mund të rezultojë në bërjen e supozimeve se cilat grupe të grave kanë më shumë gjasa të jenë seksualisht të disponueshme dhe për këtë arsye “e kërkojnë atë”, ose cilët meshkuj kanë më shumë gjasa të jenë të dhunshëm ose grabitqarë.

Ndonëse shumë zyrtarë policor mbajnë qëndrime dhe vlera në mbështetje të qasjes së barabartë, të paanshme dhe të drejtë në drejtësi, gjinia e nënkuptuar dhe paragjykimet e tjera mund të paraqesin një pengesë të rëndësishme për të siguruar qasje të barabartë në drejtësi. Ekspertët besojnë se kjo ndodh sepse paragjykimet e nënkuptuara veprojnë në një nivel të pavetëdijshëm, që do të thotë se gjykimet tona mund të bëhen në pak sekonda, pa ndonjë vetëdije të ndërjegjshme dhe madje, dhe shpesh mund të kundërshtojnë besimet dhe vlerat e mbajtura me vetëdije.<sup>18</sup>

Për shembull, Hohl dhe Stanko (2015)<sup>19</sup> në analizimin e modeleve të konsumimit në rastet e përdhunimit në Mbretërinë e Bashkuar vërejnë se, “Përkatësia etnike e të dyshuarit gjithashtu ka rëndësi. Të dyshuarit jo-të bardhë kanë 70 gjasa më të ulëta të moskryerjes së krimi<sup>20</sup>. Pavarësisht nga përkatësia etnike e viktimës. Përfshirja e një efekti ndërveprimi ndërmjet të dyshuarit dhe përkatësisë etnike të viktimës në analizë tregon se në krahasim me një të dyshuar jo të bardhë, një i dyshuar i bardhë ka dy herë gjasa të moskryerjes së krimi nëse viktimë e tij është

e bardhë, dhe 11 herë më shumë gjasa nëse viktimë është jo e bardhë. Ky zbulim sugjeron që të dyshuarit e bardhë kanë shumë më tepër të ngjarë të shmangin hetimet e mëtejshme sesa të dyshuarit jo-të bardhë, veçanërisht nëse viktimë e tyre është jo e bardhë.”

**Drejtuesit janë të kujdesshëm që të mos e kalojnë paragjykimin e tyre tek anëtarët e ekipit vartës.**



Hulumtimi i Hohl dhe Stanko<sup>21</sup> tregon se (në rastin e Mbretërisë së Bashkuar) faktorë të rëndësishëm në normat e konsumimit përfshijnë përkatësinë etnike të të dyshuarit, si dhe atë që zyrtarët policorë dhe prokurorët e perceptojnë si provë kundër vërtetësisë së pohimit.

Tejkalimi i paragjykimeve gjinore dhe të tjera nuk do të jetë e lehtë për ju në një pozitë udhëheqëse. Kjo do të kërkojë një kombinim të shumë elementeve siç janë shqyrtimi dhe rishikimi i zbatimit të politikave dhe procedurave të brendshme, dhe trajnimi dhe vetëdijesimi i policisë që rezulton në policinë e ndërjegjshme për sjelljen e tyre dhe efektin e saj të mundshëm të tjerët në punën e tyre të përditshme.<sup>22</sup> Departamenti Amerikan i Drejtësisë jep disa këshilla të dobishme më poshtë për zbutjen e paragjykimeve gjinore në polici (shih Kutinë 1):

**Shih Kapitullin 10: ‘Ngritja institucionale për rekomandimet mbi politikën institucionale që synojnë të kontrollojnë ndikimin e paragjykimeve gjinore në polici, dhe Kapitullin 11: ‘Sfidat dhe strategjitë për zbatimin e policimit të përgjegjshëm në aspektin gjinor’ për diskutime mbi stereotipet gjinore të përfshira zakonisht në kulturën e policisë.**

17 Identifikimi dhe Parandalimi i Paragjykimet Gjinor në Regjimin e Zbatimit të Ligjit ndaj Sulmeve Seksuale dhe Dhunës në Familje (Departamenti Amerikan i Drejtësisë, 2015)

18 Po aty

19 Hohl, K. and Stanko, E. (2015), ‘Ankesat për përdhunimin dhe sistemin e drejtësisë penale: Dëshmi të reja mbi problemin e dobësisë të sistemit në Angli dhe Uells’, *Buletini Evropian për Kriminologji*, 12(3), f. 324-341. doi: 10.1177/1477370815571949.

20 Në Mbretërinë e Bashkuar, “jo-kriminalizimi” ndodh kur një krim i regjistruar më vonë është gjetur të mos jetë një krim dhe, në fakt, është anuluar, gjoja me informacion të verifikueshëm se një krim i tillë nuk është kryer. Shih: Laura Bates (2014), ‘Si po i zhgënjën policia viktimat e krimi seksual’ në <https://www.theguardian.com/lifeandstyle/womens-blog/2014/nov/21/police-letting-rape-victims-down-too>

21 Hohl, K. dhe Stanko, E. (2015), ‘Ankesat për përdhunimin dhe sistemin e drejtësisë penale: Dëshmi të reja mbi problemin e dobësisë të sistemit në Angli dhe Uells’, *Buletini Evropian për Kriminologji*, 12(3), f. 324-341. doi: 10.1177/1477370815571949.

22 Për udhëzime më të hollësishme mbi mbikëqyrjen gjinore dhe të brendshme të policisë, shihni Mjetin 2: Policimi dhe Gjinia në ‘Paketa e Veglave për Gjini dhe Siguri’ (Gjenevë: DCAF, OSCE/ZIDDNJ, UN Women, 2019), dhe ‘Integrimi i gjinisë në mbikëqyrjen e brendshme të policisë’ (OSCE/ODIHR, 2014).

## Kutia 1

### Këshilla për zbutjen e paragjyqimeve gjinore në policimin e aktiviteteve ditore

#### Drejtuesit e policisë mund të:

- Njohin dhe trajtojnë paragjykimet, supozimet dhe stereotipet për viktimat/të mbijetuarat;
- Sigurojnë që ata nuk i bazojnë gjykimet e tyre në lidhje me besueshmërinë e tregimit të një viktime/të mbijetuare mbi supozimet ose stereotipet në lidhje me 'llojet' e njerëzve që mund të jenë viktimat/të mbijetuara të sulmeve seksuale, ose për mënyrën sesi viktimat/të mbijetuarat e sulmit seksual dhe dhunës në familje 'duhet' të reagojnë ose të sillën;
- Jenë të vetëdijshëm dhe komunikojnë me ekipin e tyre se si paragjykimi gjinor është shumë kundërproduktiv për punën e policisë, përfshirë mënyrën se si ndikon në cilësinë e hetimit dhe perceptimin e përgjithshëm të policisë;
- Sigurojnë që ekipet e tyre të kuptojnë rolin e rëndësishëm që luan paragjykimi gjinor në nën-raportimin e krimeve të DHGV-së, veçanërisht nga gratë dhe vajzat nga grupet ose komunitetet e marginalizuara.

Burimi: Departamenti i Drejtësisë Lëshon Udhëzime për Identifikimin dhe Parandalimin e Paragjyqimeve Gjinore në Reagimin e Zbatimit të Ligjit ndaj Sulmeve Seksuale dhe Dhunës në Familje (Departamenti Amerikan i Drejtësisë, Zyra e Çështjeve Publike, 2015) në: <https://www.justice.gov/opa/pr/justice-department-issues-guidance-identifying-and-preventing-gender-bias-law-enforcement>

Kolegji i Policimit në Mbretërinë e Bashkuar thekson rëndësinë e promovimit të tipareve të sjelljes siç janë ndjeshmëria dhe perceptimi në polici duke u përqendruar në mënyrën se si të shmangen stereotipet, paragjykimet personale dhe diskriminimi dhe të qenit të vetëdijshëm për reagimet e tjera.<sup>23</sup>

Veprime të tjera konkrete që lidshipi i policisë mund të ndërmarrë përfshijnë si në vijim:

- Të sigurojë që përkufizimet e veprave penale të mos lejojnë keqinterpretime ose ngjallin mite apo stereotipe, përfshirë sigurimin që të gjitha aktet seksuale

23 Shih 'Hetimi: Puna me viktimat dhe dëshmitarët', Kolegji i Policisë, në: <https://www.app.college.police.uk/app-content/investigations/victims-and-witnesses/>

të kryera kundër çdo gruaje jo-miratuese pavarësisht nga prejardhja e saj, edhe kur ajo nuk shfaq shenja të rezistencës, konsiderohen dhunë seksuale dhe penalizohen;<sup>24</sup>

- Të zhvillojë dhe zbatojë masat për të mbrojtur gratë në ekipet e tyre nga dhuna dhe ngacmimi;
- Të miratojë një qasje 'zero tolerancë' për sjelljet dhe veprimet e papranueshme;
- Të romovojë dhe vlerësojë zyrtarët policor që i nënshtrohen trajnimeve të rregullta dhe të institucionalizuara të ndjeshme ndaj gjinisë dhe ngritjes së kapaciteteve, përfshirë trajnimin specifik kur të miratohet legjislacioni i ri.<sup>25</sup>

Tipare të tilla të sjelljes që pasqyrojnë objektivitetin dhe profesionalizmin do të ndihmojnë në nxitjen e besimit të viktimës/të mbijetuarës dhe mund të lehtësojnë rritjen e raportimit dhe pjesëmarrjes në hetimin dhe ndjekjen penale të incidenteve të dhunës ndaj grave dhe vajzave.

Në një manual trajnimi për policinë në Meksikë, UNODC (2017) siguron një listë, të frymëzuar nga Departamenti Amerikan i Drejtësisë,<sup>26</sup> nga paragjykimet më të shpeshta që mund të shfaqen nga një zyrtar policor kur interviston viktimat/të mbijetuarit e dhunës me bazë gjinore, përfshirë DHGV-në.<sup>27</sup>

24 Shih 'Forcimi i Parandalimit të Krimin dhe Përgjigja e Drejtësisë Penale ndaj Dhunës ndaj Grave' (Nju Jork, Zyra e OKB -së për Drogat dhe Krimin, 2014)

25 Është e rëndësishme të sigurohet që një trajnimi i tillë të njohet përmes konsultimit me organizatat joqeveritare dhe ofruesit e shërbimeve që punojnë për të mbështetur viktimat/të mbijetuarit e dhunës kundër grave dhe vajzave. Për veprime më konkrete në adresimin e paragjyqimeve gjinore në shërbimet thelbësore të policisë dhe drejtësisë, shihni 'Gjyqi i Përdhunimit - Kuptimi i Përgjigjes së Sistemit të Drejtësisë Penale ndaj Dhunës Seksuale në Tajlandë dhe Vietnam' (UN Women, UNDP dhe UNODC, 2017).

26 Në shumë raste, paragjykimet e nënkuptuara dhe qarta gjinore mund t'i pengojnë hetuesit të ndjekin praktikat më të mira, apo edhe të fillojnë një hetim (Departamenti Amerikan i Drejtësisë, 2015).

27 Shih 'Manuali i Trajnimit për Programin e Fuqizimit të Zyrtarëve Policor për Sigurinë e Grupeve të Ndjeshme' (UNODC, në partneritet me Qeverinë e Meksikës, 2017). Shih gjithashtu 'Doracak mbi Reagimin Efektiv të Prokurorisë ndaj Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave' (UNODC, në partneritet me UN Women, 2014).

## Kutia 2

### Paragjykimet më të shpeshta të identifikuar në reagimet e policisë ndaj DHGV-së\*

- Raportimi i vonuar nga viktimat;
- Historia e viktimës për të bërë raporte të ngjashme;
- Çfarë kishte veshur viktimat në kohën kur ndodhi krimi i supozuar dhe si vishet ajo në përgjithësi;
- Rezistenca e viktimës ndaj paraqitjes së një ankese;
- Historia seksuale e viktimës;
- Gjendja emocionale e viktimës (për shembull, nëse ajo duket e qetësuar ose dukshëm e mërzhitur);
- Mungesa e rezistencës së viktimës;
- Dosja penale e viktimës, ose përfshirja e saj në prostitucion;
- Besimi se viktimat ka një sëmundje mendore;
- Besimi se viktimat mund të jetë nën ndikimin e alkoolit ose drogës;
- Gjatësia e viktimës është e krahasueshme me gjatësinë e agresorit;
- Mungesa e ndonjë shenje të dukshme të lëndimit fizik të viktimës;
- Nëse viktimat është sulmuar nga një person i të njëjtës gjini;
- Orientimi seksual ose identiteti gjinor i viktimës.

\*Burimet: 'Manuali i Trajnimit për Programin e Fuqizimit të Zyrtarëve Policor për Sigurinë e Grupeve të Ndjeshme' (UNODC, në partneritet me Qeverinë e Meksikës, 2017); Gjithashtu Identifikimi dhe Parandalimi i Paragjyqimeve Gjinore në Reagimin e Zbatimit të Ligjit ndaj Sulmeve Seksual dhe Dhunës në Familje (Departamenti Amerikan i Drejtësisë, 2015)

Më poshtë (Kutia 2) nxjerr nga të dy burimet dhe rëndit paragjykimet më të zakonshme në polici, të cilat rezultojnë në një përgjigje kundërproduktive të policisë ndaj DHGV-së:

Për më tepër, drejtuesit e policisë gjithashtu duhet të marrin parasysh se si zakonisht prejardhja sociale e viktimës/të mbijetuarës ndikon në paragjykimet, veçanërisht nëse ajo vjen nga një mjedis i ndjeshëm. Ajo mund të trajtohet dobët, veçanërisht nëse agresori

vjen nga 'një familje e mirë', ka një lloj 'statusi social', apo madje është zyrtar policor ose pjesëtar i forcave të sigurisë.

Paragjykimet e tilla të mbajtura nga policia mund të ndikojnë në interpretimin e tyre se si duhet të duket viktimat/e mbijetuarat 'e përsosur' dhe si duhet të veprojnë ajo. Për shembull, ekziston një mit që një grua 'e pastër' dhe 'e ndershme' që ka përjetuar dhunë seksuale duhet të kërkojë një hetim të shpejtë. Në mënyrë të ngjashme, ekziston një mit tjetër që një raportim i vonuar nga një grua pasi ajo ka përjetuar një dhunë të tillë disi barazohet me raportim të pabesueshëm ose të rremë nga ana e saj.

Për më tepër, një studim i UNHCHR-it vë në dukje gjetjet e organizatave joqeveritare që tregojnë se incidentet e DHGV-së që përfshijnë gra dhe vajza me aftësi të kufizuara shpesh nuk hetohen për shkak të një numri pengesash. Këto përfshijnë dështimin e policisë për të ngritur kallëzime penale, për shkak të perceptimit stereotipik të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, dhe barrierave strukturore, siç është kërkesa e aftësisë juridike në mënyrë që të shihen si 'dëshmitare kompetente'.<sup>28</sup>

Paketa e Veglave të Policisë së OKB-së për Gjininë 'Praktikat më të Mira të Standardizuara për Integrimin Gjinor në Përmbledhjen e Mjeteve të Projektit' (2015) gjithashtu ofron një pasqyrë shumë të dobishme sesi disa mite mund të ndikojnë në qëndrimin e zyrtarëve policor dhe krijojnë barriera në hetimin e dhunës seksuale, veçanërisht kur zyrtarët policor nuk e kuptojnë qartë se dhuna seksuale - qoftë publike apo private - është një krim dhe se ata kanë për detyrë të hetojnë, regjistrojnë dhe ngritin raste, si dhe të arrestojnë kryerësin e dyshuar.<sup>29</sup> Shih më poshtë disa shembuj të miteve në lidhje me përdhunimin nga Paketa e Veglave të Policisë së OKB-së për Gjininë:

<sup>28</sup> Shih shënimin 2.

<sup>29</sup> Paketa e Veglave të Policisë së OKB-së 'Praktikat më të Mira të Standardizuara për Integrimin Gjinor në Përmbledhjen e Mjeteve të Projektit' (Departamenti për Operacione Paqësore i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, 2015) në <http://repository.un.org/handle/11176/387374> f. 197. Shih gjithashtu Udhëzimet e OBSH-së për kujdes mjekësor-ligjor për viktimat e dhunës seksuale (2003).

**Kutia 3****Mitet për përdhunimin nga Paketa e Veglave të Policisë së OKB-së për Gjininë (2015)**

<b>Miti</b>	<b>Fakti</b>
Seksi është motivi kryesor për përdhunimin	Fuqia, zemërimi, dominimi dhe kontrolli janë faktorët kryesorë motivues për përdhunimin, jo seksi.
Vetëm disa lloje të grave përdhuheshen	Çdo grua mund të jetë viktimë e përdhunimit. Megjithatë, shumë njerëz besojnë se gratë që janë me karakter të lartë moral ('vajzat e mira') nuk përdhuheshen dhe se femrat me karakter të ulët moral ('vajzat e këqija') përdhuheshen.
Gratë raportojnë në mënyrë të rreme përdhunimin	Vetëm një përqindje shumë e vogël e përdhunimeve të raportuara mendohet të jenë raporte të rreme.
Përdhunimi kryhet nga një i huaj	Pjesa dërmuese e përdhunimeve kryhen nga një sulmues i njohur.
Përdhunimi përfshin një sasi të madhe të dhunës fizike dhe përdorimin e një arme	Shumica e përdhunimeve nuk përfshijnë një forcë të madhe fizike. Shumica e viktimave/të mbijetuarave raportojnë se kishin frikë se mos pësonin lëndime serioze ose të vriteshin dhe kështu ofruan pak rezistencë ndaj sulmit. Kjo gjithashtu mund të shpjegojë pse nevojitet pak forcë ose armë për të nënshtruar viktimat.
Përdhunimi lë shenja të dukshme të lëndimit	Për shkak se shumica e përdhunimeve nuk përfshijnë një sasi të konsiderueshme të forcës, nuk mund të ketë lëndime fizike. Vetëm për shkak se një person nuk ka lëndime fizike nuk do të thotë se nuk është përdhunuar. Vetëm afërsisht një e treta e viktimave të përdhunimit pësojnë lëndime të dukshme fizike.
Kur femrat i thonë 'jo' seksit, në të vërtetë nënkuptojnë 'po'	'Jo' do të thotë jo; dëshirat e një femre në këtë drejtim duhet të respektohen gjatë gjithë kohës.
Punonjësit e seksit nuk mund të përdhuheshen	Çdo burrë apo grua, pavarësisht nga përfshirja e tij ose saj në industrinë e seksit komercial, mund të përdhuheshen. Studimet tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e punonjësve seksualë meshkuj dhe femra janë përdhunuar nga klientët e tyre, policia ose partnerët e tyre.
Një burrë nuk mund të dhunojë gruan e tij	Çdo seks i detyruar ose aktivitet seksual i detyruar përbën përdhunim, pavarësisht nëse gruaja është e martuar apo jo me dhunuesin. Fatkeqësisht, shumë juridiksione kanë përjashtime për përdhunimin martesor në ligjet e tyre; edhe pse gratë e martuara i nënshtrohen përdhunimit nga burrat e tyre, legjislacioni në fjalë nuk e njeh atë si të tillë.
Përdhunimi raportohet menjëherë në polici	Shumica e përdhunimeve nuk raportohen kurrë në polici. Nga ato që raportohen, shumica janë bërë më shumë se 24 orë pas incidentit. Viktimat/të mbijetuarit mund të mos paraqesin një raport fare ose të vonojnë raportimin sepse ato mendojnë se asgjë nuk do të bëhet, kryerësi mund të ketë bërë kërcënime kundër tyre ose familjeve të tyre, ato kanë frikë nga përgjigjet e familjes ose komunitetit, ose kanë turp. Disa viktimat thjesht mendojnë se është çështje private ose nuk dinë ku ta raportojnë incidentin.



Foto kurtuazie nga Forca Ndërkombëtare (Kosovë)

## CAKTIMI I PRIORITETEVE DHE OBJEKTIVAVE PËR POLICIM TË PËRGJEGJSHËM NË ASPEKTIN GJINOR

Përcaktimi i prioriteteve realiste dhe përcaktimi i objektivave të ndërlidhura janë mënyra më efektive për ta mbajtur ekipin tuaj të motivuar. Sidoqoftë, suksesi i ekipit tuaj do të ndikohet nga **lloji** dhe **cilësia** e objektivave që keni vendosur si udhëheqës i ekipit. Lloji dhe cilësia e objektivave tuaja do të formësohen nga prioritetet strategjike të organizatës suaj dhe do të përshtaten për të përmbushur kërkesat e sigurisë të komuniteteve tuaja lokale.



*Të kuptuarit pse marrëdhëniet gjinore janë thelbësore për avancimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave dhe arritjen e rezultateve pozitive të policisë. Transformimi i marrëdhënieve të pabarabarta gjinore rezulton nga vendimmarrja e përbashkët dhe ndarja e duhur e burimeve*

Njohja e nevojave në zhvillim dhe të ndryshme të sigurisë të bashkësive tuaja lokale do të jetë faktori kryesor në suksesin tuaj operacional. Qëndrimet negative ose të njëanshme të anëtarëve të ekipit tuaj që çojnë ose rezultojnë në diskriminim kundër anëtarëve të caktuar ose një grupi brenda komunitetit, do të minojnë efektivitetin tuaj operacional.

Në të kundërtën, qëndrimet pozitive dhe sjelljet e policisë që demonstrojnë gatishmërinë për të punuar dhe mbështetur viktimat e DHGV-së do të ndihmojnë në legjitimitimin e përpjekjeve të policisë brenda komuniteteve tuaja. Kuptimi dhe demonstrimi i marrjes në konsideratë të nevojave diferenciale të sigurisë të komuniteteve do të mundësojë një shërbim më të mirë të përgjithshëm policor, pasi policia do të jetë më e informuar për trendët e krimit lokal, përfshirë mënyrën se si DHGV mund të mbivendoset me krime të tjera siç janë trafikimi i qenieve njerëzore dhe skllavëria moderne.

Qëndrimet pozitive dhe sjelljet e policisë për të reaguar në mënyrë efektive ndaj DHGV-së duhet të reflektohen në kompetencat kryesore dhe grupet e aftësive të promovuara dhe institucionalizuara nga organizata juaj pasi ato reflektojnë prioritetet nacionale.


Megjithatë, prioritetet kërkojnë një kuptim të përbashkët të problemit dhe pse problemi duhet të adresohet. Për sa i përket DHGV-së, është thelbësore që drejtuesit e lartë të policisë të krijojnë një kuptim të informuar dhe të zakonshëm të natyrës së DHGV-së, shkaqeve dhe pasojave të saj dhe si ndikon ajo tek gratë dhe vajzat në mënyrë të ndryshme dhe në mënyrë disproporcionale. Kjo do t'ju japë juve, si drejtues të mesëm, legjitimitetin institucional për të qenë agjentë aktivë të ndryshimit në transformimin e organizatës tuaj dhe për të zbutur çdo paragjykim të dëmshëm të shfaqur nga stafi juaj në këtë proces.

Prioritetet gjithashtu kanë nevojë për një vizion të qartë strategjik që ia mundëson tërë organizatës policore, pavarësisht gradës, të dijë në cilin drejtim të orientojë përpjekjet.

Për më shumë informacion mbi transformimin e policisë së përgjegjshme në aspektin gjinor, shih Kapitullin 10: 'Ngritja institucionale' dhe Kapitullin 11: 'Sfidat dhe strategjitë për zbatimin e policimit të përgjegjshëm në aspektin gjinor.'

**Figura 3:**

**Një shembull i një modeli të përcaktimit të objektivave për policim të përgjegjshëm në aspektin gjinore ndaj DHGV-së**





Fotografi kurtuazie nga UNMIT/Martine Perret (Timor Leste)

Një shembull hipotetik i vizionit strategjik të një organizate policore në reagim të DHGV-së mund të jetë:

**Raportimi dhe parandalimi në rritje i DHGV-së si rezultat i shërbimeve efektive dhe adekuate policore që u japin prioritet nevojave të viktimave/të mbijetuarave dhe i lidhin ato me shërbimet thelbësore që sigurojnë mirëqenien e tyre.**

Bazuar në këtë vizion hipotetik, mund të përcaktohen prioritetet, qëllimet dhe strategjitë. Figura 3, më poshtë, është një shembull i thjeshtuar i një modeli të përcaktimit të objektivave për policimin të përgjegjshëm në aspektin gjinore ndaj DHGV-së që pasqyron parimet dhe karakteristikat e përbashkëta të PSHTH-së.

Më poshtë janë disa shembuj të veprimeve strategjike që nevojiten nga drejtuesit e mesëm për të arritur këto qëllime të propozuara:

1. Përcaktimi i marrëdhënieve të punës me palët e jashtme të interesit siç janë organizatat e grave ose të shoqërisë civile, akademia, grupet e minoritare dhe të ndjeshme, dhe akterët tjerë kryesorë për një reagim më të informuar për parandalimin dhe hetimin e DHGV-së;

2. Granatimi i standardizimit dhe kontrollit të cilësisë së kompetencave kryesore dhe grupeve të shkathëtësive të buta të zbatuara në hetimet e DHGV-së, për të siguruar që ato janë të përqendruara te viktimat/të mbijetuarat dhe të bazuara në të drejta;
3. Promovimi me shembuj dhe përforcimi i aftësisimit dhe arsimit mbi parandalimin dhe hetimin e DHGV-së, në mënyrë që zyrtarët policorë që reagojnë të angazhojnë viktimat/të mbijetuarat në mënyrë të informuar dhe jo-diskriminuese të bazuar në të drejta dhe traumë të përgjegjshme në aspektin gjinor.

## **PJESËMARRJA KUPTIMPLOTË ËSHTË NË ZEMRËN E POLICIMIT TË PËRGJEGJSHËM NË ASPEKTIN GJINORE**

Siç u diskutua më parë, policia që reagon ndaj DHGV-së në mënyrë efektive dhe të përgjegjshme ndaj gjinisë kërkon një angazhim strategjik nga lidhësi i policisë për të siguruar **pjesëmarrje kuptimplotë** të viktimës/të mbijetuarës.



Fotografi kurtuazie nga Carolyn Kovacs Anderson  
(Shtetet e Bashkuara të Amerikës)

**Pjesëmarrja kuptimplotë** kërkon që individët dhe komunitetet e tyre të kenë të drejtë të marrin pjesë në vendimet që ndikojnë drejtpërdrejt tek ta, përfshirë në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e ndërhyrjeve. Kjo mund të marrë formë të ndryshme, duke përfshirë dhënien e informacionit objektiv të viktimave/të mbijetuarave, në mënyrë që ato të mbajnë kontrollin afërt mbi vendimet kryesore që ndikojnë në mirëqenien e tyre. Ajo gjithashtu mund të përfshijë konsultimin e tyre për të marrë reagime mbi procesin e vendimmarrjes, duke përfshirë zhvillimin dhe identifikimin e zgjidhjeve alternative.

Koncepti 'kuptimplotë' kërkon që gratë dhe vajzat jo vetëm të jenë të pranishme, por që shqetësimet e tyre të dëgjohen dhe të merren parasysh. Ato duhet të kenë mundësinë të artikulojnë përvojën dhe njohuritë e tyre për atë që u nevojitet për të siguruar mirëqenien e viktimave/të mbijetuarave të dhunës gjinore, por edhe të tërë shoqërisë.

Për shembull, femrat në përgjithësi janë të nën-përfaqësuar në forcat policore në tërë botën. Barrierat strukturore dhe institucionale, dhe stereotipet negative rreth gjinisë ndikojnë dukshëm në mjedisin e punës për femrat, dhe këta faktorë përkeqësohen për femrat me aftësi të kufizuara dhe/ose ato që vijnë nga grupet ose komunitetet etnike minoritare.

Legjitimiteti i organizatës policore rritet kur grupet dhe komunitetet, të cilave u shërbejnë mund të identifikohen me ta dhe të ndihen të përfaqësuar në të njëjtën kohë.

Policimi i përgjegjshëm në aspektin gjinor duhet të jetë në thelb gjithëpërfshirës dhe përfaqësues, duke kërkuar zhvillimin e mekanizmave rreth shkëmbimit të informacionit me mbrojtësit e shoqërisë civile, duke pranuar se organizatat e shoqërisë civile nuk janë vetë përfshirëse të personave me aftësi të kufizuara.



Për të siguruar pjesëmarrje kuptimplotë të viktimave/ të mbijetuarve dhe komuniteteve të tyre në strategjitë dhe veprimet policore, Manuali propozon që menaxhimi i policisë t'i referohet nëntë karakteristikave të përbashkëta që të gjitha shërbimet thelbësore duhet të demonstrojnë në mënyrë të natyrshme. Këto karakteristika të përbashkëta, të mishëruara në PSHTH,

përafrojnë të gjitha përpjekjet thelbësore të shërbimit për të maksimizuar ndikimin pozitiv duke kërkuar të sigurojnë që viktimat/të mbijetuarat e DHGV-së të marrin pjesë në mënyrë domethënëse në procesin e drejtësisë. Veprimet dhe aktivitetet efektive të parandalimit dhe hetimit të policisë kur reagojnë ndaj DHGV-së janë kritike.

**Figura 4:**

**Karakteristikat e përbashkëta të një reagimi cilësor të policisë që thekson pjesëmarrjen kuptimplotë të viktimave/të mbijetuarve në rastet e DHGV-së**



Më poshtë janë karakteristikat e zakonshme të përshkruara nga PSHTH-ja:

**1. Disponueshmëria:** Të gjitha shërbimet thelbësore duhet të jenë të disponueshme në sasi dhe cilësi të mjaftueshme për të gjithë, pavarësisht nga vendbanimi, kombësia, etnia, kasta, klasa, statusi i emigrantit ose refugjatit, statusi autokton, mosh,

feja, gjuha dhe niveli i shkrim-leximit, orientimi seksual, statusi martesor, aftësia e kufizuar ose ndonjë karakteristikë tjetër.

**2. Qasshmëria:** Të gjitha shërbimet thelbësore duhet të jenë të qasshme për të gjithë pa diskriminim. Ato duhet të jenë fizikisht të qasshme (shërbimet janë brenda mundësive të sigurta fizike për të gjitha gratë

dhe vajzat), ekonomikisht të qasshme (të përballueshme) dhe gjuhësisht të arritshme (informacioni ofrohet në formate të ndryshme).<sup>30</sup>

3. **Përshtatja:** Të gjitha shërbimet thelbësore duhet të njohin ndikimet diferenciale të dhunës në grupe të ndryshme të grave dhe komuniteteve. Ata duhet t'u përgjigjen nevojave të viktimave dhe të mbijetuarve në mënyra që integrojnë të drejtat e njeriut (dhe parimet e vetëdijshme për kulturën).
4. **Përshtatshmëria:** Të gjitha shërbimet thelbësore duhet të respektojnë dinjitetin e viktimës/të mbijetuarës; garantojnë konfidencialitetin e tyre; të jenë të ndjeshëm ndaj nevojave dhe perspektivave të tyre dhe minimizojnë një formë tjetër të viktimizimit.
5. **Caktim i sigurisë si prioritet:** Viktimat/të mbijetuarit përballen me shumë rreziqe për sigurinë e tyre të menjëhershme dhe të vazhdueshme. Këto rreziqe do të jenë specifike për rrethanat individuale të secilit person. Vlerësimi dhe menaxhimi i rrezikut mund të zvogëlojë nivelin e rrezikut. Praktika më e mirë e vlerësimit dhe menaxhimit të rrezikut përfshin qasje të qëndrueshme dhe të koordinuara brenda dhe ndërmjet sektorëve social, shëndetësor, policor dhe të drejtësisë.
6. **Pëlqimi dhe konfidencialiteti i informuar:** Viktimat/të mbijetuarat duhet të dinë se po dëgjohen dhe se nevojat e tyre po kuptohen dhe adresohen. Informacioni, dhe mënyra se si komunikohet, mund të inkurajojë viktimat/të mbijetuarat të kërkojnë shërbime thelbësore. I gjithë komunikimi me viktimat/të mbijetuarat duhet të promovojë dinjitetin e tyre dhe të jetë respektues ndaj tyre.

<sup>30</sup> Të gjitha shërbimet thelbësore duhet të jenë të qasshme për të gjithë, përfshirë gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara. Duhet të ekzistojnë protokolle për çdo lloj dëmtimi (të shikimit, dëgjimit, lëvizshmërisë, shëndetit mendor, psikosocial, etj.) dhe zyrtarë të trajnuar për të përshtatur nevojat e grave dhe vajzave me llojet e ndryshme të aftësisë së kufizuar. Shih "Gratë dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara: Udhëzimet për Ofrimin e Shërbimeve të Bazuara në të Drejtat dhe të Përgjegjshme në Aspektin Gjinore për të Adresuar Dhunën me Bazë Gjinore dhe Shëndetin dhe të Drejtat Seksuale dhe Riprodhuese" (UNFPA-WIE, 2018)

#### Kutia 4

##### Qasshmëria gjithashtu përfshin

**Qasshmërinë fizike:** vendndodhja e shërbimeve, hyrja, dhe zonat e parkimit duhet të jenë të qasshme për gratë dhe vajzat me dëmtim të lëvizshmërisë. Lëvizja brenda objektit duhet të jetë e mundur për personat me pajisje lëvizëse dhe/ose aftësi të kufizuara shqisore;

**Qasjen në informacion dhe komunikim:** informacioni duhet të jetë i qasshëm për gratë dhe vajzat me të gjitha llojet e aftësive të kufizuara. Duhet të jenë në dispozicion mjete të ndryshme, siç janë shërbimet e përkthimit, përdorimi i gjuhës së thjeshtë, audio, printime të mëdha, brail, gjuhë e lehtë për t'u lexuar dhe me ilustrime, etj. Duhet të kihet kujdes nga përdorimi i anëtarëve të familjes ose kujdestarëve si përkthyes, përveç nëse jepet pëlqim i qartë me vullnet dhe i informuar nga viktimat/e mbijetuarat, pasi ata mund të jenë edhe kryerës të dhunës.

7. **Komunikimi efektiv dhe pjesëmarrja nga palët e interesit në hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e shërbimeve:** Të gjitha shërbimet thelbësore duhet të ofrohen në atë mënyrë që mbron privatësinë e viktimës/të mbijetuarës, garanton konfidencialitetin dhe, për aq sa është e mundur, zbulon informacionin vetëm me pëlqimin e tyre të informuar. Informacioni rreth viktimës/të mbijetuarës së dhunës mund të jetë jashtëzakonisht i ndjeshëm. Ndarja e këtij informacioni në mënyrë të papërshtatshme mund të ketë pasoja serioze dhe potencialisht kërcënuese për jetën e grave dhe vajzave dhe të njerëzve që u ofrojnë atyre ndihmë.
8. **Mbledhja e të dhënave dhe menaxhimi i informacionit:** Mbledhja e qëndrueshme dhe e saktë e të dhënave në lidhje me shërbimet e ofruara për gratë dhe vajzat është e rëndësishme në mbështetjen e përmirësimit të vazhdueshëm të shërbimeve.<sup>31</sup> Të

<sup>31</sup> Humanity & Inclusion rekomandon që të gjitha shërbimet thelbësore duhet të mbledhin të dhëna të ndara sipas aftësisë së kufizuar. Shih më tej: [www.hi-us.org/](http://www.hi-us.org/)



Fotografi kurtuazie nga Fotografitë e OKB-së/Eskinder Debebe  
(Republika e Afrikës Qendrore)

gjitha shërbimet thelbësore duhet të kenë procese të qarta dhe të dokumentuara për regjistrimin e saktë dhe ruajtjen konfidenciale e të sigurt të informacionit në lidhje me viktimat/të mbijetuarat dhe shërbimet që u ofrohen atyre.

**9. Lidhja me sektorët dhe agjencitë e tjera nëpërmjet koordinimit:** Lidhja me sektorët dhe agjencitë e tjera nëpërmjet koordinimit, siç janë rrugët e referimit, do të ndihmojë gratë dhe vajzat të marrin shërbimet me kohë dhe të përshtatshme. Proceset e referimit duhet të përfshijnë standarde për pëlqimin e informuar. Për të siguruar lundrimin e qetë të shërbimeve të ndryshme thelbësore për viktimat dhe të mbijetuarat, duhet të ekzistojnë protokolle dhe marrëveshje në lidhje me procesin e referimit, përfshirë përgjegjësitë e qarta të secilit shërbim.

## REAGIMI NDAJ DHGV-SË FILLON ME ANGAZHIMIN E KOMUNITETIT DHE INFORMIMIN PËR KONTEKSTIN LOKAL

Meqenëse politika e sigurisë kombëtare përcakton përparësitë strategjike, ajo gjithashtu duhet t'u sigurojë drejtuesve operacionalë të policisë objektivat qendrore që do të përkthehen në praktikë, në zonat lokale të komandës, në koordinim me partnerët lokalë.<sup>32</sup>

<sup>32</sup> Një strategji për adresimin e DHGV-së duhet të ofrojë qëllime të arritshme që ngërthehen në korniza të tjera strategjike, siç janë lidhja me planet e shërbimit të fëmijëve dhe strategjitë kombëtare e shëndetësisë. Në këtë mënyrë, autoritetet mund të sigurojnë që adresimi i DHGV-së është një çështje me prioritet i 'tërë qeverisë' dhe jo vetëm një çështje e kimit dhe sigurisë publike.

Në teori, duhet të ekzistojnë mekanizma konsultimi që promovojnë pjesëmarrjen kuptimplotë të palëve të interesit për tu informuar dhe konsultuar me policinë në lidhje me prioritetet e sigurisë. Këta mekanizma mund të ekzistojnë në forma të ndryshme, mund të jenë forume publike komunale ose komitete të policimit në komunitet ku - në mënyrë ideale - komuniteti informon policinë për nevojat e tyre të ndryshme të sigurisë dhe ku policia kërkon të kuptojë se si nevojat e sigurisë përfaqësojnë gratë, burrat, vajzat dhe djemtë ndryshe.

*Lidershipi ka të bëjë me njerëzit, jo me proceset, politikat ose letrat*

Kur ekzistojnë mekanizma të tillë, është kritike që ata, dhe komitetet pjesëmarrëse, të përfshijnë individë me prejardhje të ndryshme dhe që çështja e angazhimit me 'udhëheqësit e komunitetit', të cilët shpesh janë meshkuj dhe të vetë-emëruar, të prishet. Drejtuesit e policisë duhet të jetë e vetëdijshme se si mekanizmat e konsultimit mund të jenë një burim i vlefshëm informacioni dhe krijimit të partneritetit për të reaguar në mënyrë efektive ndaj DHGV-së.

Në mungesë të mekanizmave të konsultimit lokal, drejtuesit e policisë duhet të kërkojnë të avokojë për ta, ose të angazhohen me palët e interesit për të promovuar krijimin e tyre. Policia ka një rol të rëndësishëm për të luajtur në identifikimin aktiv të pikave hyrëse për bashkëpunim me komunitetet të cilave u shërbejnë, gjë që do të ndihmojë në parandalimin e krimit dhe dhunës në përgjithësi. Policia gjithashtu ka përgjegjësi për të siguruar që zërat e grupeve të komunitetit ose anëtarëve të cilët janë në rrezik më të madh të krimeve të dhunshme, siç janë personat me aftësi të kufizuara, lezbik, homoseksual, biseksual, transgjinor dhe interseksual (LGBTI), të moshuar, të rinjtë në rrezik dhe personat që jetojnë në zona të thella, të marrin pjesë në mënyrës domethënëse në procesin e konsultimit.

**Shih Kapitullin 3: 'Parandalimi' dhe Kapitullin 8: 'Kordinimi me Agjencitë e Drejtësisë' për më shumë shembuj të mekanizmave të konsultimit.**

Kuptimi i natyrës së dhunës, shkaqet dhe pasojat e saj dhe si ndikon ajo tek gratë dhe vajzat ndryshe dhe në mënyrë

disproporcionale duhet të diskutohet si pjesë e një procesi të gjerë konsultimi. Një proces i tillë kërkon pjesëmarrjen kuptimplotë të komuniteteve të ndryshme, organizatave lokale të grave, organizatave që përfaqësojnë personat dhe grupet minoritare, si dhe viktimat/të mbijetuarat që kanë pasur përvojë në vetë sistemin gjyqësor (sigurimi i pëlqimit, konfidencialitetit dhe mbrojtjes).

Të armatosur me këtë informacion, të pasur me përfaqësim dhe konsultime të ndryshme, drejtuesit e policisë mund të përshtatin një qasje të përqendruar te viktimat<sup>33</sup> për të përmbushur më mirë kërkesat e viktimave/të mbijetuarave të ndryshme kur ndodh DHGV.

*Mos harroni si polici ju jeni pjesë integrale e komunitetit, dhe komuniteti është një pjesë integrale e juaja!*

Angazhimi aktiv me komunitetet e prekura dhe një praktikë e standardizuar e aplikimit të një qasjeje të përqendruar te viktimat në rastet e DHGV-së do të kontribuojë në mënyrë të konsiderueshme që policia të perceptohet si një ofrues i shërbimeve thelbësore legjitime dhe të përgjegjshme ndaj gjinisë nga komunitetet të cilave u shërben.

Policimi i përgjegjshëm në aspektin gjinor mund të shihet si një kombinim ndërmjet bashkëpunimit të vazhdueshëm të policisë me grupe të ndryshme nga komunitetet të cilave u shërben për të parandaluar DHGV-në, dhe pjesëmarrjes kuptimplotë të viktimave/të mbijetuarave të DHGV-së në një hetim që kërkon të fokusohet tek kryerësit dhe është i bazuar në të drejtat.

Skenarët e mëposhtëm japin shembuj se si mund të duket sukcesi operacional kur reagohet ndaj DHGV-së:

<sup>33</sup> Sipas kornizës së PSHTH-së, një qasje 'e përqendruar te viktimat' ose 'e përqendruar te e mbijetuarat' vendos të drejtat, nevojat dhe dëshirat e grave dhe vajzave në qendër të fokusit të ofrimit të shërbimeve. Kjo kërkon marrjen parasysh të nevojave të shumta të viktimave/të mbijetuarave, rreziqeve dhe dobësive të ndryshme, ndikimin e vendimeve dhe veprimave të ndërmarra, dhe gjithashtu siguron që shërbimet të përshtaten me kërkesat unike të secilës grua dhe vajzë individuale. Shërbimet duhet t'i përgjigjen dëshirave të saj, shih: <https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2015/12/essential-services-package-for-women-and-girls-subject-to-violence>

1

**SKENARI 1:**

Shërbimet policore plotësojnë nevojat e viktimave/të mbijetuarave të DHGV-së duke siguruar përfshirjen dhe konsultimin e tyre, pa diskriminim gjatë gjithë procesit hetimor të fokusuar tek kryerësit dhe në koordinim me mbështetjen e anëtarëve të komunitetit dhe akterëve të shëndetësisë, shërbimeve sociale dhe drejtësisë.

2

**SKENARI 2:**

Praktika e hetimit e fokusuar në kryerësin e dhunës së bashku me bashkëpunimin proaktiv ndërmjet policisë dhe komuniteteve në parandalimin e DHGV-së ka fuqizuar më shumë viktimat/të mbijetuarat për të raportuar në polici dhe për të marrë pjesë në procesin gjyqësor deri në fund.

3

**SKENARI 3:**

Rreziket e DHGV-së zvogëlohen pasi policia dhe komunitetet bashkëpunojnë në mënyrë aktive për të siguruar një qasje të përqendruar te viktimat/e mbijetuarat që është në gjendje të përmbushë kërkesat e ndryshme të viktimave/të mbijetuarave dhe që kryerësit të mbahen përgjegjës dhe të përballen me pasojat për dhunën e tyre.

4

**SKENARI 4:**

Kryerësit e DHGV-së, siç është dhuna ndërpersonale, kanë më pak gjasa të përsërisin veprën si rezultat i zbatimit efektiv të urdhrave të mbrojtjes civile nga policia duke dërguar një mesazh të qartë se ka pasojat për shkëlqen e një urdhri dhe përsëritjen e veprës kundër të njëjtës ose një viktime/të mbijetuarat tjetër.

## DUKE JU NDIHMUAR GJATË RRUGËS: TREGUESIT E NDJESHËM NË ASPEKTIN GJINOR PËR REAGIM NDAJ DHGV-SË

Planifikimi për suksesin e ekipit kur reagohet ndaj DHGV-së do të mbështetet në aftësinë e ekipit tuaj për të zotëruar aktivitetet që po zbatohen. Kjo do të thotë që të gjithë anëtarët e ekipit i kuptojnë rolet dhe përgjegjësitë e tyre dhe të njëri -tjetrit kur reagojnë ndaj DHGV-së.

Manuali pranon se rolet dhe përgjegjësitë e ekipit do të ndryshojnë në **organizatat** policore. Megjithatë, të gjithë anëtarët e ekipit duhet, pavarësisht nga roli i tyre në ekip, të kërkojnë të demonstrojnë grupe dhe kompetenca të shkathtësive më të buta që mbështesin një reagim efektive ndaj DHGV-së. Këto aftësi dhe kompetenca do të shqyrtohen në kapitujt e mëvonshëm në Manual dhe do të pasqyrojnë parimet e PSHTH-së dhe karakteristikat e përbashkëta (Figura 2).

Planifikimi për suksesin e ekipit përfshin gjithashtu njohjen, mbledhjen, analizimin dhe përdorimin e të

dhënave të ndjeshme në aspektin gjinor dhe të ndara sipas gjinisë, të nevojshme për të informuar për performancën e përgjithshme të ekipit dhe udhëzimet e mëvonshme të kërkuara. Mbledhja e të dhënave të ekipit duhet të pasqyrojë sasinë e krimeve të ndërlydhura me gjininë, pasi është një tregues i rëndësishëm i sigurisë së grave, burrave, djemve dhe vajzave.<sup>34</sup>

**“Ndjeshmëria gjinore synon të kuptojë dhe të marrë parasysh faktorët shoqërorë dhe kulturorë të përfshirë në përjashtimin dhe diskriminimin me bazë gjinore në sferat më të ndryshme të jetës publike dhe private.”**

- Instituti Evropian për Barazi Gjinore (IEBGJ)

Masat e performancës të ndjeshme ndaj gjinisë janë vendimtare për të siguruar që ndërhyrjet tuaja policore ndaj DHGV-së janë të ndjeshme ndaj nevojave të viktimave/të mbijetuarave. Kjo nga ana tjetër do të sigurojë sfondin për viktimat/të mbijetuarit që të raportojnë në polici dhe

34 Shih gjithashtu Megan Bastick, ‘Udhëzues për Vetë-Vlerësimin Gjinor për Policinë, Forcat e Armatosura dhe Sektorin e Drejtësisë’ (Gjenevë: DCAF, 2011) për informacion të mëtejshëm mbi mbledhjen, analizën dhe përdorimin e të dhënave të ndjeshme në aspektin gjinor.

të kërkojnë mjete juridike deri në përfundimin e plotë të rastit. Për më tepër, masat e performancës të ndjeshme ndaj gjinisë informojnë hartuesit e politikave dhe komunitetin në lidhje me efektivitetin e strategjive të policimit.

Si drejtues të policisë ose udhëheqës i ekipit, arritja e suksesit operacional kur reagoni ndaj DHGV-së do të varet shumë nga sa mirë ekipi juaj është në gjendje të identifikojë dhe mbledhë të dhëna të ndjeshme në aspektin gjinor gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre të përditshme. Duke pasur një grup të qartë treguesish të performancës që janë të ndjeshëm ndaj gjinisë<sup>35</sup> dhe një ekip që është i përgatitur për të mbledhur atë informacion, këta janë hapat e parë për të ditur nëse ekipi juaj është në rrugën e duhur për të reaguar në mënyrë efektive dhe adekuate ndaj DHGV-së.

Disa shembuj të treguesve të performancës të ndjeshme ndaj gjinisë për aktivitetet e policisë përfshijnë si në vijim:

- Një rritje të shkallës së viktimave/të mbijetuarave që raportojnë DHGV në polici, e ndarë sipas moshës, gjinisë dhe variablave të tjera socio-ekonomike<sup>36</sup> përfshirë faktorë siç janë përkatësia etnike dhe aftësia e kufizuar;
- % e viktimave/të mbijetuarave që duhej të përdornin shërbimet e specializuara të DHGV-së dhe të cilat mund të raportojnë një ndërprerje të plotë të të gjitha llojeve të abuzimit, të ndara sipas moshës, aftësisë së kufizuar, gjinisë dhe variablave të tjera socio-ekonomike;
- % e grave viktime/të mbijetuara të cilat shprehën kënaqësinë me mbështetjen dhe ndihmën

35 Gjinia i referohet roleve dhe marrëdhënieve, tipareve të personalitetit, qëndrimeve, sjelljeve dhe vlerave që shoqëria ua atribuon burrave dhe grave. Prandaj 'gjinia' i referohet dallimeve të njohura ndërmjet burrave dhe grave, ndërsa 'seksi' i referohet dallimeve biologjike ndërmjet meshkujve dhe femrave. Rolet gjinore ndryshojnë shumë brenda dhe nëpër kulturë dhe mund të ndryshojnë me kalimin e kohës. Gjinia nuk i referohet thjesht grave ose burrave, por edhe marrëdhënies ndërmjet tyre. Shih: Megan Bastick, Kristin Valasek. (2008), 'Diskutimi, Monitorimi dhe Vlerësimi i Reformës në Sektorin e Sigurisë dhe Gjinia' në Paketën e Veglave Gjinore dhe RSS, Qendra e Gjenezës për Qeverisjen e Sektorit të Sigurisë.

36 Keni parasysh se një rritje e raportimit nuk është sinonim për një rritje të rasteve të DHGV-së.

## Kutia 5

### Cilët janë treguesit e performancës të ndjeshëm ndaj gjinisë?

Treguesit e performancës të ndjeshëm ndaj gjinisë mund të jenë matjet, numrat, faktet, opinionet ose perceptimet që tregojnë një gjendje ose situatë specifike në lidhje me rolet, sjelljet, aktivitetet dhe atributet që një shoqëri e caktuar në një kohë të caktuar i konsideron të përshtatshme për burrat dhe gratë. Treguesit e performancës të ndjeshëm ndaj gjinisë matin ndryshimin në këto kushte ose situata me kalimin e kohës duke siguruar informacion mbi marrëdhëniet ndërmjet grave dhe atyre ndërmjet burrave duke theksuar pritjet e tyre përkatëse të vendosura ndaj tyre nga shoqëria në proces.

që morën nga të gjitha shërbimet në lidhje me DHGV-në, të ndara sipas moshës, paaftësisë dhe variablave të tjerë socio-ekonomike.

Sidoqoftë, grumbullimi i të dhënave të kimit të ndërlidhur me gjininë ka nevojë për kritere, ashtu siç bëjnë të gjitha masat e performancës së ndjeshme gjinore, të përcaktuara për profesionalizim të shtuar dhe modernizim të vetë organizatës policore. Sigurimi i kritereve për mbledhjen e të dhënave të tilla është normalisht një proces institucional që ushqen qëllimet e nivelit strategjik. Në mungesë të këtyre kritereve, drejtuesit e policisë mund të marrin një rol për ndryshim të agjencisë dhe të zhvillojë kritere për aktivitetet e ekipit të tyre me mbështetjen e njëjësive të ngarkuara me mbledhjen dhe analizën statistikore.

***Ju lutemi referojuni Kapitullit 10 'Ngritja institucionale' për diskutim të mëtejshëm mbi angazhimin institucional në mbledhjen e të dhënave të ndjeshme gjinore në reagim ndaj DHGV-së.***

Policia duhet të ketë kujdes kur interpreton shkallën e krimeve të raportuara, siç janë rastet e dhunës seksuale. Për shembull, kur informohet publiku për një rritje ose zvogëlim të krimeve të raportuara, publiku duhet të jetë i vetëdijshëm se zvogëlimi i rasteve të raportuara nuk do të thotë domosdoshmërisht se niveli i dhunës është ulur. Kjo është veçanërisht e rëndësishme pasi fokusi

në krimin e raportuar tenton të anashkalojë krimet e pa raportuara, të cilat kanë tendencë të jenë krime të dhunës me bazë gjinore.

Nga ana tjetër, një rritje e raportimit mund të reflektojë më shumë vetëdije dhe besim në institucionet sesa një rritje të nivelit të dhunës. Fatkeqësisht, një prirje e tillë pozitive është e vështirë t'i atribuohet empirikisht policisë kur shërbimet e tjera thelbësore dhe agjencitë e zbatimit të ligjit mund të përfshihen në mënyrë të barabartë sipas kompetencës së tyre.

Për më tepër, Instituti Kombëtar i Drejtësisë në SHBA paralajmëron se fokusimi në zvogëlimin e numrit të raporteve të krimeve të rënda si përdhunimi, ofron një pasqyrë shumë të ngushtë të metodave ose strategjive të përdorura për të reaguar ndaj atyre krimeve, siç është angazhimi me komunitetet ose organizatat e grave. Kjo e bën të vështirë për organizatat policore që t'i atribuojnë ndikim veprimtarisë së shtrirjes së policisë dhe krijimit të partneritetit, të cilat janë në thelb të policimit të udhëhequr nga inteligjenca dhe komuniteti, përveç rasteve kur janë caktuar indikatorë cilësorë që matin nivelet e besimit ose perceptimit të shërbimeve policore.


Përqendrimi në zvogëlimin e numrit të raporteve të krimeve të rënda mund të bëjë presion të vazhdueshëm për të ulur ata numra, pa presion ekuivalent për të ruajtur integritetin e sistemeve të regjistrimit dhe raportimit.<sup>37</sup> Instituti Kombëtar i Drejtësisë në SHBA thekson se presioni për të arritur objektivat e sigurisë publike, veçanërisht kur është tepër ambicioz, jep shkas për manipulimin e statistikave të krimit - shtypjen e raporteve dhe klasifikimin e gabuar të krimeve - dhe format e tjera të korrupsionit.<sup>38</sup>

Ekspertët tregojnë se sjellja e pahijshme organizative lind kur kërkesa popullore vë theks më të madh në arritjen e qëllimeve sesa në kufizimin e mjeteve.<sup>39</sup> Si rezultat, normat

37 Malcolm K. Sparrow (2015), 'Matja e Perfromacës në një Organizatë Moderne Policore' në 'Perspektivat e Reja në Policim'. (Instituti Kombëtar i Drejtësisë).

38 Po aty

39 D, Vaughan, 'Kontrollimi i Sjelljes së Paligjshme Organizative: Struktura Shoqërore dhe Sjellja e Pahijshme Korporative', Çikago, Illinois: Shtypi i Universitetit të Çikagos, 1983 dhe R.K., Merton, 'Struktura Sociale dhe Anomia,' në Teorinë Sociale dhe Strukturën Sociale, ed. i zmadhuar., Nju Jork: Nju Jork: The Free Press, 1968. Shih gjithashtu sh. 37



*Analiza gjinore është një shqyrtim kritik i mënyrës sesi ndryshimet në rolet, aktivitetet, nevojat, mundësitë dhe të drejtat/garancitë ndikojnë tek burrat, gratë, vajzat dhe djemtë në situata ose kontekste të caktuara.*

që rregullojnë mjetet marrin më pak vëmendje dhe priren të humbasin ndikimin e tyre në sjelljen rregulluese.

Për shembull, politikat e sigurisë që theksojnë objektivat kundër terrorizmit mund të nxisin veprimin e policisë ndaj komuniteteve të synuara përmes "pranisë së tepërt të policisë" me rrezikun e prishjes së përpjekjeve të mëparshme të policisë në komunitet për të fituar besimin e komuniteteve, përfshirë nga gratë dhe vajzat që mund të jenë në grup minoritar dhe/ose të padukshëm, pra më i ndjeshëm ndaj DHGV-së. Në një shembull tjetër, politikat e sigurisë që kërkojnë të zvogëlojnë numrin e imigrimeve të paligjshme shpesh i detyrojnë migrantët ilegalë të mos raportojnë krimet e kryera kundër tyre ose të tjerëve, siç janë ato të ndërlydhura me skllavërinë moderne, trafikimin e qenieve njerëzore, dhunën ndërpersonale dhe dhunën seksuale ndër të tjera.

Duke zbatuar një **analiza gjinore** që merr parasysh faktorët ndërsektorial (shih më poshtë) në mbledhjen e të dhënave të krimit të ndërlydhur me gjininë, drejtuesit e policisë mund të identifikojnë më mirë ndikimin diferencial që kanë veprimet e tyre në komunitetet të cilave u shërbejnë dhe mbrojnë. Një informacion i tillë është kritik për t'i përcjellë publikut kur paraqitet shkalla e krimit të raportuar.

Për më tepër, sigurimi se planifikimi i ekipit tuaj përfshin një analizë të ndjeshme gjinore<sup>40</sup> mbi veprimet e veta do të ndihmojë për të zbutur përforcimin e diskriminimit të së kaluarës të kryer nga kolegë policë ose partnerë të tjerë të ngushtë në sistemin e drejtësisë. Kjo nga ana tjetër

40 Analiza gjinore gjithashtu duhet të përqipet të vlerësojë profilin demografik të viktimës/të mbijetuarës kundër tendencave të viktimizimit, perceptimit publik të studimeve të policisë dhe statistikave të krimit nga të gjitha nivelet.

**“Mund të jetë e lehtë të kategorizosh nën-komunitetet, siç janë gratë që janë të ndjeshme. Kjo nga ana tjetër mund të krijojë një perceptim se grupet e grave janë më të dobëta se grupet e burrave, duke i marginalizuar më tej nën-komunitetet e grave. Duhet të miratohet një qëndrim që i fuqizon gratë të njohin pikat e forta që posedojnë. Prandaj, një zyrtare policore femër në një pozitë udhëheqëse është një model i vlefshëm për gratë dhe vajzat në komunitete.”**

Paketa e Veglave Gjinore të Policisë së OKB-së (2015)

do të ndihmojë për të zvogëluar rrezikun që ekipi juaj të kryejë shkelje të të drejtave të njeriut gjatë detyrës.

Manuali i ofron policisë shumë tregues të ndryshëm të referencës bazuar në *Karakteristikat e Përbashkëta të Shërbimeve Thelbësore Cilësore* të PSHTH-së për të plotësuar normat e krimeve të veçanta në mënyrë që e gjithë pasqyra e përpjekjeve të policisë të vlerësohet nga komunitetet të cilave u shërben.

Treguesit e propozuar të referencës shpjegohen më gjerësisht në Kapitujt 3 deri në 9 të Manualit për të ndihmuar drejtuesit e policisë të identifikojnë se cilat burime të të dhënave do të forcojnë reagimin e ekipit të tyre ndaj DHGV-së, sipas Modullit 3: *Drejtësia dhe policimi i PSHTH-së*. Treguesit e referencës nuk janë domosdoshmërisht normativ, por përkundrazi kanë për qëllim të frymëzojnë udhëheqje proaktive drejt veprimeve të informuara me dëshmi.

## **NJOHJA E FAKTORËVE DIFERENCIALË DHE NDËRLIDHËS**

Gratë dhe vajzat nuk janë një grup homogjen, kështu që të dhënat e krimit duhet të pasqyrojnë nevojat diferenciale dhe ndërlidhëse të sigurisë së grave dhe vajzave, mbledhja e informacionit të detajuar dhe të ndjeshëm gjinor në lidhje me profilet demografike dhe socio-ekonomike të viktimave/të mbijetuarave do të jetë imperativ.<sup>41</sup>

41 *Strategjia e Modelit të Përditësuar dhe Masat Praktike për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave në Fushën e Parandalimit të Krimit dhe Drejtësisë Penale* (Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së 65/228, shtojca) u bën thirrje Shteteve Anëtare të krijojnë dhe forcojnë mekanizmat për mbledhjen sistematike të të dhënave mbi dhunën ndaj grave me qëllim të vlerësimit të fushëveprimit dhe shtrirjes së një dhune të tillë dhe për të udhëhequr hartimin, zbatimin dhe financimin e reagimeve efektive të parandalimit të krimit dhe drejtësisë penale.

Të dhënat e mbledhura gjithashtu duhet t'i nënshtrohen një **analize të ndjeshme gjinore** e cila kërkon të përcaktohet se cilat janë nevojat dhe pritjet e grave, burrave, vajzave dhe djemve, si janë të ndryshëm nga njëri-tjetri, nëse ndërhyrja e planifikuar po adreson nevojat e tyre gjinore dhe si mund të forcohet kontributi për nevojat e grave, burrave, djemve dhe vajzave.

**“Rreth 15 përqind e popullsisë së botës jeton me një formë aftësie të kufizuar.”**

Manuali i The Sphere (2018)

Si pjesë përbërëse e analizës së ndjeshme gjinore, lider-shipi i policisë duhet të angazhohet në zbatimin e një qasje ndërlidhëse ose **‘ndërlidhshmërinë’** që tregon se sa ndryshe gratë dhe vajzat i nënshtrohen dhunës dhe si e përjetojnë krimin. Kjo mund të përdoret për të kuptuar përvojat e grave dhe vajzave në ndërlidhjen e një sërë faktorësh shtypës të njëkohshëm duke përfshirë [por pa u kufizuar në] racën, klasën, kastën, gjininë, përkatësinë etnike, seksualitetin, aftësinë e kufizuar, kombësinë, statusin e imigrimit, vendndodhjen gjeografike, fenë e kështu me radhë.<sup>42</sup>

Identiteti shoqëror i një individi siç është të qenit një person me aftësi të kufizuara ose nga një grup minoritar<sup>43</sup> ose i nën-përfaqësuar, mund të kombinohet me

42 ‘Vlera e Ndërlidhshmërisë në Kuptimin e Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave (DHGV)’ (Imkaan, UN Women dhe Bashkimi Evropian, korrik 2019).

43 Minoritizimi në mënyrë efektive krijon dhe mban kushtet sociale, politike, ekonomike dhe të tjera që çojnë në trajtimin dhe përcaktimin e grupeve të njerëzve si pakica, p.sh. ‘pakica etnike’ dhe ‘etni minoritare’. Minoritizimi është një proces i vazhdueshëm, aktiv i cili marginalizon grupe të veçanta në bazë të ‘racës’, përkatësisë etnike dhe arsyeve të tjera. Shih: ‘Nga Margjina në Qendër: Akti Alternativ për Adresimin e Dhunës Kundër Grave dhe Vajzave’ (Imkaan, tetor 2018).



rrethanat e situatës, siç është konflikti i armatosur dhe/ose kriza humanitare për të rritur nivelet e rrezikut të DHGV-së.

**Shih Kapitullin 13 ‘Çështjet në zhvillim’ për më shumë informacion mbi mënyrën sesi rrethanat e ndërlidhura me konfliktin dhe identitetet individuale shoqërore ndërlidhen për të rritur ndjeshmërinë ndaj DHGV-së.**

Meqenëse policia ka detyrë kushtetuese dhe detyrim ndërkombëtar për të mbrojtur popullsinë vendase nga dhuna dhe krimi pa diskriminim, mënyra se si policia mbledh të dhëna të tilla reflekton angazhimin e tyre ndaj këtij shërbimi dhe detyre.

*Manuali i Sferës* (2018) rekomandon ndarjen e të dhënave në masën e mundshme dhe me kategoritë e përshtatshme për kontekstin për të kuptuar dallimet e bazuara në seks ose gjini, moshë, aftësi të kufizuar, gjeografi, etni, fe, kastë ose ndonjë faktor tjetër që mund të kufizojë qasjen në ndihmë të paanshme.<sup>44</sup>

**“Njerëzit që identifikohen si lezbike, homoseksualë, biseksualë, transgjitorë, homo ose interseksualë (LGBTQI) shpesh janë në rrezik të shtuar të diskriminimit, njolloshjes dhe dhunës seksuale dhe fizike.”**

Manuali i The Sphere (2018)

Të kuptuarit se si identiteti shoqëror dhe rrethanat e situatës mund të konvergojnë (ndërlidhën) për të rritur ose zvogëluar rrezikun ose kërcënimin për gratë dhe vajzat do të lejojë vendimmarrje më të informuar mbi caktimin e prioritetëve të burimeve njerëzore dhe materiale si në mënyrë parandaluese ashtu edhe në reagim ndaj DHGV-së. Për të ndihmuar në kuptimin e qasjes ndërseksionale<sup>45</sup> ndaj DHGV-së, UN Women (2018)<sup>46</sup> ka ilustruar karakteristikat dhe faktorët e situatës që ndikojnë në ndjeshmërinë e një gruaje dhe/ose vaje ndaj dhunës (Figura 5):


44 ‘Manuali i Sferës: Karta Humanitare dhe Standardet Minimale në Reagimin Humanitar’, botimi 4, (Shoqata The Sphere. Gjenevë, Zvicër, 2018).

45 Crenshaw, K., ‘Demargjinalizimi i Ndërlidhshmërisë së Racës dhe Seksit: Një Kritikë e Zezë Feministe e Doktrinës Kundër Diskriminimit, Teoria Feministe dhe Politikat Antiraciste’, *Vëllimi i Forumit Juridik* të Universitetit të Çikagos 1989, botimi 1 Neni 8.

46 ‘Paketa e Veglave të një Praktikuesi për Programimin e Qasjes së Grave në Drejtësi (UN Women et al. 2018), në: <https://www.unwomen.org/-/media/headquarters/attachments/sections/library/publications/2018/wa2j-complete-toolkit-en.pdf?la=en&vs=2654>

Figura 5:

Karakteristikat dhe faktorët e situatës që ndikojnë në ndjeshmëri



## ÇFARË NËNKUPTOHET ME QASJE TË PËRQENDRUAR TE VIKTIMA/E MBIJETUARA?

Sipas UNODC,<sup>47</sup> policia vepron me një **qasje të përqendruar te viktimat/e mbijetuara** kur vendos nevojat e viktimës/të mbijeturës në thelbin e çdo ndërhyrjeje, nga politika institucionale, deri në operacione dhe veprime konkrete. Kjo nënkupton sigurimin e një shërbimi që mbron, ndihmon dhe mbështet fuqizimin e grave dhe vajzave, duke i dhënë përparësi njëkohësisht çështjeve të sigurisë fizike dhe psikologjike.

Më e rëndësishmja, qasja e përqendruar te viktimat/e mbijetuara synon të shoqërojë viktimat/të mbijetuarat në kërkimin e tyre për qasje në drejtësi për krimet e DHGV-së në mënyrë të shprehur dhe me respekt, dhe paralelisht, të dekurajojë zyrtarët që t'i fajësojnë ata për ngurrimin e tyre për të bashkëpunuar me sistemin e drejtësisë penale. Prandaj, është e rëndësishme që policia të jetë në dijeni dhe të jetë e ndjeshme ndaj ndi-

kimit të traumës<sup>48</sup> dhe ta ketë viktimën/të mbijeturën në qendër, veçanërisht kur viktimat/të mbijetuarat duken jo bashkëpunuese pasi në fakt mund të jenë të traumatizuar nga frika e kryerësit dhe/ose presioneve më të gjera sistematike dhe kanë nevojë për mbështetje urgjente.

**Ruajtja e suksesshme e konfidencialitetit nga policia mund të çojë në raportimin e më shumë krimeve dhe më shumë besim në polici në përgjithësi.**

Paketa e Veglave Gjinore të Policisë së OKB-së 2015

47 'Fuqizimi i Parandalimit të Krimet dhe Reagimi i Drejtësisë Penale ndaj Dhunës ndaj Grave' (UNODC, 2014).

48 Të qenit i ndjeshëm ndaj përvojës traumatike të dikujt ose të qenit i informuar për traumat fokusohet në përvojat specifike që ndikojnë në traumën e viktimës/të mbijeturës, kujtesën, reagimet dhe sjelljen dhe mënyrën sesi interpretimi i reagimit të policisë ndaj kësaj sjelljeje ndikon në hetimet e sulmeve seksuale. Për më shumë informacion shihni 'Trajtimi i Hetimit të Sulmeve Seksuale të Informuara nga Trauma' nga Shoqata Ndërkombëtare e Shefave të Policisë (SHNSHP), në: <https://www.theiacp.org/projects/trauma-informed-sexual-assault-investigations>

Një qasje e përqendruar te viktimat/e mbijetuara nga policia kërkon që ata të kundërshtojnë qëndrimet e tolerancës ndaj DHGV-së, të dekurajojnë pasivitetin shoqëror dhe fajësimin e viktimave, dhe të pranojnë sesi këto krime kanë kosto të gjatë negative sociale dhe ekonomike për të gjithë shoqërinë, e lëre më ndikimin fizik dhe në shëndetin mendor tek viktimat/të mbijetuarat dhe fëmijët e tyre dhe anëtarët e tjerë të familjes.

Kjo gjithashtu do të thotë që zyrtarët policor në kontakt me viktimën/të mbijetuarën duhet të ndërmarrin hapa për të siguruar që ata të mos shkaktojnë viktimizim dytësor. Viktimizimi dytësor nuk ndodh si rezultat i drejtëpërdrejtë i një veprë penale, por më tepër nga reagimi joadekuat i policisë dhe institucioneve dhe individëve të tjerë kompetent ndaj viktimës.<sup>49</sup>

Vetëm duke qenë proaktiv dhe profesional në ushtrimin e detyrave të tyre të caktuara, zyrtarët policorë që reagojnë mund të minimizojnë ndjeshëm rrezikun e viktimizimit dytësor. Për shembull, zyrtarët policorë reagues lehtë mund të jenë vigjilent në vënien në dispozicion të raporteve policore për viktimat/të mbijetuarat për t'i ndihmuar ato në ndjekjen e urdhrave të mbrojtjes, mjeteve juridike civile, peticioneve të emigracionit, përfitimeve të sigurimit dhe kërkesave për kompensim.

Për të siguruar që qasja e përqendruar te viktimat/e mbijetuara mbron viktimën/të mbijetuarën nga dëmtimet e mëtejshme, kjo ju ndihmon të përballojnë ndjenjat e njollosjes dhe të fuqizojnë vendimmarrjen e tyre pa presion dhe gjykim, Policia e OKB-së ka propozuar katër parime udhëzuese që policia duhet t'i ndjekë me vigjilencë dhe profesionalizëm të duhur;<sup>50</sup>

1. Siguria fizike e viktimës/të mbijetuarës;
2. Konfidencialiteti i viktimës/të mbijetuarës;
3. Respektimi i të drejtave të viktimës/të mbijetuarës;
4. Mosdiskriminimi.

Më poshtë është një version i ngjeshur i veprimeve kryesore (Figura 6) që policia mund të ndërmarrë për të zbatuar *Parimet Udhëzuese për një Qasje të Përqendruar te Viktima* të Policisë së OKB-së për të siguruar që të mos bëhet dëm tjetër:

49 Shih sh. 47.

50 Paketa e Veglave Gjinore të Policisë së OKB-së (OKB. Departamenti i Operacioneve Paqësore - DOP/DPVT/Shërbimi i Trajnimit të Integruar, 2015)

## Figura 6

### Qasja e përqendruar te viktimë e Policisë së OKB-së

#### SIGURIA FIZIKE E VIKTIMËS

- Siguroni njohuri për rreziqet e sigurisë ndaj të cilave mund të ekspozohet viktimë
- Zhvilloni të gjitha bisedat, vlerësimet dhe intervistat në një mjedis të sigurt
- Siguroni që viktimë të ketë një vend të sigurt për të shkuar
- Verifikoni nëse viktimë rrezikon të ballafaqohet me kryerësin e dhunës
- Jini në dijeni për sistemet mbështetëse në dispozicion

#### KONFIDENCIALITETI I VIKTIMËS

- Ndani historinë e viktimës me profesionistë të tjerë të sistemit mbështetës vetëm kur viktimë e kupton se çfarë nënkupton kjo dhe ka dhënë pëlqimin paraprakisht
- Kufizoni qasjen në informacionin mjekësor për zyrtarët e autorizuar dhe profesionistët mjekësorë
- Mbronni të gjitha informacionet e hetimit për të siguruar sigurinë e viktimës dhe për të shmangur kërcënimin ose izolimin e viktimës nga komuniteti i tyre
- Siguroni që viktimë të mos përjetojë dhunë, pasiguri ose ri-viktimizim të mëtejshëm si rezultat i raportimit të krimit
- Veproni në mënyrë të veçantë sipas parimit të konfidencialitetit nëse ka bazë të arsyeshme për të vërtetuar abuzimin ose neglizhimin e fëmijëve, situatat kërcënuese për jetën, dyshim për prirje vetëvrasëse ose kërcënim serioz të dëmtimit të të tjerëve
- Kërkoni këshilla nga punonjësit e kujdesit shëndetësor dhe këshilltarët në situata që shkaktojnë përfashime nga parimi i konfidencialitetit

#### RESPEKTONI TË DREJTAT E VIKTIMËS

- Respektoni dëshirat, të drejtat dhe dinjitetin e viktimave duke demonstruar një qëndrim mbështetës
- Caktoni si prioritet vëmendjen për të gjitha nevojat e viktimës, përfshirë kërkesat mjekësore, psikologjike, sociale dhe ligjore
- Siguroni që interesat më të mira të çdo fëmije të përfshirë përfshirë marrjen e masave paraprake shtesë kur kërkohet pëlqimi dhe kur të konsultohet kujdestari i tyre ligjor
- Siguroni që drejtë e viktimës për informacion duke ofruar përditësime të përshtatshme për rastin e tyre për të lejuar vendimmarrjen e informuar dhe vlerësimin e rrezikut
- Siguroni që viktimë të jetë e përfshirë në vendimmarrje, në mënyrë që ato të fuqizohen dhe të kontrollojnë jetën e tyre
- Shmangeni dhënia e këshillës për viktimën pasi mund të merret për t'i thënë dikujt atë që mendoni se duhet të bëjë dhe si duhet ta bëjë, që do të thotë të futni mendimin tuaj personal
- Respektoni që viktimat kanë të drejtë të mos i nënshtrohen asnjë trajtimi, ekzaminimi ose ndërhyrjeje tjetër
- Viktimat të kenë të drejtë të shoqërohen nga një zyrtar policor ose këshilltar gjatë gjithë hetimit, por kjo duhet të vendoset nga viktimë, përfshirë nga kush ato duan të shoqërohen kur marrin informacion, merren në pyetje ose marrin shërbime të tjera

#### MOSDISKRIMINIMI

- Siguroni që të gjitha viktimat të trajtohen në mënyrë të barabartë me respekt dhe dinjitet, pavarësisht nga gjinia, mosha, prejardhja, raca, statusi i aftësisë së kufizuar, përkatësia etnike, orientimi seksual ose rrethanat e incidentit
- Jini të vetëdijshëm për paragjykimet dhe supozimet tuaja dhe të ekipit tuaj për dhunën seksuale me bazë gjinore, në mënyrë që të mos diskriminoni viktimat
- Monitoroni sjelljen tuaj dhe atë të ekipit tuaj, duke mos lejuar që besimet personale të ndikojnë në punën tuaj kolektive
- Jini të vetëdijshëm për gjuhën tuaj, gjuhën e trupit dhe qëndrimin e përgjithshëm ndaj viktimës

Source: See [http://repository.un.org/bitstream/handle/1176/387374/United%20Nations%20Police%20Gender%20Toolkit%20Compendium%20of%20Project%20Tools.pdf?sequence=55&isAllowed=y\\_at\\_p.303](http://repository.un.org/bitstream/handle/1176/387374/United%20Nations%20Police%20Gender%20Toolkit%20Compendium%20of%20Project%20Tools.pdf?sequence=55&isAllowed=y_at_p.303).

Pavarësisht sfidave organizative, ju si drejtues të policisë mund t'i udhëhiqni ekipet tuaja drejt suksesit operacional kur reagojnë ndaj DHGV-së duke u fokusuar në qasje me kosto efikase. Këto kërkojnë angazhimin tuaj drejtues ndaj paanësisë dhe barazisë, qëndrim proaktiv ndaj një qasjeje të përqendruar te viktimat/e mbijetuarat dhe shkathtësi në angazhimin e partneritetit. Për shembull, në Kutinë 6, Policia e OKB-së identifikon sesi drejtuesit e policisë mund t'i fuqizojnë policet femra të jenë agjente transformuese të ndryshimit dhe kanale të efektivitetit dhe efikasitetit të policisë për të reaguuar ndaj DHGV-së:

Ky Manual është hartuar për t'ju ndihmuar në rolin tuaj si drejtues i mesëm policor i cili ka përgjegjësinë për një ekip ose ekupe zyrtarësh policor në ofrimin e një shërbimi efektiv dhe të përgjegjshëm ndaj gjinisë për komunitetet tuaja lokale. Pavarësisht nëse jeni në krye të një stacioni policor, departamenti ose rajoni të policisë, do të përballeni me shumë sfida të përditshme, duke përfshirë mospërputhjen as për së afërmi të burimeve të kufizuara me një ngarkesë pune gjithnjë në rritje dhe ndryshim. Kjo është arsyeja pse është thelbësore që ju dhe stafi juaj të ndërtoni besimin dhe besueshmërinë e komuniteteve tuaja lokale në aftësinë tuaj për t'u ofruar atyre siguri dhe mbrojtje. Pa ndihmën dhe mbështetjen e komuniteteve të cilave ju i shërbeni, puna juaj do të jetë shumë më e vështirë; aftësia juaj për të arritur rezultate pozitive, për të nxitur performancën personale dhe ekipore dhe në këtë mënyrë të demonstroi tek drejtuesit tuaj të lartë kompetencat tuaja si udhëheqës, do të zvogëlohen shumë.

Kapitujt e mëposhtëm janë zhvilluar për përfitimin tuaj dhe stafit tuaj dhe ju jeni të inkurajuar të zbatoni udhëzimet e dhëna brenda kontekstit të mjedisit tuaj lokal të punës.

## Kutia 6

### Këshillat për komandantin në përdorimin e zyrtarëve policorë femra në një mënyrë efikase dhe efektive kur angazhohen komunitetet

**1. Bëjini zyrtarët policorë femra të qasshme për publikun:** Zyrtarët policor femra që punojnë në patrulla dhe poste fikse në zona me popullsi të madhe përmirësojnë dukshmërinë dhe sigurinë për personat, veçanërisht gratë dhe fëmijët, brenda atyre zonave;

**2. Pjesëmarrja e zyrtarëve policorë femra në operacione me rezultate të larta:** Zyrtarët policor femra që marrin pjesë në operacione me rezultate të larta dërgojnë një mesazh të rëndësishëm se ato kanë një rol kritik për të luajtur si ofrues të sigurisë. Për më tepër, zyrtarët policorë femra që kryejnë arrestime publike tregojnë se gratë janë të fuqishme dhe të afta. Roli i zyrtarëve policorë femra është veçanërisht i rëndësishëm në intervistimin e viktimave, dëshmitarëve dhe të dyshuarve, veçanërisht me gratë dhe fëmijët;

**3. Caktoni zyrtarë policorë femra në rolet në vijën e parë:** Zyrtarët policorë femra të përfshirë në reagimin e shpejtë ndaj incidenteve emergjente, veçanërisht incidenteve të çrregullimit, mund të demonstrojnë rolin e grave si një rol kryesor në njësitë policore;

**4. Njësi të specializuara me zyrtarët policorë femra:** Është e rëndësishme të krijohen njësi policore që janë veçanërisht të dedikuara për rastet e DHGV-së që përfshijnë zyrtarët policorë femra. Aftësia për një viktimë/të mbijetuar për të folur me një person të gjinisë së tyre do të sigurojë që të merren dëshmitë më të mira dhe viktimat të mbështeten;

**5. Rolet drejtuese:** Në takimet me viktimat, grupet e prekura, OJQ-të dhe agjencitë qeveritare, është e rëndësishme që vazhdimisht të demonstroi roli i grave në një rol kryesor në njësitë policore që merren me zgjidhjen e problemeve dhe zgjidhjen e çështjeve. Kjo siguron një mundësi për të nxjerrë në pah rolin e femrave në polici;

**6. Mbështetësit meshkuj:** Mbështetja aktive e zyrtarëve policor meshkuj për rolin e zyrtarët policorë femra është thelbësore. Kjo gjithashtu përfshin punën së bashku me zyrtarët policor të shtetit pritës për të promovuar rolin e ekupeve të barabarta anëtare, ku të gjithë pjesëtarët mbështesin dhe inkurajojnë aktivisht njëri-tjetrin.

Burimi: Paketa e Veglave Gjimore të Policisë së KB-ve (2015) fq 298



## SHËNIME DHE LEXIM TË SUGJERUAR

1. 'Strategjia e Abuzimit në Familje 2015-2020'. Prodhimi i këtij dokumenti dhe kontributi i burimeve për të mbështetur zhvillimin dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të Strategjisë, sponsorizohet nga Departamenti i Brendshëm i Shteteve të Guernsey, shih: <https://www.gov.gg/CHttpHandler.ashx?id=98929&p=0>
2. 'Paketa e veglave të një praktikuesi për programimin e qasjes së grave në drejtësi' (UN Women et al. 2018), në <https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2018/5/a-practitioner-toolkit-on-womens-access-to-justice-programming>
3. 'Çështje e të gjithëve: Përmirësimi i përgjigjes së policisë ndaj abuzimit në familje', në: <https://www.justiceinspectorates.gov.uk/hmicfrs/wp-content/uploads/2014/04/improving-the-police-response-to-domestic-abuse.pdf>
4. 'Pse disa burra përdorin dhunën kundër grave dhe si mund ta parandalojmë atë?' Të gjetura kuantitative nga Studimi Shumë-Shtetësh i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Burrat dhe Dhunën në Azi dhe Paqësor, në: <http://www.partners4prevention.org/sites/default/files/resources/p4p-report.pdf> Partnerët për parandalim (2013). Partnerët për parandalim janë program i përbashkët UNDP, UNFPA, UN Women dhe UNV për parandalimin e dhunës me bazë gjinore në Azi dhe Paqësor.
5. Paketa e Veglave Gjinore: Praktikat më të Mira të Standardizuara për Integrimin Gjinor në Manualin e Paqeruajtjes (Policia e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, 2015) në: <http://repository.un.org/bitstream/handle/11176/387374/United%20Nations%20Police%20Gender%20Toolkit%20Handbook.pdf?sequence=51&isAllowed=y>
6. Departamenti i Drejtësisë Lëshon Udhëzime për Identifikimin dhe Parandalimin e Paragjyqimeve Gjinore në Reagimin e Zbatimit të Ligjit ndaj Sulmeve Seksuale dhe Dhunës në Familje (Departamenti Amerikan i Drejtësisë, Zyra për Çështje Publike, 2015) në: <https://www.justice.gov/opa/pr/justice-department-issues-guidance-identifying-and-preventing-gender-bias-law-enforcement>
7. Sondazhi i udhëhequr nga OSBE për dhunën ndaj grave: Raporti kryesor (Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë, 2019) në: <https://www.osce.org/secretariat/413237?download=true>
8. Standardet Kombëtare të Rezultateve për Ndërhyrjet ndaj Kryerësve (SKRNNK), Raporti Bazë 2015-2016. Departamenti Australian për Shkencat Sociale. <https://plan4womenssafety.dss.gov.au/wp-content/uploads/2018/08/nationaloutcome-standardsreportweb.pdf>
9. Welch, J. Dhe F. Mason., (2007), 'Përdhunimi dhe Sulmet Seksuale' Revista Mjekësore Britanike 334, nr. 7604: 1154-1158.
10. Përparimi i Grave të Botës në Ndjekje të Drejtësisë (UN Women, 2011), në: <https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2011/7/progress-of-the-world-s-women-in-pursuit-of-justice>
11. Crenshaw, K. 'Demargjinalizimi i Ndërlidhshmërisë së Racës dhe Seksit: Një Kritikë e Zezë Feministe e Doktrinës Kundër Diskriminimit, Teoria Feministe dhe Politikat Antiraciste', Vëllimi i Forumit Juridik të Universitetit të Çikagos 1989, botimi 1 Neni 8. <https://chicagounbound.uchicago.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1052&context=uclf>
12. Manuali i Sphere: 'Karta Humanitare dhe Standardet Minimale në Reagimin Humanitar' botimi 4, (Gjenevë, Zvicër, 2015) në: [www.spherestandards.org/handbook](http://www.spherestandards.org/handbook)
13. Bastick, M., dhe Valasek, K., Diskutimi, Monitorimi dhe Vlerësimi i Reformës në Sektorin e Sigurisë dhe Gjinia. Paketa e Veglave Gjinore dhe RSS (Qendra e Gjenevës për Qeverisjen e Sektorit të Sigurisë, 2008), në: <https://www.dcaf.ch/gender-security-sector-reform-toolkit>
14. Paketa e Burimeve të Dhunës me Bazë Gjinore: Një Mjet i Standardizuar i Trajnimit për Mbajtësit e Detyrave, Palët e Interesit dhe Mbajtësit e të Drejtave (UN Women, 2019)
15. Rasti studimor: Imkaan - Mbështetja e të Mbijetuarave Aziatike, Zezake, të Pakicave, Etnike dhe Refugjate (MB), në: [http://www.endvawnow.org/uploads/browser/files/shelter\\_uk\\_case\\_study\\_imkaan.pdf](http://www.endvawnow.org/uploads/browser/files/shelter_uk_case_study_imkaan.pdf)
16. 'Si po i zhgënjën policia të viktimat e dhunës seksuale' (2014) Bates, L., për *The Guardian* në: <https://www.theguardian.com/lifeandstyle/womens-blog/2014/nov/21/police-letting-rape-victims-down-too>
17. 'Nga Margjina në Qendër: Akti Alternativ për Adresimin e Dhunës Kundër Grave dhe Vajzave' (Imkaan, tetor 2018), në: [https://829ef90d-0745-49b2-b404-cbea85f15fda.filesusr.com/ugd/2f475d\\_91a5eb3394374f24892ca1e1ebf6ea2e.pdf](https://829ef90d-0745-49b2-b404-cbea85f15fda.filesusr.com/ugd/2f475d_91a5eb3394374f24892ca1e1ebf6ea2e.pdf)
18. Mjeti 2: Policimi dhe Gjinia në *Paketën e Veglave për Gjini dhe Siguri* (Gjenevë: DCAF, OSCE/ZIDDNJ, UN Women, 2019) në: [https://www.dcaf.ch/sites/default/files/publications/documents/GSToolkit\\_Tool-2%20EN%20FINAL.pdf](https://www.dcaf.ch/sites/default/files/publications/documents/GSToolkit_Tool-2%20EN%20FINAL.pdf)
19. 'Policia', Seritë e RSS-së në Prapaskenë, (Gjenevë: DCAF, 2015) në: <http://ssrbackgrounders.org/fall.php?p=16&l=EN>
20. 'Integrimi i gjinisë në mbikëqyrjen e brendshme të policisë' (DCAF, OSBE, OSCE/ZIDDNJ, 2014) në: <https://www.dcaf.ch/integrating-gender-internal-police-oversight>
21. 'Policia si një Pikë Hyrëse për t'i Dhënë Fund Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave. Mësime nga Organizatat e Shoqërisë Civile' (Fondi i Mirëbesimit i OKB -së për t'i dhënë fund dhunës kundër grave, Nju Jork, 2019).
22. 'Vlera e Ndërlidhshmërisë në Kuptimin e Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave (DHGV)' (Imkaan, UN Women dhe Bashkimi Evropian, korrik 2019) në: <https://www2.unwomen.org/-/media/field%20office%20eca/attachments/publications/2019/10/the%20value%20of%20intersectionality%20in%20understanding%20violence%20against%20women%20and%20girls.pdf?la=en&vs=3339>
23. 'Studim tematik mbi çështjen e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe aftësinë së kufizuar' Raport i Zyrës së Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, (A/HRC/20/5), 30 mars 2012, në: <https://www2.ohchr.org/english/issues/women/docs/A.HRC.20.5.pdf>

24. 'Gjykimi i Përdhunimit. Kuptimi i Reagimit të Sistemit të Drejtësisë Penale ndaj Dhunës Seksuale në Tajlandë dhe Vietnam' (UN Women, UNDP dhe UNODC, 2017), në: [https://www.unwomen.org/-/media/field%20office%20easia/docs/publications/2019/08/ap-trial-of-rape\\_26aug2019\\_low-res-compressed.pdf?la=en&vs=1916](https://www.unwomen.org/-/media/field%20office%20easia/docs/publications/2019/08/ap-trial-of-rape_26aug2019_low-res-compressed.pdf?la=en&vs=1916)
25. 'Politika për Reagimin ndaj Dhunës ndaj Partnerit Intim dhe Udhëzimet e Përmbajtjes së Trajnimit 6 (Shoqata Ndërkombëtare e Shefave të Policisë, 2015) në: <https://www.theiacp.org/sites/default/files/all/i-j/IACPIntimatePartnerViolenceResponsePolicyandTrainingGuidelines2017.pdf>
26. Fjalor i Termave të Përbashkët në Barazinë Gjinore dhe Teorinë Feministe (2015). Šribar, R. në ShkencaT Gjinore: Anketat dhe Studimet Sllovene për Paradigmat e BE-së, Vjenë, Echoraum. M. Ule, R. Šribar and A. U. Venturini, bt.
27. 'Ndjeshmëria gjinore. Instituti Evropian për Barazi Gjinore', në: [https://eige.europa.eu/thesaurus/terms/1218?utm\\_source=newsletter&utm\\_medium=email&utm\\_campaign=how\\_gender\\_equal\\_is\\_your\\_parliament&utm\\_term=2019-11-27](https://eige.europa.eu/thesaurus/terms/1218?utm_source=newsletter&utm_medium=email&utm_campaign=how_gender_equal_is_your_parliament&utm_term=2019-11-27)
28. UNODC, Doracak për Reagimet Efektive Policore ndaj Dhunës ndaj Grave (Vjenë 2010), në dispozicion në [anglisht](#), [spanjisht](#), [frëngjisht](#)
29. UNODC, Plan-programi i Trajnimit për Reagimet Efektive Policore ndaj Dhunës ndaj Grave (Vjenë, 2010), në dispozicion në [anglisht](#), [spanjisht](#), [frëngjisht](#)







# PARANDALIMI

*“Parandalimi është imperativi i parë i drejtësisë”*

**Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për sundimin e ligjit dhe drejtësinë tranzicionale në shoqëritë pas konfliktit (S/2004/616, para. 4)**

---

# QËLLIMI I KAPITULLIT

---

**Krimet e DHGV-së po pengohen si rezultat i strategjive të parandalimit të policisë që janë të informuara në mënyrë adekuate nga palët e interesit, të mbështetura nga komunitetet dhe janë të përqendruara në qasjen e tyre ndaj viktimave/të mbijetuarve.**

---

## Mesazhet kryesore dhe pikat mësimore

- Kuptimi i natyrës së DHVG-së, shkaqeve dhe pasojave të saj dhe si ndikon ajo tek gratë dhe vajzat ndryshe dhe në mënyrë disproporcionale, është në thelb të parandalimit të tij;
- Parandalimi fillon me aftësinë për të identifikuar dhe analizuar shkaqet rrënjësore të DHVG-së në mënyrë që të gjejnë zgjidhje;
- Parandalimi i DHVG-së kërkon një qasje bashkëpunuese ndërmjet policisë, agjencive të tjera/ofruesve të shërbimeve dhe komunitetit lokal;
- Parandalimi i DHVG-së nënkupton konsultimin e atyre që janë në rrezik më të madh të dëmtimit;
- Rritja e besimit dhe besueshmërisë së publikut ndaj policisë janë shenja se strategjitë parandaluese po funksionojnë;
- Burrat mund dhe duhet të tregojnë udhëheqje duke mbajtur një qëndrim vokal kundër DHVG-së;
- Prioriteti duhet të jetë në aktivitetet që fokusohen në ndërhyrjet për të ndaluar dhunën, parandaluar dhunën në të ardhmen dhe inkurajuar gratë dhe vajzat të raportojnë për sigurinë e tyre.



## HYRJE

Që parandalimi të ketë ndikim në zvogëlimin e krimeve të përhapura dhe të nën-raportuara siç është DHVG, policia duhet të mbështetet nga komunitetet të cilave u shërben. Investimi i përpjekjeve, kohës dhe burimeve për parandalimin e krimit për komunitetet nuk është vetëm një investim i mirë, por gjithashtu shpëton jetë.

Foto kurtuazie nga MINUSTAH/Logan Abassi (Haiti)

Në marrjen e një qasjeje të bazuar në prova<sup>1</sup> për policimin, autoritetet britanike mësuan se krimi rritet kur ka më shumë mundësi për të kryer vepra, dhe bie kur zvogëlohet numri i mundësive.<sup>2</sup> Kjo i ka shtyrë ata të supozojnë se krimi mund të parandalohet duke hequr mundësinë për ta kryer atë. Kjo mund të bëhet vetëm në bashkëpunim me komunitetet e prekura.

Duke pasur parasysh që komunitetet shpesh janë shumë të ndryshme; është e rëndësishme që qasja e policimit të jetë e ndjeshme dhe e përgjegjshme ndaj këtij diversiteti. Kjo përfshin të kuptuarit se, brenda shumë komuniteteve, ka individë dhe grupe që përfshihen dhe marginalizohen në mënyra të shumta dhe të ndërlikura.

1 Shih Guerette, RT & Bowers, KJ (2009), 'Vlerësimi i Shtrirjes së Zhvendosjes së Krimit dhe Përhapja e Përfitimeve: Një Përmbledhje e Vlerësimeve të Parandalimit të Krimit të Rastit', në *Kriminologji*, 47 (4), në *Strategjinë Moderne të Parandalimit të Krimit* (Ministria e Brendshme e MB-së, 2016).

2 *Strategjia Moderne për Parandalimin e Krimit*, (Ministria e Brendshme e MB-së, 2016).

Për të mbështetur dhe bashkëpunuar me policinë, komunitetet presin një shërbim policor sa legjitim aq edhe efektiv. Sipas Qendrës së Gjenevës për Qeverisjen e Sektorit të Sigurisë ('DCAF'), legjitimiteti i policisë është një dimension vendimtar i policimit të mirë; i referohet shkallës së mbështetjes publike për policinë.<sup>3</sup>

**“Në përputhje me standardet e OKB -së, çdo polici ose agjenci tjetër e zbatimit të ligjit duhet të jetë përfaqësuese dhe përgjegjëse dhe llogaridhënëse ndaj komunitetit të cilit i shërben.”**

Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 34/169 e 17 dhjetorit 1979

Mbështetja publike për policinë kërkon që ata të jenë të përgjegjshëm ndaj nevojave të ndryshme të sigurisë së komunitetit. Integrimi i zërave të grave, pavarësisht nga prejardhja e tyre, duke mbështetur nismat dhe organizatat që kërkojnë pjesëmarrje të barabartë dhe

3 *Paketa e Veglave të Integritetit të Policisë (DCAF, 2012).*

## Kutia 1

### Koordinim do të thotë konsultim



Foto kurtuazie nga MINUSTAH/Logan Abassi /(Haiti)

Për të kuptuar fenomenin e krimit dhe dhunës që prek gratë dhe vajzat, përpjekjet e koordinuara duhet të informohen përmes një procesi konsultativ. Ky proces konsultativ duhet të sigurojë pjesëmarrjen kuptimplotë të grave dhe vajzave, në mënyrë që zërat e tyre të dëgjohen dhe prioritetet e tyre të reflektohen në përpjekjet e koordinuara.

Instituti Evropian për Barazi Gjinore ka propozuar katër hapa për konsultimin e palëve të interesit që mund të jenë shumë të dobishme për policinë kur krijojnë partnerë koordinues në përgjithësi dhe sigurojnë pjesëmarrjen e tyre domethënëse. Këta përfshijnë:

- **Planifikimi** Kjo përfshin përcaktimin e qëllimit të konsultimit dhe temat që do të trajtohen, identifikimin e atyre që duhet të konsultohen dhe kushtimin e vëmendjes për të siguruar balancin gjinor, si dhe një përfaqësim adekuat dhe të larmishëm të organizatave me ekspertizë gjinore. Në këtë fazë, është e rëndësishme të identifikohen grupet, zërat e të cilëve tradicionalisht janë marginalizuar në proceset e vendimmarrjes (p.sh. gratë migrante) dhe të cilët mund të kenë nevojë për mbështetje të përshtatur për angazhim, si dhe marrjen parasysh të kërkesave specifike për pjesëmarrje që duhet të përmbushen (për shembull, sigurimi i kujdesit për fëmijët).
- **Konsultimi me palët e interesit.** Ky proces duhet të kryhet herët, kështu që çështjet e duhura ndikojnë në vendimet me të cilat ndërlidhen, shpërndajnë informacionin përkatës paraprakisht dhe lokalizohen për të pasqyruar kornizat kohore të përshtatshme, kontekstin dhe gjuhët lokale.
- **Përfshirja e reagimeve** nga konsultimet në planifikimin strategjik të përpjekjeve të koordinuara për të siguruar që opinionet e palëve të interesit, nevojat dhe shqetësimet e ndryshme mbi barazinë gjinore të pasqyrohen në mënyrë adekuate në vendimin/ndërhyrjen përfundimtare.
- **Dokumentimi** i procesit të konsultimit dhe rezultatet e tij dhe raportimi tek palët e interesuara. Kjo përfshin informimin e atyre që janë konsultuar për çështjet kryesore të ngritura si një hap thelbësor për ruajtjen e angazhimit.

Burimi: Përshtatur nga Konsultimet me Grupet e Interesit Gjinor (Instituti Evropian për Barazi Gjinore).

kuptimplotë të grave në zhvillimin dhe zbatimin e strategjive të parandalimit të krimit dhe dhunës është një mënyrë efektive që policia të fitojë legjitimitet dhe mbështetje, dhe përfundimisht, besim.

Në fakt, pjesëmarrja e grave në zhvillimin dhe zbatimin e strategjive parandaluese nuk duhet të kufizohet vetëm në DHGV dhe forma të tjera të krimeve të DHGV-së, por në të gjitha kategoritë dhe nivelet e krimeve. Kjo do të ndihmojë që të sigurohet që jo vetëm nevojat specifike dhe të larmishme të sigurisë së grave dhe vajzave të merren parasysh, por që përdorimi i kësaj perspektive të përdoret në mënyrë efektive dhe efikase për të zvogëluar mundësitë për të kryer krime në përgjithësi.

**“Legjitimiteti i policisë i përgjigjet nevojave të komunitetit, duke treguar gjykim të paanshëm dhe profesional dhe duke qenë efektiv në ofrimin e sigurisë.”**

Amnesty International (2007)


Integrimi i zërave të grave në strategjitë e parandalimit të krimit dhe dhunës nga policia duhet të krahasohet me ngritjen në mënyrë aktive të ndërgjegjësimit të publikut për DHGV, shkaqet e saj dhe pasojat për gratë dhe vajzat, familjet e tyre dhe komunitetet e tyre të ndryshme, si dhe dënimin me të cilin kryerësit e dhunës mund dhe duhet të përballen.

Po aq e rëndësishme është informimi i rregullt i komuniteteve në lidhje me angazhimin e policisë për një qasje të përqendruar tek viktima, një strategji hetimi të fokusuar tek kryerësit dhe një proces transformimi institucional që është i përgjegjshëm dhe gjithëpërfshirës.

Sigurimi i informacionit në lidhje me shërbimet dhe mënyra se si viktimat/të mbijetuarit mund t'i përdorin ato pa diskriminim është një mënyrë tjetër, pasi i

dërgon një mesazh publikut se viktimat/të mbijetuarit e DHGV-së do të kenë qasje në mbrojtje dhe mbështetje.

Në thelb, zhvillimi dhe promovimi i kulturave organizative që punojnë për të siguruar qasje në drejtësi pa diskriminim dhe i japin përparësi qasjes me viktimën/të mbijetuarën në qendër do të jetë më i suksesshëm për parandalimin e krimit pasi do të gjenerojë legjitimitet dhe mbështetje për veprimet e policisë dhe besimin eventual nga komuniteteve që ata synojnë t'u shërbejnë.



## UDHËZIMET NGA KOLEGËT


Luftimi i DHGV-së nuk është vetëm përgjegjësi e policisë, në **të vërtetë parandalimi i DHGV-së është përgjegjësi e tërë shoqërisë; ju**, megjithatë, luani një rol kritik. Ekzistojnë një numër aspektesh kryesore në parandalimin e krimit, një prej të cilave është zbatimi i ligjeve ekzistuese për të siguruar që kryerësit të sillen para drejtësisë.

Duke kryer një hetim të plotë dhe të fuqishëm, duke identifikuar dhe ruajtur provat në një mënyrë të qartë dhe të detajuar, rritet perspektiva e sigurimit të shpalljes fajtor dhe dënimin të kryerësit të dhunë. Shpallja fajtor dhe dënimi do të dërgojnë një mesazh të qartë për shoqërinë se DHGV nuk do të tolerohet. Përderisa nuk keni kontroll mbi dënimin, ju keni kontroll mbi cilësinë e hetimit, duke siguruar që rasti më i fuqishëm i mundshëm t'i paraqitet prokurorit për shqyrtim përmes sistemit gjyqësor.

Një aspekt tjetër kryesor i parandalimit është aftësia për të analizuar problemin në mënyrë që të identifikohen zgjidhjet dhe të zbatohen strategji parandaluese. Ka disa modele që mund të përdorni për t'ju ndihmuar në proces, më poshtë është një shembull i vetëm njërit prej tyre:

Figura 1:

### Cikli i zgjidhjes së problemeve



Drejtuesit e policisë shpesh besojnë se raportimi i shtuar i DHGV-së është një reflektim negativ mbi kompetencën e reagimeve të policisë ndaj një krimi të tillë kur, në fakt, në fazat fillestare, ai duhet parë si një rezultat pozitiv.

Sa më shumë besim dhe besueshmëri të kenë gratë në polici, aq më shumë ka të ngjarë të raportojnë krimet e DHGV-së. Më shumë raportime ju sigurojnë më shumë të dhëna që ju mundësojnë të identifikoni problemet në mënyrë më efektive, kështu që ju mund të drejtoni ndërhyrjet e duhura parandaluese të cilat, në një afat më të gjatë, duhet të fillojnë të shohin një reduktim të përgjithshëm në këtë lloj krimi.

Nëse nuk ka raportim, nuk ka krim dhe për këtë arsye nuk mund të ketë drejtësi për viktimat/të mbijetuarat. Të dhënat për DHGV mund të merren edhe nga agjenci të tjera. Çfarë raportesh, për shembull, marrin ofruesit e tjerë të shërbimeve kur viktimat/të mbijetuarat janë shumë të frikësuara, ose mungesa e besimit i pengon ato që ta raportojnë atë në polici? Si mund të keni qasje në një informacion të tillë? A keni krijuar marrëdhënie bashkëpunimi me agjenci të tjera për të mundësuar shkëmbimin e informacionit për parandalimin e DHGV-së?

Që parandalimi i DHGV-së të jetë efektiv, kërkohet bashkëpunim ndërmjet policisë, agjencive të tjera/ofruesve të shërbimeve dhe komunitetit lokal.


Figura 2:

### Kuptimi i Dhunës ndaj Grave<sup>4</sup>

Për t'ju mundësuar që të analizoni në mënyrë efektive problemin, do të keni nevojë për të dhëna të kohëve të fundit dhe të sakta.

Inteligjenca është e vlefshme në këtë proces dhe sa më shumë besim dhe besueshmëri të ketë policia brenda komunitetit tuaj lokal, aq më shumë ka gjasa që të merrni inteligjencë përkatëse. Këtu janë disa gjëra që duhet të keni parasysh:

- Si siguroheni që mbahen shënime të sakta, jo vetëm për krimet e DHGV-së, por edhe incidentet që mund të mos përbëjnë një krim?
- Sa shpesh i analizoni krimet e DHGV-së për të përcaktuar se cilat modele të kryerjes së veprës janë të përhapura në zonën tuaj të juridiksionit?
- Si mund të parandaloni krimet e ardhshme nëse nuk jeni të vetëdijshëm për problemin dhe për këtë arsye nuk jeni në gjendje të vendosni në mënyrë efektive burimet tuaja të kufizuara?
- Si krahasohen krimet e DHGV-së në zonën tuaj me të dhënat e mbajtura në shkallë vendi?
- Si ndikon diversiteti i komunitetit tuaj lokal në llojet e krimeve të DHGV-së që po kryhen dhe nivelet e raportimit?
- Cila është përbërja kulturore e komunitetit tuaj?



### SHKAQET RRËNJË TË DHNVG

#### Pabarazia gjinore dhe diskriminimi në veçanti kontekstet e formuara nga

- faktorët ekonomikë, politikë dhe socialë, sistemet dhe normat, duke përfshirë politikat dhe kornizat ligjore dhe strukturat
- faktorët historikë (p.sh. praktikat kulturore me rrënjë të thella, lufta, kolonizimi)
- dallimet strukturore në bazë të moshës, të ardhurave, vendndodhjen, përkatësinë etnike, aftësinë e kufizuar, identitetin gjinor, seksual orientimi dhe karakteristika të tjera

4 Një Kornizë për të Mbështetur Veprimet për Parandalimin e Dhunës ndaj Grave (UN Women, 2015), f. 23 në: <https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2015/11/prevention-framework>



Fotografi kurtuazie nga UNMIT/Martine Perret (Timori Lindor)

Cilat rrjete bashkëpunuese ekzistuese ose partneritete/ forume komunitare ekzistojnë brenda zonës tuaj të policisë? Nëse ato nuk ekzistojnë, do t'ju duhet të jeni aktiv në angazhimin me agjenci të tjera dhe ofrues të shërbimeve, përfshirë shoqërinë civile, të cilët mund t'ju ndihmojnë për të zgjidhur problemet e krimit brenda zonës tuaj të përgjegjësive. Faktori më i rëndësishëm është që të gjithë të jeni dakord të angazhoheni për kryerjen e veprimeve për të parandaluar DHGV-në. Mund të ketë partneritete ekzistuese ose rrjete bashkëpunuese ku policia nuk është ftuar të bashkohet. Prandaj, duhet të siguroheni që dera të jetë e hapur në mënyrë që të jeni pjesë e zgjidhjes, jo vetëm për të ndihmuar viktimat/të mbijetuarat e DHGV-së, por edhe për të ndihmuar në përpjekjet tuaja në parandalimin e krimeve të tilla që të ndodhin në radhë të parë.

Lidhja ndërmjet angazhimit të komunitetit dhe rritjes së besimit dhe besushmërisë në polici është kritike. Mund të lehtësojë një gatishmëri më të madhe për publikun që të bashkëpunojë me policinë dhe, si rezultat, të përmirësojë mbledhjen e inteligjencës - dhe në këtë mënyrë përmirëson mbledhjen e të dhënave për analizën e problemeve, të cilat mund të ndihmojnë në parandalimin e të gjitha krimeve.

Shih Kolegjin e Policimit në Mbretërinë e Bashkuar *Cikli i Konfidencës*<sup>5</sup> (Figura 3) si një shembull se si lidhja ndërmjet angazhimit të komunitetit dhe rritjes së besimit dhe besushmërisë në polici mund të shihet si një proces ciklik.

*Informata shtesë për angazhimin mund të gjenden në Kapitullin 7: 'Mbështetja dhe Ndihma' dhe Kapitulli 8: 'Kordinimi ndërmjet Agjencive të Drejtësisë'.*

Çfarë mesazhesh jepni që **dhuna e çfarëdo lloji nuk do të tolerohet ndaj askujt, përfshirë në mesin e stafit tuaj?**



Foto kurtuazie nga Graham Goulden, Kryehetues në pension i Policisë së Skocisë

5 'Praktika Profesionale e Autorizuar e Angazhimit dhe Komunitetit' (Kolegji i Policimit, MB).



Çfarë mesazhesh i jepni stafit tuaj dhe komunitetit më të gjerë që burrat dhe djemtë kanë një rol kyç për të luajtur në parandalimin e DHGV-së? Si udhëheqës, ju duhet të dërgoni mesazhe të qarta dhe të caktuara se DHGV do të merret seriozisht. Pse të mos merrni parasysh identifikimin e stafit meshkuj dhe anëtarëve meshkuj të komunitetit të cilët mund të veprojnë si ‘kampionë meshkuj’ për të edukuar dhe ndikuar tek bashkëmoshtarët e tyre përse DHGV duhet të merret seriozisht?


Angazhimi i burrave dhe djemve për të adresuar DHGV-në është një përpjekje sfiduese dhe shpërblyese.

Kërkon angazhim për të udhëzuar me shembuj dhe për të qenë në gjendje të kuptojmë se si normat shoqërore dhe kulturore mund të ndikojnë në perceptimin e një dhune të tillë.

Në Shtojcën 1 ‘Angazhimi i Burrave’, Graham Goulden, një Kryehetues në pension i Policisë së Skocisë, me 30 vite shërbim përfshirë si hetues i specializuar në hetimin penal, hetimin e drogës, trajnimin dhe parandalimin e krimit, ofron udhëzime për veprimet që burrat mund të ndërmarrin për të ndihmuar në parandalimin e DHGV-së.

Figura 3<sup>6</sup>.

Cikli i Konfidencës së Kolegjit të Policisë në Mbretërinë e Bashkuar



Shënim: MKI është Modeli Kombëtar i Inteligjencës (MB) i cili siguron një qasje të strukturuar në mbledhjen, analizën dhe përdorimin e inteligjencës në tre nivele, 1. Çështjet lokale; 2 Çështjet ndërkufitare; 3 Çështjet kombëtare dhe ndërkombëtare - Krime serioze dhe të organizuar. Shih gjithashtu ‘Praktika Profesionale e Autorizuar e Angazhimit dhe Komunikimit’ (Kolegji i Policimit, MB).

6 Shih: <https://www.app.college.police.uk/app-content/engagement-and-communication/engaging-with-communities/>

## BALLAFAQIMI ME SFIDAT NË REAGIMIN NDAJ DHGV-SË FILLON ME IDENTIFIKIMIN E BOSHLLËQEVË NË PERFORMANCËN E EKIPIT TUAJ

Mungesa e strategjive efektive për parandalimin e krimit dhe dhunës do të ketë pasoja të mëdha. Viktimat/të mbijetuarat e DHGV-së janë në rrezik të lartë të problemeve të rënda dhe afatgjata shëndetësore, madje edhe të humbjes së jetës. Në nivelin shoqëror, DHGV mund të çojë në stigma shoqërore, refuzim, ndarje të familjeve, pastrehë, shpërndarje dhe varfëri.<sup>7</sup> Përveç kësaj, studimet kanë treguar se fëmijët që rriten me dhunë ka më shumë gjasa të bëhen viktimat/të mbijetuara vetë ose kryerës të krimeve të tilla si DHGV në të ardhmen.<sup>8</sup>



*Identiteti shoqëror i një individi, siç është personi me aftësi të kufizuara ose nga një grup i minorituar, mund të kombinohet me rrethanat e situatës, siç është konflikti i armatosur për të rritur nivelet e rrezikut të DHGV-së.*

Një reagim joefektive ndaj DHGV-së nga policia reaguese mund të gjurmohet nga mungesa e një kuptimi të qartë të natyrës së DHGV-së, shkaqeve dhe pasojave të saj dhe si ndikon ajo tek gratë dhe vajzat ndryshe dhe në mënyrë disproporcionale. Boshllëqet në performancën e ekipit të nxitur nga paragjykimet dhe stereotipet mund t'i atribuohen jo vetëm kuptimit të ndikimit të dhunës dhe krimit gjinor në gratë dhe vajzat, por edhe në shoqërinë në përgjithësi.

Si rezultat, është kritike që udhëheqja e policisë në të gjitha nivelet të kuptojë pse investimi në priorizimin e strategjive parandaluese nuk ka vetëm kuptim policor, por edhe socio-ekonomik.

7 Paketa e Burimeve të Dhunës me Bazë Gjinore: Një Mjet i Standardizuar Trajnimi për Bartësit e Detyrave, Palët e Interesit dhe Mbjatësit e të Drejtave (UN Women, 2019).

8 Dhënia Fund Dhunës ndaj Grave: Nga Fjalët në Veprim. Studimi i Sekretarit të Përgjithshëm (botimi i Kombeve të Bashkuara, Nr. i Shitjes E.06.IV.8).

Për shembull, pasojat ekonomike të DHGV-së janë të mëdha. Në Egjipt, një studim kombëtar arriti në përfundimin se kostoja e përgjithshme kombëtare e ekspozimit të grave ndaj dhunës tejkalon 785 milion funta egjiptiane (LE) në vit, dhe mbi tre miliardë LE gjatë tre viteve të fundit, ndërmjet 2007-2010.<sup>9</sup>

Një studim i ngjashëm në Keni tregoi se shpenzimet mjekësore nga xhepi (paratë që të mbijetuarat ose familjet e tyre i paguanin nga burimet e tyre financiare) dhe humbjet e produktivitetit nga dëmtimet u vlerësuan në një humbje totale prej 46 miliardë KES, që përkthehet në rreth 1.1 përqind të bruto produktit të brendshëm të Kenias.<sup>10</sup> Për më tepër, Banka Botërore raporton se në disa vende, dhuna ndaj grave vlerësohet t'i kushtojë vendeve deri në 3.7% të Bruto Produktit të Brendshëm - më shumë se dyfishi i asaj që shumica e qeverive shpenzojnë për arsim.<sup>11</sup>

Në vitin 2018, UNFPA zhvilloi një ilustrim informues si pjesë e *Udhëzimeve për Vlerësimin e Kostos Ekonomike të Dhunës në Familje në Rajonin Arab* për të ndihmuar qeveritë dhe partnerët e tyre të kuptojnë se si DHGV, si një fenomen social, ka implikime serioze ekonomike dhe sociale.<sup>12</sup>

9 'Një studim për Krijimin e një Mekanizmi të Reagimit Shumëdisiplinar ndaj Dhunës kundër Grave në Egjipt' (UNO-DC, 2015).


10 Paketa e Burimeve të Dhunës me Bazë Gjinore: Një Mjet i Standardizuar Trajnimi për Bartësit e Detyrave, Palët e Interesit dhe Mbjatësit e të Drejtave (UN Women, 2019).

11 Dhuna me Bazë Gjinore (Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave), (Banka Botërore, prill 2019) në: <https://www.worldbank.org/en/topic/socialsustainability/brief/violence-against-women-and-girls>

12 'Udhëzimet për Vlerësimin e Kostos Ekonomike të Dhunës në Familje në Rajonin Arab' (UNFPA, 2019) në: shiko: [https://archive.unescwa.org/sites/www.unescwa.org/files/publications/files/guidelines-estimate-economic-cost-domestic-violence-arab-region-english\\_o.pdf](https://archive.unescwa.org/sites/www.unescwa.org/files/publications/files/guidelines-estimate-economic-cost-domestic-violence-arab-region-english_o.pdf) Gjithashtu, shih 'Vlerësimi i Kostove të Dhunës Martesore në Modelin Operacional të Rajonit Arab (UN Women E/ESCWA/ECW/2017/Dokument teknik4, 18 korrik 2017).

Figura 4:

Vlerësimi i kostove të dhunës në familje në rajonin arab



Shih: <https://www.nuigalway.ie/media/researchcentres/womensstudies/womenstudies2020/Guidelines-to-estimate-the-economic-cost-of-domestic-violence-in-the-Arab-Region.pdf> p.6

Diagrami i mësipërm nga *Udhëzimet* e UNFPA 2019 demonstroi sesi dhuna në familje ka ndikime të shumta në shëndetin, arsimin dhe mundësitë e punës së grave.

Për shembull, diagrami nxjerr në pah sesi aftësia e grave për të përfitur nga mundësitë e punësimit dhe performanca e tyre e punës pengohen si rezultat i nënshtrimit ndaj dhunës në familje, duke çuar në humbje të produktivitetit që ndikon në ekonominë kombëtare.<sup>13</sup>

DHVG luan një rol të madh në përjashtimin e grave dhe vajzave nga jeta politike dhe ekonomike si rezultat. Kjo prek komunitete të tëra. Studime të tilla ato të dokumentuara në *Udhëzimet* e UNFPA 2019 se fuqizimi dhe

përfshirja ekonomike e grave mbështet rritjen ekonomike të tërë vendit.

Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se DHGV, në veçanti dhuna ndërpersonale, mund të shkaktojë paaftësi të përkohshme ose të përhershme, si mendore ashtu edhe fizike. Kjo mund të ndikojë drejtpërdrejt dhe tërthorazi në mundësinë e një gruaje ose vajze për të pasur qasje dhe për të shijuar arsimimin, punësimin dhe mundësi të tjera, përfshirë shumë vite pas kryerjes së veprimeve abuzive, si rezultat i të gjitha barrierave me të cilat ato do të përballen si gra dhe vajza, përfshirë diskriminimin dhe njollosjen.<sup>14</sup>

13 Po aty

14 Shih më tej: Humanity & Inclusion në: <https://www.hi-us.org/>

UNFPA shton se një dhunë e tillë ka efekte afatgjata në shëndetin dhe arsimin e fëmijëve, duke kufizuar potencialisht pjesëmarrjen e tyre të ardhshme ekonomike të cilat, kur kombinohet së bashku, rezultojnë në kosto të konsiderueshme për ekonominë kombëtare. Rritja e investimeve në parandalimin, mbrojtjen, ndjekjen penale dhe kompensimin, në fakt, do të rezultonte në kursime të konsiderueshme për qeveritë.

Për të kuptuar ndikimin tek fëmijët si rezultat i ndikimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga DHGV, është e dobishme të shqyrtohen rezultatet e gjetjeve nga një studim amerikan mbi përvojat e pafavorshme të fëmijërisë ('PPF'). Këto gjetje janë duke u zhvilluar dhe përdorur për të krijuar nisma parandaluese brenda një numri të forcave policore në të gjithë Mbretërinë e Bashkuar (shih Kutinë 2).

## Kutia 2

### Cilat janë përvojat e pafavorshme të fëmijërisë (PPF)?

PPF-të janë përvoja të pafavorshme të fëmijërisë që dëmtojnë zhvillimin e trurit të fëmijëve dhe çojnë në ndryshime në mënyrën se si ata reagojnë ndaj stresit. PPF -të dëmtojnë sistemin imunitar të një personi të ri aq thellë sa efektet shfaqen dekada më vonë. Në shumë mënyra, ndërsa mendja mund të harrojë, trupi jo.

PPF-të shkaktojnë pjesën më të madhe të barrës sonë të sëmundjeve kronike, shumicën e sëmundjeve mendore dhe janë burimi i dhunës më të madhe në shoqëri.

"PPF" vjen nga *Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (QKS)-Kaiser Adverse Childhood Experience Study*, një studim novator i shëndetit publik që zbuloi se traumat e fëmijërisë çojnë në shfaqjen e sëmundjeve kronike, depresionit dhe sëmundjeve të tjera mendore, dhunës dhe të qenit viktimë e dhunës tek të rriturit, si dhe probleme financiare dhe sociale.

## Përvoja të pafavorshme të fëmijërisë

Ngjarjet traumatike që mund të kenë efekte negative dhe të qëndrueshme në shëndet dhe mirëqenie




Figura 5: Imazhi nga përvojat e pafavorshme të fëmijërisë (PPF). Me kurtuazi nga organizata bamirëse WAVE Trust, shihni: <https://www.wavetrust.org/adverse-childhood-experiences>

10 PPF-të që studiuesit matën:

- Abuzimi fizik, seksual dhe verbal
- Neglizhenca fizike dhe emocionale
- Një anëtar i familjes i cili është:
  - në depresion ose i diagnostikuar me sëmundje të tjera mendore
  - i varur nga alkooli ose një substancë tjetër
  - ne burg
- Dëshmimi i abuzimit të nënës
- Humbja e prindërve nga ndarje, shkurorëzimi ose arsye të tjera

Pas studimit të PPF-së, anketat tjera të PPF-së kanë zgjeruar llojet e PPF-së për të përfshirë racizmin, diskriminimin gjinor, dëshmimin e abuzimit të vëllait ose motrës, dëshmimin e dhunës jashtë shtëpisë, dëshmimin e abuzimit të babait nga nëna, ngacmimin nga një bashkëmoshatar ose i rritur, përfshirjen në sistemin e kujdestarisë, jetesën në një zonë lufte, jetesën në një lagje të pasigurt, humbjen e një anëtar i familjes në dëbim, etj.

Përfshirja e të qenit viktimë ose dëshmitari i abuzimit sugjeron që fokusi në DHGV mund të mbështesë reduktimin e PPF-së në shoqëri dhe të kontribuojë në zvogëlimin e dhunës në të gjitha komunitetet. Ndërgjegjësimi i policisë për PPF-të dhe si t'i zvogëlojë ato duhet të diskutohet gjithmonë brenda çdo strategjie të parandalimit të dhunës.

Trajtimi i PPF-ve në komunitetin tuaj përfshin që ju të punoni në partneritet me një sërë organizatash dhe të shikoni se si PPF-të mund të minimizohen dhe parandalohen me qëllim të mbështetjes së një shoqërie më fleksibile, të sigurt dhe më të shëndetshme. Organizata Botërore e Shëndetësisë ('OBSH') në udhëzimin e saj "Çfarë funksionon" sugjeron që fokusi në "marrëdhënie të sigurta dhe mbështetëse prindërore" është çelësi për parandalimin e dhunës.

Ndërsa përkrahja e prindërve mund të mos duket një rol për policimin, përqendrimi në DHGV bie shumë domen i tij dhe prandaj zyrtarët policor duhet të jenë të vetëdijshëm për studimin e PPF-së dhe se si një fokus i tillë do të mbështesë policimin në përgjithësi.

Burimi: Graham Goulden për Kultivimin e Mendjeve në Mbretërinë e Bashkuar. Gjithashtu, shihni parandalimin e Dhunës nga Organizata Botërore e Shëndetësisë: Dëshmia <https://www.who.int/publications/i/item/violence-prevention-the-evidence> dhe ACES too High News <https://acestoohigh.com/>

Një përmbledhje e kohëve të fundit (2019) e qasjes së studimit të PPF-së ka shtuar se, për të parandaluar PPF-në, është e rëndësishme që monitorimi rutinor dhe i vazhdueshëm të përputhet me punën e shumë shërbimeve thelbësore për të arritur një kuptim më gjithëpërfshirës të ekspozimeve ndaj PPF-së, pasojat e tyre, dhe përpjekjet efektive parandaluese në këtë fushë. Po aq e rëndësishme është që policia dhe shërbimet e tjera thelbësore të gjurmojnë progresin e parandalimit të përpjekjeve të tyre dhe të vlerësojnë ndikimin e këtyre përpjekjeve.<sup>15</sup>

<sup>15</sup> Parandalimi i Përvojave të Pafavorshme të Fëmijërisë (PPF): Përdorimi i dëshmisë më të mirë të disponueshme) (Divizioni i Parandalimit të Dhunës, Qendra Kombëtare për Parandalimin e Lëndimeve dhe Qendrat e Kontrollit për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve, Atlanta, Gjeorgjia, 2019).

Kjo do të thotë që policia nuk duhet të jetë e ndjeshme vetëm ndaj të kuptuarit të natyrës së DHGV-së, shkaqeve dhe pasojave të saj siç është PPF, dhe si ndikon ajo tek gratë dhe vajzat ndryshe dhe në mënyrë disproporcionale, por gjithashtu të jetë proaktive dhe e vigjilente në raportimin e sistemeve të monitorimit institucional që kërkojnë të gjurmojnë progresin e përpjekjeve parandaluese.

Reagimi i zyrtarëve policorë të cilët nuk janë në gjendje të identifikojnë rolin(et) e tyre brenda një strategjie parandaluese mund të minojë përpjekjet kolektive për të reaguar në mënyrë efektive DHGV-së. Drejtuesit e policisë në të gjitha nivelet luajnë role kritike për të

siguruar që zyrtarët e tyre policor reagues të jenë të vetëdijshëm për kontributet e tyre individuale në parandalimin e DHGV-së.

Në vijim është një listë jo shteruese e frymëzuar nga një hartëzim i gjerë global e praktikave të mira dhe boshllëqeve të kapaciteteve të organizatave policore kur reagojnë ndaj DHGV-së. Hartëzimi përfshinte shtrirjen deri tek disa zyrtarë policor në shërbim dhe në pension, dhe personeli i OKB-së me përvojë në punën me policinë dhe organizatat joqeveritare të specializuara në adresimin e DHGV-së.

Boshllëqet e kapaciteteve të renditura më poshtë janë njohur si të dëmshme për përpjekjet e policisë në të gjitha pikat e procesit të hetimit, por në këtë rast, ato janë veçanërisht kundërproduktive për strategjitë e parandalimit të DHGV-së. Lista ka për qëllim të ndihmojë lidhshirë dhe policisë me përgjegjësi komanduese operacionale për të identifikuar shpejt boshllëqet e kapaciteteve në fazën më të hershme të mundshme para se të bëhet dëm ose dëmtim i mëtejshëm kundër viktimave/të mbijetuarave të DHGV-së.

Titujt e kategorive kanë për qëllim të ndihmojnë lexuesin të mbështetet në një çështje kryesore të hendekut të kapacitetit të identifikuar; megjithatë, në fakt, ato janë të gjitha të zbatueshme dhe/ose komplementare për secilën pikë:

## Paragjykimi gjinor

- Mungesa e të kuptuarit të natyrës së DHGV-së, shkaqeve dhe pasojave të saj dhe si ndikon ajo tek gratë dhe vajzat ndryshe dhe në mënyrë disproporcionale nxit paragjykime dhe stereotipe të dëmshme gjinore dhe minon përpjekjet parandaluese;
- Ajo merr veprimet e vetëm disa policëve që veprojnë në mënyrë të papërshtatshme dhe/ose tregojnë paragjykim ndaj grave dhe vajzave viktimave/të mbijetuarave për të minuar besimin e kërkuar të policisë nga partnerët - veçanërisht shoqëria civile,
- Lidhshirë i policisë shpesh nuk ka standarde institucionale që ofrojnë udhëzime të qarta dhe unike për dre-

jtuesit kur parandalojnë dhe reagojnë ndaj paragjykimeve gjinore dhe stereotipeve të ekspozuara nga stafi.

## Praktika e keqe

- Strategjitë që nuk janë parandaluese në natyrë shpesh rezultojnë të jenë joefektive për udhëzimet operacionale për *Reaguesit e Parë* të policisë kur ballafaqohen me lloje të caktuara të DHGV-së, siç janë martesat e fëmijëve dhe gjymtimi/prerja e organeve gjinore;
- Një fokus joproporcional në reagim sesa në një strategji parandaluese. Kjo zakonisht rezulton në rreziqe të reja të DHGV-së, siç është DHGV në internet e lehtësuara nga TIK, dhe krimet e ndërlydhura perceptohen shumë vonë nga disa komandantë policie. Në shumë raste, kjo është për shkak të mungesës së raportimit të detajuar nga vartësit të cilët nuk i vlerësojnë ose i kuptojnë kërkesat e të dhënave për parandalim efektiv;
- Në përgjithësi, politikatat nacionale të parandalimit të krimit nuk marrin parasysh përvojat unike dhe të larmishme të grave dhe vajzave - përfshirë viktimizimin - kështu që, kjo u lihet komandantëve të policisë që veprojnë në nivel lokal, pa burimet e duhura për ta bërë këtë.

## Boshllëqet në trajnim dhe arsim

- Një numër i konsiderueshëm i zyrtarëve policorë zakonisht nuk janë në dijeni të rolit të tyre individual në kuadrin e partneritetit kur parandalojnë DHGV-në;
- Edhe pse ata janë të vetëdijshëm për këtë, lidhshirë policor që menaxhon ekipet operative nuk kanë trajnim menaxherial për të adresuar në mënyrë efektive pranimin e nënkuptuar ose të qartë për krimet e DHGV-së, siç janë dhuna ndërpersonale, të ashtuquajturat krime “nderi” dhe vrasje të grave me motive gjinore, dhe për të fuqizuar komunitetet për t’i parandaluar ato;
- Programet e trajnimit për policinë nuk adresojnë sa duhet sjelljen e kryerësve të DHGV-së, veçanërisht elementet e kontrollit të detyruar që janë kritike për qasjet parandaluese. Si rezultat, zyrtarët policor përpiqen të

kuptojnë se si ky kontroll shtrëngues ndikon në veprimet e ndërmarra nga viktimat/të mbijetuarat e DH-GV-së. Për shembull, në rastin e dhunës ndërpersonale:

- duke mbetur me partnerin;
  - duke mos dashur të mbështesin veprimet e policisë; ose
  - duke u tërhequr nga mbështetja e një çështjeje penale.
- Mungesa e standardeve institucionale, të cilat ofrojnë udhëzime të qarta dhe unike për udhëheqjen e policisë kur parandalojnë dhe reagojnë ndaj paragjy-kimeve dhe stereotipave në polici, shpesh tregojnë se drejtuesit operacionalë nuk janë në një gjendje ideale për të reaguar ndaj saj.

## PËRKUFIZIMI DHE KORNIZAT

Udhëzimet e kornizës së PSHTH-së e drejtojnë përdoruesin drejt *Strategjive Model për Parandalimin e Krimit* të dakorduara nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në vitin 2010, *Strategjive Model të Përditësuara dhe Masave Praktike për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave në Fushën e Parandalimit të Krimit dhe Drejtësisë Penale*<sup>16</sup> si dhe *Udhëzimeve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimit*.<sup>17</sup>

Këto dokumente të dakorduara ndërkombëtarisht përforcojnë njëra-tjetrën duke theksuar se parandalimi në policim përfshin elementët e mëposhtëm: të drejtat e bazuara të njeriut, menaxhimin e rrezikut dhe promovimin e sigurisë dhe fuqizimit të viktimës/të mbijetuarës, duke siguruar përgjegjësinë e kryerësit. PSHTH shton se masat parandaluese të udhëhequra nga policia duhet të kenë përparësi në aktivitetet fokusohen kryesisht në ndërhyrjet për të ndaluar dhunën, parandaluar dhunën në të ardhmen dhe për të inkurajuar gratë dhe vajzat të raportojnë për sigurinë e tyre.<sup>18</sup>

16 A/RES/65/228 e 31 mars 2011, shtojcë.

17 Rezoluta e Këshillit Ekonomik dhe Social 2002/13 e 24 korrikut 2002, shtojcë.

18 Moduli 3: Paketa e Shërbimit Thelbësor të Drejtësisë dhe Policimit për Gratë dhe Vajzat që i Nënshtrohen Dhunës PSHTHGVNDH: Elementet Themelore dhe Udhëzimet për Cilësinë, (Programi i Përbashkët Global i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Shërbimet Thelbësore për Gratë dhe Vajzat që i Nënshtrohen Dhunës, 2015)

*“Parandalimi i krimit përfshin strategji dhe masa që kërkojnë të zvogëlojnë rrezikun e krimeve që ndodhin, dhe efektet e tyre të mundshme të dëmshme për individët dhe shoqërinë, përfshirë frikën nga krimi, duke ndërhyrë për të ndikuar në shkaqet e tyre të shumta.”*

Udhëzimet për Parandalimin e Krimit (Rezoluta e KESOKB 2002/13, Shtojca).

Në vitin 2002, Këshilli Ekonomik dhe Social i OKB-së dha udhëzime për parandalimin e krimit bazuar në praktikat më të mira, duke përfshirë një përkufizim pune:<sup>19</sup>

Paralelisht, Bashkimi Evropian rekomandoi<sup>20</sup> për shtetet anëtare të tij, *Ligjin Austriak për Dhunën në Familje dhe Modelin e Ndërhyrjes* për zgjidhjet e tij novatore në krijimin e një integrali të fokusuar në parandalimin, dhe sistemi të koordinuar për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, i njohur më mirë si *Modeli Austriak i Ndërhyrjes në Rastet e Dhunës në Familje*.<sup>21</sup> Rastësisht, modelit austriak iu dha çmimi i Politikave të Ardhshme 2014 si një politikë e praktikës më të mirë për t'i dhënë fund DHGV-së, pas pranimit të reagimeve pozitive nga viktimat/të mbijetuarat e dhunës.<sup>22</sup>

Modeli austriak është i rëndësishëm në dërgimin e një mesazhi të fuqishëm se DHGV nuk është një çështje private, por një çështje publike, ndër masat e tjera, duke i dhënë policisë kompetenca më të mëdha për të ndërhyrë kur ndodhin akte të tilla dhune. Modeli austriak

19 Udhëzimet për Parandalimin e Krimit, Rezoluta e KESOKB 2002/13, Shtojca).

20 ‘Modeli austriak’ është miratuar/përshtatur në një numër vendesh evropiane. Shih: “Lufta kundër Dhunës ndaj Grave: Standardet Minimale për Shërbimet Mbështetëse”, Drejtoria e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut dhe Çështjeve Ligjore, (Këshilli i Evropës, Strasburg, 2008); Shih gjithashtu ‘Studimin analitik të rezultateve të raundit 4 të monitorimit të zbatimit të Rekomandimit Rec (2002) 5 mbi mbrojtjen e grave nga dhuna në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, (Këshilli i Evropës, 2014), në: <https://rm.coe.int/16805915eg>

21 Shih Logar, Rosa, ‘Modeli austriak i ndërhyrjes në rastet e dhunës në familje’, Dokument i paraqitur në Takimin e Grupit të Ekspertëve të OKB -së: Dhuna ndaj Grave: Praktika e Mirë në Luftimin dhe Eliminimin e Dhunës ndaj Grave (Vjenë, 17–20 maj 2005).

22 Shih “Ndalimi i dhunës ndaj grave dhe vajzave: Politikat më të Mira Botërore (Çmimi i Politikave të Ardhshme, 2014) në Eliminimin e Dhunës ndaj Grave në Paqësorin Aziatik: Është e gjithë përgjegjësia jonë (UN Women, World Future Council dhe Inter-Parliamentary Union).

### Kutia 3

#### Masat e parandalimit\*

<b>Primare: duke përjashtuar shfaqjen e dhunës</b>	<b>Sekondare: identifikimi i faktorëve të rrezikut dhe grupeve në rrezik, ofrimi i ndihmës</b>	<b>Terciare: masat për të parandaluar dhunën e mëtejshme</b>
Rritja e vetëdijesimit, fushatat, nismat e komunitetit, arsimimi për të drejtat e njeriut, programet edukative për fëmijët dhe adoleshentët, masat e përgjithshme kundër diskriminimit dhe në favor të barazisë aktuale të grave, integrimi gjinor	Programet e sensibilizimit në institucione të ndryshme, krijimi i një linje ndihme për gratë, kontrollimi i shëndetit, masa për të fuqizuar pavarësinë e grave në nivelet juridike, ekonomike dhe sociale, nisma që mbështesin gratë emigrante	Ndihma për gratë e prekura nga dhuna, krijimi i strehimoreve për gratë, hartimi i ligjeve për mbrojtje nga dhuna, ndërhyrjet e kujdesshme dhe efektive të policisë, procedurat efektive të gjykatave penale

\*Burimi: Modeli Austriak i Ndërhyrjes në Rastet e Dhunës në Familje f.2

është gjithashtu i mirënjohur për dhënien e shembujve konkretë të masave parandaluese që kanë çuar në rezultate, të cilat janë klasifikuar në masa primare, sekondare dhe terciare.

Këto tre klasifikime të masave (shih Kutinë 3 Tabela për Masat e Parandalimit) mund t'i referohen policisë si mundësi për bashkëpunim dhe koordinim në parandalimin dhe hetimin e DHGV-së:

Për më tepër, është e rëndësishme të sqarohet se grupet në rrezik nuk janë të kufizuara në gratë dhe vajzat emigrante. Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara janë gjithashtu në rrezik të shtuar. Prandaj, policia duhet të përfshijë masa parandaluese terciare që sigurojnë që gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara të kenë qasje në shërbimet e drejtësisë, të mbrohen dhe të fuqizohen më tej për të thyer rrethin e viktimizimit.<sup>23</sup>

Frymëzuar nga qasja e tri masave të modelit austriak, Këshilli Ekonomik dhe Social i OKB-së Komisioni për Parandalimin e Krimit dhe Drejtësinë Penale ka rekomanduar katër masa kryesore të parandalimit për të

reaguar ndaj DHGV-së.<sup>24</sup> Lista më poshtë (Kutia 4) ofron katër masat kryesore të parandalimit të propozuara nga Komisioni i KESOKB-së me shembujt përkatës të veprimeve policore që mund të ndërmerren në përputhje:

Emëruesi i përbashkët përmes të gjitha përkufizimeve dhe kornizave të përshkruara është fokusi në proaktivitetin e policisë, brenda mundësive dhe kompetencave të tyre, për të modifikuar kushtet dhe situatat që mund të rrisin probabilitetin e krimeve të tilla siç është DHGV. Me fjalë të tjera, zvogëloni mundësitë që krime të tilla si DHGV të ndodhin.

**“Angazhimi efektiv i policisë identifikon të gjitha grupet e komunitetit, në veçanti gratë dhe fëmijët, dhe siguron mundësinë për reagime përmes përfaqësimit në grupe këshilluese, anketa të komunitetit, forume dhe takime.”**

Një Kornizë për të Mbështetur Veprimin për të Parandaluar Dhunën Kundër Grave. (UN Women, 2015).

<sup>23</sup> “Gratë dhe të Rejat me Aftësi të Kufizuara: Udhëzimet për Ofrimin e Shërbimeve të Bazuara në të Drejta dhe të Përgjegjshme Gjinore për të adresuar Dhunën me Bazë Gjinore dhe Shëndetin dhe të Drejtat Seksuale dhe Riprodhuese”, (UNFPA-WEI, nëntor 2018).

<sup>24</sup> Aspektet e dhunës kundër grave që i përkasin drejtpërdrejt Komisionit për Parandalimin e Krimit dhe Komisionit të Drejtësisë Penale për Parandalimin e Krimit dhe Drejtësinë Penale (Shënim nga Sekretariati, E/CN.15/2008/CRP.1 (2008) dhe studimi i Sekretarit të Përgjithshëm mbi dhunën ndaj grave, A/61/122/Sht.1, para. 337.



#### Kutia 4

#### Masat primare të KESOKB-së për parandalimin e DHGV-së

<b>Komisioni i Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimit dhe Drejtësinë Penale rekomandon:</b>	<b>Shembuj të veprimeve policore:</b>
Ndryshimi i qëndrimeve dhe sfidimi i stereotipeve në shoqëri dhe ndihma e komuniteteve për t'i dhënë fund pranimin të dhunës me bazë gjinore	Futja e trajnimit të detyrueshëm mbi paragjykimet gjinore dhe sistemit të meritave të ndërlidhura në të gjitha nivelet që synon dhe dekuron në mënyrë aktive qëndrimet dhe stereotipet e dëmshme brenda organizatës policore
Gratë të fuqizohen si politikisht ashtu edhe ekonomikisht, në mënyrë që të kapërcejnë pozitën e tyre vartëse në shoqëri	Prezantoni dhe përforconi një politikë me “Zero Tolerancë” për ngacimin seksual institucional dhe një mekanizëm për trajtimin e ankesave për të ndihmuar zyrtarët policorë femra të përmbushin potencialin e tyre në organizatë dhe për të bërë karrierën në polici më tërheqëse për zyrtarët policorë të ardhshëm femra
Mjediset fizike duhet të ndryshohen për të promovuar sigurinë e grave	Bashkëpunoni me palët e interesit në qeverisjen lokale dhe shoqërinë civile për të konsultuar gjerësisht grupe të ndryshme të grave dhe vajzave në të gjitha komunitetet për të përcaktuar mënyrën më efektive për t'i bërë mjediset fizike më të qeta dhe të sigurta për to
Programet e shumta të parandalimit, trajtimit dhe rehabilitimit të abuzimit me alkool dhe drogë duhet t'u ofrohen atyre, varësia nga substanca e të cilëve rrit gjasat e tyre për dhunë	Merrni pjesë në nismat e vetëdijesimit të komunitetit për të promovuar një kuptim të zakonshëm të natyrës së dhunës, shkaqeve dhe pasojave të saj dhe si ndikon ajo tek gratë dhe vajzat ndryshe dhe në mënyrë disproporcionale

*Paketa e Veglave Gjinore* të Policisë së OKB-së ju rekomandon drejtuesve të mesëm të policisë të zbatojnë modelin SARV si një mjet për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve të identifikuara me komunitetet.<sup>25</sup> SARV është një formë analize ndërsa kërkon zgjidhje. Modeli SARV ka katër hapa:

- Skanimi: Përcaktimi i problemit
- Analizimi: Studimi i problemit
- Reagimi: Vepra
- Vlerësimi: Vlerësoni sa mirë funksionuan veprimet

Modeli SARV mund të përdoret si një mjet efektiv angazhimi me komunitetin për të zgjidhur problemet përmes qasjeve pjesëmarrëse.<sup>26</sup>

Në Kapitulli i mëparshëm, udhëzimet për planifikimin e qëllimeve të frymëzuara nga PSHTH ofrohen për liderhipin e policisë me përgjegjësi komanduese operacionale (ose drejtuesit e mesëm). Si një strategji për të modifikoni kushtet dhe situatat që mund të rrisin krimet e DHGV-së, udhëzimet e kapitullit të mëparshëm theksuan përqendrimin e përpjekjeve të policisë në tri shtylla të parandalimit: 1) Kohëzimi i komunitetit për zgjidhje të bazuara në komunitet për DHGV; 2) Komunikimi i angazhimit politik dhe shoqëror për të reaguar

<sup>25</sup> *Paketa e Veglave Gjinore* të Policisë së Kombeve të Bashkuara (Departamenti i OKB-së për Operacionet Paqësore - DOP/DPVT/Shërbimi i Trajnimit të Integruar, 2015).

<sup>26</sup> Shihni Mjetin e Projektit 130: Lista kontrolluese për zgjidhjen e problemeve duke përdorur modelin SARV në *Paketën e Veglave Gjinore* të Policisë së OKB-së, Praktikant më të Mira të Standardizuara për Integrimin Gjinor në Përmbledhjen e Mjeteve të Projektit (2015).

Zyrtari i lartë i policisë skoceze mbështet fushatën e Shirimit të Bardhë të për t'i dhënë fund dhunës të bazuar në gjini



Fotografi kurtuazie e Policisë së Skocisë/PA Wire

ndaj DHGV-së dhe ndikimit të saj në anëtarët e komunitetit dhe shoqërinë; dhe 3) Akterët e drejtësisë dhe sigurisë janë duke mësuar dhe duke u reformuar për të reaguar në mënyrë adekuate ndaj DHGV-së. Udhëzimet e mëposhtme të ofruara janë të frymëzuara drejtpërdrejt nga Moduli i PSHTH-së 3 dhe përfshihen në tri shtyllat strategjike tashmë të përmendura.

Udhëzime plotësuese dhe të hollësishme mund të gjenden në seritë e publikimeve të UNODC mbi *Forcimin e Parandalimit të Krimit dhe Reagimin e Drejtësisë Penale ndaj Dhunës ndaj Grave* (2014) si dhe në *Paketën e Veglave Gjinore të Policisë së OKB-së: Praktikën më të Mira të Standardizuara për Integrimin Gjikor në Ruajtjen e Paqes* (2015). Udhëzimi i dhënë nga këto dokumente të OKB-së burojnë nga përvoja e ndarë nga institucionet policore në tërë botën, të cilët mbështesin sundimin e ligjit në mjedise sfiduese dhe shpesh ballafaqohen me burime të kufizuara. Këto dokumente duhet të shihen në bashkëpunim me udhëzimin e OKB-së për paran-

dalimin, “*Një Kornizë për të Mbështetur Veprimin për të Parandaluar Dhunën ndaj Grave*” (UN Women et al. 2015). Ky udhëzim do të ndihmojë në forcimin e një kuptimi të përbashkët të faktorëve që kontribuojnë dhe ofrojnë mbrojtje kundër DHGV-së, dhe rolin që sektorët dhe disiplinat e ndryshme mund të luajnë për të parandaluar këtë dhunë.

## KOMPETENCAT KRYESORE MENAXHERIALE PËR ZBATIMIN E STRATEGJIVE TË PARANDALIMIT TË DHGV-SË

Lista e mëposhtme e kompetencave të sjelljes për lidershipin e policisë është frymëzuar nga *Strategjia Model të Përditësuar dhe Masat Praktike për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave në Fushën e Parandalimit të Krimit dhe Drejtësisë Penale të vitit 2010* (Rezoluta e Asamblesë

së Përgjithshme 65/228).<sup>27</sup>

Ai përcakton sjelljet dhe vlerat e njohura ndërkombëtare isht dhe përshkruan se si duhet të kryeni punën tuaj që parandalimi i krimit të jetë i suksesshëm, duke rezultuar që ju dhe ekipi juaj të kryeni detyrat në një nivel më të lartë dhe të rrisni kënaqësinë e atyre që u shërbeni.

Kjo është një referencë e krijuar për të siguruar që ka pritshmëri të qarta për standardet ndërkombëtare<sup>28</sup> dhe, në të njëjtën kohë, plotëson dhe përforcon politikën e organizatës suaj kombëtare të policisë mbi vlerat, etikën dhe integritetin.

Është një listë jo shteruese e kompetencave kryesore të performancës që duhet të zbatohen dhe promovojnë drejtuesit e policisë me përgjegjësi komanduese operationale kur synojnë të pengojnë DHGV-në si rezultat i strategjive parandaluese që janë informuar në mënyrë adekuate nga palët e interesit, të mbështetura nga komunitetet dhe të përqendruara te viktimat/e mbijetuarat në qasjen e tyre. Drejtuesit duhet të sigurojnë që zyrtarët policor reagues të ofrojnë:

#### **Komunikim efektiv dhe pjesëmarrje nga palët e interesit në hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e shërbimeve**

- Promovoni barazinë, bashkëpunimin, respektin e ndërsjellë dhe përgjegjësi të përbashkëta ndërmjet grave dhe burrave;
- Jepni udhëzime të qarta dhe komunikoni pritshmëritë e qarta të përgjegjësi të përcaktuara mirë nga policia e specializuar, agjencitë kompetente, institucionet dhe personeli i përfshirë në përpjekjet parandaluese të DHVG-së;
- Jepni udhëzime të qarta dhe keni pritshmëri të qarta, duke ndihmuar të tjerët të kuptojnë se si funksionon parandalimi i tyre në kontekstin më të gjerë;
- Udhëhiqni ekipin drejt përmbytjes dhe menaxhimit të

<sup>27</sup> Shih Kodin e Sjelljes për Zyrtarët e Zbatimit të Ligjit (miratuar nga rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 34/169 e 17 dhjetorit 1979).

<sup>28</sup> Po aty

#### **Kutia 5**

#### **Edukimi dhe Trajnimi për Rezistencë ndaj Bandave (G.R.E.A.T)**

G.R.E.A.T. është një program mësimor në klasë që synon fëmijët e moshës 8 deri në 13 vjeçare me qëllim parandalimin e sjelljeve të dhunshme dhe anëtarësimin në banda, si dhe zhvillimin e marrëdhënieve pozitive ndërmjet të rinjve dhe policisë. Të 13 mësimet mbahen nga zyrtarët policor, të cilët marrin trajnime për të punuar me të rinjtë. Mësimet përfshijnë zhvillimin e aftësive sociale dhe emocionale dhe të mësuarit rreth krimit dhe anëtarësimit në banda. G.R.E.A.T.u zhvillua në SHBA, ku u vërtetua se ul rrezikun e anëtarësimit në banda dhe rrit qëndrimet më pozitive dhe ndihmuese në mesin e nxënësve 11-13 vjeçar. Qasja tani është zgjeruar në vendet e Amerikës Qendrore si Belize, Kosta Rika dhe El Salvador, ku zyrtarët policor janë trajnuar për t'ua ofruar projektin fëmijëve të shkollave fillore.

Burimi: Esbensen et al. (2012) në: <https://www.great-online.org/GREAT-Home>

niveleve të DHGV-së (hetim i mirë dhe zbatim i mirë);

- Bashkëpunoni me partnerët për të formësuar normat shoqërore që kontribuojnë në shkaqet e DHGV-së;
- Angazhohuni në programet e komunikimit për kryerësit e veprave ose personat e identifikuar si kryerës të mundshëm në mënyrë që të promovoni zgjidhjen paqësore të konflikteve, menaxhimin dhe kontrollin e zemërimit dhe modifikimin e qëndrimit për rolet dhe marrëdhëniet gjinore;
- Udhëhiqni në qasje multidisiplinare dhe të ndjeshme ndaj gjinisë me subjektet publike dhe private përmes partneriteteve për mbrojtjen e grave dhe vajzave viktimat të dhunës;<sup>29</sup> Kjo mund të përfshijë policinë që planifikon fushatën të rregullta proaktive me fokus DHGV-në (shih Kutinë 9, fotografia e Zëvendëshefit të Policisë së Skocisë, Iain Livingstone, duke dhënë mbështetjen e tij për fushatën e Shiritit të Bardhë - pjesë e një fushate globale për të inkurajuar burrat

<sup>29</sup> Kjo mund të përfshijë policinë që planifikon fushatën të rregullta proaktive me fokus DHGV-në.

## Kutia 6

### Parandalimi fillon me ju!



Qendra e Gjenevës për Qeverisjen e Sektorit të Sigurisë ('DCAF') ka rekomanduar në *Paketën e Veglave të Integritetit të Policisë* (2012) tri masa kontrolli për të parandaluar gabimet, praktikat korruptive ose sjelljet joetike. Gabimet, praktikat dhe sjelljet e tilla mund të destabilizojnë lehtësisht besimin që po ndërtohet nga policia me komunitetet të cilave u shërbejnë dhe, si rezultat, të rrisin nën-raportimin e DHGV-së duke çuar në pandëshkueshmëri më të madhe të krimeve të tilla. Masat e rekomanduara të kontrollit fillojnë me ju si komandant i policisë dhe drejtues i një ekipi. Ato janë krijuar për të shmangur ngjarjet ose pasojat e qëllimshme ose të padëshiruara si rezultat i veprimtimit të individëve në ekipin tuaj.

Kontrollet parandaluese grupohen në tri fusha kryesore: 1) mbikëqyrja, 2) llogaridhënia e brendshme dhe 3) anulimi i procedurave me rrezik të lartë që mund të nxisin korrupsionin ose sjelljen e keqe. Ato janë modifikuar për qëllimet e këtij Manuali:

**1. Mbikëqyrja:** sigurohuni që ekipi juaj të jetë i qartë në zinxhirin e komandës dhe mekanizmat mbikëqyrës në vend. Çdo zyrtar policor në ekipin tuaj, përfshirë edhe juve, duhet të trajnohet për aktivitetet e kontrollit dhe duhet të inkurajohet të raportojë praktikave të keqja. Njohja e personelit tuaj do të jetë shumë e rëndësishme, madje edhe më e rëndësishme sesa të jeni në gjendje të vlerësoni punën e ekipit tuaj. Të njohësh mirë anëtarët e ekipit tuaj do të thotë të jeni në gjendje të identifikoni dobësitë e mundshme ndaj praktikave të keqja për shkak të mjedisit të tyre privat dhe pikëpamjeve armiqësore ndaj njerëzve ose grupeve të njerëzve.

**2. Llogaridhënia:** Përgjegjësitë dhe delegimet e kompetencave duhet të jenë koherente. Lidhshipin e policisë në çdo nivel duhet të inkurajojë një ndjenjë kolektive të lidhshipit individual kur parandalon praktikave të keqja. Kjo do të thotë që praktika e keqe korrigjohet menjëherë nga mbikëqyrësi, por edhe potencialisht nga të tjerët, të cilët mund të jenë në gjendje të marrin rolin e kampionit dhe të udhëheqin me shembuj kur veprojnë me integritet profesional gjatë reagimit ndaj DHGV-së. Në këtë mënyrë, sinjale të qarta dërgohen në të gjithë nivelet e policisë që drejtuesit dhe stafi po punojnë së bashku për të qëndruar të përgjegjshëm ndaj rregullave organizative të integritetit dhe kodeve të sjelljes që mbështesin një shërbim efektiv dhe legjitim policor.

**3. Menaxhimi i rrezikut të procedurave me rrezik të lartë:** Disa fusha të punës policore janë më të ekspozuara ndaj praktikave të keqja se të tjerat; këto fusha, siç janë kontrolli kufitar ose siguria e burgjeve, duhet të identifikohen qartë si me rrezik të lartë. Në këto raste, mund të krijohen rutina dhe procedura të menaxhimit të rrezikut që zvogëlojnë mundësitë për sjellje të keqe. Këto mund të përfshijnë mentorimin nga kolegët dhe vizitat mbështetëse psikosociale nga ekspertë në dhe për policinë në burgjet e sigurisë së lartë ose pikat e izoluara të kontrollit kufitar.

që t'i japin fund dhunës mashkullore kundër grave në mënyrë aktive.<sup>30)</sup>

- Angazhohuni në programet në terren dhe jini gati të ofroni informacion për gratë, përfshirë viktimat/të mbijetuarat e dhunës, të drejtat e njeriut të grave dhe aspektet sociale, shëndetësore, ligjore dhe ekonomike

<sup>30</sup> Zyrtari i lartë i policisë skoceze mbështet fushatën e Shiritit të Bardhë të për t'i dhënë fund dhunës me bazë gjinore. Bussey, K. për The Sunday Post. 25 nëntor 2017. <https://www.sunday-post.com/fp/senior-scots-police-officer-backs-white-ribbon-campaign-to-end-gender-based-violence/>

të dhunës ndaj grave, në mënyrë që të fuqizoni gratë që të mbrohen nga të gjitha format e dhunës;

- Angazhoni të rinjtë që të marrin pjesë në politikën dhe proceset e parandalimit të delikuencës, duke përfshirë përdorimin e burimeve të komunitetit, vetë-ndihmën e të rinjve, dhe programet e kompensimit dhe ndihmës së viktimave. Kjo mund të përfshijë policinë që angazhohet në programe të bazuara në shkollë siç është rekomanduar nga OBSH *Edukimi dhe Trajnimi i Rezistencës ndaj Bandave (G.R.E.A.T.)*, i cili ka pasur suk-

ses në SHBA dhe Amerikën Qendrore (shih Kutinë 5).<sup>31</sup>

### Përshtatja

- Zhvilloni marrëdhënie me grupet që përfaqësojnë interesat e grupeve të veçanta të grave dhe vajzave, siç janë personat me aftësi të kufizuara, komunitetet minoritare ose të nën-përfaqësuar, migrantët, ata me pengesa gjuhësore ose gratë në konflikt me ligjin;

### Lidhja me sektorët dhe agjencitë e tjera nëpërmjet referimit dhe koordinimit

- Identifikoni agjencitë/grupet që mund të jenë burime për parandalimin e krimit dhe dhunës;
- Krijoni dhe/ose zbatoni mekanizma për koordinimin e duhur të përpjekjeve parandaluese ndërmjet agjencive qeveritare dhe joqeveritare;

### Mbledhja e të dhënave dhe menaxhimi i informacionit

- Kryeni analiza të thella të problemit duke përdorur informacion të ndjeshëm ndaj gjinisë dhe inventarë të operacioneve, shërbimeve, lehtësive dhe burimeve në dispozicion.

## TREGUESIT REFERUES PËR POLICINË OË OFRON SHËRBIME THELBËSORE: PARANDALIMI

Siç u diskutua në Kapitullin e mëparshëm, PSHTH propozon që të gjitha shërbimet e drejtësisë dhe mbështetjes për viktimat/të mbijetuarat duhet të ndajnë një sërë karakteristikash të përbashkëta dhe aktiviteteve të përbashkëta për të siguruar ndikimin maksimal.

Ato janë të zbatueshme pavarësisht nga 'sektori' specifik që mund t'u përgjigjet grave dhe vajzave që përjetojnë dhunë. Lista e mëposhtme është frymëzuar nga karakteristikat dhe aktivitetet e përbashkëta të PSHTH-së;

<sup>31</sup> Parandalimi i dhunës në shkollë: Një manual praktik 'Gjenevë: Organizata Botërore e Shëndetësisë. Për udhëzime të mëtejshme për trajtimin e dhunës me bazë gjinore në lidhje me shkollën, shih: 'Udhëzues Global për Adresimin e Dhunës Gjinore të Ndërlidhur me Shkollën' (UN Women dhe UNESCO, 2016) në: <https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2016/12/global-guidance-on-addressing-school-related-gender-based-violence>

ajo propozon disa shembuj të treguesve referues për aktivitetet e policisë kur synohet zbatimi i strategjive të parandalimit të DHGV-së, të cilat janë informuar në mënyrë adekuate nga palët e interesit, të mbështetura nga komunitetet dhe janë të përqendruara te viktima/e mbijetuarat në qasjen e tyre. Këta janë tregues që lider-shipi i policisë me përgjegjësi komanduese operacionale mund t'i referojë (nëse ekzistojnë), por në mënyrë të barabartë inkurajojë drejtuesit e lartë t'i përfshijë nëse nuk ekzistojnë:



**Disponueshmëria dhe qasshmëria:** Numri i kënaqësisë/besimit të komunitetit në anketa e shërbimit policor lokal të ndara sipas gjinisë që përfshijnë dallimet në vendbanim, kombësi, etni, kastë, klasë, status të emigrantit ose refugjatit, status autokton, moshë, fe, gjuhë dhe nivel të shkrim-leximit, orientim seksual, status martesor, aftësi të kufizuara ose ndonjë karakteristikë tjetër që nuk merret parasysh.

**“Një strategji për inkurajimin e publikut për të vepruar si partnerë me policinë në parandalimin dhe menaxhimin e krimit, si dhe aspekte të tjera të sigurisë dhe rendit bazohet në nevojat e komunitetit.”**

Operacionet e Policisë së OKB-së (2015)



**Përshtatja dhe qasshmëria:** Numri i projekteve policore që përfshijnë komunitetet lokale dhe grupet specifike në rrezik brenda këtyre komuniteteve siç janë të rinjtë, LGBTQI dhe gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara. Projektet e policisë-komunitetit që synojnë të ndërtojnë mjedise më të sigurta duke siguruar që komunitetet t'i ndihmojnë ata në kuptimin e trendëve në rritje në DHGV, dhe zgjidhjen e problemeve që gjenerojnë dhunë, krim ose pasiguri.



**Përshtatshmëria dhe qasshmëria:** Numri i forumeve të parandalimit të krimit të mbështetura nga policia ose aktivitetet e përbashkëta të udhëhequra, ose me, përfshirjen kuptimplote të grave lokale ose organizatave të grave që puno-

jnë për t'i dhënë fund DHVG-së, si dhe atyre që fokusohen në avancimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave. Në raste të caktuara, mund të jetë e nevojshme të bëhet një shtrirje për të lejuar më shumë gra dhe vajza të marrin pjesë në ngjarje. Diskutime të ndara vetëm për femra mund të jenë të nevojshme për të siguruar që ato janë në gjendje të flasin hapur. Parandalimi i krimit në përgjithësi varet shumë nga ajo që publiku bën për veten e tij duke rritur qëndrueshmërinë e komunitetit të tij ndaj kërcënimeve kriminale, përfshirë DHGV-në.

për dhunën dhe parandalimin e krimit. Organizimi i javës së vizitorëve të stacionit policor me komunitete lokale dhe të ndryshme mund të jetë një nismë shumë e rëndësishme ku mund të monitorohet mjedisi i viktimës/të mbijetuarës.

**“Angazhimi i njerëzve duhet të inkurajohet dhe duhet të ketë pasoja të sigurta dhe të dukshme për ata që veprojnë në kundërshtim me kulturën e ligjshmërisë. Kjo përfshin mbajtjen përgjegjës të burrave dhe grave që abuzojnë me gratë për veprimet e tyre. “**

Një Kornizë për të Mbështetur Veprimet për Parandalimin e Dhunës ndaj Grave (UN Women et al., 2015)

**“Angazhimi efektiv i policisë identifikon të gjitha grupet e komunitetit, në veçanti gratë dhe fëmijët, dhe siguron mundësinë për reagime përmes përfaqësimit në grupe këshilluese, anketa të komunitetit, forume dhe takime.”**

Një Kornizë për të Mbështetur Veprimet për Parandalimin e Dhunës ndaj Grave (UN Women et al., 2015).



**Caktim i sigurisë si prioritet:** Numri dhe cilësia e produkteve të qasjes së policisë ndaj komunitetit që veçanërisht informojnë gratë dhe vajzat se si të raportojnë DHGV-në, përfshirë ngacmimin seksual dhe/ose përndjekjen në internet (p.sh., në mediat sociale), kërkon mbrojtje dhe mbështetje shëndetësore kur ndodh dhuna, si dhe shmangien e zonave të krimit të lartë dhe/ose formave të tjera të dhunës online dhe të lehtësuara nga TIK-u që synojnë gratë dhe vajzat. Në mënyrë të barabartë, produktet në terren duhet të synojnë burrat dhe djemtë në komunitet në një mënyrë që i inkurajon ata të marrin role proaktive në ndërtimin e zgjidhjeve drejt DHGV-së.



**Pëlqimi i informuar dhe konfidencialiteti dhe qasshmëria:** Numri i takimeve të rregullta dhe formale me komunitetet lokale që përqendrohen në nevojat specifike në rritje dhe diferenciale të sigurisë së grave dhe vajzave. Këto takime duhet të synojnë të përfshijnë qasjen me viktimë/të mbijetuarën në qendër brenda strategjisë së përgjithshme të policisë



**Komunikimi efektiv dhe pjesëmarrja nga palët e interesit në hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e shërbimeve:**

Numri dhe shpeshësia e komunikimeve të jashtme (të përbashkëta) të kuptueshme për të gjithë anëtarët e komuniteteve lokale, përfshirë ata me lloje të ndryshme aftësish të kufizuara që detajon angazhimin e policisë ndaj qasjeve të fokusuara tek autorët dhe viktimat/të mbijetuarat kur reagojnë ndaj DHGV-së. Kjo duhet të përfshijë detaje mbi strategjitë e ndërhyrjes së hershme të DHGV-së, partneritetet me ofruesit e shërbimeve të tjera dhe anëtarët me ndikim të komunitetit (veçanërisht anëtarët e komunitetit femra), dhe politikat e brendshme të barazisë gjinore të policisë, siç është politikat e ngacmimit anti-seksual.



**Mbledhja e të dhënave dhe menaxhimi i informacionit:**

Numri i vlerësimeve të pavarura të strategjive të DHGV-së të policisë të zbatuara në nivel lokal ose komunal. Këto vlerësime duhet të sigurojnë gjetje në nivelin e rezultateve, njohuri mbi mundësitë e të mësuarit dhe të propozojnë rekomandime për forcimin e parandalimit të DHGV-së. Vlerësimi në mënyrë ideale duhet të bëhet publik ose të ndahet me një komitet drejtues të palëve të ndryshme të interesit të komunitetit dhe ofruesve të shërbimeve thelbësore.

**Java e Vizitorëve të Stacionit Policor ('JVSP')** është një nismë globale e krijuar nga Aleanca Globale Altus i cili fton anëtarët e komunitetit të vizitojnë stacionet policore lokale, të ndërveprojnë me personelin e policisë dhe të vlerësojnë shërbimet policore

(Aleanca Globale Altus, 2012)



**Lidhja me sektorët dhe agjencitë e tjera nëpërmjet koordinimit:** Numri dhe cilësia e trajnimeve të përbashkëta për parandalimin dhe strategjitë e referimit të hartuara dhe zbatuara nga policia, së bashku me akterët vendorë të shërbimit thelbësor dhe organizatat joqeveritare të grave ose fëmijëve. Nënshkrimi i marrëveshjeve të ofrimit të shërbimeve/partneritetit për ofrimin e shërbimeve të referimit në DHGV-së do të ndihmojë jashtëzakonisht shumë.

## RASTI STUDIMOR

### KËSHILLI LOKAL I SIGURISË: KONGO, EKUADOR DHE MEKSIKË<sup>31</sup>

Imazhe kurtuazie nga COGINTA për Reformat Policore dhe Sigurinë në Komunitete<sup>32</sup>

Sipas Komisionit të Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimit dhe Drejtësinë Penale, pjesëmarrja aktive e komuniteteve dhe segmenteve të tjera të shoqërisë civile është një pjesë thelbësore e parandalimit efektiv të krimit. Komunitetet luajnë një rol të rëndësishëm në identifikimin e prioriteteve për parandalimin e krimit, në zbatimin dhe vlerësimin dhe në ndihmën për të identifikuar një bazë të qëndrueshme burimesh.<sup>34</sup>



Praktikat e mira në mobilizimin e komunitetit përfshijnë një proces pjesëmarrës dhe angazhimin e të gjitha niveleve të shoqërisë, përfshirë përfaqësuesit e qeverisjes vendore, udhëheqësit e komuniteteve, OJQ-të dhe grupet e grave.<sup>35</sup>

Megjithatë, një mobilizim i tillë kërkon mekanizma të sanksionuar nga qeveria për të siguruar qën-

drueshmërinë e përpjekjeve të kombinuara dhe pronësinë nga mbajtësit e detyrave lokale. **Këshillat lokale të sigurisë ('KLS')** janë mekanizma të tillë ku policia dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve lokale mund të mblidhen së bashku me shoqërinë civile lokale për të diskutuar dhe planifikuar projekte të përbashkëta të sigurisë në nivel komuniteti, përfshirë parandalimin e DHGV-së.



Mekanizmat e tipit KLS-së ekzistojnë në çdo kontinent. Në Francë dhe Republikën e Guinesë, ata quhen 'këshilla lokale të sigurisë për parandalimin e delikuencës' ('CLSPD'); në Republikën Demokratike të Kongos (RDK), ato njihen si 'këshilla të sigurisë së bashkë-

sisë lokale' ose ('CLS'); në Ekuador, ata njihen si 'këshilla komunale sigurisë' ose ('CSM'). Varësisht nga modeli dhe madhësia e popullsisë së komunës, zyrtarët e lartë të policisë në komunitet mund të jenë përfaqësuesit kryesorë të policisë në KLS.

Në përgjithësi, KLS-të veprojnë si mekanizma koordinues ndërmjet aktërëve të sigurisë, në të dy nivelet e decentralizuara dhe ato të federalizuara. Nëse përfshihen dhe financohen në mënyrë të qëndrueshme, KLS-të mund të jenë një hapësirë e përbashkët ku kërcënimet me të cilat përballen grupet specifike dhe dobësitë e tyre të sigurisë mund të identifikohen dhe adresohen përmes qasjeve të synuara dhe bashkëpunuese.

KLS-të mund të luajnë role kritike si në planifikimin strategjik ashtu edhe në funksionalizimin e strategjive dhe politikave të sigurisë kombëtare dhe të drejtësisë në dobi të popullsisë vendase. Kjo shtrihet edhe në

32 Coginta për Reformat e Policisë dhe Sigurinë në Komunitete, në: <http://www.coginta.org/en>. Për më shumë informacion, shihni *Kuptimi i Këshillave Lokale të Sigurisë në Dy Minuta* (Coginta, 2015) në: [https://www.youtube.com/watch?v=7f-GFo\\_nteGA&t=6s](https://www.youtube.com/watch?v=7f-GFo_nteGA&t=6s) dhe *Guide Pratique Conseil Local de Sécurité et de Prévention de la Délinquance en République de Guinée* (Coginta 2017).

33 Frymëzuar nga Fernandez, M., Piaget, K., Hernandez, T., dhe Berthoud, S. (2017), 'Decentralizimi i Qeverisjes së Sigurisë: Lehtësues i një Qasjeje të bazuar në të Drejtat e Njeriut (QBDNJ) në RSS?' ISSAT Dokumenti i Grupit Punues të QBDNJ 3.

34 Neni 16, Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimit (Rezoluta e Këshillit Ekonomik dhe Social 2002/13, shtojcë)

35 'Aspektet e dhunës ndaj grave që i përkasin drejtpërdrejt Komisionit për Parandalimin e Krimit dhe Drejtësinë Penale (Komisioni për Parandalimin e Krimit dhe Drejtësinë Penale V.08-52191 (E) \* 0852191 \* Sesioni i Shtatëmbëdhjetë Vjenë, 14-18 prill 2008).



politikën dhe strategjinë kombëtare për reagim ndaj DHGV-së. Për policinë, KLS-të mund të jenë shumë të rëndësishme pasi ato mund të përdoren për të forcuar partneritetet policore për një qasje policore të udhëhequr nga inteligjenca dhe për të komunikuar në mënyrë strategjike me zyrtarët e qeverisjes lokale dhe palët e interesit të bazuara në komunitet.

KLS-të janë platforma dialogu ku agjenci të ndryshme me ndikim në sigurinë publike mund të konsultohen me njëra-tjetrën, të identifikojnë problemet dhe të bien dakord për një plan lokal për parandalimin e pasigurisë.<sup>36</sup> Bazuar në këtë, KLS-të kanë potencialin të marrin kompetenca për kontrollin e cilësisë së veprimeve të koordinuara që përfshijnë policinë dhe partnerët e tyre në vazhdimësinë e drejtësisë, përfshirë kur reagojnë ndaj DHGV-së.

Meqenëse KLS-të normalisht përfshijnë autoritetet komunale, agjencitë e qeverisjes vendore, zyrtarët e drejtësisë dhe nganjëherë përfaqësuesit e shoqërisë civile së bashku me policinë, ata mund të gjenerojnë kontribute kritike kolektive për procesin e mësimin të reagimit të koordinuar ndaj DHGV-së.<sup>37</sup> Kjo mund të përfshijë komisionet e rishikimeve dhe vlerësimet e jashtme të reagimeve të koordinimit në rastet e DHGV-së, për shembull.

KLS-të gjithashtu mund të sjellin llogaridhënie më të madhe nga ofruesit e drejtësisë dhe sigurisë, duke pasur parasysh që ata bashkëpunojnë me komunitetet të cilëve u shërbejnë. Këto modele, në teori, do të ishin një parakusht i rëndësishëm për ndërtimin e besimit ndërmjet ofruesve të drejtësisë dhe sigurisë si bartës të detyrave të të drejtave të njeriut dhe komunitetit si mbajtës të të drejtave. Në këtë mënyrë, KLS-të mund të jenë të favorshme për të sjellë një qasje të bazuar në

të drejtat e njeriut ('QBDNJ')<sup>38</sup>, pasi që kërcënimet dhe nevojat e sigurisë me të cilat ballafaqohet komuniteti do të identifikoheshin nga perspektiva të ndryshme, përfshirë ato nga personat/grupet që konsiderohen të cenueshëm si rezultat i diskriminimit.

## REPUBLIKA DEMOKRATIKE E KONGOS (RDK)

Sektori i sigurisë është identifikuar nga Qeveria si një nga sektorët më kritikë që kërkon vëmendje në kontekstin e zgjidhjes së konflikteve, veçanërisht në pjesën lindore të vendit, ku ka pasur akuza të vazhdueshme për shkelje të të drejtave të njeriut nga duart e forcave të armatosura dhe policia.



Pas përpjekjeve të decentralizimit nga Qeveria e Kongos, Comités Local de Sécurité ('CLS') u krijuan në vitin 2013 për të ndihmuar në parandalimin e pasigurisë dhe për të lidhur shtetin qendror me autoritetet lokale. KLS-të përbëhen nga një Kryesues (i cili mund të jetë kryetari i qytetit, menaxheri i sektorit ose kreu i kryesisë, në varësi të njësisë territoriale), një zyrtarë nga Prokuroria e Përgjithshme, Komandanti i stacionit policor dhe dy përfaqësues nga shoqëria civile.

<sup>36</sup> 'Kuptimi i këshillave lokale të sigurisë në dy minuta', Coginta për Reformat Policore në: [https://www.youtube.com/watch?v=7fGfo\\_nteGA&t=6s](https://www.youtube.com/watch?v=7fGfo_nteGA&t=6s)

<sup>37</sup> Shih Fernandez, M., Piaget, K., Hernandez, T., and Berthoud, S (2017), 'Decentralizimi i Qeverisjes së Sigurisë: Lehtësues i një Qasjeje të bazuar në të Drejtat e Njeriut (QBDNJ) në RSS' 'ISSAT Dokumenti i Grupit Punues të QBDNJ 3, dhe 'Guide pratique conseil local de sécurité et de prévention de la délinquance en république de guinée' (Coginta për Policinë Reforma, 2017).

<sup>38</sup> QBDNJ e OKB-së është një 'kornizë konceptuale që bazohet në mënyrë normative në standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe e drejtuar operacionalisht në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.' QBDNJ pranon se gratë dhe vajzat kanë të drejta të barabarta njerëzore me burrat dhe djemtë dhe se dhuna ndaj grave është një shkelje e këtyre të drejtave. Shih UN Women: Nismat kryesore të programit në: <https://www.unwomen.org/en/how-we-work/flagship-programmes>

Ato financohen ligjërisht nga një fond krahinor, edhe pse jo gjithmonë në praktikë, dhe *forumet e lagjes* shërbejnë si takime lokale të hapura për të gjithë anëtarët e komunitetit, ku ata mund të shprehin shqetësimet e tyre në lidhje me pasigurinë. Megjithatë, është jetike për ndikimin e KLS-së që policia të promovojë në mënyrë aktive konsultimin me shoqërinë civile dhe komunitetin, në mënyrë që ato gjithashtu përfshijnë grupet e grave dhe sigurojnë kërcënimet e sigurisë të mbledhura në *forumet e lagjes* të raportohen, dhe statistikat ndahen, ndër të tjera, sipas gjinisë, përkatësisë etnike dhe orientimit seksual.

## CUYABENO, SUCUMBÍOS, EKUADOR

Në Ekuador, decentralizimi i qeverisjes së sigurisë ka arritur statusin kushtetues (2008). Kjo ka rezultuar në krijimin e kornizave ligjore për këshillat komunalë të sigurisë në të gjithë vendin, përfshirë në komunën Cuyabeno, e vendosur në rajonin e Amazonës në kufi me Kolumbinë.

Afërsia e Cuyabeno me Kolumbinë dhe pasuria në burimet natyrore, përfshirë naftën, paraqet shumë sfida të sigurisë që i vendosin të rinjtë, gratë, fëmijët dhe grupet autoktone në pozicione të larta të ndjeshmërisë.

Si përgjigje, korniza ligjore për Këshillin Komunal të Sigurisë në Cuyabeno ('KKS') është përshtatur për të përfshirë një konsultim të rregullt, i përbërë nga përfaqësues nga administrata komunale, policia dhe ushtria, komunitetet autoktone dhe afro-ekuatoriane dhe organizatat e grave, si dhe shërbimet shëndetësore dhe agjencitë e mirëqenies së fëmijëve.

Është i ftuar edhe një përfaqësues nga kompania e hidrokarbonit që ka më së shumti ndikim. Nga pikëpamja e të drejtave të njeriut, kjo është shumë pozitive dhe progresive pasi siguron hapësirë për palët e treta me detyrime të të drejtave të njeriut, siç janë si kompanitë e naftës dhe siguria e tyre private, për të marrë pjesë në diskutimet mbi çështjet e sigurisë që ndikojnë në zonë, me një shkallë të mbikëqyrjes. KKS në Cuyabeno është vetë-financuar, por ka të drejtë të marrë burime

shtetërore përmes buxheteve të policisë kombëtare nën rubrikën e policimit në komunitet.

## JUAREZ, CHIHUAHUA, MEKSIKË

Në vitin 2010, u lansua një strategji e përqendruar në komunitet për të ofruar siguri dhe drejtësi në Ciudad Juárez, Chihuahua, Meksikë. 'Mesa de Seguridad de Cd. Juárez' ('MSCJ') është ka për mandat të trajtojë efektet dhe burimet e identifikuar të dhunës. Është një organ i pavarur nga qeveria lokale, dhe si i pari nga shumë KLS në Meksikë, ai ka frymëzuar krijimin e mbi 15 MSCJ-ve në të gjithë vendin. Si rrjet, *Mesas* e ndryshme koordinohen nga OJQ-ja SOS México, e cila është e pëkushtuar ndaj pjesëmarrjes së qytetarëve në sigurinë publike.<sup>39</sup> MSCJ përbëhet nga zyrtarë qeveritarë dhe qytetarë dhe vendos një theks të fuqishëm në raportimin e bazuar në rezultate për çështjet që pasojnë. Megjithatë, MSCJ-të duhet të sigurojnë informacion të gatshëm për financat, përbërjen organizative ose gjithëpërfshirjen e tyre, që të konsiderohen mekanizma legjitime nga të gjithë sektorët e popullsisë. Mungesa e një informacioni të tillë pakëson transparencën dhe ofrimin e shërbimeve që MSCJ synonte të mishërojë fillimisht.

Edhe pse shoqëria civile përfaqësohet normalisht si një sektor, akterët e MSCJ-së, siç është policia, duhet të sigurojnë shpalojsjen e vazhdueshëm të të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe faktorëve të tjerë të diversitetit, siç janë përkatësia etnike, lidhja (autoktone), aftësia e kufizuar dhe mosha në lidhje me anëtarësimin e saj. MSCJ ka kompetencë për t'u angazhuar në çështjet gjinore dhe për të ndihmuar në forcimin e strategjive kombëtare që synojnë dhunën në familje dhe me bazë gjinore. Potenciali i MSCJ-së si një mekanizëm efektiv i koordinimit për shërbimet thelbësore për viktimat/të mbijetuarat e DHGV-së duhet të jetë i lidhur në mënyrë të natyrshme me gjerësinë e përfaqësimit të saj dhe kapacitetin e tij për të siguruar efikasitetin e ndërhyrjeve lokale të sigurisë publike.

<sup>39</sup> 'SOS Mexico' u krijua në vitin 2008 nga Alejandro Marti dhe synon të krijojë dhe mbajë një sistem efektiv të sigurisë dhe drejtësisë në Meksikë. Ajo ka tri objektiva kryesore: forcimin institucional, reformën legjislative dhe pjesëmarrjen e qytetarëve.

# SHTOJCA 1

## Angazhimi i burrave në parandalim

### Box 7

“Për sa kohë që ne kemi pikëpamjen se këto janë probleme që duhet të zgjidhen vetëm për gratë, nuk mund të presim që të kemi sukses në zvogëlimin e rasteve të shumta të përdhunimit, abuzimit të fëmijëve dhe dhunës në familje. Ne e dimë se shumë burra nuk abuzojnë me gratë dhe fëmijët dhe përpiqen të jetojnë gjithmonë me respekt dhe dinjitet. Por deri më sot, zëri kolektiv i këtyre burrave nuk është dëgjuar kurrë, sepse çështja nuk është konsideruar si një për tërë kombin. Nga sot, ata që ushtrojnë dhunë ndaj të tjerëve do ta dinë se janë të izoluar dhe nuk mund të mbështeten tek burrat e tjerë për t’i mbrojtur ata. Tani e tutje, të gjithë burrat do të dëgjojnë thirrjen për të marrë përgjegjësinë e tyre për zgjidhjen e këtij problemi.”

Marshi Kombëtar i Burrave i Nelson Mandelas, Pretoria, Afrika e Jugut, 1997.

Kur flasim për dhunën ndaj grave dhe vajzave, shumica e njerëzve do ta shihnin atë si çështje të gruas. Pse mos të bëjnë këtë? Kur flisni me vajza dhe gra në tërë botën, shumica mendojnë për abuzimin dhe ngacmimin çdo ditë. Disa do të vazhdojnë të përjetojnë ngacmime dhe abuzime. Shumë do të jenë individë që shërohen nga përvoja e kaluar e dhunës ose si të rritur ose si fëmijë. Në të gjitha rastet, shumë vajza dhe gra vazhdojnë të planifikojnë ditët e tyre, në mënyrë që të parandalojnë ose zvogëlojnë kërcënimin e dhunës së burrave.

Është gabim ta quash këtë formë dhune një çështje të grave. Pavarësisht nëse marrim parasysh përdhunimin, sulmin seksual ose dhunën në familje, shumica dërrmuese e këtyre krimeve përfshijnë djem dhe burra si kryerës të dhunës. A nuk duhet që këto fakte të konfirmojnë se dhuna e meshkujve është çështje e meshkujve?

Kështu, DHGV është një “çështje burrash”, jo vetëm sepse burrat janë më së shpeshti kryerës, por sepse parandalimi i DHGV-së krijon dobi për komunitete të tëra - përfshirë burrat.

Kur flasim për burrat në role si kryerës të dhunës, ndihemi komod t’i diskutojmë ata si përbindësia ose kafshë, por jo si burra. Në shumë mënyra, sado e pakëndshme të jetë kjo, ne duhet të riformulojmë këto çështje si çështje të burrave që burrat mund të ndihmojnë në parandalimin e tyre. Nevojitet një qasje më e drejtpërdrejtë për të ndihmuar në parandalimin e DHGV-së dhe, në shumë

mënyra, për të zvogëluar kërkesën për polici të shkaktuar nga kjo formë dhune. Ndërsa sjellja e kryerësve pra drejtësisë mbetet një prioritet, ne duhet të mendojmë ‘jashtë kutisë’ dhe të shikojmë kulturën që prodhon këta burra të dhunshëm dhe abuzues. Duhet të jemi të patrembur, të guximshëm dhe të ndihemi të jokomod me të vërtetën se dhuna (dhe veçanërisht dhuna kundër grave dhe vajzave) është kryesisht çështje e burrave. Ndërsa shumica e burrave nuk abuzojnë ose përdorin dhunë, thjesht të thuash ‘Unë jam një djalë i mirë, nuk e bëj këtë’, nuk është e mjaftueshme. Ne kemi nevojë për burra që të tregojnë lidhshmëri dhe të mbajnë qëndrim kundër sjelljeve abuzive të ‘disa burrave’ që bëjnë abuzime.

Ka shumë gjëra që burrat mund të bëjnë për të parandaluar dhunën e burrave ndaj grave. Gjetja e një vullneti kolektiv në kulturën mashkullore për ta bërë atë si prioritet është çelësi. Është e qartë se shumica e burrave nuk janë të kënaqur me sjelljet abuzive të burrave të tjerë, por ata nuk e kanë kuptuar se çfarë të bëjnë në lidhje me të, ose ende nuk kanë marrë guximin për të vepruar vetë.

Këtu janë dhjetë gjërat që të gjithë burrat mund të bëjnë për të ndihmuar në parandalimin e DHGV-së:



**Own the problem** – Take time to reflect on the issue of VAWG and don’t become defensive when men are viewed as perpetrators. Remember the words of Nelson Mandela, it’s only some men.

**2** **Zotëroni problemin** - Merrni kohë për të reflektuar mbi çështjen e DHGV-së dhe mos u bëni mbrojtës kur burrat shihen si kryerës të dhunës. Mos harroni fjalët e Nelson Mandelës, janë vetëm disa burra.

**3** **'Merrni njohuri'** - Mësoni më shumë rreth temës. Fakti që po lexoni këtë sugjeron që keni interes.

**4** **Flisni me të tjerët** - Përdorni njohuritë tuaja të sapo fituara për të folur me burra të tjerë mbi çështjet. Ndihmohuni atyre të kapërcejnë qëndrimin e tyre defanziv.

**5** **Flisni me gratë në jetën tuaj** - Dëgjoni përvojat e tyre të ngacmimit dhe abuzimit. Mësoni nga këto përvoja.

**7** **Bëhuni ajo udhërrëfyes** - Burrat ka të ngjarë të jenë baballarë. Bijtë tuaj po shikojnë se si silleni. Bëhuni ai modeli në jetën e tyre. Bëhu një njeri i butë, ji i sjellshëm. Bijtë tuaj do të mësojnë të bëjnë si ju. Bijat tuaja do të mësojnë se si burrat do t'i trajtojnë ato.

**8** **Bëhuni një aleat për gratë** - Me njohuritë tuaja të reja, ju duhet ta përdorni këtë. Mbështetni gratë dhe burrat e tjerë që po mbajnë qëndrim kundër ngacmimeve.

**9** **Mbështesni të tjerët** - Aty ku dyshoni se një mike apo e afërm është viktimë/e mbijetuar e abuzimit, mbështetni ato. Mos jeni spektatorë, bëhu mik. Detyra juaj nuk është të zgjidhni problemin. Thjesht njohja e përvojave të viktimës/të mbijetuarës do të sigurojë mbështetje. Sigurohuni që t'i thoni që nuk është faji i tyre.

**10** **Sfidoni të tjerët** - Kur dëgjoni bashkëmoshatarët ose të tjerët që veprojnë në mënyrë abuzive, thoni diçka. Do të jetë e vështirë, dhe do të duhet guxim. Bëhuni një udhëheqës dhe thoni diçka që tregon se ajo që ata po bëjnë është e gabuar. Realiteti është se burrat e tjerë në të vërtetë do të mbështesin qëndrimin tuaj.

Sfidoni kulturën - Përveç sfidimit të të tjerëve, kini guxim të sfidoni kulturën ku rriten djemtë dhe burrat. Vetëm duke e adresuar këtë kulturë do të shohim ulje të niveleve të DHGV-së.

**6** **Keni guxim të shikoni nga brenda** - Vetë-inspektimi është i mirë për shpirtin. Të gjithë burrat, nganjëherë, do të jenë përfshirë drejtpërdrejt ose tërthorazi duke bërë komente nënçmuese për gratë. Burrat marrin frymë në ajër. Mos kini turp. Me këtë qasje të re, zemërohuni dhe bëni diçka për të bërë ndryshimin.



Foto kurtuazie nga Graham Goulden, Kryehetues në pension i Policisë së Skocisë



## SHËNIME DHE LEXIMI I SUGJERUAR

1. Kodi i Sjelljes për Zyrtarët e Zbatimit të Ligjit (miratuar nga rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 34/169 e17 dhjetorit 1979), shih: <https://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/LawEnforcementOfficials.aspx>
2. 'Aspektet e dhunës ndaj grave që i përkasin drejt-përdrejt Komisionit për Parandalimin e Krimit dhe Drejtësinë Penale '(Komisioni për Parandalimin e Krimit dhe Drejtësinë Penale ' V.08-52191 (E) \*0852191\* Sesioni i Shtatëmbëdhjetë Vjenë, 2018).
3. Rekomandimet për Veprim kundër Vrasjeve të Grave dhe Vajzave të Ndërlidhura me Gjininë (UNODC, 2015), shih: [https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/15-08233\\_A4-GRK\\_eBook.pdf](https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/15-08233_A4-GRK_eBook.pdf)
4. Strategjitë Model të Përditësuara dhe Masat Praktike për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave në Fushën e Parandalimit të Krimit dhe Drejtësisë Penale, të miratuar nga rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 65/228 e21 dhjetorit 2010, shih: [https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/crimeprevention/Model\\_Strategies\\_and\\_Practical\\_Measures\\_on\\_the\\_Elimination\\_of\\_Violence\\_against\\_Women\\_in\\_the\\_Field\\_of\\_Crime\\_Prevention\\_and\\_Criminal\\_Justice.pdf](https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/crimeprevention/Model_Strategies_and_Practical_Measures_on_the_Elimination_of_Violence_against_Women_in_the_Field_of_Crime_Prevention_and_Criminal_Justice.pdf)
5. Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimit (Rezoluta e Këshillit Ekonomik dhe Social 2002/13, shtojcë), shih: [https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/crimeprevention/resolution\\_2002-13.pdf](https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/crimeprevention/resolution_2002-13.pdf)
6. *Standardet dhe Normat e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Parandalimin e Krimit Këshilla në Dorën Tuaj* (UNODC), në: [https://www.unodc.org/pdf/criminal\\_justice/UN\\_standards\\_and\\_norms\\_in\\_crime\\_prevention\\_at\\_your\\_fingertips.pdf](https://www.unodc.org/pdf/criminal_justice/UN_standards_and_norms_in_crime_prevention_at_your_fingertips.pdf)
7. Manual i Udhëzimeve për Parandalimin e Krimit: Duke i Bërë Ata të Punojnë (UNODC, 2010), në: [https://www.unodc.org/pdf/criminal\\_justice/Handbook\\_on\\_Crime\\_Prevention\\_Guidelines\\_-\\_Making\\_them\\_work.pdf](https://www.unodc.org/pdf/criminal_justice/Handbook_on_Crime_Prevention_Guidelines_-_Making_them_work.pdf)
8. Udhëzime për Operacionet Policore në Operacionet Paqeruajtëse të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe Misionet Speciale Politike (DPKO-DFS, 2015), në: [https://police.un.org/sites/default/files/sgf-guidelines\\_police\\_operations-2015.pdf](https://police.un.org/sites/default/files/sgf-guidelines_police_operations-2015.pdf)
9. Raporti Global Javës së Vizitave në Stacionet Policore (2012): Avancimi i Standardeve të të Drejtave të Njeriut në Stacionet Policore (Alianca Globalle Altus) në: [https://issat.dcaf.ch/download/29464/413964/Altus%20Global%20Report%202012%20\(2\).pdf](https://issat.dcaf.ch/download/29464/413964/Altus%20Global%20Report%202012%20(2).pdf)
10. Studimi i thelluar i Sekretarit të Përgjithshëm mbi të gjitha format e dhunës ndaj grave (A/61/122/Shto.1), në: <https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/No6/419/74/PDF/No641974.pdf?OpenElement>
11. 'Një kornizë për të Mbështetur Veprimin për të Parandaluar Dhunën ndaj Grave' (UN Women et al., 2015), në: <https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2015/11/prevention-framework>
12. 'Përforcimi i strukturave të komunitetit dhe lokale të sigurisë në Suzak, Kirgizi' (Saferworld, 2015), në: <https://www.saferworld.org.uk/en-stories-of-change/reinforcing-community-and-local-security-structures-in-suzak-kyrgyzstan>
13. *Paketa e Veglave të Integritetit të Policisë* (Qendra e Gjenevës për Qeverisjen e Sektorit të Sigurisë, 2012), në: [https://www.dcaf.ch/sites/default/files/publications/documents/Toolkit\\_ENG\\_screen.pdf](https://www.dcaf.ch/sites/default/files/publications/documents/Toolkit_ENG_screen.pdf)
14. Logar, R., 'Modeli Austriak i Ndërhyrjes në Rastet e Dhunës në Familje', Dokument i paraqitur në Takimin e Grupit të Ekspertëve të OKB-së: Dhuna ndaj Grave: Praktika e Mirë në Luftimin dhe Eliminimin e Dhunës ndaj Grave (Vjenë, 17–20 maj 2005), në: <https://www.un.org/womenwatch/daw/egm/vaw-gp-2005/docs/experts/logar.dv.pdf>
15. Dhënia Fund e Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave: Ligjet dhe politikat më të mira në botë '(Çmimi i Politikave të së Ardhmes, 2014) (UN Women, World Future Council dhe Union Inter-Parlamentar), në: [https://www.worldfuturecouncil.org/wp-content/uploads/2016/01/WFC\\_2014\\_Future\\_Policy\\_Award\\_En.pdf](https://www.worldfuturecouncil.org/wp-content/uploads/2016/01/WFC_2014_Future_Policy_Award_En.pdf)
16. 'Eliminimi i Dhunës ndaj Grave në Paqësorin Aziatik: Është e gjithë përgjegjësia jonë', (UN Women), në: [https://www.aidsdatahub.org/sites/default/files/publication/UN\\_Women\\_2015\\_Eliminating\\_violence\\_against\\_women\\_in\\_the\\_Asia\\_Pacific.pdf](https://www.aidsdatahub.org/sites/default/files/publication/UN_Women_2015_Eliminating_violence_against_women_in_the_Asia_Pacific.pdf)
17. Dhjetë Vite të Legjislacion Austriak kundër Dhunës: Konferenca Ndërkombëtare 2017 në Kontekst të Fushatës së Këshillit të Evropës për të Luftuar Dhunën ndaj Grave, Përfshirë Dhunën në Familje (Vjenë dhe St. Pölten, Austri, 5 deri më 7 nëntor 2007), në: <https://www.interventionsstelle-wien.at/download/?id=406>

18. 'Një studim për Krijimin e një Mekanizmi të Reagimit Shumëdisiplinar ndaj Dhunës kundër Grave në Egjipt' (UNODC, 2015).
19. 'Praktika Profesionale e Autorizuar e Angazhimit dhe Komunikimit' (Kolegji i Policimit, MB), në: <https://www.app.college.police.uk/app-content/engagement-and-communication/engaging-with-communities>
20. Dhuna e Bazuar në Gjini (Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave) (Banka Botërore, 2019), në: <https://www.worldbank.org/en/topic/socialdevelopment/brief/violence-against-women-and-girls>
21. Udhëzimet për Vlerësimin e Kostos Ekonomike të Dhunës në Familje në Rajonin Arab (UNFPA, 2019) në: [https://www.unescwa.org/sites/www.unescwa.org/files/publications/files/guidelines-estimate-economic-cost-domestic-violence-arab-region-english\\_o.pdf](https://www.unescwa.org/sites/www.unescwa.org/files/publications/files/guidelines-estimate-economic-cost-domestic-violence-arab-region-english_o.pdf)
22. 'Vlerësimi i Kostove të Dhunës në Familje në Rajonin Arab: Modeli Operacional' (UN Women E/ESCWA/ECW/2017/Dokument teknik 4, 18 korrik 2017), në: [https://www.unescwa.org/file/66255/download?token=fGod\\_SpM](https://www.unescwa.org/file/66255/download?token=fGod_SpM)
23. 'Kuptimi i këshillave lokale të sigurisë në dy minuta', Coginta për Reformat Policore, në: [https://www.youtube.com/watch?v=7fGFo\\_nteGA](https://www.youtube.com/watch?v=7fGFo_nteGA)
24. Qu'est ce qu'un CLSPD - CISPDP ? Qeveria e Francës, në: <http://www.isere.gouv.fr/Politiques-publiques/Securites/Securite-publique/Prevention-de-la-delinquance2/Qu-est-ce-qu-un-CLSPD-CISPDP>
25. 'Guide pratique conseil local de sécurité et de prévention de la délinquance en république de guinée (Coginta për Reformën Policore, 2017), at: <http://www.coginta.org/uploads/documents/cedd246fbc7d133bcf-29135bec8a66d561202ae4.pdf>
26. Fernandez, M., Piaget, K., Hernandez, T., dhe Berthoud, S (2017), 'Decentralizimi i Qeverisjes së Sigurisë: Lehtësues i një Qasjeje të bazuar në të Drejtat e Njeriut (QBDNJ) në RSS në RSS? ISSAT Dokumenti i Grupit Punues të QBDNJ 3, në: <https://issat.dcaf.ch/download/111714/2027474/HRBA%20Working%20Group%20Paper%203.pdf>
27. Ndërlidhja dhe qasja gjithëpërfshirëse në trajtimin e dhunës të bazuar në gjini: Një Dokument Qëndrimi nga Gratë Kundër Dhunës në Evropë (WAVE), në: [http://file-server.wave-network.org/researchreports/WAVE%20positionpaper\\_intersectionality2018.pdf](http://file-server.wave-network.org/researchreports/WAVE%20positionpaper_intersectionality2018.pdf)
28. Organizata Botërore e Shëndetësisë, 'Parandalimi i Dhunës: Dëshmia', në: [https://www.who.int/violence\\_injury\\_prevention/violence/the-evidence/en/](https://www.who.int/violence_injury_prevention/violence/the-evidence/en/)
29. ACES too High News, shih: <https://acestoohigh.com/>
30. Martinez Calvo, S, Përvojat e Pafavorshme të Fëmijërisë (PPF), në <https://www.70-30.org.uk/18737-2/>
31. 'Lufta kundër Dhunës ndaj Grave: Standardet Minimale për Shërbimet Mbështetëse' (Drejtoria e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut dhe Çështjeve Ligjore, Këshilli i Evropës, Strasburg, 2008), në: [https://www.coe.int/t/dg2/equality/domesticviolencecampaign/Source/EG-VAW-CONF\(2007\)Study%20rev.en.pdf](https://www.coe.int/t/dg2/equality/domesticviolencecampaign/Source/EG-VAW-CONF(2007)Study%20rev.en.pdf)
32. 'Studimi analitik i rezultateve të raundit 4 të monitorimit të zbatimit të Rekomandimit Rec (2002) 5 për mbrojtjen e grave kundër dhunës në vendet anëtare të Këshillit të Evropës' (Këshilli i Evropës, 2014), në: <https://rm.coe.int/16805915e9>
33. Çfarë është G.R.E.A.T.? Shih: <https://www.great-online.org/GREAT-Home>
34. Parandalimi i Dhunës në Shkollë: Një Doracak Praktik (Organizata Botërore e Shëndetësisë Gjenevë, 2019), shih: <https://apps.who.int/iris/bitstream/handle/10665/324930/9789241515542-eng.pdf?sequence=1&isAllowed=y>
35. 'Parandalimi i Përvojave të Pafavorshme të Fëmijërisë (PPF): Përdorimi i dëshmisë më të mirë të disponueshme', (Divizioni i Parandalimit të Dhunës, Qendra Kombëtare për Parandalimin e Lëndimeve dhe Qendrat e Kontrollit për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve, Atlanta, Gjeorgjia, 2019): në: <https://www.cdc.gov/violenceprevention/pdf/preventingACES-508.pdf>
36. Shih Mjetin e Projektit 130: Lista kontrolluese për zgjidhjen e problemeve duke përdorur modelin SARV në Paketën e Veglave Gjimore të Policisë së OKB-së, Praktikën më të Mirë të Standardizuara për Integrimin Gjini në Përmbledhjen e Mjeteve të Projektit (2015), në: <http://repository.un.org/bitstream/handle/11176/387374/United%20Nations%20Police%20Gender%20Toolkit%20Compendium%20of%20Project%20Tools.pdf?sequence=55&isAllowed=y>



## KONTAKTI FILLESTAR

*“Një hap pozitiv për të rritur përgjegjshmërinë është bërja e përdhunimit universalisht të paligjshme. Aktualisht më shumë se gjysma e të gjitha vendeve nuk kanë ende ligje që kriminalizojnë në mënyrë eksplicite përdhunimin martesor ose që bazohen në parimin e pëlqimit. Së bashku me kriminalizimin e përdhunimit, ne duhet të bëhemi shumë, shumë më të mirë në vendosjen e viktimës në qendër të përgjigjes dhe mbajtjen e përgjegjësisë ndaj përdhunuesve. Kjo nënkupton forcimin e kapacitetit të zyrtarëve të zbatimit të ligjit për të hetuar këto krime dhe mbështetjen e të mbijetuarave përmes procesit të drejtësisë penale, me qasje në ndihmë juridike, polici dhe shërbime të drejtësisë, si dhe shërbime shëndetësore dhe sociale, veçanërisht për gratë që janë më të marginalizuara ”.*

**Phumzile Mlambo-Ngcuka, Dretor Ekzekutiv Gratë e Kombeve të Bashkuara**







# HYRJEON

Një përvojë pozitive e kontaktit fillestar me sistemin e drejtësisë është vendimtare për viktimat/ të mbijetuarat e dhunës. Shërbimet duhet të jenë të disponueshme dhe të arritshme për të gjitha gratë.<sup>1</sup> Sipas PSHTH, elementi më i rëndësishëm i kontaktit fillestar do të jetë aftësia e policisë për t'i demonstruar viktimës/mbijetuarës se sistemi i drejtësisë dhe ofruesit e shërbimeve të drejtësisë në këtë sistem janë të përkushtuar për shëndetin dhe sigurinë e marrin seriozisht ankesën e saj, lejojnë që tregimi i saj të dëgjohet dhe dëshirojnë ta sigurojnë që ajo mbështetet mirë në udhëtimin e saj nëpër sistemin e drejtësisë.<sup>2</sup>

Foto mirësjellje nga UNMIT/Martine Perret (Timor-Leste)

Udhëheqja e policisë me komandën operacionale duhet të sigurojë që protokollet organizative për oficerët e parë që përgjigjen ose *Përgjigjesit e parë* në rastet e DHGV-së janë të krijuara në mënyrë të natyrshme për të mbrojtur mirëqenien e viktimave/të mbijetuarave dhe janë një pikënisje për një hetim efektiv dhe të kryer në mënyrë profesionale.

Për këtë qëllim, oficerët drejtues të udhëheqjes së policisë që i përgjigjen DHGV-së duhet të zbatojnë pavarësinë e tyre operacionale për të kontekstualizuar udhëzimet që ata japin kur stafi zbaton protokollet e *Përgjigjesit të parë*. Kjo bëhet për të siguruar që ata po adresojnë në mënyrë adekuate sigurinë e menjëhershme dhe nevojat

**“Ndërsa gratë dhe vajzat në mënyrë universale përjetojnë një formë të dhunës me bazë gjinore (DHBGJ), është një tragjedi e dyfishtë për gratë dhe vajzat autoktone dhe pakicë. Në disa vende, mungon njohja ligjore e identitetit të tyre si një komunitet i veçantë me stilin e jetesës, kulturën dhe mënyrën e veçantë të jetesës, duke i lënë ato të padukshme në statistikat kombëtare dhe shërbimet sociale. «**

Grupi ndërkombëtar për të drejtat e pakicave

e ndryshme të viktimave/të mbijetuarave, pavarësisht nga prejudhja e tyre, statusi ligjor dhe kapaciteti fizik ose mendor.


Në kontekstualizimin e udhëzimeve të tyre për *Përgjigjesin e parë*, udhëheqja e policisë duhet të kërkojë që të konsultohet gjerësisht me përfaqësuesit e individëve në pozita më të rrezikuara, siç janë organizatat e grave të

1 Shihni Modulin 3: Drejtësia dhe policimi, *Paketa e shërbimeve thelbësore për gratë dhe vajzat që i nënshtrohen dhunës: Elementet themelore dhe udhëzimet për cilësinë* (2015), ps. 6-7.

2 Për shërbimet dhe udhëzimet thelbësore që lidhen me vajzat viktimat/të mbijetuarat, shih *Udhëzimet mbi drejtësinë në çështjet që përfshijnë fëmijët viktimat dhe dëshmitarë të krimit* (rezoluta ECOSOC 2005/20).

pakicave<sup>3</sup> ose të nën-përfaqësuar<sup>4</sup> dhe udhëheqësit nga komunitetet pakicë etnike (veçanërisht udhëheqëset femra) ose, të paktën, të kërkojë një informacion të tillë nga kolegët e policisë që angazhohen rregullisht me komunitetet në fushën e tyre të kompetencës.

Procesi i konsultimit në vetvete është praktikë e mirë për krijimin e marrëdhënieve të punës me komunitetet lokale, të cilat mund të ndihmojnë policinë të njohë ndikimet e dhunës në grupe të ndryshme të grave dhe komuniteteve në përgjithësi. Mbajtja e mbështetjes së komunitetit për t'iu përgjigjur DHGV, do të ndihmojë në hedhjen e bazës për viktimat/të mbijetuarat për ta parë policinë si një burim legjitim të mbrojtjes së menjëhershme dhe t'i frymëzojë ato drejt kontaktit fillestar.



## UDHËZIMI I BASHKËPUNËTORËVE

Anëtari i parë i stafit tuaj që ka kontakte me një viktimë/të mbijetuar ka një rol kritik për të kryer; ato janë 'fasada e dyqaneve' për ju dhe agjencinë tuaj policore. Është e rëndësishme që ata të kuptojnë parimin e «çdo kontakti lë gjurmë», kur bëhet fjalë për t'u angazhuar me komunitetin, prandaj cilësia e atij kontakti fillestar është jetike.

Për të mundësuar që viktimat/të mbijetuarat e DHGV-së të raportojnë krimin tek ju ose stafi juaj, duhet të siguroheni që mekanizmi i raportimit është kuptuar dhe është i arritshëm për të gjitha viktimat/të mbijetuarat. Gratë dhe vajzat jo gjithmonë kanë mjetet për të shoqëruar një stacion policie, gjë që është për shkak të

3 'Minoritizimi' krijon dhe mban në mënyrë efektive kushtet sociale, politike, ekonomike dhe të tjera që çojnë në grupet e njerëzve që trajtohen dhe përcaktohen si pakica p.sh. 'pakica etnike' dhe 'etnia pakicë'. Është një proces i vazhdueshëm, aktiv që marginalizon grupe të veçanta në bazë të racës, përkatësisë etnike dhe arsyeve të tjera.

4 Në disa grupe minoritare, organizatat mund të udhëhiqen nga burra dhe/ose të dominuar nga meshkujt. Kjo ka qenë për një kohë të gjatë për organizatat e personave me aftësi të kufizuara, për shembull. Është e rëndësishme që zëra të tillë ende të përfshihen si bashkëbisedues, nëse organizatat e drejtuara nga gratë me aftësi të kufizuara nuk janë të pranishme.

shumë faktorëve. Mund të jetë e vështirë për ato të largohen nga shtëpia pa u shoqëruar; stacioni policor mund të jetë shumë larg vendit ku ato jetojnë; ato mund të mos kenë mjete për të hyrë në transport ose transporti nuk është i sigurt ose i arritshëm për to; ato mund të kenë përgjegjësi përkujdesjeje në shtëpi, dhe/ose të jetojnë në frikën e autorit të dyshuar, anëtarëve të familjes ose komunitetit më të gjerë. Ato gjithashtu thjesht nuk mund ta kuptojnë se policia mund të merret me krime të tilla, pasi këto mund të konsiderohen një çështje "private". Nëse ato marrin shoqërohen në një stacion policie, ato ende mund të përballen me barriera të tilla si qëndrimet negative të oficerëve; mungesa e objekteve miqësore për viktimat/të mbijetuarat, ose objekte të tilla që nuk janë të disponueshme ose të arritshme për ato viktimat/të mbijetuarat me lloje të ndryshme të aftësisë së kufizuar.

Prandaj, për të mbrojtur të drejtën e viktimës/të mbijetuarës për të kërkuar drejtësi, ju keni një përgjegjësi për t'i ndihmuar ato. Duhet të keni parasysh me sa vijon:

- A keni oficerë femra të trajnuara siç duhet në DHGV dhe të pozicionuara në mënyrë që ato të jenë të arritshme për të gjitha gratë dhe vajzat?
- A keni mekanizma të përshtatshëm dhe të arritshëm të raportimit për viktimat/të mbijetuarat e DHGV?
- A janë botuar gjerësisht dhe a janë të disponueshme në gjuhë dhe formate të ndryshme (alfabeti braj, printime të mëdha, të lexueshme lehtë) aty ku është e përshtatshme?
- A ka tryeza të ndihmës për gra ose vende të tjera të veçanta miqësore raportimi për viktimat/të mbijetuarat brenda zonës tuaj të policisë?
- Nëse tryezat e ndihmës ekzistojnë, a janë ato të vendosura në zona të përshtatshme? Për shembull, viktimat/të mbijetuarat nuk duhet të ecin nëpër zonat kryesore të arritshme për publikun, përfshirë stacionet policore, për të qenë në gjendje të raportojnë krimet që janë shpesh të ndjeshme, veçanërisht duke pasur parasysh se viktimat/të mbijetuarat shpesh kanë frikë nga pasojat e raportimit tek policia. Si mund të ruhet

privatësia dhe konfidencialiteti nëse një viktimë/e mbijetuar femër duhet të kalojë nëpër një stacion policie të zënë, duke kaluar zonën e qelisë në mënyrë që të arrijë në tryezën e ndihmës? Nëse nuk keni objekte miqësore për viktimat/të mbijetuarat, merrni parasysh të kërkontë ndihmë nga shërbime të tjera thelbësore, të tilla si ofruesit e shërbimeve shëndetësore, në mënyrë që stafi juaj të takojë viktimat/të mbijetuarat në një vend larg stacionit të policisë.

Roli i parë i policisë është të sigurojë sigurinë dhe shëndetin e menjëhershëm të viktimës/të mbijetuarës, pas çdo raportimi të dhunës, dhe kështu një përgjigje e shpejtë është parësore.

Edhe gjatë fazës fillestare të reagimit, stafi juaj duhet të vlerësojë rreziqet e mundshme për sigurinë e viktimës/të mbijetuarës dhe familjes së tyre, në mënyrë që të parandalojë ose zbusë çdo kërcënim, hakmarrje ose riviktimizim. Përkundër faktit se viktimat/e mbijetuarat mund të jetë ngurruese, shpesh nga frika e përfshirjes në procesin e drejtësisë penale, ju dhe stafi juaj ende keni përgjegjësinë për t'i mbrojtur ato ose ndonjë anëtar të familjes që mund të jetë në rrezik. Kjo është veçanërisht e rëndësishme nëse fëmijët janë në rrezik, përfshirë nga dëmtimet fizike dhe psikologjike.

Keni për detyrë të mbronit dhe për këtë arsye kërkohet veprim pozitiv, në çfarëdo forme, dhe të bësh asgjë nuk është një opsion. Veprimi pozitiv mund të jetë sigurimi i sigurisë së viktimës/të mbijetuarës dhe të tjerëve duke i larguar ato në një vend të sigurt ose, ndoshta një strehë ose një qendër me një ndalesë nëse është e disponueshme, ose mundësisht duke larguar autorin e dyshuar nga vendi. Duhet të siguroheni që përdorni gamën e plotë të kompetencave në dispozicion për ju në të njëjtën kohë duke kujtuar se autorët e dyshuar gjithashtu kanë të drejta të cilat duhet të mbështeten.

Me të mbërritur në vendin e ngjarjes, është e rëndësishme që ata policë përgjigjës fillestarë të kuptojnë konceptin se ajo që ata shohin kur mbërrijnë mund të mos jetë ajo që ata presin. Për shembull, në rastin e dhunës ndërpersonale, viktimat/e mbijetuarat mund të ketë rregulluar shtëpinë pas dhunës.

*Kur i përgjigjeni një skenë të dhunës në familje, sigurohuni që të shikfnnnnnnnnnnnOfnnnnn000o0o000oni përtej skenës që është para jush*



Ju duhet të siguroheni që kolegët tuaj oficerë të kuptojnë rëndësinë e shikimit përtej skenës që paraqitet para tyre, dhe se ata janë atje për të ndihmuar jo vetëm në këtë rast, por në një afat më të gjatë. Një rregull themelor është që viktimat/e mbijetuarat dhe autori i dyshuar duhet të ndahen për t'i mundësuar viktimës/të mbijetuarës ti flitet veçmas, në mënyrë që të përcaktohet se çfarë ka ndodhur.

Një viktimë/e mbijetuar shpesh vendos të merret me një incident vetë, si rezultat i të menduarit se nuk do të besohet nga familja, policia dhe komuniteti i saj i gjerë. Kjo është ndoshta arsyeja më e zakonshme e dhënë për të mos kontaktuar policinë ose ofruesit e shërbimeve të tjera (siç është rasti në Bashkimin Evropian). Kjo është veçanërisht një çështje për ata individë me lloje të ndryshme aftësish të kufizuara.

Hulumtimi cilësor ofron arsye shtesë pse gratë nuk përfshijnë policinë (ose shërbimet e tjera). Për shembull, *Organizata për sigurinë dhe bashkëpunimin në Evropë (OSBE)* ofron një pasqyrë mbi barrierat tipike me të cilat ballafaqohen gratë dhe vajzat dhe pse ato preferojnë të merren vetë me incidentet e dhunës<sup>5</sup>:

- **Turpi, përfshirë turpin e lidhur me lloje të caktuara të dhunës dhe me divorc;**
- **Arsyet financiare, përfshirë shqetësimet se gruaja nuk mund të mbajë veten dhe fëmijët e saj financiarisht dhe nuk do të marrë mbështetje nga familja e saj;**
- **Mungesa e besimit në institucione: gratë nuk presin një përgjigje efektive nga policia ose kanë frikë se nuk do të besohen;**

5 Anketa e udhëhequr nga OSBE mbi dhunën kundër grave: Raporti kryesor Organizata për sigurinë dhe bashkëpunimin në Evropë (Vjenë, 2019).



*Si policë ju jeni dërguar për të ndihmuar dhe jo për të gjykuar*

- **Mungesa e vetëdijes për shërbimet e specializuara:** *gratë nuk e dinë se ku mund të shkojnë për të marrë ndihmë;*
- **Frika nga ndëshkimi nga ana e autorit të dyshuar:** *gratë kanë frikë se dhuna mund të përshkallëzohet.*

Mjedisi në të cilin zhvillohet kontakti fillestar me një viktimë/të mbijetuar është me rëndësi jetike - mbani mend, ajo mund të ketë frikë të mos vijë tek ju në radhë të parë, dhe në rastin e DHPI, nuk ka gjasa të jetë hera e parë ajo ka pësuar dhunë nga duart e autorit të dyshuar. Prandaj, prioriteti i juaj kryesor është ta bëni atë të ndihet e sigurt, që ajo të mund të flasë lirshëm në privatësi dhe se informacioni që ajo jep do të mbetet konfidencial. Duhet të siguroheni që stafi juaj të kuptojë rëndësinë e kësaj, dhe ata duhet të identifikojnë çdo nevojë të veçantë të viktimës/të mbijetuarës dhe të sigurojnë strehim sipas nevojës.

Përshembull, njerëzit e moshuar mund të kenë vështirësi në dëgjim ose të kenë shikim të dobët. Në këto rrethana gjetja e një vendi për të folur pa zhurmë në prapavijë, të ndriçuar mirë ose me natyrë të mirë mund të ndihmojë jashtëzakonisht. Nëse viktimat/e mbijetuara është një person me aftësi të kufizuara në dëgjim dhe/ose të folur, do të jetë e rëndësishme që oficeri të përcaktojë nëse ajo e njeh gjuhën e shenjave dhe të sigurojë një përkthyes për të vazhduar komunikimin.

Është praktikë e mirë të flisni me viktimat/të mbijetuarat e DHGV larg stacionit të policisë, përveç nëse keni një hapësirë miqësore për viktimat/të mbijetuarat, ku ato mund të ndihen rehat dhe që u siguron atyre privatësi dhe konfidencialitet. Në varësi të prejardhjes së tyre, veçanërisht nëse ato nuk janë nga vendi juaj, siç është **refugjati** ose **migranti**, ato mund të lidhin organizatat policore dhe personelin tjetër të uniformuar të sigurisë me dhunën, kështu që është e rëndësishme që stafi juaj të përpiqet të kuptojë rrethanat e viktimës/të mbijetuarës.

### Kutia 1

#### Kush është refugjati dhe kush është migrant?

Refugjat	Migrant
Refugjati është dikush jashtë vendit të origjinës i cili ka nevojë për mbrojtje ndërkombëtare për shkak të një kërcënimi serioz për jetën, integritetin fizik ose lirinë në vendin e origjinës si rezultat i persekutimit, konfliktit të armatosur, dhunës ose çrregullimeve serioze publike kundër të cilave autoritetet në vendin e origjinës nuk mund ose nuk do t'i mbrojnë ato. <sup>6</sup>	Migranti ndërkombëtar (migrant) i referohet “çdo personi që është jashtë një shteti, shtetas i të cilit është, ose, në rastin e një personi pa shtetësi, shtetin e tij të lindjes ose vendbanimit e zakonshëm.” <sup>7</sup> Nuk ka një përkufizim universal dhe ligjor të “migrantit.” <sup>8</sup>

**Për më shumë informacion mbi sigurimin e një “hapësire të sigurt” për të folur me viktimat/të mbijetuarat shih Kapitullin 7: “Mbështetje dhe asistencë”.**

6 Parimet dhe udhëzimet, të mbështetura nga udhëzime praktike, për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të migrantëve në situata të rrezikueshme (OHCHR dhe Grupi global i migrimit)).  
 7 Shih OHCHR, ‘Parimet dhe udhëzimet e rekomanduara’ kap. I, para. 10. UNHCR vazhdimisht bën dallimin midis refugjatëve dhe emigrantëve, për të qenë të qartë në lidhje me shkaqet dhe karakterin e lëvizjeve të refugjatëve dhe të drejtat specifike të refugjatëve sipas ligjit ndërkombëtar.  
 8 Për një shpjegim të termit “migrantë në situata të cenushme”, shihni hyrjen në Parimet dhe udhëzimet (nr.6).

Për të siguruar një “qasje të përqëndruar te viktimat”, ju dhe oficerët tuaj duhet të kuptoni perspektivën e viktimës/të mbijetuarës dhe ato duhet të merren seriozisht. Çdo paragjykim i vetëdijshëm ose i pavetëdijshëm që ju ose stafi juaj mund të keni nuk duhet t’u transmetohet atyre. Për shembull, si është veshur viktimat/e mbijetuara, nëse ka konsumuar alkool apo drogë, nëse ka qenë vetëm, në çfarë vendndodhje ishte apo në cilën kohë ishte atje, nëse është e përfshirë në industrinë e seksit, nuk do të thotë ajo është përgjegjëse për dhunën e ushtruar ndaj saj. Asnjë nga këta faktorë nuk

justifikon atë që ka kryer autori. **Mos harroni se ju dhe stafi juaj jeni atje për të 'ndihmuar, jo për të gjykuar.'**

Viktimat/të mbijetuarat e DHGV shpesh fajësohen se e bëjnë veten të lëndueshme nga mënyra se si sillen ose ku shkojnë, por kërkoni nga stafi juaj që ta marrë parasysh këtë - nëse një pronar shtëpie raporton një vjedhje, është faji i tyre sepse nuk kishin bravë në të gjitha dritare apo dyer? Jo, raporti i tyre merret dhe krimi hetohet. Viktimat/të mbijetuarat e DHGV duhet të trajtohen në të njëjtën mënyrë.

## Paragjykimi gjinor dhe raportet e rreme

Paragjykimi gjinor<sup>9</sup> – qoftë e nënkuptuar (e pavetëdijshe) apo e qartë (e vetëdijshe)-formohet dhe informohet nga stereotipet dhe qëndrimet e bazuara në gjini që u caktojnë karakteristika, role dhe sjellje të ndryshme burrave kundrejt grave dhe kjo përfshin rolet dhe sjelljet seksuale. Gjinia gjithashtu kryqëzohet me faktorë të tjerë që rezultojnë në besimet për grupe të veçanta të grave dhe burrave, p.sh., se disa grupe të grave janë më të "disponueshme" seksualisht, duke ndikuar negativisht në besueshmërinë e tyre.

Ndërsa shumë prej nesh mbajnë qëndrime dhe vlera në mbështetje të barazisë gjinore, si dhe qasje të barabartë, të paanshme dhe të drejtë në drejtësi, paragjykimet e nënkuptuara gjinore megjithatë mund të ndikojnë në këto qëndrime dhe vlera. Kjo ndodh sepse paragjykimet e nënkuptuara veprojnë në një nivel të pavetëdijshtëm. Gjykimet tona mund të bëhen brenda pak sekondash, pa ndonjë vetëdije të vetëdijshe. Në fakt, ato mund, dhe shpesh, të kundërshtojnë besimet dhe vlerat tona të mbajtura me vetëdije.


Paragjykimi gjinor mund të shpjegojë pjesërisht besimet e përhapura gjerësisht se raportet e sulmeve seksuale janë shpesh të rreme. Ky besim, nga ana tjetër, mund të ndikojë në përgjigjet e profesionistëve, si brenda ashtu edhe jashtë sistemit të drejtësisë penale. Profesionistët që përgjigjen në mënyrë të pashmangshme do të bëjnë përcaktime të pavetëdijshe në lidhje me vërtetësinë e

<sup>9</sup> Përkufizimi i frymëzuar nga seria me katër pjesë nga Huhtanen, H., Lonsway, K.A., Archambault, J., 'Paragjykimi gjinor në përgjigjen dhe hetimin e sulmeve seksuale. Seria e buletinit të trajnimit', Fundi ndërkombëtar i dhunës kundër grave (EVAWI, 2017).

Figura 1:

### Akuza të rreme (Krizë e përdhunimit në Skoci)

<https://www.rapecrisisscotland.org.uk/false-allegations/>



#### FACT:

Akuzat e rreme janë më e zakonshme përpërdhunojnë se sa janë për krimet e tjera. Perceptimi se ato dëmtojnë përdhunim të mbijetuarit.

një raporti - por nëse këto gjykime janë të gabuara, ata mund të dështojnë të ndërmarrin veprimet e duhura ose mund të nxjerrin përfundime të pasakta. Paragjykimet dhe gjykimet gjinore ka shumë të ngjarë të detyrojnë viktimën/të mbijetuarën të mbyllet, të refuzojë të japë informacion apo edhe të heqë dorë nga historia e saj.

Çfarë ndodh nëse organet e rendit nuk besojnë se historia e një viktime/të mbijetuarë është e besueshme? Çfarë ndodh nëse organet e rendit nuk besojnë se një viktimë/e mbijetuar është e denjë për burimet e policisë për të kryer një hetim të plotë të bazuar në prova?

Stafi juaj duhet të fillojë me kuptimin se pretendimet e rreme për përdhunim janë në të vërtetë shumë të rralla, dhe shqetësimi më i madh është se krimet e përdhunimit, sulmit seksual dhe abuzimit seksual të fëmijëve në nivel global janë nën-raportuar dhe se ata kanë një mundësi për ta ndryshuar këtë duke trajtuar viktimat/të mbijetuarat me dinjitet dhe respekt.

Ndonjëherë mbështetja më e madhe për një viktimë/të mbijetuar është të tregosh se ajo besohet dhe se ke simpati për sprovën që ajo ka përjetuar. Ndërtimi i besimit dhe raportit me viktimën/të mbijetuarën është çelësi që ato të ndihen në gjendje të tregojnë historinë e tyre në mënyrë të plotë, por kjo mund të marrë kohë, madje edhe orë në një intervistë.

## Kutia 2

### Fillo duke besuar: Përmirësimi i përgjigjeve, zbulim një nga një \*

Fillo duke besuar (FDB) është një fushatë ndërgjegjësimi e fokusuar në përgjigjen e publikut ndaj sulmeve seksuale, pasi personi i parë që një viktimë i beson është zakonisht një mik ose anëtar i familjes. Si reagojnë ata përcakton në një pjesë të madhe atë që ndodh më pas. Një reagim pozitiv mund të përmirësojë mirëqenien e viktimave dhe të rrisë mundësinë që ata të raportojnë tek zbatuesit e ligjit dhe të kërkojnë ndihmë nga burime të tjera. Është krijuar gjithashtu për të përmirësuar përgjigjet profesionale.

Rreshteri Archambault - *"Frymëzimi fillestar për fushatën ishte ky: Herë pas here, pashë viktimat të sulmit seksual të trajtuar sikur duhej të provonin se ishin viktimat legjitime, para se të merreshin seriozisht." Thua se je përdhunuar? Vërtetoje!"*

*Kurrë nuk kam dëgjuar ndonjë oficer të kërkojë që një viktimë e një vjedhjeje të provojë se kishin TV para se ta paraqes padinë penale. Megjithatë kjo është pikërisht ajo që ne u bëjmë viktimave të sulmeve seksuale çdo ditë - në gjithë këtë vend dhe në mbarë botën".*

Ndërsa duket ndryshe në çdo komunitet, mesazhi është gjithmonë i njëjtë: "Kur dikush më thotë se janë përdhunuar ose sulmuar seksualisht, Fillova duke besuar."

FDB është një qëndrim filozofik që duhet të udhëheqë përgjigjet tona ndaj sulmeve seksuale. E "rrokullis skenarin" në mesazhin që viktimat kanë marrë historikisht nga profesionistë dhe njerëz mbështetës, e që është: "Si ta di që nuk po gënjen?"

Zbatimi i vërtetë i një qasjeje FDB do të ketë implikime të thella për pothuajse çdo aspekt të përgjigjes së një agjencie dhe komuniteti. Filozofia duhet të bartet në politika, praktika të përditshme dhe protokolle multidisiplinare. Duhet të ndikojë në gjuhën që ne përdorim dhe mënyrën se si i bëjmë punët tona. Kjo është lloji i strategjisë që nevojitet për të zvogëluar paragjykimet gjinore në përgjigjet e drejtësisë penale. Përsëri, Joanne Archambault e përmbledh atë:

*Viktimat e dinë kur dëgjojnë dhe merren seriozisht - por jo sepse themi disa fjalë. Ato e dinë atë nga veprimet tona. FDB ka të bëjë me dëgjimin me kujdes të viktimave, të dyshuarve dhe dëshmitarëve dhe kryerjen e një hetimi të plotë, kështu që vendimet bazohen në të gjitha informacionet dhe provat.*

\*'Fillo duke besuar' (FDB) është një filozofi e zhvilluar në Shtetet e Bashkuara nga Rreshteri Joanne Archambault e Luftës ndërkombëtare kundër dhunës ndaj grave (LNKDHNG) dhe e lansuar në 2011. Gjithashtu, shih Tanner, H., 'Fillo duke besuar për të përmirësuar përgjigjet ndaj sulmit seksual dhe parandalimin e paragjyqimeve gjinore' (2017).

Duhet t'i lejonit stafit tuaj kohë për të krijuar një marrëdhënie me viktimën/të mbijetuarën - kjo nuk duhet të nxitohet. Ka të ngjarë që viktimat/e mbijetuara i DHGV do të ketë pësuar një lloj traume dhe, në varësi të ashpërsisë së reagimit të tyre, do të përcaktojë se sa kohë mund të jetë e nevojshme me to, duke ofruar siguri dhe duke i inkurajuar ato të përshkruajnë në detaje atë që u ka ndodhur atyre.

  - duke kërkuar nga viktimat/të mbijetuarat e sulmeve seksuale që të përsërisin rrëfimin e tyre nga pika të ndryshme të sekuencës, për shembull, duke kërkuar që një viktimë/e mbijetuar të fillojë historinë nga fundi dhe ta tregojë atë mbrapsht;
  - bërja e pyetjeve viktimave/të mbijetuarave të krijuara për të ngatërruar ose testuar rrëfimin e tyre (si një mënyrë për të vlerësuar vlefshmërinë e tij).
- Pyetjet e intervistës të konsideruara si kundërproduktive në raport buronin nga përdorimi i gjuhës/pyetjeve dhe supozimeve për fajësimin e viktimave, të tilla si ‘Pse e bëtë ...’
- Intervistat tradicionale të policisë përfshijnë shumë ndërprerje kur viktimat/të mbijetuarat japin deklarata për përvojat e tyre të sulmit seksual. Ndërprerjet janë një e metë fatale në qasjen hetimore dhe pengojnë marrjen e kujtesës.

**Sipas shumë ekspertëve, qëndrimi i përcjellë nga zbatimi i ligjit është “faktor i vetëm më i rëndësishëm në përcaktimin e suksesit të intervistës së viktimave, dhe për këtë arsye i gjithë hetimi”.**

Një studim mbi ndikimin e traumave tek viktimat e sulmeve seksuale të rritur (Departamenti i drejtësisë, Kanada, 2019)

## Kutia 8

### Kur viktimat e sulmeve seksuale ndjejnë:

1. Që dikush po i dëgjon;
2. Që dëgjuesi mund të tolerojë atë që ka për të thënë;
3. Që dëgjuesi kupton atë që ka për të thënë;
4. Që dëgjuesi të imagjinojë historinë e tyre të jetë e vërtetë.

Ato do të ndihen më rehat kur zbulojnë përvojën e tyre dhe do të ndihen më rehat duke ofruar informacion në lidhje me të.

Një studim mbi ndikimin e traumave tek viktimat e rritura të sulmeve seksuale (Departamenti i drejtësisë, Kanada, 2019)

## Cila është rruga përpara

Raporti identifikon disa veprime dhe teknika pozitive që policia mund të ndërmarrë dhe zbatojë, në mënyrë që të jetë më e informuar për traumat në qasjen e saj ndaj DHGV:

- Institucionalizimi i trajnimit në hetimet e traumatizuar për punonjësit e policisë si pjesë integrale e praktikës së intervistimit të policisë;
- Trajnimi duhet të promovojë kompetencën emocionale, e cila kërkon zhvillimin e aftësive thelbësore shoqërore për të njohur, interpretuar dhe reaguari në mënyrë konstruktive ndaj emocioneve tek vetja dhe të tjerët. Kjo nënkupton zhvillimin e aftësisë për të intervistuar viktimat/të mbijetuarat në mënyra që i fuqizojnë dhe qetësojnë ato, në mënyrë që ato të jenë në gjendje të ofrojnë tregime më të sakta, koherente, të qëndrueshme dhe bindëse;
- Intervista fillestare me një viktimë/të mbijetuar e cila e para raporton një sulm seksual duhet të jetë i shkurtër, pastaj i ndjekur nga një intervistë më e plotë disa ditë më vonë kur viktimat/e mbijetuara ka pasur kohë për të fjetur dhe konsoliduar kujtimet e saj të përvojës traumatike.<sup>31</sup> Kjo do të lejojë kujtime më të konsoliduara që priren të jenë më të qëndrueshme,

<sup>31</sup> Disa shërbime policore në Shtetet e Bashkuara dhe Kanada lejojnë konsolidimin e kujtesës pas dy cikleve të gjumit të plotë para se të intervistojnë oficerët e policisë të cilët janë përfshirë në të shtënat. Kjo praktikë mund të zbatohet në procesin e intervistimit me viktimat/të mbijetuarat e VAWG. Shih Haskell, L. dhe Randell, M., 'Ndikimi i traumës në viktimat e rritur të sulmeve seksuale' (2019). Raporti i dorëzuar: Drejtësia Kanada (2019).

më të besueshme dhe më të qëndrueshme të kujtuara, dhe kështu më të dobishme për deklaratat e holësishme të viktimave të marra nga policia.<sup>32</sup>

- Gjatë intervistës në polici të një viktime/të mbijetuarare të sulmit seksual, fokusi duhet të jetë në kujtimet shqisore, emocionale që viktimat/e mbijetuara ka koduar dhe kujtuar në vend që të presë që viktimat/e mbijetuara të japë një tregim me një kronologji.
- Është e rëndësishme që punonjësit e policisë të pranojnë se zbulimi është një proces, jo një ngjarje e njëhershme. Është gjithashtu e rëndësishme që policia të pranojë se zbulimi i incidenteve të sulmeve seksuale, të cilat viktimat/të mbijetuarat shpesh i përjetojnë si poshtëruese dhe të pafuqishme, është veçanërisht i vështirë. Kjo është veçanërisht e vërtetë në një shoqëri ku mitet e përdhunimit ende ekzistojnë.
- Efekti i qëndrimit të hetuesit policor ndaj një viktime/të mbijetuarare, veçanërisht një viktime/të mbijetuarare të sulmit seksual, është një ndryshore shumë domethënëse në një takim të parë (dhe në të vërtetë çdo takim). Viktimat/të mbijetuarat shpesh ndihen të frikësuar, të turpëruara ose të frikësuar kur policia u përgjigjet atyre me shkëputje, ashpërsi, mosbesim ose pushim nga puna.
- Shpesh qasjet tradicionale të policisë ndaj intervistave

<sup>32</sup> McCaugh, J. L. 'Konsolidimi i kujtesës dhe amigdala: një perspektivë e sistemeve', Trends Neurosci. (2002) shtator; 25 (9):456.

të viktimave/të mbijetuarave në rastet e sulmeve seksuale janë fokusuar në detajet periferike, të cilat nuk kujtohen lehtë dhe mund të mos jenë as të rëndësishme. Në vend të kësaj, policia duhet të përqëndrohet në detajet qendrore të cilat viktimat/të mbijetuarat i kujtojnë më shpesh dhe më lehtë.



## SHËNIME DHE LEXIM TË SUGJERUAR

1. Moduli 3: Paketa e shërbimeve themelore të drejtësisë dhe policimit për gratë dhe vajzat që i nënshtrohen dhunës: elementet themelore dhe udhëzimet për cilësinë (Programi i përbashkët global i Kombeve të Bashkuara për shërbimet thelbësore për gratë dhe vajzat që i nënshtrohen dhunës, 2015), shih: <https://www.unwomen.org/-/media/headquarters/attachments/sections/library/publications/2015/essential-services-package-module-3-en.pdf?la=en&vs=3520>
2. Udhëzime mbi drejtësinë në çështjet që përfshijnë fëmijët viktime dhe dëshmitarë të krimit (rezoluta ECOSOC 2005/20).
3. Anketa e Drejtuar nga OSBE mbi Dhunën ndaj grave: Raporti kryesor. (Organizata për sigurinë dhe bashkëpunimin në Evropë (Vjenë, 2019), shih: <https://www.osce.org/secretariat/413237?download=true>
4. Kodi i sjelljes për zyrtarin e zbatimit të ligjit miratuar nga rezoluta e Asamblesë së përgjithshme 34/169 e 17 dhjetorit 1979
5. Huhtanen, H., Lonsway, K.A., Archambault, J., 'Paragjykimi gjinor në përgjigjen dhe hetimin e sulmeve seksuale', Seria e buletinit të trajnimit: Pjesa 1. Fundi ndërkombëtar i dhunës kundër grave (EVAWI, 2017)
6. Huhtanen, H., Lonsway, K.A., Archambault, J., 'Paragjykimi gjinor në përgjigjen dhe hetimin e sulmeve seksuale', Seria e buletinit të trajnimit: Pjesa 2. Fundi ndërkombëtar i dhunës kundër grave (EVAWI, 2017).
7. Huhtanen, H., Lonsway, K.A., Archambault, J., 'Paragjykimi gjinor në përgjigjen dhe hetimin e sulmit seksual' Seria e buletinit të trajnimit: Pjesa 3. Fundi ndërkombëtar i dhunës kundër grave (EVAWI, 2017).
8. Huhtanen, H., Lonsway, K.A., Archambault, J., 'Paragjykimi gjinor në përgjigjen dhe hetimin e sulmeve seksuale', Seria e buletinit të trajnimit: Pjesa 4. Fundi ndërkombëtar i dhunës kundër grave (EVAWI, 2017).
9. 'Manuali i trajnimit të dhunës me bazë gjinore për oficerët gjyqësorë në Uganda', (Gratë e KB, 2019 i pabotuar).
10. Guerette, R.T. & Bowers, K.J. (2009), 'Vlerësimi i shtrirjes së zhvendosjes së krimit dhe përhapja e përfitimeve: Rishikimi i vlerësimeve të parandalimit të krimit të situatës' *kriminologjia*, 47 (4), fq.1331-1368.
11. Paketa e mjeteve të një praktikuesi për programimin e qasjes së grave në drejtësi. (Gratë e KB etj., 2018), shih: <https://www.unwomen.org/-/media/headquarters/attachments/sections/library/publications/2018/waaj-complete-toolkit-en.pdf?la=en&vs=2654>
12. Deklarata mbi eliminimin e dhunës ndaj grave, 23 shkurt 1994, shih: <https://undocs.org/en/A/RES/48/104>
13. Forcimi i parandalimit të krimit dhe reagimi i drejtësisë penale ndaj dhunës kundër grave (UNODC, 2014).
14. 'Integrimi i perspektivës gjinore në udhëzimet dhe praktikën e hetimeve për të drejtat e njeriut'. Zyra e OKB -së e Komisionit të lartë për të drejtat e njeriut (Nju Jork dhe Gjenevë, 2018). <https://www.ohchr.org/Documents/Issues/Women/Publications/GenderIntegrationintoHRInvestigations.pdf>
15. 'Biznesi i të gjithëve: Përmirësimi i reagimit të policisë ndaj abuzimit në familje' (HCIM 2014). <https://www.justiceinspectorates.gov.uk/hmicfrs/wp-content/uploads/2014/04/improving-the-police-response-to-domestic-abuse.pdf>
16. Kodi i sjelljes për zyrtarët e zbatimit të ligjit, miratuar me rezolutën e Asamblesë së përgjithshme 34/169 të 17 dhjetorit 1979, shih: <https://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/LawEnforcementOfficials.aspx>
17. Haskell, L. dhe Randell, M., 'Ndikimi i traumës në viktimat e sulmeve seksuale të të rriturve (2019). Raporti i dorëzuar në: Drejtësia Kanada (2019), shih: [https://www.justice.gc.ca/eng/rp-pr/jr/trauma/trauma\\_eng.pdf](https://www.justice.gc.ca/eng/rp-pr/jr/trauma/trauma_eng.pdf)
18. Randall, M. (2010), 'Ligji për sulmet seksuale, besueshmëria dhe "Viktimat ideale": Pëlqimi, rezistenca dhe fajësimi i viktimës', *Revista Kanadeze e grave dhe ligji*, 22 (2), 397-43.
19. McGaugh, J. L. (2002), 'Konsolidimi i kujtesës dhe amigdala: Perspektivë e sistemeve'. *Trendet Neurosci* (2002) shtator; 25 (9): 456.
20. Tanner, H., 'Filloni duke besuar në përmirësimin e përgjigjeve ndaj sulmeve seksuale dhe parandalimit të paragjyqimeve gjinore' (2017), shih: <https://www.evaw-intl.org/Library/DocumentLibraryHandler.ashx?id=919>
21. Sara Ferro Ribeiro dhe Danaé van der Straten Ponthoz, 'Protokolli ndërkombëtar mbi dokumentimin dhe hetimin e dhunës seksuale në konflikt. Praktika më e mirë mbi dokumentimin e dhunës seksuale si krim ose shkelje e Ligjit ndërkombëtar' (Zyra e jashtme dhe e Komonuelthit në Mbretërinë e Bashkuar, Edicioni i dytë, mars 2017), shih: <https://assets.publishing>

[service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment\\_data/file/598335/International\\_Protocol\\_2017\\_2nd\\_Edition.pdf](https://www.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/598335/International_Protocol_2017_2nd_Edition.pdf)

22. 'Fëmijët dhe interpretimi joformal: Shumë fëmijë të marrin një rol interpretimi ose përkthimi joformal për familjen e tyre', (Shoqëria e fëmijëve në Mbretërinë e Bashkuar), shih: <https://www.chil-drenssociety.org.uk/youngcarer/refugee-toolkit/children-and-informal-interpreting>
23. 'Akuza të rreme', (Kriza e përdhunimit në Skoci), shih: <https://www.rapecrisisscotland.org.uk/false-allegations/>
24. 2013 QPS 57 Konkluzionet e dakorduara u bëjnë thirrje shteteve të marrin masat e nevojshme legjislative dhe/ose masa të tjera për të ndaluar proceset e detyrueshme dhe të detyruara të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, përfshirë ndërmjetësimin dhe pajtimin e detyruar, në lidhje me të gjitha format e dhunës kundër grave dhe vajzave (E/2013/27 - E/CN.6/2013/11, para (g).
25. Grupi ndërkombëtar për të drejtat e pakicave, shih: <https://minorityrights.org/2019/12/10/marginalized-and-violated-gbv/>
26. *Parimet dhe udhëzimet*, të mbështetura nga udhëzimet praktike, për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të migrantëve në situata të cenueshme (OHCHR dhe Grupi global i migrimit), shih: <https://www.ohchr.org/Documents/Issues/Migration/PrinciplesAndGuidelines.pdf>
27. *Paketa e veglave* të UNPOL -it për praktikën më të mira mbi integrimin gjinor në ruajtjen e paqes: Përmbledhje e mjeteve të projektit (2015), shih: <http://repository.un.org/bitstream/handle/11176/387374/United%20Nations%20Police%20Gender%20Toolkit%20Compendium%20of%20Project%20Tools.pdf?sequence=55&isAllowed=y>





## HETIMI

*“Përgjegjësia kryesore për fillimin e hetimeve dhe ndjekjet penale bie mbi policinë dhe autoritetet e prokurorisë dhe nuk bie mbi gratë që i nënshtrohen dhunës, pavarësisht nga niveli ose forma e dhunës.”*

**Asambleja e Përgjithshme e KB -së në Strategjitë Model të Përditësuara me 2010 dhe Masat Praktike mbi Eliminimin e Dhunës ndaj Grave në Fushën e Parandalimit të Krimit dhe Drejtësisë Penale (2011, rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 65/228, shtojcë).**

---

# QËLLIMI I KAPITULLIT

---

**Policia po i plotëson në mënyrë efektive kërkesat dëshmuese dhe hetimore kur i përgjigjet DHGV -së duke kryer hetime në kohën e duhur dhe në mënyrë profesionale, dhe në këtë proces, duke shteruar të gjitha mjetet në dispozicion për të siguruar llogaridhënien e autorit (kryesit) dhe për të parandaluar ri-shkeljen e ligjit.**

---

## Mesazhet Kryesore dhe Pikat e Mësimit

- Autoritetet e policisë dhe prokurorisë kanë përgjegjësinë kryesore për fillimin e hetimit - e jo viktimat/e mbijetuara;
- Nuk ka hierarki dhune kur përcaktohet cilësia e reagimit të policisë;
- Hetimi që është i ancoruar në fuqizimin e viktimës/të mbijetuarës përmes një qasjeje të përqendruar tek viktimat/e mbijetuara rrit kënaqësinë dhe besimin tek policia;
- Etika e “Mos Bëj Dëm” duhet të jetë qendrore për çdo vendim ose veprim të ndërmarrë gjatë hetimit;
- Tregues i një hetimi të kryer profesionalisht dhe të përgjegjshëm gjinor është kur mirëqenia e viktimës/të mbijetuarës është e balancuar me plotësimin e kërkesave hetimore;
- Mbledhja e provave mjeko/mjekësoro-ligjore duhet të jetë edhe ndjeshme ndaj gjinisë dhe e zellshme në përputhje me protokollet;
- Kujdes i veçantë kërkohet kur viktimat/e mbijetuara është e moshuar, shumë e re ose personi me aftësi të kufizuara, pasi ata mund të kenë nevoja specifike;
- Njohja e fazave të sjelljes shtrënguese(detyruese) dhe kontrolluese në dhunën ndërpersonale mund të përcaktojë rezultatin e një hetimi;
- Parandalimi i akteve të DHGV-së që lidhen me dhunën/abuzimin me bazë nderi dhe praktikatat e dëmshme kërkon zgjidhje të bazuara në komunitet dhe hetues të ndjeshëm në kontekst.



# HYRJJE

Çdo hetim është i ndryshëm dhe mund të kërkojë një strategji ose qasje të ndryshme hetimi. Pa varësisht nga strategjia/qasja e përdorur, normat ndërkombëtare që përcaktojnë standardet minimale kërkojnë që policia të reagojë me zell, në mënyrë efektive në kohë, duke përdorur të gjitha burimet në dispozicion pa diskriminim.

Foto me mirësjellje nga OKB/Martine Perret (Timor-Leste)

Në rastet e DHGV- së, ESP shton se tregues i hetimi të kryer profesionalisht dhe të përgjegjshëm gjinor është kur hetuesit me mjeshtri gjejnë ekuilibrin e duhur midis të siguruarit që siguria dhe dinjiteti i viktimës/ të mbijetuarës të ruhet gjatë gjithë procesit dhe përm-bushjes së kërkesave dëshmuese dhe hetimore për të vërtetuar veprën penale dhe/ose të dhunshme.<sup>1</sup>

Çelësi për gjetjen e këtij ekuilibri të duhur do të jetë aftësia e hetuesit (ve) për të inkurajuar pjesëmarrjen domethënëse të viktimës/të mbijetuarës, duke aplikuar qasjen e përqendruar te viktimat/e mbijetuara, duke bashkëpunuar me ofruesit e tjerë të shërbimeve thelbësore dhe palët e interesit të bazuara në komunitet,

1 Paketa e Shërbimeve Thelbësore për Gratë dhe Vajzat që i nënshtrohen Dhunës: Elementet Themelore dhe Udhëzimet për Cilësinë (Programi i Përbashkët Global i Kombeve të Bashkuara mbi Shërbimet Thelbësore për Gratë dhe Vajzat që i nënshtrohen Dhunës, 2015).


si formale<sup>2</sup> ashtu edhe joformale<sup>3</sup> dhe për të kryer punë në mënyrë profesionale që zbut kundër anshmërive të dëmshme dhe viktimizimit dytësor.

**Shih Kapitullin 2: ‘Bërja e Dallimit si Menaxher dhe Udhëheqës i Ekipit’ për më shumë informacion mbi qasjen e përqendruar te viktimat/e mbijetuara.**

Po aq i suksesshëm për hetimin e DHGV-së do të jetë të kuptuarit e oficerit hetues se çfarë përbën DHGV-në dhe se si sjellje dhe paragjykime të caktuara e shtojnë atë. Kjo do të mundesojë oficerëve hetues të identifikojnë modelet (rregullat) e sjelljes abuzive nga autori i dyshuar dhe variablat e ndryshëm mjedisorë që ndikojnë në natyrën e dhunës që ka përjetuar viktimat/e mbijetuara, si dhe sjelljen dhe reagimet e viktimës/të mbijetuarës.

2 Për shembull, klinikat mjekësore të komunitetit, strehimoret e viktimave/të mbijetuarave të mbështetura nga shteti dhe OJQ -të lokale që ofrojnë mbështetje për viktimat/të mbijetuarat që hyjnë në sistemin formal të drejtësisë.

3 Për shembull, udhëheqëset e komuniteteve femra, këshillat fetare ose autoritetet fetare ose zbatuesit e drejtësisë tradicionale.



## UDHËZIME NGA KOLEGËT

Ky informacion do të jetë vendimtar gjatë planifikimit të masave të sigurisë dhe mbrojtjes për të siguruar mos përsëritjen e dhunës (shih Kapitullin 6: «Siguria dhe Mbrojtja») pasi ai do të ndihmojë në vendosjen e sjelljes abuzive dhe shtrënguese (detyruese) të autorit të supozuar brenda një cikli të modelit të dhunës të krijuar nga ekspertë në këtë fushë.

### Shih Kapitullin 11: 'Sfidat dhe Strategjitë për Zbatimin e Punës Policore të Përgjegjshme Gjimore' në zbatimin e ciklit të modeleve të dhunës në strategjitë e reagimit të DHGV-së.

Vendosja e modelit (rregullës) të sjelljes abuzive të autorit të dyshuar në një cikël të modelit të dhunës do të ofrojë informacionin e nevojshëm për të kryer një hetim efektiv të fokusuar tek autorët. Ky fokus hetimor do të ndihmojë për të hedhë dritë mbi mënyrën se si të ndalohet dhe sanksionohet sjellja abuzive dhe ndoshta si të mbështetet autori i dyshuar nga përsëitja e shkeljes ligjore, një skenar që zakonisht preferohet nga viktimat/ të mbijetuarat e dhunës në familje ose nga partneri intime (DhPI).

Ne kapitullin vijues do të diskutohet mjedisi i përshtatshëm i nevojshëm për të kryer një hetim mbi DHGV-në që është efektiv në përmbushjen e kërkesave dëshmuese dhe hetimore dhe paralelisht, sigurimi i pjesëmarrjes kuptimplote të viktimës/të mbijetuarës në procesin e vendimmarrjes.

Udhëzimet e dhëna për menaxherët e mesëm të policisë do të bazohen në hulumtimet dhe praktikat aktuale mbi policimin (Punën Policore) e paanshëm dhe të përgjegjshëm ndaj gjinisë dhe se si kjo qasje mund të mbështesë efektivitetin e hetimeve në DHGV. Për më tepër, kapitulli do të ndjekë nga afër kornizën ESP-se dhe do t'i rekomandojë lexuesit të vështroje udhëzimet kornizë të dhëna në Modulin 3 të ESP-se për Drejtësinë dhe Policimin (Punën Policore), veprimin thelbësor numër 3 për «Hetimin». Paralelisht, lexuesit gjithashtu duhet t'i referohen udhëzimeve kornizë të dhëna në Modulin 2 të ESP-se për Shëndetësinë, veçanërisht në veprimin thelbësor numër 6 mbi «Dokumentacionin (Mjekësi-Ligjore)».

Si udhëheqës, është thelbësore të siguroni që stafi juaj të ofrojë një shërbim efektiv policor për viktimat/të mbijetuarit e DHGV-së, dhe ndërsa njihet ju do të keni kërkesa konkurruese për shërbimet tuaja dhe burimet që keni në dispozicion, mesazhet që u jepni si stafit tuaj ashtu edhe komunitetit lokal janë vendimtare. Duhet të bëhet shumë e qartë se **DHGV-ja nuk do të tolerohet**, se ju dhe stafi juaj do të respektoni ligjin dhe autorët e supozuar do të ndiqen në mënyrë rigorozë me qëllim që të vendosen ata para gjykatës së ligjit. A i keni bërë të qartë të gjithë stafit tuaj se çfarë pritet prej tyre dhe a i monitoroni dhe mbani përgjegjes individë për performancën e tyre?

Për të siguruar që stafi juaj po plotëson standardet që pritet prej tyre nga organizata juaj, ata do të duhet të dinë përmbajtjen e çdo politike ose Procedure Standarde të Operimit (PSO) për luftimin/reagimin ndaj DHGV-së.

Nëse një dokument i tillë nuk ekziston brenda organizatës suaj, ju mund të konsideroni të hartoni një komplet (set) vendor udhëzimesh për stafin tuaj të cilit ata duhet t'i përmbahen. Ju gjithashtu mund t'i nxisni eprorët tuaj që të llojnë për krijimin (hartimin) e PSO-së për organizatën tuaj (bazuar në kontributin dhe përvojat nga ekipi/njësia juaj).

Pavarësisht nëse ka një politikë organizative/PSO apo jo, ju duhet të identifikoni sfidat me të cilat përballeni ju dhe stafi juaj në trajtimin e incidenteve të tilla dhe çfarë zbrastësish ka në burime ose njohuri që duhet të adresohen ose që keni nevojë për ndihmë qoftë nga komuniteti, ofruesit tjerë të shërbimeve ose nga dikush tjetër brenda organizatës suaj.

Ju do të duhet të bindeni se stafi juaj është në dijeni dhe i përditësuar për çdo dispozitë ligjore përkatëse që ka të bëjë me DHGV-në. Ata duhet të jenë të vetëdijshëm për rolet dhe përgjegjësitë e tyre në respektimin (mbështetjen) si të ligjeve kombëtare ashtu edhe të çdo ligji, konvente ose protokollit ndërkombëtar, për të cilin Qeveria juaj mund të jetë nënshkruese.

**Dhuna kundër grave dhe vajzave (DHGV) është “çdo akt dhune me bazë gjinore që rezulton, ose ka të ngjarë të rezultojë në dëmtime ose vuajtje fizike, seksuale ose psikologjike ndaj grave, duke përfshirë kërcënimet e akteve të tilla, detyrimin ose privimin arbitrar të lirisë, kudo që ndodhin ato qofshin në jetën publike ose private”**

Deklarata mbi Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 48/104 (1993).

Një shembull i mirë do të ishin dispozitat mbi të drejtat e njeriut të përfshira në Kushtetutë ose traktatet ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi juaj, të cilat zbatohen jo vetëm për viktimat/të mbijetuarit, por edhe për autorët e supozuar. A është stafi juaj i vetëdijshëm për përgjegjësinë e tyre për të ofruar siguri dhe mbrojtje për të gjithë njerëzit që janë përgjithmonë ose përkohësisht brenda kufijve të vendit tuaj? Kjo do të përfshijë çdo refugjat, azilkërkues dhe emigrant, qofshin ata të dokumentuar apo të padokumentuar.

Nëse keni ndonjë kamp refugjatësh të vendosur brenda zonës tuaj të policisë, a është stafi juaj i vetëdijshëm se ata që jetojnë në kampe kanë ende të drejtë të jetojnë atje të sigurt dhe të trajtohen me dinjitet dhe respekt? Siguria dhe mbrojtja e tyre nuk është përgjegjësi e vetme e policisë. Të gjitha agjencitë e përfshira në kampet dhe përreth kanë një rol për të luajtur, por njësoj policia nuk mund të heqë veten nga çdo përgjegjësi vetëm sepse kampi drejtohet nga Zyra e Kombeve të Bashkuara e Komisionerit të Lartë për Refugjatët (UNHCR)<sup>4</sup> ose organizata të tjera ndërkombëtare.

Ekziston një rol i qartë për policinë në parandalimin, hetimin dhe mbështetjen dhe aktivitetet e asistencës dhe, për të qenë efektive, duhet të ketë një qasje

4 Zyra e Komisarit të Lartë për Refugjatët e Kombeve të Bashkuara u krijua më 14 dhjetor 1950 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara. Agjencia është e mandatuara të udhëheqë dhe koordinojë veprimet ndërkombëtare për të mbrojtur refugjatët dhe për të zgjidhur problemet e refugjatëve në mbarë botën, shih: <https://www.un.org/youthenvoy/2013/09/office-of-the-united-nations-high-commissioner-for-refugees/>

bashkëpunuese dhe të koordinuar midis policisë dhe të gjitha agjencive të tjera dhe palëve të interesit.

**Për më shumë informacion mbi punën bashkëpunuese shih Kapitullin 3: ‘Parandalimi’, Kapitullin 7: Mbështetje dhe Ndihmë’ dhe Kapitullin 8: ‘Koordinimi midis Agjencive të Drejtësisë’.**

Pasi të keni përcaktuar nëse stafi juaj është plotësisht i përditësuar për çdo legjislacion në lidhje me DHGV-në, duhet të jeni të sigurt se ata janë të vetëdijshëm për rolet dhe përgjegjësitë e tyre individuale në luftimin e krimeve të tilla. I gjithë stafi duhet të jetë i vetëdijshëm për përgjegjësitë e tyre specifike që nga ai që ka kontaktin e parë me viktimën/të mbijetuarën - qoft ai që merr telefonatën, oficer për informata ose oficer patrulle (Reaguesi i Parë), ekspertë të vendngjarjes ose mjeko-ligjorë - deri tek hetuesit e përgjithshëm os specialist, menaxherët e rasteve, mbikëqyrësit dhe menaxherët e linjës.

Mënyra në të cilën reagon personi i parë që vjen në kontakt me viktimën/të mbijetuarën do të ketë ndikimin më të madh dhe të qëndrueshëm në besimin dhe sigurinë e viktimës/të mbijetuarës në polici. Kjo pastaj do të përkthehet në besimin dhe sigurinë që kanë familja dhe miqtë e tyre dhe komuniteti në polici.

**Për më shumë informacion mbi trajtimin e viktimave/të mbijetuarve, shih Kapitullin 4: ‘Kontakti fillestar’ dhe Kapitullin 9: ‘Komunikimet’.**

**Çdo reagim ndaj incidenteve të raportuara të DHGV-së** duhet të jetë e menjëhershëm, në mënyrë që të demonstron angazhimin për të luftuar kundërvatjet e tilla dhe të dërgohet mesazhi i qartë se të gjitha viktimat/të mbijetuarët janë të rëndësishme, dhe se ata dhe ankesat e tyre po merren seriozisht. Reagimet e menjëhershme janë me shumë rëndësi për të siguruar sigurinë dhe mbrojtjen e tyre dhe të çdo familjeje ose bashkëpunëtori tjetër që mund të jenë në rrezik. Viktima/e mbijetuarara mund të ketë nevojë për kujdes mjekësor për çdo dëmtim fizik ose psikologjik dhe marrja e këtij trajtimi në mundësinë më të hershme jo vetëm që përmbush nevojat e viktimës/të mbijetuarës, por përmirëson edhe perspektivën e marrjes së dëshmimeve të mundshme drejtpërdrejt prej tyre.

## Kutia 1

### A jeni duke siguruar që po monitorohet performanca e Reaguesve tuaj të Parë ndaj krimeve të DHGV-së?

Më poshtë është një listë e thjeshtë kontrolluese për mbikëqyrësit e Reaguesve të Parë, bazuar në këshillat e Kolegjit të Policimit (Punës Policore) në Mbretërinë e Bashkuar:

1. Viktimat/të Mbijetuarat u bënë të ndihen të sigurt, Reaguesi i Parë duke demonstruar ndjeshmërinë
2. Reaguesi i parë nuk bën gjykime mbi zgjedhjet e jetës së viktimës/të mbijetuarës ose mekanizmave të përballimit
3. Është kryer procesi i Vlerësimit të Riskut
4. Kontrolloni mirëqenien e fëmijëve dhe sigurinë që u ofrohet fëmijëve në vendin e ngjarjes
5. Planifikimi i sigurisë me viktimën/të mbijetuarën dhe fëmijët
6. Sigurimi i intimitetit gjatë ndarjes së viktimës/të mbijetuarës dhe autorit të supozuar
7. Informimi i viktimës/të mbijetuarës se atyre u besohet dhe se ata kanë marrë vendimin e duhur për të kërkuar ndihmë
8. Demonstron të kuptuarit se pse disa viktimat/të mbijetuarat mund të jenë jo bashkëpunuese
9. Ruajtja sipas nevojës individuale
10. Trajtimi i duhur me nevojat e viktimave/të mbijetuarve me prejardhje të ndryshme
11. Identifikimi, mbrojtja dhe ruajtja e vendit të krimit
12. Identifikimi, ruajtja dhe, aty ku është e përshtatshme, mbledhja e provave
13. Marrja e veprimeve pozitive dhe shpjegimi i këtyre viktimës/të mbijetuarës
14. Adresimi i kundër supozimeve

Edhe nëse një hetues ose oficer posaçërisht i trajnuar nuk është në dispozicion në kohën e raportimit, viktimat/e mbijetuara nuk duhet të lihet kurrë në pritje të një reagimi, prandaj është jetike që GJITHE stafi të ketë, së paku, vetëdije të përgjithshme për atë se si të sillen me viktimat/të mbijetuarat e DHGV-së, përfshirë edhe ata që janë më të cenueshëm. Në fund të fundit, që nga momenti i raportimit të një incidenti, stafi duhet të kuptojë etosin (karakterin) e «**Mos Bëj Dëm**»<sup>5</sup> në lidhje me çdo vendim ose veprim.

Është mëse e rëndësishme që gjithçka të bëhet për të parandaluar që viktimat/e mbijetuar që të pësojnë trauma të mëtejshme nga nxitja e çdo procesi ose procedure policore që mund të arrijë në viktimizimin dytësor. Ata duhet të kuptojnë se sa e vështirë mund

të ketë qenë për viktimën/të mbijetuarën të raportojë në polici në radhë të parë dhe çdo rrezik shtesë me të cilin ata mund të përballen nga familja e tyre ose komuniteti më i gjerë si rezultat i raportimit.

Sipas Doracakut të UNODC-ut mbi *‘Reagimet Efektive të Policisë ndaj Dhunës kundër Grave’* (2010), hetimi është një ushtrim metodik në zgjidhjen e problemeve që përfshin identifikimin e kundërvajtjes duke shqyrtuar faktet ose rrethanat e një incidenti dhe identifikimin e opsionit të zbatimit të përshtatshëm për faktet ose rrethanat. Ndërsa kompleksiteti dhe natyra dinamike e DHGV-së janë unike nga hetimet e tjera, qëllimi dhe parimet udhëzuese mbeten kryesisht të njëjta.

Bazuar në [Doracakun e UNODC-ut](#), më poshtë janë listat kontrolluese me qëllim të hetimit dhe, përveç kësaj, se çfarë e bën një hetim efektiv:

<sup>5</sup> Parimi “mos bëj dëm” i referohet sigurimit të veprimeve dhe komunikimeve që nuk përforcojnë pa dashje stereotipet negative për burrat dhe gratë që kontribuojnë në dhunën kundër grave dhe vajzave.

## Kutia 2

### Qëllimi i hetimit është:

- Të përcaktojë nëse është kryer një veprë penale ose të hedh poshtë një pretendim;
- Të identifikojë viktimën/të mbijetuarën dhe dëshmitarët;
- Të mbledh dhe ruaj dëshmitë e çdo lloji që mund të jenë të rëndësishme;
- Të zbulojë shkakun, mënyrën dhe vendndodhjen e një veprë penale;
- Të vërtetojë identitetin e autorit të dyshuar ose personit (ave) përgjegjës;
- Aty ku është e përshtatshme, të formulojë bazat mbi të cilat mund të ngrihet një akuzë;
- Të dokumentojë hetimin dhe provat dhe të përgatit për të paraqitur prova në gjyq;
- Të parandalojë viktimizimin e mëtejshëm (përfshin si viktimën/të mbijetuarën ashtu edhe të tjerët që mund të preken, siç janë fëmijët).

### Hetimi efektiv, në përgjithësi, është ai ku hetuesi:

- Ka vepruar në mënyrë profesionale, të paanshme, gjithëpërfshirëse dhe objektive;
- Ishte i zellshëm në mbledhjen e dëshmive dhe deklaratave fizike ose jo-fizike;
- Në çdo kohë i trajtoi me respekt dhe dinjitet çdo/të gjithë viktimë(ët)/të mbijetuar(ët), dëshmitarë(ët) dhe autorët(ët) e supozuar;
- Ka siguruar që, nëse ka një veprë, e cila çoi në identifikimin e autorit (ave) të supozuar, të mblidhte prova të mjaftueshme cilësore, për të siguruar një perspektivë realiste të një dënimi në gjykatë;
- Ka konsideruar mbrojtjen dhe sigurinë e viktimës/të mbijetuarës, dëshmitarit(ëve) dhe autorit(ëve) të supozuar; Ka kryer vlerësimin e rrezikut, identifikimin e rrezikut dhe procesin e menaxhimit të rrezikut.

Ju gjithashtu duhet të jeni të sigurt se të gjitha raportet e DHGV-së regjistrohen me saktësi dhe në detaje të mjaftueshme për të mundësuar një hetim të plotë. Për shembull, a regjistrohen fjalët aktuale të viktimës/të mbijetuarës? Do të dobësojë komplet rastin nëse, në gjykatë, viktimat/e mbijetuara ose dëshmitari deklarojnë me fjalët e tyre atë që ka ndodhur, e cila nuk korrespondon me raportin fillestar të policisë ose deklaratën e tyre.

Mos regjistrimi në detaje të sakta i asaj që është bërë ose thënë mund të rezultojë gjithashtu që rasti të mos arrij në sistemin gjyqësor. Nëse keni përmbledhur ose përdorur terminologji më 'të sjellshme', kjo dobëson peshën e veprës së paraqitur prokurorit ose ofruesit të tjerë të drejtësisë. Regjistrimi i saktë i të gjitha incidenteve, të vërtetuara (validuara) si krim apo jo, është e rëndësishme për ju që të krijoni të dhëna mbi mbizotërimin dhe llojin e krimeve të DHGV-së, të cilat do t'ju mundësojnë të drejtoni burimet, aty ku është e përshtatshme, për të parandaluar incidente të ngjashme ose të përsëritura.

**Shih Kapitullin 3: 'Parandalimi', Kapitullin 6: 'Siguria dhe Mbrojtja', Kapitullin 7 'Mbështetja dhe Ndihma' dhe**

**Kapitullin 8: 'Kordinimi midis Agjencive të Drejtësisë' për më shumë detaje mbi kapjen dhe përdorimin e të dhënave.**

Nevojat e menjëhershme të viktimës/të mbijetuarës duhet të përcaktohen që në fillim për t'ju mundësuar të kuptoni se çfarë mbështetje dhe ndihme shtesë mund të kërkohet. Ju dhe stafi juaj do të keni nevojë për ndihmë nga ofruesit e tjerë të shërbimeve për të mbështetur hetimin tuaj, kështu që bashkëpunimi është tepër i rëndësishëm. Duke punuar me ofruesit e tjerë të shërbimeve për të mbështetur viktimën/mbijetuarën, stafi juaj mund të fokusohet në rolin e tyre kryesor të mbledhjes së provave për të identifikuar faktet e rastit për të paraqitur gjetjet të tyre tek prokurori ose gjykatat.

**Shih Kapitullin 7: 'Mbështetja dhe Ndihma' për informacione të mëtejshme dhe shembuj të praktikës së mirë siç janë qendrat e krizave të viktimave/të mbijetuarave dhe qendrat e referimit të sulmeve seksuale.**

Gjatë fazës së reagimit të menjëhershëm të hetimit, çdo autor i supozuar që është i pranishëm ose mund të identifikohet shpejt, duhet të trajtohet në mënyrë efektive.

### Kutia 3

#### Të gjitha raportet e incidenteve të DHGV-së duhet të kenë(përmbajnë) së paku këto të dhëna:

- Kush është i përfshirë në hetim dhe si mund të kontaktohen ata? - Numrin e dosjes/incidentit të policisë, Ankuesin/viktimën, Dëshmitarët, Autorin e pretenduar(supozuar), Reaguesit fillestarë të policisë, Oficerin (ët) hetues.
- Çfarë ndodhi? - Çdo/të gjitha veprë/at penale e(të) kryer/a; marrëdhëniet midis viktimës dhe autorit të supozuar; lëndime (të dukshme ose të tjera); çfarë dëshmish janë në dispozicion; gjendja dhe vendndodhja e tij; çdo veprim i ndërmarrë dhe veprimi i mëtejshëm i nevojshëm; cilat dëshmi të dëshmitarëve janë në dispozicion dhe çfarë hetimesh janë bërë për të gjetur dëshmitarët. Asistenca mjekësore e ofruar dhe nga kush/në cilin institucion mjekësor është dërguar viktimë - detajet e personelit mjekësor dhe detajet e kontaktit.
- Kur ka ndodhur secila ngjarje - Koha (fillimi/mbarimi), data, dita. Data/Koha e raportuar nëse është e ndryshme.
- Ku ka ndodhur secila ngjarje - Identifikimi i vendit/eve të krimit; vendndodhja e saktë; vendndodhjen e ankuesit/viktimës; vendndodhjen e autorit të supozuar; vendndodhjen e dëshmitarëve. Përshkruani skenën e krimit, apartamentin, shtëpinë (cila dhomë), kat, ndërtesën publike, parkun, rrugicën, udhën ose rrugën. Përshkruani se çfarë veprimi u ndërmor për të mbrojtur dhe ruajtur vendin/et e krimit nga ndotja ose ndotja e tërthortë, p.sh., si i parandaluat njerëzit që të kenë qasje në vendngjarje dhe të shkatërrojnë provat fizike dhe/ose mjekoligjore; qasja/kontrolli i dokumentuar p.sh., cili/cilët oficer(ë) specialist dhe staf hynë në vendngjarje - dhe pse - datën dhe orën e hyrjes së tyre dhe datën dhe orën e daljes së tyre.
- Detajet e secilës ngjarje - A janë përdorur armët, nëse po ku janë ato tani? Pse ndodhi ngjarja? Historinë e autorit të supozuar; historinë e gjykatës dhe/ose urdhrave kufizues; historinë e dhunës që përfshin autorin/viktimën e supozuar.
- Siguria e viktimës/të mbijetuarit - veprimet e ndërmarra për të ruajtur dhe mbrojtur ankuesin/viktimën, çdo anëtar tjetër të familjes, përfshirë fëmijët dhe individët e tjerë të cenusëshëm dhe dëshmitarin(ët).d on the UNO-DC- Handbook on Effective Police Responses to Violence Against Women (2010).

Eshtë e rëndësishme që stafi juaj të veprojë në mënyrë etike dhe profesionale ndaj çdo autori të supozuar (pretenduar), pavarësisht nga pikëpamjet e tyre personale.

Përveç marrjes parasysh se çfarë rreziqe autori i supozuar mund të paraqesë për viktimën/të mbijetuarën, ju gjithashtu keni “detyrën e kujdesit” ndaj autorit të pretenduar, i cili duhet të supozohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia nga gjykata.

Kjo do të thotë që ju gjithashtu duhet të merrni parasysh rreziqet ndaj çdo autori të pretenduar nëse natyra e asaj për të cilën akuzohen dhe identiteti i tyre bëhet i njohur. Ky është një aspekt tjetër i privatësisë dhe konfidencialitetit që duhet të respektohet, dhe çdo veprim i policisë në lidhje me dhënien e informacionit për publikun duhet të ndjekë procesin ligjor që ka të bëjë me ligjet kombëtare.

Në disa vende, për shembull, identiteti i autorit të pretenduar mbrohet derisa akuzë formale e krimit të jetë dorëzuar me një datë të mëvonshme të gjykatës të specifikuar. Edhe kur akuzohen zyrtarisht dhe brenda procesit të drejtësisë, autori i pretenduar dhe familja e tyre mund të jenë ende në rrezik nga raprezaljet, kërcënimet apo edhe dëmtimet fizike, të shkaktuara nga të tjerët ose nga vetëvetja. Kjo shpesh mund të ndodhë kur autori i pretenduar është dikush që zakonisht konsiderohet me respekt të lartë brenda shoqërisë, siç është një mësues, udhëheqës tradicional ose i bazuar në besim, ose mjek.

**Për informacion të mëtejshëm mbi konsideratat pas arrestimit, akuzës dhe dënimit, shih Kapitullin 6: ‘Siguria dhe Mbrojtja.’**

Ju duhet të siguroni pajtueshmërinë me çdo masë të aplikuar për të mbrojtur viktimën/të mbijetuarën, siç



janë urdhrat e mbrojtjes, dhe për çdo raport të shkeljeve të fillojë reagimi i menjëhershëm i policisë. Kjo vlen jo vetëm pasi autori i pretenduar është kapur, pasi urdhrat e mbrojtjes dhe masat e tjera mund të jenë lëshuar në një fazë të hershme.

### Shih Kapitullin 6: 'Siguria dhe Mbrojtja' për informacion më të detajuar.

Një aspekt kyç i hetimit është dëshmia e ofruar nga viktimat/e mbijetuara, kjo duhet të regjistrohet përmes një deklarate të detajuar të incidentit, duke përfshirë çdo informacion që mund të ndihmojë në sigurimin e një sfondi të dhunës. Jo vetëm që fjalët dhe veprimet aktuale të përdorura kundër viktimës/të mbijetuarës duhet të regjistrohen, por është gjithashtu e dobishme të përfshihen informacione periferike të tilla si përbërja e familjes dhe historia e mëparshme e dhunës. Arsyeja e mos raportimit më parë, siç është frika nga ana e viktimës/të mbijetuarës, gjithashtu duhet të regjistrohet.

Çdo intervistë e viktimës/të mbijetuarës, dëshmitarëve ose të dyshuarit duhet të kryhet nga një hetues i special-

izuar i trajnuar në aftësitë e intervistimit hetues, dhe në rastin e viktimave/të mbijetuarve dhe dëshmitarëve, ose fëmijëve të dyshuar për kryerjen e veprës, pasi kryerjes së trajnimit të specializuar për intervistimin e viktimave/të mbijetuarve të cënueshem dhe dëshmitarëve/fëmijëve (sipas rastit). Ndjekja e kësaj metode do t'i lejojë hetuesit të mbledhë provat dhe deklaratat më të dobishme dhe të shmangë përsëritjen e intervistës, duke parandaluar intervistimin me dhunë dhe viktimizimin dytësor.<sup>6</sup> Një intervistë e tillë duhet të planifikohet me kujdes dhe të zhvillohet në një mjedis të përshtatshëm.

Regjistrimi i një deklarate është veçanërisht i rëndësishëm në rastet e IPV-së, pasi viktimat/të mbijetuarat mund të kenë vuajtur në shumë raste para se të raportojnë një incident në polici. Në rastin e kontrollit detyrues, mund të ketë pasur një ngritje graduale të dominimit të viktimës/të mbijetuarës nga autori i pretenduar me kalimin e kohës.

<sup>6</sup> Shih "Protokollin mbi Intervistimin Efektiv të Mbledhjes së Informacionit me Ekspertizë Shkencore, Praktikë të Bazuar në Dëshmi, Standardet e të Drejtave të Njeriut dhe Etikën Profesionale" ('Protokolli Mendez').

#### Kutia 4

##### Viktimave/të mbijetuarve dhe autorëve(kryesve) të supozuar duhet patjetër t'u garantohen të drejta të caktuara

- Këto përfshijnë të drejtën për t'u trajtuar me respekt dhe dinjitet nga policia; t'ju tregohet menjëherë për arsyen e arrestimit/ndalimit; të supozohen të pafajshëm; të mbrohen nga dhuna e panevojshme e kryer nga Shteti (pra praktikat abuzive të policisë) për të mos inkriminuar veten; për privatësinë dhe konfidencialitetin; qasje në këshilltar juridik; për të apeluar çdo urdhër ndalimi dhe për një gjykim të drejtë.
- Është gjithashtu e rëndësishme që oficerët të jenë të vetëdijshëm për atë që NUK duhet të kenë parasysh kur përcaktojnë nëse arrestimi është i përshtatshëm:
  - Statusin martesor; pronësinë ose të drejtat e qiramarrjes; garancitë verbale se dhuna do të ndalet; statusin emocional i viktimës/të mbijetuarës; lëndimet e dukshme ose të padukshme; mohimin e dhunës në familje nga secila palë; besimin se arrestimi nuk mund të çojë në dënim; pasojat financiare të një arrestimi për secilën palë; statusin racor, kulturor, social, politik ose profesional ose orientimin seksual të viktimës/të mbijetuarës ose autorit të supozuar; përdorimin e alkoolit ose drogës ose të dyjat nga secila ose të dyja palët; ose perceptimin e gatishmërisë së çdo pale për të dëshmuar ose marrë pjesë në një proces gjyqësor.
  - Mënyrën se si ishte veshur viktimat/e mbijetuara; nëse ajo ishte e angazhuar në punë seksuale ose lloje të tjera të sjelljes që mund të gjykohen si 'të rrezikshme' nga të tjerët; duke qenë jashtë e vetme; vendndodhjen ku ajo ishte ose kohën e ditës apo natës kur ajo ishte jashtë, etj.

Based on: UNODC- Handbook on Effective Police Responses to Violence Against Women 2010

**Ndjeshmëria gjinore merr parasysh nevojat dhe perspektivat unike të viktimës/të mbijetuarës, respekton dinjitetin dhe integritetin e saj dhe minimizon ndërhyrjen (imponimin) duke respektuar standardet për mbledhjen e provave mjeko -ligjore.**

Programi i Përbashkët Global i OKB -së për Shërbimet Thelbësore për Gratë dhe Vajzat që i Nënshtrohen Dhunës (2015)

Deklarata e viktimës/të mbijetuarës duhet të kapë sesi ata ndihen si fizikisht ashtu edhe emocionalisht, ndikimin e dhunës dhe abuzimeve që ata i janë nënshtruar dhe anëtarët e tjerë të familjes, veçanërisht kur fëmijët, kanë qenë dëshmitarë. Mund të duhet pak kohë për të përfunduar një deklaratë të detajuar.

Mund të mos jetë e mundur, për shkak të ndonjë traume që vuan viktimat/e mbijetuara ose trajtimit mjekësor që u duhet, për të marrë deklaratën në një seancë. Durimi dhe ndjeshmëria janë aftësitë kryesore që duhet të ketë stafi juaj, dhe sa më shumë kohë të kalojnë me viktimën/të mbijetuarën duke ndërtuar besim dhe raport, aq më shumë informacion do të marrin prej tyre.

Është më mirë që stafi juaj të marrë kohën e tij për të marrë një deklaratë të saktë dhe të detajuar nga viktimat/e mbijetuara vetëm një herë, sesa të shpenzon kohë duke intervistuar përsëri viktimën/të mbijetuarën deri sa më shumë informacion del në dritë. Duke vepruar kështu, vetëm sa do të shtoni traumat e viktimave/të mbijetuarve pasi ata do ta përjetojnë incidentin çdo herë, pasi ata duhet ta kujtojnë atë. Ky është një shembull i 'viktimizimit dytësor' nga policia. Nëse kërkohet një intervistë tjetër, atëherë arsyet specifike për mbajtjen e saj duhet të shpjegohen me kujdes viktimës/të mbijetuarës, ose ata mund të mendojnë se ju nuk i besoni, duke shtuar traumat e tyre. Nëse viktimat/e mbijetuara ka barriera komunikimi, ndoshta për shkak të një aftësie të kufizuar siç është shurdhësia, mund të nevojitet më shumë kohë për të mbledhur deklaratën e tyre.

Nëse viktimat/i mbijetuarit është fëmijë, është edhe më e rëndësishme të regjistrohen fjalët aktuale që përdorin. Fëmijët kanë më pak gjasa të përdorin ose, në disa raste, të kuptojnë termat e të rriturve ose ligjorë dhe kështu

oficerët tuaj nuk duhet të tundohen të ndryshojnë atë që u thonë atyre në «gjuhën e të rriturve». Fëmijët viktimat/e mbijetuar gjithashtu duhet të intervistohen nga hetuesit specialistë.

Kur oficerët tuaj punojnë me vajza që mund të jenë viktimat/mbijetuese, është e rëndësishme që ata të njohin nevojat e tyre unike bazuar në moshën e tyre dhe të përshkruajnë reagimin e tyre në përputhje me rrethanat. Ata duhet të sigurojnë që mjedisi në të cilin flasin me vajzën të jetë miqësorë për fëmijët, dhe që prindi, kujdestari, përfaqësues ligjor etj. i cili nuk është i përfshirë në incidentin që po hetohet, të jetë i pranishëm dhe i përfshirë në mënyrë aktive në proces. Ata gjithashtu duhet të sigurojnë që fëmijëve t'u jepen të njëjtat konsiderata si të rriturve në lidhje me konfidencialitetin dhe privatësinë, dhe se shërbimet mjekësore, psiko-sociale dhe mbështetjen e viktimave/të mbijetuarve janë të përshtatshme për moshën.

Kur merrni një deklaratë nga një viktimë/e mbijetuar, veçanërisht nëse ata kanë pësuar trauma të rëndësishme, të tilla si gjatë një sulmi serioz seksual, është praktikë e mirë të dëgjoni rrëfimin e tyre të parë, ndoshta duke marrë shënime të shkurtra në mënyrë që një hetim të fillojë sa më shpejt sa të jetë e mundur. Mos harroni se trauma mund të ndikojë tek viktimat/të mbijetuarit në mënyra të ndryshme, dhe ata fillimisht mund të mos mbajnë mend gjithçka që u ndodhi atyre, ose në një mënyrë kronologjike. Ata mund të mos u duken stafiu tuaj se kanë vepruar në mënyrë racionale gjatë incidentit, por kjo nuk do të thotë se ata nuk po thonë të vërtetën.

Përfshirja e arsyeve për të vepruar ose mos vepruar ashtu siç vepruan kur iu nënshtruan dhunës është gjithashtu dëshmi e dobishme në deklaratë. Lejimi i kohës për viktimën/të mbijetuarën nuk do të thotë që marrja e deklaratës duhet të vonohet në mënyrë të padrejtësishtme; megjithatë, qasja me viktimën/të mbijetuarën në qendër kërkon që stafi juaj të marrë parasysh nevojat e saj në çdo kohë, duke ndihmuar në drejtimin e hetimit, veçanërisht gjatë fazave të hershme.

**Shih Kapitullin 4: 'Kontakti fillestar' për informacion më të detajuar mbi traumën dhe Kapitullin 9: 'Komunikimi' për udhëzime se si të ndërtohet besimi dhe raporti me viktimat/të mbijetuarat.**

## Kutia 5

### Udhëzimet e OBSH-së/UNODC-ut për Mbledhjen e Mostrave Mjeko-Ligjorë

#### Sfondi/ arsyeshmëria::

Pëlqimi për grumbullimin duhet të merret nga të gjithë individët. Mostrat mund të vërtetojnë kontaktin midis individëve ose midis një individi dhe vendndodhjes; dëshmia e kontaktit ndodh në kohën e veprës, por zhduket shpejt. Vetëm prova që është mbledhur, ruajtur dhe analizuar në mënyrë të duhur duhet të përdoret në hetimet/procedurat gjyqësore. Rezultatet e analizës duhet të interpretohen me kujdes, objektivisht dhe në kontekstin e hetimit; është jashtëzakonisht e rrallë që rasti të procedohet mbi një provë të vetme, p.sh. ADN, gjurmë gishtash.



#### Pikat kryesore:

- Pëlqimi për mbledhjen dhe lëshimin e mostrave (për hetuesit) duhet të merret nga viktimat/e mbijetuara. Ndikimi i grumbullimit të mostrave tek viktimat/e mbijetuara (si fizikisht ashtu edhe psikologjikisht) duhet të merret parasysh me kujdes;
- Rrëfimi i ofruar nga viktimat/e mbijetuara (ose dëshmitarët), dhe koha midis sulmit të pretenduar dhe ekzaminimit, do të diktojë nëse duhet të bëhet grumbullimi dhe çfarë lloj mostrash të mblidhen;
- Grumbulloni mostra nga vendet ku materiali biologjik mund të jetë depozituar: lëkura, flokët dhe hapjet orale, vaginale dhe anale;
- Kushtojini vëmendje të veçantë detajeve në etiketimin dhe regjistrimin e mostrave të mbledhura;
- Lejoni që çdo mostër e lagur të thahet. Mos përdorni media kulturash për mostra mjeko -ligjore;
- Mblidhni mostra të gjakut dhe urinës për analiza toksikologjike nëse ka pretendime për administrim të fshehtë ose jo të drogës;
- Transferimi i dokumenteve të mostrave (zinxhiri i kujdestarisë): çfarë, kujt dhe kur ka ndodhur transferimi. Përndryshe, sigurohuni që mostrat të ruhen në mënyrë të përshtatshme;
- Merrni masa paraprake kundër ndotjes: kufizoni qasjen në objektet e ekzaminimit, sigurohuni që objektet të pastrohen midis rasteve dhe ndëroni dorashka shpesh.

Burimi: ' Paketa e Veglave për Forcimin e Reagimit mjekësor-ligjor ndaj Dhunës Seksuale' (OBSH/UNODC, 2015).

Çdo ekzaminim mjeko/mjekësor-ligjor duhet të organizohet menjëherë, përsëri, për të siguruar që viktimat/e mbijetuara nuk i nënshtrohet viktimizimit dytësor, duke shtuar kështu traumat e tyre. **Ndjeshmëria gjinore**<sup>7</sup> është parësore, dhe gratë viktimat/të mbijetuarat duhet patjetër të shoqërohen (përcillen) vetëm gjatë ekzaminimit nga anëtare femër e stafit.

7 Ndjeshmëria gjinore synon të kuptojë dhe të marrë parasysh faktorët shoqërorë dhe kulturorë të përfshirë në përfshirjen dhe diskriminimin me bazë gjinore në sferat më të ndryshme të jetës publike dhe private (Instituti Evropian për Barazi Gjinore, 2019), shih: [https://eige.europa.eu/thesaurus/terms/1218?utm\\_source=newsletter&utm\\_medium=email&utm\\_campaign=how\\_gender\\_equal\\_is\\_your\\_parliament&utm\\_term=2019-11-27](https://eige.europa.eu/thesaurus/terms/1218?utm_source=newsletter&utm_medium=email&utm_campaign=how_gender_equal_is_your_parliament&utm_term=2019-11-27)

Imshhtë e domosdoshme që të siguroheni që oficeri është plotësisht i vetëdijshëm për të gjitha kërkesat provuese dhe se si të trajtojë, shënojë dhe ruajë çdo provë materiale që mund të dorëzohet atyre nga ekzaminuesi mjekësor.

*Paketa e veglave të OBSH-së/UNODC-ut për Forcimin e Reagimit Mjekësor-Ligjor ndaj Dhunës Seksuale (2015)* ofron udhëzime për mbledhjen e mostrave nga individët që pretendojnë dhunë seksuale dhe mund të ofrojë hetuesve (dhe gjykatës) informacion për të mbështetur ose mohuar pretendimet (shih Kutinë 7) Paketa e veglave të OBSH-së/UNODC-ut thekson nevojën që të gjithë individët të japin pëlqimin e tyre të informuar kur mblidhin mostra.

Një çështje e zakonshme në stacione, veçanërisht në zonat rurale, është mungesa e hetuesve femra ose stafit femra të cilët nuk janë të trajnuar për të marrë deklaratat ose për të trajtuar provat materiale në rastet e DHGV-së, por thjesht përdoruren si përcjellëse. Nëse kjo vlen për ju, atëherë duhet të merrni parasysh trajnimin e të gjitha oficerëve femra nën komandën tuaj për atë se si të merrni deklaratat nga të gjitha viktimat/të mbijetuarat e DHGV-së, përfshirë ato me aftësi të kufizuara.

Fokus i veçantë duhet t'i kushtohet marrjes së deklaratave nga viktimat/të mbijetuarat e dhunës seksuale, si dhe ndërgjegjësimin e provave mjeko-ligjore dhe trajtimin e provave materiale. Kjo më pas do t'ju sigurojë që ju të mund t'i siguronit viktimës/të mbijetuarës përgjigjen më të përshtatshme të ndjeshme, për të cilën ajo ka nevojë, duke e trajtuar atë me dinjitet dhe respekt, dhe në të njëjtën kohë duke marrë dëshmi kritike për t'iu mundësuar hetuesve tuaj meshkuj të përmbushin rolin e tyre.

*Reaguesit e parë* dhe kushdo tjetër që merr pjesë në vendngjarje duhet patjetër të shmangë tundimin për të lëvizur në një zonë ose për të prekur çdo gjë të pranishme që nuk është e nevojshme, pasi të jetë trajtuar çdo rrezik për jetën, siç është kujdesi për një viktimë/të mbijetuar të plagosur rëndë.

Ju duhet të siguroheni që oficerët tuaj të kuptojnë se askujt nuk duhet t'ju lejohet qasja në vendin e ngjarjes, përveç nëse ata kanë rol kritik brenda hetimit ose ofronjë trajtim mjekësor për këdo që përndryshe nuk mund të largohet në mënyrë të sigurt.

A janë në dijeni *Reaguesit* tuaj të *Parë* se në rastin e krimeve të rënda si vrasja dhe përdhunimi, vendi i ngjarjes duhet të sigurohet dhe të fillohet me marrjen e shënimeve të kujtdo që përipiqet të ketë qasje, madje edhe të oficerëve me gradë më të lartë?

Gjatë reagimit fillestar, dhe gjatë gjithë hetimit, stafi juaj duhet të qëndrojë me mendje të hapur dhe të lejojë që provat të udhëheqin vendimmarrjen e tyre në vend se të paragjykojnë çdo situatë.

Mbrojtja e vendit të krimit është kritike në ruajtjen e çdo dëshmie të mundshme nga dëmtimi, shkatërrimi, humbja e ndryshuar në çfarëdo mënyre nga gjendja e tij

origjinale. Kjo lejon që hetuesit e vendit të krimit të regjistrojnë gjithçka në detaje dhe të marrin sa më shumë prova të mundshme.

Mbledhja e provave është çelësi në çdo hetim. Në rastet e DHGV-së, prova e krimit mund të mos jetë gjithmonë e dukshme. Prandaj është e rëndësishme që oficerët të marrin parasysh të gjitha mundësitë kur marrin pjesë në incidente. Kjo gjithashtu duhet të shtrihet në situatat ku flisni me viktimat/të mbijetuarat, dëshmitarët dhe gjithashtu gjatë intervistimit të autorit të pretenduar. Udhëheqësit tradicionalë, të bazuar në besim dhe të komunitetit mund të jenë në gjendje po ashtu të japin dëshmi përkatëse, veçanërisht nëse janë femra.

### Parimi i Rëndësishëm i Hetimit

Transferimi i materialit ndërmjet personit dhe sendeve me të cilët ata vijnë në kontakt do të ndodhë gjithmonë, kjo bazohet në Parimin e Shkëmbimit të Locard-iy - *"Çdo veprim i individit, dhe padyshim veprimi i dhunshëm që përbën një krim, nuk mund të ndodhë pa lënë gjurmë."*

Çdo "ndotje e tillë e kryqëzuar" mund të ketë një ndikim katastrofik në hetimin e mëvonshëm dhe besueshmërinë e çdo dëshmie, veçanërisht provave kriminalistike të paraqitura në gjykatë.

Jane Townsley, Ish Kryeinspektore, Policia Britanike e Transportit, MB dhe Drejtoreshë Ekzekutive aktuale e Shoqatës Ndërkombëtare të Policisë së Grave (ShNPG).

Gjate identifikimit të provave të mundshme, është e rëndësishme të kërkonit atë që nuk shihet, jo vetëm atë që është e qartë. Kjo mund të jetë veçanërisht e dobishme në rastet e IPV ku kontrolli shtrëngues (detyruet) është një tipar, shpesh i manifestuar si incidente të vogla individuale të kryera nga autori i pretenduar për një periudhë të gjatë kohore. Të marra në mënyrë të izoluar, ato mund të shihen si të parëndësishme, por së tërësi, mund të japin dëshmi vendimtare në lidhje me kontrollimin e viktimës/të mbijetuarës. Shih Kutinë 9 për 'Shembuj të Dëshmive në Dhunën në familje/partnerë intimë.'

Ndërsa oficerët nuk do të vërejnë gjithmonë shenja të abuzimit, vlen të dihen këto faza dhe çfarë mund të

## Kutia 6

### Shembuj të Dëshmime në Dhunën në Familje/në Partnerë Intimë

- Viktimat/të mbijetuarat rrefenë se çfarë ka ndodhur dhe si është jeta për ta
- Regjistrimet telefonike, në veçanti dëshmitë e «linjave të hapura telefonike» të kërkuara nga autori i pretenduar
- Mesazhe me tekst, kopje të postave elektronike, shënime që përmbajnë rregulla ose kërkesa
- Dëshmi të abuzimit përmes internetit, teknologjisë dixhitale dhe platformave të mediave sociale
- Dëshmi për sulm
- Historia e mëparshme e policisë për thirrjet për adresim
- Historia e policisë në lidhje me autorin e pretenduar
- Deklaratat e oficerëve, të përfshihen vëzhgimet pas mbërritjes
- Kirurg rasti për qëllime ekzaminimi nëse nuk ka kujdes mjekësor të menjëhershëm
- Dëshmitë kriminalistike brenda pronës: shenja gjaku, armë të përdorura.
- Dëshmitë kriminalistike nga viktimat/e mbijetuara dhe/ose autori i pretenduar: gërvishtjet/shtupat e thonjve
- Fotografitë e lëndimeve të tilla si: dëmtimet mbrojtëse në parakrah, kapje latente të krahut të sipërm, mavijosje të kokës, grumbuj flokësh të munguar, shenja të shtrëngimit
- Veshje
- Shiritat ose transkriptet e numrit të thirrjeve të urgjencës
- Televizion me qark të mbyllur ose CCTV në shtëpi/hapësirë publike/vende të tjera, d.th vende pune/restorante
- Mënyra e jetesës dhe familja, përfshirë dëshmitë fotografike në vendngjarje
- Regjistrimet e ndërveprimit me shërbime të tilla si shërbimet mbështetëse, (edhe nëse pjesë të atyre të dhënave lidhen me ngjarjet që kanë ndodhur para se vepra e re të hyjë në fuqi, përmbajtja e tyre ende, në rrethana të caktuara, mund të mbështetet në prova)
- Të dhënat mjekësore
- Dëshmia e dëshmitarit, për shembull, familja dhe miqtë e viktimës/të mbijetuarës mund të jenë në gjendje të japin dëshmi në lidhje me efektin dhe ndikimin e izolimit të viktimës/të mbijetuarës nga familja dhe/ose miqtë
- Dëshmi nga kolegët e punës
- Marrja e informatave lokale nga: fqinjët, dërgesat e rregullta, posta, shpërndarja e qumështit, pastruesi i dritareve etj.
- Të dhënat bankare për të treguar kontrollin financiar
- Kërcënimet e mëparshme të bëra ndaj fëmijëve ose anëtarëve të tjerë të familjes
- Ditari i mbajtur nga viktimat/e mbijetuara
- Dëshmia e izolimit siç është mungesa e kontaktit midis familjes dhe miqve, tërheqja e viktimës/mbijetuarës nga aktivitetet dhe gjithashtu nëse shtëpia e viktimës/të mbijetuarës është në një vend të izoluar
- Kontaktoni me agjenci të tjera; Agjencitë e specializuara të DA, si brenda me Policinë ashtu edhe jashtë
- Shiritat/transkriptet e intervistës
- Marrja në konsideratë e intervistës(ave) të fëmijëve
- ADN nga autori i pretenduar
- Ruajtja/rikuperimi i dëshmimeve të mediave dixhitale
- Të dhënat e strehimit për të konfirmuar zënien

paraqitet nga viktimat/e mbijetuara kur i përgjigjet një thirrjeje. Më poshtë është një listë e fazave të njohura të sjelljes shtrënguese (detyruese) dhe kontrolluese brenda një marrëdhënieje të zhvilluar nga Graham Goulden, në *'Cultivating Minds'* MB<sup>8</sup>:

- Pastrimi (Zbukurimi)
- Menaxhimi i situatës
- Shtrembërimi i perspektivës
- Përkufizimi i abuzimit
- Rivlerësimi i marrëdhënies
- Përfundimi i marrëdhënies
- Përfundimi i abuzimit

### **Ju lutemi referojuni Shtojcës 1 për më shumë detaje mbi "Fazat e Njohura të Sjelljes Shtrënguese dhe Kontrolluese brenda një Marrëdhënie" të Goulden-it.'**

Ju duhet të përforconi mesazhin për stafin tuaj se roli i policisë është të mbledhë dhe analizojë provat për të vërtetuar faktet dhe nëse pretendimi është i besueshëm; ai NUK duhet të përqëndrohet në 'besueshmërinë' e viktimës/të mbijetuarës. Policia është atje për të ndihmuar dhe hetuar, jo për të gjykuar.

Disa krime kanë tregues specifikë që oficerët duhet të kërkojnë, kështu që ata mund të identifikojnë atë që përbën 'provën më të mirë' në raste specifike dhe më komplekse. Disa praktika kulturore dhe tradicionale mund të përbëjnë një krim, jo vetëm në vende të caktuara, por edhe brenda bashkësive me origjinë të ndryshme nga vendi pritës. Disa shembuj të krimeve të tilla përfshijnë dhunën/abuzimin me bazë nderi dhe praktikatat e dëmshme p.sh., Gjymtimi Gjenital i Femrave (GGF) dhe Martesa e Hershme dhe e Detyruar e Fëmijëve (MHDF). Informacion shtesë mbi këto, së bashku me treguesit e tyre, përmbahen në **Shtojcën 2 mbi 'Dhunën/Abuzimin e bazuar në nder dhe Praktikatat e Dëmshme.'**

Dëshmitarët mund të japin dëshmi të vlefshme dhe, si me të gjitha dëshmitë, ata mund të konfirmojnë apo

edhe të hedhin poshtë një pretendim. Roli i stafit tuaj është të paraqesë të gjitha provat, dhe i takon gjykatave të vendosin fajësinë ose pafajësinë. Prandaj është e domosdoshme të identifikohen dëshmitarët e mundshëm sa më shpejt të jetë e mundur, dhe Reaguesit e Parë në çdo incident ose vendnin e krimit duhet të bëjnë çdo përpjekje për të marrë të dhënat e çdo personi të pranishëm ose në afërsi, edhe nëse ata thonë se nuk kanë parë asgjë.

Sapo informacioni i ri të del në dritë gjatë hetimit, njerëz të tillë mund të ri-vizitohen nëse besohet se ata mund të jenë në gjendje të japin prova për diçka që nuk ishte e qartë në atë kohë. Marrja e detajeve nga ta duhet të kryhet me dinjitet dhe respekt dhe brenda parametrave ligjorë, duke siguruar që të drejtat e tyre mbrohen. Disa dëshmitarë gjithashtu mund të kenë nevojë për mbështetje dhe/ose strehim specifik për t'u siguruar që ata mund të japin dëshmi të vlefshme. Kjo mund të jetë rasti për dëshmitarët me lloje të ndryshme të aftësisë së kufizuar ose dëshmitarët të cilët janë të moshuar ose shumë të rinj. Vajzat kanë nevojë unike bazuar në moshën e tyre, qofshin ato viktimat/të mbijetuara apo dëshmitare.

### **Shih Kapitullin 4 mbi 'Kontaktin Fillestar' dhe Kapitullin 9 mbi 'Komunikimet' për këshilla për të folur me fëmijët, të moshuarit, gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara dhe individët e tjerë me nevojë të veçanta. Shih gjithashtu Kapitullin 2 për përkufizimin e 'Ndërthurshmërisë.'**

Kujdes i veçantë nevojitet kur ose viktimat/e mbijetuara ose dëshmitari është i moshuar, shumë i ri ose person me aftësi të kufizuara, pasi ata mund të kenë nevojë të veçanta. Për shembull, nëse viktimat/e mbijetuara ose dëshmitari është i moshuar, ata mund të kenë vështirësi në dëgjim. Në këtë rast sigurohuni që stafi juaj të flasë me ta diku në heshtje me zhurmë të kufizuar në sfond. Nëse janë me shiqim të shkurtër, me ata duhet të flitet në një dhomë të ndriçuar mirë, ndoshta diku me ndriçim shtesë.

Ata gjithashtu mund të kenë probleme me kujtesën për shkak të moshës së tyre dhe kjo mund të përkeqësohet nga ndikimi i traumës, kështu që stafi juaj duhet të jetë i durueshëm dhe të kuptojë nevojat e tyre shtesë. Stafi juaj duhet të sigurojë që të marrin parasysh çdo paaftësi që viktimat/mbijetuesit mund të ketë për të siguruar që

8 Graham Goulden, Kryeinspektor (në pension), Njësia për Reduktimin e Dhunës, Policia e Skocisë; tani Drejtor i **'Cultivating Minds'** në MB <https://grahamgoulden.com/cultivating-minds-uk/about/>

## Kutia 7

### Lista Kontrolluese e Standardeve minimale për reagimin fillestar

- Të ndahet menjëherë viktimat/e mbijetuarat nga autori i pretenduar dhe të ofrohet siguria e viktimës/mbijetuarës. Meqenëse shpesh është një situatë fuqie dhe kontrolli, është detyrë e oficerëve të sigurojnë që palët të jenë jashtë shikimit dhe dëgjimit të njëri-tjetrit, duke mbajtur oficeri gjithmonë sigurinë si prioritet;
- Të identifikohen dhe sigurohen çdo armë që mund të jetë në dorë, në mënyrë që të mbrohen të gjithë personat e pranishëm;
- Nëse është i pranishëm, të izolohet, kontrollohet dhe sigurohet autori i pretenduar - të largohet ai nga vendi i ngjarjes;
- Të aranzhohet trajtimi mjekësor për çdo person të dëmtuar;
- Të konstatohen faktet fillestare të asaj që ka ndodhur dhe të identifikohet vepra;
- Të fillohet identifikimi dhe grumbullimi i të gjitha provave të mundshme të veprës;
- Të kryhet intervista fillestare e viktimës/mbijetuarës (një intervistë e thelluar mund të bëhet më vonë, përfshirë deklaratën zyrtare me shkrim);
- Të intervistohen të gjithë dëshmitarët dhe të mirren deklaratat me shkrim sipas nevojës;
- Të aranzhohet çdo përcjellje e kërkuar/hetim dytësor (p.sh., kriminalistika, ekzaminimi mjekësor);
- Të kontaktohen shërbimet e viktimës/mbijetuarës (nëse ka) për të ndihmuar me kujdesin dhe mbështetjen e viktimës/mbijetuarës;
- Të fillohet dokumentimi i hetimit, provave dhe deklaratave.

Burimi: Doracak mbi Reagimet Efektive të Policisë ndaj Dhunës Kunder Grave (UNODC, 2010).

nevojat specifike të secilës viktimë/të mbijetuar të merren parasysh dhe që të bëhen rregullimet (përshtatjet) përkatëse.

Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara që përballen me dhunën dhe diskriminimin gjithashtu hasin në pengesa për qasjen në drejtësi, për shkak të stereotipeve të dëmshme, qëndrimeve diskriminuese dhe mungesës së lehtësirave procedurale dhe të arsyeshme, të cilat mund të çojnë në dyshimin e besueshmërisë së tyre dhe hedhjen poshtë të akuzave të tyre.<sup>9</sup>

Udhëzime të mëtejshme të dobishme për intervistimin e viktimave/të mbijetuarve të pretenduar me aftësi të kufizuara mund të jenë *'Masat e Hetimit, Mbrojtjes dhe Mbështetjes për Viktimat e DhBGJ-së - Libri i Burimeve: Përvoja dhe Udhëzimet e Policisë Koreane'* (2019) e UNDP-

së.<sup>10</sup> Në lidhje me intervistimin e personave (përfshirë fëmijët) me aftësi të kufizuara, libri i burimeve jep udhëzime të përgjithshme mbi: 1) caktimin e intervistës; 2) komu-

nikim verbal dhe jo verbal; dhe 3) atributet e aftësisë së kufizuar për të ndihmuar oficerët e policisë të kuptojnë konsideratat e kërkuara në procesin e intervistimit.

Libri i Burimeve të UNDP-ë thotë në mënyrë specifike se fëmijët duhet të trajtohen sipas moshës së tyre, pasi ata zhvillohen në faza të ndryshme, fëmijët nën 10 vjeç janë veçanërisht të prekshëm.



<sup>9</sup> Lisa Adams dhe Yumi Sera, 'Udhëzimet Gjineses'. *Fondi për të Drejtat e Aftësisë së Kufizuar & Fondi i Mbrojtjes së të Drejtave të Aftësisë së Kufizuar* (2018)

<sup>10</sup> Masat e Hetimit, Mbrojtjes dhe Mbështetjes për Viktimat e DhBGJ-së Libri i Burimeve: Përvoja dhe Udhëzimet e Policisë Koreane (Qendra e Politikave të UNDP Seoul, 2019).

Akomodimi i arsyeshëm dhe aranzhimet e tjera të veçanta kërkohen kur menaxhohen rastet kur viktimat/e mbijetuara ose dëshmitari është një person me aftësi të kufizuara, duke adresuar barrierat me të cilat përballen viktimat/të mbijetuara me aftësi të kufizuara gjatë gjithë procesit të drejtësisë.<sup>11</sup>

Si shembull, programi SAVE i kryer nga Cape Mental Health në Afrikën e Jugut synon të mbështesë viktimat/të mbijetuara me aftësi të kufizuara intelektuale.<sup>12</sup> Udhëzime të mëtejshme mund të gjenden në Udhëzimet e UNFPA-se dhe 'Women Enabled International' mbi ofrimin e te drejtave dhe shëndetit seksual

## Kutia 8

### Demonstrimi i Dinjitetit dhe Dhembshurisë ndaj Fëmijëve Viktima/të Mbijetuar dhe Dëshmitarëve të Krimit

Siguria	Zgjidhni një mjedis të sigurt dhe të rehatshëm për të takuar dhe/ose intervistuar fëmijën. Nëse një mjedis i tillë nuk është në dispozicion, zgjidhni një vend sa më të rehatshëm dhe sa më të ndjeshëm ndaj fëmijëve.
Jo në telashe	Sigurojeni fëmijën, veçanërisht nëse ai ose ajo është shumë i/e ri/e, se ai ose ajo nuk ka bërë asgjë të keqe dhe nuk është "në telashe". Fëmijët e vegjël viktimat/të mbijetuar dhe dëshmitarë shpesh mendojnë se mund të fajësohen për problemet dhe/ose të ndjehen llogaridhënës për atë që kanë pësuar. Shpjegojini qartë fëmijës se personi që i ka shkaktuar dëm atij ose asaj ka shkelur ligjin. Fëmija nuk është dhe nuk duhet të ndihet përgjegjës për sjelljet dhe keqbërjet e të tjerëve.
Besimi dhe raporti	Merrni kohë për të krijuar besim dhe raport para se të diskutohen specifikat e rastit ose incidentit. Kjo bëhet më së miri duke dëgjuar fëmijën dhe duke i dhënë atij/asaj mundësinë për të bërë pyetje dhe të ndajë gjithçka që ai/ajo dëshiron. Fëmijët viktimat/të mbijetuarit dhe dëshmitarët zakonisht kanë shumë pyetje, shqetësime dhe frikë. Ata kanë më shumë gjasa të jenë bashkëpunues dhe të rehatshëm nëse mendojnë se profesionistët i dëgjojnë shqetësimet dhe idetë e tyre.
Ndjeshmëria	Mbani qëndrim jo-gjykses dhe bashkendjeni me fëmijën.
Respect	Si rezultat i viktimizimit të tyre, fëmijët viktimat/të mbijetuar dhe dëshmitarë mund të jenë shumë të ndjeshëm ndaj çdo aluzioni të mosrespektimit. Fjalët duhet të zgjidhen me shumë kujdes.
Veçantia	Trajtojeni fëmijën si një individ me nevojat, dëshirat, ndjenjat dhe shqetësimet e tij/saj. Asnjëherë mos e krahasoni fëmijën me fëmijët e tjerë - edhe për të dhënë një shembull.
Ndjeshmëria ndaj moshës	Kuptoni që fëmijët viktimat/të mbijetuar dhe dëshmitarë piren të përkeqësohen emocionalisht gjatë stresit. Ata mund të sillen si më të rinj se moshja e tyre aktuale. Për shembull, një viktimë/e mbijetuar 8-vjeçare mund të thithë përsëri gishtin e tij/saj të madh.
Gjuhë e përshtatshme	Përdorni gjuhë të ndjeshme ndaj fëmijës të përshtatshme për moshën e fëmijës. Shmangni bisedit "fëminore".
Luaj	Lejoni viktimat/të mbijetuarit dhe dëshmitarët e vegjël, dhe aty ku është e përshtatshme, edhe fëmijët më të mëdhenj, të luajnë. Inkurajoni ata të shpjegojnë atë që ndodhi në mënyrë lozonjare, për shembull, me ndihmën e një kukulle ose kafshë të mbushur ose përmes vizatimit ose pikturës.
Marrja e kohës për të dëgjuar	Merrni kohë të mjaftueshme për të Përfshijeni fëmijën, kurdo që të jetë e mundur, në diskutimet për vendimmarrje dhe zgjidhjen e problemeve. Identifikoni dhe përgjigjuni me durim të gjitha pyetjeve të tij/saj, në mënyrë që ai/ajo të mund t'i shpreh pikëpamjet dhe shqetësimet e informuara. Dëgjuar fëmijën dhe për të kuptuar se çfarë i ka ndodhur atij/asaj. Nëse fëmija mund të thotë gjithçka që dëshiron, situata mund të trajtohet në mënyrë adekuate.
Marrja e pikëpamjes	Përfshijeni fëmijën, kurdo që të jetë e mundur, në diskutimet për vendimmarrje dhe zgjidhjen e problemeve. Identifikoni dhe përgjigjuni me durim të gjitha pyetjeve të tij/saj, në mënyrë që ai/ajo të mund t'i shpreh pikëpamjet dhe shqetësimet e informuara.

<sup>11</sup> Parashtrimi tek Raportuesi Special për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara: Praktika të Mira për Rritjen e Qasjes Efektive në Drejtësi për Gratë dhe Vajzat me Aftësi të Kufizuara, 9 Gusht 2019, *Women Enabled International*.

<sup>12</sup> Shih <https://www.westerncape.gov.za/facility/cape-mental-health>



riprodhues dhe dhunës së bazuar në të drejta dhe me përgjegjesi gjinore.<sup>13</sup>

### **Më shumë informacion se si të komunikoni me fëmijët viktimat/të mbijetuar dhe dëshmitarë mund të gjenden në Kapitullin 9: 'Komunikimet'.**

Më poshtë në Kutinë 8, janë disa sugjerime<sup>14</sup> sesi stafi juaj mund të demonstrojë dinjitet dhe dhembshuri ndaj fëmijëve viktimat/të mbijetuar dhe dëshmitarëve të krimit:

Roli juaj edhe si menaxher dhe udhëheqës është të siguroni që hetimet e incidenteve të DHGV-së të fillojnë dhe të mbeten në qendër të viktimave/të mbijetuarve, dhe kjo do të kërkojë mbikëqyrje të procesit të hetimit dhe menaxhimit të rastit duke siguruar se bëhet mbikëqyrje efektive dhe të përshtatshme. Mbikëqyrje kërkohet për të siguruar që hetimi po kryhet sipas standardeve etike dhe të integritetit. Si udhëheqës, ju duhet të inkurajoni, të jeni mbështetës dhe të afrueshëm, por prapëseprapë të jeni në gjendje t'i mbani individët përgjegjës kur është e nevojshme.

- How do you ensure your staff are working according to your expectations and those of your organization?
- How do you ensure privacy and confidentiality is being maintained?

### **For more information on what constitutes a 'victim/survivor-centred' approach, see Chapter 2: 'Making a Difference as a Manager and Team Leader'.**

Merrni parasysh keto:

- Si e siguroni mbikëqyrjen e dosjeve të rasteve para se të parashtroni në fazën tjetër të procesit të drejtësisë?

13 'Gratë dhe të Rinjtë me Aftësi të Kufizuara: Udhëzime për Ofrimin e Shërbimeve të Bazuara në të Drejta dhe me Përgjegjësi Gjinore për të Adresuar Dhunën me Bazë Gjinore dhe Shëndetin dhe të Drejtat Seksuale dhe Riprodhuese', (UNFPA-WEI, 2018), shih: <https://www.womenenabled.org/wei-unfpa-guidelines.html>

14 'Programi i Trajnimit mbi Trajtimin e Fëmijëve Viktimat/të Mbijetuar dhe Dëshmitarëve Fëmijë të Krimit' (UNODC, 2015), shih: [https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/Training\\_Programme\\_on\\_the\\_Treatment\\_of\\_Child\\_Victims\\_and\\_Child\\_Witnesses\\_of\\_Crime\\_-\\_Law\\_Enforcement.pdf](https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/Training_Programme_on_the_Treatment_of_Child_Victims_and_Child_Witnesses_of_Crime_-_Law_Enforcement.pdf) f. 44.

- A jeni në dijeni se çfarë, nëse ka ndonjë mangësi që mund të ketë brenda një hetimi që mund të rezultojë në ndërprerjen e ndjekjes penale ose lirim nga akuzat në gjykatë?

- Sa mirë punon stacioni ose departamenti juaj policor në krahasim me kolegët tuaj?

- A takoheni ju ose dikush nga stafi juaj rregullisht me prokurorët ose zyrtarët e gjykatës për të diskutuar nevojat dhe pritjet tuaja përkatëse? Është praktikë e mirë të përfshini agjencitë tjera të drejtësisë në rastin më të parë (hershëm) në përgatitjen e dosjeve të rasteve. Në disa vende, policia dhe prokurorët që punojnë në rastet e DHGV-së janë me një vend bashkë, duke siguruar kështu një mundësi për dialog të vazhdueshëm mes tyre dhe duke forcuar aftësitë specialiste që çojnë në më pak lirime në gjykatë. Ndihmon gjithashtu në zvogëlimin e numrit të intervistave të cilave iu nënshtrohen viktimat/të mbijetuarët, duke zvogëluar kështu mundësinë e viktimizimit dytësor dhe duke nxitur një ndjenjë besimi dhe sigurie tek viktimat/të mbijetuarët në sistemin e drejtësisë;

- Si siguroheni që ka 'mësime të nxjerra' nga te gjitha rastet që nuk plotësojnë kriteret e ndjekjes penale?

- Cila është shkalla e konsumimit (shterjes) të rasteve të DHGV-së që shkojnë në gjykatë?

- Cilat janë arsytet e konsumimit (shterjes)?

- Për t'ju mundësuar t'i përgjigjeni këtyre pyetjeve, do t'ju duhet të analizoni të dhënat, të cilat mund t'i kërkonin nga prokurorët ose zyrtarët e gjykatave përmes koordinimit dhe bashkëpunimit. **(Shih Kapitullin 8: 'Koordinimi mes Agjencive të Drejtësisë').**

Derisa të analizohen të dhënat e skedarit, sa të sigurt mund të jeni që hetimi i policisë ishte i fuqishëm pa boshllëqe në prova? Mund të ketë disa ndryshime të thjeshta që mund të bëhen nga ju, siç është dhënia e udhëzimeve të reja stafit tuaj; megjithatë, nëse nuk i keni ekzaminuar të dhënat, mund të mos jeni të vetëdijshëm për ndonjë çështje.

Për të siguruar zhvillimin e vazhdueshëm profesional, duhet të jeni të vetëdijshëm se cilat dobësi ka brenda fushës suaj të përgjegjësisë dhe marrja dhe trajtimi i ankesave publike është një mekanizëm për marrjen e atij informacioni. Përsëri, duke kuptuar çështjet, ju jeni në pozitë më të mirë për të dhënë udhëzime të qarta për stafin tuaj, për të bërë ndryshime pozitive aty ku është e rëndësishme, me qëllimin përfundimtar të ndërtimit të besimit dhe sigurisë brenda komunitetit tuaj lokal.

- What procedures do you have in place to enable victims/survivors to make a formal complaint about any police action or inaction in relation to their report?
- How accessible is the process, and has it been communicated to communities within your locality?

Menaxhimi dhe mbikëqyrja e hetimeve nuk ka të bëjë me mikro-menaxhimin e stafit tuaj, por ju i jepni llogari menaxherëve tuaj të lartë, si dhe komunitetit lokal për rezultate. Ju duhet të demonstroi udhëheqje të dukshme, duke fuqizuar dhe mundësuar stafin tuaj duke u stërvitur, mentoruar dhe, kur është e nevojshme, duke i mbajtur ata përgjegjës për veprimet e tyre, ose mungesë veprimi. Duke e bërë këtë, ju do të dërgoni një mesazh të qartë të fortë në lidhje me pritjet tuaja dhe ata do të kuptojnë se çfarë kërkohet prej tyre.

## **BALLAFAQIMI ME SFIDAT NË REAGIMIN NDAJ DHGV-SE FILLON ME IDENTIFIKIMIN E BOSHLLËQEVE NË PERFORMANCËN E EKIPIT TUAJ**

Më poshtë është një listë e frymëzuar nga një hartëzim i gjerë global i praktikave të mira dhe boshllëqeve të kapaciteteve të organizatave policore gjatë reagimit ndaj rasteve të DHGV-së. Ky hartëzim përfshinte shtrirjen, ndër të tjera, në disa oficerë policie në shërbim dhe në pension, dhe stafin e OKB-së me përvojë në punën me policinë dhe organizatat joqeveritare të specializuara në adresimin e DHGV-së. Titujt e kategorive kanë për qëllim të ndihmojnë lexuesin të lidhet me çështjen kryesore që ka të bëjë me hendekun e kapacitetit të identifikuar;

megjithatë, ato janë të gjitha të zbatueshme dhe/ose plotësuese për secilën pikë:

### **Qëndrimi**

- Një perceptim i përgjithshëm se është shumë e vështirë të hetosh përdhunimin ose se është një detyrë e specializuar;<sup>15</sup>
- Njerëzit me aftësi të kufizuara shpesh portretizohen si fëminor, të varur dhe të paaftë për të marrë vendimet e tyre, duke shtuar stigmën dhe frikën.

### **Anshmëria Gjinore**

- Besimi në mitet që rrethojnë DHGV-në, p.sh., se oficerët komandues janë në dijeni për pretendimet e dhunës seksuale të kryer nga policia, por kjo nuk adresohet (shih më poshtë mbi rezultatet e zakonshme të anshmërisë gjinore nga forcat e policisë, të identifikuar nga Departamenti i Drejtësisë i Shteteve të Bashkuara);
- Mitet që lidhen me ‘sjelljen ideale të viktimës/të mbijetuarës, veçanërisht në krimet e dhunës seksuale ndaj grave dhe vajzave, që prekin oficerët e policisë’ dhe kështu edhe cilësinë e hetimit;
- Oficerët e policisë mund të fajësojnë viktimat/të mbijetuarat, duke besuar se ata provokuan një sulm nga mënyra se si u veshën ose si u sollën.

### **Viktimizimi Dytësor**

- Viktimat/të mbijetuarat merren në pyetje në mënyrë të përsëritur shumë herë nga policët meshkuj dhe trajtohen pa respekt kur japin deklaratat.

### **Keqpërdorimi**

- Hetuesit e policisë shpesh vendosin barrën e provës mbi viktimën/të mbijetuarën për të provuar nëse ajo ishte kërcënuar ose nënshtruar dhunës (dmth. nuk

<sup>15</sup> Erin Gallagher, ‘Planifikimi i Hetimeve të SDhBGJ-së’, *Instituti për Hetimet Penale Ndërkombëtare (IHPN) dhe Reagimin e Shpejtë të Drejtësisë* (2015).

## Kutia 9

### Rezultatet e Përbashkëta të Anshmërive Gjimore nga Forcat Policore \*

- Ofron më pak mbrojtje për disa viktime /të mbijetuara në bazë të gjinisë;
- Dështon t'u përgjigjet krimeve që dëmtojnë në mënyrë disproporcionale njerëzit e një gjinie të caktuar;
- Ofron shërbime të reduktuara ose më pak të fuqishme në dispozicion për shkak të mbështetjes në stereotipet gjimore;
- Keq klasifikon ose raporton mangët rastet e sulmeve seksuale ose të dhunës në familje;
- Përfundon në mënyrë të papërshtatshme se rastet e sulmeve seksuale janë të pabazuara;
- Dështon në testimin e kompleteve(pajisjeve) të sulmit seksual;
- Merr në pyetje në vend që të intervistojë viktimat/të mbijetuarat dhe dëshmitarët;
- Trajton dhunën në familje si çështje familjare dhe jo si krim;
- Dështon në zbatimin e urdhrave të mbrojtjes;
- Dështon ta trajtojë dhunën në familje të të njëjtit seks si krim;
- Pengon aftësinë për të konstatuar faktet, për të përcaktuar nëse incidenti është krim dhe për të zhvilluar një rast që mbështet ndjekjen penale efektive dhe të mbaj përgjegjës kryesin.

\* Burimi: Departamenti i Drejtësisë së SHBA- së, 2015

dha pëlqimin) në një rast sulmi seksual në vend që të përqëndrohen në veprimet e autorit të pretenduar për të provuar se ai kishte marrë pëlqimin prej saj

- Keq klasifikimi ose raportimi i mangët i rasteve të sulmeve seksuale ose dhunës në familje, ose duke konkluduar në mënyrë të papërshtatshme se rastet e sulmeve seksuale janë të pabazuara. Për shembull, në rastet e raportuara të grave të humbura dhe vajzave adoleshente, policia shpesh pret konfirmimin se një krim është kryer në të vërtetë para se të reagojnë;
- Burime të joadekuate, të tilla si transporti për të çuar viktimat/të mbijetuarat në destinacionet e duhura, duke rezultuar në atë që policia kërkon para nga viktimat/të mbijetuarat për të kryer në thelb rolet e tyre në parandalimin dhe hetimin e DHGV-së;
- Sistemet e menaxhimit të rasteve nuk janë të integruara në mënyrë adekuate, të azhuruara vazhdimisht dhe lehtësisht të qasshme për agjencitë e drejtësisë penale përgjegjëse për përcjelljen e viktimeve/të mbijetuara;
- Oficerët mund t'i japin përparësi hetimit mbi mirëqenien e viktimës/të mbijetuarës duke përdorur krye-

sisht viktimën/të mbijetuarën si burim informacioni ose dëshmie;<sup>16</sup>

- Protokollet për ndarjen e informacionit me agjencitë e tjera të drejtësisë penale për të siguruar ndarjen në kohë të informacionit përkatës, në përgjithësi nuk monitorohen për pajtueshmëri dhe mësim.

## Diskriminimi

- Viktimat/të mbijetuarat me aftësi të kufizuara ose që janë analfabetë shpesh nuk mbështeten në mënyrë adekuate kur raportojnë DHGV-në, veçanërisht kur nënshkruajnë deklarata që kanë implikime serioze ligjore.<sup>17</sup>

## Boshllëqet në trajnim dhe arsim

- Policia ka njohuri të kufizuara sesi të mbështeten të mbijetuarit e përdhunimit në kohën e zakonshme të reagimit prej 72 orësh (parandalimi i HIV -it,

<sup>16</sup> Nathan Birdsall, Stuart Kirby & Michelle McManus (2017), 'Angazhimi polici -viktimitë në ndërtimin e qasjes së fuqizimit të viktimeve në rastet e dhunës së partnerëve intim', *Praktika dhe Kërkime Policore*, 18:1, 75-86, DOI: 10.1080/15614263.2016.1230061.

<sup>17</sup> Pajoja e Mjeteve të Praktikuesit për Programimin e Qasjes së Grave në Drejtësi' (UN Women et al., 2018).

## Kutia 10

### Shembuj e të Mos Bërit Dëm \*

Policia duhet të marrë parasysh nëse veprimet dhe komunikimet e tyre padashur përforcojnë stereotipet tradicionale të padobishme për burrat dhe gratë që kontribuojnë në dhunën kundër grave dhe vajzave.

Policia gjithashtu duhet të jetë e ndërgjegjshme për të gjeneruar pa qëllim qëndrime të tjera diskriminuese gjinore (të tilla si burrat që mendojnë se kanë nevojë t'i 'mbrojnë' gratë duke kufizuar lëvizshmërinë e tyre, lirinë ose privatësinë e tyre) ose perspektivat kundër barazisë (të tilla si homofobia) që lindin ndonjëherë.

Si të shmangët mosberja e dëmit:

- Sigurohuni që ndërhyrjet të përqëndrohen në ruajtjen e sigurisë dhe mirëqenies së viktimës/të mbijetuarës, të informuar nga përvojat e ndryshme të grave dhe vajzave në komunitet dhe ekspertë në fushën e DHGV-se;
- Siguroni përshtatshmërinë kulturore të qasjeve dhe veprimeve duke përfshirë organizatat dhe individët lokalë - burra dhe gra - të cilët kanë njohuri si për kontekstin ashtu edhe për rezultatet e ndërhyrjeve të kaluara;
- Përfshini djem dhe burra në zhvillimin e mesazheve të fushatës, materialeve të komunikimit dhe produkteve ose ndërhyrjeve të tjera të rëndësishme;
- Testoni të gjitha materialet për shtrirje në terren me audiencën specifike të synuar (për shembull, sipas nën-grupit të moshës, grupit gjuhësor, grupit etnik ose karakteristikave të tjera të rëndësishme të grupit);
- Monitoroni dhe vlerësoni vazhdimisht ndërhyrjet;
- Përfshini informata kthyes nga gratë në vlerësimet (për shembull, në konfirmimin e ndryshimeve të qëndrimit ose të sjelljes të vetë-raportuara të burrave).

\*Adapted from 'Do No Harm' UN Women (2010)



shtatzënësisë etj.), të cilat tashmë janë në dispozicion në një spital;

- Trajnimi mbi ndërhyrjet e informuara nga traumat shpesh nuk përfshihet në trajnimin dhe edukimin e të gjithë oficerëve që potencialisht do të angazhohen me viktimat/të mbijetuarat e DHGV-së;
- Mungesa e përgjithshme e të kuptuarit të ligjeve kombëtare për mbrojtjen e të dhënave personale nga oficerët.

## PËRKUFIZIMI DHE KORNIZAT

ESP e përshkruan procesin e hetimit policor të incidentit të DHGV-së, i cili përfshin aktivitetet e mëposhtme:

- Vlerësimin e rastit dhe hetimit, të kryer përgjithësisht në sistemin e drejtësisë penale;

- Menaxhimin e skenës;
- Planifikimin e hetimit;
- Intervistimin e viktimës/të mbijetuarës dhe dëshmitarit;
- Identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut;
- Mbledhjen, përpunimin dhe analizën e dëshmive;
- Ekzaminimet mjeko-ligjore;
- Inteligjencën në lidhje me autorët e pretenduar dhe vendet e përsëritura;
- Identifikimin e autorit të pretenduar, intervistimin, arrestimin dhe përpunimin; dhe
- Dokumentimin e gjetjeve dhe veprimeve të ndërmarra.

Tepër e rëndësishme për këtë proces është të bëhet dallimi në mes të asaj se kush është autori i pretenduar dhe kush është viktimat/e mbijetuara, pastaj për ta trajtuar atë

marrëdhënie në përputhje me rrethanat.<sup>18</sup> Kjo praktikë do t'i vendosë zyrtarët hetues në rrugën drejt identifikimit të dimensioneve të ndryshme të vuajtjeve të përjetuara nga viktimat/e mbijetuara dhe nevojat e mbrojtjes që dalin nga kjo; një hap i rëndësishëm kur fillohet me qasjen që ka në qendër viktimën/të mbijetuarën.<sup>19</sup> Ajo gjithashtu duhet t'i drejtojë hetuesit drejt identifikimit të modeleve të sjelljes abuzive të përdorura kundër viktimës/të mbijetuarës dhe variablave mjedisore që ndikojnë në natyrën e dhunës.

Të armatosur (pajisur) me këtë informacion, policia mund të përcaktojë proporcionalitetin e reagimit së saj për të siguruar balancën e duhur midis ofrimit të sigurisë dhe dinjitetit të viktimës/të mbijetuarës gjatë gjithë procesit dhe përmbushjes së kërkesave dëshmuese dhe hetimore për të provuar veprën kriminale dhe/ose të dhunshme. Çelësi për këtë do të jetë zbatimi i parimit “mos bëni dëm”. Shihni më poshtë për shembuj se si policia mund të ‘mos bëjë dëm’, kur i përgjigjet DHGV-së:

Reagimi i ndjeshëm dhe vëzhgues i policisë që punon me shpejtësi mbi parimet e ‘mos bëni dëm’, objektivitetit dhe pa diskriminim do të jetë çelësi për të aplikuar qasjen e përqendruar te viktimat/e mbijetuara në **hetim të fokusuar tek autori (kryesi)**.

Hetimi i përqendruar tek viktimat/e mbijetuara dhe i fokusuar tek autori ka tre veprime kryesore:

1. Fillon duke besuar viktimën/të mbijetuarën (hetoni sipas detyrës zyrtare);
2. Siguron që nuk ka dëm tjetër për viktimën/të mbijetuarën dhe anëtarët e tjerë të familjes, si dhe mundësinë e dëmit (ose vetë-dëmtimit) për autorin e pretenduar;

18 Doracaku pranon se shumë autorë të dhunës janë ose kanë qenë vetë viktimat të dhunës.

19 Sipas kornizës së ESP-së, një qasje e përqendruar mbi viktimat/e mbijetuarat vendos të drejtat, nevojat dhe dëshirat e grave dhe vajzave si qendrën e fokusit të ofrimit (kryerjes) të shërbimeve. Kjo kërkon marrjen parasysh të nevojave të shumta të viktimave dhe të mbijetuarve, rreziqet dhe cenueshmëritë e ndryshme, ndikimin e vendimeve dhe veprimeve të ndërmarra dhe siguron që shërbimet të jenë të përshtatura për kërkesat unike individualisht secilës grua dhe vajze. Shërbimet duhet t'i plotësojnë nevojat e saj.

**“Llogaridhënia e kryerësit kërkon shërbime thelbësore, aty ku është e përshtatshme, për të mbajtur përgjegjës në mënyrë efektive kryerësit, duke siguruar drejtësi në përgjigjet e drejtësisë. Shërbimet thelbësore duhet të mbështesin dhe lehtësojnë pjesëmarrjen e viktimës/të mbijetuarës në procesin e drejtësisë, të promovojnë aftësinë e saj për të vepruar ose ushtruar perfaqësimin e saj, duke siguruar që barra ose përgjegjësia e kërkimit të drejtësisë nuk është mbi të, por mbi shtetin.”**

Programi i Përbashkët Global i OKB -së për Shërbimet Thelbësore për Gratë dhe Vajzat që i Nënshtrohen Dhunës (2015)

3. Mbështetet në mbledhjen e provave materiale<sup>20</sup> dhe biologjike/mjeko-ligjore për të vërtetuar elementet ose faktet e rastit, duke përdorur të gjitha mjetet në dispozicion dhe në kohën e duhur;<sup>21</sup>
4. Kërkon të krijojë (ndërtojë) një rast të fortë që nuk e ngarkon ekskluzivisht viktimën/të mbijetuarën si burimin e vetëm të provës, as nuk i mbështet provat në dëshmitë e bëra nën detyrim, përfshirë edhe nga autorët e pretenduar ose dëshmitarët.

Për shembull, në rastet e dhunës seksuale kundër grave dhe vajzave, hetimi i fokusuar tek kryesi kërkon të përqëndrojë vëmendjen tek kryesi (autori) i dyshuar, në mënyrë që të përcaktojë objektivisht nëse pëlqimi është marrë në të vërtetë nga viktimat/e mbijetuara, për dallim nga vendosja e barrës së provës mbi të për të provuar se ajo ishte e kërcënuar ose nënshtruar dhunës (dmth. nuk dha pëlqimin).

Në një rast të tillë, përcaktimi se si modeli i sjelljes abuzive të autorit të pretenduar përshtatet brenda një modeli

20 Provat materiale nuk duhet të kufizohen në provat fizike, por gjithashtu të përfshijnë efektin e dhunës dhe traumës mbi viktimën/të mbijetuarën dhe sjelljen e saj, siç është qëndrimi në një marrëdhënie me autorin e dhunës nga partneri intim.

21 Shih: Nathan Birdsall, Stuart Kirby & Michelle McManus (2017), ‘Angazhimi i policisë-viktimës në ndërtimin e një qasjeje të fuqizimit të viktimave ndaj rasteve të dhunës së partnerëve intimë’, *Praktika dhe Kërkime Policore*, 18:1, 75-86, DOI: 10.1080/15614263.2016.1230061 dhe Ellison, L. (2002), ‘Ndjekja penale e dhunës në familje pa pjesëmarrjen e viktimës’, *Rishikimi i së Drejtës Moderne*, 65, 834-858.

të ciklit të dhunës të sanksionuar nga ekspertët, do të jetë në përputhje me një qasje hetimore të paanshme dhe objektive, siç promovohet nga praktika më e mirë ndërkombëtare.

**Pëlqimi** përkufizohet si kur një individ bën një zgjedhje të informuar për të bërë lirisht dhe vullnetarisht diçka. Nuk ka pëlqim nëse merret me përdorimin e, ose kërcënimeve, forcës, shtrengimit, mashtrimit, dinakërisë ose shtrembërimit.<sup>22</sup>

Me këtë përkufizim në mendje, policia duhet të jetë veçanërisht e kujdesshme kur vërteton faktet rreth pëlqimit në një rast të dhunës seksuale - nëse viktimë/e mbijetuara e pretenduar ka pësuar, në kohën e aktit, ndonjë defekt mendor ose fizik që do të ndikonte në aftësinë(mundësinë) për të dhënë pëlqimin.

Për më tepër, pëlqimi nuk duhet të konsiderohet kurrë si një faktor kur moshë e viktimës/të mbijetuarës është nën moshën minimale ligjore kombëtare, në të cilën një individ konsiderohet ligjërisht aq i vjetër sa të japë pëlqimin për pjesëmarrjen në aktivitetin seksual.

Sipas UNICEF-it, standardet ndërkombëtare nuk tregojnë një moshë minimale për pëlqimin seksual.<sup>23</sup> Sidoqoftë, Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve ('KDF') ka konsideruar moshën 13 vjeqare si "shumë të ulët."

Për më tepër, KDF u kërkon Shteteve Anëtare të respektojnë kapacitetet në zhvillim të fëmijës dhe për këtë moshë minimale të mos vendoset shumë lartë. Shtetet duhet të marrin parasysh, si kriter, diferencën e moshës midis partnerëve të përfshirë si një tregues të ekuilibrit të fuqisë mes tyre dhe gjithashtu të adresojnë rastet në të cilat përfshihen dy adoleshentë të mitur.<sup>24</sup>

22 'Paketa e Burimeve të Dhunës me bazë Gjinore: Një Mjet i Trajnimit të Standardizuar për Bartësit e Detyrës, Palët e Interesuara dhe Mbajtësit e të Drejtave (UN Women, 2019).

23 'Moshat minimale ligjore dhe realizimi i të drejtave të adoleshentëve' (UNICEF), shih: <https://www.unicef.org/lac/media/2806/file>

24 Shih komentin e Përgjithshëm nr. 4 të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve (CRC/GC/2003/4 të 2003) dhe Komentin e Përgjithshëm Nr. 21 të Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW/C/GC/21, të 1994).

**"Objektivi i moshës minimale të pëlqimit seksual është të mbrojë adoleshentët nga abuzimi seksual dhe nga pasojat e aktivitetit të hershëm seksual në të drejtat dhe zhvillimin e tyre."**

Moshë minimale e pëlqimit seksual (UNICEF)

### Referoju Kapitullit 9: 'Komunikimet' për shembuj të asaj se çfarë përbën dhe nuk përbën pëlqimin.

Mbledhja proaktive e dëshmimeve të tilla është jetike në sigurimin e bashkëpunimit të viktimës/të mbijetuarës me policinë, pasi ka efektin e shtuar të lehtësimit të barrës së provës mbi viktimën/të mbijetuarën nëpërmjet dëshmimeve mbështetëse, duke i dhënë besueshmëri dhunës së cilës ajo iu nënshtrua dhe të sigurohet që policia të hetojë rastet me një perspektivë reale të ndjekjes penale që nga fillimi.<sup>25</sup>

Grafiku i mëposhtëm ilustron sekuencën nga qasja e përqëndruar tek viktimë/e mbijetuara, deri tek hetimi i fokusuar tek autori në DHGV:

Për fat të keq, studimet tregojnë se anshmëritë eksplicite dhe të nënkuptuara nga zyrtarët e policisë të përfshirë në reagimet e DHGV-së kanë dhe vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në përcaktimin se si ata do t'i menaxhojnë rastet.<sup>26</sup> Jo vetëm që disa oficerë policie dhe akterë të tjerë të drejtësisë do të mbajnë pikëpamje diskriminuese, por ata mund të jenë vetë autorë të DHGV-së ose përndryshe ta lejojnë atë.


Në disa raste, anshmëritë gjinore, veçanërisht ato në lidhje me stereotipet rreth roleve gjinore, sulmit seksual dhe dhunës në familje kanë rezultuar në atë që policia ka turbulluar apo edhe ka ndryshuar klasifikimet ose statusin e autorit me viktimën.

25 Shih Nathan Birdsall, Stuart Kirby & Michelle McManus (2017), 'Angazhimi i policisë-viktimës në ndërtimin e një qasjeje të fuqizimit të viktimave në rastet e dhunës së partnerëve intim', Praktika dhe Kërkime Policore, 18:1, 75-86, DOI: 10.1080/15614263.2016.1230061

26 Huhtanen, H., Lonsway, K.A., Archambault, J. (2017), 'Njëanshmëria Gjinore në Reagimin dhe hetimin e Sulmeve Seksuale'; Seria e Buletinit të Trajnimit: Pjesa 1-4. *End Violence Against Women International* (EVAWI).

Figura 1:

Qasja e përqëndruar tek Viktimën/e Mbijetuara në Hetimin e fokusuar tek Kryerësi



Në raste të tilla, oficerët ragues mund të fillojnë të vënë në dyshim besueshmërinë e viktimës/të mbijetuarës, madje edhe ta fajësojnë atë për vetë dhunën, kur ndihen te pasakte ose iu është ofruar informacioni jokonsistent. Si rezultat, oficeri hetues i deleguar i policisë ka tendencë të humbasë fokusin nga hetimi i sjelljes dhe veprimtarive të autorit të pretenduar, duke zhvendosur në mënyrë kundërproduktive vëmendjen në sjelljen e viktimës/të mbijetuarës, duke minimizuar në të njëjtën kohë përgjegjësinë e autorit të pretenduar dhe kriminalitetin për dhunën e pretenduar.

Për të zbutur ndikimin destruktiv të anshmërive gjinore në punën e policisë, organizatat policore duhet të bëjnë një përkushtim institucional të mbështetur nga politika të informuara dhe mekanizma të llogaridhënies që nxisin një ndryshim në të menduarit dhe qëndrimet e DHGV-së. Ky ndryshim i të menduarit dhe qëndrimeve duhet të bazohet në njohjen se DHGV është: a) shkelje e të drejtave të njeriut dhe: b) sfidë sistemike që izolon dhe marginalizon grupe të caktuara të shoqërisë dhe pengon kohezionin social, integrimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.<sup>27</sup>

27 'Masat e Hetimit, Mbrojtjes dhe Mbështetjes për Viktimat e DhBGJ, Libri i Burimeve: Përvoja dhe Udhëzimet e Policisë Koreane (Qendra e Politikave të UNDP Seul, 2019).

Strategjitë e Modelit të Përditësuar të vitit 2010 rekomandojnë zhvillimin e standardeve të zbatueshme të praktikës dhe sjelljes dhe kodeve të sjelljes dhe të sigurohet që zyrtarët e policisë të mbahen përgjegjës për çdo shkelje të këtyre, përmes mekanizmave të duhur të mbikëqyrjes dhe llogaridhënies.<sup>28</sup>

**Shih Kapitullin 10: «Ndërtimi i institucioneve për Reagimin Efektiv dhe Llogaridhënës të Policisë ndaj DHGV-se» dhe Kapitullin 11: «Sfidat dhe Strategjitë për Zbatimin e Punës Policore të Përgjegjshme Gjinore», për udhëzime mbi zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe mekanizmave për të siguruar punën policore të përgjegjshme gjinore.**

Veçanërisht në rastet e DhPI-se, mund të ketë kundër-pretendime të bëra kundër personit që bën ankesën fillestare në polici. Situata të tilla duhet të trajtohen me kujdes, dhe pa rënë në kurthin e të besuarit të të dy individëve se janë «aq të këqij sa njëri -tjetri», dhe për këtë arsye të hedhin poshtë ankesat në tërësi.

28 'Strategjitë Model të Përditësuar dhe Masat Praktike mbi Eliminimin e Dhunës ndaj Grave në Fushën e Parandalimit të Krimit dhe Drejtësisë Penale '(2011, rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 65/228, shtojcë).

Në këtë situatë të «një fjale kundër tjetrës», oficerët mund të kërkojnë indikacione të tjera se kush mund të jetë viktimat/mbijetuesi dhe kush është autori i pretenduar, në mënyrë që të identifikohen dinamikat e fuqisë së abuzimit në familje. Më poshtë janë shembuj të indikacioneve të sjelljes së viktimës/të mbijetuarit:

- **Frika** - viktimat/i/e mbijetuarit/a ka më shumë të ngjarë të ketë frikë ose nga partneri i tyre ose nga pasojat e përfshirjes së policisë, duke e shprehur atë qoftë verbalisht ose përmes komunikimit jo-verbal, të cilin oficeri duhet ta kërkojë.
- **Përgjegjësia** - Viktimat/të mbijetuarat(it) shpesh justifikojnë partnerët e tyre me sjellje të dhunshme ose abuzive dhe ose marrin përgjegjësinë për të kundërshtuar situatën ose të mos e bëjnë atë që pritej prej tyre. Autorët e pretenduar mund të pranojnë sjellje të dhunshme ose abuzive dhe t'i justifikojnë ato.
- **Detajet e Incidentit** - Autorët e pretenduar ka më shumë të ngjarë të jenë të paqartë kur bëhet fjalë për detajet e asaj se çfarë ndodhi ndërsa viktimat/të mbijetuarit kanë më shumë gjasa, me kusht që të mos jenë shumë të traumatizuar, që të përshkruajnë në detaje atë që ndodhi.

Duke marrë parasysh këta tregues të thjeshtë, menaxherët operacionalë duhet të vlerësojnë në mënyrë kritike sfondin, deklaratat, skenën, dëmtimet dhe mekanizmin e mundshëm të atyre dëmtimeve për të identifikuar 'Agresorin Parësor.' Pyetja 'kush është Agresori Parësor' është e mirë për t'u përdorur në rastet e DhPI-së ku linjat mund të duken të paqarta me deklaratat 'tha ai/ajo' dhe dëmtimet për të dyja palët.

Menaxherët e policisë dhe ekipet e tyre duhet të ndërhyjnë menjëherë në rastet e DHGV-seë duke kuptuar se përgjegjësia kryesore për fillimin e hetimeve dhe ndjekjeve penale i takon autoriteteve të policisë dhe prokurorisë dhe jo viktimave/të mbijetuarve dhe se nuk ka hierarki dhune gjatë përcaktimit të cilësisë së reagimit.<sup>29</sup>

29 Në fakt, aktet e DHGV-së nuk mund të çojnë në dëmtim fizik, prandaj nuk lëjnë prova fizike, por janë ende një formë dhune dhe duhet të adresohen në mënyrë efektive.

Në vend të kësaj, policia duhet të shikojë DHGV-në si fenomene ciklike me sjellje të caktuara që nxisin çdo fazë. Duke ndërhyrë në mënyrë efektive më afër 'fillimit' të ciklit në një pikë që tregon formën më pak të rëndë të dhunës, policia mund të parandalojë dhunën e mëtejshme.

Kjo do të ishte një mënyrë më efektive për policinë që të hetojë DHGV-në, por kërkon të kuptuarit e ciklit të dhunës dhe sjelljeve të pretenduara të autorit të lidhura në çdo fazë të ciklit.

Zbatimi i cikleve të modeleve të dhunës në hetimet e DHGV-se është strategjia kryesore që mbështet hetimin e fokusuar tek autori. Figurat 2 ilustrojnë sesi këta elementë bashkohen për të përfituar reciprokisht nga hetimi efektiv dhe efikas të fokusuar kah autori në DHGV (Fernandez-Townsley 'Model me Katër Pika').

Fernandez-Townsley 'Modeli me Katër Pika' është i zbatueshëm për të gjitha format e hetimit të DHGV-se nga dhuna në familje deri tek ngacmimi kibernetik deri te trafikimi i qenieve njerëzore dhe është i rëndësishëm si për kontekstin e konfliktit ashtu edhe për atë pa konflikte. "Modeli me Katër Pika" i Fernandez-Townsley duhet të shihet si një ilustrim i elementeve kryesore të nevojshëm për qasjen e përqendruar të viktimat/mbijetuarit për të ndikuar në aplikimin e protokollit organizativ dhe praktikën e hetimeve të policisë në DHGV.


Strategjia ose qasja hetimore, qoftë reaktive ose proaktive<sup>30</sup>, do të varet nga vetë krimi dhe elementët e nevojshëm për ndjekjen penale. Në këtë drejtim, *Strategjia Model të Përditësuar* e vitit 2010 rekomandojnë zhvillimin e teknikave hetimore që nuk

30 Sipas Kolegjit i Punës Policore në MB, fillimi i hetimit policor mund të klasifikohet në dy qasjet e mëposhtme: 1) **qasje reaktive**, ku informacioni mblidhet kryesisht nga raportet nga publiku i gjerë, referimi nga agjencitë e tjera, lidhjet e inteligjencës me krimet e tjera (seri të lidhura), ri-hetim si rezultat i informacionit të ri ose si pasojë e veprimeve të tjera të policisë; ose 2) **qasje proaktive**, e cila në përgjithësi vjen nga burimet e inteligjencës, të tilla si analiza e modeleve të krimet, analiza e rrjetit, vlerësimi operacional i inteligjencës, profilet e problemeve ose vlerësimi taktik, ndër të tjera. Shih: 'Procesi i Hetimit', *Kolegji i Punës Policore* në MB.



Figura 2:

Fernandez-Townsley 'Model me Katër Pika'



degradojnë gratë që i'u janë nënshtruar dhunës dhe të minimizojnë ndërhyrjen, duke ruajtur standardet për mbledhjen e dëshmive më të mira.<sup>31</sup>

Është e rëndësishme të theksohet se të kuptuarit e sjelljes së kryesit dhe ciklit (ave) të dhunës, pavarësisht nëse rezultojnë në dhunë fizike apo jo, gjithashtu do të luajë një rol kyç në parandalimin e dëmit për viktimë/të mbijetuarin, të afërmit e saj të ngushtë ose miqtë, madje mund ndihmojë në parandalimin e autorit të pretenduar nga vetë-shkaktimi i dëmit. Ndërhyrjet e shpejta dhe të informuara për traumën nga policia ndihmojnë në parandalimin e DHGV-së dhe krimeve të lidhura me to.

**Shih Kapitullin 11: 'Sfidat dhe Strategjitë për Zbatimin e Punës Policore të Përgjegjshme Gjinore' për udhëzime mbi të kuptuarit e cikleve të fuqisë dhe kontrollit/dominimit.**

<sup>31</sup> 'Strategjitë Model të Përditësuar dhe Masat Praktike mbi Eliminimin e Dhunës ndaj Grave në Fushën e Parandalimit të Krimit dhe Drejtësisë Penale' (2011, rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 65/228, shtojcë).

## KOMPETENCAT KRYESORE MENAXHERIALE PËR HETIMIN E FOKUSUAR KAH KRYERËSI NË DHGV

Duke qenë se anshmëritë eksplicite dhe të nënkuptuara gjinore janë ngulitur në kulturën tonë, është shumë sfiduese për menaxherët e policisë të zbusin supozimet dhe stereotipet negative dhe kundër-produktive për viktimat/të mbijetuarit që kërkojnë qasje në drejtësi si rezultat i përjetimit të dhunës.

Do të kërkojë gatishmëri nga ana e oficerëve të policisë për t'u përballur me mundësinë e një prirjeje të pavetëdijshme për të pritur që viktimat/të mbijetuarit të veprojnë në një mënyrë të krahasueshme me atë që ata e perceptojnë me qenë "viktima e mirë", duke përfshirë edhe atë nëse ka karakterin "e nderuar" dhe në gjendje të ofrojë dëshmi të prekshme dhe logjike lehtësisht të paraqitshme për ndjekjen penale.

Adresimi i anshmërisë gjinore do të kërkojë gjithashtu një ndërgjegjësim të shtuar për studimet aktuale në shkencat e policisë, të cilat kanë treguar se në rastet e

## Kutia 11

### Parimet për punën policore të paanshme

Në British Columbia, Kanada, qeveria provinciale prezantoi parimet udhëzuese në lidhje me punën policore të paanshme. Kjo pasoi me një proces të angazhimi publik, ku zyrtarët qeveritarë u takuan me palët e interesuara dhe organizatat e komunitetit përballë akuzave për punën policore të njëanshme. Rekomandimet\* nga hetimi i policisë u përkthyen në parime dhe u përdorën për të promovuar standardet e paanshme të punës policore në provincë. Ato përfshijnë:

- Pranimi i njëanshmërisë është një hap i rëndësishëm në adresimin e efekteve negative të tij;
- Publiku duhet të ketë besim tek policia që puna policore të jetë efektive, e drejtë dhe e sigurt;
- Besimi i njerëzve në polici rritet kur njerëzit janë të sigurt se puna policore është e drejtë dhe e paanshme;
- Puna policore e bazuar në stereotipe ose praktika diskriminuese të punës policore është joefektive, e padrejtë dhe e pasigurt;
- Politikat dhe praktikat duhet të informohen duke kuptuar historinë dhe gjendjen aktuale të marrëdhënieve polici-komunitet, dhe shkaqet rrënjësore të marginalizimit;
- Disa grupe janë edhe në rrezik të shtuar për t'u prekur nga dhuna dhe kanë më pak gjasa ta raportojnë atë;
- Policia ka për detyrë të sigurojë barazi në ofrimin e shërbimeve dhe qasje në drejtësi;
- Sigurimi i barazisë përfshin marrjen e hapave për t'u mbrojtur nga njëanshmeria dhe përshtatjen e proceseve, sipas nevojës, për të kompensuar barrierat.

\*Burimi: Puna Policore e Paanshme. Qeveria Provinciale e Kolumbisë Britanike.

DHGV-së, metodat konvencionale të hetimit, veçanërisht praktikat e intervistimit në përgjithësi nuk janë ideale nga pikëpamja e provave, as ato nuk janë domosdoshmërisht të përqendruara në viktima/të mbijetuar (**referojuni Kapitullit 4: 'Kontakti Fillestar' për informacion mbi hetimet e informuara nga trauma**).

Në shumë raste, anshmëritë e nënkuptuara dhe eksplicite gjinore mund t'i pengojnë hetuesit të ndjekin praktikat e mira, apo edhe të fillojnë fare hetimin.

Për të kapërcyer anshmëritë gjinore, menaxherët e policisë mund të prezantojnë dhe promovojnë parimet hetimore, kundër të cilave anëtarët e ekipit mund të vlerësohen. Për shembull, në British Columbia, Kanada, qeveria provinciale lëshoi një sërë parimesh udhëzuese mbi punën policore të paanshme, bazuar në procesin e angazhimit me palët e interesuara dhe organizatat e komunitetit, pas një sërë akuzash për sjellje të njëanshme të policisë, veçanërisht kundër

komuniteteve autoktone ose anëtarët e komunitetit të Kombeve të Parë.

Këto akuza për njëanshmërinë nga ana e Forcave të Policisë Provinciale të Kolumbisë Britanike buruan gjithashtu nga dështimi i tyre për të hetuar në mënyrë adekuate raportet e grave të zhdukura në provincë, shumica e të cilave kishin një përvojë të Kombeve të Parë.<sup>32</sup> Kutia 16 përshkruan parimet që nënvizojnë

<sup>32</sup> Nga 1997 deri në 2002, 67 gra u zhdukën nga rajoni Metro Vancouver i British Columbia, Kanada. Shumë prej këtyre grave u gjetën të vrara, ndërsa të tjerat mbeten të zhdukur. Gratë që u zhdukën i përkisnin një grupi shumë të marginalizuar dhe të cënueshëm të grave në British Columbia. Komisioni i Hetimit të Grave të Zhdukura ('KHGZh') u krijua në vitin 2010 për të shqyrtuar reagimet e sistemit të drejtësisë ndaj grave të raportuara të zhdukura gjatë kësaj kohe. KHGZh zbuloi se aspektet e vendimeve dhe strategjive të punës policore reflektonin stereotipe të përhapura brenda komunitetit në lidhje me gratë e cënueshme dhe të marginalizuara. Raporti përfundimtar, i publikuar në vitin 2012, përfshiu disa rekomandime për të adresuar këto çështje. Shih: 'Puna Policore e paanshme nga Qeveria Provinciale e (British Columbia)Kolumbisë Britanike' për informacione të mëtejshme, në <https://engage.gov.bc.ca/unbiasedpolicing/missing-women-commission-of-inquiry/>

standardet nga Forcat Policore të Provincës British Columbia për punën policore të paanshme:<sup>33</sup>

Menaxherët e policisë duhet patjetër të jenë njësoj të vetëdijshëm se cilat kompetenca kryesore, (p.sh. aftësi të vëzhgueshme, shkathtësitë, njohuritë, motivimet ose tiparet), janë të nevojshme për t'u siguruar që parimet respektohen dhe se hetimet kryhen në mënyrë objektive dhe me kohë.

Për shembull, posedimi i vetëdijes teknike në rastet e dhunës seksuale për të kuptuar se, në këto raste, hapësira e caktuar për viktimën/të mbijetuarit për të marrë trajtim mjekësor, për të folur me policinë, për të ndrruar rrobat duke ruajtur provat dhe për të marrë mbështetje psikologjike mund të bëjë një dallim pozitiv për viktimën/të mbijetuarin dhe hetimin, është kritik (tepër e rëndësishme).

Ekspertët në kriminologji, shkencat e punës policore dhe shkencat e sjelljes kanë qenë vazhdimisht duke demonstruar se kur një filozofi e punës policore për të reaguar ndaj DHGV-së ancorohet në fuqizimin e viktimës/të mbijetuarës - nëpërmjet pjesëmarrjes së saj kuptimplote në qasjen e përqendruar tek viktimat - kjo rrit kënaqësinë dhe besimin e viktimës/të mbijetuarës.<sup>34</sup> Kjo, nga ana tjetër, inkurajon bashkëpunimin e viktimës/të mbijetuarës.<sup>35</sup> Për më tepër, fuqizimi i viktimës/të mbijetuarës rrit gjithashtu krijimin e rrjetit efektiv mbështetës,<sup>36</sup> pasi viktimat/e mbijetuarat do të ketë gjithnjë e më shumë gjasa të perceptojë policinë si më legjitime dhe të besueshme.<sup>37</sup>

Birdsall et al. (2017) shtuan se kjo përvojë bie në kontrast ndjeshëm me përvojat e viktimave/të mbijetuarve të

33 Shih mëtej në: <https://engage.gov.bc.ca/unbiasedpolicing/work-to-date/>

34 Wilson, S., & Jasinski, J. (2004), 'Kënaqësia e publikut me policinë në rastet e dhunës në familje: Rëndësia e arrestimit, pritjet dhe kontakti i pavullnetshëm, 28, 235-254

35 Nathan Birdsall, Stuart Kirby & Michelle McManus (2017), 'Angazhimi i policisë-viktimës në ndërtimin e qasjes për fuqizimin e viktimave ndaj rasteve të dhunës nga partneri intim', *Praktika dhe Kërkime Policore*, 18:1, 75-86, DOI: 10.1080/15614263.2016.123006

36 Hohl, K., Bradford, B., & Stanko, E. (2010), 'Ndikimi i besimit dhe sigurisë në policinë metropolitane të Londrës: Rezultatet nga një eksperiment që teston efektin e pikave të fletëpalosjeve në opinionin publik', *British Journal of Criminology*, 50, 491-513

37 Tyler, T. (2004), 'Rritja e legjitimitetit të policisë', *Analet e Akademisë Amerikane të Shkencave Politike dhe Sociale*, 59, 84-99.

tjerë, ku akuza penale rrëzohet për shkak të mungesës së provave, ose kur sistemi i drejtësisë penale po shtyn për ndjekjen penale të autorit të pretenduar dhe që punon në mënyrë aktive kundër shprehjes së dëshirave të viktimës/të mbijetuarës.<sup>38</sup>

Më poshtë është një listë jo shteruese e kompetencave kryesore të performancës, të cilave menaxherët e policisë mund t'i referohen dhe të promovojnë zbatimin e hetimit efektiv dhe të paanshëm ndaj DHGV-së. Menaxherët duhet të sigurojnë që zyrtarët reagues janë në gjendje të:

## Disponueshmëria dhe qasja

- Demonstronjë të menduarit strategjik afatgjatë mbi parandalimin e DhNGGV-se, duke shkuar përtej qëllimeve personale dhe duke marrë parasysh se si sukcesi i hetimit ndikon në mjedisin më të gjerë shoqëror dhe ekonomik;
- Kuptojnë se si angazhimi i oficerëve me viktimat/të mbijetuarat kontribuon në shërbimin më të gjerë policor;
- Vendosin masa që do t'i lejojnë oficerët e tjerë të marrin përgjegjësi efektive kur delegohet vendimarrja, dhe në të njëjtën kohë të ndihmojnë vartësit të përmirësojnë performancën e tyre;
- Inkurajojnë dhe mbështesin aktivisht mësimin nga hetimi brenda ekipeve dhe kolegëve.

## Komunikim efektiv dhe pjesëmarrje nga palët e interesuara në hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e shërbimeve:

- Kuptojnë dhe komunikojnë dallimin midis parandalimit të rasteve të DHGV-së dhe rasteve që zgjidhen;

38 Nathan Birdsall, Stuart Kirby & Michelle McManus (2017), 'Angazhimi polici-viktimë në ndërtimin e qasjes të fuqizimit të viktimave në rastet e dhunës së partnerëve intim', *Praktika dhe Kërkime Policore*, 18:1, 75-86, DOI: 10.1080/15614263.2016.1230061. Also, see Harris-Short, S., & Miles, J. (2011), *E DREJTA Familjare* (Bot. i dytë.), Oxford: Oxford University Press; and Payne, D., & Wermeling, L. (2009), 'Dhuna në familje dhe viktimat femër: Arsyeja e vërtetë pse gratë qëndrojnë!', *Gazeta e Studimeve Multikulturore, Cjinore dhe të Pakicave*, 3, 1-6.

- komunikojnë se si lidhet vizioni i përgjithshëm me planet dhe objektivat e hetimit, në mënyrë që oficerët reagues të jenë të motivuar dhe të kuptojnë qartë qëllimet e hetimit të fokusuar tek autori;
- Ofrojnë siguri në lidhje me procesin, përfshirë pritjet e qarta, se çfarë të presin në proces, me sa më shumë siguri të jetë e mundur dhe në një mënyrë të kuptueshme për viktimën/të mbijetuarën<sup>39</sup>;
- Njohin modelet, temat dhe lidhjet e DHGV-se midis shumë burimeve të ndryshme të informacionit dhe dëshmitave më të mira në dispozicion.

## Përshtatshmëria

- Njohin mënyrën se si njëanshmerite gjinore dhe të aftësisë së kufizuar, të tilla si supozimet dhe stereotipet për viktimat/të mbijetuarit dhe si ndikojnë këto në vendimmarrjen e përditshme.

## Përshtatje

- Largojnë mitet dhe keqkuptimet që rrjedhin nga njëanshmeria gjinore që rrethojnë viktimat/të mbijetuarit e DHGV-së, më së shumti në lidhje me pretendimet e rreme;
- Identifikojnë arsyet kryesore, motivet ose incidentet pas akteve të dhunshme, p.sh., njohja e punës me modelet e ciklit të dhunës, dinamikat e fuqisë dhe sjelljet e zakonshme të lidhura me akte të ndryshme të DHGV-së që përfshijnë si viktimën/mbijetuarin ashtu edhe autorin e pretenduar;
- Kuptojnë kuptimin e ‘ndjeshmërisë ndaj fëmijëve’ dhe “të drejtës për t’u trajtuar me dinjitet dhe dhembshuri’, veçanërisht që kanë të bëjnë me fëmijët viktimat/të mbijetuar dhe dëshmitarë.<sup>40</sup>

39 Training Programme on the Treatment of Child Victims and Child Witnesses of Crime for Law Enforcement Officials (UNODC, 2015).

40 Ibid.

## Kutia 12

### Hetimet e Policisë të Ndjeshme ndaj Fëmijëve \*

Më poshtë janë faktorët specifikë që zyrtarët e zbatimit të ligjit duhet të marrin parasysh kur kanë të bëjnë me një fëmijë viktimë/dëshmitar të veçantë, të cilët ata mund t’i justifikojnë si të ndjeshëm (të njohur edhe si “trajtim diferencial”) janë:

- Faktorët që lidhen me rrethanat personale të fëmijës: moshë, dëshirat, mirëkuptimi, gjinia, orientimi seksual;
- Faktorët që lidhen me nevojat e veçanta të fëmijës: shëndeti, aftësitë, kapacitetet, nevoja të tjera të veçanta;
- Faktorët që lidhen me mjedisin shoqëror të fëmijës: prejardhja etnike dhe kulturore, prejardhja fetare, prejardhja gjuhësore dhe sociale, kasta;
- Faktorët që lidhen me gjendjen socio -ekonomike të familjes së fëmijës: gjendja socio -ekonomike, statusin e imigrimit, statusi i refugjatit.

\* Burimi: Programi i Trajnimit për Trajtimin e Fëmijëve Viktima dhe Dëshmitarëve Fëmijë të Krimin për Zyrtarët e Zbatimit të Ligjit (UNODC, 2015)

## Jepini përparësi vlerësimit të rrezikut të sigurisë dhe planifikimit të sigurisë

- Kërkojnë dhe lidhin informacion në lidhje me karakteristikat e profilit të viktimave/të mbijetuarve, të tilla si gjinia, seksualiteti, aftësia e kufizuar, përkatësia etnike, feja dhe moshë, me ciklet e DHGV-së dhe modelet e sjelljes së kryesit;
- Me të marrë informacion nga viktimat/të mbijetuarit e DHGV-se, të zbatojnë parimet e paanësisë dhe proporcionalitetit për të siguruar reagimin e menjëhershëm dhe adekuat ndaj nevojave të mbrojtjes;<sup>41</sup>
- Sigurojnë përdorimin efikas të burimeve për të siguruar mbrojtje dhe bashkëpunim adekuat nga viktimat/e mbijetuarat.<sup>42</sup>

41 Në rastet e grave dhe vajzave të raportuara të zhdukura, policia nuk duhet të presë për konfirmimin se një krim ka ndodhur në të vërtetë para se të reagojë.

42 ‘Më shumë sesa thjesht një devijim: Udhëzuesi për refugjatët gra për të zhvilluar plane veprimi për aktin e diskriminimit të aftësisë së kufizuar’, Gratë me Aftësi të Kufizuara Australi (GMA) (2007).

## Kutia 13

### Roli i Mbikëqyrësit në Rastet e dhunës Seksuale \*

- Nëse kërkohet nga oficeri, ose kur shihet e nevojshme, reagimi për të ndihmuar oficerët që hetojnë incidentet e sulmeve seksuale;
- Oficerët duhet patjetër të përgjigjen në mënyrë objektive, profesionale, jo gjykuese; mbikëqyrësit duhet patjetër të sigurojnë që zyrtarët e linjës të jenë të vetëdijshëm për këto pritshmëri.
- Ndihmon si në gjetjen e burimeve të agjencisë ashtu edhe të komunitetit për të hetuar në mënyrë efektive sulmin e ndodhur;
- Inkurajon partneritetet për zgjidhjen e problemeve midis departamentit dhe organizatave të komunitetit, të tilla si qendrat e krizës së përdhunimit dhe programet e ekzaminimit mjeko-ligjor, për të nxitur bashkëpunimin dhe mbështetur më mirë viktimat;
- Shqyrton të gjitha raportet e sulmeve seksuale të policisë për saktësinë, qëndrueshmërinë dhe reagimin e përqëndruar tek viktimat/e mbijetuara;
- Inkurajon oficerët që të kërkojnë krime të bashkë-ndodhura dhe të ndërlidhura kur reagojnë ndaj sulmeve seksuale;
- Siguron që oficerët dhe hetuesit të kuptojnë kodimin e rasteve dhe të kodojnë në mënyrë të përshtatshme rastet e sulmeve seksuale;
- Kryen rishikimet e pas veprimit dhe auditimet e rasteve të sulmeve seksuale për të siguruar që oficerët dhe hetuesit po kryejnë hetime gjithëpërfshirëse, të përqendruara te viktimat/e mbijetuara, të fokusuar tek autori;
- Krijon mundësi trajnimi të vazhdueshme për anëtarët e departamentit për të përmirësuar aftësitë e nevojshme për të hetuar siç duhet sulmet seksuale. Punon për të rritur komunikimin midis zbatimit të ligjit dhe prokurorëve për të lehtësuar tranzicionin për viktimat/të mbijetuara, ndërsa ata kalojnë nga faza e hetimit në ndjekje penale;
- Përfshin çështje të shërbimit të viktimave dhe përgjigjet ndaj viktimave të sulmit seksual në vlerësimet e performancës, dhe rekomandimeve për shpërblime dhe promovimin e pjesëtarëve të departamentit;
- Mban përgjegjësi pjesëtarët kur sillen në mënyrë që nuk është në përputhje me vlerat dhe misionin e departamentit në lidhje me hetimet e sulmeve seksuale;
- Ndan rregullisht informacionin e shërbimeve të viktimave/të mbijetuara në thirrjet e zakonshme dhe njoftimet e stafit. Ky edukim dhe trajnim duhet të jetë i vazhdueshëm dhe gjithashtu mund të bëhet në terren me oficerët kur nuk u përgjigjen thirrjeve për shërbim;
- Njeh dhe shpërblen oficerët për ofrimin e shërbimeve efektive të viktimave/të mbijetuara.

\* Burimi: Shoqata Ndërkombëtare e Drejtuesve të Politikave të Reagimit ndaj Sulmeve Seksuale të Policisë dhe Udhëzime për Përmbytjen e Trajnimit (2015).

## Lidhja me sektorët dhe agjencitë e tjera përmes referimit dhe koordinimit

- Rregullojnë metodologjitë e hetimit të DHGV-së, të tilla si intervistimi i viktimës/të mbijetuarës dhe mbështetja e rekomanduar e viktimës/të mbijetuarës, për të akomoduar përvojën traumatike të pësuar dhe për të siguruar pjesëmarrjen kuptimplote të viktimës/të mbijetuarës gjatë hetimit.

## Mbledhja e të dhënave dhe menaxhimi i informacionit

- sillen në mënyrë objektive, të paanshme dhe të plotë, sipas protokollit kur plotësojnë dokumentacionet e kërkuara të raportit të rastit, përfshirë klasifikimin e duhur të aktit të dhunës;
- Sigurojnë transparencën e procedurave të raportimit, përfshirë në lidhje me marrjen e raporteve, marrjen fillestare dhe përgjigjen ndaj raporteve.<sup>43</sup>

<sup>43</sup> Këto procedura duhet të publikohen dhe të jenë lehtësisht në dispozicion për publikun, të gjithë sektorët në qeveri dhe agjenci të tjera të drejtësisë penale. Për rekomandime të mëtejshme mbi menaxhimin e rasteve, ju lutemi referojuni “Forcimi i Parandalimit të Krimit dhe Reagimi i Drejtësisë Penale ndaj Dhunës kundër Grave” (UNODC, 2014).

- Të marrin përgjegjësinë personale për ta parë hetimin përmes një përfundim të kënaqshëm dhe për të korrigjuar çdo problem, si menjëherë ashtu edhe hapur.

## Pëlqimi i informuar dhe konfidencialiteti

- Identifikojnë pikat e zakonshme të hyrjes për format dytësore të viktimizimit të viktimës/të mbijetuarit gjatë hetimit;
- Të përfaqësojnë mendimet e viktimave/të mbijetuarve në mënyrë të saktë dhe të qëndrueshme, që do të thotë se janë vendosur (krijuar) procese adekuate për të mbledhur mendimin e viktimës/të mbijetuarit, madje edhe kur viktimat/i mbijetuarit përballet me barrierat komunikimi ose i mungon aftësia ligjore.

Në vitin 2015, Shoqata Ndërkombëtare e Shefave të Policisë ('ShNSHP') krijoi *Politikën e Reagimit ndaj Sulmeve Seksuale dhe Udhëzime për Përmbajtjen e Trajnimit*, të cilat synonin të ofronin zbatimin e ligjit me çështjet, procedurat dhe rekomandimet që duhen marrë parasysh gjatë zhvillimit të një politike të lidhur me sulmet seksuale si si dhe përmbajtje shoqëruese të trajnimit.<sup>44</sup>

Në Udhëzimet, ShNSHP-ja theksoi rolin kyç që luan mbikëqyrja efektive në sigurimin e përgjigjeve dhe hetimit gjithëpërfshirës të krimeve të DHGV-së, të tilla si sulmet seksuale. ShNSHP-ja rekomandon që mbikëqyrësit e linjës së parë të demonstrojnë një kuptim të plotë të çështjeve të viktimave/të mbijetuarve dhe përgjigjen e duhur nga vartësit.<sup>45</sup> Për të përforcuar rekomandimet, ShNSHP-ja i ka ofruar zbatimin të ligjit një listë të veprimeve kryesore që duhet të ndërmerren mbikëqyrësit në rastet e dhunës seksuale, të cilat mund të jenë të zbatueshme, në një farë mase, për të gjitha format e DHGV-se:

44 Shih më tej: <https://www.theiacp.org/resources/sexual-assault-response-policy-and-training-content-guidelines>

45 Ibid.

## REFERENCE INDICATORS FOR THE POLICE PROVIDING TREGUESIT E REFERENCËS PËR POLICINË QË OFRON SHËRBIME THELBËSORE: HETIMI

Siç u diskutua në Kapitullin 2, ESP propozon që të gjitha shërbimet e drejtësisë dhe mbështetjes për viktimat/të mbijetuarit duhet të ndajnë një sërë karakteristikash dhe aktivitete të përbashkëta për të siguruar ndikimin maksimal. Ato janë të zbatueshme pavarësisht nga 'sektori' specifik që mund t'i përgjigjet nevojave të grave dhe vajzave që po përjetojnë dhunë.

Lista e mëposhtme është frymëzuar nga karakteristikat dhe aktivitetet e përbashkëta të ESP-së; ajo propozon shembuj të treguesve referues për aktivitetet e policisë, kur synon të përmbushë në mënyrë efektive kërkesat dëshmuese dhe hetimore kur reagon ndaj rasteve të DHGV-së. Kjo përfshin kryerjen e hetimeve në kohën e duhur dhe në mënyrë profesionale, dhe në proces, shterimin e të gjitha mjeteve në dispozicion për të siguruar llogaridhënien e autorit dhe parandalimin e kryerjes së sërishme të veprës. Këta janë tregues që menaxherët e policisë mund t'i referojnë nëse ekzistojnë, por gjithashtu inkurajojnë përfshirjen e tyre nga nivelet e larta nëse ato nuk ekzistojnë.

**1. Disponueshmëria dhe mundësia e qasjes:** Përqindja ose proporcioni i reagimeve pozitive nga viktimat/të mbijetuarit dhe/ose përfaqësuesit e tyre në lidhje me mundësinë e qasjes në shërbimet e policisë, si në aspektin e cilësisë ashtu edhe të sasisë. Reagimet duhet të synojnë të përfshijnë atë sesi policia po i informon viktimat/të mbijetuarit për statusin e hetimit, gjatë gjithë procesit. Nga kjo, menaxherët mund të vlerësojnë shkallën në të cilën stafi i tyre po mbledh dhe menaxhon siç duhet detajet e kontaktit të viktimës/të mbijetuarve.

**2. Përshtatshmëria dhe mundësia e qasjes:** Përqindja ose proporcioni i raporteve të rasteve të DHGV-së që integrojnë analizën e sjelljes së kryesit, në përputhje me ciklin e rekomanduar të modeleve të dhunës. Kjo analizë duhet të informojë fokusin e autorit të

**“Cilësia e hetimit dhe mënyra se si dokumentohet, së bashku me vendimet e hetuesit janë kritike për një rezultat të suksesshëm. Për shembull, trajtimi i zinxhirit të provave veçanërisht kur lidhet me provat mjeko-ligjore është i një rëndësie jetike dhe është një nga të parët fushat që do të sfidohen në sistemin e drejtësisë.”**

Gerry Campbell, ish Kryeinspektori i Detektivit,  
Scotland Yard

hetimit, si dhe nevojat për mbrojtjen e viktimës/të mbijetuarit.

**3. Përshtatja dhe mundësia e qasjes:** Përqindja ose proporcioni i anëtarëve të ekipit të trajnuar për të reaguuar ndaj fëmijëve viktimat/të mbijetuarve të dhunës. Kjo duhet të përfshijë si trajnimin e specializuar për ekipe të veçanta, ashtu edhe trajnimin e përgjithshëm të vazhdueshëm për të gjithë oficerët. Trajnimi duhet të ofrojë përditësime mbi kontaktet e referimit të viktimës/të mbijetuarit; ligje të reja, përfshirë dhunën dhe krimin e lidhur me kibernetikën; dhuna e lidhur me shkollën dhe roli i mediave sociale; dhe aktivitetet kriminale që prekin grupet e cënueshme siç janë emigrantët.

**4. Jepini përparësi sigurisë:** Përqindja ose proporcioni i urdhrave të mbrojtjes të rekomanduara dhe zbatuara nga policia në rastet e DHGV-së, kur autori i pretenduar është i njohur. Po aq e rëndësishme do të jetë përqindja ose proporcioni i rasteve të DHGV-se ku urdhrat e mbrojtjes nuk rekomandohen dhe/ose rekomandohen, por nuk ekzekutohen. Ky tregues duhet të merret parasysh në shoqëri me numrin e arrestimeve të bëra në raste të tilla.

**5. Pëlqimi i informuar dhe konfidencialiteti dhe mundësia e qasjes:** Përqindja ose proporcioni i oficerëve të trajnuar në qasjet e punës policore të informuara nga traumat. Trajnimi gjithashtu duhet të përfshijë trauma të përjetuara dhe të inkorporohet në trajnime të specializuara për ekipe të veçanta, si dhe trajnime të përgjithshme të vazhdueshme për të gjithë oficerët.

**6. Komunikim efektiv dhe pjesëmarrje nga palët e interesuara në hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e shërbimeve:** Numri i viktimave/të mbijetuarve me të cilët është folur dhe deklaratat e marra. Edhe pse ky tregues nuk jep informacion mbi cilësinë e komunikimit midis oficerit të policisë dhe viktimës/të mbijetuarit ose dëshmitarit në vetvete, ai është thelbësor në plotësimin e reagimeve cilësore të dhëna nga viktimat/të mbijetuarit.

**7. Mbledhja e të dhënave dhe menaxhimi i informacionit:** Përqindja ose proporcioni i rasteve të regjistruara dhe të ruajtura në mënyrë adekuate, sipas protokollit ose procedurës së menaxhimit të dosjes së çështjes. Regjistrimi i këtij informacioni demonstroi llogaridhënien dhe integritetin e procesit hetimor. Kjo përfshin të dhënat që viktimat/të mbijetuarit morën, me rastin e raportimit të krimit, një njohje me shkrim të ankesës së tyre nga policia, duke treguar elementet themelore të krimit, të tilla

#### Kutia 14

##### Udhëheqja Efektive e Policisë: Dhuna në Familje

Sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme të MB-se, udhëheqje efektive për të luftuar dhunën në familje ose dhunën e partnerëve intim në këtë fushë do të thotë\*:

- Duke e bërë abuzimin në familje një përparësi, me zyrtarët që kuptojnë se çfarë do të thotë kjo në praktikë;
- Duke qenë të qartë se abuzimi në familje është punë e të gjithëve, nuk është vetëm për njësitë e specializuara;
- Përforsimi i një kulture dhe qëndrimi pozitiv;
- Shpërblimi dhe njohja e njerëzve që mbështesin viktimat/të mbijetuarat e abuzimit në familje, me stimuj nga lavdërimet deri në perspektivat për promovim. Ne kemi “shpërblime për trimërinë e policisë” - a duhet të ketë “shpërblime për kujdesin ndaj viktimave”?
- Duke siguruar se ekziston fokusi dhe menaxhimi efektiv i performancës në këtë fushë; dhe
- Duke siguruar se ekziston një mbikëqyrje efektive për të përforcuar qasjen profesionale dhe kompetente.

\* Burimi: ‘Puna e të gjithëve: Përmirësimi i reagimit të policisë ndaj abuzimit në familje’ (Inspektorati i Komandës së Madhërisë së saj (HMIC, 2014).

si lloji i krimit, koha, vendi dhe çfareëdo dëm i shkakuar nga krimi. Kjo njohje duhet të përfshijë numrin e dosjes, datën, stacionin policor dhe emrin e zyrtarit që ka marrë raportin. Kjo duhet të shërbejë si dëshmi se krimi është raportuar (për shembull, në lidhje me kërkesat për kompensim).<sup>46</sup>

**8. Lidhja me sektorët dhe agjencitë e tjera përmes koordinimit:** Përqindja ose proporcioni i rasteve të DHGV-së që iu referuan agjencive dhe partnerëve të jashtëm. Është po aq e rëndësishme të dokumentohet përqindja ose proporcioni i rasteve kur viktimat/i mbijetuarit refuzoi një ofertë për mbështetjen e referimit.

---

<sup>46</sup> Për rekomandime të mëtejshme mbi menaxhimin e rasteve, ju lutemi referojuni “Forcimi i Parandalimit të Krimit dhe Përgjigja e Drejtësisë Penale ndaj Dhunës ndaj Grave” (UNODC, 2014).



## SHTOJCA 1

# FAZAT E NJOHURA TË DHUNËS BRENDA NJË MARRËDHËNIEJE

*Nga Graham Goulden, Krye Hetuesi (në pension) i Policisë, Scotland Yard*

Ndërsa oficerët nuk do të vërejnë gjithmonë shenja të abuzimit, vlen të dihen këto faza dhe çfarë mund të paraqitet nga një viktimë/e mbijetuar kur i përgjigjet një thirrjeje.

**Zbukurimi** – Shumë abuzues do të jenë të hijshëm gjatë fazave të hershme të një marrëdhënieje. Ata mund të jenë ‘partneri perfekt’. Kjo shpesh do të shihet nga miqtë dhe familjet e një viktime/të mbijetuare.

Gjatë fazave të hershme, taktikat e përdorura nga një kryes do të jenë; të izolojë viktimën/të mbijetuarën nga familja dhe miqtë. Kjo mund të shihet si kujdes dhe dashuri.

Procesi i zbukurimit të një viktime/të mbijetuare është shpesh gradual dhe e vë abuzuesin në një pozitë më të mirë për të filluar të zbatojë abuzime më të rënda dhe dhunë fizike.

Oficerët e policisë mund të marrin thirrje nga anëtarët e familjes ose miqtë që janë të shqetësuar për një individ.

### Shenjat dëshmuese - Flamujt e Kuq

- **Shenja dëshmuese - Flamujt e Kuq**
- **Izolimi nga familja dhe miqtë**
- **Varësia e hershme financiare - huatë e marra në emër të viktimës/të mbijetuarës**
- **Shtatzënia e hershme në një lidhje**
- **Lëvizja së bashku në një lidhje të hershme**
- **Autori mund të përshkruhet nga miqtë si partneri i përsosur**

**Shënim:** Është pranuar se flamujt e kuq të mësipërm nuk do të jenë gjithmonë shembuj të zbukurimit. Gjatë hetimit të abuzimit në familje, një oficer duhet të marrë parasysh të pyesë për fazat e hershme të marrëdhënieve.

**Menaxhimi i Situatës** - Kur fillon abuzimi më i shpeshtë dhe/ose dhuna fizike, disa viktime/të mbijetuara

mund të largohen nga lidhja. Shumë nuk e bëjnë këtë, për shkak të nivelit të kontrollit të vendosur gjatë fazës së zbukurimit. Viktimat/të mbijetuarat ka të ngjarë të përpiqen të gjejnë shpjegime për abuzimin për të lënë të hapur mundësinë se gjërat do të përmirësohen.

Viktima/e mbijetuara do të zhvillojë strategji për të menaxhuar autorin dhe situatat specifike, më shpesh duke ndryshuar sjelljen e tyre. Në këtë mënyrë, standartet e kryesit imponohen në marrëdhënie dhe abuzimi bëhet pjesë e marrëdhënies.

Nëse thirret policia, ka të ngjarë të jetë si një strategji për menaxhimin e abuzimit në kuadër të marrëdhënies. Nëse viktimat/e mbijetuara nuk dëshiron të angazhohet në këtë pikë, ata nuk po bëhen pengues ose jo-bashkëpunues qëllimisht - ata thjesht po e menaxhojnë situatën në një mënyrë që i bën ata të ndihen më të sigurt.

Është e rëndësishme që në këtë fazë oficerët të bëjnë pyetje që i mundësojnë viktimës të shohë se si ata mund të ndryshojnë dhe kufizojnë sjelljen e tyre për të përshatur sjelljen e autorit.

### Shenjat dëshmuese - Flamujt e Kuq

- **Shenjat dëshmuese - Flamujt e Kuq**
- **Izolimi nga miqtë dhe familja**
- **Vetë-fajësimi nga ana e viktimës/të mbijetuarës**
- **Tërheqja nga puna për shkak të lëndimeve**
- **Grup i identifikuar i rregullave të ngurtë të kërkuara nga një kryerës (p.sh., darka, pastrimi, pastërtia e viktimës/të mbijetuarës, veshjet që duhen veshur, etj.)**
- **Kryerësi kontrollon lëvizjet e viktimës/të mbijetuarës. Oficerët gjithashtu duhet të kenë parasysh se autorët mund të përdorin teknologji për të vendosur kontrollin.**
- **Dëmtimi i pronës**

**Shtrembërimi i Perspektivës/Realitetit** - Sjellja kontrolluese me forcë përfshin shumë taktika të ndryshme dhe të mbivendosura. Të kombinuara, këto rezultojnë në atë që viktimat/e mbijetuara të jeton në frikë. Ata ka të ngjarë të jenë të shqetësuar dhe të frikësuar.

Autorët do të përpiqen të transferojnë fajin dhe përgjegjësinë për abuzimin mbi viktimën/të mbijetuarën. Disa viktimat/e mbijetuar do të luftojnë dhe do të rezistojnë. Alkooli dhe substanca të tjera përdoren shpesh si mekanizma përballues, dhe të cilët mund të turbullojnë gjykimin dhe të bëjnë të duket se viktimat/e mbijetuara nuk po ndihmon, ose se 'të dy janë aq të këqij sa njëri-tjetri.'

Përgjigjet kryesore nga policia në këtë fazë janë të përpiqen dhe të sfidojnë çështjen e fajit, duke theksuar se viktimat/e mbijetuara nuk është për t'u fajtuar, dhe duke u përpjekur përsëri për t'i bërë ata të shohin se si po ndryshojnë sjelljen e tyre për të provuar dhe akomoduar autorin.

### **Shenjat dëshmuese - Flamujt e Kuq**

Oficerët duhet të marrin në konsideratë që të pyesin se si ndihen viktimat/të mbijetuarat në një lidhje, në vend që të pyesin thjesht se "çfarë ndodhi?"

Kur telefonatat merren, oficerët duhet të flasin vetë me viktimën/të mbijetuarën dhe të jenë të vetëdijshëm se sjelljet kontrolluese madje mund të ndodhin në praninë tuaj.

- **Frika e vazhdueshme në marrëdhënie për shkak të sjelljes kontrolluese**
- **Vetë-fajësimi**
- **Abuzimi me alkoolin/substancat**
- **Deklarata nga miqtë/familja/punëdhënësi**
- **Kritikat në publik**
- **Kryesi kthehet në fazën e zbulimit (pastrimit) pasi kanë frikë se viktimat/e mbijetuara mund të jetë duke menduar të largohet**
- **Kryesi duke qëndruar me viktimën/të mbijetuarën gjatë takimeve mjekësore dhe të tjera**
- **Skena nuk është ajo që e prisnit**

**Kur marrin pjesë në thirrje, oficerët duhet të kërkojnë shenja delikate të kontrollit shtrëngues. Këto mund të përfshijnë:**

- **Kur marrin pjesë në thirrje, oficerët duhet të kërkojnë shenja delikate të kontrollit shtrëngues. Këto mund të përfshijnë:**
- **Gjestet e dorës për të heshtur një viktimë/të mbijetuar**
- **Autori fajëson viktimën/të mbijetuarën**
- **Autori që pretendon statusin e viktimës/të mbijetuarës.**

Një rast i raportuar në Shtetet e Bashkuara vuri në dukje se si një viktimë/e mbijetuar do të ndalonte së foluri kur autori i pretenduar hynte në dhomë. Vetëm më vonë oficerët zbuluan se kjo ndodhi kur autori i pretenduar hyri duke mbajtur një peshqir të bardhë. Pas marrjes në pyetje, viktimat/e mbijetuara më vonë tha se ky peshqir shpesh përdorej për t'ja marr frymën (mbytur) viktimën.

**Përkufizimi i Abuzimit - Shpesh vetëm pas një periudhe kohore viktimat/e mbijetuara përkufizon atë që po ndodh si abuzim, veçanërisht nëse ka pasur pak dhunë fizike, ose nëse dhuna është 'e nivelit të ulët', por detyrim.**

Kjo mund të jetë një fazë e vështirë për viktimën/të mbijetuarën, pasi ata do të duhet të pranojnë statusin e tyre si të viktimës/të mbijetuarës dhe se personin që ata kanë dashur është një abuzues. Kjo fazë gjithashtu do të përfshijë, të paktën në një farë mase, njohjen e abuzimit si të vazhdueshëm në krahasim me incidentet 'e njehershme'.

Mund të ndihmojë nëse reaguesi e ndihmon viktimën/të mbijetuarën të sfidojë stereotipet në lidhje me 'viktimat' dhe 'autorët' e pretenduar. Është e rëndësishme që oficerët të validojnë përvojën e viktimës/të mbijetuarës dhe të heqin fajin prej tyre. Të thuash diçka si "Ky nuk ishte faji yt" viktimes/te mbijetuares mund të jetë shumë fuqizuese për ta.

### **Shenjat dëshmuese - Flamujt e Kuq**

- **Deklaratat e hollësishme nga viktimat/e mbijetuara me abuzimin e identifikuar të komunikuar nga viktimat/e mbijetuara**

- **Pranimi i statusit të viktimës/të mbijetuarës**
- **Pranimi se partneri është kryesi**
- **Thirrjet nga viktimat/e mbijetuara në lidhje me abuzimin**

**Rivlerësimi i Marrëdhënies** - Pasi që viktimat/e mbijetuara të ketë pranuar atë që po i ndodh si abuzim, ajo mund të fillojë të rivlerësojë të gjithë marrëdhënien e tyre.

Strategjitë e saj ekzistuese për menaxhimin e abuzimit mund të vazhdojnë. Largimi, qoftë përkohësisht ose përgjithmonë, dhe përfshirja e sistemeve formale të mbështetjes do të bëhet më realiste.

Ndërhyrja në këtë fazë mund të kërkojë eksplorimin se çfarë barrierash praktike ka për të lënë marrëdhënien.

Përsëri, oficerët duhet të kërkojnë të vërtetojnë (validojnë) përvojën e viktimës/të mbijetuarës.

#### **Shenjat dëshmuese - Flamujt e Kuq**

- **Vetë-reflektim nga viktimat/e mbijetuara**
- **Planifikimi i sigurisë**
- **Komunikimi me shërbimet e viktimës/të mbijetuarës**
- **Duke qëndruar me autorin e krimit derisa bëhet e sigurt për t'u larguar**
- **Duke folur me shokun/familjen/policinë për largimin**

**Përfundimi i Marrëdhënies** - Është thelbësore të kihet parasysh se shumë viktimat/të mbijetuar bëjnë përpjekje të shumta për të lënë një partner abuziv para se ta bëjnë në të vërtetë.

Arsyet për të mos i dhënë fund një marrëdhënieje shpesh do të jenë praktike dhe përfshijnë: sjellje dhe taktika të shumta kontrolluese dhe premtime për të ndryshuar; strehim; mbështetje ekonomike; dhe fëmijët; presioni nga familja dhe frika se ata nuk mund të garantojnë sigurinë e tyre.

*Reaguesit e parë* duhet të jenë të vetëdijshëm për kërkesat e menjëhershme të planifikimit të sigurisë dhe të sigurojnë që viktimat/të mbijetuarat të referohen në shërbimet mbështetëse të specializuara që mund t'i ndihmojnë ata të përballen me vendime të vështira për të ardhmen.

**Krijimi i 'hapësirës për veprim' është thelbësor dhe reaguesit mund të luajnë një rol vendimtar në krijimin e asaj hapësire duke hequr autorin dhe duke i arrestuar ata nëse ka arsye për ta bërë këtë.**

#### **Shenjat dëshmuese**

- **Planet e sigurisë**
- **Diskutime me shërbimet e viktimës/të mbijetuarës**
- **Duke qëndruar me autorin e krimit derisa bëhet e sigurt për t'u larguar**

**Përfundimi i Abuzimit** - Është e rëndësishme të theksohet se përfundimi i marrëdhënies nuk do të thotë gjithmonë përfundimi i dhunës dhe abuzimit. Periudha pas ndarjes në fakt mund të jetë më e rrezikshme. Shumë viktimat/të mbijetuar vuajnë nga abuzimi pas ndarjes dhe reaguesit duhet të jenë të vetëdijshëm për rritjen e rrezikut. Kontakti me fëmijët mund të jetë një çështje domethënëse pas ndarjes. Shumë abuzues vazhdojnë të përpiqen dhe të ushtrojnë kontroll përmes kontaktit me fëmijët, dhe viktimat/të mbijetuarat dhe fëmijët janë abuzuar dhe vrarë gjatë vizitave të kontaktit të urdhëruara nga gjykata.

#### **Shenjat dëshmuese**

- **Kontakti i vazhdueshëm me autorin ku përfshihen fëmijët**
- **Kontaktoni nga kryesi përmes telefonit celular, në punë, ose përmes miqve dhe familjes**

## SHTOJCA 2

# DHUNA/ABUZIMI DHE PRAKTIKAT E DËMSHME TË BAZUARA NË NDERIN P.SH., FËMIJËT, MARTESA E HERSHME DHE E DETYRUAR DHE GJYMTIMI GJENITAL I FEMRËS

Nga Gerry Campbell MBE FCMI AFHEA, Kryeinspektor Detektiv (në pension), Scotland Yard

### Çfarë është dhuna/abuzimi i bazuar në nder?

Për të përcaktuar abuzimin e bazuar në nder, është e rëndësishme të kuptohet se çfarë nënkuptohet me fjalën 'nder'. Mund të argumentohet se të gjitha kulturat në të gjithë globin përdorin një kod nderi të një përshkrimi.

Në mënyrë të pandryshueshme, ka të bëjë me rregullat e vendosura në shoqëritë tona që përcaktojnë se cilat janë sjelljet e pranueshme dhe të papranueshme, 'Po-jat dhe Jo-jat'. Për disa kultura, kodi i nderit është më shumë një mënyrë jetese.

Nderi i referohet respektit të lartë ose vlerësimit të lartë dhe është si një tipar pozitiv i lidhur me integritetin dhe karakterin e mirë moral. Individët me cilësi të tilla përshkruhen si "të nderuar"<sup>47</sup>, e cila jep karakteristika të tjera pozitive të tilla si besimi dhe respekti dhe gjithashtu lidhet me statusin dhe reputacionin.<sup>48</sup> Ekziston rëndësia që nderi ka në sytë e një personi, por edhe në sytë e shoqërisë së tij/saj.



Gerry Campbell MBE FCMI AFHEA - Kryeinspektor Detektiv (në pension), Scotland Yard

Ky aspekt i rëndësisë në kulturat e nderit është i lidhur në thelb me reputacionin e një individi dhe për këtë arsye me statusin brenda komunitetit. Mund të jetë jashtëzakonisht dëmtuese kur ka pasur një shkelje të perceptuar të nderit, e cila mund të çojë në një "ndëshkim të dhunshëm" të kryer për të mbrojtur nderin e një individi ose të familjes.<sup>49</sup> Një ndëshkim i tillë i dhunshëm mund të jetë i shpejtë dhe të shohë përdorimin e forcës së paimagjinueshme që çon në humbjen e jetës.

<sup>47</sup> Vandello, J. A. & Cohen, D. (2003), 'Nderi mashkullor dhe besnikëria femërore: Skriptet e nënkuptuara kulturore që përjetësojnë dhunën në familje', *Revista e Personalitetit dhe Psikologjisë Sociale*, 84, në f. 997.

<sup>48</sup> Julian Pitt-Rivers, 'Nderi dhe Statusi Social', tek *Nderi dhe Turpi: Vlerat e Shoqërisë Mesdhetare* (red. J. G. Peristiany, Weidenfeld dhe Nicolson, 1965), f21.

<sup>49</sup> Ibid.

## STUDIMI I RASTIT: VRASJA E ZONJËS SË NDJERË BANAZ MAHMUD (2006)

**“Ky ishte një krim barbar dhe i pashpirt .... Për të rikthyer të ashtuquajturin nder familjar, u vendos nga babai dhe xhaxhai i saj që ajo të vdiste dhe kujtesa e saj të fshihej” (Gjykatësi Brian Barker).**

Zonja e ndjerë Banaz Mahmud lindi në Kurdistanin Iraikian më 16 dhjetor 1985. Në moshën 10 vjeçare, Banaz u transferua në MB me familjen e saj, ku ata kërkuan azil.

Kur ishte 17 vjeç, Banaz hyri në një martesë të aranzhuar me një burrë 10 vjet më të madh se ajo. Dy vjet më vonë dhe pas abuzimit seksual dhe fizik, Banaz e la atë dhe u kthye për të jetuar me prindërit e saj në Mitcham, Londër, me pëlqimin e tyre. Pas kësaj ndarje, Banaz krijoi një marrëdhënie të re me një burrë tjetër, i cili u konsiderua nga anëtarët meshkuj të familjes së saj si “i papërshtatshëm”. Banaz dhe i dashuri i saj po ndiqeshin dhe vëzhgoheshin nga anëtarët e komunitetit dhe me sa duket u puthën jashtë një stacioni nëntokësor në Londër.

Në Dhjetor 2005, Xhaxhai nga babai i Banazit thirri një takim ose këshill familjar në një apartament në Londër, i cili vulosi fatin e Banaz, pasi ajo konsiderohej se kishte sjellë turp në familjen e saj.

Midis shtatorit 2005 dhe janarit 2006, Banaz ra në kontakt me oficerë policie nga Shërbimi Policor Metropolitan (Londër) dhe Policia e West Midlands (Birmingham, MB) në pesë raste, gjatë të cilave u bënë akuza serioze, përfshirë sulme seksuale dhe kërcënime për vrasje. Komisioni i Pavarur i Ankesave të Policisë (tani Zyra e Pavarur e Sjelljes Publike) më vonë do të konstatonte se kishte mangësi në mënyrën sesi disa policë i hetuan këto pretendime (KPAP, Nëntor 2008).

Në një rast më 31 dhjetor 2005, fqinji i gjyshes së Banaz njoftoi policinë se panelet e xhamit të derës së saj ishin thyer. Banaz kishte thyer xhamin në një përpjekje të dëshpëruar për të shpëtuar nga babai i saj, ndërsa ai e lyente me raki. Banaz u iku në një kafene aty pranë dhe stafi dhe klientët panë që ajo ishte e shqetësuar dhe se duart i kishte me gjak. Banaz u tha atyre se ishte detyruar të pinte alkool, se njerëzit ishin “duke e ndjekur atë” dhe se asaj i duhej të thyente një dritare për të shpëtuar. Shërbimi i ambulancës dhe policia u dërguan në vendngjarje. Banaz i tha ekipit të ambulancës se ajo kishte thyer një

dritare dhe se babai i saj e kishte detyruar të pinte alkool dhe po përpiqej ta vriste. Ajo tha gjithashtu se “ata” do të vrisnin të dashurin e saj - z. Rahmat Suleimani.

Rahmat deklaroi se Banaz u tha policëve se ajo besonte se babai dhe xhaxhai i saj donin ta vrisnin.

Gjatë mbrëmjes së 22 janarit 2006, të dashurit të Banazit iu afruan katër burra. Ata i kërkuan të shkonte me ta dhe kur ai refuzoi, u kërcënua si për jetën e tij ashtu edhe për jetën e Banazit. Ai e raportoi këtë në polici. Më 23 janar, Banaz shkoi në një stacion policie për të raportuar kërcënimin. Ajo i tha një oficeri policie emrat e burrave që kishin kërcënuar të dashurin e saj. Banaz u zhduk menjëherë pas kësaj. Ajo ishte përdhunuar, shtrënguar (mbytur) për vdekje dhe vendosur në një valixhe.

Më 25 janar 2006, Banaz u raportua e zhdukur nga Rahmat dhe jo nga ndonjë anëtar i familjes së saj. Shërbimi Policor Metropolitan (Londër) filloi një hetim tre-mujor të personave të zhdukur me rrezik të lartë. Më 29 Prill 2006, trupi i dekompozuar i Banaz u gjet në valixhen e varrosur në një kopsht të një prone pranë Birmingham, 200 milje nga shtëpia e familjes së saj në Londër.

Më 11 qershor 2007, babai i Banazit, Mahmud Mahmud, xhaxhai i saj nga babai, Ari Mahmud dhe një i afërm tjetër, Mohammed Hama, u dënuan për vrasjen e saj dhe u dënuan me burgim të përjetshëm. Anëtarët e tjerë të komunitetit Kurdistan nga Iraku janë të dënuar për krime të lidhura me vrasjen e Banazit p.sh. dëshmi e rreme dhe parandalimi i varrimit të ligjshëm dhe të denjë të Banaz.

Në Mars 2016, Rahmat Suleimani, i cili kishte qenë në mbrojtjen e policisë gjatë 10 viteve të fundit, vdiq në spital pasi me sa duket i mori jetën vetvetës. Shtë raportuar se ai kishte bërë dy përpjekje të mëparshme për vetëvrasje.

Rahmat u citua të thoshte, “Jeta ime varej nga ajo. Ajo ishte e tashmja ime, e ardhmja ime, shpresa ime. Ajo ishte gjëja më e mirë që më kishte ndodhur ndonjëherë. Jeta ime u zhduk kur Banaz vdiq. Nuk ka jetë. E vetmja gjë që po më mbante në këmbë ishte momenti për të parë drejtësinë për Banazin.”

Rahmat është një tjetër viktimë e vrasjes së nderit të Banaz.

Për më tepër, çështjet e nderit dhe reputacionit [‘Izzat’ (Nderi) dhe ‘Sharam’ (Turp) brenda bashkësive të Azisë Jugore, si dhe shumë versione të tjera gjuhësore të këtyre fjalëve] është gjithashtu një ndikim i dukshëm në nocionet e nderit. Nderi dhe turpi janë emocione të fuqishme, të cilat mund të vetë-imponohen dhe imponohen nga të tjerët dhe janë ndikime të fuqishme në veprimet individuale. Ndërsa abuzimi i bazuar në nder është një reagim negativ ndaj të turpëruarit ose një perceptim i të turpëruarit, ai gjithashtu kryhet për të parandaluar ose shmangur turpërimin. Ndërsa gratë, fëmijët dhe burrat janë viktimat të dhunës dhe abuzimit të bazuar në nder, gratë dhe vajzat kanë më shumë gjasa të viktimizohen, duke e bërë këtë ofendim një formë të dhunës me bazë gjinore.

Në shkallën e dëmit, shkeljet e pretenduara të kodit të nderit të një kulture ose komuniteti mund të përfshijnë A - Z të veprave penale të tilla si vrasje, rrëmbim, burg të rremë, përdhunim, sulme serioze fizike (përfshirë sulmet me acid, përdorimi i armëve), kërcënime për të vrarë, ngacmim, përndjekje, frikësim dhe shumë vepra të tjera. KB vlerëson se 5000 femra vriten në emër të nderit çdo vit.<sup>50</sup> Realiteti është se shumë më tepër femra zhduken, dhe ato nuk raportohen asnjëherë si të zhdukura, dhe/ose gjetura ose nuk regjistrohen nga autoritetet.<sup>51</sup> Përveç kësaj, ka nga ato viktimat që vdesin si rezultat i ‘vetëvrasjes së detyruar’; të cilët vdesin nga vetë-djegia, plagët me thikë dhe shkaqe të tjera.

Një studim i vitit 2018 nga UNODC ka gjetur se në vitin 2017, 87,000 gra në mbarë botën u vranë qëllimisht.<sup>52</sup> Më shumë se gjysma e viktimave (58%) ose 50,000 u vranë nga partnerët intim ose anëtarët e familjes. Kjo përkthehet në 137 gra në të gjithë botën që vriten nga një anëtar i familjes së tyre çdo ditë. Më shumë se një e treta (30,000) e grave të vrara me dashje në vitin 2017 u vranë nga partneri i tyre intim aktual ose i dikurshëm. Kjo është në përputhje të gjerë me studimin e përhapjes së Organizatës Botërore të Shëndetit 2018. Ky studim njeh gjithashtu vrasjet e nderit dhe vrasjet e grave që

50 Lajmet e OKB -së (4 Mars 2010) qasja nëpërmjet <https://news.un.org/en/story/2010/03/331422>

51 Studim Global mbi Vrasjet, Vrasja e grave dhe vajzave lidhur me gjininë (UNODC, 2018).

52 Ibid.

lidhen me prikën, si dhe vrasjet e grave dhe vajzave të lidhura me magjinë<sup>53</sup>; një formë tjetër e praktikave të dëmshme.

## Praktika të dëmshme

Dhuna dhe abuzimet e tilla ndaj grave janë të shumëanshme dhe bashkë-ekzistojnë në një vazhdimësi të temave të ndërsjella të shumëfishta dhe të ndërlidhura me kontekst të ndryshëm shoqëror, ekonomik, kulturor dhe politik.<sup>54</sup> Dhuna ndaj grave është një shkak dhe një pasojë e pabarazisë dhe diskriminimit<sup>55</sup> gjinor dhe është një nga pengesat më të mëdha për arritjen e barazisë gjinore.<sup>56</sup>

Traditat janë modele të vendosura prej kohësh të veprimeve ose sjelljeve, të cilat shpesh jepen brenda familjeve dhe komuniteteve, gjatë shumë brezave. Këto zakone bazohen në besimet dhe vlerat e mbajtura. Traditat shpesh mbrohen nga tabutë, të cilat janë ndalime të forta shoqërore që lidhen me veprimtarinë njerëzore ose zakonet shoqërore të bazuara në gjykimin moral dhe besimet fetare. Kjo do të thotë se traditat nuk janë të lehta për tu ndryshuar, sepse njerëzit i përmbahen këtyre modeleve të sjelljes, duke besuar se ato janë gjërat e duhura për të bërë.

Traditat kanë një ndikim pozitiv tek individët, familjet dhe komunitetet; megjithatë, ato gjithashtu mund të jenë të dëmshme. KB-ja i është referuar shkeljeve të mëposhtme të të drejtave të njeriut si praktika të dëmshme, të cilat ndikojnë seriozisht dhe në mënyrë shkatërruese në shëndetin e grave dhe vajzave, mirëqenien dhe të drejtat e njeriut: gjymtimi gjenital femëror (GjGjF); ushqyerja e detyruar e grave; martesat të hershme dhe të detyruara të fëmijëve; preferenca për djalin; vrasje e foshnjave femra; shtatzënia e hershme; dhe çmimi i prikës.<sup>57</sup> Praktika të

53 Ibid.

54 Ibid.

55 Studimi i thelluar i Sekretarit të Përgjithshëm të KB-së për të gjitha format e dhunës kundër grave, (A/61/122/Add.1 (2006), para 65, p.27).

56 Studimi i thelluar i Sekretarit të Përgjithshëm të KB-së për të gjitha format e dhunës kundër grave, (A/61/122/Add.1 (2006), para 1, p.9).

57 KB, Fletë Fakti Nr. 23, Praktika të Dëmshme Tradicionale që Ndikojnë në Shëndetin e Grave dhe Fëmijëve të qasshme përmes <https://www.ohchr.org/Documents/Publications/FactSheet-23en.pdf>

tjera të dëmshme përfshijnë krimet e nderit, çmimin e nuses, rrëmbimin e nuses, gjakmarrjen, 'hekurosjen' e gjirit/majmërinë dhe plagët.

Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara gjithashtu i nënshtrohen të njëjtave praktika të dëmshme të kryera kundër grave dhe vajzave pa aftësi të kufizuara, me pasoja që ndonjëherë përkeqësojnë aftësitë e kufizuara ekzistuese, krijojnë të reja, ose që rrisin cenueshmërinë e tyre ekzistuese dhe përjashtimin social.<sup>58</sup>

## Martesa e detyruar

Një martesë e detyruar është një martesë në të cilën një ose të dy bashkëshortët (burrë dhe grua) nuk japin pëlqimin e informuar për martesën, por sulmohen, kërcënohen, mashtrohen ose detyrohen ndryshe në të. Detyrimi i përdorur për të detyruar dikë në martesë mund të marrë shumë forma dhe mund të përfshijë presion fizik, psikologjik, financiar, seksual dhe emocional.<sup>59</sup>

Martesa e detyruar, si një formë tjetër e dhunës kundër grave dhe vajzave, është formë e abuzimit të fëmijëve dhe të rriturve, është një abuzim themelor i të drejtave të grave dhe vajzave dhe është një vepër penale në shumë vende dhe juridiksione.

Ndërsa njihet se si gratë ashtu edhe burrat detyrohen të martohen, gratë dhe vajzat janë kryesisht viktima ose janë të prekshme nga kjo praktikë e dëmshme. Pasi detyrohen të martohen, viktimat ekspozohen, përballen dhe përjetojnë një mori krimesh të tjera të rënda, dhunë fizike dhe seksuale, abuzime psikologjike dhe emocionale dhe servilitet në familje gjatë gjithë jetës së tyre me pasoja të mëdha shëndetësore.

Martesa e fëmijëve, domethënë martesa para moshës 18 vjeçare bëhet në shumë vende të globit, përfshirë SHBA dhe Mbretërinë e Bashkuar.

58 Një Parashtrim që Thekson Praktikën e Dëmshme që Synojnë Personat me Aftësi të Kufizuara, dhe Veçanërisht Gratë dhe Vajzat me Aftësi të Kufizuara, (Aleanca Ndërkombëtare e Aftësisë së Kufizuar, 2017).

59 Udhëzimet e praktikës së shumë agjencive të Qeverisë HM, *Trajtimi i rasteve të Martesës së Detyruar* (qershor 2014).

Kishte shumë motive të ndryshme dhe variacione rajonale në arsyet e martesave të detyruara që përdodhin, duke përfshirë ruajtjen dhe/ose sigurimin e pasurisë dhe statusit, varfërinë, sigurinë, parandalimin e izolimit të komunitetit, sigurimin e një kujdestari për një fëmijë të sëmurë, si dhe lidhjen me forma të tjera të praktikave të dëmshme siç është rrëmbimi i nuses.

### Kutia 15

#### Martesa e detyruar - Dosja e fakteve

- 700 milionë gra të gjalla sot u martuan para ditëlindjes së tyre të 18-të. Nga këto, 250 milionë u martuan para moshës 15 vjeç.
- Në vitin 2019, 1 në 5 gra, të moshës 20-24 vjeç, u martuan para moshës 18 vjeç.<sup>1</sup>
- Nëse nuk ka reduktim të martesës së hershme dhe të detyruar të fëmijëve, deri në vitin 2030, 950 milionë gra dhe vajza do të martohen para ditëlindjes së tyre të 18 -të. Kjo shifër do të arrijë në afro 1.2 miliardë deri në vitin 2050.<sup>2</sup>
- Globalisht, gati një në tre vajza adoleshente të moshës 15 - 19 vjeç (84 milionë) ka qenë viktimë e dhunës emocionale, fizike dhe/ose seksuale të kryer nga burri ose partneri i tyre.<sup>3</sup>
- Komplikimet e shtatzënisë dhe lindjes janë ndër shkaqet kryesore të vdekjes tek vajzat e moshës 15-19 vjeç në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme.<sup>4</sup>
- 115 milion meshkuj u martuan para 18 vjetësh; 23 milionë prej të cilëve u martuan para moshës 15 vjeç.<sup>5</sup>

1 Kombet e Bashkuara, Departamenti i Çështjeve Ekonomike dhe Sociale, Divizioni i Statistikave (2020). Achieve gender equality and empower all women and girls.

2 GirlsNotBrides, qasur përmes <https://www.girlsnotbrides.org/700-million-women-married-children-reveals-new-uncif-data/>

3 Organizata Botërore e Shëndetit (OBSh), Adoleshentët: rreziqet dhe zgjidhjet shëndetësore (13 Dhjetor 2018) qasur përmes <https://www.who.int/en/news-room/fact-sheets/detail/adolescents-health-risks-and-solutions>

4 Ibid.

5 115 milion djem dhe burra në të gjithë botën u martuan si fëmijë - UNICEF Mbretëria e Bashkuar qasur përmes <https://www.unicef.org.uk/press-releases/115-million-boys-and-men-around-the-world-married-as-children-uncif/>

## Kutia 16

### Konventa e KB -së për të Drejtat e Fëmijëve<sup>1</sup>

Neni 2 thotë:

1. Shtetet Palë do të respektojnë dhe sigurojnë të drejtat e përcaktuara në këtë Konventë për secilin fëmijë brenda juridiksionit të tyre pa asnjë diskriminim të çfarëdo lloji, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, mendimi politik ose tjetër, prejardhjes kombëtare, etnike ose shoqërore, prona, paaftësia, lindja ose statusi tjetër i fëmijës ose i prindërve të tij ose të saj ose kujdestarit ligjor.

2. Shtetet Palë do të marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar që fëmija të mbrohet nga të gjitha format e diskriminimit ose ndëshkimit në bazë të statusit, aktiviteteve, opinioneve të shprehura ose bindjeve të prindërve të fëmijës, kujdestarëve ligjorë ose anëtarëve të familjes.

<sup>1</sup> Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (1990), e qasur përmes: [https://downloads.unicef.org.uk/wp-content/uploads/2010/05/UNCRC\\_PRESS-200910web.pdf?\\_ga=2.16687990.170076905.1577836147-1551955756.1577836147](https://downloads.unicef.org.uk/wp-content/uploads/2010/05/UNCRC_PRESS-200910web.pdf?_ga=2.16687990.170076905.1577836147-1551955756.1577836147)

## Martestat e Aranzhuara

Tradita e martesës së aranzhuar festohet në të gjithë botën ku anëtarët e familjes, veçanërisht prindërit, marrin një rol udhëheqës në organizimin e martesës. Sidoqoftë, është e rëndësishme që të bëhet dallimi midis martesës të aranzhuar dhe martesës së detyruar. Që një martesë të jetë me të vërtetë e aranzhuar, ajo duhet të bazohet në **pajtueshmërinë, zgjedhjen dhe pëlqimin e informuar** të të dy palëve në bashkim.

Festuesit e martesës, policia, profesionistë të tjerë të zbatimit të ligjit, anëtarët e familjes së gjerë dhe komunitetit duhet të jenë të gjithë vigjilentë për faktin se një martesë e detyruar mund të «vishet» për t'u dukur si një martesë e aranzhuar me konsensus. Prandaj është jetike që përkundër mbështetjes së komunitetit për praktikatat e dëmshme, të cilat shkelin të drejtat e njeriut dhe ligjet kombëtare dhe ndërkombëtare, kujdesi

## Kutia 17

### Bea\* 14 vjeç

Bea ishte një vajzë katërmëdhjetë vjeçare që jetonte në Kenia, e cila u detyrua t'i nënshtrohej GjGJF-së gjatë pushimeve të shkollës. Ajo duhej të martohej me një burrë 67-vjeçar pasi prindërit e saj e shitën për 2 kg gjethe çaji dhe 10 kg sheqer, domethënë çmimi i saj si nuse.

Jo çuditërisht, ditën kur burri i saj i synuar erdhi për ta marrur atë, Bea bërtiti se ajo nuk do të shkonte me të dhe nuk do të martohej me të. I moshuari u largua pasi i tha babait të 'B' se kur ajo të qetësohej, ai do të kthehej për të. Kur burri i synuar i Beas u largua nga fermë-shtëpia, babai i saj me sa duket u ndje aq i turpëruar dhe i zemëruar sa Bea e kishte çnderuar atë duke mos iu bindur dhe duke refuzuar të martohej.

Ndëshkim i Beas për mos dëgjimin e tij përfshiu vëllezërit e saj duke e shtrënguar në tokë dhe babai i saj i preu lobet e veshit me një hanxhar.

Pasi plagët e saj ishin shëruar, Bea u martua me burrin 67-vjeçar. Bea u shpëtua më pas dhe po jeton e sigurtë në një qendër shpëtimi së bashku me shumë vajza të tjera që u shpëtuan nga martestat e detyruara në pritje ose u përballën me fatet e ngjashme.

\* emri jo i vërtetë i viktimës

i duhur ushtrohet nga shtetet kombëtare dhe qeveritë rajonale, organet mbikëqyrëse dhe organet e zbatimit të ligjit për të mbrojtur fëmijët nga të gjitha format e diskriminimit.

Ndërkombëtarisht, organizatat policore dhe ato të zbatimit të ligjit, prandaj edhe oficerët dhe zyrtarët e tyre, kanë qëllimet kryesore: **Mbrojtjen e jetës, Parandalimin dhe Zbulimin e Krimin dhe Ruajtjen e Rendit dhe Sigurisë.**

Në Udhëzimet e saj Shumë Agjencore për Martestat e Detyruara, Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar mbron konceptin e «Rregulli i një rasti» për policët dhe profesionistët e tjerë në trajtimin e rasteve të martesës së



## Kutia 18

### FGM/C - Fakte Kryesore<sup>1</sup>

- Gjymtimi/prerja gjenitale femërore (FGM/C) përfshin procedura që me dashje ndryshojnë ose shkaktojnë dëmtim të organeve gjenitale femërore për arsye jo mjekësore.
- Procedura nuk ka përfitime shëndetësore për vajzat dhe gratë.
- Procedurat mund të shkaktojnë gjakderdhje të rëndë dhe probleme me urinimin, dhe cista të mëvonshme, infeksione, si dhe komplikime në lindje dhe rritje të rrezikut të vdekjeve të të porsalindurve.
- Më shumë se 200 milionë vajza dhe gra të gjalla sot janë prerë në 30 vende në Afrikë, Lindjen e Mesme dhe Azi, ku është përqendruar FGM/C.
- FGM/C kryhet kryesisht tek vajzat e reja midis foshnjërisë dhe moshës 15 vjeç.
- FGM/C është një shkelje e të drejtave të njeriut të vajzave dhe grave.
- Ekzistojnë katër lloje të FGM/C (shih më poshtë).

<sup>1</sup> Ibid.

detyruar.<sup>60</sup> Ky koncept nënvizon se profesionistët kanë, në terma realë, «një shans» për të ruajtur, mbrojtur dhe shpëtuar një individ nga viktimizimi ose viktimizimi i mëtejshëm. Bëhet fjalë për motivimin e profesionistëve për të ndërmarrë veprime pozitive për të ruajtur dhe mbrojtur viktimat/të mbijetuarat dhe viktimat/mbijetuarat e mundshme nga dëmtimi.

Ndërsa është zhvilluar për martesë të detyruar, «Rregulli i një shansi» mund të përkthehet në të gjithë spektrin e fushave të lëndës së DHGV-së.

## Gjymtimi gjenital i femrës (FGM)/Prerja (FGM/C)

Gjymtimi/prerja gjenitale femërore (FGM/C) mbetet një sfidë e dukshme për hetuesit policorë dhe prokurorët në shumë prej juridiksioneve në të gjithë globin ku është kriminalizuar.<sup>61</sup>

Organizata Botërore e Shëndetit (OBSh) përkufizon FGM/C si i përbërë nga të gjitha procedurat që përfshijnë

*heqjen e pjesshme ose të plotë të organeve gjenitale të jashtme femërore, ose dëmtime të tjera të organeve gjenitale femërore për arsye jo mjekësore.*<sup>62</sup>

FGM/C është një abuzim i tmerrshëm i të drejtave të grave dhe vajzave dhe ka ndikime të rënda në shëndetin dhe mirëqenien e tyre, madje çon në vdekje.<sup>63</sup>

Është e rëndësishme që oficerët e policisë dhe udhëheqësit e tyre të pranojnë se FGM/C shkakton dëmtime serioze trupore dhe psikologjike për viktimat/të mbijetuarat. Këto lëndime fizike janë të ngjashme me lëndimet me thikë/goditje me thikë.

Në 1997, OBSh klasifikoi gjymtimin/prerjen gjenitale femërore në katër lloje kryesore:

- **Lloji 1:** Shpesh i referuar si **klitoridektomi**, kjo është heqja e pjesshme ose e plotë e klitorisit (një pjesë e vogël, e ndjeshme dhe erektilë e organeve gjenitale femërore), dhe në raste shumë të rralla, vetëm prepuca (palosja e lëkurës që rrethon klitorisin)
- **Lloji 2:** Shpesh i referuar si **prerje**, kjo është heqja e pjesshme ose e plotë e klitorisit dhe labia minora (palosjet e brendshme të vulvës), me ose pa heqje të labia majora (palosjet e jashtme të lëkurës së vulvës).

<sup>60</sup> Udhëzimet e praktikës së shumë agjencive të Qeverisë HM:

Trajtimi i rasteve të Martesës së Detyruar, (qershor 2014), f.16.

<sup>61</sup> Fondacioni Thomson Reuters dhe 28TooMany, 'Ligji dhe FGM, Një Përmbledhje e 28 Vendeve Afrikane', (Shtator 2018).

<sup>62</sup> Ibid.

<sup>63</sup> Ibid.



*Gerry Campbell MBE FCMI  
AFHEA- Detective Chief  
Superintendent (Retired)  
Scotland Yard*

- **Lloji 3:** Shpesh i referuar si **infibulim**, ky është ngushtimi i hapjes vaginale përmes krijimit të një vulë që mbulon. Vula formohet duke prerë dhe ripozicionuar labia minora, ose labia majora, ndonjëherë përmes qepjes, me ose pa heqjen e klitorisit (klitoridektomi).
- **Lloji 4:** Kjo përfshin të gjitha procedurat e tjera të dëmshme për organet gjenitale femërore për qëllime jo-mjekësore, p.sh. shpimi, mprehja, prerja, gërvishtja dhe kauterizimi i zonës gjenitale.

De-infibulimi i referohet praktikës së prerjes së hapjes vaginale të mbyllur në një grua që është infibuluar, e cila shpesh është e nevojshme për të përmirësuar shëndetin dhe mirëqenien, si dhe për të lejuar marrëdhënie ose për të lehtësuar lindjen e fëmijëve.<sup>64</sup>

Ka shumë arsye dhe motivime pse FGM/C praktikohet nga familjet dhe komunitetet duke përfshirë kontrollin e autonomisë seksuale të grave, dhe «shpesh motivohet nga besimet në lidhje me atë që konsiderohet sjellje e pranueshme seksuale.»<sup>65</sup>

Hetimi dhe/ose ndjekja penale e FGM/C është më e vështirë si rezultat i një kombinimi të faktorëve që përfshijnë:<sup>66</sup>

- Koha kur ndodh FGM/C - o - 15 vjeç. Viktima/e mbijetuara nuk mban mend nëse, ose kur ka ndodhur FGM/C, dhe ekziston gjithashtu problemi i shtuar i datimit të plagëve me gjurmë;
- Përfshirja e nënave dhe të afërmeve të tjerë femra ndonjëherë ndikon në vendimmarrjen e viktimave/të mbijetuarve në lidhje me policinë, prokurorët dhe autoritetet e tjera me familjen;

- Për një viktimë/të mbijetuar që përfshin aktivisht policinë ose autoritetet e tjera, kjo mund të çojë në izolim komunitar dhe social;
- Viktimat/të mbijetuarat që nuk dëshirojnë të kriminalizojnë ose demonizojnë fenë e tyre. Megjithatë asnjë shkrim fetar nuk e përshkruan praktikën, praktikuesit shpesh besojnë se praktika ka mbështetje fetare;
- Strukturat lokale të pushtetit dhe autoritetit, të tillë si udhëheqësit e komunitetit, udhëheqësit tradicionalë dhe të bazuar në besim, rrethprerësit, madje edhe disa personel mjekësor mund të kontribuojnë në ruajtjen e praktikës, e cila shton presionet me të cilat përballen viktimat/të mbijetuarat.

Faktorët e mësipërm nxjerrin në pah rëndësinë e menaxherëve të mesëm të policisë dhe të tjerëve që punojnë në partneritet dhe krijojnë marrëveshje partneriteti me anëtarët e komunitetit, udhëheqësit e komunitetit, avokatët, udhëheqësit tradicionalë dhe të bazuar në besim, prokurorët, profesionistët e kujdesit shëndetësor dhe social. Komunikimi dhe angazhimi me komunitetet e prekura dhe me profesionistë të tjerë është thelbësor për rritjen e ndërgjegjësimit dhe krijimin e besimit dhe besimit për të ndërmarrë veprime pozitive për të raportuar rastet e FGM dhe për të parandaluar që kjo të ndodhë në shkallën e parë.

Është roli i menaxhereve të mesëm të policisë që të:

- Negociojnë dhe të ndikojnë me organizatat dhe partnerët e tjerë në zhvillimin e protokolleve p.sh. hetimi dhe ndjekja penale, marrëveshjet për ndarjen (shkëmbimin) e informacionit (MNI) etj.;
- Informojnë udhëheqjen e organizatës së tyre për aranzhimet;
- Komunikojnë dhe rrisin ndërgjegjësimin për gamën e protokolleve dhe marrëveshjeve me oficerët dhe stafin e tyre;
- Sigurojnë burime për të mundësuar që protokollet dhe MNI-të të ndodhin në mënyrë efektive;
- Sigurojnë që protokollet dhe MNI-të të zbatohen në mënyrë efektive.

64 Ibid.

65 Ibid.

66 Ibid.

## Praktikë e mirë në partneritet që funksionon në hetimin dhe ndjekjen penale të praktikave të dëmshme

Shembujt kryesorë të marrëveshjeve të partneritetit në hetimin e abuzimit të bazuar në nderin, martesën e detyruar dhe gjymtimin gjenital femëror që të çohen përpara nga menaxherët e mesëm të policisë gjenden në udhëzimet e Këshillit Kombëtar të Shefave të Policisë të MB-se (KKShP)<sup>67</sup> dhe Shërbimit të Prokurorisë së Kurorës (ShPK) [Angli dhe Uells],<sup>68</sup> të cilat përfshijnë protokollet e mëposhtëm për hetim dhe ndjekje penale:

### (1) Protokoll i Hetimit dhe Ndjekjes Penale i KKShP dhe ShPK GjGjF

- Protokoll për trajtimin e veprave penale të Gjymtimit Gjenital të Femrave (GjGjF) midis Këshillit Kombëtar të Shefave të Policisë dhe Shërbimit të Prokurorisë së Kurorës.<sup>69</sup>

### (2) Protokoll i KKShP-se dhe ShPK-se për Hetimin dhe Ndjekjen Penale të Abuzimit të Bazuar në Nderin dhe Martesën e Detyruar

- Protokoll për trajtimin e “të ashtuquajturës” dhunës/abuzimit të bazuar në nderin dhe veprat e martesës së detyruar midis Këshillit Kombëtar të Shefave të Policisë dhe Shërbimit të Prokurorisë së Kurorës.<sup>70</sup>
- Abuzimi me bazë nderi, Martesa e Detyruar dhe Gjymtimi Gjenital Femëror; Strategji e Politikës për Anglinë, Uellsin dhe Irlandën e Veriut - Çrrënjësja e Abuzimit të Bazuar në Nder, Martesës së Detyruar dhe Gjymtimi Gjenital Femëror Së bashku.<sup>71</sup>

## Kutia 19

### Praktikë e mirë në hetimet individuale të Praktikave të Dëmshme

Më poshtë janë disa ‘Bëj-at dhe Mos-at’ në hetimin e praktikave të dëmshme, që menaxherët e mesëm të policisë të miratojnë, promovojnë dhe përforcojnë me reaguesit dhe hetuesit e vijës së parë.

Fushat e mëposhtme rrjedhin nga praktika e mirë:

BEJ-at	MOS-at
Mbroni viktimën/të mbijetuarën dhe parandaloni kryerjen e krimeve të tjera	Bëni gjykime subjektive për viktimën/të mbijetuarën, stilin e jetës së saj/tij, kulturën ose fenë/besimin, etj.,
Sigurojeni dhe empatizoni me viktimën/të mbijetuarën	Intervistoni viktimën/të mbijetuarën në prani të autorëve dhe dëshmitarëve. Në vendin e ngjarjes, ndani palët - viktimën/të mbijetuarën, dëshmitarët dhe autorin(ët)
Mbroni, ruani dhe siguroni vendet e krimit dhe dëshmitë e dëshmitarëve për të maksimizuar rikuperimin e provave	Mos bëni asgjë
Menaxhoni rastin në mënyrë profesionale, të ndjeshme dhe me konfidencialitet	Afrohuni familjes së viktimës/të mbijetuarës ose kërkoni që të përfshihen në çdo formë të ndërmjetësimit (pasi kjo mund të ofrojë një rrezik të shtuar)

67 Këshilli i Shefave të Policisë Kombëtare (MB), shih: <https://www.npcc.police.uk>

68 Shërbimi i Prokurorisë së Kurorës (MB), shih: <https://www.cps.gov.uk>

69 Protokoll për trajtimin e veprave të Gjymtimit Gjenital të Femrave (FGM) midis Këshillit të Shefave të Policisë Kombëtare dhe Shërbimit të Prokurorisë së Kurorës (2016), Këshilli i Shefave të Policisë Kombëtare (MB).

70 Ibid.

71 ‘Abuzimi me bazë nderi, Martesa e Detyruar dhe Gjymtimi Gjenital i Femrave: Strategji e Punës Policore për Anglinë, Uellsin dhe Irlandën Veriore - Çrrënjësja e Abuzimit të Bazuar në Nder, Martesës së Detyruar dhe Gjymtimi Gjenital Femëror Së bashku’, Këshilli i Shefave të Policisë Kombëtare (MB).

BEJ-at	MOS-at
Rishikoni çështjet e vlerësimit të rrezikut dhe menaxhimit që prekin viktimën/të mbijetuarin dhe njerëzit e tjerë p.sh. fëmijë, të rritur të prekshëm dhe njerëz që kanë qenë duke e mbështetur viktimën/të mbijetuarën. Zhvilloni një plan të menaxhimit të rrezikut ose sigurisë, i cili përfshin një plan shpëtimi dhe metoda të sigurt kontakti	Zbuloni detajet e rastit kujtdo jashtë hetimit ose “rrethit të besimit”. Rrethi i besimit do të përfshinte IDVA, specialistë të rasteve - JO këshilltari lokal, kryetar komune, udhëheqës komuniteti, politikan i zgjedhur dhe njerëz të tjerë në jetën publike dhe/ose pozita e autoriteti.
Trajtoni, ruani dhe transferoni të dhënat personale të viktimës/të mbijetuarës me kujdes dhe konfidencialitet	deklaroni kurrë se dhuna ndaj grave dhe vajzave NUK është punë për shërbimin policor
Menaxhoni rastin në bazë të “nevojës për të ditur”	përdorni kurrë një anëtar të familjes (veçanërisht një fëmijë), anëtar të komunitetit, mik apo ndonjë person tjetër të paautorizuar për të përkthyer
Sigurojeni dhe mbështesni viktimën/të mbijetuarën duke siguruar që të ofrohen përditësime në kohë dhe të rregullta, duke përdorur metodën e preferuar të kontaktit të viktimës/të mbijetuarës	Bëni kontakte të drejtpërdrejta me agjencitë e huaja të zbatimit të ligjit ose zyrtarë qeveritarë kur ndodh një vepër në një juridiksion të huaj. Bëni këtë vetëm duke përdorur burime të besuara dhe procese autorizimi
Jini të singertë, të hapur dhe transparentë me viktimën / të mbijetuarën	Vendosni barrën mbi viktimën/të mbijetuarën për të mbrojtur atë ose fëmijët e saj pa mbështetjen e policisë, agjencive të tjera të zbatimit të ligjit ose organizatave mbështetëse të specializuara
Siguroni mundësinë e qasjes së plotë të shërbimeve tuaja dhe mundësoni praktika gjithëpërfshirëse gjatë menaxhimit të rasteve	
Sigurohuni që menaxheri të informohet për të ofruar këshilla, udhëzime dhe mbështetje të burimeve, p.sh. Këshilltar Taktik, Zyrtar për Ndërlidhje me Familjen, Këshilltar i Intervistave, Menaxher i Mjekësisë Ligjore (në varësi të seriozitetit dhe kompleksitetit të veprës)	
Rishikoni veprimet e reaguesit të parë. Nëse infrastruktura mbështet - merrni gjurmët e gishtërinjve, ADN -në dhe një fotografi nga viktimat/e mbijetuara me pëlqimin e informuar dhe krijoni një pemë familjare	
Drejtojini viktimën/të mbijetuarën në organizate e shoqërisë civile e besuar nga ana kulturore	
Referojini rastin në njësi të specializuar të hetimit të policisë dhe/ose prokurorit specialist	
Merrni parasysh përdorimin e ekspertëve kulturorë dhe të tjerë për të këshilluar gjatë hetimit. Gjithmonë ushtroni kujdesin e duhur në kontrollimin e kredencialeve të ekspertëve dhe përkthyesve të punësuar	
<ul style="list-style-type: none"> <li>sigurohuni që përdorni ekspertin e duhur për arsyen e duhur</li> </ul>	
Zhvilloni një kuadër këshilltarësh policorë specialistë për të këshilluar mbi qasjet strategjike dhe/ose operacionale për të trajtuar abuzimin me bazë gjinore	
Drejtoni dhe zhvilloni sesione të përbashkëta trajnimi me reaguesit e parë të policisë/hetuesit fillestarë, hetimet e specializuara dhe oficerët e tyre mbikëqyrës, në mënyrë që të gjithë të dinë se si ata përshtaten në modelin e reagimit dhe hetimit.	
Zgjeroni këto sesione trajnimi për partnerë me shumë agjenci.	



## SHËNIME DHE LEXIMI I SUGJERUAR

1. Procesi i Hetimit (Kolegji i Punës Policore), shih: <https://www.app.college.police.uk/app-content/investigations/investigation-process/>
2. Huhtanen, H., Lonsway, K.A., Archambault, J. (2017), 'Njëanshmëria Gjinore në Reagimin dhe Hetimin e Sulmeve Seksuale. Seria e Buletinit të Trajnimit: Pjesa 1', End Violence Against Women International (EVAWI).
3. Puna Policore e paanshme (Qeveria Provinciale e Kolumbisë Britanike), shih: <https://engage.gov.bc.ca/unbiasedpolicing/work-to-date/>
4. Malcolm K. Sparrow (2015), 'Matja e Performancës në një Organizatë Policore Moderne në Perspektiva të Reja në Punën Policore' (Instituti Kombëtar i Drejtësisë), shih: <https://www.ncjrs.gov/pdffiles1/nij/248476.pdf>
5. Erin Gallagher, Planifikimi i Hetimeve SGBV (2015), Instituti për Hetimet Penale Ndërkombëtare (IICI) dhe Reagimi i Shpejtë i Drejtësisë.
6. Nathan Birdsall, Stuart Kirby & Michelle McManus (2017), 'Angazhimi policor-viktimë në ndërtimin e një qasjeje për fuqizimin e viktimave në rastet e dhunës së partnerëve intim', *Praktika dhe Kërkime Policore*, 18:1, 75-86, DOI: 10.1080/15614263.2016.1230061
7. Programi i Trajnimit mbi Trajtimin e Fëmijëve Viktima / të mbijetuar dhe Fëmijë Dëshmitarë të Krimin për Zyrtarët e Zbatimit të Ligjit (UNODC, 2015), shih: [https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/Training\\_Programme\\_on\\_the\\_Treatment\\_of\\_Child\\_Victim/survivors\\_and\\_Child\\_Witnesses\\_of\\_Crime\\_-\\_Law\\_Enforcement.pdf](https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/Training_Programme_on_the_Treatment_of_Child_Victim/survivors_and_Child_Witnesses_of_Crime_-_Law_Enforcement.pdf)
8. Kutia e veglave gjinore të Policisë së Kombeve të Bashkuara (KB. Departamenti i Operacioneve të Paqes - DOP/DPET/Shërbimi i Trajnimit të Integruar, 2015).
9. 'Doracak për Reagimin e Policisë ndaj Dhunës në Familje: Promovimi i Komuniteteve më të Sigurta duke Integruar Kërkimin dhe Praktikën', shih: [https://www.lfcc.on.ca/publication/handbook-for-police-responding-to-domestic-violence-2004/a-handbook-for-police-responding-to-domestic-violence\\_-\\_promoting-safer-communities-by-integrating-research\\_-\\_practice\\_toc/](https://www.lfcc.on.ca/publication/handbook-for-police-responding-to-domestic-violence-2004/a-handbook-for-police-responding-to-domestic-violence_-_promoting-safer-communities-by-integrating-research_-_practice_toc/)
10. Programi i Trajnimit mbi Trajtimin e Fëmijëve Viktima/ të mbijetuar dhe Fëmijë Dëshmitarë të Krimin (UNODC, 2015), shih: <file:///C:/Users/User/Documents/UNWomenGVA/Resources/Secondary/2015%20UNODC%20UNICEF%20Training%20Programme%20Treatment%20of%20Child%20Victim/survivors%20and%20Child%20Witnesses.pdf>
11. Manuali i Trajnimit për Programin e Forcimit të Oficerëve të Policisë për Sigurinë e Grupeve të Cënueshme, (UNODC në partneritet me Qeverinë e Meksikës, 2017), shih: [http://www.policia-mas.org/manuales/Manual\\_Policias\\_INGLES\\_PREVIO\\_090817.pdf](http://www.policia-mas.org/manuales/Manual_Policias_INGLES_PREVIO_090817.pdf)
12. Udhëzimet e OBSH-së për Kujdesin Mjekësor-Ligjor për Viktimat/të Mbijetuarat e Dhunës Seksuale (2003), shih: [https://www.who.int/violence\\_injury\\_prevention/publications/violence/med\\_leg\\_guidelines/en/](https://www.who.int/violence_injury_prevention/publications/violence/med_leg_guidelines/en/)
13. Roberts, Campbell dhe Lloyd, 'Dhuna e Bazuar në Nderin: Puna Policore dhe Parandalimi' CRC Press (Taylor dhe Francis Group), 2013
14. Politika e Reagimit ndaj Sulmeve Seksuale dhe Udhëzime për Përmbajtjen e Trajnimit. Shoqata Ndërkombëtare e Shefave të Policisë (2015), Nisma Kombëtare e Lidershit për Zbatimin e Ligjit mbi Dhunën ndaj Grave <https://www.theiacp.org/resources/sexual-assault-response-policy-and-training-content-guidelines>
15. Udhëzimet për Kujdesin Mjekësor-Ligjor për Viktimat/ të Mbijetuarat e Dhunës Seksuale (Organizata Botërore e Shëndetit (2003), shih: [https://www.who.int/violence\\_injury\\_prevention/publications/violence/med\\_leg\\_guidelines/en/](https://www.who.int/violence_injury_prevention/publications/violence/med_leg_guidelines/en/)
16. Programi i Trajnimit mbi Trajtimin e Fëmijëve Viktima/ të mbijetuar dhe Fëmijë Dëshmitarë të Krimin për Zyrtarët e Zbatimit të Ligjit (UNODC, 2015), shih: [https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/Training\\_Programme\\_on\\_the\\_Treatment\\_of\\_Child\\_Victim/survivors\\_and\\_Child\\_Witnesses\\_of\\_Crime\\_-\\_Law\\_Enforcement.pdf](https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/Training_Programme_on_the_Treatment_of_Child_Victim/survivors_and_Child_Witnesses_of_Crime_-_Law_Enforcement.pdf)
17. 'Mos bëj dëm' (UN Women, 2010), shih: <https://end-violence.org/en/articles/200-do-no-harm.html>
18. 'Paketa e Burimeve të Dhunës me bazë Gjinore - Mjeti i Standardizuar Trajnimi për Bartësit e Detyrës, Palët e Interesuara dhe Mbajtësit e të Drejtave (UN Women, 2019)
19. Lisa Adams dhe Yumi Sera, 'Udhëzimet Gjinore' (2018), Fondi për të Drejtat e Aftësisë së Kufizuar dhe Fondi i Mbrojtjes së të Drejtave të Aftësisë së Kufizuar, shih: <http://disabilityrightsfund.org/wp-content/uploads/DRF-DRAF-Gender-Guidelines-Print.pdf>
20. 'Më shumë sesa thjesht një devijim: Udhëzues për Refugjatët e Grave për të zhvilluar Planet e Veprimt të Aktit të Diskriminimit të Aftësisë së Kufizuar' (2007), Gratë me Aftësi të Kufizuara Australi (WWDA), shih: [http://wwda.org.au/wp-content/uploads/2013/12/More\\_Than\\_Just\\_A\\_Ramp.pdf](http://wwda.org.au/wp-content/uploads/2013/12/More_Than_Just_A_Ramp.pdf)

21. KB, Fleta e Fakteve Nr.23, mbi Praktikrat e Dëmshme Tradicionale që Ndikojnë në Shëndetin e Grave dhe Fëmijëve, e qasur përmes <https://www.ohchr.org/Documents/Publications/FactSheet23en.pdf>
22. Parashtrimi që Thekson Praktikrat e Dëmshme që Synojnë Personat me Aftësi të Kufizuara, dhe veçanërisht Gratë dhe Vajzat me Aftësi të Kufizuara, Aleanca Ndërkombëtare e Aftësisë së Kufizuar (2017), shih: <http://www.internationaldisabilityalliance.org/resources/submission-highlighting-harmful-practices-targeted-persons-disabilities-and-particular>
23. Nathan Birdsall, Stuart Kirby & Michelle McManus (2017), 'Angazhimi Polici - viktimë në ndërtimin e një qasjeje për fuqizimin e viktimave në rastet e dhunës nga partneri intim', *Praktika dhe Kërkimi i Policisë*, 18:1, 75-86, DOI: 10.1080/15614263.2016.1230061.
24. Ellison, L. (2002), 'Ndjekja penale e dhunës në familje pa pjesëmarrjen e viktimave', *Modern Law Review*, 65, 834-858
25. Vandello, J. A. & Cohen, D., 'Nderi mashkullor dhe besnikëria femërore: Skriptet e nënkuptuara kulturore që përjetësojnë dhunën në familje', [2003] *Gazeta e Personalitetit dhe Psikologjisë Sociale* 84 në f. 997.
26. Julian Pitt-Rivers, "Nderi dhe Statusi Social," në *Nder dhe Turp: Vlerat e Shoqërisë Mesdhetare* (ed. J. G. Peristiany, Weidenfeld dhe Nicolson, 1965), f 21.
27. Lajmet e OKB -së (4 Mars 2010) qasja nëpërmjet <https://news.un.org/en/story/2010/03/331422>
28. Studimi Global mbi Vrasjet, Vrasja e grave dhe vajzave lidhur me gjininë (UNODC, 2018), e qasur përmes [https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/GSH2018/GSH18\\_Gender-related\\_killing\\_of\\_women\\_and\\_girls.pdf](https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/GSH2018/GSH18_Gender-related_killing_of_women_and_girls.pdf) p.31.
29. Studimi i thelluar i Sekretarit të Përgjithshëm të KB-së për të gjitha format e dhunës ndaj grave, A/61/122/Add.1 (2006), para 65, f27.
30. Studimi i thelluar i Sekretarit të Përgjithshëm të KB-së për të gjitha format e dhunës ndaj grave, A/61/122/Add.1 (2006), para 1, fg.
31. Fleta e Fakteve e KB-se Nr. 23 mbi Praktikrat e Dëmshme Tradicionale që Ndikojnë në Shëndetin e Grave dhe Fëmijëve, e qasur përmes <https://www.ohchr.org/Documents/Publications/FactSheet23en.pdf>
32. Parashtrimi që Thekson Praktikrat e Dëmshme që Synojnë Personat me Aftësi të Kufizuara, dhe Veçanërisht Gratë dhe Vajzat me Aftësi të Kufizuara (Aleanca Ndërkombëtare e Aftësisë së Kufizuar, 2017).
33. Udhëzimet e praktikës së shumë agjencive të Qeverisë HM, Trajtimi i rasteve të Martesës së Detyruar (qershor 2014)
34. GirlsNotBrides, qasur përmes <https://www.girlsnotbrides.org/700-million-women-married-children-reveals-new-unicef-data/>
35. Organizata Botërore e Shëndetit (OBSh), Adolehentët: rreziqet dhe zgjidhjet shëndetësore, 13 Dhjetor 2018 e qasur përmes <https://www.who.int/en/news-room/fact-sheets/detail/adolescents-health-risks-and-solutions>
36. 115 milion djem dhe burra në të gjithë botën u martuan si fëmijë - UNICEF Mbretëria e Bashkuar, e qasur përmes <https://www.unicef.org.uk/press-releases/115-million-boys-and-men-around-the-world-married-as-children-unicef/>
37. Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, e qasur përmes [https://downloads.unicef.org.uk/wp-content/uploads/2010/05/UNCRC\\_PRESS200910web.pdf?\\_ga=2.16687990.170076905.1577836147-1551955756.1577836147](https://downloads.unicef.org.uk/wp-content/uploads/2010/05/UNCRC_PRESS200910web.pdf?_ga=2.16687990.170076905.1577836147-1551955756.1577836147)
38. Udhëzimet e praktikës së shumë agjencive të Qeverisë HM, Trajtimi i rasteve të Martesës së Detyruar, f.16, Qershor 2014, e qasur përmes [https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment\\_data/file/322307/HMG\\_MULTI\\_AGENCY\\_PRACTICE\\_GUIDELINES\\_v1\\_180614\\_FINAL.pdf](https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/322307/HMG_MULTI_AGENCY_PRACTICE_GUIDELINES_v1_180614_FINAL.pdf)
39. Fondacioni Thomson Reuters dhe 28TooMany, "Ligji dhe FGM, Një përmbledhje e 28 Vendeve Afrikane" (shtator 2018) e qasur përmes [https://www.28toomany.org/static/media/uploads/Law%20Reports/the\\_law\\_and\\_fgm\\_v1\\_\(september\\_2018\).pdf](https://www.28toomany.org/static/media/uploads/Law%20Reports/the_law_and_fgm_v1_(september_2018).pdf)
40. Organizata Botërore e Shëndetit (OBSh), Fletë Fakti mbi Gjymtimin gjenital të Femrës, 31 Janar 2018, qasur përmes <https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/female-genital-mutilation>
41. Këshilli i Shefave të Policisë Kombëtare (MB), shih: <https://www.npcc.police.uk>
42. Shërbimi i Prokurorisë së Kurorës (MB), shih: <https://www.cps.gov.uk>
43. Protokollin midis Këshillit të Shefave të Policisë Kombëtare dhe Shërbimit të Prokurorisë së Kurorës (Këshilli i Shefave të Policisë Kombëtare në Mbretërinë e Bashkuar) për trajtimin e veprave të Gjymtimit Gjenital të Femrave (FGM), shih: [https://www.cps.gov.uk/sites/default/files/documents/legal\\_guidance/hbv\\_and\\_fm\\_protocol\\_nov\\_16.pdf](https://www.cps.gov.uk/sites/default/files/documents/legal_guidance/hbv_and_fm_protocol_nov_16.pdf)
44. 'Abuzimi me Bazë Nderi, Martesa e Detyruar dhe Gjymtimi Gjenital i Femrave: Strategjia e Punës Policore për Anglinë, Uellsin dhe Irlandën e Veriut - Çrrenjosja e Abuzimit të Bazuar në Nder, Martesa e Detyruar dhe Gjymtimi Gjenital Femëror Së bashku' (Këshilli i Shefave të Policisë Kombëtare në Mbretërinë e Bashkuar), shih: <https://www.npcc.police.uk/Publication/Final%20NPCC%20HBA%20strate-gy%202015%202018December%202015.pdf>



## SIGURIA DHE MBROJTJA

*“Dhuna nga partneri intim (IPV) është forma më e zakonshme e dhunës ndaj grave në nivel global, me pasoja të mëdha shëndetësore për gratë dhe kosto të konsiderueshme sociale dhe ekonomike për familjet, komunitetet dhe qeveritë.”*

**Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, 2006**

---

# QËLLIMI I KAPITULLIT

---

**Policia ka fuqizuar viktimat/të mbijetuarit e VAWG që të vazhdojnë qasjen e tyre në drejtësi duke siguruar në mënyrë efektive masat e mirë-informuara të mbrojtjes të cilat janë në dispozicion dhe të pavarura nga çdo inicim i një çështjeje penale, civile ose familjare dhe u mundëson atyre të qëndrojnë të sigurt duke qenë të angazhuar në procesin e drejtësisë.**

---

## **Porositë Kryesore dhe Pikat e të Mësuarit:**

- IPV përfaqëson një komponent thelbësor të punës të policisë dhe, si i tillë, të gjithë oficerët që përgjigjen duhet të jenë kompetent në zbatimin e parimit 'mos bëj dëm';
- Siguria dhe mbrojtja e viktimave/të mbijetuarve duhet të jetë kryesore në vendim-marrje;
- Vlerësimi i rrezikut, planifikimi dhe rishikimi i sigurisë duhet të jetë një proces i vazhdueshëm që nga koha kur viktimat/i mbijetuarit përfshihen në procesin e drejtësisë;
- Planet e sigurisë janë mjete parandaluese, nuk janë parashikuese, e të cilat duhet të zhvillohen së bashku me viktimën/të mbijetuarin, prandaj ato janë specifike për rrethanat;
- Masat mbrojtëse duhet të monitorohen dhe zbatohen në mënyrë proporcionale me kërcënimin dhe për të siguruar fuqizimin e viktimës/të mbijetuarit;
- Rishikimet ose vlerësimet e mjeteve të vlerësimit të rrezikut janë kritike për identifikimin e nënformancës dhe promovimin e profesionalizimit;
- Aftësitë dhe kompetencat e buta që pasqyrojnë dëgjimin aktiv, veprimin në mënyrë jo-gjyquese dhe respektimin e dinjitetit të të tjerëve kontribuojnë për policimin e suksesshëm;
- Lidhshmëria e natyrës joproporcionale të akteve të veçanta të dhunës dhe diskriminimit me mjedisin kontekstual është thelbësore për zbatimin e masave mbrojtëse.





# PREZANTIMI

Strategjitë Model të Përditësuar dhe Masat Praktike për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave në Fushën e Parandalimit të Krimit dhe Drejtësisë Penale të vitit 2010 kërkon që zyrtarët e drejtësisë penale, si policia dhe avokatët e viktimave/të mbijetuarve, të bëjnë vlerësimin e rrezikut të cilat e paraqesim nivelin ose shkallën e dëmit që viktimat/të mbijetuarit mund t'i nënshtrohen, bazuar në pozitën e tyre të cenueshmërisë, kërcënimet ndaj të cilave ata janë të ekspozuar, praninë e armëve dhe faktorëve të tjerë përcaktues.

Foto e çastit UN Women/ Jashim Salam (Bangladesh)

Në këtë masë, Komisioni i KB për Parandalimin e Krimit nxjerr në pah disa faktorë rreziku që mund të lidhen me dhunën në bazë gjinore ('DhBGJ').<sup>1</sup>

**“Dhuna në bazë gjinore ose DhBGJ është një term ombrellë për secilin veprim të dëmshëm që kryhet kundër vullnetit të një personi dhe që bazohet në dallimet shoqërore (gjinore) ndërmjet femrave dhe meshkujve. Natyra dhe shtrirja e llojeve të veçanta të GBV ndryshojnë në kultura, vende dhe rajone.”**

Burimi: UNICEF, UNFPA, UNDP, UN Women

Këto përfshijnë analfabetizmin; pabarazitë ekonomike; normat kulturore dhe praktikat socio-zakonore;

<sup>1</sup> Shembuj të dhunës në bazë gjinore përfshijnë: dhunën seksuale, përfshirë shfrytëzimin/abuzimin seksual dhe prostitucionin e detyruar; dhunën në familje; trafikimin e grave dhe vajzave; praktikat e dëmshme të si gjymtimi/prerja gjenitale femërore; Vrasjet 'për nder'; dhe fëmijë, martesën e hershme dhe të detyruar.

mungesën e qasjes të grave në shtëpi të sigurta dhe të përbalueshme dhe trashëgiminë e pronës; mungesën apo joefektivitetin e shërbimeve dhe burimeve për gratë; mungesën apo joefektivitetin e politikave të barazisë gjinore; normat shoqërore të cilat e mbështesin dhunën, pabarazinë gjinore dhe të drejtën e meshkujve; sanksionet e dobëta të komunitetit ndaj dhunës; një sistem joefektiv të drejtësisë; infrastrukturë të dobët urbane; dhe abuzimin me alkool dhe drogë.<sup>2</sup>

Faktorë të tjerë i përfshijnë format diskriminuese institucionale dhe/ose të pranura shoqërisht në bazë të përkatësisë etnike, orientimit seksual, origjinës kombëtare dhe/ose paaftësisë që i vendosin gratë dhe vajzat në pozita të cenueshmërisë lartë.

<sup>2</sup> Shih UN-HABITAT dhe Komisionin Huairou, 'Vlerësimi Global mbi Sigurinë e Grave. Rezultatet e Anketës Preliminare', draft dokumenti i punës, shtator 2007, f. 8. në Aspektet e Dhunës ndaj Grave që i përkasin drejtpërdrejtë Komisionit për Parandalimin e Krimit dhe Drejtësisë Penale (Komisioni për Parandalimin e Krimit dhe Drejtësisë Penale V.08-52191 (E) \* o852191 \* Mbledhja e Shtatëmbëdhjetë) Vjenë, 14-18 prill 2008.

Kapitulli vijues do t'i përqendrojë elementet kryesore të masave mbrojtëse të kërkuara në një ndërhyrje efektive dhe adekuate të policisë në DHGV kur kryerësi i pretenduar është i njohur në një farë mase për viktimën/të mbijetuarin dhe/ose policinë.

Varësisht nga korniza ligjore vendore, policia do të ketë mjete dhe procedura të ndryshme të cilat mund t'i përdorë gjatë ndërhyrjes për të mbrojtur në rastet e DHGV, siç është kompetenca për të lëshuar urdhra për ndërhyrje ose për mbrojtje në emër të viktimave/të mbijetuarve. Zbatimi proaktiv i mjeteve dhe procedurave të tilla mund të bëjë një ndryshim thelbësor për gratë dhe vajzat që kërkojnë mbrojtje.

Një rishikim kombëtar nga Departamenti i Shërbimeve Sociale i Qeverisë Australiane se si shërbimet thelbësore po i mbanin përgjegjës kryerësit në të gjitha sistemet, theksoi se kompetenca e policisë për të lëshuar urdhra për ndërhyrje në emër të viktimave/të mbijetuarve është e një rëndësie thelbësore. Departamenti pranoi nevojën për t'i mbrojtur gratë dhe fëmijët e tyre nga dëmtimet e mëtejme që burojnë nga aplikimi i vetë urdhrave për ndërhyrje, si hakmarrja nga kryerësit, dhe për të zvogëluar barrën dhe përgjegjësinë mbi viktimat/të mbijetuarit për t'u vetë-mbrojtur.<sup>3</sup> Si rezultat, raporti i përcaktoi standardet e mëposhtme për t'i aplikuar masat e mbrojtjes dhe sigurisë të zbatuara nga ofruesit e shërbimeve thelbësore:<sup>4</sup>

- Siguria e grave dhe fëmijëve të tyre duhet të jetë në thelb të të gjitha ndërhyrjeve të kryerësve;
- Kryerësit t'i marrin ndërhyrjet e duhura në kohën e duhur;
- Kryerësit të përballen me drejtësinë dhe pasojat ligjore kur kryejnë dhunë;
- Kryerësit marrin pjesë në programe dhe shërbime që u mundësojnë atyre t'i ndryshojnë sjelljet dhe qëndrimet e tyre të dhunshme;

3 Shih Standardet Kombëtare të Rezultateve për Ndërhyrjet e Kryerësit ose Raportin Bazë të NOSPI (2015-2016), (Departamenti Australian për Shkenca Shoqërore, 2017), në: [https://plan4womenssafety.dss.gov.au/wp-content/uploads/2015/04/nospi\\_coag\\_paper.pdf](https://plan4womenssafety.dss.gov.au/wp-content/uploads/2015/04/nospi_coag_paper.pdf)

4 *Ibid.*

- Ndërhyrjet e kryerësve nxiten me dëshmi të besueshme për t'u përmirësuar vazhdimisht;
- Personat të cilët punojnë në sistemet e ndërhyrjes të kryerësit janë të aftësuar për t'iu përgjigjur dinamikës dhe ndikimeve të dhunës në familje dhe dhunës seksuale.

Ky kapitull do të përqendrohet në promovimin e atyre standardeve të rishikimeve të sponsorizuara nga qeveria, së bashku me parimet kryesore mbi masat e mbrojtjes të policisë siç paraqitet në ESP, në mënyrë që ato të mund të hartohen posaçërisht për secilën viktimë/të mbijetuar dhe t'u japin atyre një ndjenjë kontrolli mbi procesin.

**Është e rëndësishme të theksohet se policia duhet t'i sigurojë në mënyrë të barabartë masat mbrojtëse për viktimat/të mbijetuarat e DHGV që zgjedhin të mos shkojnë përmes sistemit të drejtësisë.**

Përveç këtij kapitulli, policisë i rekomandohet që ta shqyrtojë *Nenin 8: Siguria dhe Mbrojtja e Modullit 3: Drejtësia dhe Policimi i ESP*.

Ky kapitull mbi sigurinë dhe mbrojtjen është unik nga të tjerët pasi që do të fokusohet kryesisht në rastet e Dhunës të Partnerëve Intim ("IPV") ku, në shumicën dërrmuese të rasteve, kryerësi i pretenduar i dhunës tanimë është i njohur ose është bërë i njohur për viktimën/të mbijetuarin si rezultat drejtpërdrejtë i veprimit. ESP përshkruan IPV-në si:

“formën më të zakonshme të dhunës të përjetuar nga gratë në nivel global.... dhe përfshin një sërë aktesh detyruese seksuale, psikologjike dhe fizike të përdorura ndaj grave të rritura dhe adoleshente nga një partner aktual ose ish partner intim, pa pëlqimin e saj. Dhuna fizike përfshin përdorimin e qëllimshëm të forcës fizike, forcës ose armës për ta dëmtuar ose lënduar gruan. Dhuna seksuale përfshin kontakt seksual abuziv, duke e bërë një grua të përfshihet në një akt seksual pa pëlqimin e saj, dhe tentuar ose kryer akte seksuale me një grua të sëmurë, me aftësi të kufizuara, nën presion



## Konfidencialiteti

ose nën ndikimin e alkoolit ose substancave të tjera. Dhuna psikologjike përfshin kontrollin ose izolimin e gruas dhe poshtërimin ose turpërimin e saj. Dhuna ekonomike përfshin mohimin e një gruaje në qasje dhe kontroll mbi burimet bazë.”<sup>5</sup> Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së (2006).


IPV përfaqëson një komponent thelbësor të punës të oficerëve që përgjigjen dhe, si i tillë, të gjithë policët që përgjigjen duhet të jenë kompetent në zbatimin e **parimit të mos-dëmtimit** i cili fillon me respektimin e të drejtave të viktimës/të mbijetuarit, duke përfshirë privatësinë e saj dhe nevojën për konfidencialitet<sup>6</sup>. “Mos dëmto” mund të kuptohet gjithashtu se do të thotë që ndërhyrjet nuk duhet të përshkallëzojnë situatën ose problemin që është në shqyrtim dhe nuk duhet të paraqesin rrezik për familjet dhe komunitetet në fjalë<sup>7</sup>. Mbajtja e të gjitha bisedave, vlerësimeve dhe intervistave me viktimat/të mbijetuarit në një mjedis të sigurt është një shembull i pajtueshmërisë me parimin e të bërit asnjë dëm.

5 Raport i Sekretarit të Përgjithshëm, studim i thellë mbi të gjitha format e dhunës ndaj grave, Kombet e Bashkuara, A/61/122/Shtojc.1, (6 korrik 2006) para. 111- 112.

6 Ekzistojnë përjashtime të mundshme nga parimi i konfidencialitetit. *Pakoja Gjinore* e UNPOL-it jep shembuj, përfshirë dyshimin për abuzim ose neglizhencë ndaj fëmijëve, situata kërcënuese për jetën, dyshime për tendenca vetëvrasëse ose kërcënim serioz për dëmtim të të tjerëve. Sipas UNPOL, në raste të tilla, policia mund të veprojë nëse ka arsye të bazuar për t'i dëshmuar këto situata dhe të kërkojë këshilla nga punonjësit e kujdesit shëndetësor dhe këshilltarët. Shih: *Pakon Gjinore të Policisë të OKB (OKB Departamenti i Operacioneve të Paqes - DPO/ DPET/ Shërbimi i Trajnimit të Integruar, 2015).*

7 *Pakoja Gjinore e një Praktikanti mbi Programimin e Qasjes të Grave në Drejtësi (UN Women et al., 2018).*

*Siguria e Grave të OKB -së, Pëlqimi dhe trekëndëshi Konfidencial (më poshtë)* është një ilustrim i mirë që duhet marrë parasysh kur kërkoni të siguron siguri dhe mbrojtje për një viktimë/të mbijetuar të DHGV. Trekëndëshi i promovon autoritetet si akterë kryesorë për t'i mbrojtur gratë dhe vajzat të cilat përjetojnë dhunë në shtëpi; duke theksuar rëndësinë e kërkimit të pëlqimit të tyre para se të ndërmarrin veprime dhe të ruajnë konfidencialitetin e identitetit dhe përvojave të tyre. Është thelbësore që ata të veprojnë vetëm me lejen e tyre, përveç nëse jeta iu rrezikohet.



## UDHËZIMET E BASHKË-VEPRUESVE

Policia është një partner kyç brenda sistemit të drejtësisë kur bëhet fjalë për sigurimin dhe mbrojtjen fillestare dhe të vazhdueshme të viktimave/të mbijetuarve, kështu që ju keni një rol jetik për të luajtur në punën me agjencitë e tjera dhe ofruesit e shërbimeve.

Duke bashkëpunuar me partnerë të tjerë, roli juaj në hetimin e krimeve të DHGV do të fuqizohet dhe mbështetet, ndërsa viktimat/të mbijetuarit do të marrin siguri dhe mbrojtje të përshtatshme për nevojat e tyre specifike. Për t'i identifikuar nevojat e sigurisë dhe mbrojtjes të viktimës/të mbijetuarit, së pari do të duhet të identifikoni rreziqet specifike për atë. Një vlerësim i tillë i rrezikut do të jetë specifik për secilën viktimë/të mbijetuar, në varësi të rrethanave të saj individuale dhe ajo duhet të jetë në qendër të procesit të vlerësimit të rrezikut.

*Shtojca 1 Vlerësimi Standard i Riskut dhe Rrezikut: Vlerësimi i Rrezikut Vdekshmërisë dhe Rrezikut të Dhunës së Përsëritur ofron një listë të faktorëve të rrezikut nga Manuali i UNODC dhe UN Women mbi 'Përgjigjet efektive të Prokurorisë në Dhunë ndaj Grave dhe Vajzave.'* Është e rëndësishme të kuptohet se prania e ndonjërit prej rreziqeve mund të tregojë një rrezikshmëri më të lartë të lëndimit serioz ose fatalitetit; gjithashtu, mungesa e këtyre faktorëve nuk do të thotë se nuk ka rrezik fataliteti.

Rezultati i çdo vlerësimi të rrezikut duhet të jetë një plan i sigurisë i cili është pronësi të përbashkët e juaj,

## Kutia 1

### Çfarë mund të bëni ju dhe stafi juaj për t'i ulur rreziqet me të cilat përballen viktimat dhe bashkëpunëtorët e tyre?

Masat përfshijnë:

- Kërkimin e urdhrave për mbrojtje nga gjykata, asnjë urdhër kontakti, etj.;
- Punën me viktimat/të mbijetuarit për t'i identifikuar faktorët e rrezikut dhe për të krijuar një plan të personalizuar të sigurisë;
- Referimin e grave ose shoqërimin e tyre në strehimore;
- Miratimin e një politike të detyrueshme të arrestimit në të gjitha rastet e dhunës në familje të pretenduar ose të dyshuar;
- Kërkimin, sipas nevojës, të kushteve të rrepta të liritimit të kryerësve, duke përfshirë orën policore, urdhrat për të mos pasur kontakt, abstenimin nga alkooli, ndalimin e armëve dhe kërkimin dhe duke marr pjesë në këshillim;
- Monitorimin dhe zbatimin e kushteve të liritimit me kusht/liritimit dhe kushteve të liritimit pas shqyrtimit gjyqësor, njoftimet e viktimës/të mbijetuarve para liritimit të një kryerësi;
- Kryerjen e vlerësimeve të rrezikut dhe miratimin e planeve të menaxhimit të kërcënimit për të zvogëluar rrezikun e sulmeve të ardhshme.

Source: Handbook on Effective Police Responses to Violence Against Women (UNODC, 2010).

oficerëve tuaj dhe viktimës/të mbijetuarit. Roli juaj është që të mundësoni zhvillimin e planit dhe derisa një plan i sigurisë nuk do të parasheh se kur mund të ndodhë ndonjë dhunë në të ardhmen, ai është krijuar duke pasur parasysh parandalimin dhe duke zvogëluar rrezikun dhe duke e ngritur sigurinë ndaj një viktime/të mbijetuarë.

Plani i sigurisë duhet të përqëndrohet në zbutjen e çdo rreziku të identifikuar, dhe kjo mund të arrihet në partneritet me ofruesit e tjerë të shërbimeve thelbësore, të cilët shpesh mund të ofrojnë shërbime shtesë mbështetëse që ju nuk i keni në dispozicion. Ashtu si me vlerësimin e rrezikut, një plan i sigurisë do të jetë specifik për secilën viktimë/të mbijetuar pasi kompleksiteti i rrethanave të tyre individuale do të jetë i ndryshëm. Kutia 1 më poshtë paraqet shembuj të masave zbutëse të rrezikut në rastet e DHGV:

Ashtu sikur me të gjitha aspektet e përgjigjes ndaj viktimave/të mbijetuarve të DHGV, përmbajtja e vlerësimit të rrezikut dhe e planit të mëvonshëm të sigurisë duhet të mbahen personale dhe konfidenciale, vetëm me ata të cilët janë të angazhuar në mbrojtjen e viktimës/të mbijetuarit nga ofruesit e shërbimeve të ndryshme që kanë qasje në ato.

Më lartë është një [Grafikon](#) i dobishëm e [Vlerësimit të Rrezikut](#) marrë nga MBROJTJA II 'Ndërtimi i Kapaciteteve në Vlerësimin e Rrezikut dhe Menaxhimit të Sigurisë për t'i Mbrojtur Viktimat me Rrezik të Lartë - Një Burim i Mësimi', (Vjenë, 2012), f.105.

Në lidhje me çdo veprim specifik të policisë:

- Si garantoni që siguria e viktimës/të mbijetuarit është kryesore në vendim-marrjen tuaj?
- Si siguroheni që kushdo që është vendimmarrës, për shembull stafi i kujdestarisë, t'i ketë të gjitha informatat në dispozicion për të marrë një vendim të informuar, p.sh., arrestimin, lirimimin ose ndalimin e vazhdueshëm të një kryerësi të pretenduar?
- Si siguroheni që vlerësimi i rrezikut është rishikuar kur është lëshuar një urdhër për mbrojtje apo jeni njoftuar mbi shkeljen e një urdhri ekzistues për mbrojtje dhe, kur është relevante, që plani i sigurisë është i përditësuar?
- Cilat janë mekanizmat tuaj të rishikimit?
- Si i monitoroni planet e sigurisë dhe pajtueshmërinë me urdhrat e gjykatës?



**Figura 1**

**Grafikoni i Vazhdës së Vlerësimit të Rrezikut (MBROJTJA II, 2012)**

## Kutia 2

### Dhuna në Familje, Përndjekja dhe Dhuna e Bazuar në 'Nder' (DASH) Identifikimi dhe Vlerësimi i Rrezikut dhe Modeli i Menaxhimit

Në mars të vitit 2009, Këshilli i Shoqatës të Oficerëve të Lartë të Policisë (ACPO) akreditoi modelin DASH që të zbatohet në të gjitha shërbimet policore në MeB. Lista e plotë DASH u siguron oficerëve dhe stafit një mjet praktik për të ndihmuar në identifikimin e hershëm të rrezikut. Ai përbëhet prej 27 pyetjeve. Me trajnimin e duhur, aplikimi i listës të plotë të DASH u mundëson oficerëve dhe stafit që t'i identifikojnë rastet me rrezik të lartë, dhe t'i identifikojnë kryerësit e rrezikshëm dhe serik. Pas identifikimit dhe vlerësimit fillestar të rrezikut, rastet do të klasifikohen në tri nivele të rrezikut:

- **Standard** – provat aktuale nuk paraqesin gjasat për të shkaktuar dëmtimit të rëndë;
- **Mesatar** – ekzistojnë tregues të identifikueshëm të rrezikut të dëmtimit të rëndë; Kryerësi ka potencialin për të shkaktuar dëm të rëndë, por nuk ka gjasa ta bëjë këtë nëse nuk ka ndonjë ndryshim në rrethanë, për shembull, dështimi për të marr ilaçe, humbje të akomodimit, dobësim të marrëdhënies dhe keqpërdorim të drogës ose alkoolit;
- **E Lartë** – ekzistojnë tregues të identifikueshëm të rrezikut të dëmtimit të rëndë. Ngjarja e mundshme mund të ndodhë në çdo kohë dhe ndikimi do të ishte i madh.

Rreziku i dëmtimit të rëndë përkufizohet si: 'Një rrezik që është kërcënues për jetën dhe/ose traumatik, dhe nga i cili shërimi, qoftë fizik apo fizikologjik, mund të pritet të jetë i vështirë ose i pamundur' (Burimi: Zyra Qendrore 2002 dhe Sistemi i Vlerësimit të Kryerësve, 2006).

Source: Everyone's Business: Improving the Police Response to Domestic Violence – HMIC (2014)

Secili ndryshim në rrethanat e një viktime/të mbijetuarit ose kryerësi të pretenduar duhet të jetë pjesë e një procesi të vazhdueshëm të vlerësimit të rrezikut dhe do të kërkojë monitorim të vazhdueshëm të planit të sigurisë. Kutia 2 më poshtë është një shembull i një procesi të vlerësimit të Rrezikut nga shembulli i Abuzimit, Përndjekjes dhe Ngacimit në Familje ('DASH'):

Modele të Përbashkëta të vlerësimit të rrezikut siç janë DASH<sup>8</sup> (MeB) dhe B-SAFER<sup>9</sup> (Kanada) synojnë të sigurojnë një kuadër sistematik, të standardizuar dhe praktikisht të dobishëm për grumbullimin dhe marrjen parasysh të informatave kur merren vendimet lidhur me rrezikun e dhunës. Ato mund të përshkruhen si një listë e plotë ose udhëzues për të ndihmuar policinë dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve thelbësore të cilët përgjigjen të parët, për të vlerësuar rrezikun dhe për të identifikuar IPV si në cilësimet penale ashtu edhe në ato civile.

Këto modele dhe korniza janë të informuara mbi IPV nga literaturat shkencore dhe profesionale, mbi vlerësimin e rrezikut dhe planifikimin e sigurisë të viktimave/të mbijetuarve<sup>10</sup> dhe konsiderohen gjerësisht si të dobishme nga vetë oficerët e policisë. Për shembull, menjëherë pas prezantimit të tij në praktikë standarde në vitin 2014, Policia e Shtetit të Maryland (SHBA) raportoi një rënie prej 30% të vdekjeve në IPV.<sup>11</sup>

Është e rëndësishme të theksohet se modeli DASH është vazhdimisht nën shqyrtim nga bashkëvepruesit, me rezultate të ndara në internet. Pasi që asnjë model nuk është i përkryer, procese të tilla të rishikimit janë thelbësore për identifikimin e nënformancës të modelit dhe promovimin e profesionalizimit të përdoruesve të tij. Për më tepër, fakti që rezultatet e atij rishikimi - në këtë rast DASH - ndahen në internet (online) paraqet një angazhim për transparencë dhe llogaridhënie. Shihni Studimin

8 Dhuna në Familje, Përndjekja dhe Dhuna e Bazuar në 'Nder' (DASH, 2009) Identifikimi dhe Vlerësimi i Rrezikut dhe Modeli i Menaxhimit, shih: <https://www.dashriskchecklist.co.uk/>

9 Formulari i Shkurtër i Sulmit Bashkëshortor për Vlerësimin e Rrezikut (B-SAFER), shih: [https://www.justice.gc.ca/eng/tp-pr/fl-lf/famil/rros\\_vf1-rros\\_vf1/index.html](https://www.justice.gc.ca/eng/tp-pr/fl-lf/famil/rros_vf1-rros_vf1/index.html)

10 Shih: Pakon Gjinore të Policisë të OKB (OKB Departamenti i Operacioneve të Paqes - DPO/ DPET/ Shërbimi i Trajnimit të Integruar, 2015).

11 Shih 16 pyetje të përdorura për të identifikuar viktimat e dhunës në familje që ka të ngjarë të vriten, në <https://www.cbsnews.com/news/16-questions-used-to-id-domestic-abuse-victims-likely-to-be-killed/>

### Kutia 3

#### Krijimi i një Plani për Siguri Personale

Në krijimin e një plani për siguri personale, duke marrë parasysh faktorët mbështetës të sigurisë, mund të përfshijnë:

- Nivelin e mbështetjes personale në dispozicion për viktimën/të mbijetuarin;
- Gjendjen e tyre personale të jetesës;
- Nivelin e frikës;
- Barrierat ndaj sigurisë të krijuara nga qëndrimet dhe besimet personale, dhe qëndrimet dhe besimet e familjes së gjeruar, komunitetit ose kulturës;
- Ndikimet shëndetësore të keqtrajtimit;
- Statusin e punësimit ose problemet financiare;
- Shqetësimet që lidhen me fëmijët;
- Çështjet të përdorimit/abuzimit personal të substancave (alkooli dhe/ose droga, të ligjshme dhe të kundërligjshme);
- Qasjen dhe disponueshmërinë e shërbimeve lokale dhe përgjigja e tyre ndaj nevojave të viktimës/të mbijetuarve;
- Qasjen dhe disponueshmërinë e informtave të nevojshme;
- Koordinimin e shërbimeve mbështetëse.

Burimi: Doracaku mbi Përgjigjet Efektive të Policisë në Dhunën Ndaj Grave (UNODC, 2010).

e Rastit të Instrumentit për Vlerësimin e Rrezikut të Mbretërisë së Bashkuar në fund të këtij kapitulli.<sup>12</sup>

Për të siguruar që stafi juaj është duke i mbrojtur në mënyrë efektive viktimat/të mbijetuarit e DHGV, ju gjithashtu do të duhet të merrni parasysh si në vijim:

- Çfarë roli keni ju (policia) në urdhrat për mbrojtje civile dhe/ose penale aty ku ato janë në dispozicion?
- Sa shpejt mund të merren urdhrat për mbrojtje?
- Çfarë probleme po hasni ju ose stafi juaj gjatë procesit të aplikimit të urdhrat për mbrojtje, pavarësisht nëse aplikimi është apo jo nga ndonjë agjenci tjetër?
- Çfarë nevojitet për t'i mposhtur dhe identifikuar problemet?
- Cilat janë kompetencat, nëse janë, për të nxitur urdhra për mbrojtje emergjente? Cilat janë kërkesat për t'u përmbushur dhe a keni dijeni ju dhe stafi juaj për ato?

Nëse ju ose stafi juaj nuk jeni në dijeni mbi përgjigjet të pyetjeve të mësipërme, si mund t'i siguronit informatat e detajuara dhe të sakta viktimave/të mbijetuarve në mënyrë që t'i menaxhojnë pritjet e tyre dhe të lejojnë, si pjesë e një qasjeje të përqendruar tek viktimat/mbijetuesit, në mënyrë që ata të marrin vendime të informuara se si duket drejtësia për ata? Nëse një viktimë/i mbijetuar është në rrezik ose ka frikë, do t'ju kërkohet që të garantoni sigurinë e tyre para se ata të jenë të gatshëm të bëjnë një ankesë ndaj kryerësit të pretenduar, veçanërisht në rastet e dhunës në familje/IPV.

Një shembull i praktikës së mirë të punës me ofruesit e tjerë të shërbimeve për t'i ulur rreziqet ndaj viktimave/ të mbijetuarve dhe familjeve të tyre mund të gjeni në MeB, ku praktika e mbajtjes së **Konferencës së Vlerësimit të Rrezikut nga Agjencitë e Shumta** ('MARAC') tani është e zakonshme.<sup>13</sup> IPV MARAC është një takim ku agjencitë diskutojnë çdo rrezik të dëmtimit të ardhshëm për ata që përjetojnë IPV dhe, kur është e nevojshme, fëmijët e tyre, duke e ndjekur krijimin e një plani të sigurisë për të

Në vitin 2014, Ambasada Britanike në Bullgari, e mbështetur nga Alison Eaton, organizoi një vizitë për dy zyrtarë të Ministrisë së brendshme për të vizituar Qendrën Saturn, q QRSS në Sussex, MB. Në vitin 2015, një punëtor QRSS u zhvillua në Bullgari me aktorët kryesorë të shërbimit





Punëtori SARC në Bullgari. Fotografia mirësjellje nga Alison Eaton.

thelbësor, me qëllim krijimin e QRSS të parë në Burgas, Bullgari. Vselena QRSS u hap zyrtarisht në korrik 2016.

Që nga hapja e QRSS, Ambasada Britanike në Bullgari vazhdon të ofrojë mbështetje për policinë dhe partnerët lokalë, duke organizuar një numër punëtorish dhe programe trajnimi për policinë, prokurorët dhe agjencitë e tjera partnere. Kjo përvojë ka treguar se si policia dhe partnerët me sukses punojnë së bashku. U krijua gjithashtu një Bord Drejtues i QRSS.

QRSS 'Vselena' ndodhet pranë spitalit kryesor në Burgas.

QRSS 'Vselena' është një vend i sigurt ku viktimat/të mbijetuarat e sulmit seksual mund të vijnë dhe të flasin në konfidencë për përvojën e tyre dhe të marrin kujdesin, mbështetjen dhe mirëkuptimin e nevojshëm nga profesionistët, për të ndihmuar në rimëkëmbjen e tyre. Ai gjithashtu rrit hetimin dhe ndjekjen penale të këtyre krimeve. Shërbimi mbështet viktimat/të mbijetuarat nga Bullgaria dhe jashtë saj.

Që nga hapja e Vselena QRSS, partnerë shtesë kanë nënshkruar një marrëveshje për zhvillimin e mëtejshëm të QRSS, dhe këto përfshijnë Prokurorinë e Rrethit Burgas, komnatat Sozoplo, Karnobat, Pomorie, Nessebar dhe Primorsko.

### **Qëndrueshmëria, pronësia lokale dhe mbikëqyrja**

Suksesi i QRSS 'Vselena' tani ka tërhequr shumë vëmendje në të gjithë Bullgarinë dhe kjo është zgjeruar edhe në Rumani. Dy konferenca të suksesshme u mbajtën Tetor 2018 në Burgas dhe Plovidiv, duke u fokusuar në paran-



Fotografia mirësjellje nga Alison Eaton. Fazat e hershme të SARC Bullgare

dalimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e dhunës seksuale, me qëllim të rritjes së ofrimit të QRSS në të dy vendet.

Për sa i përket financimit, fillimisht rajoni i Burgas siguroi financimin për QRSS; megjithatë, më shumë partnerë janë bashkuar nga Prokuroria e Qarkut dhe komnatat e tjera.

QRSS i Burgasit i është nënshtuar tre kontrolleve të Sigurimit të cilësisë të udhëhequr nga Alison Eaton duke përdorur Veglën e auditimit QRSS në Mbretërinë e Bashkuar. Bordi drejtues i QRSS ndërmerr një rishikim vjetor të QRSS.

### **KËSHILLA DHE UDHËZIME PËR ZHVILLIMIN E NJË QRSS**

#### **Vendndodhja:**

Është e rëndësishme të vizualizoni QRSS si një koncept, se sa një ndërtesë;

- QRSS-të kanë përfitime kur ndodhen në spitale dhe ambiente të tjera të autoriteteve shëndetësore. (p.sh. të integruar në shërbimet e shëndetit seksual).

#### **Qasja në QRSS:**

- Shenjat e jashtme dhe të brendshme duhet të jenë të qarta (merrni parasysh gjuhë të ndryshme);
- Një hartë e QRSS duhet të jetë e disponueshme në internet dhe për email;
- Parkimi për policinë, stafin dhe viktimat/të mbijetuarat duhet të jetë aty pranë, i shënuar dhe i disponueshëm 24/7;
- Zonat e hyrjes duhet të jenë të pastra dhe të ndriçuara mirë;



Fazat e hershme të SARC Bullgare. Fotografia mirësjellje e Alison Eaton.

- Telefonat me video-hyrje/CCTV do të lehtësojnë qasjen për viktimat/të mbijetuarat duke siguruar sigurinë e stafit gjatë natës.

#### **Lokalet:**

- Hyrja në QRSS duhet të kufizohet, p.sh. tastiera ose kartela rrëshqitëse;
- QRSS duhet të përmbajë të paktën një ose më shumë dhoma për përdorim forenzik, dhe gjithashtu mund të përmbajë objekte përcjellëse;
- Privatësia përmirësohet duke mundësuar qasje të drejtpërdrejtë në QRSS, në vend që të kalojë nëpër mjedisë të tjera;
- Siguria e lokaleve dhe stafit është një pjesë e rëndësishme e planifikimit të një QRSS, p.sh. sistemet e alarmit.

#### **Objektet e QRSS duhet të përfshijnë:**

- Recepcioni i mirëseardhjes;
- Dhoma e pritjes forenzike;
- Dhoma e ekzaminimit forenzik;
- Tualeti dhe dushi;
- Dhoma e intervistimit për policinë.

#### **Objektet për përcjellje:**

- Terminet mund të bëhen në kohën e ekzaminimit forenzik
- Hyrje e veçantë në dhomën përcjellëse për të shmangur përvojën fillestare të pjesëmarrjes në ekzaminimin forenzik;

- Objektet përcjellëse duhet të përfshijnë:
  - Recepcioni i mirëseardhjes;
  - Zona e pritjes me ulëse të rehatshme;
  - Dhoma e këshillimit;
  - Dhoma e hetimit;
  - Tualet dhe dush;
  - Dhoma për intervista për përdorim nga policia/psikologu.

#### **Objektet/integriteti kriminalistik**

- Dhoma e pritjes forenzike (karrige dhe dysheme të pastrueshme);
- Të gjitha dhomat duhet të etiketohen qartë në lidhje me përdorimin e tyre, p.sh. ekzaminimi mjekësor, dhoma e pritjes, banjo;
- Dhoma forenzike duhet të ketë dyer të kyçura dhe të mbahen të kyçura kur nuk janë në përdorim për të ruajtur integritetin e procedurës së pastrimit;
- Ngjitëset e laminuara reverzibile duhet të vendosen në pjesën e jashtme të të gjitha dyerve të dhomave forenzike;
- Vendosni nëse nevojitet një frigorifer/frigorifer brenda dhomës mjekësore për të ruajtur mostrat;
- Protokoll i pastrimit për zonat forenzike.

#### **Regjistrimi i detajeve të secilës viktimë/të mbijetuar që merr pjesë në QRSS:**

- Një regjistër i përgjithshëm për regjistrim si më poshtë duhet të jetë i disponueshëm dhe të kompletohet sa herë që bëhet një vizitë në QRSS:
  - Numri për hyrje;
  - Data dhe koha e prezencës;
  - Emri;
  - Intervista e kryer nga policia;
  - Ndërmarrja e forenzikës;
  - Kërkesa për pastrim;
  - Pastrimi i ndërmarrë (koha, data, emri);
  - Rimbushja e stoku të kërkuar;
  - Stoku i rimbushur nga (koha, data, emri);

- Dosja e referimit që përmban udhëzime për protokollet e pastrimit, heqjen e rrobave të ndotura nga banjo, këshilla për asgjësimin e gjilpërave;
- Detajet e prokurimit në lidhje me rimbushjen e pajisjeve të dhomës mjekësore dhe banjës.

#### **Kujdesi për viktimat/të mbijetuarat:**

- Siguroni produkte higjienike për një përdorim për çdo viktimitë/të mbijetuar të sulmit seksual, për shembull, gel dushi, pastë dhëmbësh, furçë dhëmbësh dhe krehër;
- Disa rroba të pakthyeshme, të brendshme, këpucë, si veshje zëvendësuese kur viktimat/e mbijetuara nuk ka veshje për ndërrim me vete;
- Fletëpalosje që jep këshilla për viktimat/të mbijetuarat që janë sulmuar seksualisht, për të përfshirë detajet e organizatave përkatëse mbështetëse;
- Jepni informacion që përmban detajet e kontaktit të QRSS, duke përfshirë emrat e stafit që iu drejtuan viktimës/të mbijetuarës dhe çdo ilaç të dhënë;
- Jepni viktimës/të mbijetuarës fletëpalosje për kontracëpsionin emergjent.

#### **Stafi:**

- Shtirirja e numrit të mundshëm të viktimave që do të shihen në QRSS nëse kjo është e mundur për të informuar stafin e kërkuar.

#### **Rolet kryesore:**

- Menaxheri i QRSS - me kohë të plotë;
- Administratori QRSS - me kohë të plotë;
- Punonjësi/psikologu/infermierja për mbështetjen e krizës - me kohë të plotë;
- Drejtori klinik - dy ditë në javë;
- Ekzaminues(ë) forenzik (Hulumtimet nga Mbretëria e Bashkuar sugjerojnë se shumica e viktimave/të mbijetuarave të përdhunimit preferojnë të shqyrtohen nga një EML femër);
- Policia - Trajnuar në Hetimin e veprave seksuale;
- Bordi drejtues.

#### **Kompetencat kryesore për Punëtorin e mbështetjes në krizë:**

- Infermier i kualifikuar ose këshilltar shëndetësor me përvojë ose këshilltarë me përvojë/të kualifikuar;
- Kuptimi i nevojave të një individi që është sulmuar seksualisht;
- Aftësi të mira komunikimi verbale dhe me shkrim;
- Aftësi për të punuar si pjesë e një ekipi shumë-profesional.

#### **Nevojat e trajnimit:**

- Trajnimi i shkeljeve seksuale;
- Trajnimi në gjykatë;
- Trajnim i hershëm i provave;
- Përgjigja e parë;
- Policia do të ketë nevojë për informacion/trajnim të qartë për punën me QRSS.

#### **Komunikimi:**

- Komunikimi efektiv është një përbërës thelbësor për drejtimin e suksesshëm të një QRSS:
  - Emëroni një oficer ndërlidhës policie i cili mund të jetë rruga qendrore e komunikimit me policinë;
  - Emëroni një oficer ndërlidhës shëndetësor i cili mund të jetë poashtu rruga qendrore e komunikimit me autoritetin shëndetësor;
  - Themeloni Bordin menaxhues me anëtarët përkatës të shumë agjencive;
  - Protokollet e dakorduara për shkëmbimin e informacionit;
  - Politikat dhe procedurat specifike operacionale që do të krijohen dhe dakordohen.

#### **Auditimi dhe cilësia:**

- Thelbësore që auditimet të kryhen dhe statistikave të mbledhen mbi aspektet e ndryshme të ofrimit të shërbimeve në QRSS, për shembull:
  - Disponueshmëria e ekzaminimit forenzik;
  - Sondazhe të kënaqësisë së përdoruesit;
  - Informacioni i menaxhimit;
- Këto do të ofrojnë dëshmi për efektivitetin e tij dhe do të ndihmojnë në marrjen e financimit afatgjatë.

## RAST STUDIMI 2

# QENDRA PËR MBËSHTETJEN E VIKTIMAVE: PORTA E DREJTËSISË NË BANGLADESH

Nga Shamima Begum PPM, Addl.DIG<sup>46</sup> Policia e Bangladeshit,



Qendra për mbështetjen e viktimave. Foto mirësjellje policisë së Bangladeshit në Facebook

Dhuna ndaj grave dhe fëmijëve është një plagë kundër shoqërisë. Në Bangladesh, policia bashkoi forcat me OJQ-të lokale për t'iu përgjigjur kolektivisht rasteve të DHGV përmes modelit të **Qendrës për mbështetjen e viktimave** ('QMV'). QMV-ja e parë u krijua për herë të parë në 2009 si pjesë e një projekti të reformës së policisë të UNDP-së dhe u bë një nismë novatore për policinë e Bangladeshit dhe OJQ-të.

### Si?

QMV fokusohet në dhënien e përgjigjes së shpejtë dhe riintegrimin e viktimave/të mbijetuarave në komunitet. Me staf dhe e mbështetur tërësisht nga gra profesioniste si police, juriste, këshilltare dhe mjeket, qendra ofron mbështetje të integruar, duke përfshirë strehim, këshillim, ndihmë juridike, trajtim urgjent dhe ndërmjetësim. Së bashku me 10 OJQ partnere, ajo siguron kujdes gjatë gjithë kohës për (24 orë/ditë) për gratë dhe fëmijët që janë viktimat/të mbijetuarat të DHGV.

<sup>46</sup> 'Addl DIG' është një Zëvendës inspektor i përgjithshëm shtesë. Shamima Begum është Nënkryetare aktuale e Rrjetit të grave të policisë në Bangladesh ('RRGPB') dhe Koordinatore e rajonit 22, Shoqata ndërkombëtare e policisë së grave (SHNPG).



Qendra për mbështetjen e viktimave. Foto mirësjellje nga Policia e Bangladeshit në Facebook

QMV gjithashtu mban një bazë të dhënash për të mbrojtur gratë dhe fëmijët nga riviktimizimi dhe ofron numër telefoni për ndihmë, lidhje në Facebook për Policinë Metropolitane të Daka dhe faqe në internet ([www.dmpwsid.gov.bd](http://www.dmpwsid.gov.bd)) për të mbështetur policinë në përgjigjen e tyre ndaj viktimave/të mbijetuarave në mënyrë më efektive.

Aktivitete të tjera të përbashkëta që përfshijnë policinë dhe QMV përfshijnë:

- Fushata në institucionet arsimore që inkurajojnë zhvillimin e programeve të ndërgjegjësimit për ngacmimin seksual, shfrytëzimin dhe format e tjera të DHGV për studentët;
- Ditë e hapur në stacionet e policisë;
- Organizimi i stendës në panaire lokale, për ngritjen e vetëdijes me komunitetet;
- Shpërndarja e fletëpalosjeve dhe broshurave.

Nga 2009 - 2014, QMV e Policisë Metropolitane të Dakës ofroi mbështetje për mbi 3,000 viktimat/të mbijetuarat.

## Cilat shërbime po bëjnë një ndryshim?

QMV krenohet me pritjen e grave dhe fëmijëve dhe trajtimin e tyre me dinjitet dhe respekt duke siguruar një mjedis të përshtatshëm në të cilin personeli i policisë regjistron ankesat dhe kujdeset për nevojat e tyre të menjëhershme. Më konkretisht, QMV:

- Ndhmon me 'Raportin e parë të informacionit' ('RPI'), u siguron viktimave/të mbijetuarave informacion në lidhje me proceset e drejtësisë, ndihmën urgjente mjekësore dhe, në rrethanat e përshtatshme, lehtëson vizitat në një qendër mjekësore për trajtim;
- Ndhmon në proceset e hetimit, informon viktimat/të mbijetuarat për proceset, përfshirë dhënien e informacionit në telefon (nëse është e nevojshme) dhe këshillimin psikosocial;
- Ofron referime si për organizatat qeveritare ashtu edhe për ato joqeveritare për ndihmë afatgjatë si rehabilitimi, ndihma juridike, mbështetje shtesë mjekësore dhe psikologjike dhe riintegrimi në familje, në mënyrë që të parandalohen viktimat/të mbijetuarat nga viktimizimi i përsëritur.

## 'Çfarë funksionoi': Hapa proaktivë të ndërmarrë nga Udhëheqja e policisë e QMV

**Sigurimi i stabilitetit financiar:** Menaxheri i lartë i policisë QMV lobi në Qeveri dhe krijoi një propozim për financim që u përcoll përmes selisë kryesore të policisë së Dakës në Ministrinë e financave. Kjo rezultoi në ndarjen e fondeve nga një buxhet tjetër i qeverisë, i cili më pas lejoi që QMV të ofrojë trajtim mjekësor, ushqim dhe veshmbathje dhe të mbulojë kostot e tjera që lidhen me menaxhimin e rasteve. Financimi shtesë gjithashtu mbështeti rekrutimin e më shumë grave policore, të cilat tani janë të përfshira në hetimin e rasteve dhe menaxhimin e viktimave.

**Zhvilloi strategji të qartë:** Një nga strategjitë e prezantuara nga Policia Metropolitane e Dakës ('QMV') ishte krijimi i Ekipit të reagimit të shpejtë ('ERSH') që mund



Qendra për mbështetjen e viktimave. Foto mirësjellje nga policia e Bangladeshit në Facebook.

t'i përgjigjet shpejt një incidenti dhe të ofrojë ndihmë. ERSH përbëhet nga një Nën-Inspektor si shef i ERSH, dhe Nën-Inspektor ndihmës dhe dy policë si anëtarë të ekipit. Të gjithë anëtarët e ekipit janë police femra.

## Siguroi që të përfshihen njësitë e duhura të policisë:

Menaxhmenti i policisë së QMV mbledhi stafin me të gjitha aftësitë dhe profesionalizmin e duhur nga Njësia për mbështetjen e viktimave, Njësia e hetimit dhe Ekipi i reagimit të shpejtë, për të siguruar që ofrohet një gamë e gjerë e grupeve të aftësive dhe mbështetjes për viktimat/të mbijetuarat.

## Ndikimi i QMV që nga viti 2009

QMV ka qenë një nismë revolucionare si në Bangladesh ashtu edhe në Rajonin e Azisë Jugore dhe tani konsiderohet si pioniere në promovimin e qasjes në drejtësi për gratë dhe fëmijët që kanë përjetuar dhunë. Që kur QMV e parë u prezantua nga Policia Metropolitane e Dakës, tani janë krijuar 8 qendra të tjera mbështetëse për të siguruar mbështetje për viktimat/të mbijetuarat në Bangladesh.



## SHËNIME DHE LEXIM TË SUGJERUAR

1. 'Pjesëmarrja: Gjinia, barazia dhe të drejtat e njeriut (OBSh) në: <https://www.who.int/gender-equity-rights/understanding/participation-definition/en/>
2. 'Praktika të mira në mbështetjen e viktimave të terrorizmit brenda Kornizës së drejtësisë penale '(UNODC, 2015) në: [https://www.unodc.org/documents/terrorism/Publications/Good%20practices%20on%20victims/good\\_practices\\_victims\\_E.pdf](https://www.unodc.org/documents/terrorism/Publications/Good%20practices%20on%20victims/good_practices_victims_E.pdf)
3. Strategjitë model të përditësuar dhe masat praktike për eliminimin e dhunës ndaj grave në fushën e parandalimit të krimit dhe drejtësia penale (2011, rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 65/228, shtojcë)
4. Paketa e shërbimeve thelbësore për gratë dhe vajzat që i nënshtrohen dhunës: Elementet themelore dhe udhëzimet për cilësinë (Programi i përbashkët global i Kombeve të Bashkuara për shërbimet thelbësore për gratë dhe vajzat subjekte të dhunës, 2015) në: <https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2015/12/essential-services-package-for-women-and-girls-subject-to-violence>
5. Hartëzimi dhe analiza e mjeteve juridike në familje për çështjet e dhunës kundër grave (DHKG), (Byroja ligjore dhe e të drejtave të grave dhe Gratë e KB, 2010).
6. Hill Collins, P., 1990. Mendimi feminist i zi: dituria, vetëdija dhe politika e fuqizimit. Routledge, Nju Jork; cituar në Imkaan dhe Gratë e KB (2019), Vlera e ndërsektoritetit në kuptimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave, në: <https://www2.unwomen.org/-/media/field%20office%20eca/attachments/publications/2019/10/the%20value%20of%20intersectionality%20in%20understanding%20violence%20against%20women%20and%20girls.pdf?la=en&vs=3339>
7. 'Abuzimi i pozicionit të cenueshmërisë dhe «mjeteve» tjera brenda përkufizimit të trafikimit të njerëzve, Dokumenti i çështjes (UNODC, 2013), në: [https://www.unodc.org/documents/human-trafficking/2012/UNODC\\_2012\\_Issue\\_Paper\\_-\\_Abuse\\_of\\_a\\_Position\\_of\\_Vulnerability.pdf](https://www.unodc.org/documents/human-trafficking/2012/UNODC_2012_Issue_Paper_-_Abuse_of_a_Position_of_Vulnerability.pdf)
8. Deklarata e primeve themelore të drejtësisë për viktimat e krimit dhe abuzimit me pushtetin (miratuar me rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme 40/34 të 29 nëntorit 1985)
9. Forcimi i parandalimit të krimit dhe përgjigja e drejtësisë penale ndaj dhunës ndaj grave, (UNODC, 2014).
10. Dowling, C., Morgan, A., Boyd, C., Voce, I., 'Policimi i dhunës në familje: Një përmbledhje e dëshimive' (Instituti Australian i kriminologjisë, raporti i kërkimit 13, 2018) në: [https://aic.gov.au/file/6650/download?token=CgV\\_eGo](https://aic.gov.au/file/6650/download?token=CgV_eGo)
11. Politika e reagimit ndaj sulmeve seksuale dhe udhëzimet e përmbajtjes së trajnimit (Shoqata ndërkombëtare e shefave të policisë 2015) në: <https://www.theiacp.org/sites/default/files/all/i-j/IACP%20Sexual%20Assault%20RPSHTHorse%20Policy%20and%20Training%20Content%20Guidelines.2017.3.23.pdf>
12. Lindgren, M dhe Nikolić-Ristanović, V., (2015), 'Viktimat e krimit: Perspektiva ndërkombëtare dhe serbe' (Organizata për sigurinë dhe bashkëpunimin në Evropë, Misioni në Serbi, departamenti i zbatimit të ligjit), në: <https://www.osce.org/serbia/85268?download=true>
13. Logar, Rosa, 'Modeli Austriak i ndërhyrjes në rastet e dhunës në familje', Punim i paraqitur në Takimin e grupit të ekspertëve të OKB -së mbi dhunën ndaj grave: Praktika të mira në luftimin dhe eliminimin e dhunës ndaj grave (Vjenë, 17–20 maj 2005).
14. Reuland, M., Schaefer-Morabito, M., Preston, C., Cheney, J., 2006) 'Partneritetet policore-komunitare për të adresuar dhunën në familje', Departamenti Amerikan i drejtësisë zyra e shërbimeve të policimit të orientuar në komunitet, në: <https://cops.usdoj.gov/RIC/Publications/cops-p091-pub.pdf>
15. 'Rrota e partneritetit - Protect II - Ndërtimi i kapaciteteve në vlerësimin e rrezikut dhe planifikimin e sigurisë për të mbrojtur viktimat e rrezikut të lartë ', (Vjenë, 2012), at: [http://files.wave-network.org/trainingmanuals/PROTECTII\\_Risk\\_Assessment\\_and\\_Safety\\_2012\\_English.pdf](http://files.wave-network.org/trainingmanuals/PROTECTII_Risk_Assessment_and_Safety_2012_English.pdf)
16. 'Hulumtimi do të rishikojë mbështetjen e ofruar për viktimat e sulmeve seksuale '(Universiteti i Birmingham, 2018) në: <https://www.birmingham.ac.uk/university/colleges/mds/news/2018/08/Research-sex-assault-victims-support.aspx>
17. Barker, N., Gregware, P.R., Cassidy, MA, (1999), 'Fushat e vrasjes së familjes: Arsyetimet e nderit në vrasjen e grave.'
18. 'Nga margjina në qendër: Adresimi i dhunës ndaj grave dhe vajzave: fatura alternative (Imkaan, tetor, 2018), në: [https://829ef90d-0745-49b2-b404-cbea85f15fda.file-susr.com/ugd/2f475d\\_91a5eb3394374f24892ca1e1eb-feeaze.pdf](https://829ef90d-0745-49b2-b404-cbea85f15fda.file-susr.com/ugd/2f475d_91a5eb3394374f24892ca1e1eb-feeaze.pdf)
19. Oficeri i ndërlidhjes me familjen (Kolegji i policimit, MB), në: <https://profdev.college.police.uk/professional-profile/family-liaison-officer-flo/#role-purpose>
20. Çfarë është dëgjimi aktiv? (Instituti i paqes i Shteteve të Bashkuara) në: <https://www.usip.org/public-education/educators/what-active-listening>
21. 'Parimet themelore mbi përdorimin e forcës dhe armëve të zjarrit nga zyrtarët e zbatimit të ligjit

'(miratuar nga Kongresi i tetë i OKB -së mbi parandalimin e krimit dhe trajtimin e shkelësve, Havana, Kubë, 27 gusht deri më 7 shtator 1990).

22. Përfashtimi i dëshmime të marra përmes torturës (Shoqata për parandalimin e torturës), në: <https://SHPT.ch/en/evidence-obtained-through-torture/>







# KOORDINIMI NDËRMJET AGJENCIVE TË DREJTËSISË

*“Koordinimi është një rrugë e mundshme për zgjidhjen e këtij problemi, nëse kjo i bashkon në një platformë të përbashkët, organizatat që vijnë nga baza, avokuesit për të drejtat e viktimave, ofruesit e shërbimeve dhe punonjësit e sistemit të drejtësisë penale.”*

**Pasqyrë e praktikave më të mira në botë për parandalimin e përdhunimit dhe për të ndihmuar gratë viktime të përdhunimit (Parlamenti Evropian, 2013)**

---

# QËLLIMI I KAPITULLIT

---

**Policia po ofron shërbime esenciale cilësore në mënyrë efektive që mundëson rezultatet më të mira për viktimat/të mbijetuarat. Kjo është arritur duke përmbushur në mënyrë aktive standardet dhe pritjet e agjencive të ndryshme të drejtësisë dhe të ofruesve të shërbimeve në një përgjigje të koordinuar që përqendrohet në viktimat/të mbijetuara dhe me përgjigje të ndjeshme nga aspekti gjinor ndaj DHNGV-së.**

---

## **Mesazhet kryesore dhe pikat e nxjerra si mësim:**

- Përfshirja e hisedarëve të jashtëm në mbikëqyrjen e bashkëpunimit të shërbimeve esenciale është me rëndësi për transparencën dhe legjitimitetin;
- Koordinimi mund të ndihmojë në shmangien e duplikimit ose kundërthënies nga agjenci të ndryshme të drejtësisë ose të pengojë agjencitë e tjera të drejtësisë, si dhe të zvogëlojë rrezikun nga viktimizimi për së dyti për viktimën/të mbijetuarën;
- Informacioni që u ofrohet viktimave/të mbijetuarave duhet të jetë konsistent në të gjitha agjencitë e drejtësisë për të siguruar që pritjet e tyre mund të menaxhohen në mënyrë efektive;
- Balancimi i mbikëqyrjes së hisedarëve të jashtëm në proceset e koordinimit të hetimeve të DHNGV-së me ruajtjen e integritetit të vetë hetimit është me rëndësi kritike;
- Drejtuesit e nivelit të mesëm të policisë mund të jenë të rëndësishëm në krijimin dhe/ose zbatimin e kornizave të mbikëqyrjes për mekanizmat koordinues;
- Parimi i mos dëmtimit të zbatohet në procesin e zgjedhjes së partnerëve në përgjigjen ndaj krimit, pasi kjo mund t'u japë status grupeve, dhe, nënkuptohet, t'ua mohojë atyre që nuk njihen aq shumë.



# HYRJE

Si rezultat i detyrave të tyre kryesore dhe i pranisë territoriale, policia dhe zyrtarët e tjerë të zbatimit të ligjit në përgjithësi janë vija e parë e drejtësisë për viktimat/të mbijetuarat e krimit dhe dhunës. Megjithatë, pavarësisht se është më e dukshme nga aktorët e drejtësisë, organizata policore nuk është dhe nuk duhet të jetë asnjëherë, shërbimi i vetëm ku mund të mbështetet një viktimë/e mbijetuar e DHGV-së kur kërkon drejtësi.

Fotografia me lejen e MINUSTAH/Logan Abassi (Haiti)

Ruajtja e rendit dhe e drejtësisë në një territor të caktuar mbi të cilin ka kontroll efektiv, është përgjegjësi e shtetit dhe e organizatave të tij të ndryshme, që mes tjerash, përfaqësojnë sektorët e drejtësisë, shëndetësisë dhe të mirëqenies sociale. Si rezultat i kësaj, organizatat policore dhe agjencitë e drejtësisë duhet t'i kenë disa mundësi bashkëpunimi dhe mekanizma koordinues për të vënë në zbatim një kornizë të përbashkët teorike mbi DHGV-në që kërkon të nxjerrë rezultatet më të mira për viktimat/të mbijetuarat.

Këto mundësi dhe mekanizma koordinimi mund të gjenden në nivel kombëtar, rajonal<sup>1</sup>, dhe në nivelet lokale të qeverisjes komunale, dhe normalisht mbështeten në një kornizë të gjerë qasjesh shumë sektoriale me secilin aktor, përfshirë policinë, që luan rol të koordinuar sipas fushës së vet të kompetencës në kuadër të tërësisë së drejtësisë.

<sup>1</sup> Varësisht nga vendi, këtij niveli sub-nacional mund t'i referohemi si nivel rajoni, departamenti, territorial, kantonal ose krahinor.

Normalisht, agjencitë plotësuese të zbatimit të ligjit kanë protokolle ose memorandume mirëkuptimi për bashkëpunimin ndërmjet agjencive dhe takohen rregullisht me agjenci të tjera të sigurisë dhe ofrues të tjerë të shërbimeve esenciale në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal për t'u përshtatur strategjikisht përmes këshillave ose komiteteve të sigurisë në nivel kombëtar, rajonal ose komunal.

Si drejtues të nivelit të mesëm të policisë, mundësitë për të siguruar kontributet për një përgjigjeje të integruar dhe të koordinuar të ndjeshme nga aspekti gjinor ndaj DHGV-së do të gjenden në përgjithësi në nivelin lokal komunal dhe atë komunitar. Forumet që drejtohen nga puna policore në komunitet dhe/ose këshillat lokale (komunale) të sigurisë ofrojnë shumë pika hyrëse në këtë nivel, dhe suksesi i tyre varet nga ajo se sa mirë policia lokale, partnerët e tyre në sistemin e drejtësisë (tërësia) dhe hisedarët lokal kanë pikëpamje të përbashkët për atë se çfarë paraqet DHGV-ja, si dhe veprimet e nevojshme strategjike për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive mbi-zotërimit të saj.



Fotografia me lejen e UNMIT/Martine Perret (Timor-Leste)

Po ashtu në këto hapësira të përbashkëta, forume ose këshilla, ku policia dhe partnerët e tyre në sistemin e drejtësisë mund të kërkojnë në mënyrë pro aktive partneritete me hisedarët e jashtëm për forcimin e sistemeve mbështetëse. Këto partneritete mund të japin informata se si të mësohet kolektivisht për sa i përket bashkëpunimit më efektiv ndërmjet ofruesve të shërbimeve esenciale, përfshirë policinë dhe agjencitë tjera të drejtësisë.

Duke përfshirë hisedarë të jashtëm, lokalë dhe kompetentë në mbikëqyrjen e koordinimit të shërbimit të tyre esencial, policia dhe partnerët e tyre në tërësinë e drejtësisë, do të sjellin transparencën dhe legjitimitetin shumë të nevojshëm në një proces shumë teknik dhe të ndërlikuar, të cilit shpesh i mungon rishikimi, monitorimi dhe vlerësimi i rregullt.

Në kapitullin e mëposhtëm jepen udhëzime për drejtuesit e policisë në rolet e tyre koordinuese në nivel lokal me agjencitë e tjera të drejtësisë, me kontributin nga **hisedarët** me bazë në komunitet për ofrim efektiv të shërbimeve esenciale që u përgjigjen nevojave gjinore. Udhëzimi do ta orientojë lexuesin kah praktikatat më të mira në përpjekjet e koordinimit që kontrollohen nga policia ku kërkohen rezultatet më të mira për viktimat/të mbijetuarat, si dhe t'i plotësojnë standardet dhe pritjet e agjencive të ndryshme të drejtësisë dhe ofruesve të shërbimeve kur reagojnë ndaj DHGV-së.


Në këtë kapitull do t'i hulumtojmë më tej kompetencat dhe aftësitë e policisë qendrore për angazhim dhe koordinim efektiv me agjencitë e drejtësisë dhe hisedarët, si brenda, dhe jashtë vazhdës së drejtësisë, për qasje të bashkërenduar ndaj DHGV-së të përqendruar te viktimat/e mbijetuara. Meqenëse ky kapitull fokusohet në çfarë policia mund dhe duhet të kontrollojë sa i përket koordinimit, këtu nuk do të trajtohen rolet koordinuese të aktorëve të tjerë të drejtësisë, pasi që kjo do të diskutohet në mënyrë më të detajuar në Kapitullin 12: *Tërësia e Drejtësisë*.

Ky kapitull do të bazohet mbi supozimin se mekanizmat për qasje të koordinuar ndërmjet agjencive të drejtësisë për t'iu përgjigjur DHGV-së tashmë ekzistojnë në një shtet në nivele të ndryshme qeverisjeje, secila me protokollet dhe procedurat e veta të përcaktuara. Në këtë kapitull ofrohet edhe udhëzimi mes kolegësh në radhët e policisë, ku do të kërkohet plotësimi i instrumentet kombëtare ekzistuese duke përfunduar karakteristikat dhe parimet e përbashkëta të pakos së shërbimeve esenciale (PSHE) për koordinimin ndërmjet aktorëve të drejtësisë.

Ngjashëm me kapitujt e kaluar, lexuesit i rekomandohet ta shikojë këtë kapitull në lidhje me *Seksionin 11: Koordinimi mes aktorëve të drejtësisë* të Modullit 3 të PSHE mbi *Drejtësinë dhe Punën Policore* dhe Modulin 5 të PSHE mbi *Koordinimin dhe Qeverisjen e Koordinimit*. Lexuesit gjithashtu i rekomandohet të shikojë, në lidhje me këtë kapitull, *Planin për Veprim* të UNODC 2014: *Plani i Zbatimit për Sistemet e Drejtësisë Penale për Parandalimin dhe Përgjigjen kundër Dhunës ndaj Grave* (i përfshirë në botimin me titull *Forcimi i Parandalimit të Krimin dhe Përgjigja e Drejtësisë Penale kundër Dhunës ndaj Grave*); *Udhëzimet për Integrimin e Ndërhyrjeve të Dhunës me Bazë Gjinore në Veprimin Humanitar* (2015) nga Komiteti i Përhershëm Ndërmjet-Agjencive<sup>2</sup>, ku në mënyrë specifike përmendet qasja e bazuar në komunitet që ajo promovon; *studimi* i UNODC 2015 për Krijimin e një Mekanizmi të Reagimit Shumë disiplinor kundër Dhunës ndaj Grave në Egjipt për përvojat globale

2 'Udhëzime për Integrimin e Ndërhyrjeve të Dhunës me Bazë Gjinore në Veprimin Humanitar: Reduktimi i rrezikut, promovimi i qëndrueshmërisë dhe ndihma në rikuperimi', (Komiteti i Përhershëm Ndër-Agjencive, 2015).

në gjetjen e zgjidhjeve të koordinuara për DHGV; dhe *studimi tematik i UNHCHR mbi çështjen e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe aftësisë së kufizuar për udhëzime* në të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me qasjen në drejtësi për gratë me aftësi të kufizuara.<sup>3</sup>



## UDHËZIME MES KOLEGËSH

Për hetim efektiv është e domosdoshme që të ketë koordinim ndërmjet agjencive të drejtësisë, ashtu që të mos duplikohen përpjekjet, ose veprimet e ndërmarra që mund të jenë kundërthënëse ose që i pengojnë agjencitë e tjera të drejtësisë. Koordinimi është shumë i rëndësishëm për sigurimin e qasjes që përqendrohet te viktima/e mbijetuara në hetimin, ndjekjen dhe dënimin e krimeve të DHGV, si dhe zvogëlimin e rrezikut të viktimizimit për së dyti, duke rritur kështu potencialin e marrjes së drejtësisë për viktimat/të mbijetuarat.

Nëse koordinimi ndërmjet agjencive të drejtësisë ende nuk ekziston, ose nuk është mjaft i fuqishëm brenda zonës tuaj të punës policore, ju duhet të merrni rol prijës për të sjellë ndryshime pozitive. Sigurimi i drejtësisë është përpjekje ekipore, dhe asnjë agjenci e drejtësisë si e vetme nuk mund ta arrijë qëllimin përfundimtar të mbrojtjes dhe zbatimit të ligjit dhe t'u sigurojë viktimave drejtësi të arritshme, efektive dhe të ndershme pa secilën prej agjencive që punon me ndjeshmëri, etikë, respekt dhe dinjitet, dhe, mbi të gjitha, së bashku si partnerë.

Për fillim, ju duhet të identifikoni se **kush** saktësisht janë partnerët tuaj në agjencitë e drejtësisë (hisedarët), aty mund të hyjnë p.sh. avokatët ligjorë, juristët, prokurorët, magjistratët, gjyqtarët dhe, aty ku është relevante, pleqtë e komunitetit dhe mbrojtësit dhe mbështetësit e ligjeve ose besimeve lokale. Pasi t'i keni përcaktuar partnerët hisedarë, ju duhet të identifikoni sesi secili prej tyre kon-

tribuon në procesin e drejtësisë, cilat janë kërkesat dhe pritjet e tyre nga policia dhe, nga ana tjetër, cilat janë kërkesat dhe pritjet tuaja prej tyre. Është ide e mirë t'i tuboni përfaqësuesit nga secila agjenci për të diskutuar se si i kuptojnë ata rolet e njëri-tjetrit dhe t'i shkëmbeni pritjet, nevojat dhe sfidat e tyre përkatëse ndërmjet agjencive. Duke vepruar kështu, ju do të arrini nivel më të lartë të vetëdijesimit ndërmjet agjencive dhe siguroni platformë për të ndërtuar marrëdhënie bashkëpunimi.

Për shembull, nëse ju dhe stafi juaj i kuptoni plotësisht kërkesat dhe nevojat e prokurorëve, ashtu që ata të mund të paraqesin një rast të fortë para gjykatës, ju keni gjasa ta zvogëloni numrin e rasteve 'të rrëzuara' nga prokurorët madje edhe para se ato të shkojnë në sistemin gjyqësor. Njësoj edhe prokurorët kanë nevojë t'i kuptojnë kërkesat dhe nevojat e gjykatës për të nxjerrë dënime të suksesshme dhe këto informata mund t'u vijnë 'nga lart' juve, që ju të mund ta informoni stafin tuaj.

Duke qenë të pajisur me njohuritë më të mira për atë se çfarë kërkohet për të nxjerrë dënim të suksesshëm në gjykatë, kjo do ta fuqizonte stafin tuaj për të identifikuar dhe siguruar provat më të mira sa më parë që të jetë e mundur.

Për t'ju ndihmuar që t'i kuptoni pritjet mes policisë dhe shërbimit të prokurorisë, UN Women ka dhënë këshilla të dobishme dhe koncize:

<sup>3</sup> 'Studim tematik mbi çështjen e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe aftësisë së kufizuar, Raport i Zyrës së Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut', (A/HRC/20/5, 30 mars 2012).

## Rubrika 1

### Këshilla të shpejta: Pritjet e Policisë dhe të Prokurorisë<sup>4</sup>

Aktori	Pritjet
Policia pret që Zyra e Drejtorit të Prokurorisë Publike të:	<ul style="list-style-type: none"><li>• Informojë nëse fletëpagesa është hartuar siç duhet;</li><li>• Informojë nëse deklaratat shtesë duhet të regjistrohen;</li><li>• Informojë nëse duhen të kryhen hetime shtesë;</li><li>• Paraqesë në gjykatë të dhënat policore të kryesit të krimit;</li><li>• Aty ku është e nevojshme, të kundërshtojë lirimin me kusht/dorëzani të kryesit të veprës penale/t'u jep përparësi rasteve të DHGV-së, sidomos kur e mbijetuara është në gjykatë;</li><li>• Marrë në pyetje dëshmitarët në gjykatë;</li><li>• Lehtësojë lidhjet me Agjencinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve.</li></ul>
Zyra e Drejtorit të Prokurorisë Publike pret që Policia të:	<ul style="list-style-type: none"><li>• Kryejë hetime të duhura mbi incidentet e DHGV;</li><li>• Arrestojë të dyshuarin;</li><li>• Regjistrojë deklarata gjithëpërfshirëse nga të mbijetuarat, dëshmitarët dhe të dyshuarit;</li><li>• Shoqërojë të mbijetuarat dhe të dyshuarit në spital për ekzaminim mjekësor;</li><li>• Hartojë fletën e akuzës, me deklaratën e duhur për veprën penale dhe veçoritë e akuzës;</li><li>• Mirëmbajë zinxhirin e duhur të ruajtjes së provave;</li><li>• Mbledh dhe ruajë siç duhet provat;</li><li>• Paraqesë të dyshuarit në gjykatë brenda 24 orëve;</li><li>• Prezantojë dhe paraqesë provat në gjykatë;</li><li>• Prangosë dhe paraqesë dëshmitarët për të marrë pjesë në gjykatë;</li><li>• Kryejë hetime shtesë aty ku kërkohet një gjë e tillë;</li><li>• Informojë për regjistrimin e mëtejshëm të deklaratës;</li><li>• Gjurmojë të dyshuarit dhe/ose garantuesit kur është e nevojshme;</li><li>• Shpëtojë të mbijetuarat e cenueshme. Paraqesë dosjet e mëparshme të të dyshuarit;</li><li>• Paraqesë dosjet e rasteve të policisë në prokurori të paktën tri ditë para datës së secancës;</li><li>• Dëshmojë në gjykatë;</li><li>• Sigurojë dëshmi me betim për përdorim në kundërshtimin e kërkesave për lirim me kusht dhe dorëzani.</li></ul>

4 'Pakoja e Resurseve të Dhunës me bazë Gjinore. Mjet i standardizuar trajnimi për mbajtësit e detyrave, palët e interesuara dhe mbajtësit e të drejtave (UN Women, 2019), ff. 92-93,



Fotografia me lejen e UNMIT/Martine Perret (Timor-Leste)

Koordinimi mes agjencive të drejtësisë mund ta minimizojë potencialin për viktimizimin për herë të dytë të viktimës/të mbijetueses, duke zvogëluar numrin e herëve që ajo duhet ta tregojë historinë e saj - ideale do të ishte, që ajo ta bëjë këtë vetëm një herë. Koordinimi do të krijojë besim dhe konfidencë të, dhe ndërmjet, të gjitha agjencive të drejtësisë, duke çuar në rritje të shkëmbimit të informacionit dhe informatave të zbulimit. Kështu mundësohet kapja e të dhënave më të sakta dhe si rrjedhojë mund të ketë më shumë mundësi parandalimi.

Procesi i vlerësimit të rrezikut duhet të koordinohet ndërmjet agjencive. Nëse secila agjenci e përgatit vlerësimin e vet të rrezikut, shtohet mundësia e që informacioni thelbësor të mund të humbasë, dhe çdo plan i mëvonshëm i sigurisë të mund të ketë boshllëqe brenda masave të tij lehtësuese.

Koordinimi efektiv mbështetet në një kornizë të dakorduar dhe transparente të praktikave të punës, me përgjegjësi të përbashkëta dhe masa të përbashkëta të performancës të hartuara në bashkëpunim me të

gjithë aktorët. Një punë e tillë e koordinuar do të kërkojë gjithashtu hartimin e protokolleve që përshkruajnë fushat e përgjegjësisë së secilës agjenci, dhe atë se ku qëndrojnë përgjegjësitë individuale dhe të përbashkët të agjencive dhe hisedarëve.

Një aspekt themelor i strukturës dhe i procesit të koordinimit është përmbushja e kërkesave të privatësisë dhe konfidencialitetit ligjor, dhe, mbi të gjitha, kujdesi ndaj nevojave të një viktime/të mbijetuarit mbetet pikë kryesore për çdo tregues të performancës. Qëllimi i përgjithshëm duhet të jetë gjithmonë nxjerrja e rezultatit më të mirë për viktimat/të mbijetuarat, çfarëdo që të duket kjo.

Me një koordinim efektiv në të gjitha agjencitë e drejtësisë, çdo informacion që u jepet viktimave/të mbijetuarave duhet të jetë konsistent, duke hequr potencialin për mesazhe të përziera, që shpijnë në konfuzion. Menaxhimi i pritjeve të viktimës/të mbijetuarës dhe i të gjithë atyre që janë të përfshirë në procesin e drejtësisë do të bëhet më i lehtë përmes një koordinimi efektiv.



Viktimizimi për herë të dytë ndodh jo si rezultat i drejtpërdrejtë i një vepre penale, por nëpërmjet reagimit joadekuat të institucioneve dhe individëve ndaj viktimës/të mbijetuarës

Koordinimi ndërmjet agjencive të drejtësisë mund të përfshijë edhe çështje ndër-juridiksionale në radhët e organizatave policore. Nëse një viktimë/e mbijetuar vjen tek ju ose stafi juaj për të raportuar një incident të DHGV-së, por incidenti ka ndodhur në kuadër të një stacioni policor, shtabi rajonal ose zone tjetër rajonale të përgjegjësive, viktimë/e mbijetuara duhet të trajtohet nga ju dhe stafi juaj, sikur incidenti të kishte ndodhur brenda zonës tuaj të juridiksionit. Çdo transferim i mëvonshëm i të dhënave të krimit ose hetimit duhet të jetë vetëm pjesë e një procesi administrativ dhe viktimë/e mbijetuara nuk duhet të dërgohet në një stacion ose zonë tjetër policie, gjë që vetëm do të shtonte traumën e përjetuar tashmë. Ky do të ishte viktimizim për së dyti dhe nuk do të përmbushte kriteret e qasjes që përqudrohet tek viktimë/e mbijetuara ose të një shërbimi policor të përgjegjshëm nga aspekti gjinor.

## BALLAFAQIMI ME SFIDAT NË REAGIMIN NDAJ DHGV-SË FILLON ME IDENTIFIKIMIN E BOSHLLËQEVE NË PERFORMANCËN E EKIPIT TUAJ

Kriminelët nuk respektojnë juridiksionin territorial të organizatave të veçanta të policisë; përkundrazi, ata mund t'i shmangen qëllimisht zbulimit, duke i kryer aktivitetet e tyre përtej kufijve dhe duke i shfrytëzuar boshllëqet në proceset tradicionale hetimore të zbatimit të ligjit. Hetimet shumë-juridiksionale mund të lëkunden, edhe në rastet kur organizatat policore kanë marrëdhënie të gjithanshme bashkëpunimi dhe linja të përgjithshme komunikimi.<sup>5</sup>

5 I nderuari Wally T. Oppal., 'FORSAKEN Raporti i Komisionit Hetues të Grave të Zhdukura: VËLLIMI IIB "Askushet": Si dhe Pse Dështuam me Gratë e Zhdukura dhe të Vrra, Pjesët 3, 4 dhe 5' (2012).

Siç u përshkrua më lart, mangësitë në përpjekjet e koordinuara nga ofruesit e shërbimeve esenciale janë burim i përbashkët i viktimizimit për së dyti për viktimat/të mbijetuarat, pasi përgjegjësia për dështimet është e vështirë të parashikohet, e madje edhe më e vështirë të përcaktohet.

Koordinimi i shkëmbimit të informacionit ndërmjet policisë dhe agjencive të tjera të zbatimit të ligjit dhe agjencive të drejtësisë është proces strategjik që mund të jetë sfidues për të funksionalizuar, për arsye burokratike.

Një sfidë e veçantë është tendenca që mekanizmat e kontrollit të brendshëm të policisë t'i anashkalojnë proceset e koordinimit të jashtëm, për shkak të kompleksitetit teknik në harmonizimin e sistemeve dhe ndjeshmërive që përfshihen në menaxhimin e rasteve.

Si rezultat, ata që kanë më shumë për të humbur si pasojë e boshllëqeve të koordinimit ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit janë viktimat/mbijetueset të krimit dhe dhunës, pasi ato nuk kanë kontroll mbi këtë proces dhe faji normalisht u ngarkohet agjencive të ndryshme kompetente, në vend që të merret përsipër kolektivisht.

Se si koordinohet policia në rastet e DHGV-së me aktorët e drejtësisë, përfshirë agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit, varet ndjeshëm nga korniza qeverisëse e vendit. Kjo vlen njësoj si për mënyrën sesi proceset e tilla të koordinimit kontrollohen me qëllim të përmirësimit të cilësisë dhe të performancës.

Për shembull, në organizatat policore, si ato në Honduras dhe Rusi, që kanë një agjenci të centralizuar policore,

### Shkëmbimi i informacionit në hetimet e dhunës në familje ka dy funksione të rëndësishme:

- Të mundësojë monitorimin efektiv të incidenteve të dhunës në familje për të dhënë informata për reagimet e shërbimeve dhe ndarjen e burimeve;
- Zgjidhjen efektive të disa rasteve të dhunës në familje, ku kërkohet reagim urgjent nga shumë agjenci.

Komisioni i OKB-së mbi Parandalimin e Krimit dhe Drejtësinë Penale (2008)





Fotografia me lejen e Force International (Bangladesh)

kontrolli i cilësisë për performancën, përfshirë edhe për koordinimin me aktorët e jashtëm të drejtësisë, i mbetet ngushtësisht menaxherit tjetër të linjës, me rrezikun që normalisht nuk ndahet ndërmjet agjencive partnere me kompetenca të ngjashme.<sup>6</sup> Si rezultat i kësaj, drejtuesit e nivelit të mesëm të policisë varen në mënyrë të konsiderueshme nga mbështetja e kolegëve dhe e nivelit të lartë, për të siguruar koordinimin efikas dhe efektiv ndërmjet njësive të policisë, të agjencive të tjera të zbatimit të ligjit, kriminalistikës civile ose ekspertëve mjeko-ligjorë dhe aktorëve të tjerë të drejtësisë.

Kjo do të thotë që nëse mekanizmat e centralizuar të kontrollit të cilësisë nuk janë vendosur sa i përket rrugës së koordinimit, ose nuk rishikohen në mënyrë rigoroze dhe periodike nga drejtuesit e policisë të nivelit të lartë, atëherë efikasiteti dhe efektiviteti i koordinimit të informacionit ose reagimeve me agjencitë e tjera të drejtësisë varet nga personaliteti i drejtuesit, në vend se të drejtohet nga organizata. Kjo jep hapësirë për shumë dështime ose boshllëqe mbrojtëse, në dëm të të gjitha viktimave/të mbijetuarave të krimit dhe dhunës, jo vetëm të viktimave/të mbijetuarave të DHGV-së.

Në modelet më të decentralizuara të policisë, ekziston një pritje në rritje që policia të kërkojë marrëdhënie pune me qeveritë lokale, komunitetet dhe aktorët e tjerë të nivelit lokal me rëndësi që paraqiten<sup>7</sup> për të për-

6 Po aty.

7 Hisedarët e nivelit lokal me rëndësi gjithnjë e më të madhe mund të përfshijnë kompani private të sigurisë që veprojnë në zona me prani të kufizuar shtetërore ose ndërmarrje të mëdha private biznesi me ndikim të konsiderueshëm në komunitete, siç janë kompanitë e mëdha të minierave.

forcuar tërësinë e drejtësisë, pasi që ata punojnë për të parandaluar dhe hetuar krimet e DHGV-së. Në teori, kjo do të thotë që rrugët e koordinimit të policisë, përfshirë atë ndërmjet agjencive të tjera të drejtësisë, duhet të vendosen nën një kontroll më të gjerë.

Si rezultat i kësaj, informata për kontrollin e cilësisë për sistemet e koordinimit të policisë mund të jepen nga disa burime, në varësi të marrëdhënies që policia ka ndërtuar me aktorët lokalë që shpesh angazhohen me ofruesit e shërbimeve esenciale.

Nëse policia nuk ka krijuar marrëdhëniet e nevojshme me aktorët kryesorë, siç parashikohet zakonisht në një model të policisë së decentralizuar (përfshirë strategjitë e Punës Policore në Komunitet), atëherë boshllëqet sistemore që minojnë koordinimin efikas dhe efektiv të policisë me aktorët e tjerë të drejtësisë bëhen praktikë e zakonshme, dhe jo ngjarje të izoluar.

Gjetja e ekuilibrit të duhur ndërmjet zgjerimit të fushës së hisedarëve vendorë (përfshirë ofruesit e tjerë të shërbimeve esenciale), që duhet të përfshihen në kontrollin e cilësisë së proceseve të koordinimit të hetimit të DHGV-së, ndërsa ruajtja e integritetit të vetë hetimit është sfiduese, por me rëndësi kritike.

Duke gjetur këtë ekuilibër, drejtuesit e policisë jo vetëm që do ta zvogëlojnë rrezikun e viktimizimit për herë të dytë me të cilin normalisht përballen viktimat/të mbijetuarit gjersa kalojnë në tërësinë e drejtësisë, por gjithashtu do të rrisë dukshmërinë e policisë në përgjithësi si një agjenci legjitime e zbatimit të ligjit.

Në vijim është dhënë një listë e dështimeve emblematike të koordinimit ndërmjet policisë dhe agjencive të tjera të drejtësisë kur reagojnë në rastet e DHGV-së. Kjo në masë të madhe është frymëzuar nga *'FORSAKEN, Raporti i Komisionit të Hetimit të Grave të Zhdukura'* nga qeveria provinciale e Kolumbisë Britanike ('BC') në Kanada që shqyrtoi përgjigjen e përgjithshme të koordinuar nga Forcat Policore të BC-së në rastet e grave të humbura, shumica e viktimave/të mbijetuarave janë gra dhe vajza me origjinë indigjene.<sup>8</sup>

8 I nderuari Wally T. Oppal, „FORSAKEN Raporti i Komisionit Hetues të Grave të Zhdukura: VËLLIMI IIB "Askushet": Si dhe Pse Dështuam me Gratë e Zhdukura dhe të Vrra, Pjesët 3, 4 dhe 5' (2012).

**“Përgjegjësia i mbetet para së gjithash Komandantit të Ekipit, i cili do të ishte autoriteti përfundimtar, përgjegjësia/llogaridhënia për [ekipin e hetimit], burimet e tij (njerëzore dhe fizike) dhe mandati i tij. Komandanti i Ekipit duhet të qëndrojë i shkëputur nga përgjegjësitë themelore të hetimit për të qenë në gjendje të menaxhojë nismën e përgjithshme. Normalisht nuk ndodh kështu, dhe Komandanti i Ekipit shpesh duhet të manovrojë me disa prioritete të tjera konkurruese, duke vënë kështu në rrezik kontrollin e cilësisë të koordinimit të përpjekjeve të policisë.”**

I nderuari Wally T. Oppal, në 'FORSAKEN Raporti i Komisionit të Hetimit të Grave të Zhdukura' (2012).

Lista është plotësuar edhe me reagimet nga një hartë e gjerë globale e praktikave të mira dhe boshllëqet në kapacitetet e institucioneve policore që i koordinojnë reagimet ndaj DHGV-së. Hartëzimi përfshinte kontaktimin me disa prej oficerëve të policisë në shërbim dhe atyre në pension, shoqërisë civile dhe stafit të organizatave ndërkombëtare si OKB të cilët kanë përvojë në punën me policinë dhe organizatat joqeveritare të specializuara në adresimin e DHGV-së.

Lista ka për qëllim t'i ndihmojë drejtuesit e policisë në identifikimin e shpejtë të boshllëqeve në kapacitete në fazën sa më të hershme të mundshme, para se të shkaktohej dëm i mëtejshëm ndaj viktimave/të mbijetuarave të DHGV-së. Titujt e kategorive kanë për qëllim ta ndihmojnë lexuesin të lidhet me një çështje kryesore të boshllëkut në kapacitetin e identifikuar, por, në fakt, ato të gjitha vlejné dhe/ose janë plotësuese për secilën pikë:

### Qëndrimi

- Qeverisja e mekanizmave koordinues është sfidë për ofruesit e shërbimeve esenciale, pasi agjencitë tentojnë t'i shmangin përballjet me njëra-tjetrën në rast dështimesh.

### Viktimizimi për së dyti

- Policia lufton për të siguruar që viktimat/e mbijetuarat të mbetet në qendër të procesit kundrejt presioneve konkurruese nga proceset e brendshme burokratike dhe kërkesat e agjencive të tjera të drejtësisë.

### Praktika e keqe

- Përpjekjet e koordinuara nga ofruesit e shërbimeve esenciale shpesh vënë shumë theks mbi kriminalizimin, duke çuar në humbjen e fokusit në interesat e viktimave/të mbijetuarave;
- Boshllëqet e koordinimit mes prokurorisë dhe policisë ndikojnë në cilësinë e menaxhimit të rasteve të DHGV-së;
- Në rastet e krimeve të rënda që përfshijnë DHGV-në (si personat e zhdukur), ekipet hetimore zakonisht nxjerren nga seksione të ndryshme të një agjencie policore dhe prandaj mund të qëndrojnë jashtë kanaleve normale të raportimit. Nevoja për raportim të qartë dhe marrëdhënie mbikëqyrëse është veçanërisht e rëndësishme në hetimet multi-juridiksionale;<sup>9</sup>
- Mungesa e bashkëpunimit brenda agjencisë çon në gabime në menaxhim të të dhënave, shqyrtim të pamjaftueshëm të dosjeve për sistemin e vlerësimit të rrezikut/raportimit; hapa hetuesorë të pa dokumentuar në mënyrë standarde, duke shkaktuar vështirësi në procesin e rishikimit dhe mungesë të vazhdimësisë së hetimit të DHGV-së;
- Pikat kryesore të koordinimit shpesh nuk kanë një strukturë të duhur raportimi dhe praktika komunikimi dhe këto veprime joadekuate kanë ndikim të dëmshëm në hetime;
- Pamundësia e adresimit të plotë të çështjeve ndër-juridiksionale nga agjencitë e policisë mund të jetë një dështim shumë i rëndësishëm i policisë, duke kufizuar kështu ndjeshëm efektivitetin e hetimeve. Policisë shpesh i mungojnë letrat e qëndrueshme të marrëveshjes ndërmjet forcave që mund të aktivizo-

<sup>9</sup> Po aty.

hen menjëherë, dhe, në vend të kësaj, shpesh humbet kohë e çmuar e hetimit në aranzhimet e hollësishme administrative ndërmjet forcave;<sup>10</sup>

- Komunikimi dështon kur shfaqen mosmarrëveshjet ndërmjet hetuesve lidhur me besueshmërinë e informatorëve.<sup>11</sup> Edhe ndarja e tepruar e informatave mund t'i vë viktimat/dëshmitarët në rrezik.

## PËRKUFIZIMI DHE KORNIZAT

PSHE-ja e konsideron **koordinimin** si element kryesor të reagimit ndaj DHGV-së. Ekzistojnë tri nivele të koordinimit që duhet të harmonizohen kur sigurohet që shërbimet esenciale po ofrohen në mënyrë cilësore dhe efektive për viktimat/të mbijetuarat e DHGV-së.

Këto tri nivele koordinimi ndodhin në nivelet kombëtare, rajonale/të departamentit, dhe lokale komunale të qeverisjes. Çdo nivel llogarit mandatet e ndryshme të secilës agjenci të drejtësisë, duke përfshirë kompetencat e mbivendosura të agjencive të zbatimit të ligjit (varësisht nga dhuna dhe krimet e identifikuar) dhe rolin në rritje të hisedarëve të jashtëm të cilët mund të ndikojnë në reagimet e koordinuara ndaj DHGV-së.

Në nivel kombëtar, ekzekutivi dhe niveli i lartë i policisë janë të përfshirë me kolegët hisedarë nga tërë sistemi i drejtësisë në planifikimin strategjik të reagimit të koordinuar të shërbimeve esenciale për viktimat/të mbijetuarat.<sup>12</sup> Pikërisht në këtë nivel, fillimisht kërkohet të kuptuarit e përbashkët e DHGV-së dhe pastaj hartohet një kornizë filozofike mbi reagimin ndaj DHGV-së në radhët e ofruesve të shërbimeve esenciale.

<sup>10</sup> Po aty.

<sup>11</sup> Po aty.

<sup>12</sup> Bashkimi Evropian thekson se planet kombëtare të veprimit për adresimin e DHNGV-së dhe mekanizmat koordinues përcjellës konsiderohen si elementë kryesorë në zbatimin e ligjeve dhe të politikave. Për më tepër, Doracaku i OKB -së i vitit 2010 mbi Legjislacionin mbi Dhunën ndaj Grave, i konsideron planet e veprimit kombëtar si rrugën kryesore në të cilën mund të garantohet një qasje gjithëpërfshirëse dhe e koordinuar për zbatimin e legjislacionit përkatës. Shih: 'Pasqyrë e praktikave më të mira botërore për parandalimin e përdhunimit dhe për të ndihmuar gratë viktime të përdhunimit' (Drejtorja e Përgjithshme për Politikën e Brendshme, Departamenti i Politikave C: Të Drejtat e Qytetarëve dhe Çështjet Kushtetuese, Barazia Gjinore, Parlamenti Evropian, 2013).

Bazuar në këtë, marrëveshjet për shkëmbimin e informatave krijohen dhe/ose përditësohen ndërmjet ofruesve të shërbimeve esenciale të nivelit të lartë, përfshirë ato mes aktorëve ekzekutivë të zbatimit të ligjit që janë me kompetenca të ndryshme, por plotësuese. Produktet kryesore nga marrëveshjet për shkëmbimin e informatave përfshijnë **memorandumet e mirëkuptimit** ndërmjet aktorëve, **udhëzimet e kontrollit të cilësisë**<sup>13</sup> dhe **komunikimet e përbashkëta** të zotimit për t'u përgjigjur DHGV-së. Këto produkte të shkëmbimit të informatave bëhen instrumente esenciale, madje shumë të rëndësishme, për drejtuesit e mesëm me ekipet që veprojnë në vijën e parë.

Drejtuesit e mesëm, stafi i të cilëve po angazhon viktimat/të mbijetuarat të DHGV-së, dhe/ose që janë të përfshirë në hetimin e DHGV-së, luajnë role kyçe në efektivitetin e **udhëzimeve të kontrollit të cilësisë**. Në varësi të gradës dhe modelit të punës policore, drejtuesit e mesëm të policisë mund të jenë të rëndësishëm në krijimin dhe/ose forcimin e kornizave të mbikëqyrjes për mekanizmat koordinues.


Kur krijohen mekanizma për të siguruar përgjigje të koordinuara ndaj DHGV-së përfshirë kornizën e tij të kontrollit të cilësisë, PSHE i rekomandon policisë që të kërkojë të përfshijë **ekipe shumë disiplinore**. PSHE shton se ekipe të tilla shumë-disiplinore duhet të përfshijnë një gamë të gjerë të **hisedarëve** që kanë hyrë në marrëveshje pune ose që kanë ndikim pozitiv kur sigurojnë një përgjigje të koordinuar në rastet kur ka DHGV me policinë dhe akterët e tjerë të drejtësisë. Shih Rubrikën 10 Nismat premtuese për koordinim në Illinois dhe Oromina për shembuj të ekipit shumë-disiplinor që përfshin hisedarë.

PSHE-ja rekomandon që policia t'i shikojë hisedarët në koordinimin e shërbimeve esenciale si të përmbledhur: viktimat/të mbijetuarat dhe përfaqësuesit e tyre, shërbimet sociale, sektorin e kujdesit shëndetësor, ofruesit e

<sup>13</sup> Sipas PSHE-së, udhëzimet mbi cilësinë, e mbështesin ofrimin dhe zbatimin e elementeve bazë të shërbimeve esenciale për të siguruar që ato janë efektive dhe me cilësi të mjaftueshme për të adresuar nevojat e grave dhe të vajzave. Udhëzimet mbi cilësinë ofrojnë 'se si të bëhet' që shërbimet të ofrohen brenda një qasjeje të bazuar në të drejtat e njeriut, të vetëdijshme për kulturën dhe fuqizimin e grave. Ato bazohen në dhe i plotësojnë standardet ndërkombëtare dhe i pasqyrojnë praktikën më të mira të njohura në përgjigjen ndaj DHNGV-së.

Figura 1:

Nivelet koordinimit qeveritar dhe hisedarët



ndihmës juridike, policinë, prokurorët, gjyqtarët, agjencitë për mbrojtjen e fëmijëve dhe sektorin e edukimit, mes tjerash.<sup>14</sup> Përfshirja e hisedarëve, e OSHC-ve, të afta për të sjellë ekspertizë në menaxhimin e rasteve kur viktimat/e mbijetuarat u përket grupeve të rrezikuara si gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, do të siguronte cilësi në shërbimet e ofruara dhe do të mundësonte qasje në drejtësi.<sup>15</sup>

Si një mjet për të instrumentalizuar kornizën e kontrollit të cilësisë për të ndihmuar në sigurimin e reagimit të koordinuar efektiv dhe efikas ndaj DHGV-së me

agjencitë e tjera të drejtësisë dhe palët e interesuara, drejtuesit e mesëm mund t'i shfrytëzojnë mekanizmat e qeverisjes vendore, si këshillat lokale të sigurisë në nivel komunal ose KLS-të.<sup>16</sup>

KLS-të janë platforma të dialogut ku agjenci të ndryshme me interes për sigurinë publike mund të konsultohen me njëra-tjetrën, t'i identifikojnë problemet dhe të pajtohen për një plan lokal për parandalimin e pasigurisë.<sup>16</sup> Bazuar në këtë, KLS-të kanë potencialin të marrin kompetenca për kontrollin e cilësisë së veprimeve të koordinuara, përfshirjen e policisë dhe partnerëve të tyre në tërësinë e drejtësisë, përfshirë kur reagimin ndaj DHGV-së.

14 PSHE po ashtu deklaron se këta hisedarë mund dhe duhet të përfaqësohen në të gjitha organet koordinuese në të gjitha nivelet e qeverisjes, në mënyrë që të sigurojnë që ligjet, strategjitë, protokollet dhe marrëveshjet kombëtare për një përgjigje efektive ndaj DHNGV-së po zbatohen, implementohen dhe/ose respektohen. Shih Modulin 5: Koordinimi dhe Qeverisja e Koordinimit, Pakoja e Shërbimeve Esenciale për Gratë dhe Vajzat që i nënshtrohen dhunës: Elementet Themelore dhe Udhëzimet mbi Cilësinë, (Programi i Përbashkët Global i Kombeve të Bashkuara mbi Shërbimet Esenciale për Gratë dhe Vajzat që i nënshtrohen Dhunës, 2015)

15 Për shembull, Cape Mental Health drejton programin SAVE për t'u siguruar të mbijetuarave me aftësi të kufizuara intelektuale mbështetje psikologjike për të dëshmuar në gjykatë. Shih: <https://www.westerncape.gov.za/facility/cape-mental-health>

**“Hisedarë kryesorë janë të gjitha agjencitë qeveritare dhe organizatat e shoqërisë civile që kanë një rol në reagimin ndaj DHNGV-së në të gjitha nivelet e qeverisë dhe të shoqërisë civile.”**

-Pakoja e Shërbimeve Esenciale e OKB-ve

16 ‘Kuptoni këshillat lokalë të sigurisë në dy minuta’, Coginta për Reformën Policore, shih: [https://www.youtube.com/watch?v=7fGFO\\_nteGA](https://www.youtube.com/watch?v=7fGFO_nteGA)

**“Gratë nuk janë grup homogjen. Për të siguruar veprim efektiv kundër DHNGV-së, nevojat specifike të grupeve të caktuara duhet të merren parasysh. Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara që përballen me dhunën dhe diskriminimin po ashtu hasin në pengesa për qasjen në drejtësi për shkak të stereotipeve të dëmshme, qëndrimeve diskriminuese dhe mungesës së lehtësirave procedurale dhe të arsyeshme, që mund të çojnë deri në vënien në dyshim të besueshmërisë së tyre dhe në hedhjen poshtë të akuzave të tyre. Pengesat për raportimin e krimeve dhe/ose rastet e diskriminimit fillojnë në komunitet ku qëndrimet e anëtarëve të familjes, përfaqësuesve të komunitetit dhe të gjyqësorit lokal mund t’i frikësojnë viktimat ose t’i dekurajojnë ato nga ndjekja e drejtësisë.”**

*Udhëzimet Gjinore (Fondi për të Drejtat e Aftësisë së Kufizuar dhe Fondi për Mbrojtjen e të Drejtave të Aftësisë së Kufizuar 2018)*

Meqenëse KLS-të normalisht përfshijnë autoritetet komunale, agjencitë e qeverisjes lokale, zyrtarët e drejtësisë e nganjëherë përfaqësues të shoqërisë civile së bashku me policinë, ato mund të gjenerojnë kontribute shumë të rëndësishme kolektive për procesin e mësimin të reagimit të koordinuar ndaj DHGV-së.<sup>17</sup> Kjo mund të përfshijë porositjen e rishikimeve dhe vlerësimeve të jashtme të reagimeve të koordinimit në rastet e DHGV-së, për shembull.

Një proces i tillë konsultativ i hapur dhe transparent për kontrollin e cilësisë që përfshin mandatet e policisë, kontribuon ndjeshëm në legjitimitetin e tyre të përgjithshëm në sytë e popullatës të cilës ata i shërbejnë dhe e mbrojnë.

<sup>17</sup> Mekanizmat e tipit KLS ekzistojnë në çdo kontinent. Në Francë dhe Republikën e Guinesë, ato quhen këshilla lokale të sigurisë për parandalimin e delikuencës (KLSPD); në Republikën Demokratike të Kongos (RDK), ato njihen si këshilla të sigurisë të komunitetit lokal ose KSKL; në Ekuador, ato njihen si këshilla komunale të sigurisë ose ‘KKS’. Në varësi të modelit dhe madhësisë së popullsisë së komunës, zyrtarët e lartë të policisë në komunitet mund të jenë përfaqësuesit kryesorë të policisë në KLS-të. Shih: Fernandez, M., Piaget, K., Hernandez, T., and Berthoud, S., ‘Decentralizimi i Qeverisjes së Sigurisë: Lehtësues i Qasjes të bazuar në të Drejtat e Njeriut (HRBA) në SSR?’, Dokumenti i Grupit Punues të ISSAT HRBA 3 (2017) dhe ‘Guide pratique conseil local de sécurité et de prévention de la délinquance en république de guinée’ (Cognita for Police Reform, 2017).

**Për informacion më të detajuar mbi KLS-të referojuni rastit studimor mbi Këshillat Lokale të Sigurisë: Kongo, Ekuador dhe Meksikë në Kapitullin 3: ‘Parandalimi’.**

## Rubrika 2

### Kriteret e BE-së për praktikën më të mira për koordinim

Në studimin e tyre mbi praktikën më të mira botërore për parandalimin e përdhunimit dhe për të ndihmuar gratë viktime të përdhunimit, BE -ja ka identifikuar pesë kriteret esenciale për koordinimin efektiv të shërbimeve për viktimat/ të mbijetuarat e përdhunimit. Aty hyjnë:

- Përfshirja kundrejt agjencive përkatëse, e aktorëve të drejtësisë penale dhe e avokatëve të të drejtave të grave ose të viktimave;
- Prononcimi i përbashkët i të kuptuarit të dhunës me bazë gjinore, përfshirë përdhunimin;
- Puna bashkëpunuese për hartimin e politikave, të udhëzimeve, referimeve dhe mekanizmave të mbledhjes së të dhënave;
- Të udhëhequrit nga ekspertiza gjinore dhe përvojat e të mbijetuarave;
- Mekanizmat e llogaridhënies dhe njëfarë pavarësie nga shteti.

Burimi: Pasqyrë e praktikave më të mira botërore për parandalimin e përdhunimit dhe për të ndihmuar gratë viktime të përdhunimit (Parlamenti Evropian, 2013).

## KOMPETENCAT KRYESORE DREJTUESE PËR KOORDINIM ME AGJENCITË E DREJTËSISË PËR NJË PËRGJIGJE EFEKTIVE NDAJ DHGV-SË

Interesit publik i shërbehet më së miri kur policia ndan informata dhe koordinohet në mënyrë efektive me ofruesit e shërbimeve esenciale për t’i identifikuar dhe ndjekur objektivat e përbashkëta në përgjigje ndaj DHGV-së.

Standardet ndërkombëtare kërkojnë që koordinimi ndërmjet policisë dhe ofruesve të shërbimeve esenciale, përfshirë partnerët në agjencitë e drejtësisë të jetë gjithëpërfshirës, shumë disiplinuar, i koordinuar, sistematik dhe i qëndrueshëm.<sup>18</sup>

Proceset e drejtësisë mund të jenë të natyrës komplekse dhe burokratike. Pa koordinim efektiv ndërmjet këtyre proceseve komplekse, të mbijetuarat/viktimat mund të bien nëpër të çara dhe t'i nënshtrohen viktimizimit për së dyti.

Viktimave/të mbijetuarave me nevoja të veçanta duhet t'u kushtohet vëmendje e veçantë, dhe, në mënyrë që atyre të mos u mohohet koordinimi i drejtësisë, duhet të adresohen barrierat me të cilat përballen viktimat/të mbijetuarat me aftësi të kufizuara gjatë procedurave gjyqësore.<sup>19</sup>

Viktimizimi për së dyti ndodh përgjatë vijimësisë së drejtësisë. Lista e mëposhtme (Rubrika 3) parasheh boshllëqe emblematike në koordinim dhe shembuj të ndikimeve të tyre në aspektin e viktimizimit për së dyti:

### Rubrika 3

Boshllëqet në koordinim	Efeksi i viktimizimit për së dyti
Policia shpesh i kushton shumë rëndësi ndjekjes penale dhe jo interesave të viktimave/të mbijetuarave.	Viktima/e mbijetuara e ndërpret bashkëpunimin nga frika e humbjes së të ardhurave nga babai i fëmijëve të saj ose bashkë-kujdestari që rezulton nga akuzat e mundshme penale. Viktima/e mbijetuara e vendos mirëqenien e perceptuar të fëmijëve të saj mbi të mirëqenien e saj.
Mjekët, gjyqtarët dhe policia që nuk janë të trajnuar për të trajtuar raste të tilla, ndërhyjnë	Praktikat e dëmshme të intervistimit të përsëritur ose detyrimi për dhënie të dëshmisë që e ritraumatizojnë viktimën, duke ndikuar në aftësinë e saj për t'i kujtuar ngjarjet në mënyrë kronologjike të pritshme ose çojnë në heqjen dorë nga përvoja e saj për të shmangur çdo angazhim të mëtejshëm të dëmshëm me ofruesit e pa trajnuar të shërbimeve esenciale.
Mungesa e bashkëpunimit brenda agjencisë çon në gabime sa i përket menaxhimit të të dhënave, shqyrtim të pamjaftueshëm të dosjeve për vazhdimin e sistemit të vlerësimit të rrezikut/raportimit.	Mungesa e vazhdimin të angazhimit nga policia dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve esenciale me viktimën/të mbijetuarën çon në frikë për sigurinë personale dhe sigurinë e anëtarëve të tjerë të familjes.
Qeverisja e funksionit të mekanizmave koordinues është sfidë për ofruesit e shërbimeve esenciale pasi që agjencitë tentojnë t'i shmangin konfrontimet me njëra-tjetrën në rast dështimesh.	Gjyqtarët kërkojnë prova shtesë të cilat është e vështirë të paraqiten, duke e bërë policinë të ushtrorë presion të panevojshëm mbi viktimën/të mbijetuarën për informata, ose që policia thjesht të ndërmjetësojë për ta bindur viktimën/të mbijetuarën që të heqë dorë ose të tërheqë ankesën e saj.
Policia lufton për të siguruar që viktimat/e mbijetuarat të mbetet në qendër të procesit përballë presioneve konkurruese nga procesi i brendshëm burokratik dhe kërkesat e agjencive të tjera të drejtësisë.	Viktimat/të mbijetuarat detyrohen të paguajnë për shërbimet mjekësore, ligjore, policore etj., për të qenë në gjendje të ndjekin penalisht rastin e vet ose detyrohen të qëndrojnë në streha "të sigurta" që janë të papërshtatshme për to. <sup>20</sup>

18 Shih: Moduli 1: *Hyrje 'Pakoja e shërbimeve esenciale për gratë dhe vajzat që i nënshtrohen dhunës' (Programi i Përbashkët Global i Kombeve të Bashkuara mbi Shërbimet Esenciale për Gratë dhe Vajzat që i Nënshtrohen Dhunës, 2015). Po ashtu, shih pjesën mbi bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet agjencive dhe shërbimeve përkatëse në Strategjitë Model të Përditësuar (2011).*

19 Parashtrimi tek Raportuesi Special për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara: Praktikat e mira për rritje të qasjes efektive në drejtësi për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, (International Enabled International Women, 9 gusht 2019)

20 Është e rëndësishme të theksohet se kostoja e oportunitetit bëhet më e lartë kur gratë janë të vetmet që e fitojnë bukën për familjen/fëmijët e tyre, dhe shkuarja në gjyq paraqet vështirësi; kështu, ato mund të zgjedhin të mos e mbështesin ndjekjen penale të çështjeve të tyre.

Për më tepër, vëmendje e veçantë në formën e *parimit të mos dëmtimit* duhet t'i kushtohet procesit të zgjedhjes së partnerëve kur bëhet koordinimi për të reaguar krimin dhe dhunës, pasi mund t'u japë status grupeve, dhe, nënkuptohet, t'ua mohojë atyre që nuk janë të njohur.<sup>21</sup> Departamenti i OKB -së për Operacionet e Paqes ('DOP i OKB') vëren se puna me komunitetet ose koordinimi me OSHC-të që përfaqësojnë komunitetet mund të jetë jashtëzakonisht e dobishme për policinë; megjithatë, policia duhet të jetë e ndjeshme ndaj ndikimit të shtrirjes së tyre në komunitete.

Në doracakun e tyre mbi punën policore të orientuar kah komuniteti, DOP i OKB-së rekomandon që policia t'i angazhojë të gjitha shtresat e komuniteteve ose përndryshe një ose më shumë grupe mund ta akuzojnë policinë për diskriminim dhe që kanë një marrëdhënie shumë të ngushtë me shtresat e tjera të të njëjtit komunitet.<sup>22</sup> Lista kontrolluese e UNPOL-it duhet të zbatohet në mënyrë të barabartë ndaj OSHC-ve që përfaqësojnë komunitetet sa herë që policia kërkon partnerë në koordinimin e përgjigjeve ndaj DHGV-së.

Në këtë drejtim, DOP-ja e OKB-së siguron një listë kontrolli të dobishme për përfshirjen e partnerëve të komunitetit dhe hisedarëve<sup>23</sup> (shih Rubrikën 4 më poshtë):

Në PSHE theksohet se një përgjigje e koordinuar ndërmjet agjencive të drejtësisë është e rëndësishme sepse është më efektive në mbajtjen e viktimave/të mbijetuarave të sigurta nga dhuna dhe mbajtjen llogaridhënës të kryesit të veprave sesa kur sektorë të ndryshëm të shoqërisë punojnë të izoluar për ta trajtuar çështjen.<sup>24</sup>

Tregues i përbashkët i koordinimit efektiv ndërmjet agjencive të drejtësisë është ndarja sistematike e informatave mbi rrezikun dhe kornizat e përcaktuara për të siguruar përgjegjësinë kolektive për shërbime esenciale cilësore dhe efektive.

Në Mbretërinë e Bashkuar, janë prezantuar veprimet e mëposhtme për të përmirësuar koordinimin ndërmjet agjencive të drejtësisë që reagojnë ndaj DHGV:<sup>25</sup>

- Qeveria e Shkëlqesisë së Saj ka hartuar një numër dokumentesh udhëzuese strategjike, të cilat kanë për qëllim të rrisin qasjen e shumë agjencive në fushat lëndore, duke përfshirë Martesën e Detyruar (MD), Gjymtimin Gjenital Femëror (GJGJF) dhe Shfrytëzimin Seksual të Fëmijëve. Këto dokumente u japin praktikuesve të vijës së parë informata shumë të vlefshme në lidhje me ato që duhet të 'Bëhen dhe ato që Nuk Duhet të Bëhen' se çfarë duhet bërë, si dhe 'Shenjat

#### Rubrika 4

##### Lista kontrolluese e UNPOL-it për përfshirjen e partnerëve të komunitetit dhe hisedarëve



- A i kemi identifikuar partnerët e komunitetit dhe hisedarët (dhe mënyrën më të mirë që ata mund të kontribuojnë në aktivitetet e projektit) sipas burimeve të tyre?
- A kemi komunikuar qartë dhe jemi dakorduar për përfshirjen e partnerëve të komunitetit dhe hisedarëve, rolet e tyre dhe si t'i menaxhojmë pritjet?
- A kemi krijuar një sistem koordinimi dhe reagimi, siç janë takimet e rregullta dhe raportet e aktiviteteve?
- A kemi krijuar një sistem komunikimi efektiv në terren për t'i informuar partnerët e komunitetit, hisedarët, vendim-marrësit, donatorët dhe të tjerët mbi progresin e aktiviteteve të projektit, sfidat dhe sukseset?

21 Doracaku i Punës Policore të Orientuar kah Komuniteti në Operacionet e Paqes të OKB-së (Departamenti i OKB-së për Operacione Paqësore, 2018).

22 Po aty.

23 Udhëzuesi Gjiner i Policisë së OKB-së: Praktikat më të mira të standardizuara për integrimin gjinor në ruajtjen e paqes: Përmbledhje e instrumenteve të projektit (2015).

24 Moduli 5: *Koordinimi dhe Qeverisja e Koordinimit*, Pakoja e Shërbimeve Esenciale për Gratë dhe Vajzat që i Nënshtrohen Dhunës - Elementet Themelore dhe Udhëzimet për Cilësinë (Programi i Përbashkët Global i Kombeve të Bashkuara mbi Shërbimet Esenciale për Gratë dhe Vajzat që i Nënshtrohen Dhunës, 2015).

25 Doracaku mbi ligjin në lidhje me dhunën ndaj grave, Angli dhe Uells, Greqi, Irlandë, Itali, Irlandë Veriore, Poloni dhe Spanjë (Fondacioni Evropian i Juristëve, 2018).



• Sistemi i drejtësisë është themeli i koordinimit, koherencës dhe relevancës ndërmjet viktimave/të mbijetuarave dhe të gjitha agjencive të drejtësisë.

dhe Simptomat' për t'u mundësuar praktikuesve të identifikojnë viktimat;

- Për të arritur atë që u cek më lartë, Shërbimi i Prokurorisë së Kurorës, Këshilli i Shefit të Policisë Kombëtare dhe Forcat e Policisë kanë kryer sesione të përbashkëta shumë të vlefshme të trajnimit dhe kanë zhvilluar protokolle të përbashkëta, veçanërisht në hetimin dhe ndjekjen penale të përdhunimit, abuzimit të bazuar në nder, martesën e detyruar dhe GJGJF.

Për ta ndihmuar policinë që të ofrojë shërbimet esenciale që mundësojnë rezultatin më të mirë për viktimat/të mbijetuarat, ky seksion do të sigurojë një listë të aftësive të sjelljes të cilave mund t'u referohen drejtuesit e policisë kur kërkojnë të koordinojnë një reagim që përqendrohet tek viktimat/e mbijetuarat dhe që të jetë i ndjeshëm në aspektin gjinor ndaj DHGV-së me agjencitë e tjera të drejtësisë. Këto aftësi mund të barten edhe tek partneritetet polici-publik, duke përfshirë aktorët lokalë, për zgjidhje të koordinuara ndaj DHGV-së që bazohen në komunitet.

Ngjashëm me kapitujt e mëparshëm, këto aftësi janë frymëzuar nga dokumentet e OKB-së siç janë *Strategjitë e Modelit të Përditësuar* (2011), praktikat e mira në ndërtime të partneriteteve polici-publik nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe *Korniza Strategjike Udhëzuese për Policinë Paqeruajtëse Ndërkombëtare* (KSU)<sup>26</sup>, mes tjerash. Kjo është një listë jo shteruese dhe ka për qëllim t'i plotësojë dhe përforcojë politikën dhe protokollin organizativ kombëtar të policisë për koordinim me agjencitë e tjera në sistemin e drejtësisë. Drejtuesit duhet të sigurojnë që punonjësit e policisë në pozicionet koordinuese të jenë në gjendje:

<sup>26</sup> Korniza Strategjike Udhëzuese për Policinë Paqeruajtëse Ndërkombëtare (KSU) synon të rrisë efektivitetin e paqeruajtjes policore të OKB-së përmes qasjeve më të qëndrueshme, të harmonizuara për sigurimin e sigurisë publike, reformën policore dhe mbështetjen për shërbimet policore të shtetit pritës. Shiko: <https://police.un.org/en/sgf>

## Disponibiliteti dhe qasshmëria (nga perspektiva e qeverisjes, mbikëqyrjes dhe e llogaridhënies)

- Të luajnë rol në koordinimin e lidhjes ndërmjet aktorëve të drejtësisë dhe avokuesve nga radhët e komunitetit. Avokuesit plotësojnë punën e punonjësve të policisë, japin reagime dhe ofrojnë trajnime. Duke ndërtuar partneritete me të drejtat e njeriut,<sup>27</sup> avokuesit e të drejtave të grave dhe të aftësisë së kufizuar, policia mund ta forcojë besueshmërinë e vet me komunitetin.

## Komunikim efektiv dhe pjesëmarrje nga hisedarët në hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e shërbimeve:

- Inkurajoni dhe ndihmoni gratë dhe vajzat që kanë përjetuar dhunë në paraqitjen dhe përcjelljen e ankësive formale, duke siguruar mbrojtje për viktimat/të mbijetuarat dhe duke i këshilluar ato se përgjegjësia për ngritjen e akuzave dhe ndjekjen penale të kryesve i takon policisë dhe shërbimeve të prokurorisë. Ofrojeni mbështetjen e duhur grave dhe vajzave me nevoja të veçanta.

**“Qëllimi kryesor i koordinimit duhet të jetë gjithmonë shtimi i sigurisë së viktimave. Koordinimi i përgjigjeve pa u fokusuar në sigurinë e viktimave, në fakt, mund të jetë i dëmshëm për viktimat.”**

Përfitimet e Koordinimit - Ndalni Dhunën ndaj Grave: Projekt i Avokuesve për të Drejtat e Njeriut

## Përshtatja

- Promovoni dhe avokoni për rregullore dhe politika të rrepta dhe të qarta në fushat e koordinimit, për t'u marrë me dilemat e mundshme etike ose ndikimet negative në marrëdhëniet e ngushta komunitet-policie, të cilat mund t'i shtyjnë viktimat/të mbijetuarat e DHGV-së që të mos raportojnë ose të mos bashkëpunojnë me policinë dhe agjencitë e tjera të drejtësisë;

<sup>27</sup> Kjo përfshin avokatët e personave me aftësi të kufizuara dhe variabla të tjera personale që i vënë njerëzit në pozita të cenueshme.



- Kërkoni mundësi për të ndarë kolektivisht arritjet, për të identifikuar mangësitë dhe për të zhvilluar dhe zbatuar strategji për të përmirësuar shtrirjen dhe reagimin.

### Përshtatshmëria

- Orientoni përpjekjet e koordinimit ashtu që ato t'i mbajnë interesat e grave dhe vajzave në qendër të dhunës me bazë gjinore dhe ndërhyrjeve ndaj përdhunimit.<sup>28</sup>

### Lidhja me sektorët dhe agjencitë e tjera përmes referimit dhe koordinimit

- Punoni me agjencitë e drejtësisë dhe aktorët e komunitetit për të arritur një konsensus dhe angazhim të gjerë në lidhje me pjesën e tyre të përgjegjësisë dhe nevojën për bashkëpunim të ngushtë;
- Ndiqni një qasje të zgjidhjes së problemeve kur bashkëpunoni me hisedarët për të siguruar që viktimat/të mbijetuarat e DHGV-së të ndjejnë se mund të marrin pjesë në mënyrë domethënëse në të gjitha aspektet e hetimit. Për shembull, së bashku me aktorët e tjerë të drejtësisë, krijoni një proces bashkëpunimi përfshirës me drejtuesit e komunitetit dhe mediat lokale si pjesë e përpjekjeve për të mos stigmatizuar ose marginalizuar në aspektin social viktimat/të mbijetuarat e dhunës seksuale dhe komunikojeni këtë angazhim publikisht;
- Koordinoni monitorimin e ndërhyrjeve ndaj dhunës në familje ose rishikimin e qasjeve të veçanta (mbledhja e të dhënave) dhe mjeteve me aktorët e tjerë të drejtësisë dhe hisedarët e komunitetit. Identifikimi i boshllëqeve në shërbim, përfshirë ngritjen e vetëdijes. Kërkesa për përmirësim të shërbimit në mënyrë bashkëpunuese duhet të jetë një nga objektivat e koordinimit për policinë.<sup>29</sup>

<sup>28</sup> Pasqyrë e praktikave më të mira botërore për parandalimin e përdhunimit dhe për të ndihmuar gratë viktimat të përdhunimit, (Drejtorja e Përgjithshme për Politikën e Brendshme Departamenti i Politikave C: Të Drejtat e Qytetarëve dhe Çështjet Kushtetuese Barazia Gjinore, Parlamenti Evropian, 2013).

<sup>29</sup> Logar, Rosa, 'Modeli austriak i ndërhyrjes në rastet e dhunës në familje', Dokument i paraqitur në Takimin e Grupit të Ekspertëve të OKB -së: Dhuna kundër grave: Praktikë e mirë në luftimin dhe eliminimin e dhunës ndaj grave' (Vjenë, 17–20 maj 2005).

### Mbledhja e të dhënave dhe menaxhimi i informacionit

- Koordinohuni me agjencitë e drejtësisë për ndarjen në mënyrë etike të informacionit të ndjeshëm për strategjitë e parandalimit, me një gamë të gjerë të aktorëve që bazohen në komunitet, si shërbimet private të sigurisë, për kontrollet e historikut kriminal, veçanërisht në rastet e kryesve të veprave të dhunës seksuale.<sup>30</sup>

### Pëlqimi si rezultat i informimit dhe konfidencialiteti

- Krijoni dhe mbani marrëdhënie pune me një gamë të gjerë hisedarësh drejt një rezultati hetimor, duke qenë të kujdesshëm në gjykim për të balancuar integritetin e hetimit, përfshirë të drejtën e viktimave/të mbijetuarave për trajtim dinjitoz dhe konfidencial;
- Kujdesuni që në procesin e kërkimit të pëlqimit si rezultat i informimit të arrihet pajtimi dhe të njihet mirë nga të gjithë aktorët në procesin gjyqësor, veçanërisht në rastet kur grave u mohohet zotësia e tyre ligjore për të vendosur për veten e tyre.

### Treguesit relevantë për policinë që ofron shërbime esenciale: Koordinimi ndërmjet agjencive të drejtësisë

Koordinimi merr forma të ndryshme, disa më të formalizuara dhe me më shumë implikime në zhvillimin e politikave; të tjerët më pak të formalizuara dhe të orientuara drejt një angazhimi më efikas me individë viktimat/të mbijetuarat. Një përgjigje e koordinuar është e rëndësishme sepse është më efektive në mbajtjen e viktimave/të mbijetuarave të sigurta nga dhuna dhe mbajtjen llogaridhënës të shkelësve sesa kur sektorët të ndryshëm të shoqërisë punojnë të izoluar për ta trajtuar çështjen. Me koordinim sigurohen përfitime për viktimat/të mbijetuarat, e po ashtu për agjencitë dhe institucionet që reagojnë kundër dhunës ndaj grave, si dhe për komunitetet e tyre.<sup>31</sup>

<sup>30</sup> Udhëzime për Ofruesit Privatë të Sigurisë për Parandalimin dhe Adresimin e Shfrytëzimit dhe Abuzimit Seksual (Shoqata Ndërkombëtare e Kodit të Sjelljes për Ofruesit Privatë të Shërbimeve të Sigurisë, 2019).

<sup>31</sup> Shih Moduli 5: *Koordinimi dhe Qeverisja e Koordinimit*, PSHE (2015).

Siç u diskutua në Kapitullin 2, në PSHE propozohet që të gjitha shërbimet e drejtësisë dhe të mbështetjes për viktimat/ të mbijetuarat duhet t'i kenë një sërë karakteristikash dhe aktivitete të përbashkëta për të siguruar efektin maksimal. Ato janë të zbatueshme pavarësisht nga 'sektori' specifik që mund t'u përgjigjet grave dhe vajzave që po përjetojnë dhunë. Lista e mëposhtme është frymëzuar nga karakteristikat dhe aktivitetet e përbashkëta të PSHE-së; aty propozohen disa tregues relevantë për aktivitetet e policisë kur synohet të ofrohen shërbime esenciale në një përgjigje të koordinuar që përqendrohet në viktimat/mbijetuarat dhe në ndjeshmëri nga aspekti gjinor ndaj DHGV-së.

Këta janë treguesit të cilëve mund t'u referohen drejtuesit e policisë, nëse ekzistojnë, por po ashtu të inkurajojnë përfshirjen e tyre nga nivelet e larta në rastet kur ata nuk ekzistojnë:

- **Disponibiliteti dhe qasshmëria:** Përqindja e stafit të policisë së stacionit që merr pjesë rregullisht ose ka marrë pjesë në proceset e koordinimit formal dhe/ose joformal me agjencitë e drejtësisë në rastet e DHGV. Ky tregues duhet të kategorizojë personelin e policisë sipas gjinisë, gradës, njësisë dhe të verifikojë nëse ata janë trajnuar në mënyrë adekuate për të pasur qasje në ofruesit e tjerë të shërbimeve esenciale, përfshirë agjencitë e drejtësisë. Ky tregues do t'u japë informata edhe për masën në të cilën policia e stacionit gjendet në pozicionet e *Reaguesit të Parë* në incidentet e DHGV.
- **Përshtatja dhe qasshmëria:** Përqindja e proceseve të koordinimit që përfshijnë ekipet e policisë lokale të cilat llogarisin në pjesëmarrjen domethënëse të një organizate të shoqërisë civile ('OSHC') siç është një organizatë për të drejtat e grave. Këta mekanizma duhet t'i përfshijnë në mënyrë aktive organizatat e grave, pavarësisht përkatësisë etnike, moshës së tyre,<sup>32</sup> fesë, paaftësisë, gjuhës dhe orientimit seksual, pasi që diversiteti në përfaqësim mund të japë një përshkrim më të saktë të çështjeve. Përqindja e ulët e pjesëmar-

<sup>32</sup> Mekanizmat koordinues duhet të sigurojnë që zërat e grave dhe vajzave të reja të dëgjohen, duke u kushtuar vëmendje cenueshmërive me të cilat ato përballen. Ngjashëm, mekanizmat e koordinimit duhet të sigurojnë trajtimin e nevojave dhe pengesave specifike me të cilat ballafaqohen gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara gjatë qasjes në drejtësi.

rjes domethënëse nga OShC-të, mund të nënkuptojë mungesë besimi, ose mungesë të planifikimit logjistik ose një kombinim të të dyjave.

- **Përshtatshmëria dhe qasshmëria:** Përqindja e proceseve të koordinimit që përfshijnë ekipet e policisë lokale të cilat llogarisin në ekspertizën gjinore. Ekspertiza gjinore duhet të luajë një rol të madh në kontekstualizimin e DHGV-së me ofruesit e shërbimeve esenciale, përfshirë policinë, dhe t'i ndihmojë ata që të sigurohen se ata dhe komuniteti, e kuptojnë dhe reagojnë ndaj DHGV-së. Ekspertiza gjinore mund të ndihmojë edhe për të siguruar një kornizë të përbashkët filozofike të DHGV-së ndërmjet ofruesve të shërbimeve esenciale.
- **Vendoseni si prioritet sigurinë:** Përqindja e proceseve të koordinimit që përfshijnë ekipe të policisë lokale që kanë përcaktuar një zyrtar kryesor kontaktues ose një pikë kontaktimi që mbikëqyr protokollet për sigurinë dhe mbrojtjen e viktimave/të mbijetuarave (shih Rubrikën 10 mbi rolin mbikëqyrës të KKDHF-ve). Zyrtari kontaktues ose pika kontaktuese duhet të jetë rol që ndërrohet me rotacion ndërmjet ofruesve të specializuar të shërbimeve esenciale me qëllim sigurimin e qarkullimit të informatave, veçanërisht sa i përket vlerësimit të rrezikut, dhe koordinimin e masave të sigurisë dhe mbrojtjes përmes hetimeve të ndryshme. Në këtë rol duhet të përfshihet edhe përforsimin i të kuptuarit të përbashkët të roleve që luhen nga aktorë të ndryshëm dhe të kuptuarit e përditësuar të boshllëqeve në sistem.<sup>33</sup>
- **Pëlqimi si rezultat i informimit, konfidencialiteti dhe qasshmëria:** Përqindja e proceseve të koordinimit që përfshijnë ekipe të policisë lokale që i rishikojnë politikën, procedurat dhe protokollet e tyre të standardizuara për ndërhyrje ndaj DHGV-së. Duhet të vendoset një theks i fortë në respektimin e pëlqimit dhe etikës së konfidencialitetit nga policia dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve esenciale - për të gjitha gratë dhe vajzat - përfshirë ato me aftësi të kufizuara intelektuale, ato

<sup>33</sup> E frymëzuar nga 'Përmbledhja e praktikave më të mira botërore për parandalimin e përdhunimit dhe për të ndihmuar gratë viktimat të përdhunimit (Drejtorja e Përgjithshme për Politikën e Brendshme Departamenti i Politikave C: Të Drejtat e Qytetarëve dhe Çështjet Kushtetuese Barazia Gjinore, Parlamenti Evropian, 2013).

me vështirësi në të nxënë ose me aftësi të kufizuara shqisore.

- **Komunikim efektiv dhe pjesëmarrje nga hisedarët në hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e shërbimeve:**

Numri/në vit i trajnimeve të përbashkëta të agjencive mbi proceset e koordinimit që përfshijnë stafin e policisë së stacionit. Kjo duhet të përfshijë përforsimin e të kuptuarit të përbashkët të DHGV-së, definicionet e përbashkëta, riafirmimin e pritjeve dhe të praktikave më të mira, si dhe mënyra se si ndërhyrjet nga secili sektor kontribuojnë në rritjen e sigurisë së viktimave/ të mbijetuarave.

- **Mbledhja e të dhënave dhe menaxhimi i informacionit:**

Përqindja e ekipeve të policisë që kanë kryer studime bazike për të dhënë informata për planifikimin operativ dhe për t'i identifikuar pengesat në koordinimin e suksesshëm. Monitorimi dhe vlerësimi ofrojnë mundësi për të kuptuar dhe mësuar se si funksionojnë sistemet e koordinuara. Ndarja e gjetjeve të monitorimit dhe vlerësimit mundëson që reagimet e koordinuara të përmirësohen dhe hisedarët të marrin pjesë dhe të marrin vendime për përmirësimet

- **Lidhja me sektorët dhe agjencitë e tjera përmes koordinimit:**

Numri i vlerësimeve ose i rishikimeve të paravara (por konfidenciale) të partneriteteve policore që përfshijnë ekipe të policisë lokale që synojnë strategjitë e reagimit ndaj DHGV-së. Këto vlerësime ose rishikime mund të japin informata për efektivitetin e koordinimit ndërmjet agjencive ose qasjeve ndaj DHGV-së. Ato mund të vlerësohen nga:

- kryerja e anketave të perceptimit publik dhe intervistave të fokus grupeve mbi performancën e policisë dhe situatën e sigurisë në komunitet;
- kryerja e raporteve të mbikëqyrjes së brendshme dhe publike mbi policinë; analizimi i raporteve të mediave;
- mbajtja e shënimeve për aktivitetet polici-komunitet;
- analizimi i qëndrueshmërisë së forumeve publike formale dhe joformale, etj.<sup>34</sup>

---

34 Shih "Praktika të mira në ndërtimin e Partneriteteve Polici-Publik nga Këshilltari i Lartë Policor i Sekretarit të Përgjithshëm të OSBE-së (Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë, 2008).

## Rubrika 5

### Nismat premtuese për koordinim në Illinois dhe Oromina

#### Këshillat Koordinues kundër Dhunës në Familje ('KKDHFI') Illinois, SHBA

Këshillat Koordinues kundër Dhunës në Familje të Illinois (KKDHFI) nisën punën e tyre nën kujdesin e Gjykatës Supreme të Illinois në 1990, si për nivelin shtetëror, ashtu edhe atë lokal/të qarkut. KKDHFI-të thirren dhe kryesohen nga shefat dhe gjyqtarët e qarkut dhe përbëhen nga vendim-marrës të nivelit të politikave të cilët përfaqësojnë agjencitë dhe shërbimet që ndërhyjnë dhe parandalojnë dhunën në familje. Në këto këshilla marrin pjesë policia, agjencitë e drejtësisë dhe OSHC-të.

KKDHFI-të ofrojnë forum për të përmirësuar reagimin institucional, profesional dhe komunitar ndaj dhunës në familje. Ato ofrojnë edukim dhe parandalim profesional; koordinojnë ndërhyrjet dhe shërbimet për viktimat/të mbijetuarat dhe kryesit, dhe kontribuojnë në përmirësimin e sistemit ligjor dhe administrimin e drejtësisë.

Për ta lehtësuar koordinimin, organizohen takime të rregullta të komitetit drejtues, me pjesëmarrjen e gjyqësorit, shërbimit të prokurorisë, policisë së shtetit, departamenteve përkatëse qeveritare dhe OSHC-ve.

Grupet e punës që përbëhen nga anëtarët e Komitetit Këshillëdhënës, stafi i KKDHFI-së së Illinois, koordinatorët e Këshillit Lokal dhe anëtarët e Këshillit Koordinues kundër Dhunës në Familje i rishikojnë protokollin, i përditësojnë statutet dhe krijojnë resurse të reja për protokollin e koordinimit dhe të reagimit. Për shembull, në vitin 2018, KKDHFI mori pjesë në rishikimin e Protokollit të Prokurorit për Reagimin ndaj Viktimave me Aftësi të Kufizuara dhe të rriturve të moshuar që përjetojnë sulme seksuale, dhunë në familje, abuzim, neglizhim ose shfrytëzim.

Burimi: Këshillat Koordinues kundër Dhunës në Familje (KKDHFI) dhe Protokollin e Prokurorit për Reagimin ndaj Viktimave me Aftësi të Kufizuara dhe të rriturve të moshuar të cilët përjetojnë sulme seksuale, dhunë në familje, abuzim, neglizhim ose shfrytëzim, (Shteti i Illinois, Autoriteti Informativ i Drejtësisë Penale në Illinois).

#### Qendrat me një ndalesë, Etiopi

Qendrat me një ndalesë në rajonin e Oromisë u prezantuan për herë të parë në qytetin Adama nga Qeveria në 2013 me mbështetjen e UNICEF-it. Qendra ofron shërbime mjekësisë-ligjore (mjeko-ligjore) dhe psiko-sociale për viktimat/të mbijetuarat e dhunës seksuale të cilët po ashtu mund të marrin shërbime të koordinuara nga policia dhe prokurori të gjitha në një vend.

Më vonë, dy qendra të tjera u krijuan në qytetet Shashamane dhe Jimma. Që atëherë qeveria i ka standardizuar këto qendra përmes hartimit të procedurave operative standarde dhe të strategjive.

Në Adama, Oromia \*, Qendra me një ndalesë ka një punonjës social të trajnuar dhe të përkushtuar, prokuror, zyrtarë policor, një infermiere, një nëpunës, një mjek dhe një psikiatër profesionist. Qendra është e lidhur me Byronë për Çështjet e Grave, të Fëmijëve dhe të Rinisë, Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm, policinë, Gjykatën e Lartë Speciale dhe OJQ-të lokale.

Mbikëqyrja sigurohet nga Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm përmes një komiteti drejtues shumë-sektorial. Komiteti e drejton dhe koordinon ofrimin e shërbimeve kryesore si hetimet policore, këshillimin, trajtimin mjekësor dhe ndihmën juridike falas.

Qendrat me një ndalesë kontribuojnë në organin kombëtar koordinues për parandalimin dhe reagimin ndaj DHNGV-së, që udhëhiqet nga Prokurori i Përgjithshëm Federal. Ky organ mbështetet me mjete operative si strategjia kombëtare pesëvjeçare dhe plani i veprimit.

Aktualisht, nismat e Qeverisë, me mbështetjen e UN Women, përfshijnë tubimin e tre sektorëve të drejtësisë (policia, prokurorët publikë dhe gjyqtarët) për një trajnim të standardizuar se si të koordinohen dhe reagojnë ndaj DHNGV-së. Kjo nismë filloi në vitin 2016 në një nga shtetet rajonale, me qëllim forcimin e koordinimit dhe rritjen e shkallës së ndjekjes së rasteve të DHNGV-së në rajon.

Burimi: Kifete\*, K. 'Sigurimi i një përgjigje të koordinuar për të mbijetuarat e dhunës seksuale në Rajonin Oromia, Etiopi' (UNICEF, 2019)



## SHËNIME DHE REKOMANDOHEN PËR LEXIM

1. Praktikat e mira në ndërtimin e partneriteteve polici-publik nga këshilltari i lartë i policisë i Sekretarit të Përgjithshëm të OSBE-së (Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, 2008), shih: <https://www.osce.org/secretariat/32547?download=true>
2. Anneke Osse, Kuptimi i Policimit: Një Burim për Aktivistët e të Drejtave të Njeriut (Amnesty International, 2006)
3. Manuali i Operacioneve të Paqes të Kombeve të Bashkuara për policimin e orientuar nga komuniteti (UN DPO, 2018), shih: <https://police.un.org/sites/default/files/manual-community-oriented-policing.pdf>
4. Udhëzime për Integrimin e Ndërhyrjeve të Dhunës me Bazë Gjinore në Veprimet Humanitare: Reduktimi i rrezikut, promovimi i qëndrueshmërisë dhe ndihma për rimëkëmbjen (Komiteti i Përhershëm Ndër-Agjencior, 2015), shih: [https://gbvguidelines.org/wp/wp-content/uploads/2015/09/2015-IASC-Gender-based-Violence-Guidelines\\_lo-res.pdf](https://gbvguidelines.org/wp/wp-content/uploads/2015/09/2015-IASC-Gender-based-Violence-Guidelines_lo-res.pdf)
5. Moduli 5: Koordinimi dhe Qeverisja e Koordinimit, Pako Esenciale e Shërbimeve për Gratë dhe Vajzat që i nënshtrohen Dhunës: Elementet Themelore dhe Udhëzimet e Cilësisë (Programi i Përbashkët Global i Kombeve të Bashkuara mbi Shërbimet Thelbësore për Gratë dhe Vajzat Subjekt i Dhunës, 2015), shih: <https://www.unwomen.org/-/media/headquarters/attachments/sections/library/publications/2015/essential-services-package-module-5-en.pdf?la=en&vs=3759>
6. Praktika të mira në ndërtimin e partneriteteve polici-publik nga këshilltari i lartë i policisë i Sekretarit të Përgjithshëm të OSBE-së (Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, 2008).
7. 'Të kuptojmë këshillat vendore të sigurisë në dy minuta' Coginta për Reformat e Policisë, shih: [https://www.youtube.com/watch?v=7fGfo\\_nteGA](https://www.youtube.com/watch?v=7fGfo_nteGA)
8. Qu'est ce qu'un CLSPD - CISPD? (Qeveria e Francës), shih: <http://www.isere.gouv.fr/Politiques-publiques/Securites/Securite-publique/Prevention-de-la-delinquance2/Qu-est-ce-qu-un-CLSPD-CISPD>
9. 'Guide pratique conseil local de sécurité et de prévention de la délinquance en république de' <http://94.23.195.75/uploads/documents/cedd246fbc7d-133bcf29135bec8a66d561202ae4.pdf>
10. Fernandez, M., Piaget, K., Hernandez, T., dhe Berthoud, S., "Decentralizimi i qeverisjes së sigurisë: Lehtësues i një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut (HRBA) ndaj RSS?' Dokument i Grupit të Punës të ISSAT HRBA 3 (2017), shih: <https://issat.dcaf.ch/download/111714/2027474/HRBA%20Working%20Group%20Paper%203.pdf>
11. 'Aspekte të dhunës ndaj grave që i përkasin drejtpërdrejt Komisionit për Parandalimin e Krimit dhe Drejtësinë Penale', Komisioni për Parandalimin e Krimit dhe Drejtësinë Penale V.08-52191 (E) \*0852191\* (Sesioni i shtatëmbëdhjetë, Vjenë, 14-18 prill 2008).
12. UN Women: Iniciativat kryesore të Programit, shih: <https://www.unwomen.org/en/how-we-work/flagship-programmes>
13. Përfitimet e Koordinimit. Stop dhunës kundër grave: Një projekt i Avokatëve për të Drejtat e Njeriut, shih: [http://www.stopvaw.org/Benefits\\_of\\_Coordination.html](http://www.stopvaw.org/Benefits_of_Coordination.html)
14. Një studim për krijimin e një mekanizmi multidisiplinar RPSHEonse për dhunën kundër grave në Egjipt (UNODC, 2015).
15. Manual mbi ligjin në lidhje me dhunën ndaj grave, Angli dhe Uells, Greqi, Irlandë, Itali, Irlandë Veriore, Poloni, Spanjë (Fondacioni i Avokatëve Evropian, 2018), shih: <https://elf-fae.eu/wp-content/uploads/2018/06/Manual-on-the-law-relating-to-violence-against-women.pdf>
16. Studim tematik mbi çështjen e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe aftësisë së kufizuar, Raport i Zyrës së Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, 30 mars 2012, (A/HRC/20/5) në: <https://www2.ohchr.org/english/issues/women/docs/A.HRC.20.5.pdf>
17. Dorëzimi për Raportuesin Special për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara: Praktika të mira për rritjen e qasjes efektive në drejtësi për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, (Women Enabled International, 9 gusht 2019) në: <https://www.womenenabled.org/pdfs/WEI%20Access%20to%20Justice%20Good%20Practices%20Submission%20to%20UN%20Special%20Rapporteur%20on%20Persons%20with%20Disabilities,%20Aug%209,%202019.pdf>
18. Manuali mbi Policimin e Orientuar nga Komuniteti në Operacionet e Paqes të Kombeve të Bashkuara (UN DPO, 2018), shih: <https://police.un.org/en/manual-community-oriented-policing-in-peace-operations>
19. Pako e Instrumenteve Gjinore e Policisë së OKB-së: Praktikat më të mira të standardizuara mbi integrimin gjinor në ruajtjen e paqes: Përmbledhja e Mjeteve të

Projektit (2015), shih: <http://repository.un.org/bit-stream/handle/11176/387374/United%20Nations%20Police%20Gender%20Toolkit%20Compendium%20of%20Project%20Tools.pdf?sequence=55&isAllowed=y>

20. Protokollit i Prokurorit për reagimin ndaj viktimave me aftësi të kufizuara dhe të rriturve të moshuar që përjetojnë sulme seksuale, dhunë në familje, abuzim, neglizhencë ose shfrytëzim (Shteti i Illinois, Autoriteti i Informacionit për Drejtësinë Penale të Illinois), në: [http://www.icjia.state.il.us/assets/ifvcc/Model%20Protocols/PWD\\_OA\\_Prosecutor\\_Protocol\\_113018.pdf](http://www.icjia.state.il.us/assets/ifvcc/Model%20Protocols/PWD_OA_Prosecutor_Protocol_113018.pdf)
21. Këshillat Koordinuese të Dhunës Familjare (IFVCC), Illinois, shih: <http://www.icjia.state.il.us/ifvcc>
22. Protokollit i Prokurorit për reagimin ndaj viktimave me aftësi të kufizuara dhe të rriturve të moshuar që përjetojnë sulme seksuale, dhunë në familje, abuzim, neglizhencë ose shfrytëzim, (Shteti i Illinois, Autoriteti i Informacionit të Drejtësisë Penale të Illinois), në: [http://www.icjia.state.il.us/assets/ifvcc/Model%20Protocols/PWD\\_OA\\_Prosecutor\\_Protocol\\_113018.pdf](http://www.icjia.state.il.us/assets/ifvcc/Model%20Protocols/PWD_OA_Prosecutor_Protocol_113018.pdf)
23. Kefetew, K., Sigurimi i reagimit të koordinuar për të mbijetuarit e dhunës seksuale në Rajonin e Oromisë, Etiopi (UNIFEF, 2019), shih: <https://www.unicef.org/ethiopia/stories/providing-coordinated-rPSHEonse-survivors-sexual-violence-oromia-region>



## KOMUNIKIMI

*“Komunikimi është çelësi për ndërtimin e besimit dhe arritjen e qëllimeve në mënyrë efektive.”*

**Paketa e Veglave Gjinore të UNPOL-it (2015).**

---

# KAPITULLI QËLLIMI

---

**Policia ka fuqizuar viktimat/të mbijetuarat e DHGV në të gjithë sistemin e drejtësisë duke komunikuar dhe dëgjuar në një mënyrë që ofron një ndjenjë sigurie, kap nevojat e saj të ndryshueshme të drejtësisë, mundëson një marrëdhënie të bazuar në konfidencialitet dhe privatësi.**

---

## Mesazhet Kryesore dhe Pikat e Mësimit

- Identifikimi dhe trajtimi i çdo gjinie dhe anshmërive tjera të dëmshme të ndërlidhura të komunikuar nga stafi i tyre është pjesë e përgjegjësisë komanduese të menaxherit/drejtuesit të ekipit;
- Përdorimi i aftësive të dëgjimit 'Aktiv' është një pjesë vitale e komunikimit me viktimat/të mbijetuarit, duke siguruar që ata të mos gjykohen nga 'dëgjuesi' teksa tregojnë historinë e tyre;
- Ndërtoni besim dhe raport me viktimën/të mbijetuarën për të siguruar që ajo ndihet e sigurt në historinë e saj, vërtetoheni atë dhe sigurojeni që ajo nuk është fajtores;
- Shpjegoni plotësisht procesin e hetimit dhe drejtësisë dhe mbani kontakte për të siguruar informacion të përditësuar dhe të koordinuar;
- Aftësitë e dobëta të komunikimit ndaj viktimave/të mbijetuarve të DHGV -së ka ndikime traumatike të qëndrueshme dhe nxit raportimin e pamjaftueshëm në përgjithësi;
- Anshmëria gjinore nxitet nga mungesa e të kuptuarit të diskriminimit që prek gratë dhe vajzat në mënyrë disproporcionale;
- Mungesa e pëlqimit është një pararendëse e dhunës seksuale dhe krimeve të bazuara në seks.





# HYRJE

Përveç angazhimit të përditshëm me komunitetet dhe viktimat/të mbijetuarit e dhunës dhe krimit, policia duhet të angazhohet me një gamë të gjerë të agjencive të drejtësisë dhe hisedarët lokalë për të siguruar ofrimin e shërbimeve thelbësore. Si rezultat, një gamë e gjerë e aftësive ndërpersonale për t'i mundësuar policisë të komunikojë në mënyrë efektive janë ndoshta më vendimtare se kurrë.

Foto me mirësjellje nga UNIFIL/Pasqual Gorris (Liban)

Nga jashtë, policia e vijës së parë angazhohet me viktimat/të mbijetuarit dhe qytetarët e shqetësuar të të gjitha prejardhjeve. Kjo kërkon një ndjenjë të fortë ndjeshmërie, dhembshurie, komunikimi jo verbal dhe dëgjimi aktiv së bashku me aftësinë për të përshtatur stilin e komunikimit me nevojat e bashkëbiseduesve të ndryshëm sipas moshës, nivelit të arsimit, aftësisë për të dëgjuar dhe/ose kuptuar.

Në nivel individual, aftësi të tilla janë kyçe për të siguruar viktimat/të mbijetuarit, për të qetësuar njerëzit, për të përshkallëzuar dhunën, për të siguruar qartësi gjatë transmetimit të informacionit në lidhje me rolet

dhe proceset (të përshtatura për personin me të cilin po angazhohen), dhe zhvillimin e një marrëdhënie pune ose bashkëpunimi për të adresuar çështjet e sigurisë publike.

Anshmëria gjinore është një prirje drejt, ose anshmëria ndaj një gjinie kundrejt tjetrës (ve). Anshmëria gjinore, qoftë i nënkuptuar (i pandërgjegjshëm) apo i qartë (i ndërgjegjshëm) - formësohet dhe informohet nga stereotipet dhe qëndrimet e bazuara në gjini që u caktojnë karakteristika, role dhe sjellje të ndryshme burrave kundrejt grave - dhe kjo përfshin rolet dhe sjelljet seksuale.



**“Komunikimi përfshin bashkëveprimin me komunitetet, dëgjimin e pikëpamjeve dhe ideve të tyre dhe veprimin mbi to në një mënyrë që përmirëson performancën e policisë dhe ofrimin e shërbimeve.”**

Kolejji i Policimit në Mbretërinë e Bashkuar

Institucionalisht, të gjithë oficerët e policisë, pavarësisht nga grada duhet të jenë të përgatitur për t'u angazhuar në mënyrë efektive me përfaqësuesit e komunitetit, shoqërinë civile, përfaqësuesit e tjerë të zbatimit të ligjit dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve thelbësore. Gjatë këtyre angazhimeve, komunikimet e policisë

duhet të synojnë të jenë transparente, të qarta për pritjet dhe rolet, të qëndrueshme, të drejtuara kah zgjidhja, gjithëpërfshirëse dhe bashkëpunuese.

Brenda organizatës, komunikimet ndërpersonale të policisë diktohen nga kodet e sjelljes, kornizat e integritetit (sipas doktrinës) dhe pritshmëritë e lidershit përpara i përket përgjegjësisë komanduese. Menaxherët e policisë pritet të përforcojnë këto kode, korniza dhe pritshmëri në baza ditore dhe në një mënyrë verbale të aftë me stafin e tyre për të siguruar disiplinë dhe integritet që mbështet efektivitetin dhe efikasitetin operacional.


Kjo duhet të përfshijë sigurimin e qartësisë kur një polic tjetër koleg ose një grup oficerësh nuk i kuptojnë apo madje vënë në dyshim politikat kombëtare ose vendimet institucionale. Adresimi i DHGV dhe formave të tjera të DBGJ është një çështje që thirret në shumë anshmëri të nënkuptuara dhe eksplicite të dëmshme pasi është e lidhur në mënyrë të natyrshme me normat e perceptuara shoqërore dhe kulturore që janë patriarkale dhe të natyrës diskriminuese.

Meqenëse shumë oficerë policie mund të mos kenë një vetëdije adekuate për dëmin që anshmëria e nënkuptuar dhe eksplicit mund të ketë në polici, nuk është e pazakontë që ata të vënë në dyshim rëndësinë dhe/ose zbatueshmërinë e politikave dhe strategjive që rezultojnë në lidhje me barazinë gjinore që kërkojnë ndryshime të sjelljes nga ato.

Menaxherët e policisë duhet të udhëheqin me shembull dhe të jenë të përgatitur për të identifikuar çdo gjini dhe anshmeritë tjera ndër lidhëse të dëmshme<sup>1</sup> dhe të adresojnë pyetje të tilla ose qëndrime shqetësuese kur ato lindin duke komunikuar qartë kornizat, objektivat e politikave ose kodit ndaj sigurisë publike, përfitimet për komunitetet dhe policimin në përgjithësi, si dhe pasojat kur ndodh pa-pajtueshmëria.

Kjo bëhet e domosdoshme që programet për trajnimin e oficerëve dhe sistemet organizative mbështetëse (të tilla

<sup>1</sup> Anshmëritë që ndikojnë në qëndrimin dhe sjelljen janë të lidhura me faktorë të ndryshëm të kryqëzimit si gjinia, moshja, paaftësia fizike, përkatësia etnike, orientimi seksual dhe prapavija social-ekonomike ndër të tjera.



*Ndjeshmëria gjinore merr parasysh nevojat dhe perspektivat unike të viktimës/të mbijetuarës, duke respektuar dinjitetin dhe integritetin e saj dhe duke minimizuar ndërhyrjen duke respektuar standardet për mbledhjen e provave mjeko -ligjore.*

si skemat e mentorimit) të sigurojnë mjetet dhe aftësitë ndërpersonale të komunikimit kur bëhet përgatitja e zyrtarëve policor për përgjegjësi komanduese në mënyrë që ata të jenë të vendosur më mirë për të zbutur ndikimin nga anshmëritë e dëmshme që dëmtojnë hetimin dhe përpjekjet e parandalimit të policisë për DHGV.

Sisteme të tilla trajnimi dhe mbështetjeje kanë nevojë për politika dhe strategji institucionale që të krijohen dhe të përforcohen nga lidershipi i lartë i përkushtuar, të cilët janë të përgatitur të japin përparësi në aftësitë komunikuese të **ndjeshme ndaj gjinisë**, si kompetenca kryesore për policimin e përditshëm. Kjo është veçanërisht e rëndësishme duke pasur parasysh numrin e incidenteve të lidhura me DHGV që policia i përgjigjet çdo ditë, dhe faktin që IPV nuk është një ngjarje e vetme e kufizuar në kohë, kështu që policia shpesh do të ri-angazhohet me të njëjtat viktimat/të mbijetuar dhe autorë(kryesit).

Më poshtë është një listë jo shteruese e kompetencave kryesore të performancës të cilave mund t'u referohen menaxherët e policisë kur kërkojnë të sigurojnë personelin reagues për të fuqizuar viktimat/të mbijetuarit e DHGV duke komunikuar dhe dëgjuar në atë mënyrë që siguron një ndjenjë sigurie, kap nevojat e saj për ndryshimin e drejtësië, mundëson një marrëdhënie të bazuara në konfidencialitetin dhe privatësinë. Menaxherët duhet të sigurojnë që zyrtarët reagues të jenë në gjendje të:

### **Disponueshmëria dhe qasja (nga perspektiva e qeverisjes, mbikëqyrjes dhe llogaridhënies)**

- Siguroni raportim të rregullt për komunikimet dhe raportet e DHGV për palët e interesuara vendore, përfshirë ato që mbështeten në situata humanitare duke përdorur formate dhe gjuhë të shumta për të siguruar qasjen (p.sh. Braille; shtypi i madh; gjuha e shenjave; gjuhë e lehtë për t'u lexuar, mesazhe të thjeshtuara siç janë piktogramet dhe fotografitë; etj.).

<sup>27</sup> Korniza Udhëzuese Strategjike për Paqeruajtjen Ndërkombëtare të Policisë (SGF) synon të rrisë efektivitetin e paqeruajtjes policore të KB-së përmes qasjeve më të qëndrueshme, të harmonizuara për ofrimin e sigurisë publike, reformës policore dhe mbështetjen për shërbimet policore të Shtetit pritës.

<sup>28</sup> Udhëzime për Integrimin e Ndërhyrjeve të Dhunës me Bazë Gjinore në Veprimin Humanitar: Reduktimi i rrezikut, promovimi i qëndrueshmërisë dhe ofrimi i ndihmës për rimëkëmbje (Komiteti i Përhershëm Ndër-Agjencor, 2015).

### **Komunikim efektiv dhe pjesëmarrje nga palët e interesuara në hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e shërbimeve:**

- Mbani komunikim efektiv me grupet e grave dhe fëmijëve me qëllim të ndërtimit dhe ruajtjes së besimit. Kjo duhet të përfshijë kalimin e kohës me grupe të tilla dhe komunitetet e tyre të afërta, patrullime të rregullta në këmbë, takime të rregullta, kërkimi i informatave kthyesë, kryerja e sondazheve, organizimin e forumeve të komunitetit, marrjen e mbështetjes së rangut të lartë dhe reagime të përshtatura;
- Identifikoni dhe përgjigjuni rolit tuaj në fushatat e komunikimit për të informuar popullatat e prekura rreth trendeve dhe reagimeve të DHGV.

**“Të gjitha strategjitë e komunikimit duhet t'i përmbahen standardeve të konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave gjatë përdorimit të historive, imazheve ose fotografive të të mbijetuarve për qëllime avokimi.”**

Paketa e Veglave Gjinore e Policisë se KB-se 201

### **Përshtatshmëria**

- Kuptoni dhe kushtojini vëmendje gjuhës së trupit, duke shmangur shpërqendrimet e tilla si zhurma, duke lënë mënjanë çdo anshmëri dhe gjykimin tuaj për këtë çështje, duke bërë pyetje vetëm për të sqaruar informacionin pasi ajo ka treguar historinë e saj të plotë, dhe duke parafrazuar ose rishprehur për të kontrolluar nëse informacioni ishte kuptuar saktë;<sup>29</sup>
- Kuptoni dhe përshtatuni pasi anëtarët e komunitetit reagojnë ndryshe ndaj policëve meshkuj dhe femra, veçanërisht në varësi të llojeve të krimeve që kanë pësuar;
- Kuptoni dhe përshtatni dinamikat e komunikimit në forumeve të komunitetit ose të ngjashme në mënyrë që të dëgjohen të gjithë zërat. Kjo përfshin të qenit të vetëdijshëm se në tubime të mëdha vetëm njerëzit nga grupe

<sup>29</sup> Paketa e Veglave Gjinore e Policisë se KB-se 2015. KB. Departamenti i Operacioneve të Paqes - DOP/ DPET/Shërbimi i Trajnimit të Integruar, në: <http://repository.un.org/handle/11176/387374>



**“Kur policia u jep këshilla grave për ate se si te ruhen, ekziston nevoja për t’u siguruar që kjo të jetë shtruar në një mënyrë që nuk sugjeron se ata janë fajtor”**

Raporti i Vlerësimit të Misogjinisë së Krimit të Urrejtjes financiar nga Zyra e Policisë së Nottinghamshire dhe Komisionerit per Krime (2018)

të veçanta mund të flasin, ndërsa të tjerët, veçanërisht grupet e cenueshme, të tilla si gratë dhe fëmijët, mund të heshtin. Mund të kërkojnë qasje të ndryshme në varësi të mjedisit.<sup>30</sup>

**Përshtatje**

- Dëgjoni në mënyrë aktive. Kjo do të thotë të fokusoheni në folësen dhe të përpiqeni të kuptoni përvojën e saj para se të interpretoni dhe vlerësoni atë që thuhet.<sup>31</sup> Interpretimi i asaj që thotë një person në vend të dëgjimit dhe të kuptuarit mund të jetë kundërproduktiv pasi ka të ngjarë që dëgjuesi do të “interpretojë” bazuar në anshmëritë/përvojat e veta.
- Ndani informacionin me fëmijët në atë mënyrë që ata e kuptojnë, veçanërisht versionet miqësore për fëmijët e rrugëve referuese dhe informacione të tjera kryesore;

**Kutia 6**

**Bëj-at dhe Mos-at për Angazhimin e Viktimave/Të Mbijetuarve të DHGV me Aftësi të Kufizuara<sup>32</sup>**

MOS	DO
Mos flisni me përkthyesin ose me personelin e tyre ndihmës, kujdestarin tjetër ose anëtarët e familjes.	Flisni drejtpërdrejt me personin duke i parë në fytyrë, edhe nëse personi ka dëmtime të shikimit.
Mos prekni pajisjet e lëvizshmërisë së personit pa kërkuar më parë leje.	Sa herë që flisni me një person me dëmtim të shikimit, paraqiteni së pari veten (d.m.th. “po flet oficeri X”).
Mos e nënvlerësoni një person me aftësi të kufizuara për aftësi komunikimi. Një person me dëmtim të dëgjimit gjithashtu mund të komunikojë në mënyrë efektive me stilolaps/laps dhe letër.	Kur bëhet fjalë për një person me dëmtim të dëgjimit dhe komunikimit, pyesni nëse personi ka një përkthyes në gjuhën e shenjave të cilit ajo/ ai i beson dhe do të donte të përfshihej.
Referojuni personit si “me aftësi të kufizuara”. Mos përdorni fraza “njerëz si ju” ose lloje të tjera frazash që mund të konkludojnë se ju e kategorizoni personin si të kategorisë tjetër.	Referojuni personit me emrin e tij.
Tregoni padurim.	Kuptoni nevojat e njerëzve të tjerë.
Bëni pyetje negative si “Çfarë nuk shkon me ju?” ose “A keni qenë gjithmonë kështu?”	Bëni pyetje pozitive të tilla si “A përballemi me ndonjë vështirësi me aktivitete të ndryshme?” ose “A keni nevojë për ndonjë strehim për të marrë pjesë plotësisht?”
Supozoni se të gjithë personat me aftësi të kufizuara nuk mund të shtrëngojnë duart.	Ofroni dorën tuaj për të shtrënguar. Mund të pyesni së pari nëse është në rregull, ose të informoni dikë me shikim të dobësuar që nuk mund ta shohë dorën tuaj.
Supozoni se të gjithë personat me aftësi të kufizuara kanë nevojë për ndihmë dhe se ju dini si të ndihmoni.	Pyesni nëse personi do të donte ndihmë për diçka dhe si mund të ndihmoni atë.

<sup>30</sup> Ibid.

<sup>31</sup> Ibid.

<sup>32</sup> Frymëzuar nga Elena Ratoi, Menaxhere e Programit të Grave të OKB -së në Moldavi dhe Humanitet dhe Përfshirje <https://www.hi-us.org/>

- Angazhoni (veçmas kur është e nevojshme) gratë, vajzat, burrat dhe djemtë vendorë në zhvillimin e mesazheve dhe në strategjitë për përhapjen e tyre në mënyrë që ato të jenë të përshtatshme për moshën, gjininë dhe nga ana kulturore;
- Tregoni ndjeshmëri ndaj viktimave/të mbijetuarve dhe anëtarëve të komunitetit, veçanërisht ndaj atyre që shpesh janë të marginalizuar në aspektin shoqëror. Në rastin e viktimave/të mbijetuarve, trajtimi empatik do t'i bëjë ata të ndihen më lehtë dhe do t'u mundësojë hetuesve të rindërtojnë situatën që çon në ngjarjen traumatike.

## Jepini përparësi vlerësimit të rrezikut të sigurisë dhe planifikimit të sigurisë

- Rrisni ndërgjegjësimin brenda komuniteteve të ndryshme për sigurinë e përgjithshme dhe zvogëlimin e rrezikut të DHGV;
- Vendosni dhe mirëmbani kanalet e ndryshme të komunikimit me viktimat/të mbijetuarat deri në përfundimin e çështjes(rastit) dhe sigurimin e mirëqenies së saj;

### Lidhja me sektorët dhe agjencitë e tjera përmes referimit dhe koordinimit

- Përfshini mesazhet themelore të parandalimit të DHGV në aktivitetet e shtrirjes dhe ngritjes së ndërgjegjësimit të komuniteteve specifike për sektorin;
- Sigurohuni që ngritja e vetëdijësimit përfshijn informacionin mbi parandalimin, të drejtat e viktimave/të mbijetuarve (përfshirë konfidencialitetin në ofrimin e shërbimeve dhe nivelet e komunitetit), ku të raportohet rreziku dhe si ti qasen kujdesit për DHGV;
- Inkurajoni burrat dhe djemtë vendor që të përfshihen në mënyrë aktive në diskutimet për të folur kundër DHGV.

### Mbledhja e të dhënave dhe menaxhimi i informacionit

- Kërkoni dhe përfshini informata kthyesë nga gratë police dhe gratë në komunitet nëse veprimet e propo-



Foto me mirësjellje nga Foto e KB-së/Martine Perret (Timor Leste)

zuara të policisë për DHGV janë ato që pritet të bëjë policia;

- Mblidhni dhe mbani informacion të azhurnuar mbi kapacitetet lokale të reagimit të DHGV dhe rrugët e referimit dhe ndani këtë në mënyrë proaktive me palët kryesore të interesit në mënyrë që ata të mund t'i referojnë çdo viktimë/të mbijetuar në kanalet e duhura për mbështetje/reagim.

### Pëlqimi i informuar dhe konfidencialiteti

- Zbatoni standardet të shkëmbimit të informacionit që promovojnë konfidencialitetin dhe sigurojnë anonimitetin e viktimave/të mbijetuarve. Kjo përfshin në fazat e hershme të një emergjence kur shërbimet mund të jenë të kufizuara.

## TREGUESIT E REFERENCËS PËR POLICINË QË OFRON SHËRBIME THELBËSORE: KOMUNIKIMI

ESP rekomandon si elemente thelbësore të komunikimit që informacioni të jetë i thjeshtë dhe i arritshëm në lidhje me shërbimet e drejtësisë dhe policimit. Në këtë drejtim, komunikimet policore duhet të kenë një objektiv të qartë të promovimit të dinjitetit dhe respektit të viktimës/të mbijetuarit. Kjo duhet të përfshijë komunikimin e vazhdueshëm policor me viktimën/të mbijetuarin, si dhe komunikimin e rregullt dhe efektiv me partnerët e tyre në vazhdimësinë e drejtësisë.

Për të përforcuar këto elemente kryesore, ESP propozon që të gjitha shërbimet e drejtësisë dhe mbështetjes për viktimat dhe të mbijetuarit të ndajnë një sërë karakteristikash të përbashkëta dhe aktivitete të përbashkëta për të siguruar ndikimin maksimal. Këto karakteristika të përbashkëta dhe aktivitete të përbashkëta janë të listuara në Kapitullin 2: *'Bërja e Dallimit si Menaxher dhe Udhëheqës i Ekipit.'*

Si një mjet për të ndihmuar në të kuptuarit se si karakteristikat e përbashkëta dhe aktivitetet e përbashkëta të ESP-se mund të përfshihen në strategjitë lokale të komunikimit për të reaguar ndaj DHGV në mënyrë që ata të fuqizojnë viktimat/të mbijetuarit e DHGV në të gjithë sistemin e drejtësisë, Doracku propozon shembuj të treguesve që menaxherët e policisë mund t'i referohen nëse ato ekzistojnë por gjithashtu edhe të inkurajojnë përfshirjen e tyre me nivelet e larta kur ata nuk e bëjnë këtë:

- **Disponueshmëria dhe qasja:** Përqindja e popullsisë vendase e cila është e kënaqur me informacionin e vënë në dispozicion nga policia mbi rolin që ka policia në ofrimin e shërbimeve thelbësore për viktimat/të mbijetuarit e DHGV. Çdo anketë duhet të kërkojë në mënyrë proaktive të përfshijë grupe zakonisht të marginalizuara ose me rrezik më të madh nga dhuna për të siguruar që çdo informacion i komunikuar atyre të jetë edhe i kuptueshëm dhe gjithëpërfshirës. Një burim i rëndësishëm informacioni që duhet marrë parasysh në këtë tregues janë ankesat e qytetarëve që identifikojnë komunikimin ndërpersonal të policisë si problematik.
- **Përshtatshmëria dhe qasja:** Percentage of responding local police staff who are satisfied with the relevancy and timeliness of the information commu-

nicated to them before attending a case of family violence or IPV. Që policia të reagojë në mënyrë të përshtatshme ndaj incidenteve të dhunës në familje, është thelbësore që oficerët reagues të jenë të vetëdijshëm për çdo çështje kulturore, nevoja specifike ose pjesëmarrje të mëparshme të policisë në atë adresë për dhunën në familje, dhe nëse shkelësi mund të jetë i dhunshëm.<sup>33</sup> Për sa i përket matjes së performancës, monitorimi i rregullt i përshtatshmërisë së informacionit të ofruar për oficerët e patrullës sipas zonave të komunikimit është i nevojshëm. Ky grumbullim i të dhënave të performancës duhet të mbledhet rregullisht prej zyrtarëve reagues nga menaxherët e njësive ose seksioneve në koordinim me menaxherët e rasteve hetuese. Mund të përfshihet si 'vërejtje' ose si rekomandim në raportet e dosjeve të rastit. Informacioni pastaj duhet të futet në kontrollin e cilësisë së performancës së mekanizmave dhe rrugëve të koordinimit brenda dhe jashtë me ofrues të shërbimeve të tjera thelbësore, duke përfshirë edhe agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit.

- **Përshtatje:** Numri i ankesave kundër oficerëve të policisë që reagojnë për sjellje të pahijshme në rastet e DHGV, shkalla në të cilën ankesat janë të qendrueshme, proporcioni i zyrtarëve të disiplinuar në lidhje me ankesat e tilla. Zhvillimi i bazës së provave është pika fillestare kur kërkon përmirësimin e shërbimeve që ofrohen në lidhje me viktimat/të mbijetuarit. Duke demonstruar në mënyrë empirike se ku policia duhet të përmirësohet dhe të ndërtojë praktikën e mirë në lidhje me komunikimin efektiv ndërpersonal ndaj popullatës femërore, menaxherët e policisë mund t'i drejtojnë pjesëtarët e stafit të tyre reagues kah fuqizimi i viktimave/të mbijetuarve në vend se t'i nënshtrojnë ata ndaj viktimizimit.



Emërtoni etninë siç e konsiderojnë njerëzit veçanërisht (d.th., në rastin e Romëve, në disa gjuhë ekziston një term tjetër për të përkufizuar këtë grup etnik, si "ciganë", "tsygan", e ku Romët e konsiderojnë këtë diskriminim dhe rekomandohet të shmangët)

<sup>33</sup> Komunikimet e brendshme të policisë duhet të identifikojnë dhe t'u japin oficerëve të patrullës informacionin kryesor shpejt dhe me saktësi. Përmirësimi i performancës në këtë fushë do të rrisë sigurinë aktuale dhe të perceptuar të zyrtarëve që hyjnë në situata të dhunës në familje, si dhe do t'i përgatisë më mirë ata në rast të ndonjë paaftësie mendore ose fizike ose nevoja të tjera të veçanta. Shih: 'Matja e performancës së policisë në dhunën vendore dhe në familje (2008)', Kiah Rollings dhe Natalie Taylor për Trendet dhe çështjet në Krime dhe Drejtësi Penale Nr. 367 Dhjetor 2008., Instituti Australian i Kriminologjisë.



Foto me mirësjellje nga UNAMID/Albert González Farran (rajoni Darfur, Sudan)

- **Jepini pwrparwsi sigurisw:** Perqindja ose raporti i dosjeve tw pwrditwsuara tw rasteve tw DHGV-sw (tw pwrditwsuara Brenda dy javwve tw fundit) kundrejt rasteve qw varen prej informacionit tw mwtejschw (mw shumw se dy javw). Duke e pasur këtë informacioni i lejon menaxherët të identifikojnë sasinë e rasteve të DHGV që mund të mos sigurojnë komunikim të vazhdueshëm me viktimën/të mbijetuarën. Një ekzaminim më rigoroz i këtyre rasteve që konsiderohen të pa përditësuar duhet të përcaktojë shkallën në të cilën viktimat/mbijetuarit mund të jetë në rrezik të konsiderueshëm për vazhdimin e dhunë nga autori; është informuar nëse i dyshuari në rast është kapur; ka ikur; po konsiderohet për lirim; ose është liruar dhe është me dorëzani ose me kusht, dhe nëse viktimat/mbijetuarit ka mjetet e komunikimit ose aftësinë për t'u qasur shërbimeve të kërkuara mbështetëse. Të dhënat gjithashtu duhet të kërkohen në baza mujore, tremujore dhe vjetore për të mundësuar që të bëhen krahasimet.
- **Pwlqimi i informuar, konfidencialiteti dhe qasja:** Për qindja e stacioneve policore që kanë një proces të krijuar për të ofruar raporte policore për viktimat/të

mbijetuarit dhe/ose ekipin e tyre ligjor për të lehtësuar veprimin në çështjet ligjore të ndërlidhura. Këto procese duhet të bazojnë shërbimet e tyre në kodin e etikës për shkëmbimin e informacionit (në përputhje me legjislacionin ekzistues), duke përfshirë atë se çfarë informacioni mund të ndahet, si do të ndahet, si duhet të ruhet në mënyrë të sigurt dhe me kë mund të ndahet. Theksi duhet t'i kushtojë rëndësi të madhe respektimit të pëlqimit dhe konfidencialitetit nga policia dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve thelbësore.

- **Komunikim efektiv dhe pjesëmarrje nga palët e interesuara në hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e shërbimeve & Lidhja me sektorët dhe agjencitë e tjera përmes koordinimit:** Numri/në vit i trajnimeve të përbashkëta për proceset e koordinimit të shumë agjencive që përfshijnë stafin e policisë lokale për ndarjen efektive të informacionit mes ofruesve të shërbimeve të drejtësisë. Stafin e policisë duhet të trajnohet për të ndarë informacionin në mënyrë të duhur brenda kërkesave të privatësisë dhe konfidencialitetit, të sigurojë që pëlqimi i informuar për zbulimin e informacionit kërkohet nga viktimat/e mbijetuara dhe/ose prindërit/kujdestarët dhe përfaqësuesi ligjor, kurdo



Në rast se personi nuk flet gjuhën,  
pyesni para se të caktoni një përkthyes.

që është e mundur, dhe të respektojë protokollet dhe proceset e referimit/rrugët që promovojnë rrjedhën në kohë dhe efikase të informacionit midis ofruesve të shërbimeve të drejtësisë.

- **Mbledhja e të dhënave dhe menaxhimi i informacionit:** Kërkohet sondazhi i reagimeve publike si pjesë e procesit të menaxhimit të rasteve të DHGV. Përvoja nga puna policore në Mbretërinë e Bashkuar tregon që policia duhet të bëjë më shumë për të kërkuar informata kthyesë nga viktimat/të mbijetuarit e abuzimit në familje. Sipas një studimi të sponsorizuar nga qeveria, reagimi i policisë ndaj dhunës në familje në Mbretërinë e Bashkuar, nëse forcat (policore) duan të kuptojnë arsyet pse disa viktima ngurrojnë të angazhohen me ta, ata duhet të bëjnë një përpjekje të bashkërenduar për të marrë informata kthyesë prej tyre në mënyrë që ata të mundën të veprojnë për të përmbushur nevojat e viktimave dhe të nxjerrë në pah fushat ku ato kanë nevojë të përmirësohen.<sup>34</sup>

<sup>34</sup> Reagimi i Policisë ndaj Abuzimit në Familje: Një raport i përditësuar, Inspektorati i Komandës dhe Shërbimeve të Zjarrit dhe Shpëtimit të Madhërisë së saj (HMICFRS), Shkurt 2019.

## RAST STUDI MI

# POLICIA E NOTTINGHAMSHIRE QË TRAJTON SJELLJEN E DHUNSHME NDAJ GRAVE SI KRIME TË URREJTJES



Në vitin 2016, Policia e Nottinghamshire u bë forca e parë policore në Mbretërinë e Bashkuar (MB) që lejoi gratë dhe vajzat të raportojnë raste të mizogjinisë, të ofrojnë mbështetje për viktimat/të mbijetuarat dhe të hetojnë autorët e dyshuar. Trajtuar si pilot për pjesën tjetër të Mbretërisë së Bashkuar, Policia e Nottinghamshire trajtoi aktet mizogjiniste ndaj grave dhe vajzave si krime të urrejtjes me një vlerësim të jashtëm të përparimit të arritur të publikuar në 2018.

Sipas politikës, *Krimi i Misogjinisë së Urrejtjes* përkufizohet si «incidente kundër grave që motivohen nga qëndrimi i burrave ndaj grave dhe përfshin sjellje të shënjestruara ndaj grave nga burrat thjesht sepse ato janë gra.»<sup>35</sup>

Në ligjin në Mbretërinë e Bashkuar, krimi i urrejtjes përfshin një sërë sjelljesh kriminale ku autori është i motivuar nga armiqësia ose demonstroi armiqësi ndaj paaftësisë së viktimës, racës, fesë, orientimit seksual ose identitetit transgjiniar.<sup>36</sup> Shërbimi i Prokurorisë së Kurorës në Mbretërinë e Bashkuar shton se një krim i urrejtjes mund të përfshijë abuzim verbal, kanosje, kërcënime, ngacmime, sulme dhe bullizmin, si dhe dëmtim të pronës. Për më tepër, autori mund të jetë gjithashtu një mik, kujdestar ose i njohur që shfrytëzon marrëdhënien e tyre me viktimën/të mbijetuarën për përfitime financiare ose ndonjë qëllim tjetër kriminal.<sup>37</sup>

35 Policia e Nottinghamshire regjistron misogjininë si një krim urrejtjeje. BBC <https://www.bbc.com/news/uk-england-nottinghamshire-36775398>

36 Për këtë përkufizim të përbashkët është rënë dakord në vitin 2007 nga policia, Shërbimi i Prokurorisë së Kurorës, Shërbimi i Burgjeve (tani Shërbimi Kombëtar i Menaxhimit të Shkelësve) dhe agjenci të tjera që përbëjnë sistemin e drejtësisë penale. Shih: Krimi i urrejtjes, Angli dhe Uells, 2017/18 Buletini Statistikor 20/18 16 Tetor 2018. Statistikat e Krimin dhe Policimit në Zyrën e Brendshme.

37 Krimi i urrejtjes. Shërbimi i Prokurorisë së Kurorës (CPS) Mbretëria e Bashkuar, në: <https://www.cps.gov.uk/hate-crime>

**“Ajo me të cilën përballen gratë, shpesh në baza ditore, është absolutisht e papranueshme dhe mund të jetë jashtëzakonisht shqetësuese. Është një aspekt shumë i rëndësishëm i punës së gjithëmbarshme të krimin të urrejtjes që po kryhet dhe ajo që do ta bëjë Nottinghamshire një vend më të sigurt për të gjitha gratë.”**

Shefi i policisë së Nottinghamshire Sue Fish (Në pension)

Forcat policore në Angli, Uells dhe Irlandën Veriore çdo vit monitorojnë pesë vargje të krimin të urrejtjes: paaftësia, identiteti gjinor, raca, përkatësia etnike ose kombësia, feja, besimi dhe orientimi seksual.<sup>38</sup> Sipas Policisë Metropolitane, dëshmia e elementit të urrejtjes nuk është një kërkesë. Viktimat nuk kanë nevojë që personalisht ta perceptojnë incidentin si të lidhur me urrejtjen pasi do të ishte e mjaftueshme nëse një person tjetër, një dëshmitar apo edhe një oficer policie mendonte se incidenti kishte lidhje me urrejtjen.<sup>39</sup>

Është e rëndësishme të theksohet se politika e Policisë së Nottinghamshire për Misogjininë e Krimin të Urrejtjes nuk ka ndryshuar dhe as nuk është shtuar në ligjet ekzistuese, pasi përputhet me përkufizimin e krimeve të urrejtjes të përkryer tashmë sipas ligjit të MB-së.<sup>40</sup>

Karakteristika e shtuar e politikës së Policisë në Nottinghamshire është se viktimat e dyshuara të Mizogjinisë Krimin të Urrejtjes mund të raportojnë incidente të cilat

38 Policia e Nottinghamshire regjistron misogjininë si krim urrejtjeje, në: <https://www.bbc.com/news/uk-england-nottinghamshire-36775398>

39 Çfarë është krimi i urrejtjes? Policia Metropolitane Mbretëria e Bashkuar, në: <https://www.met.police.uk/advice/advice-and-information/hco/hate-crime/what-is-hate-crime/>

40 Gjashtë gjëra që kemi mësuar në lidhje me mizogjininë si një krim urrejtjeje (2016), Bates, L. për *The Guardian*, në: <https://www.theguardian.com/lifeandstyle/womens-blog/2016/sep/22/six-things-weve-learned-about-misogyny-as-a-hate>

## Kutia 7

### Sjellja e Mizogjinisë së Krimin të Urrejtjes

Si pjesë e kësaj politike, sjelljet që Policia e Nottinghamshire e kishte dalluar si një krim të Urrejtjes Misogjine, ishin si më poshtë:

- Fishkëllima
- Ngulitja e syve
- Prekja nga ndjenjat
- Sulmi seksual
- Ndjekja për në shtëpi
- Marrja e fotove të padëshiruara në celularë
- Marrja e fotove përfundi fustanit\*
- Gjuha eksplicite seksuale
- Sjellje kërcënuese/agresive/frikësuese
- Ekspozimi i pahijshëm
- Përparime të padëshiruara seksuale
- Abuzimi online

\* Në ligjin në Mbretërinë e Bashkuar, "Marrja e fotove të padëshiruara në celularë" zakonisht përfshin shkelësit që bëjnë fotografi nën veshjen e një personi pa e ditur ata, me qëllim të shikimit të organeve gjenitale ose vitheve të tyre.

mund të mos konsiderohen si krim sipas ligjit në MB dhe policia do të hetojë. Nga Policia e Nottinghamshire kërkohet të ekzaminojë nëse dhe si mund të mbështetet viktimat/e mbijetuarat ose nëse diçka mund të bëhet për të parandaluar që ata të mos jenë përsëri në shënjestër.<sup>41</sup>

Kjo ishte veçanërisht e rëndësishme për zhvillimin e ndërgjegjësimit dhe inkurajimin e grave dhe vajzave që të raportojnë sjellje agresive që nuk e kanë parë gjithmonë si të natyrës kriminale p.sh. ngacmimi (Seksioni 4 ose 5 Akti i Rendit Publik, sulm i pahijshëm). Krimi është pamjaftueshëm i raportuar nga shumë gra (veçanërisht krimi i dhunshëm dhe seksual) në përgjithësi dhe një përfitim i parashikuar ishte përmirësimi i besimit të grave në punën policore dhe që normat e raportimit do të përmirësoheshin.

**Ky ndryshim në strategji në adresimin e akteve mizogjiniste nga Policia e Nottinghamshire do të ndikojë në perceptimet e grave për atë se çfarë mund të raportojnë ata.** Në MB, forcat e policisë mund të përfshijnë përkufizimin e tyre të krimin të urrejtjes me disa nënseksione të shtuara kohët e fundit.<sup>42</sup>

Si rezultat, regjistrimi i misogjinisë si krim i urrejtjes do t'i japë policisë një pamje më të detajuar se sa shpesh,

kur dhe ku po ndodh. Gjithashtu dërgon një mesazh shumë të fortë se policia do të marrë seriozisht aktin e mizogjinisë, duke u dhënë kështu grave dhe vajzave besimin që të paraqiten dhe të raportojnë shkeljet. Interesante, abuzimi në familje nuk u regjistrua si një krim i urrejtjes misogjin sipas punës policore të prezantuar sepse ka procedurën e vet.<sup>43</sup>

Për më tepër, bazuar në përvojën e Nottinghamshire, policia që ka pak kuptim personal për krimin e urrejtjes demonstroi një kuptim më të madh të përvojave të grave dhe vajzave në lidhje me sjelljen mizogjiniste. Si rezultat, u shfaq dhembshuri dhe ndjeshmëri më e madhe për viktimat e të gjitha llojeve të krimeve të urrejtjes dhe menjëherë pas programit të trajnimit kënaqësia e viktimave të krimin të urrejtjes u përmirësua veçanërisht me ndjeshmërinë e oficerit dhe duke u besuar.<sup>44</sup>

## Praktika e Mirë: Vlerësimi Publik i Misogjinisë si Politikë e Policisë për Krimin e Urrejtjes

Në vitin 2018, një vlerësim i porositur nga Qendra e Grave në Nottingham dhe financuar nga Zyra e Policisë dhe Komisionerit të Krimin në Nottinghamshire u krye

41 Policia e Nottinghamshire regjistron misogjininë si krim urrejtjeje, në: <https://www.bbc.com/news/uk-england-nottinghamshire-36775398>

42 Policia e Nottinghamshire regjistron misogjininë si krim urrejtjeje, në: <https://www.bbc.com/news/uk-england-nottinghamshire-36775398>

43 Kjo ishte pas konsultimit të gjerë me palët e interesuara vendore që trajtonin dhunën në familje dhe vendimin që pasqyrore pikëpamjet e tyre. Gjithashtu shih Policinë e Nottinghamshire regjistron misogjininë si krim urrejtjeje, në: <https://www.bbc.com/news/uk-england-nottinghamshire-36775398>

44 Vëzhgim personal nga Shefi i policisë së atëherëshme të policisë së Nottinghamshire Susannah Fish (2020)

me rezultatet që treguan një opinion të lartë publik të politikës. Vlerësimi raporto i se mbi 87 përqind e njerëzve të anketuar menduan se një ndryshim politikash ishte një ide e mirë.<sup>45</sup>

Megjithë reagimet pozitive të politikës nga publiku, Qendra e Grave në Nottingham dhe partnerët e tjerë joqeveritarë të përfshirë në pilot ishin subjekt i abuzimit të mediave sociale në internet, si në shkallë kombëtare ashtu edhe në atë ndërkombëtare, që shkonin (silleshin) nga mosmiratimi dhe ofendimet kërcënuese të misogjinisë.

Që nga fillimi i pilotimit, disa forca të tjera policore në MB kanë futur politika të ngjashme. Sidoqoftë, shefi i policisë së Nottinghamshire këshilloi që çdo punë e ngjashme në të ardhmen duhet të përfshijë strategji të integruara që nga fillimi për të ofruar mbështetje në trajtimin e abuzimeve në internet të tilla që synonin anëtarët e Qendrës së Grave të Nottingham-it.

Rekomandime të mëtejshme për operacionalizimin e politikës së Krimit të Urrejtjes Misogjine mund të gjenden në vlerësimin e jashtëm<sup>46</sup> të zbatimit të politikës të financuar nga Zyra e Policisë së Nottinghamshire dhe Komisionerit të Krimit.

## Rekomandime për Përmirësimin e Efektivitetit të Policisë

Rekomandimet kishin për qëllim trajnimin e ardhshëm të *Mizogjinisë së Krimit të Urrejtjes* për policinë për shumicën prej tyre duke u fokusuar në atë se si të komunikohet më mirë politika brenda për të marrë mbështetje nga oficerët që në fillim në një përpjekje për të parandaluar rezistencën e mundshme. Ato përfshijnë:

- Trajnimi në formën e punëtorive me kontributin e viktimave/të mbijetuarve dhe agjencive të jashtme. Në sondazhin e vlerësimit me policinë, oficerët e policisë

45 Mbështetje dërrmuese e publikut për Politikën e Misogjinisë së Krimit të Urrejtjes (2018), Universiteti i Nottingham-it.

46 Raporti i Vlerësimit të Misogjinisë së Krimit të Urrejtjes për Qendrën e Grave në Nottingham i financuar nga Zyra e Policisë së Nottinghamshire dhe Komisioneri i Krimit. Mullany, L. dhe Trickett, L. Qershor 2018, në: <http://www.nottingham-womenscentre.com/wp-content/uploads/2018/07/Misogyny-Hate-Crime-Evaluation-Report-June-2018.pdf>

**“Ne i marrim të gjitha raportet e krimit të urrejtjes tepër seriozisht dhe është mirë të dëgjosh se përqendrimi në këtë varg të veçantë të krimit të urrejtjes që nga viti 2016 nga forca dhe partnerët u ka dhënë grave besimin për të raportuar incidentet. Qëllimi ynë nuk është të kriminalizojmë njerëzit ose të rrisim ndjekjet penale, por ta bëjmë të qartë se sjellja që frikëson, kërcënon, poshtëron ose shënjestron gratë është krejtësisht e papranueshme.**

**Sidoqoftë, ne natyrisht do të kërkojmë ndjekje penale aty ku këto janë të përshtatshme. Siç tregon raporti, shumica dërrmuese e burrave janë të tmerruar me të drejtë nga kjo sjellje dhe është fantastike të jesh në gjendje të ofrosh perspektivën e viktimës për të edukuar dhe ndaluar gratë që të jenë subjekt i krimit të urrejtjes për shkak të gjinisë së tyre.”**

Rachel Barber, Zëvendës Shefe e Policisë së Nottinghamshire dhe udhëheqjes strategjike të forcës për krimin e urrejtjes

shprehën pakënaqësi me trajnimin e krimit të urrejtjes (në përgjithësi) dhe shpesh kritikuan si përmbajtjen ashtu edhe formatin e trajnimit, në veçanti, trajnimin online. **Policët pjesëmarrës u shprehën se preferonin kontributin njerëzor me kontributin e viktimave dhe agjencive të jashtme;**<sup>47</sup>

- Sjelljet e mbuluara në politikë duhet të shpjegohen si jo të reja dhe kryesisht janë të mbuluara tashmë nga veprat penale. Përkundrazi, politika me të vërtetë synon të përmirësojë regjistrimin dhe reagimet ndaj krimeve dhe incidenteve të cilat aktualisht nuk raportohen;
- Shpjegoni qartë se një qëllim i politikës është të regjistrojë disa incidente në mënyrë që të sigurojë publikun, të mbështesë viktimat/mbijetuesit dhe të përmirësojë grumbullimin e inteligjencës;
- Një kurs freskues mbi krimin e urrejtjes në përgjithësi duhet të mbahet, duke theksuar se është më i gjerë se urrejtja, dhe në lidhje me shënjestrimin paragjykses

47 Trajnimi për Policinë e Nottinghamshire ndoqi praktikën më të mirë me trajnime personale dhe përfshiu përdorimin e videove dhe gratë që ndajnë dëshmitë personalisht, duke lejuar kështu një debat dhe të kuptuarit më shumë mbi çështjen e kompleksitetit ose ndjeshmërisë së madhe.



bazuar në karakteristikat personale që shpesh përfshijnë pohime të pushtetit;

- Theksimi se krimi i urrejtjes përfshin regjistrimin e incidenteve dhe se politika e mizogjinisë ndjek këtë format. Kishte theks të tepërt nga oficerët mbi politikën e mizogjinisë që nuk kishte të bënte me krimin e urrejtjes - kështu që theksimi se pse këto sjellje janë tregues të përbuzjes ndaj grave dhe mund të përfshijë gjithashtu shprehje armiqësie, është i rëndësishëm;
- Sigurohuni që policia të jetë e trajnuar për të parë rëndësinë e politikës për gratë në shoqërinë më të gjerë, se si kjo ka ndikim negativ tek ato dhe cenon të drejtat e tyre themelore, përfshirë shëndetin dhe mirëqenien e tyre të përditshme, dhe jo thjesht ta shohin këtë përmes lentave të punës policore (për sa i përket asaj se çfarë do të thotë për ngarkesat e punës, etj.);
- Politika duhet të përshkruhet dhe kuptohet si një përvojë e shumëfishtë gjinore që është ndërlikohëse, duke theksuar përvoja të ndryshme për grupe të ndryshme.
- Kjo mund të ofrohet përmes një larmie të mediave të ndryshme trajnuese (filma, video, media sociale, etj.);
- Shmangni përqëndrimin në përvojat individuale të vetmuara për t'u larguar nga akuzat për "kryqëzatat" personale dhe në vend të kësaj përqëndrohuni në përvoja të shumfishta të grupeve të ndryshme ndërlikohëse të grave dhe vajzave;

**Dëshmitë nga viktimat dhe ata që nuk kanë raportuar tregon se oficerët duhet të sigurohen që ata të vazhdojnë t'u japin përgjigjet empatike dhe simpatike viktimave femra dhe t'i marrin ato seriozisht - kjo është vendimtare, edhe nëse autorët nuk mund të gjurmohen - për pjesëtarët e publikut, duke u marrë seriozisht është çelësi, dhe shpesh ata janë realistë në dijeninë se normat e dënimit do të jenë të ulëta, pasi shumica e incidenteve ndodhin shumë shpejt me pak kohë për të marrë përshkrime, etj."**

Raporti i Vlerësimit të Misogjinisë së Krimin të Urrejtjes i financuar nga Zyra e Policisë së Nottinghamshire dhe Komisioneri i Krimin (2018)

- Një debat më i gjerë rreth viktimizimit gjinor më gjerësisht për gratë dhe burrat në shoqëri duhet të inkurajohet, me mesazhin kryesor që tregon se si veprimet e policisë janë pjesë e një panorame (fotografie) më të gjerë shoqërore në të cilën ne të gjithë kemi një rol për të luajtur.



## SHËNIME DHE LEXIMI I SUGJERUAR

1. Cassino, D. Pse më Shumë Burra Amerikanë Ndihen të Diskriminuar. Harvard Business Review. 29 shtator 2016, në: <https://hbr.org/2016/09/why-more-american-men-feel-discriminated-against>
2. I nderuari Wally T. Oppal., Raporti i Komisionit për Hetimin e Grave të Zhdukura VELLIMI IIB Askush: Si dhe Pse Ne Dështuam me Gratë e Zhdukura dhe të Vrra Pjesa 3, 4 dhe 5 (2012). në: [https://www2.gov.bc.ca/assets/gov/law-crime-and-justice/about-bc-justice-system/inquiries/forsaken-vol\\_2b.pdf](https://www2.gov.bc.ca/assets/gov/law-crime-and-justice/about-bc-justice-system/inquiries/forsaken-vol_2b.pdf)
3. Studimi Global mbi Vrasjen (UNODC, 2019), në: <https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/gsh/Booklet1.pdf>
4. Studimi Global mbi Vrasjen: Vrasja e grave dhe vajzave lidhur me gjininë (UNODC, 2018) at: [https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/GSH2018/GSH18\\_Gender-related\\_killing\\_of\\_women\\_and\\_girls.pdf](https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/GSH2018/GSH18_Gender-related_killing_of_women_and_girls.pdf)
5. Reagime në Barazinë Gjinore dhe të Drejtat e Grave dhe Vajzave. Të Drejtat e Grave dhe Barazia Gjinore. Drejtoria e Politikave për të Drejtat e Qytetarëve dhe Çështjet Kushtetuese Drejtoria e Përgjithshme për Politikën e Brendshme të Unionit PE 604.955– Qershor 2018, në: [http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2018/604955/IPOL\\_STU\(2018\)604955\\_E\\_N.pdf](http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2018/604955/IPOL_STU(2018)604955_E_N.pdf)
6. Komunikimi: Angazhimi dhe komunikimi. Kolegji i Policisë së MB-së: <https://www.app.college.police.uk/app-content/engagement-and-communication/communications/>
7. Kehn, A dhe Ruthig, J.C. Perceptimet e Diskriminimit Gjinor përgjatë Gjashtë Dekadave: Rolet Moderuese të Gjinisë dhe Moshës. 16 Qershor 2013 # Springer Science+Business Media New York 2013
8. Paketa e Veglave Gjinnore e Policisë së KB-se, (Departamenti i KB -së për Operacionet e Paqes - DOP/DPET/ Shërbimi i Trajnimit të Integruar, 2015).
9. Shih Paketën e Veglave Gjinnore të Policisë së Kombeve të Bashkuara Praktikën më të Mira të Standardizuara për Integrimin Gjinor në Përmbledhjen e Mjeteve të Projektit për Paqeruajtje (2015), në: [http://repository.un.org/bitstream/handle/11176/387374/United%20Nations%20Police%20Gen der%20 Toolkit%20Compendium%20of%20Project%20Tools.pdf?sequence=55&isAllowed=y](http://repository.un.org/bitstream/handle/11176/387374/United%20Nations%20Police%20Gender%20Toolkit%20Compendium%20of%20Project%20Tools.pdf?sequence=55&isAllowed=y)
10. Protokollin Ndërkombëtar për Dokumentimin dhe Hetimin e Dhunës Seksuale në Konflikt. Praktika më e Mirë mbi Dokumentimin e Dhunës Seksuale si Krim ose Shkelje e së Drejtës Ndërkombëtare Botimi i dytë: Sara Ferro Ribeiro dhe Danaé van der Straten Ponthoz në emër të Zyrës së Jashtme dhe Komonuelthit të MB-së, Mars 2017, në: [https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment\\_data/file/598335/International\\_Protocol\\_2017\\_2nd\\_Edition.pdf](https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/598335/International_Protocol_2017_2nd_Edition.pdf)
11. Lee P. (1989), Puna policore në Komunitet: Udhëzuesi Praktik për Zyrtarët Policorë (Departamenti Amerikan i Drejtësisë, Zyra e Programeve të Drejtësisë, Uashington, DC 1989), në: <https://www.ncjrs.gov/pdffiles1/nij/118001.pdf>
12. Praktika të Mira në Ndërtimin e Partneriteteve Policore-Publike nga Këshilltari i Lartë Policor i Sekretarit të Përgjithshëm të OSBE-së (Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë, 2008), në: <https://www.osce.org/secretariat/32547?download=true>
13. Çfarë është përdhunimi dhe sulmi seksual? Policia Metropolitane e MB-së, në: <https://www.met.police.uk/advice/advice-and-information/rsa/rape-and-sexual-assault/what-is-rape-and-sexual-assault/>
14. ‘Kur bëhet fjalë për pëlqimin, nuk ka linja të turbullta’ UN Women, 18 nëntor 2019, në: <https://www.unwomen.org/en/news/stories/2019/11/feature-consent-no-blurred-lines>
15. ‘Matja e performancës së policisë në dhunën vendore dhe në familje’, Kiah Rollings dhe Natalie Taylor për Trendet dhe Çështjet në Krim dhe Drejtësi Penale Nr. 367 Dhjetor 2008, Instituti Australian i Krimnologjisë, në: <https://aic.gov.au/publications/tandi/tandi367>
16. Reagimi i Policisë ndaj Abuzimit në Familje: Një raport i Përditësuar, Inspektorati i Komandës dhe Shërbimeve të Zjarrit dhe Shpëtimit të Madhërisë së saj (HMICFRS). Shkurt 2019 <https://www.justiceinspectorates.gov.uk/hmicfrs/wp-content/uploads/the-police-response-to-domestic-abuse-an-update-report.pdf>
17. ‘Policia e Nottinghamshire regjistron misogjinë si krim urrejtjeje’ në: <https://www.bbc.com/news/uk-england-nottinghamshire-36775398>
18. Mullany, L. dhe Trickett, L. (Qershor 2018): ‘Raporti i Vlerësimit të Misogjinisë së Krimin të Urrejtjes për Qendrën e Grave në Nottingham’, financuar nga Zyra e Policisë së Nottinghamshire dhe Komisioneri i Krimin, në: <http://www.nottinghamwomenscentre.com/wp-content/uploads/2018/07/Misogyny-Hate-Crime-Evaluation-Report-June-2018.pdf>
19. Gjashtë gjëra që kemi mësuar për misogjinë si një krim urrejtjeje’, Bates, L (2016), për *The Guardian*.

<https://www.theguardian.com/lifeandstyle/womens-blog/2016/sep/22/six-things-weve-learned-about-misogyny-as-a-hate>

20. Mbështetje dërmuese publike për Politikën e Misogjinisë së Krimin të Urrejtjes (2018). Universiteti i Nottingham-it <https://www.nottingham.ac.uk/news/pressreleases/2018/july/overwhelming-public-support-for-misogyny-hate-crime-policy.aspx>
21. Krimi i Urrejtjes. Shërbimi i Prokurorisë së Kurorës (CPS) Mbretëria e Bashkuar, në: <https://www.cps.gov.uk/hate-crime>
22. Krimi i Urrejtjes, Angli dhe Uells, Buletini Statistikor 2017/18 20/18 16 Tetor 2018. Statistikat e Krimin dhe Policimit në Zyrën e Brendshme, në: [https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment\\_data/file/748598/hate-crime-1718-hosb2018.pdf](https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/748598/hate-crime-1718-hosb2018.pdf)
23. Çfarë është krimi i urrejtjes? Policia Metropolitane e Mbretërisë së Bashkuar, në: <https://www.met.police.uk/advice/advice-and-information/hco/hate-crime/what-is-hate-crime/>
24. 'Marrja e fotove perfundi veshjeve' tani një krim specifik pasi Ligji merr Pëlqimin Mbretëror (Ministria e Drejtësisë, MB, 2019), në: <https://www.gov.uk/government/news/upsirting-now-a-specific-crime-after-bill-receives-royal-assent>
25. Doracaku për Reagimet Efektive të Policisë ndaj Dhunës kundër Grave (UNODC, 2010) në: [https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/Handbook\\_on\\_Effective\\_police\\_responses\\_to\\_violence\\_against\\_women\\_English.pdf](https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/Handbook_on_Effective_police_responses_to_violence_against_women_English.pdf)
26. Doracak mbi Reagimet Efektive të Prokurorisë ndaj Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave (UNODC, UN Women, 2014), në: [https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/14-02565\\_Ebook\\_new.pdf](https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/14-02565_Ebook_new.pdf)
27. Skinnider, Eileen. 'Drejt Drejtësisë Penale të Përgjegjshme Gjimore: Praktika të Mira nga Azia Juglindore në përgjigjen ndaj dhunës kundër grave' (2018: Instituti i Drejtësisë në Tajlandë).





# NDËRTIMI I INSTITUCIONEVE PËR NJË PËRGJIGJE EFEKTIVE DHE TË PËRGJEGJSHME TË POLICISË NDAJ DHGV-SË

*Të kesh më shumë gra në forcat e policisë dhe t'i trajnosh ato në mënyrë adekuate është një hap i parë vendimtar për të siguruar që të mbijetuarit të fillojnë të besojnë përsëri dhe të ndiejnë se ankesa e tyre po merret seriozisht në çdo fazë të procesit që mund të jetë kompleks. Përparimi gjithashtu kërkon që ne të trajtojmë me sukses barrierat e shumta institucionale dhe strukturore, sistemet patriarkale dhe stereotipet negative rreth gjinisë që ekzistojnë në institucionet e sigurisë, policisë dhe gjyqësisë, siç janë në institucionet e tjera.”*

**Phumzile Mlambo-Ngcuka, Nën-Sekretare e përgjithshme e Kombeve të Bashkuara dhe Drejtore ekzekutive e grave të OKB-së, nga një deklaratë në Ditën ndërkombëtare për eliminimin e dhunës ndaj grave (25 nëntor 2019)**

---

# QËLLIMET E KAPITULLIT

---

1. Ofron udhëzime për udhëheqjen e policisë që kërkon të krijojë mjedise të favorshme për ekipet e tyre në kërkim të një përgjigje më efektive ndaj DHGV
2. Ofron udhëzime për udhëheqjen e policisë në përforcimin e një kulture të reflektimit dhe të mësuarit institucional në bashkëpunim me aktorët e jashtëm për një shërbim policor më profesional dhe të përgjegjshëm



# HYRJE

Në përputhje me standardet e OKB -së, çdo polici ose agjenci tjetër e zbatimit të ligjit duhet të jetë përfaqësuese, përgjegjëse dhe llogaridhënëse ndaj komunitetit të cilit i shërben.<sup>1</sup> Këto janë elementet kritike për t'u perceptuar si një ofrues legjitim thelbësor i shërbimit të drejtësisë.

Foto nga MINUSTAH/Logan Abassi (Haiti)

Përgjegjshmëria gjinore luan një rol përcaktues në perceptimin e organizatës policore si të besuar dhe legjitime, veçanërisht kur i përgjigjeni DHGV dhe formave të tjera të dhunës me bazë gjinore. Sidoqoftë, kjo kërkon që organizata policore së pari të “zotërojë problemin” e DHGV. Kjo do të thotë se përgjigja<sup>2</sup> për shfaqjen e saj është një përgjegjësi thelbësore e policisë.

Në thelb, zotërimi i problemit të DHGV do të thotë që policia përfshihet në mesin e atyre që preken më shumë dhe shqetësohen nga shfaqja e saj. Më e rëndësishmja, marrja e pronësisë mbi DHGV nënkupton që organizata policore është e angazhuar të shndërrohet në një shtytës të zgjidhjes për të fituar rezultate pozitive për viktimat/ të mbijetuarat.

Ndryshimi i gjërave kërkon nga udhëheqja e lartë e policisë që të reflektojë vetë përse nevojitet transformimi

- 1 Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 34/169 e 17 dhjetorit 1979.
- 2 Për qëllimet e këtij Doracakut, përgjigja ndaj DHGV nënkupton si përpjekjet për parandalimin e dhe reagimin e policisë.

në radhë të parë. Për shembull, çfarë mësimi duhet të kapet dhe cilat mjedise mundësuese nevojiten për të transformuar punonjësit e policisë, kështu që ata të jenë zgjidhje me përgjegjësi gjinore dhe nxitëse drejt zvogëlimit të përhapjes së DHGV?

Ky kapitull do të synojë të japë udhëzime për udhëheqjen e lartë të policisë dhe menaxherët e tyre të mesëm që kërkojnë të krijojnë një mjedis të përshtatshëm, në mënyrë që oficerët që përgjigjen të kontribuojnë në një organizim policor më të përgjegjshëm ndaj gjinisë, dhe kështu më **efektiv**.

Ky kapitull do të kërkojë gjithashtu të promovojë një kulturë të reflektimit dhe të mësuarit institucional përmes politikave të ndjeshme ndaj gjinisë dhe promovimit të kompetencave të oficerëve kritike për menaxherët e mesëm të policisë që të jenë në gjendje të çojnë përpara transformimin drejt policimit të përgjegjshëm gjinor. Kjo do të përfshijë nxjerrjen në pah të rolit të rëndësishëm që luajnë masat e **lloga-**

## Dhuna me bazë gjinore (DHBGJ)

DHBGJ është një term ombrellë për çdo veprim të dëmshëm që kryhet kundër vullnetit të një personi dhe që bazohet në dallimet (gjinore) e atribuara shoqërore midis femrave dhe meshkujve. Natyra dhe shtrirja e llojeve të veçanta të DHBGJ ndryshojnë në kultura, vende dhe rajone. Shembujt përfshijnë dhunën seksuale, duke përfshirë shfrytëzimin/abuzimin seksual dhe prostitucionin e detyruar; dhuna në familje; trafikimi; martesat e detyruara/e hershme; praktikat tradicionale të dëmshme siç është gjymtimi gjenital femëror; vrasjet për nder; dhe trashëgiminë e vejshës<sup>3</sup>.

Burimi: UNICEF, UNFPA, UNDP, UN Women. "Barazia gjinore, koherenca e OKB -së dhe ju".

**ridhënies** në mbështetjen e menaxherëve të mesëm përmes transformimit dhe se sa transparente janë marrëdhëniet me aktorët e jashtëm<sup>3</sup> do të shtojë jo vetëm rezistencën dhe legjitimitetin e procesit, por do të forcojë rritjen profesionale dhe modernizimin e organizatës policore.

Mjediset mundësuese për menaxherët e mesëm duhet të vijnë në formën e politikave transformuese, struktura që lehtësojnë diversitetin dhe praktika gjithëpërfshirëse që inkurajojnë një vetëdije kritike për rolet dhe normat gjinore. Kjo do të përfshijë adresimin e mënyrave për të ndryshuar normat e dëmshme gjinore në mënyrë që të nxisin marrëdhënie më të barabarta të pushtetit midis grave dhe burrave, dhe midis grave dhe të tjerëve në komunitet.

Udhëzimet mbi mjediset mundësuese që udhëheqja e policisë duhet të marrë parasysh për një përgjigje më efektive dhe kumulative ndaj DHGV do të ndahen në pjesët në vijim

3 Palët e interesuara janë të gjitha organizatat dhe agjencitë qeveritare dhe të shoqërisë civile që kanë një rol në përgjigjen ndaj dhunës kundër grave dhe vajzave në të gjitha nivelet e qeverisë dhe shoqërisë civile. Aktorët kryesorë ndër të tjera përfshijnë viktimat dhe të mbijetuarat dhe përfaqësuesit e tyre, shërbimet sociale, sektorin e kujdesit shëndetësor, ofruesit e ndihmës juridike, policinë, prokurorët, gjyqtarët, agjencitë e mbrojtjes së fëmijëve dhe sektorin e edukimit.

1. Krijimi i një kuptimi të përbashkët për DHGV;
2. Politikat dhe strategjitë që mundësojnë policimin e përgjegjshëm gjinor;
3. Ndërtimi i partneriteteve strategjike;
4. Trajnimi, edukimi dhe zhvillimi profesional;
5. Resurset njerëzore;
6. Mbledhja, analiza dhe përdorimi i të dhënave për policimin e përgjegjshëm gjinor;
7. Monitorimi dhe vlerësimi për policim efikas të përgjegjshëm gjinor.

Së fundi, është shumë e rekomandueshme për përdoruesit e këtij Doracakut që ta shikojnë këtë kapitull në lidhje me udhëzimet e fundit nga rishikimi i veglave për gjini dhe siguri 2: Policimi dhe Gjinia (2019)<sup>4</sup> prodhuar nga Qendra e Gjenezës për qeverisjen e sektorit të sigurisë (DCAF), në partneritet me Organizatën për sigurinë dhe bashkëpunimin në Evropë (OSBE)/Zyra për institucionet demokratike dhe të drejtat e njeriut (ODIHR) dhe UN Women. Sipas DCAF, ky Mjet ka për qëllim nivelin politik dhe jo atë operacional, me rëndësi për policinë e lartë, njësitë gjinore dhe ata që janë të interesuar në përmirësimin e efektivitetit të policisë përmes integritetit të perspektivës gjinore.



Foto me mirësjellje të MINUSTAH/ Logan Abassi (Haiti)

4 Vegla në paketën e veglave 2: Policimi dhe gjinia në Paketën e veglave për gjininë dhe sigurinë (Gjenevë: DCAF, OSBE/ODIHR, UN Women, 2019).



## KRIJIMI I NJË MIRËKUPTIMI TË PËRBASHKËT PËR DHGV

### Duke filluar me një Mirëkuptim të përbashkët të problemit

Gratë dhe vajzat, kudo, duhet të kenë të drejta dhe mundësi të barabarta, dhe të jenë në gjendje të jetojnë pa dhunë dhe diskriminim. Barazia gjinore kërkon veprim të gjithë qeverisë, përfshirë policinë, për të eliminuar shkaqet e shumta të diskriminimit që ende kufizojnë të drejtat e grave në sferat private dhe publike. Pabarazia gjinore është diskriminim.

Transformimi drejt policimit të përgjegjshëm gjinor do të kërkojë nga udhëheqja e policisë që të krijojë një **të kuptuar të mirë-informuar<sup>5</sup> se si natyra e dhunës, shkaqet dhe pasojat e saj ndikojnë në gra dhe vajza në mënyra** të ndryshme dhe në mënyrë disproporcionale në të gjithë organizatën.<sup>6</sup> Ky mirëkuptim, kur informohet mirë<sup>7</sup> nga më të prekurit dhe më të rrezikuarit, do t'i mundësojë udhëheqjes policore të identifikojë boshllëqet institucionale. Boshllëqe të tilla ka të ngjarë të jenë në formë të politikave dhe strategjive të pakuptueshme që janë të kufizuara në fushëveprim dhe diapazon, dhe masat të dobëta të llogaridhënies që gjenerojnë praktikë, sjellje dhe paragjykime policore që janë diskriminuese të dëmshme veçanërisht kundër grave dhe vajzave.

**Shihni ‘Hyrije’ për historikun mbi natyrën e DHGV shkaqet dhe pasojat e saj dhe si ndikon ajo te gratë dhe vajzat në mënyrë të ndryshme dhe në mënyrë disproporcionale dhe Kapitulli 11: ‘Sfidat dhe strategjitë për zbatimin e policimit gjinor-përgjegjës’ për pengesat e zakonshme institucionale.**

5 Për qëllimet e Doracakut, “mirë i informuar” do të thotë se është kontekstualisht i rëndësishëm dhe me të dhëna të rregullta që përbëhen nga të dhëna cilësore dhe sasore të siguruara nga ekspertë të policisë dhe aktorë të jashtëm, si ofruesit e shërbimeve thelbësore dhe/ose organizatat e shoqërisë civile.

6 Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet situatës së konfliktit të armatosur ose krizës humanitare.

7 ‘I mirinformuar’ do të thotë se është kontekstualisht i rëndësishëm dhe me kontribut të rregullt nga palët e interesuara të brendshme dhe të jashtme me të dhëna cilësore dhe sasore.

**Termi “perspektiva gjinore” është një mënyrë për të parë ose analizuar e cila shikon ndikimin e gjinisë në mundësitë e njerëzve, rolet shoqërore dhe ndërveprimet.**

UN Women

Me këto boshllëqe institucionale të identifikuar, politikave dhe strategjitë, duke përfshirë ato për forcimin e integritetit dhe llogaridhënies së policisë, mund të futen nga menaxhmenti ekzekutiv i policisë me qëllim përfundimin e praktikave diskriminuese dhe përfundimisht transformimin drejt një organizate policore të përgjegjshme ndaj gjinisë.

Një organizatë policore e përgjegjshme gjinore është ajo që është e përkushtuar për integrimin e parimeve të barazisë gjinore dhe jo diskriminimit në politikën dhe praktikën e saj, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, aplikimin e një **perspektive gjinore** në mësimin dhe rritjen e tij profesionale.

*Platforma e 7 mekanizmave të pavarur të OKB-së dhe ekspertëve rajonalë mbi dhunën kundër grave dhe të drejtat e grave u bëri thirrje bashkërisht të gjitha shteteve dhe aktorëve relevantë në mbarë botën që të veprojnë kundër përdhunimit si një formë e dhunës me bazë gjinore dhe një shkelje e të drejtave të njeriut, dhe, që të sigurojnë se përkufizimi i përdhunimit bazohet në mungesën e pëlqimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Gjithashtu duhet të bëhen më shumë përpjekje për të siguruar ndjekjen e përdhunimit në kohë paqeje dhe konflikti.<sup>17</sup>*

Stafi juaj duhet të jetë i vetëdijshëm se vazhdimësia e përdhunimit të përhapur dhe sistematik dhe formave të tjera të DHGV-së seksuale, edhe në vendet që kanë shpallur zero tolerancë ndaj DHGV-së, tregon se dhuna seksuale është ngulitur thellë në shoqëritë tona që janë akoma kryesisht mbizotëruese patriarkale.

Stafi juaj duhet të kuptojë që:

- Fuqia dhe kontrolli vazhdojnë të krijojnë një mjedis shoqëror ku një dhunë e tillë normalizohet, dhe stereotipet me bazë gjinore mbi rolin e grave në shoqëri nënvlerësojnë dhe zhvlerësojnë gratë; dhe

<sup>17</sup> Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, 25 nëntor 2019: Mungesa e pëlqimit duhet të bëhet standardi global për përcaktimin e përdhunimit (2019). OHCHR <https://www.ohchr.org/EN/NewsEvents/Pages/DisplayNews.aspx?NewsID=25340&LangID=E>

- Këta faktorë kontribuojnë në tolerancën e papranueshme të përdhunimit, si dhe brenda sistemeve të drejtësisë penale, shpesh duke rezultuar në mosndëshkim për autorët e dyshuar.

Ju mund të jeni nga një vend ku sistemi i drejtësisë penale miraton një përkufizim të dhunimit të bazuar në forcë, i cili mund të kërkojë prova se autori i dyshuar ka përdorur detyrim dhe se viktimat/e mbijetuara nuk ka arritur të luftojë. Si e tillë, barra i vihet gruas për të provuar se ajo rezistoi. Nëse nuk arrin ta bëjë këtë, autori i dyshuar do të dilte i lirë ndërsa viktimat/e mbijetuara mbetet e stigmatizuar. **Ju lutemi shihni Kapitullin 9: 'Komunikimet.'**

Në vendin tuaj, fushata të tilla si #MeToo, #TimesUp, #Niunamemos, #NotOneMore, dhe të tjera, zërat e të mbijetuarave të përdhunimit, si në kohë lufte ashtu edhe në paqe, mund të kenë nxjerrë në pah përdhunimin dhe vepra të tjera penale. Udhëheqësia e policisë duhet të ndërmarrë hapa për të zbuluar nëse një

Gjeni përkufizimin e përdhunimit në vendin tuaj dhe çfarë dëshmish duhet të mblidhni për të provuar veprën penale për të forcuar hetimin tuaj për rastet e përdhunimit.



fushatë e tillë është aktive në vendin e tyre, dhe nëse po, cilat vepra penale janë shqetësuese. Kjo do t'ju mundësojë të identifikoni veprat penale të cilat do të jenë objekt i vëmendjes kombëtare.

## Çfarë mund të bëjnë agjencitë e sektorit të drejtësisë dhe sigurisë për të arritur një ndryshim?

Udhëheqësia e policisë duhet të jetë e vetëdijshme se agjencitë e sektorit të drejtësisë dhe të sigurisë, të mbështetura nga ligji dhe shërbimet e tjera mbështetëse për gratë dhe vajzat mund të punojnë së bashku për të mbyllur boshllëkun midis dispozitave të përcaktuara nën ligjet ndërkombëtare dhe kombëtare për përdhunimin dhe dhunën seksuale.

Në rolin tuaj si udhëheqësi e policisë, ju mund të mos jeni në gjendje të ndikoni në qasjen kombëtare të vendit tuaj, por ju mund të merrni hapa si një nivel lokal për të bërë një ndryshim të vërtetë për viktimat/të mbijetuarat e DHGV-së. Udhëheqësia e policisë duhet:

- Të zhvillojë një kuptim të kufizimeve, për shembull, të mos pasurit të një legjislacioni gjithëpërfshirës të dhunës me bazë gjinore, përfshirë legjislacionin për përdhunimin ose kodet penale të cilat nuk përfshijnë përdhunimin martesor në vendin tuaj. Kjo mund të paraqesë një sfidë për stafin tuaj kur ata kanë të bëjnë me viktimat/të mbijetuarat të përdhunimit martesor;
- Të jetë në gjendje t'i japë udhëzime stafit të saj se çfarë duhet të bëjnë kur ballafaqohet me gra të dhunuara nga burrat/partnerët kur ligji nuk i mbron në situata të tilla;
- Të sigurojë që stafi i saj të dijë nëse ka organizata mbështetëse lokale për gratë të cilat ofrojnë mbështetje shumë të nevojshme për viktimën/të mbijetuarën.

UNHCHR ka sugjeruar një qasje në raste të tilla dhe fusha kryesore që zbatohet për udhëheqësinë e policisë është që të ofrohen shërbime të specializuara mbështetëse (aty ku ka), duke përfshirë mbështetjen



Një qasje e ndjeshme ndaj gjinisë ndaj viktimave/të mbijetuarave është hap kyç në ndërtimin e besimit në sistemin e drejtësisë kur trajtohen rastet e DHGV-së.

ndaj traumave dhe aksesin në shërbimet shëndetësore. Këto mund të bëjnë një ndryshim të vërtetë për viktimat/të mbijetuarat<sup>18</sup>. Udhëheqësia e policisë duhet të identifikojë shërbimet e mbështetjes së traumave në zonën e saj dhe të marrë parasysh se ku kërkohet referimi për shërbime shëndetësore të specializuara për të mbështetur viktimat/të mbijetuarat për të siguruar mirëqenie kritike dhe mbështetje emocionale.

<sup>18</sup> Po aty.

## Roli i Qeverisë në përcaktimin e kornizës politike dhe legjislative

Hetimi efektiv dhe ndjekja penale e DHGV-së kërkon mbështetjen nga Shteti. Megjithatë, ka veprime që mund të ndërmerren në nivel lokal nga udhëheqësia e policisë të cilat mund të bëjnë një ndryshim të vërtetë.

Udhëheqësia e policisë duhet të identifikojë se si dhe ku mund të kontribuojë në zhvillimin e politikave qeveritare dhe kornizave legjislative në lidhje me DHGV-në duke identifikuar fushat e problemeve në zhvillim dhe duke ndarë praktikën më të mira me drejtuesit e ekipit/njesisë së tij.

Udhëheqësia e policisë duhet:

- Të përdorë një qasje të ndjeshme ndaj gjinisë kur ndërvepron me viktimat/të mbijetuarat për të siguruar që kontakti i tyre i parë me shërbimin policor të krijojë besim dhe të inkurajojë viktimat/të mbijetuarat të paraqiten për të raportuar krimet;
- Të përqendrojë vëmendjen e policisë në krimet që përfshijnë DHGV-në.

Udhëheqësia e policisë duhet të ketë parasysh se mostrajtimi i raporteve fillestare të dhunës në familje mund të rezultojë në vdekjen përfundimtare për gruan e përfshirë. Vrasja e grave dhe vajzave të lidhura me gjininë (e njohur edhe si 'femicid') është një krim i tillë që mund të ndodhë.

## Vrasja e grave dhe vajzave lidhur me gjininë

Udhëheqësia e policisë duhet të vërejë përhapjen e lartë të vrasjeve të grave dhe vajzave të lidhura me gjininë në nivel ndërkombëtar dhe duhet të identifikojë nëse mblidhen të dhëna lokale në vendin/rajonin e tyre.

Nga 87,000 gra që u vranë qëllimisht në vitin 2017 në nivel global, më shumë se gjysma (50,000 - 58%) u vranë nga partnerët intim ose anëtarët e familjes, që

do të thotë se 137 gra në të gjithë botën vriten nga një anëtar i familjes së tyre çdo ditë. Më shumë se një e treta (30,000) e grave të vrara me dashje në vitin 2017 u vranë nga partneri i tyre intim aktual ose ish-partneri intim.<sup>19</sup>

Udhëheqësia e policisë duhet të ketë parasysh se në disa vende janë futur ligje për të mbështetur punën e policisë në trajtimin dhe reagimin ndaj DHGV-së.

#### Kutia 6

Disa vende kanë futur dispozita të veçanta që penalizojnë vrasjen e grave dhe vajzave lidhur me gjininë nën etiketimet “femicid” ose “femicid” (shumica e vendeve në Amerikën Latine). Vende të tjera kanë prezantuar faktorë rëndues të lidhur me vrasjet lidhur me gjininë dhe vepra të tjera penale. Faktorët rëndues mund të përfshijnë motive specifike (të tilla si paragjykimi, urrejtja dhe diskriminimi në lidhje me seksin e një personi, si në Belgjikë, Kanada dhe Spanjë, ose motivi i nderit dhe zakonit, si në Turqi) dhe rrethana faktike (të tilla si shtatzënia, si në Federatën Ruse dhe Turqi, ose të qenit bashkëshortja e viktimës, si në Belgjikë, Spanjë dhe Turqi).<sup>20</sup>

Udhëheqësia e policisë duhet të udhëzojë stafin e saj për të siguruar që në rastet e DHGV-së:

- Urdhrat e kufizimit të rekomandohen dhe merren nga gjykatat kur bëhen raporte për DHPI (Dhunën nga Partneri Intim) për të siguruar që vrasjet e grave dhe vajzave të lidhura me gjininë të mos ndodhin;
- Informacioni në lidhje me dhënien e urdhrave të kufizimit të ndahet me stafin e policisë në të gjithë zonën e tyre gjeografike për të mbrojtur viktimën/të mbijetuarën dhe për të parandaluar kryerjen e shkeljeve të tjera;
- Ekzistenca e një urdhri të kufizimit t’u sigurohet prokurorëve dhe gjyqtarëve të cilët mund të ud-

<sup>19</sup> Studimi Global mbi Vrasjen (UNODC, 2019), f.10.

<sup>20</sup> UNODC/CCPCJ/EG.8/2014/CRP.1, “Masat kombëtare të ndërmarra për të parandaluar, hetuar, ndjekur dhe ndëshkuar vrasjet e grave dhe vajzave të lidhura me gjininë, para. 12

hëheqin hetimet që përfshijnë të njëjtin autor për veprat penale lidhur me DHPI.

Këto janë masat kryesore që mund të ndihmojnë në parandalimin e vdekjeve pas një historie të dhunës nga partneri intim (‘DHPI’).<sup>21</sup>

Udhëheqësia e policisë mund të dëshirojë të kontrollojë nëse sistemet elektronike të monitorimit për shkelësit mund të përdoren ose forma të tjera monitorimi siç është raportimi në polici. Për shembull, mbledhja e të dhënave mund të përdoret si një mjet për të përmirësuar performancën e stafit tuaj, dhe një mënyrë për të ndryshuar sjelljen e tyre në trajtimin e shkeljeve të tilla. Çdo qasje duhet të jetë e ndjeshme ndaj gjinisë.

Ndërkombëtarisht, shtetet kanë filluar të prezantojnë ligje specifike për të trajtuar vrasjen e grave dhe vajzave lidhur me gjininë. Për shembull, Franca ka prezantuar kohët e fundit masa për të trajtuar këtë formë të shkeljes.

#### Kutia 7

Në Francë, Qeveria ka udhëzuar Policinë që të marrë masa specifike kur heton dhe trajton rastet e DHGV-së. Masat emergjente të shpallura në shtator të vitit 2019 përfshijnë:

- Konfiskimin e armëve të zjarrit nga personat e dyshuar për dhunë në familje dhe prioritizimin e trajnimit të policisë në mënyrë që ata të mos refuzojnë ankesat e grave duke i konsideruar ato si çështje private;
- Rritjen e përpjekjeve në shkollë për të rritur ndërgjegjësimin për DHBGJ;

<sup>21</sup> Për qëllimet e Manualit, autorët preferojnë termin “dhunë nga partneri intim” ose “DHPI” në vend të “dhunës në familje” dhe, si rezultat, do t’i japin përparësi termit “DHPI” përveç nëse termi “dhunë në familje” përdoret në burimin origjinal. Dhuna në familje është një term i gjerë që përfshin dinamika të ndryshme sociale dhe psikologjike dhe diferencime të fuqisë dhe mbulon forma të ndryshme, të tilla si abuzimi me fëmijët, abuzimi me të moshuarit dhe abuzimi ndërpersonal ose nga partneri. Nga ana tjetër, DHPI viktimizon në mënyrë disproporcionale gratë më shumë se burrat, ndërsa burrat përfaqësohen më tepër si autorë. Ajo gjithashtu lidhet fort me diferencat e fuqisë së përcaktuar shoqërore midis burrave dhe grave. Shih: Këshilli i Evropës, Komiteti i Ministrave, Takimi 1037, 8 tetor 2008 Komiteti Evropian për Studim fizibiliteti për Problemet e Krimit për një konventë kundër dhunës në familje.

- Hapjen e një linje telefonike që funksionon 24 orë për dhunën në familje;
- Punësimin e punonjësve socialë më të specializuar në stacionet e policisë;
- Rritjen e masave të trajtimit të partnerëve të dhunshëm për të shmangur shkeljet e përsëritura;
- Ndryshimin e ligjit për të njohur që viktimat e abuzimit mund të jenë nën kontrollin psikologjik të abuzuesve të tyre, të paaftë për të vepruar në mënyrë të pavarur;
- Punën me mjekët për të lehtësuar kufizimet e konfidencialitetit në rastet kur ekziston një “rrezik i menjëhershëm” i dhunës së përtërirë kundër viktimës, duke u mundësuar doktorëve që të paraqesin rastet tek autoritetet ligjore pa pëlqimin e pacientit. Aktualisht, mjekët mund ta bëjnë këtë vetëm kur një pacient është i mitur ose është “i cenueshëm”, një term i gjerë që mund t’i referohet një personi me aftësi të kufizuara, ose kur jeta e një personi është në rrezik të afërt.

Franca ka normat më të larta në Evropë të dhunës në familje, pjesërisht për shkak të reagimit të dobët të policisë ndaj raportimeve të abuzimit. Shumë nga gratë e vrara në vitin 2019 kishin kërkuar paraprakisht ndihmë nga policia, dhe në vitin 2018, 121 gra u vranë nga partnerët aktualë ose të mëparshëm. Çdo vit në Francë, rreth 219,000 gra të moshës 18 deri në 75 vjeç janë objektiva të dhunës fizike ose seksuale nga partnerët aktualë ose të mëparshëm, por statistikat e qeverisë tregojnë se vetëm 20 % paraqesin ankesa zyrtare<sup>22</sup>. Police leadership will find the example of the death of Julie Douib in France helpful. The case highlights the importance of police taking reports of violence and possession of firearms seriously. After Julie Douib was forced to give up custody of their two children for the weekend by her partner, she told the police that he had a license for a gun and that she was afraid

he would shoot her. “Madame, I am sorry,” the officer replied, according to Ms. Douib’s father, “but his license cannot be taken away unless he points the gun at you.” He did so 48 hours later, and fired twice, hitting Ms. Douib, 34, in her chest and arms. “He killed me,” she said with her last breath, said Maryse Santini, the downstairs neighbour who found her<sup>23</sup>

Shembulli i vdekjes së Julie Douib në Francë do të jetë një shembull i dobishëm për udhëheqësinë e policisë. Rasti thekson se sa me rëndësi është që policia të marrë më seriozisht raportet e dhunës dhe posedimit të armëve të zjarrit.

Pasi Julie Douib u detyrua të heqë dorë nga kujdestaria e dy fëmijëve të tyre për fundjavë nga partneri i saj, ajo i tregoi policisë se ai kishte leje për armë dhe se kishte frikë se mos e qëllonte. “Zonjë, më vjen keq”, u përgjigj oficeri, sipas babait të zonjës Douib, “por nuk mund t’ia marrim lejen përveç nëse ai ju drejton armën”. Ai e bëri këtë 48 orë më vonë dhe gjuajti dy herë, duke goditur zonjën Douib, 34 vjeç, në gjoks dhe krahë. “Ai më vrau”, tha ajo duke dhënë frymën e saj të fundit, tha Maryse Santini, fqinja e katit të poshtëm e cila e gjeti<sup>23</sup>.

Udhëheqësia e policisë duhet të ketë parasysh se qasja e propozuar franceze tregon se politika e qeverisë në lidhje me DHGV-në duhet të forcohet duke ankoruar parandalimin dhe reagimin në planet kombëtare.

Udhëheqësia e policisë duhet:

- Të hulumtojë nëse vendi juaj ka plane kombëtare në lidhje me DHGV-në për të kuptuar kornizën më të gjerë në të cilin po punoni. Planet gjithashtu mund të detajojnë rolin e agjencive të sektorit të drejtësisë dhe sigurisë dhe shoqërisë civile për të adresuar dhe parandaluar DHGV-në në vend;

<sup>22</sup> Les Chiffres de Référence sur les Violences Faites aux Femmes (2019). Secrétariat d’Etat chargé de l’égalité entre les femmes et les hommes et de la lutte contre les discriminations, at : <https://www.egalite-femmes-hommes.gouv.fr/le-secretariat-d-etat/>

<sup>23</sup> Fourquet, L. (2019), ‘Përderisa vdekjet po rriten, Franca përpiket të bëhet serioze për dhunën në familje’ për New York Times, në: <https://www.nytimes.com/2019/09/03/world/europe/france-domestic-violence.html>



- Duke pasur një pikturë më të madhe të planeve kombëtare, përfshirë rolin e agjencive të sektorit të drejtësisë dhe sigurisë dhe organizatave të shoqërisë civile, të drejtojnë oficerët tuaj të vijës së parë për të siguruar që vlerësimi juaj i rrezikut po merr parasysh rastet e kaluara të abuzimit në familje që përfshijnë të njëjtin autor;
- të mësojë nga rastet lokale të vrasjeve të grave dhe vajzave në lidhje me gjininë, ku vlerësimet efektive të rrezikut nuk janë kryer.

Udhëheqësia e policisë duhet të sigurojë që stafi i saj:

- Të kuptojë rolet dhe përgjegjësitë e policisë kur merret me DHGV-në;

Sipas OBSH-së, Gjymtimi/Prerja e Gjenitaleve të Femrës përfshin të gjitha procedurat që përfshijnë heqjen e pjeshme ose totale të organeve gjenitale të jashtme femërore, ose dëmtime të tjera të organeve gjenitale femërore për arsye jomjekësore.

## PËRKUFIZIMI DHE KORNIZAT

Moduli 5 i PSHTH për Koordinimin dhe Qeverisjen e Koordinimit nënvizon rëndësinë e një reagimit të koordinuar për viktimat/të mbijetuarat, duke rezultuar në rritje të sigurisë, duke i vendosur ato në qendër të çdo ndërhyrjeje ose reagimi institucional.<sup>24</sup>

Udhëheqësia e policisë duhet të jetë e vetëdijshme se një reagim i koordinuar u jep qasje viktimave/të mbijetuarave tek praktikuesit e informuar dhe të aftë të cilët ndajnë njohuritë në një mjedis përkushtues dhe përkrahës. Një reagim i koordinuar mund të njohë nevojat e shumta të viktimave/të mbijetuarave, të cilat mund të plotësohen përmes shërbimeve të bashkë-lokalizimit dhe rrjeteve të referimit. Për shembull, në disa forca policie, organizata të veçanta për gratë janë në dispozicion për t'u ofruar grave mbështetje të nevojshme, të tillë si rehabilitimi nga përdorimi i drogës, strehimi ose abuzimi në familje.

Viktimat e mbijetuara duhet të zënë vend në zemër të adresimit tuaj policor ndaj DHGV-së.

<sup>24</sup> Paketa e Shërbimit Thelbësor për Gratë dhe Vajzat që janë objekt i Dhunës: Elementet Themelore dhe Udhëzimet për Cilësinë (Programi i Përbashkët Global i Kombeve të Bashkuara mbi Shërbimet Thelbësore për Gratë dhe Vajzat që janë objekt i Dhunës, 2015), në: <https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2015/12/essential-services-package-for-women-and-girls-subject-to-violence>

- Të kuptojë që pajtueshmëria me standardet minimale nga agjencitë partnere të drejtësisë mund të ofrojë përgjigje më të qëndrueshme;
- Të kuptojë se qartësia e roleve dhe përgjegjësi nënkupton që çdo agjenci drejtësie mund të shkëlqejë në fushën e saj të ekspertizës dhe puna e secilit profesionist të plotësohet me atë të agjencive dhe profesionistëve të tjerë.

Koordinimi me sektorët e tjerë përmirëson aftësinë e sistemit të drejtësisë penale për t'i mbajtur përgjegjës autorët për të gjitha format e dhunës, përfshirë ato që mund të përkufizohen nga një autor si “traditë.” Një shembull i tillë është Gjymtimi/Prerja e Gjenitaleve të Femrës ose GJ/PGJF.

Hapi i parë për udhëheqësinë e policisë është të sigurojë që personeli i saj të kuptojë se çfarë është Gjymtimi/Prerja e Gjenitaleve të Femrës, ndikimi i tij dhe mbizotërimi në komunitetet të cilat ata i kanë nën kontroll. Vetëm atëherë mund të hartohen protokolle të përbashkëta për të siguruar komunikim të qartë dhe transparent dhe mekanizma të llogaridhënies midis agjencive të sektorit të drejtësisë dhe sigurisë (**shih Kapitullin 5: “Hetimet” i cili i referohet GJ/PGJF**). Ndërkombëtarisht ne jemi ende duke mësuar për kontekstet në të cilat kryhet Gjymtimi/Prerja e Gjenitaleve të Femrës (GJ/PGJF). Në Mbretërinë e Bashkuar, Protokollin për trajtimin e veprave penale GJ/PGJF midis Këshillit të Shefave të Policisë Nacionale dhe Shërbimit të Prokurorisë së Kurorës është hartuar për të përmirësuar mënyrat e punës midis policisë dhe prokurorëve,

për të përmirësuar hetimin dhe për të rritur ndjekjen e veprave të tilla.<sup>25</sup>

Campbell et al. japin më shumë informacione mbi identifikimin e qasjeve më të mira drejt përfundimit dhe ndjekjes penale ndaj praktikave të dëmshme, përfshirë gjymtimin/prerjen e gjenitaleve të femrës, martesën e detyruar, të ashtuquajturat vrasje dhe abuzime ‘për



nder’, ndalimin e rritjes së gjinjve, magjinë dhe abuzimin me bazë besimi që mund të gjenden në *Praktikat e Dëmshme Tradicionale: Parandalimi, Mbrojtja dhe Policimi (2020)*. Ky botim kërkon të rrisë mirëkuptimin duke ofruar një pasqyrë unike në perspektivën e viktimës/të mbijetuarat, e cila mund të forcojë vetëm njohuritë dhe besimin e punonjësve të policisë në trajtimin e këtyre krimeve.<sup>26</sup>

Udhëheqësia e policisë duhet të ketë parasysh se përkufizimet gjithashtu mund të jenë subjekt i debatit dhe pikëpamjeve të ndryshme. Termi dhunë “e bazuar në nder” në Mbretërinë e Bashkuar, për shembull, është kundërshtuar nga disa komentues sepse synon komunitete specifike në mënyrë disproporcionale, duke rezultuar në rritjen e mbikëqyrjes dhe policimit të atyre komuniteteve. Kjo i lidh komunitetet me agjendat që nuk lidhen me një përgjigje efektive të DHGV-së - ato mbështeten në stereotipet dhe kategorizimet e tjera diskriminuese që synojnë individët dhe komunitetet, dhe ligje të veçanta zbatohen për të adresuar problemet me masat ndëshkuese specifike që zbatohen në mënyrë disproporcionale dhe që nuk përputhen me ligje të tjera të lidhura me DHGV-në.<sup>27</sup>

25 Protokollin për trajtimin e veprave penale të Prerjes së Gjenitaleve të Femrës (‘PGJF’) midis Këshillit të Shefave të Policisë Nacionale dhe Shërbimit të Prokurorisë së Kurorës (2016). Këshilli i Shefave të Policisë Nacionale. <https://www.cps.gov.uk/sites/default/files/documents/publications/FGM-Protocol-june-2016.docx>

26 *Praktikat e Dëmshme Tradicionale: Parandalimi, Mbrojtja dhe Policimi* (2020). Campbell, G., Roberts, K.A., Sarkaria, N. Palgrave Macmillan.

27 Shih ‘Nga margjina në qendër: ‘Projektligji alternativ për adresimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave’ (Imkaan, tetor 2018), shih: [https://829ef90d-0745-49b2-b404-cbea85f15fda.filesusr.com/ugd/2f475d\\_g1a5eb3394374f24892ca1e1ebfeca2e.pdf](https://829ef90d-0745-49b2-b404-cbea85f15fda.filesusr.com/ugd/2f475d_g1a5eb3394374f24892ca1e1ebfeca2e.pdf)

Udhëheqësia e policisë do të udhëhiqet nga Moduli 5 i PSHTH i cili detajon përbërësit e përbashkët të një reagimi të koordinuar. Janë menaxherët operacionalë ata që do të kenë përgjegjësinë për të punuar me eproret e tyre për të zhvilluar reagime të tilla<sup>28</sup>. Një ekstrakt është dhënë në diagramin më poshtë:

## Agjencitë e Sistemit të Drejtësisë

Stafi juaj duhet të kuptojë se hetimi në vetvete paraqet pikën hyrëse në sistemin e drejtësisë. Një hetim gjithëpërfshirës dhe i ndjeshëm ndaj gjinisë është jetik për të siguruar llogaridhënien për DHGV-në për të eliminuar mosndëshkimin dhe për të siguruar mbrojtje për viktimat/të mbijetuarat.

Në fakt, një hetim i ndjeshëm ndaj gjinisë duhet të jetë një element kritik për veprimin e përgjegjshëm ndaj gjinisë nga sistemi i drejtësisë penale. Kjo do të thotë të sigurohet që ligjet, institucionet e drejtësisë penale, proceset e drejtësisë penale dhe rezultatet e drejtësisë penale të mos diskriminojnë askënd në bazë të gjinisë. Ai kërkon marrjen e një perspektive gjinore mbi vetë ligjin penal, si dhe një vlerësim të qasjes dhe pengesave në procedurat e drejtësisë penale të disponueshme për gratë dhe burrat dhe miratimin e strategjive të ndjeshme gjinore për mbrojtjen e viktimave/të mbijetuarave dhe promovimin e qasjes në drejtësinë penale.<sup>29</sup>

Drejtësia penale me përgjegjësi gjinore nënkupton jo vetëm të kuptuarit e marrëdhënieve të ndërsjella midis gjinisë dhe krimin dhe sesi gratë dhe burrat ndikohen ndryshe nga krimi dhe dhuna. Ajo gjithashtu kërkon veprime të synuara për të përbushur nevojat specifike të grave ose burrave në sistemin e drejtësisë penale, si dhe adresimin e shkaqeve të pabarazisë gjinore që sistemi gjeneron ose përjetëson<sup>30</sup>. Studi-

28 Moduli 5: Koordinimi dhe Qeverisja e Koordinimit, *Paketa e Shërbimit Thelbësor*

29 Skinnider, Eileen, ‘Drejt Drejtësisë Penale Përgjegjëse ndaj Gjinisë: Praktika të mira nga Azia Juglindore në reagimin ndaj dhunës kundër grave’ (2018: Instituti i Drejtësisë në Tajlandë).

30 ‘Shkalla e Vlerësimit të Përgjegjshëm ndaj Gjinisë: Kriteret për Vlerësimin e Programeve dhe Politikave’ në Integrimin Gjinor për Menaxherët e Shëndetit: një Qasje Praktike/Mjete të Analizës Gjinore të OBSH-së. Udhëzuesi për moderatorë. Shënimet e pjesëmarrësve (OBSH, 2011), at: [https://www.who.int/gender-equity-rights/knowledge/health\\_managers\\_guide/en/](https://www.who.int/gender-equity-rights/knowledge/health_managers_guide/en/)

Figura 3:

Përbërësit e Përbashkët të një Reagimi të Koordinuar

## PËRBËRËSIT E PËRBASHKËT TË NJË PËRGJIGJEJE TË KOORDINUAR



Reagimet e koordinuara zakonisht përfshijnë një kombinim të më poshtmeve	Partneritetet midis sektorëve dhe agjencive shpesh rriten përmes mjeteve të mëposhtme
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Një kuadër për bashkëpunim shumë sektorial midis agjencive</li> <li>• Një komitet ose trup koordinues për të monitoruar progresin dhe zhvillimin e politikave</li> <li>• Mekanizmat për të menaxhuar, punuar dhe sanksionuar shkelësit</li> <li>• Shërbimet për të mbijetuarat, të tilla si shëndeti, strehimi dhe mbështetja e avokimit, duke përfshirë integrimin e mjeteve juridike të mbrojtjes civile me procesin e drejtësisë penale</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Takime të rregullta sy më sy</li> <li>• Politikat dhe protokollet e përbashkëta të zhvilluara nga agjencitë kryesore</li> <li>• Planifikimi i përbashkët i aktiviteteve dhe ndërhyrjeve</li> <li>• Trajnimi i përbashkët i stafit në organizatat/ sektorët partnerë</li> <li>• Ndarja e informacionit në lidhje me të mbijetuarat dhe autorët, duke respektuar privatësinë dhe duke siguruar sigurinë</li> <li>• Mbledhja e vazhdueshme e të dhënave për të monitoruar progresin dhe rezultatet e rastit, dhe identifikimi i praktikave të mira dhe të dobëta</li> </ul>
Reagimet e koordinuara shumë disiplinore kërkojnë	Organi përgjegjës për koordinimin mund të jetë
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëpunim, komunikim dhe shkëmbim të informacionit midis agjencive</li> <li>• Pjesëmarrje aktive nga një sërë aktorësh</li> <li>• Marrëveshje për mënyrën më efektive për t'iu përgjigjur dhunës ndaj grave</li> <li>• Bashkëpunim, komunikim dhe shkëmbim të informacionit midis agjencive</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Një organ i pavarur ose agjenci e specializuar, roli i të cilës është koordinimi i sektorëve kryesorë</li> <li>• Një koalicion agjencish që takohen rregullisht, njohur gjithashtu si këshill, komitet ose task forcë</li> <li>• Një organ i nivelit të lartë, duke përfshirë ministra dhe/ose drejtues të institucioneve kryesore</li> </ul>

met globale në përgjithësi zbulojnë se meshkujt janë më shpesh viktimat të vrasjeve dhe sulmeve, përveç sulmeve seksuale, në të cilat gratë janë më shpesh viktimat<sup>31</sup>.

Megjithatë, gratë kanë më shumë të ngjarë të jenë objekt i dhunës dhe abuzimit brenda sferës private shtëpiake, të kryera nga dikush që ato njohin, dhe shpesh nga partneri i tyre. Kryesit e dhunës, qoftë dhunës ndaj burrave apo grave, janë kryesisht meshkuj. Një sistem i drejtësisë penale që i përgjigjet gjinisë është ai që u jep grave besim për të raportuar dhunën dhe, pasi të

<sup>31</sup> Studim Global mbi Vrasjen<sup>3</sup> 2013; Gratë dhe Sistemi i Drejtësisë Penale (UNODC, 2011). Mahony, T.H., Jacob, J., dhe Hobson, H. për Qeverinë e Kanadasë

raportojnë, jep një përgjigje efektive për të zvogëluar rreziqet e dëmtimeve të mëtejshme. Një sistem i drejtësisë penale që i përgjigjet gjinisë siguron gjithashtu një mjet efektiv, si dhe mbështetje dhe trajtim me dinjitet në të gjithë zinxhirin e drejtësisë penale.

## 1. Prokurorët

Në varësi të kornizës ligjore kombëtare ose sistemit të drejtësisë, prokurorët do të luajnë një rol kyç në vendosjen e fokusit të procedurave ligjore në emër të shtetit kundër një autori të dyshuar për DHGV.

Drejtuesit e policisë duhet të kenë parasysh që:


- Ata do të kenë nevojë të ndërtojnë marrëdhënie të forta pune me prokurorin për të ofruar ndjekje penale dhe rezultate efektive për viktimat/të mbijetuarat e DHGV-së;
- Për të kuptuar më mirë rolin e prokurorit në sistemin e tyre të drejtësisë, ata mund të zhvillojnë, për shembull, seanca të përbashkëta për rritjen e ndërgjegjësimin për të ndërtuar marrëdhënie pune efektive midis policisë dhe prokurorëve<sup>32</sup>.

Pavarësisht nga sistemi ligjor që ekziston, duhet të jeni të vetëdijshëm se prokurorët kryejnë një rol aktiv në shqyrtimin e ligjshmërisë dhe drejtësisë së hetimeve dhe mbledhjen e provave, si dhe në monitorimin e respektimit të të drejtave të njeriut nga hetuesit, të paktën për të vendosur nëse ndjekja duhet të fillojë ose të vazhdojë.

Udhëheqësia e policisë duhet të sigurojë që stafi i saj të kuptojë DHGV-në dhe të marrë trajnimin e kërkuar për DHGV. Ata do të punojnë ngushtë me prokurorët dhe për këtë arsye do të kenë nevojë të dinë se çfarë bëjnë prokurorët në vendin e tyre.

Për shembull, në vendet ku prokurorët mbikëqyrin

<sup>32</sup> Përgjigje efektive në rastet që përfshijnë DHGV: Roli i prokurorit në Doracakun për Përgjigjet Efektive të Prokurorisë ndaj Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave, Seria e Doracakëve të Drejtësisë Penale (UNODC, 2014) në: <https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2014/12/handbook-effective-prosecution-of-vaw>



Në disa vende, prokurorët hetojnë dhe ndjekin çështjet dhe, në të tjerat, policia kryen rolin e hetimit para se t'ia dorëzojë çështjen prokurorit për ndjekje penale.

hetimet e policisë, ata duhet të sigurojnë që policia:

- Ka përdorur teknikat e duhura të hetimit dhe kërkimit në mënyrë që provat të jenë të pranueshme në gjykatë;
- Ka kryer intervista të hollësishme, private dhe me respekt të viktimave/të mbijetuarave dhe dëshmitarëve;
- Është siguruar që aty ku është e mundur, zyrtaret femra janë vënë në dispozicion nëse viktimat/e mbijetuarat ka zgjedhur kështu;
- Ka plotësuar plotësisht një raport policor mbi incidentin;
- Ka kryer intervista pasuese për informacion dhe prova shtesë;
- Ka kuptuar ligjet përkatëse mbi dhunën ndaj grave (përfshirë elementet e krimit dhe procedurat e veçanta penale të zbatueshme për këto vepra); dhe
- Ka kuptuar dhe zbatuar konceptin e vetëmbrojtjes dhe politikave mbizotëruese të agresorit, aty ku është e përshtatshme.

Udhëheqësia e policisë duhet të kuptojë që roli kryesor që ajo luan në mbikëqyrjen e hetimeve të DHGV-së është të sigurojë që:

- Informacioni i saktë i paraqitet prokurorëve sapo të jetë në dispozicion;
- Staf i saj kupton çdo standard të rënë dakord në nivel lokal për paraqitjen e dosjeve tek prokurorët;
- Staf i saj është i vetëdijshëm për standardet që keni vendosur për cilësinë;



National Penitentiary Haiti. Foto nga MINUSTAH Photo/Victoria Hazou

- Se çdo nevojë për trajnim në lidhje me të kuptuarit e veprave të DHGV-së adresohet;
- Prokurorët luajnë një rol të rëndësishëm në hetimin e DHGV-së pasi mund të përcaktojnë nëse janë bërë të gjitha hetimet e nevojshme dhe të arsyeshme para se të merret një vendim për të ndjekur penalisht apo jo, ose para se të merren vendime të tjera që mund të ndikojnë në rrjedhën e drejtësisë<sup>33</sup>.

Në juridiksionet ku prokurorët dhe hetuesit kanë role të pavarura, me hetuesit përgjegjës për kryerjen e hetimit në mënyrë të pavarur, zakonisht ka masa për të siguruar bashkëpunimin midis hetuesit dhe prokurorit. Në këto sisteme të drejtësisë, prokurorët nuk i udhëzojnë hetuesit, por mund t'i këshillojnë ata bazuar në rezultatet e hetuesve të hetimit dhe rishikimin objektiv të prokurorëve të atyre rezultateve, bazuar në ligj dhe udhëzime.

Udhëheqësia e policisë në juridiksione të tilla mund të kërkojë këshilla nga prokurorët kur ata përballen me

<sup>33</sup> Po aty.

vështirësi provuese. Ose, në situata të tjera, prokurori mund të marrë raportin e policisë ose dosjen e këshillimit për konsultim për shkak të një rasti “të dobët” ose një komentit me opinionin e hetuesit se nuk ka perspektivë dënimi<sup>34</sup>. Udhëheqësia e policisë duhet të sigurojë që stafi i saj të mos shprehë opinione në lidhje me fuqinë e një rasti bazuar në pikëpamjet e tyre personale, dhe vështirësitë evidentuese duhet të theksohen dhe vlerësohen kundër ligjit në fuqi.

Në juridiksione të tjera, prokurorët luajnë një rol më aktiv në hetime dhe mund të marrin pjesë, të kryejnë, drejtojnë ose mbikëqyrin hetimet. Disa shtete i lejojnë prokurorit të japë udhëzimet dhe këshillat e duhura për policinë për të zbatuar përparësitë e politikave të krimit, për të ndarë rastet dhe burimet, për t'i dhënë përparësi rasteve dhe për të aplikuar metoda hetimore.

Në disa juridiksione, prokurorët kontaktohen pas kontaktit fillestar të viktimës/të mbijetuarës nga policia

<sup>34</sup> Po aty.



Përqendrohuni në ndërtimin e çështjes tuaj dhe sigurohuni që të mos diskreditoni viktimën/të mbijetuarën.

dhe mund të përgjigjen në vendin e ekzaminimit në mënyrë që ata të njihen me rastin dhe të ndihmojnë në drejtimin e hetimit. Në juridiksione të tilla, udhëheqësia e policisë duhet të sigurojë që stafi i tyre të mbështesë rolin e prokurorit për të mbledhur prova dhe t'u sigurojë viktimave/të mbijetuarave ndihmën që u nevojitet për të qëndruar në sistemin e drejtësisë penale.

Në përgjithësi, udhëheqësia e policisë duhet të sigurojë që:

- Stafi i saj të ndërtojë raste të forta, ose të mbështesë prokurorët për ta bërë këtë;<sup>35</sup>
- Bashkëpunimi me policinë dhe prokurorët zhvillohet për të adresuar shkeljet e DHGV-së;
- Stafi i saj nuk diskrediton një viktimë/të mbijetuar dhe përqendrohet në ndërtimin e një çështjeje kundër autorit të supozuar;
- Krijohet një marrëdhënie pune me homologët e tyre në zyrën e prokurorit.

Studimet kanë treguar se në disa lloje të rasteve të DHGV-së (d.m.th. sulmit seksual) ka pak dëshmi të përpjekjeve për të ndërtuar raste. Përkundrazi, ka dëshmi të hetimeve të dobëta, paragjytimeve gjinore<sup>36</sup> dhe të kuptuarit të ligjit. Bashkëpunimi i fortë midis policisë dhe prokurorëve është thelbësor në këto raste për të

35 Për më shumë informacion mbi praktikën më të mirë dhe standardet minimale për ndërtimin e rasteve më të forta në DHGV, shihni 'Përgjigja Model ndaj Dhunës Seksuale për Prokurorët (Modeli RSVP): Një Ftesë për të Drejtuar', (AEquitas, Instituti i Menaxhimit të Drejtësisë (IMI), dhe Instituti Urban, 2016), në: <https://aequitasresource.org/wp-content/uploads/2020/01/RSVP-Vol.-I-1.8.20.pdf>

36 'Gjyqi i Përdhunimit. Kuptimi i Reagimit të Sistemit të Drejtësisë Penale ndaj Dhunës Seksuale në Tajlandë dhe Viet Nam' (UN Women, UNDP dhe UNODC, 2017), në: [https://www.unwomen.org/-/media/field%20office%20easia/docs/publications/2019/08/ap-trial-of-rape\\_26aug2019\\_lowres-compressed.pdf?la=en&vs=1916](https://www.unwomen.org/-/media/field%20office%20easia/docs/publications/2019/08/ap-trial-of-rape_26aug2019_lowres-compressed.pdf?la=en&vs=1916)

siguruar që përpjekjet e policisë të përqendrohen në ndërtimin e një rasti në vend të diskreditimit të viktimës/të mbijetuarës<sup>37</sup>.

#### Kutia 8

Në qershor të vitit 2017, UNODC mbajti trajnim të përbashkët për policinë dhe prokurorët në Namibi mbi dhunën me bazë gjinore për të nxjerrë në pah punën dhe bashkëpunimin e përbashkët të kërkuar për të arritur rezultate të suksesshme për viktimat/të mbijetuarat. Pjesëmarrësit zhvilluan një kuptim më të mirë të roleve dhe përgjegjësisë të agjencive përkatëse dhe, si rezultat, marrëdhënia e tyre e përbashkët e punës u përmirësua.

#### Kutia 9

Në Finlandë, policia dhe prokurorët janë trajnuar për hetime teknike ose taktike në lidhje me vrasjet ose krime të tjera të dhunshme. Policia e Angolës (Komanda e Përgjithshme e Policisë Kombëtare) ka bërë përpjekje për ngritjen e vetëdijes për t'u ofruar punonjësve të policisë njohuritë dhe aftësitë e kërkuara në situatat e dhunës në familje dhe me bazë gjinore.

Udhëheqësia e policisë duhet t'i sigurojë stafit të saj udhëzime të qarta:

- Për trajtimin e rasteve të abuzimit në familje, për shembull, për të siguruar që ndërveprimi i parë i viktimës/të mbijetuarës me agjencitë e sektorit të drejtësisë dhe sigurisë e inkurajon atë që të vazhdojë me rastin e saj nëse ngritet;
- Për katalogimin dhe mirëmbajtjen e kasetave të thirrjeve të urgjencës të DHPI pasi ato mund të përmbajnë dëshmi të mundshme të shprehura. Kjo ndodh sepse shumica e thirrjeve për ndihmë policore bëhen nga viktimat/e mbijetuarat;
- Lidhur me protokollet e shkëmbimit të informacionit në vend midis gjykatave penale dhe gjykatave familjare;

37 Po aty.

## Kutia 10

### Praktika e Mirë në Tajlandë: Trajnimi i vazhdueshëm i Policisë Mbretërore Tajlandeze, prokurorëve dhe personelit të gjykatës në partneritet me UN Women

Ligji i ri për Barazinë Gjinore ('GEL') u shpall zyrtarisht më 8 mars 2015, i cili i mbron individët kundër diskriminimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në bazë të seksit ose seksualitetit. Ligji përcakton që politikat, rregullat, rregulloret, urdhrat, masat, projektet ose praktikat e publikut, organizatave private ose individëve që janë diskriminuese për nga aspekti gjinor nuk lejohen, përveç me qëllim të eliminimit të barrierave për gëzimin e barabartë të të drejtave dhe lirive, parimeve fetare dhe Sigurisë Kombëtare.

GEL gjithashtu krijon një Komitet për Promovimin e Barazisë Gjinore, i cili është i mandatuar për të përmirësuar modelet sociale dhe kulturore të sjelljeve, në mënyrë që të eliminojë paragjykimet dhe praktikat diskriminuese gjinore, si dhe dhunën me bazë gjinore, me qëllim që të eliminojë barrierat për të drejta të ndryshme.

Policia Mbretërore Tajlandeze, në partneritet me UN Women, Departamentin e Çështjeve të Grave dhe Zhvillimit të Familjes dhe Fondacionin Friends of Women, gjithashtu ka zgjeruar trajnimin e zyrtarëve policorë të hetimit për mbrojtjen e grave viktime/mbijetuese të dhunës, dhunës në familje dhe trafikimit për të përfshirë 900 zyrtarë policorë kryesorë të hetimit në të gjitha rajonet e Tajlandës.

Bazuar në mësimet e nxjerra nga këto trajnime dhe trajnimet e mëparshme gjatë viteve të fundit, module të veçanta trajnimi po zhvillohen për t'u institucionalizuar në Policinë Mbretërore Tajlandeze. Si rezultat i drejtpërdrejtë i këtij studimi, Instituti Tajlandez i Drejtësisë ka ndarë fonde shtesë për të zgjeruar kërkimin dhe për të zhvilluar një kuti mjetesh dhe fushatë publike për të informuar si viktimat/të mbijetuarat ashtu edhe bartësit e detyrës për të drejtat dhe detyrimet e tyre, si dhe ligjet përkatëse, dhe ku mund të kërkohet mbështetje në sistemin e drejtësisë penale dhe shërbimet mbështetëse kombëtare dhe lokale.

Burimi: 'The Trial of Rape. Understanding the Criminal Justice System Response to Sexual Violence in Thailand and Viet Nam' (UN Women, UNDP dhe UNODC, 2017).

- Për dhënien e detajeve prokurorëve për çdo urdhër të mbrojtjes civile që shërbimi policor ka marrë në emër të viktimeve/të mbijetuarave për të forcuar ndjekjet për DHGV. Ka vende ku prokurorët mund të rishikojnë dosjet civile pasi mund t'i ndihmojnë ata në vlerësimin e rrezikut të viktimës/të mbijetuarës dhe të ndihmojnë në vendosjen e akuzave dhe dënimeve të sakta.

Mund të jetë e përshtatshme që prokurorët të informojnë ekipet lokale të hetimit mbi praktikat e tyre lokale dhe duhet të merret parasysh trajnimi<sup>38</sup>.

<sup>38</sup> Manual trajnimi për gjyqtarët dhe prokurorët mbi sigurimin e qasjes së grave në drejtësi. Partneriteti për Qeverisje të Mirë. Bashkimi Evropian, në: [https://www.ohchr.org/Documents/Issues/Women/WRGS/TrainingManualAccessJustice\\_EN.pdf](https://www.ohchr.org/Documents/Issues/Women/WRGS/TrainingManualAccessJustice_EN.pdf)

## 2. Gjyqësori<sup>39</sup>

Gjyqësori ose sistemi gjyqësor është sistemi i gjykatave që administrojnë drejtësinë në emër të sovranit ose shtetit.

### Urdhrat mbrojtës

Në varësi të juridiksionit, gjykatat mund të kenë fuqinë të lëshojnë urdhra mbrojtjeje ose të rishikojnë dhe zgjasin ose anulojnë urdhrat ndalues të lëshuar nga policia kundër autorëve të dyshuar për DHPI.<sup>40</sup>

<sup>39</sup> Po aty.

<sup>40</sup> Për shembull në Austri. Shih: Të drejtat e viktimeve për mbështetje dhe mbrojtje nga dhuna (2013). Legjislacioni për Mbrojtjen nga Dhuna në Austri (2019). Qendra për Ndërhyrje në Abuzimin Familjar dhe Shoqata e Strehëve Autonome të Grave Austriake. <https://www.interventionsstelle-wien.at/download/?id=692>

Në mënyrë tipike, gjyqtari kryeson një seancë në të cilën kohë viktimat/e mbijetuara dhe autorët e dyshuar paraqesin prova. Përcaktimi i gjyqtarit nëse një viktimë/e mbijetuar kërkon masa mbrojtëse është kritik, jo vetëm për sigurinë e viktimës/të mbijetuarës dhe anëtarëve të tjerë të familjes, por edhe në krijimin e kushteve më të mira të mundshme për çështjen në vazhdim dhe që rezultojnë në një dënim. Seancat mbrojtëse janë një mundësi e parë e rëndësishme për gjyqtarin për të vendosur një ton të përshtatshëm dhe për të demonstruar se Shteti kujdeset për të shmangur dëmtimin e viktimave/të mbijetuarave të mundshme në rastet e DHPI.

Udhëheqësia e policisë duhet të sigurohet që stafi i saj



Viktimizimi dytësor nuk ndodh si rezultat i drejtpërdrejtë i një vepre penale, por më tepër si reagim i papërshtatshëm i policisë dhe institucioneve dhe individëve të tjerë kompetent ndaj viktimës/të mbijetuarës.

të kuptojë:

- Rolin kryesor që stafi luan në parandalimin e DHGV-së ku ka pengesa kulturore dhe shoqërore në komunitetet që praktikojnë praktika të dëmshme të cilat i pengojnë viktimat/të mbijetuarat të ngritin zërin për të raportuar një vepër penale;
- Urdhrat e mbrojtjes që janë në dispozicion në vendin e tyre për shkeljet e DHGV-së dhe masat që u kërkohet të marrin për t'i zbatuar ato në mënyrë efektive;
- Rolin e gjykatave civile në parandalimin e DHGV-së;
- Nevojën për të vazhduar ndërtimin e besimit të komuniteteve që ata kanë nën kontroll.

Në disa juridiksione, masat mbrojtëse për disa vepra penale të marra nga gjykatat e familjes mund të tejkalojnë ndjekjet penale. Për shembull, në Mbretërinë e Bashkuar, numri i urdhrave për mbrojtjen e PGJF rrit një ndjekje të suksesshme që ka ndodhur.

Udhëheqësia e policisë duhet të sigurojë që stafi i saj të jetë i vetëdijshëm për nevojën për të punuar me autoritetet e kujdesit social, shëndetësor dhe arsimor.

#### Kutia 11

##### Shembull nga Mbretëria e Bashkuar

Komentuesit kanë theksuar nevojën që shërbimi policor, kujdesi social dhe gjykata në Mbretërinë e Bashkuar të punojnë së bashku për të mbrojtur viktimat/të mbijetuarat, kur profesionistët e drejtësisë nuk identifikojnë ato viktimat/të mbijetuara që jetojnë me pasojat e PGJF. Mund të ketë gjithashtu një mungesë besimi në lidhje me mënyrën se si policia me marrëveshje i përgjigjet raporteve të policisë për PGJF nga profesionistët e shëndetësisë, arsimin dhe kujdesit social<sup>41</sup>.

Gjyqtarët e **Procesit Penal** mund të ushtrojnë diskrecion gjatë fazave paraprake të një procesi penal për të ndërmar hapa për të mbrojtur të drejtat dhe dinjitetin e viktimave/dëshmitarëve dhe për të siguruar që ata të mos përjetojnë viktimizim dytësor, për shembull, duke përjashtuar publikun nga seancat nëse rasti ka të bëjë me dhunën seksuale dhe kërkon konfidencialitet (faza hetimore paraprake, seancat e urdhrin mbrojtës, seancat e dorëzimit, etj.)<sup>42</sup>.

Si prokurorët ashtu edhe gjyqtarët mund të ndërmarin hapa nga fillimi i një kallëzimi penal në lidhje me DHGV-në për të siguruar që nuk ka vonesa në fazat e hetimit dhe mbledhjes së provave (veçanërisht në lidhje me mbledhjen dhe testimin e provave mjeko-ligjore) që do të rrezikonin ndjekjen dhe gjykimin.

Është një praktikë e mirë e përgjithshme të përdoren procedura të përshtatshme (të tilla si gjykatat e shpejta dhe të specializuara) në rastet e DHGV-së. Gjyqtarët

41 Maja e Ajsbergut, Sarkaria, N. dhe Campbell, G. Për Revistën Counsel <https://www.counselmagazine.co.uk/articles/tip-of-the-iceberg-the-family-court-ready-surge-activity-fgm>

42 Përmbledhje e praktikave të mira për të zvogëluar pengesat ekzistuese dhe lehtësuar qasjen e grave në drejtësi, (Komisioni i Barazisë Gjinore i Këshillit të Evropës, Strasburg, 2015) f. 24-26.





Ju duhet të kontrolloni nëse autori i supozuar i nënshtrohet ndonjë masë aktuale joburguese p.sh. urdhër për shërbim në komunitet, punë sprovuese.

mund ta bëjnë këtë vetëm nëse pajisen me informacionin përkatës nga policia, veçanërisht çdo vlerësim rreziku për të siguruar që viktimat/e mbijetuara të vazhdojnë të mbështesë një akuzë.

Udhëheqësia e policisë duhet të sigurojë që stafi i saj:

- Të dijë për qëllimin e procedimit të përshpejtuar; dhe
- Të dijë se si policia mund të mbështesë prokurorët dhe gjyqtarët për të kryer procedura të tilla.

### 3. Roli i shërbimit sprovues

Udhëheqësia e policisë duhet të kuptojë rolin që Shërbimi Sprovues luan në procesin e drejtësisë, në juridiksionet ku ekziston një shërbim i tillë. Shërbimi Sprovues zakonisht është i mandatuar për të zbatuar masa pa burgim, të përcaktuara me ligj dhe të ngarkuara për shkelësin<sup>43</sup>. Masa të tilla mund të përfshijnë alternativa të paraburgimit para dhe gjatë gjyqimit ose dënimit me burgim, si dhe lirimin e parakohshëm nga burgu. Ato zakonisht përfshijnë mbikëqyrje, udhëzime dhe ndihmë që synojnë përfshirjen sociale të një shkelësi, si dhe kontributin në sigurinë e komunitetit.

Udhëheqësia e policisë duhet të jetë e vetëdijshme se ajo do të luajnë një rol kyç kur arreston/akuzon një autor të DHGV-së, për të kontrolluar nëse ai është objekt i ndonjë mase joburguese, për shembull në lirim me kusht, nëse është liruar kohët e fundit nga burgu.

Udhëheqësia e policisë duhet të rishikojë dhe të jetë e njohur me Rregullat Standarde Minimale të OKB-së

43 HM Inspectorate of Probation Academic Insights 2019/02 Rregullat Evropiane të Sprovimit, Rob Canton në: <https://www.justiceinspectors.gov.uk/hmiprobation/wp-content/uploads/sites/5/2019/03/Academic-Insights-Canton-Jan-19-final.pdf>

për Masat Joburguese ('Rregullat e Tokios'), të cilat ofrojnë udhëzime të hollësishme mbi llojet e ndryshme të masave që mund të zbatohen në faza të ndryshme procedurale, në varësi të secilit juridiksion. Për shembull, aty listohen dymbëdhjetë masa të cilat autoritetet gjyqësore mund të jenë në gjendje t'i shqiptojnë si pjesë e një dënimi<sup>44</sup>. Këto janë:

- Sanksionet verbale, të tilla si paralajmërimi, qortimi dhe paralajmërimi;
  - Shkarkimi me kusht;
  - Dënimet e statusit;
- Sanksionet ekonomike dhe dënimet monetare, të tilla si gjobat dhe gjobat ditore;
- Konfiskimi ose një urdhër shpronësimi;
- Dëmshpërblimi i viktimës/të mbijetuarës ose një urdhër kompensimi;
- Dënimi i pezulluar ose i shtyrë;
- Shërbimi sprovues dhe mbikëqyrja gjyqësore;
- Një urdhër për shërbim në komunitet;
- Referimi në një qendër frekuentimi;
- Arresti shtëpiak;
- Çdo mënyrë tjetër trajtimi jointitucional.

Monitorimi elektronik zakonisht nuk është një mënyrë trajtimi, por një mjet për të mbikëqyrur zbatimin e opsioneve të dënimit sprovues joburgues, siç janë dënimet me burg të pezulluara.

Udhëheqësia e policisë gjithashtu duhet të rishikojë dhe të jetë e njohur me Strategjitë Model dhe Masat Praktike të Përditësuara, të cilat kërkojnë që:

- Vendimet mbi arrestimin, ndalimin dhe kushtet e çdo forme të lirimimit të autorit të marrin parasysh

44 Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Masat Joburguese (Rregullat e Tokios), miratuar me rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme 45/110 të 14 dhjetorit 1990, në: <https://www.penalreform.org/priorities/alternatives-to-imprisonment/international-standards/>

nevojën për sigurinë e viktimës/të mbijetuarës dhe të tjerëve;

- Rreziqet e sigurisë, përfshirë cenueshmërinë e viktimave/të mbijetuarave, të merren parasysh në vendimet në lidhje me dënimet joburguese ose kuaziburguese, dhënien e dorëzarisë, lirimin me

kusht ose shërbimet provuese, veçanërisht kur kemi të bëjmë me shkelës përsëritës dhe të rrezikshëm;

- Viktimat/të mbijetuarat e dhunës të kenë të drejtë të njoftohen për lirimin e autorit nga paraburgimi ose burgimi.

## Kutia 12

### Praktika më e mirë në Mbretërinë e Bashkuar<sup>45</sup>

Qeveria e HM (Madhërisë së saj) dhe Sistemi Gjyqësor i Anglisë dhe Uellsit, SHPK dhe agjencitë e zbatimit të ligjit njohin vlerën e luajtjes së roleve të pavarura për të mbrojtur gratë dhe vajzat që përjetojnë dhunë dhe abuzim. Me kalimin e kohës, praktika të mira janë shfaqur për të mbështetur dhe mbrojtur gratë duke i mbajtur përgjegjës kryesisht e veprave në Sistemet e Drejtësisë Penale dhe Civile, gjë që varet nga çdo organ dhe agjenci që luan rolin e saj në mënyrë cilësore. Kjo praktikë e mirë përfshin:

(i) Qeveria e HM ka zhvilluar një numër dokumentesh udhëzuese strategjike, të cilat kanë për qëllim të rrisin qasjen e shumë agjencive në fushat që përfshijnë Martesën e Detyruar, Gjymtimin/Prerjen e Gjenitaleve të Femrës dhe Shfrytëzimin Seksual të Fëmijëve.

Këto dokumente u japin praktikuesve të linjës së parë informacion të paçmuar në lidhje me çfarë “Duhet bërë” dhe çfarë “Nuk duhet bërë” dhe “Shenjat” dhe “Simptomat” për t’u mundësuar praktikuesve të identifikojnë viktimat.

(ii) Udhëzimi gjithashtu plotësohet në një nivel strategjik me udhëzimin e policisë të prezantuar nga Kolegji i Policisë dhe KSHPN. Kolegji zhvillon njohuri, standarde të sjelljes, udhëheqje dhe profesionalizëm të kërkuar nga punonjësit e policisë, e cila krijohet përmes Praktikës Profesionale të Autorizuar.

KSHPN ka një numër funksionesh kryesore duke përfshirë koordinimin e operacioneve kombëtare që përfshin përcaktimin, monitorimin dhe testimin e kontributeve të forcës në Kërkesën Strategjike të Policimit; koordinimin e reagimit të policisë kombëtare ndaj emergjencave kombëtare dhe koordinimin e mobilizimit të burimeve përtej kufijve të forcave dhe ndërkombëtarisht; zbatimin operacional kombëtar të standardeve dhe politikave të përcaktuara nga Kolegji i Policisë dhe Qeverisë; dhe punën me Kolegjin e Policisë për të zhvilluar qasje të përbashkëta kombëtare mbi drejtësinë dhe performancën penale.

Kolegji i Policisë ka zhvilluar Praktikë Profesionale të Autorizuar për të ofruar standarde të udhëheqjes, drejtimin dhe hetimit në lidhje me fushat e mëposhtme të lëndëve të DHGV-së:

- Abuzimi në familje
- FM dhe HBV (Martesa e Detyruar dhe Dhuna e Bazuar në Nder)
- Kolegji i policimit GJ/PGJF
- Shfrytëzimi seksual i fëmijëve
- Sklavëria moderne
- Përndjekja dhe ngacmimi

<sup>45</sup> Kapitulli i Anglisë dhe Uellsit në Manualin mbi Ligjin në lidhje me Dhunën ndaj Grave (2018), Sarkaria, N., dhe Campbell, G. Fondacioni Evropian i Avokatëve. <https://elf-fae.eu/wp-content/uploads/2018/06/Manual-on-the-law-relating-to-violence-against-women.pdf>

## Përdhunimi dhe krimet seksuale

32. Nga dëshmitë në politikë: Adresimi i dhunës me bazë gjinore kundër grave dhe vajzave në Bangladesh: Një raport i dorëzuar Departamentit për Zhvillim Ndërkombëtar nga: ICDDR, B në bashkëpunim me Këshillin e Popullsisë, Janar 2013 [https://assets.publishing.service.gov.uk/media/57a08a16ed915d3cfd0005a4/VAWG\\_Bangladesh\\_Final\\_Report.pdf](https://assets.publishing.service.gov.uk/media/57a08a16ed915d3cfd0005a4/VAWG_Bangladesh_Final_Report.pdf)
33. Programi TOSTAN. Vlerësimi i një Programi Arsimor të bazuar në Komunitet në Senegal. Diop, N. J., Faye, M. M., Moreau, A., Cabral, J., & Benga, H. (2004). Nju Jork: Këshilli i Popullsisë. <https://namati.org/wp-content/uploads/2015/12/Tostan-Senegal-2004-evaluation.pdf>
34. PGJF dhe marrëdhënia midis Gjykatave të Familjes dhe Gjykatave Penale (2015). Sarkaria, N., dhe Campbell, G. International Family, Law and Practice Journal.
35. Praktika të dëmshme tradicionale: parandalimi, mbrojtja dhe policimi (2020). Campbell, G., Roberts, K.A., Sarkaria, N. Palgrave Macmillan.
36. Shënim udhëzues për integrimin gjinor të stafit të UNODC në punën e UNODC (2013). UNODC <https://www.unodc.org/documents/Gender/UNODC-GuidanceNote-GenderMainstreaming.pdf>
37. Studim Global mbi Vrasjen (2013). UNODC. [https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/statistics/GSH2013/2014\\_GLOBAL\\_HOMICIDE\\_BOOK\\_web.pdf](https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/statistics/GSH2013/2014_GLOBAL_HOMICIDE_BOOK_web.pdf)
38. Gratë dhe sistemi i drejtësisë penale (2011). Mahony, T.H., Jacob, J., dhe Hobson, H. për Qeverinë e Kanadasë. <https://www150.statcan.gc.ca/n1/en/pub/89-503-x/2015001/article/14785-eng.pdf?st=Nyr7c4ce>

39. Drejt Drejtësisë Penale përgjegjëse ndaj gjinisë: Praktika të mira nga Azia Juglindore në reagimin ndaj dhunës ndaj grave (2018). Skinnider, E. Instituti i Drejtësisë në Tajlandë. <https://icclr.org/wp-content/uploads/2019/06/Towards-Gender-Responsive-Criminal-Justice.pdf?x37853>
40. Studimi i Fizibilitetit për një Konventë kundër Dhunës në Familje (2008). Këshilli i Evropës, Komiteti i Ministrave, Takimi 1037, 8 tetor 2008 Komiteti Evropian për Problemet e Krimit.
41. Ndërthurje dhe përtej: Ligji, fuqia dhe politika e loka-cionit (2009). Redaktuar nga Grabham, E., Herman, D., Cooper, D., dhe Krishnadas, J., Routledge-Cavendish.
42. Gjykimi i përdhunimit. Të kuptuarit e Reagimit të Sistemit të Drejtësisë Penale ndaj Dhunës Seksuale në Tajlandë dhe Viet Nam (2017). UN Women, UNDP dhe UNODC. [https://www2.unwomen.org/-/media/field%20office%20easia/docs/publications/2019/08/ap-trial-of-rape\\_26aug2019\\_lowres-compressed.pdf?la=en&vs=1916](https://www2.unwomen.org/-/media/field%20office%20easia/docs/publications/2019/08/ap-trial-of-rape_26aug2019_lowres-compressed.pdf?la=en&vs=1916)
43. Manual mbi Ligjin në lidhje me Dhunën ndaj Grave në Angli dhe Uells, Greqi, Irlandë, Itali, Irlandë Veriore, Poloni, Spanjë (2018). Fondacioni Evropian i Juristëve dhe Bashkimi Evropian. <https://elf-fae.eu/wp-content/uploads/2018/06/Manual-on-the-law-relating-to-violence-against-women.pdf>
44. Masat e Hetimit, Mbrojtjes dhe Mbështetjes për Viktimat e DHBGJ (2019). Libri i Burimeve: Përvoja dhe Udhëzimet e Policisë Koreane. Qendra e UNDP për Politikën në Seul
45. Një përmbledhje e dëshmimeve mbi ndërhyrjet shumë-sektoriale për të zvogëluar dhunën kundër vajzave adoleshente (2013) "Blanc, AK, Melnikas, A., Chau, M., dhe Stoner, M. Qasje të integruara për përmirësimin e jetës së vajzave adoleshente, Seria e Punimeve: Girl Hub.
46. Të drejtat e viktimave për mbështetje dhe mbrojtje nga dhuna (2013). Legjislacioni për Mbrojtjen nga Dhuna në Austri (2019). Qendra për Ndërhyrje në Abuzimin Familjar dhe Shoqata e Strehëve Autonome të Grave Austriake. <https://www.interventionsstelle-wien.at/download/?id=692>







# PREZANTIMI

Policimi gjinor duhet të jetë i informuar rregullisht, i konsultuar gjerësisht dhe dinamik në ndërtimin e partneritetit. Themeli i tij është një kuptim institucional i natyrës së DHGV, shkaqeve dhe pasojave të saj dhe si ndikon kjo tek gratë dhe vajzat në mënyrë të ndryshme dhe në mënyrë jo proporcionale.

Foto me mirësjellje të Shoqatës Ndërkombëtare të Policisë së Grave (Bangladesh)

Nga ky kuptim, policimi i përgjegjshëm gjinor kthehet në kornizën e vet të parimeve dhe karakteristikave të përbashkëta (Figura 1) për të identifikuar rrugën drejt zotërimit të problemit të DHGV dhe nxitjen e zgjidhjeve për një përgjigje më efektive.

Duke pasur një themel të tillë dhe një kornizë shoqëruuese, policia do të jetë e pozicionuar mirë për t'u përgjigjur ndaj DHGV në drejtim të zbatimit të strategjive parandaluese dhe reagimit në mënyrë efektive dhe në kohën e duhur kur kjo të ndodhë.

Qëndrueshmëria e policimit të përgjegjshëm gjinor do të burojë nga aftësia e tij për të reflektuar dhe mësuar vazhdimisht nga mënyra se si po i përgjigjet sfidave aktuale dhe atyre në zhvillim.

Kapitujt e mëparshëm në Doracak janë fokusuar kryesisht në ofrimin e udhëzimeve për një qasje të policimit të përgjegjshëm gjinor ndaj DHGV. Ky kapitull do të jetë i ndryshëm në kuptimin që do të synojë të hulumtojë çështjet e reja të hetimit të DHGV dhe të ofrojë udhëzime se si policimi i përgjegjshëm gjinor mund të përshtatet për t'u përgjigjur në mënyrë efektive, si pjesë e një qasjeje të shumanshme me palët e tjera të interesit.

Megjithëse, ka shumë çështje të reja në temën e hetimit të DHGV, Doracaku do të përqëndrohet në tre prej tyre:

- Ngacmimi Seksual DHGV
- DHhKGV ose DHGV-LK të lidhura me konfliktin
- DHGV online dhe i lehtësuar nga TIK

Këta tre shembuj do të përdoren për të ilustruar se si udhëzimi i përgjegjshëm gjinor i dhënë në këtë Doracak është një referencë e përshtatshme për policinë që i përgjigjet një dhune të tillë.

1 Për qëllimet e këtij Doracaku, përgjigja ndaj VAWG për policinë përfshin si dimensionin e parandalimit ashtu edhe atë të reagimit.

Figura 1

**Korniza e Parimeve dhe Karakteristikat e Përbashkëta për Policimin Gjinator**

Parimet	një përjasje e bazuar në te drejtë	avancimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave	E ndjeshme nga ana kulturore dhe e përshtatshme për moshën
	Qasja me në qendër të viktimës/të mbijetuarit	siguria është parësore	përgjegjësia e autorit
Karakteristikat e përbashkëta	përgjegjësia e autorit vlefshmeri		aksesueshmërisë
	përshtatshmëria		përshtatshmërisë
	jepni prioritet sigurisë		miratim i informuar dhe konfidencialiteti
	mbledhjen e të dhënave dhe menaxhimin e informacionit		Komunikim efektiv
	lidhjen me sektorë dhe agjenci të tjera nëpërmjet referimit dhe koordinimit		

## NGACMIMI SEKSUAL SI NJË FORMË E DHGV

Ngacmimi seksual është një shprehje mbizhotëuese dhe e përhapur e DHGV, ajo pasqyron normat diskriminuese shoqërore, stereotipet, mosndëshkimin dhe pabarazinë gjinore me të cilat përballen gratë dhe vajzat. Kërcënimi i mundshëm i ngacmimit seksual ka një ndikim të rëndësishëm në vendimet e marra nga gratë dhe vajzat në baza ditore, të tilla si cilin transport publik duhet marrë në cilat profesione për të investuar talentin e tyre njerëzor. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për profesionet e mbizotëruara nga meshkujt që ofrojnë shërbime për publikun, siç është policia, e cila, pavarësisht nga kuptimi i përfitimeve nga të pasurit anëtare femra brenda organizatës së tyre, përpiqet t'u garantojë atyre mjedise pune pa ngacmime. Kjo ka një ndikim në numrin e grave dhe vajzave që aspirojnë të bëhen police ose të qëndrojnë në organizatë si një zgjedhje karriere. Në skenarë të tjerë, ngacmimi seksual mund të sigurojë një arsye për t'i mbajtur gratë dhe vajzat e reja në shtëpi ose për t'i nxjerrë jashtë shkollës.

Ngacmimi seksual është shumë pak i raportuar, edhe kur ndodh brenda organizatave policore, arsyet e mos raportimit do të ndryshojnë. Për shembull, një studim i përbashkët i OKB-së për gratë dhe Bashkimin Evropian mbi ngacmimin seksual në Egjipt dokumentoi arsyet më të zakonshme që gratë dhe vajzat nuk raportojnë në

policia kur ndodh ngacmimi seksual (figura 2).<sup>2</sup> Arsyja më e cituar është se ndodhja e ngacmimit seksual është normalizuar mjaftueshëm për t'i ndodhur kujtdo.


Perceptimi se një dhunë e tillë normalizohet në një shoqëri të caktuar kërkon një përgjigje proporcionale nga policia dhe autoritetet e tjera. Sidoqoftë, çdo iniciativë për rritjen e raportimit të ngacmimit seksual dhe strategjitë për ta trajtuar atë duhet të informohen mirë me konsultime të gjera me publikun e gjerë dhe brenda vetë organizatës policore për të siguruar efikasitetin dhe efektivitetin e përpjekjeve. Shoqatat e grave policore siç janë ato të krijuara në Kosovë, Bangladesh, Ekuador dhe Ganë mund të jenë burime të vlefshme konsultimi për përmirësimin e përgjigjeve ndaj ngacmimeve seksuale (shih rastin studimor në Kapitullin 10 mbi mënyrën sesi *shoqatat/rrjetet policore të grave mund të mbështesin zbatimin e ndjeshmërisë ndaj gjinisë dhe Policimit gjinator të përgjegjshëm*).

Konsultimi i jashtëm duhet t'i japë përparësi njerëzve dhe/ose grupeve që konsiderohen të cenueshëm dhe/ose pakicë në shoqëri për të kuptuar nevojat e tyre specifike të sigurisë. Për shembull, njerëzit me aftësi të kufizuara kanë më shumë gjasa të përjetojnë të gjitha

2 Studim mbi Mënyrat dhe Metodën për Eliminimin e Ngacmimit Seksual në Egjipt Rezultatet / Rezultatet dhe Rekomandimet Përmbledhje (UN Women dhe Bashkimi Evropian), në dispozicion në: [https://web.law.columbia.edu/sites/default/files/microsites/gender-sexuality/un\\_womensexual-harassment-study-egypt-final-en](https://web.law.columbia.edu/sites/default/files/microsites/gender-sexuality/un_womensexual-harassment-study-egypt-final-en)

Figura 2

Arsyet për mos raportimin e ngacmimit seksual në Egjipt tek policia (Studimi i Grave të OKB-së)



format e ngacmimit dhe sulmit seksual sesa njerëzit pa aftësi të kufizuara. Në një sondazh nacional të kryer në 2018 në SHBA, gjetjet treguan se 87% e grave me aftësi të kufizuara të anketuara ishin subjekt i ngacmimit seksual (verbal, online, i lehtësuar nga TIK dhe fizik) krahasuar me 66% të grave të anketuara pa aftësi të kufizuara.<sup>3</sup> Nga i njëjti grup, 66% e grave me aftësi të kufizuara të anketuara i ishin nënshtruar ngacmimit seksual agresiv fizik<sup>4</sup> në 57% të grave të anketuara pa aftësi të kufizuara.

3 Matja e #MeToo: Një studim nacional mbi ngacmimet dhe sulmet seksuale (2019). Qendra UC San Diego për Barazinë Gjinore dhe Shëndetin.


4 Studimi përcaktoi ngacmimin fizik agresiv seksual si një person që ekspozonte organet gjenitale pa lejen e personit tjetër, ndiqte fizikisht dikë pa lejen e tij dhe ose prekte ose godiste me qëllim dikë në një mënyrë seksuale të padëshiruar. Matja e #MeToo: Një studim nacional mbi ngacmimet dhe sulmet seksuale (2019). Qendra UC San Diego për Barazinë Gjinore dhe Shëndetin.

Për më tepër, studimi raportoi se ngacmimi seksual në një vendbanim privat dhe ngacmimi në internet kishin shumë më shumë gjasa tek gratë me aftësi të kufizuara kundrejt atyre pa aftësi të kufizuara.

Kuptimi i shtrirjes dhe ndikimit të ngacmimit seksual në format e tij verbale dhe fizike është pjesë e zgjidhjes. Përgjigja efektive ndaj ngacmimeve seksuale do të thotë gjithashtu të kuptuarit se cilat ligje kërkojnë zbatimin si dhe fushëveprimin e tyre. Për shembull, në disa vende, ngacmimi nuk kriminalizohet, në të tjerat kërkohet prania e dëshmitarëve për të filluar një hetim ose regjistrimi zyrtar i incidentit duhet të bëhet në një stacion policor. Të tre këta shembuj në fakt e bëjnë të vështirë për viktimën/të mbijetuarin e ngacmimit të vërtetojë se akti (et) ka ndodhur dhe të kërkojë mbrojtje në formën e urdhrave kufizues ose ndalues.

Nga ana tjetër, në disa sisteme ligjore ngacmimi seksual është një formë diskriminimi e bazuar në seks dhe është e paligjshme. Në disa sisteme, ngacmimi seksual trajtohet gjithashtu në ligjet e punës duke u fokusuar në mjediset e punës, të cilat shpesh kërkojnë nga njësitë private dhe publike të zhvillojnë politika të brendshme për “Zero Tolerancë” me mekanizma ankesash dhe masa të mundshme për mjetet juridike. Zhvillimi i politikave të tilla janë pikat kryesore të hyrjes për policinë për të bashkëpunuar në partneritetet publike-private që do të shërbenin për të dekurajuar dhe dënuar kolektivisht aktet e ngacmimit seksual.

Ndryshimet në qëndrimet kulturore ndaj ngacmimit seksual mund të jenë në fund të fundit mjeti më i vlefshëm në luftimin e kësaj forme të DHGV duke krijuar një ndjenjë të përbashkët të përgjegjësisë dhe përgjegjësisë publike-private. Kërkimi i partneriteteve me aktorët privatë për të dekurajuar ngacmimin seksual do t'i japë policisë një shtrirje më të madhe kur t'i përgjigjet atij dhe në proces potencialisht të identifikojë sjelljet që janë tregues të formave më të dhunshme të DHGV me qëllim parandalimin e përshkallëzimit të dhunës.<sup>5</sup>



## UDHËZIM NGA KOLEGËT6

Në rastet e përndjekjes dhe/ose ngacmimit përparësia juaj dhe stafit tuaj duhet të jetë ajo e sigurisë dhe mbrojtjes me fokus në vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut. Në rastet e përndjekjes është veçanërisht e rëndësishme që vlerësimi i rrezikut të jetë një proces i vazhdueshëm, duke qenë të vetdijshëm se një përshkallëzim i sjelljes mund të ndodhë në çdo kohë. Parandalimi i çdo përshkallëzimi kërkon gjithashtu një ndërhyrje të hershme.

Ashtu si me të gjitha krimet e DHGV, është e rëndësishme që të “Dëgjoni në mënyrë aktive” viktimën/ të mbijetuarën, për të kuptuar kontekstin e sjelljes së

<sup>5</sup> Po aty.

<sup>6</sup> Frymëzuar nga Kolegji Britanik i Praktikës së Autorizuar Profesionale të Policimit, shih: <https://www.app.college.police.uk/app-content/major-investigation-and-public-protection/stalking-or-harassment/>

autorit të supozuar dhe ndikimin që ka tek ajo. Të gjitha rastet e përndjekjes kërkojnë menaxhim të fortë të rrezikut pasi sjellje të tilla mund të jenë tregues të një rreziku më të lartë të dëmit i cili mund të përshkallëzohet në çdo kohë.

**Informacione të mëtejshme mbi vlerësimin e rrezikut dhe planifikimin e sigurisë mund të gjenden në Kapitullin 6 të Doracakut: “Siguria dhe Mbrojtja”, duke përfshirë një listë kontrolli të rrezikut.**

**“Unë i vlerësoj pikëpamjet dhe opinionet e secilit duke dëgjuar në mënyrë aktive për të kuptuar perspektivën e tyre.”**

—A behaviour reflecting the value of police integrity (UK College of Policing, 2016)

Stafi juaj duhet të identifikojë nëse aktet përbëjnë përndjekje ose ngacmim, p.sh., përndjekja tenton të përqëndrohet tek një individ ndërsa ngacmimi mund të përfshijë mosmarrëveshje midis palëve.

Një udhëzues i dobishëm nga Kolegji Britanik i Praktikës Profesionale të Autorizuar të Policimit është riprodhuar më poshtë (Kutia 1):

Një mënyrë e dobishme për stafin tuaj për të shqyrtuar nëse sjellja përbën përndjekje mund të arrihet përmes metodis Mnemonik **KATËR**. Sjelljet janë:

- Fikse
- Obsesive
- Të padëshiruara
- Të përsëritura

Ju dhe stafi juaj duhet të siguroheni që ata të marrin sa më shumë informacione nga viktimat/i mbijetuarit, i cili, siç përshkruhet diku tjetër në Doracak, kërkon durim, ndjeshmëri dhe aftësi dëgjimi aktiv. Ashtu si me krimet e tjera të DHGV, ju mund të keni nevojë të shpenzoni kohë për ndërtimin e besimit dhe raportit me viktimën/ të mbijetuarin dhe çdo ndikim i traumës që ata mund të shfaqin duhet kuptuar dhe trajtuar brenda kontaktit fillestar. Është e rëndësishme që ju të jeni në gjendje



## Kutia 1

Përndjekje	Ngacmimi
<p><b>Konsiderata të dyshimta</b></p> <p>Katër sjellje kryesore të përndjekjes: Fikse, Obsesive, të Padëshiruara, të Përsëritur?</p> <p>A ka ndryshuar i dyshuari rutinat e tyre për të lehtësuar ndjekjen e tyre?</p> <p>A janë ata të preokupuar me viktimën në mendimet dhe veprimet e tyre?</p> <p>A është sasia e kohës/përpjekjeve/burimeve që po investon i dyshuari duke konsumuar jetën e tyre të përditshme?</p> <p>A ka një sërë sjelljesh që synojnë viktimën?</p> <p>A duket i dyshuari nuk ka gjasa të ndalojë sjelljet?</p> <p>A duket i dyshuari se ka një ndjenjë të fortë të së drejtës/përcaktimit?</p> <p>I dyshuari nuk e vret mendjen për shqetësimin që sjellja e tyre po shkakton.</p> <p><b>Konsideratat e viktimës</b></p> <p>A ndihet viktimja e ndikuar nga sjellja në aspektin fizik/emocional dhe/ose psikologjik?</p> <p>A ka viktimja një frikë të vazhdueshme nga ajo që mund të ndodhë?</p> <p>A ndërhyjnë sjellja në jetën e viktimës?</p> <p>A ka pasur sjellja ndonjë efekt serioz në aktivitetet e përditshme të viktimës?</p>	<p><b>Konsiderata të dyshimta</b></p> <p>A ka dëshmi të sjelljes së përsëritur që është e paarsyeshme por jo e fiksuar tek viktimja?</p> <p>A është sjellja e të dyshuarit, edhe pse e përsëritur, jo konsumuese jetën e tyre të përditshme?</p> <p>A është sjellja përgjithësisht e fokusuar në adresimin e një mosmarrëveshjeje (financiare, fqinjësore, punësimi, etj.) në vend që të synohet tek një individ?</p> <p>A do të vazhdojmë gjasë sjellja e të dyshuarit nëse problemi i cekur vazhdon, por individ i ndaluar në fjalë është më ndryshe?</p> <p>A ka ndonjë dëshmi se kjo sjellje do të ndalet nëse problemi themelor të zgjidhet?</p> <p><b>Konsideratat e viktimës</b></p> <p>A ndihet viktimja e shtypur por nuk alarmohet apo shqetësohet seriozisht nga sjellja?</p> <p>A është viktimja e frikësuar për akte të caktuara, por jo në një gjendje të vazhdueshme frike?</p>

të kuptoni sjelljen për të cilën është bërë një ankesë në terma të gjerë dhe të mos përqendroheni vetëm në një incident të vetëm.

Informacioni i historikut është i rëndësishëm në rastet e përndjekjes si p.sh:

- Çfarë ka ndodhur më parë, përfshirë edhe ndaj individëve të tjerë siç janë anëtarët e familjes?
- A ka pasur ndonjë përshkallëzim në sjelljen e autorëve të dyshuar deri më sot?

Mos harroni të kontrolloni burimet e tjera të informacionit, të tilla si familja, miqtë, kolegët e punës dhe mediat sociale, të gjitha këto mund të jenë të dobishme

në sigurimin e informacionit të mëparshëm, si dhe dëshmive përkatëse për hetimin.

Një burim tjetër i dobishëm nga Kolegji i Policimit në Mbretërinë e Bashkuar është *Lista e Kontrollit të Linjave të Hetimeve*<sup>7</sup> (shih Kutinë 2) të cilat ofrojnë udhëzime të dobishme në rastet e përndjekjes dhe ngacmimit seksual për policinë për të eksploruar në mënyrë të kuptueshme historinë e abuzimit. Sipas Kolegjit të Policimit në Mbretërinë e Bashkuar, modelet e abuzimit nuk janë gjithmonë të dukshme sepse incidentet e ndjekura në të kaluarën mund të jenë regjistruar vetëm si verbale ose të konsideruara ndryshe të parëndësishme. Si rezultat, oficerët që përgjigjen duhet të marrin sa më shumë

<sup>7</sup> Hetimi i madh dhe mbrojtja e publikut: Zhvillimi Investigativ-Linjat e Hetimit. Kolegji i Policisë në Mbretërinë e Bashkuar.

## Kutia 2

### Lista kontrolluese: Linjat e hetimit

Oficerët duhet të marrin parasysh këto linja të mundshme hetimi:

- Historitë e marrëdhënies (nëse ka);
- Incidentet e mëparshme të abuzimit, përfshirë ato me partnerë të mëparshëm, p.sh. regjistrimet e thirrjeve të mëparshme në polici;
- Sistemet e inteligjencës policore lokale, sistemet kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Kontrollat e dënimeve penale kombëtare të huaja nëse i dyshuari, viktimat ose dëshmitari është shtetas i huaj;
- Dëshmitarët të cilëve mund t'u jetë bërë zbulimi i parë;
- Informacioni mjekësor ose psikologjik që mund të përbëjë dëshmi - pëlqimi duhet të merret aty ku është e rëndësishme;
- Dëshmitë e mbajtura nga çdo burim i të dhënave për viktimat e mëparshme;
- Regjistrimet e telefonit dhe emailit;
- Mediet sociale.

Burimi: Frymëzuar nga Kolegji i Policimit në Mbretërinë e Bashkuar i [Lines of Enquiry Checklist](#)

informacion të detajuar që të jetë e mundur për të kuptuar kontekstin dhe për të identifikuar shenjat e sjelljes shtrënguese, kontrolluese ose kërcënuese. Për më tepër, eksplorimi i historisë dhe përfundimi i vlerësimeve të rrezikut mund të çojë në zbulimin e abuzimeve ose të veprave seksuale të mëparshme.<sup>8</sup>

Çdo çështje e shëndetit mendor që identifikohet nëse ka të bëjë me autorin e dyshuar ose viktimën/të mbijetuarin, duhet të informojë procesin e vlerësimit të rrezikut dhe planin pasues të sigurisë, por nuk duhet të lejohet të pengojë hetimin. Viktima/i mbijetuarit mund të vuajë nga probleme të shëndetit mendor si rezultat i sjelljes së përndjekur ose mund të jenë shënjestruar për shkak të cenueshmërisë së tyre shtesë. Në secilin rast, duhet të siguroheni që ofrohet mbështetja e duhur për nevojat e tyre specifike gjatë gjithë hetimit.

Si në të gjitha rastet e DHGV, procesi i vlerësimit të rrezikut duhet të çojë në krijimin e një plani sigurie me përfshirjen e viktimës/të mbijetuarit të jetë një komponent thelbësor i zhvillimit të tij. Çdo përgjigje mbrojtëse duhet të jetë proporcionale me çdo rrezik të identifikuar. Ju dhe stafi juaj jeni përgjegjës për ndërmarrjen

<sup>8</sup> Po aty.

e veprimeve pozitive për të ruajtur sigurinë e viktimës/të mbijetuarit.

Rrethanat e secilës viktimë/të mbijetuar do të jenë unike për ta dhe kjo mund të rezultojë që ata të mos ndjekin gjithmonë këshillat tuaja të sigurisë. Kjo nuk do të thotë se ajo nuk po bashkëpunon dhe ju ose stafi juaj nuk duhet ta gjykoni atë për këtë. Ajo mund të besojë se, për ta mbajtur veten të sigurt, duhet të sillet në një mënyrë të caktuar. Kjo është një arsye tjetër pse është e rëndësishme të bëni një vlerësim të plotë të rrezikut me të dhe të bini dakord për një plan sigurie që plotëson nevojat e saj specifike.

Kolegji i Policimit në Mbretërinë e Bashkuar ofron disa udhëzime të dobishme për mbrojtjen e konsideratave nga të cilat lista e mëposhtme është përshtatur:<sup>9</sup>

- Arrestimi dhe paraburgimi ose kushtet e duhura me kusht;
- Telefoni mobil (celular) i urgjencës;
- Njoftoni miqtë, familjen, punëdhënësit për rreziqet;

<sup>9</sup> Përndjekja ose ngacmimi (2019). Kolegji i Policimit në Mbretërinë e Bashkuar

- Alarmi i panikut nëse është i disponueshëm;
- Nëse është e nevojshme të konfiskoni telefonin celular të viktimës për qëllime dëshmuese, kini parasysh zëvendësimin e pajisjes së tyre me një tjetër;
- Referim në shërbime të tjera mbështetëse;
- Përdorimin e urdhrave të mbrojtjes aty ku është e mundur;

Këshilla që mund t'i jepen viktimës/të mbijetuarit:

- Njoftoni miqtë, familjen, punëdhënësit për rreziqet;
- Përdorimi i televizorit me qark të ngushtë (CCTV) aty ku është i qasshëm dhe i përshtatshëm;
- Alarm sulmi personal;
- Ndryshimi i kohës/rrugëve për në punë, qendrat sociale ose arsimore.

Është shumë e zakonshme që sjelljet online të kryerësit të veprës penale të jenë të lidhura me rastet e përndjekjes dhe ngacmimit dhe kështu është e dobishme që viktimës/të mbijetuarit t'i jepni këshilla dixhitale. Teksti në vijim është përshtatur përsëri nga Kolegji i Policimit në Mbretërinë e Bashkuar:

- Kontrolloni për spyware, aplikacione malware ose pajisje përcjellëse;
- Siguroni ose rregulloni cilësimet e privatësisë;

- Mbani informacionin e ndarë të sigurt, mos zbuloni adresën, numrin e telefonit etj. dhe kërkoni nga miqtë që të mos i publikojnë të dhënat e tilla;
- Mos zbuloni informacione për të cilat nuk doni që autori i dyshuar të ketë dijeni, p.sh. marrëdhënie e reja, punën, etj.;

Ashtu si me të gjitha llojet e DHGV, stafi juaj në asnjë mënyrë nuk duhet ta bëjë viktimën/të mbijetuarin të ndiejë se është fajtorë.

Ju gjithashtu duhet të siguroheni që stafi juaj, veçanërisht marrësit e thirrjeve dhe ata që punojnë në zyrën e pranimit të palëve në stacionin policor, të dinë se çfarë kërkohet prej tyre kur një viktimë/i mbijetuar raporton një rast përndjekjeje ose ngacmimi, në mënyrë që ata t'i japin oficerit që përgjigjet me aq informacion sa e mundshme. Është poashtu e rëndësishme të sigurohet që çdo regjistër incidenti, i shkruar ose elektronik, të mos mbyllet ose regjistrohet para se të jetë bërë kontakti me viktimën/të mbijetuarin dhe të jetë kryer një vlerësim i rrezikut.

Prioriteti i çdo stafi që ka kontaktin e parë me viktimën/të mbijetuarin është të vlerësojë natyrën e saktë të incidentit (ave)/kriminalit (ve), cënueshmërinë e viktimës/të mbijetuarit dhe atë që kërkohet për një reagim dhe menaxhim efektiv të çdo rreziku të identifikuar.

Në Kutinë 3, Kolegji i Policimit në Mbretërinë e Bashkuar ofron një listë të dobishme të pyetjeve fillestare të kontrollit për identifikimin e përndjekjes:

### Kutia 3

#### Mbledhja e Informacionit nga Personi që Raporton

Në rastet e përndjekjes ekziston një model i sjelljes së padëshiruar, të fiksuar dhe obsesive e cila është ndërhyrës. Ngacmimi mund të jetë përndjekje dhe përndjekja mund të shkaktojë frikë nga dhuna ose alarm serioz ose shqetësim. Ngacmimi përshkruhet si një sjellje e paarsyeshme dhe shtypëse që përsëritet dhe mund të shkaktojë alarm ose shqetësim ose frikë nga dhuna të viktimës/i mbijetuarit.

- A është viktimë/i mbijetuarit i frikësuar?
- A është i angazhuar autori(ët) i/e dyshuar në ngacmime /përndjekje në raste të mëparshme ose me këtë viktimë /të mbijetuar ose të tjerë?
- A i ka shkatërruar apo dëmtuar ndonjëherë autorët e dyshuar ndonjë pronë të viktimës/të mbijetuarit?
- A e viziton autori (ët) e dyshuar viktimën/të mbijetuarin në punë, shtëpi, etj., Më shumë se 3 herë në javë? (Hulumtimet kanë identifikuar se nëse më shumë se 3 herë në javë ka më shumë gjasa një sulm fizik)<sup>10</sup>

<sup>10</sup> Po aty.

- A posedon autori (ët) i/e dyshuar ose ka/kanë qasje në armë zjarri ose armë të tjera?
- A është sjellur autori (ët) i/e dyshuar rreth shtëpisë, vendit të punës të viktimës/të mbijetuarit etj?
- A ka/kanë kryer autori(ët) i/e dyshuar dhunë fizike ose seksuale në incidentet aktuale të ngacmimit/përndjekjes?
- A ka/kanë kryer autori(ët) i/e dyshuar kërcënime me armë zjarri ose armë të tjera?
- A e ka/kanë përfshirë ose sulmuar autori(ët) i/e dyshuar ndonjë palë të tretë që nga fillimi i ngacmimit/përndjekjes? (p.sh. miqtë, familjen, fëmijët, kolegët, partnerët ose fqinjët)
- A i ka/kanë bindur autori(ët) i/e dyshuar të tjerët që ta ndihmojnë atë me vetëdije ose ndryshe?
- A dihet nëse autori (ët) i/e dyshuar abuzon me drogë dhe/ose alkool?
- A dihet nëse autori(ët) i/e dyshuar ka qenë abuzues në të kaluarën (fizike ose psikologjike)?

Burimi: Frymëzuar nga [Stalking or Harassment](#) (2019). Kolegji i Policisë në Mbretërinë e Bashkuar.

## NGACMIMI SEKSUAL

Ngacmimi seksual merr shumë forma dhe mund të kryhet në vende publike, hapësira pune dhe online, megjithëse interneti gjithashtu mund të konsiderohet si një vend publik dhe privat. Sipas hulumtimit, ngacmimi seksual është forma më e zakonshme e DHGV.<sup>11</sup> Në disa vende, ka ligje specifike që e bëjnë ngacmimin seksual një vepër penale, p.sh., Portugalia (2015), Franca (2018) dhe Egjipti (2014). Një studim i UN Women në Egjipt zbuloi se 96.5% e grave raportuan se kishin përjetuar ngacmim seksual verbal. Një fakt shqetësues i gjetur nga i njëjti studim ishte se të anketuarit pohuan se 16.9 % e autorëve ishin oficerë policie<sup>12</sup>.

Ndonëse në Mbretërinë e Bashkuar nuk ka një legjislacion penal specifik në lidhje me ngacmimin seksual, ekzistojnë disa shembuj pozitivë të punës për të përfshirë Misogjininë si një “Krim i urrejtjes”. Policia e Nottinghamshire ofron një studim të praktikës së mirë për këtë nismë pozitive, duke përshkruar përkufizimin e tyre të Misogjinisë si, “incidente kundër grave të motivuara nga qëndrimet e burrave ndaj grave dhe përfshin sjelljen e drejtuar grave nga burrat thjesht sepse ato janë gra”. Ky pozicion i marrë nga Policia e Nottinghamshire u vlerësua brenda një raporti të vitit

2018 nga Universiteti Nottingham Trent dhe Universiteti i Nottinghamit.<sup>13</sup>

**Për më shumë informacione shikoni studimin e rastit Policia e Nottinghamshire që Trajton Sjelljen e Dhunshme ndaj Grave si Krime të Urrejtjes në Kapitullin 9: ‘Komunikimi’.**

Ngacmimi seksual mund të përfundojë në forma të tjera të krimeve seksuale siç është sulmi seksual, por sjellja që nuk përbën një krim nuk do të thotë se është më pak e dëmshme për viktimën/të mbijetuarën. Ngacmimi seksual shpesh përjetohet që në moshë të re, gjë që krijon rrezikun që të ‘normalizohet’, gjithashtu ndikon në pikëpamjet e djemve dhe vajzave se cila sjellje është e pranueshme. Kjo mund të rezultojë që gratë të kufizojnë lirinë e tyre në hapësirat publike dhe të besojnë se kanë përgjegjësinë për të shmangur situatat ‘e rrezikshme’.<sup>14</sup>

Ngacmimi Seksual gjithashtu mund të ndërthuret me forma të tjera të abuzimit si ngacmimi i lidhur me aftësinë e kufizuar dhe ngacmimi seksual i motivuar nga raca.<sup>15</sup> Për shembull, një grua me ngjyrë mund të përjetojë ngacmime ndryshe nga një femër e bardhë,

11 Agjencia Evropiane për të Drejtat Themelore (2015), Dhuna kundër Grave: Një studim i gjerë në BE.

12 Studimi i Grave të OKB-së (pa datë) mbi mënyrat dhe metodat për të eliminuar ngacmimet seksuale në Egjipt: Përmbledhje e Rezultateve dhe Rekomandimeve.

13 Raporti i Vlerësimit të Krimit të Urrejtjes nga Misogjia për Qendrën e Grave në Nottingham e financuar nga Zyra e Policisë dhe Komisarit të Krimit në Nottinghamshire, Mullany, L. dhe Trickett, L. Qershor 2018

14 Komiteti i shoqatës së Grave dhe Barazive i (MB), (2018) Ngacmimi seksual i grave dhe vajzave në hapësirat publike: Raporti i 6-të i sesionit 2017-2019.

15 Po aty.

#### Kutia 4

### Njihni të drejtat tuaja në punë: Ngacmimi seksual

Shembuj të sjelljes që mund të konsiderohen si ngacmime përfshijnë, por nuk kufizohen, në:

- Bërja e kërkesave të padëshiruara për favore ose takime seksuale;
- Bërja e komenteve të papërshtatshme për trupin ose pamjen e dikujt;
- T'i thuash gjëra të këqija ose ta tallësh dikë ose të gjithë njerëzit e një gjinie ose orientimi seksual të caktuar (p.sh. 'gratë janë ...' ose 'të gjithë homoseksualët...');
- Përdorimi i sharjeve me bazë gjinore ose orientimit seksual (fjalë sharëse);
- Bërja e shakave vulgare, ofenduese ose eksplicite për seksin ose aktet seksuale;
- Dërgimi ose shkëmbimi i email-eve, teksteve ose mesazheve të një natyre seksuale që thashethemet për marrëdhëniet personale ose jetën seksuale të dikujt;
- Prekje e padëshiruar ose e papërshtatshme e ndonjë pjese të trupit, veshjeve, fytyrës ose flokëve, përfshirë përqafimin, puthjen ose sulmin;
- Ngulitja, shikimi provokues ose bërja e gjesteve të një natyre seksuale duke bllokuar lëvizjen e dikujt;
- Shfaqja, dërgimi ose ndarja e fotografive vulgare ose pornografisë.

Burimi: [Equal Rights Advocates](#)

ajo mund të jetë në shënjestër për shkak të kombinimit të seksit të saj dhe racës ose etnisë së saj.<sup>16</sup>

Promundo është një organizatë globale që punon rreth maskulinitetit dhe barazisë gjinore, dhe në vitin 2016 botoi një studim të titulluar «*Demaskimi i Ngacmimit Seksual*» duke u përqëndruar në pikëpamjet e të rinjve mbi burrërinë në SHBA, MB dhe Meksikë. Nga pjesëmarrësit e anketuar, studimi zbuloi se ngacmimi seksual fillon në moshë të re dhe merr forma

<sup>16</sup> Mbrojtësit e të drejtave të barabarta (2019) Njihni të drejtat tuaja në punë: Ngacmimi seksual.

të ndryshme. Studimi gjithashtu zbuloi se autorët e ngacmimit seksual vijnë nga të gjitha prejardhjet, nivelet e të ardhurave, prejardhjet arsimore dhe të gjitha moshat. Ndikimi më i madh në sjelljen e tyre janë qëndrimet e tyre për atë që do të thotë të jesh burrë.<sup>17</sup>

Ngacmimi seksual në vendet publike, si format e tjera të DHGV, po evoluon pasi teknologjitë dhe platformat online lehtësojnë format e reja të ngacmimit dhe mënyrat e kryerjes së tij. Shembuj të ngacmimeve në internet dhe të lehtësuara nga TIK-u përfshijnë shikimin e pornografisë në telefonat inteligjentë në vende publike dhe “ngritjen”, e cila përfshin marrjen e fotografive ose videove në fund të dikujt pa pëlqimin e tyre. Ngacmimi është shpesh i përhapur në sistemet e ngarkuara të transportit publik, veçanërisht gjatë kohës së pikut të udhëtimit, kur njerëzit shpesh janë në afërsi shumë të madhe në hapësira të mbushura me njerëz. Shpesh gratë mund të mos e dinë se kush i ka shkelur të drejtat e tyre në këtë mënyrë, dhe/ose mund të mos jenë në gjendje të reagojnë për shkak të ‘bllokimit’ dhe si format



<sup>17</sup> [Unmasking Sexual Harassment How Toxic Masculinities Drive Men's Abuse in the US, UK, and Mexico and What We Can Do to End It: Një përmbledhje kërkimore e Promundo e prodhuar për Takimin Vjetor të Forumit Ekonomik Botëror 2018. Promundo.](#)

e tjera të DHGV, incidente të tilla nuk raportohen në masë të konsiderueshme.

Si pjesë e rishikimit nga Komiteti i Shoqatës së Grave dhe Barazive në Mbretërinë e Bashkuar 2018, “*Ngacmimi seksual i grave dhe vajzave në hapësirat publike*”, mediat sociale u përshkruan si një “vend publik”.<sup>18</sup> Hulumtimi i kryer nga Amnesty International (2017) zbuloi se 1 në 5 gra kishin përjetuar abuzim ose ngacmim përmes mediave sociale me gratë e reja midis moshës 18 dhe 24 vjeç që ishin veçanërisht të prekura.<sup>19</sup>

Ngacmimi seksual është gjithashtu një problem brenda institucioneve arsimore dhe mund të rezultojë në efekte afatgjata, veçanërisht gjatë viteve të hershme formuese. Gratë që përjetojnë ngacmime seksuale në Universitete ka të ngjarë të jetojnë dhe/ose studiojnë në afërsi të dhunuesit.<sup>20</sup>

Në vitin 2019, një studim i kryer në Indonezi për Koalicinin për Hapësirë Publike të Sigurt (KHPS)<sup>21</sup> u zbulua se 3 nga 5 gra përjetuan ngacmime seksuale në hapësirat publike, format e ngacmimit që ndryshonin nga ato verbale, fizike dhe jo-fizike duke përfshirë:

- fishkëllima,
- imitim tinguj puthjesh,
- shaka të ndyra ose vërejtje seksuale për trupin ose rrobat,
- kapje,
- fërkim,
- ekspozim i pjesëve intime.

18 Komiteti i Shoqatës së Grave dhe Barazive (MB), (2018) Ngacmimi seksual i grave dhe vajzave në hapësirat publike: Raporti i 6 -të i sesionit 2017-2019.

19 Amnesty zbulon ndikimin alarmant të abuzimit në internet kundër grave. Amnesty International.

20 ‘Spotted: Detyrimet për të mbrojtur sigurinë dhe barazinë e studenteve gra duke përdorur obligimin e barazisë në sektorin publik dhe aktin e të drejtave të njeriut në institucionet e arsimit të lartë dhe të mëtejshëm për të përmirësuar politikën dhe praktikën mbi dhunën kundër grave dhe vajzave, Prezantim Ligjor i përgatitur nga Louise Whitfield dhe Holly Dustin Koalicioni Për Fundin e Dhunës Kundër Grave Janar 2015.

21 Widadio, N. A. (2019) Shumë gra indoneziane përballen me ngacmim seksual: Anketa, Koalicioni për Hapësirë Publike të Sigurt.

Si një zgjidhje afatshkurtër, qeveria e Xhakarta filloi të përdorë karroca vetëm për gra për Trans Jakarta dhe Linjat e udhëtarëve si një masë parandaluese.

Ngacmimi seksual brenda vendit të punës është gjithashtu një çështje globale dhe organizatat e Policisë dhe Zbatimit të Ligjit nuk ndryshojnë nga çdo mjedis tjetër pune kur bëhet fjalë për këtë lloj DHGV. Në fakt, mund të argumentohet se për shkak se është një kulturë e dominuar nga burrat dhe hierarkike, gratë që punojnë brenda mjediseve të policisë dhe zbatimit të ligjit janë më të rrezikuara nga ngacmimet seksuale.

Si drejtues policie, ju duhet të siguroheni që stafi juaj të kuptojë se ngacmimi seksual nuk do të tolerohet dhe aty ku ndodh ju duhet të ndërhyni menjëherë për të parandaluar përshkallëzimin dhe për të dërguar një mesazh të fortë se një sjellje e tillë do të trajtohet në mënyrë të fuqishme.

A i keni paraqitur stafit tuaj pritshmëritë tuaja për sjelljen e tyre ndaj kolegëve, që ata duhet t’i trajtojnë të gjithë me respekt dhe dinjitet? Nëse organizata juaj ka një kod etike që udhëzon sjelljen, sjelljen, veprimet dhe vendimmarrjen, ju duhet të siguroheni që të gjithë janë të vetëdijshëm për përmbajtjen e tij dhe t’i mbani individët përgjegjës për përputhshmëri.

A ka organizata juaj një politikë kundër ngacmimit? Nëse është kështu, a është:

- E qasshme dhe e dukshme për të gjithë stafin?
- A kuptohet lehtë?
- Sa është efektive?

A ka organizata juaj një procedurë Ankesash për raportimin e ngacmimeve seksuale ose formave tjera të ngacmimit?

- A është e qasshme për të gjithë stafin?
- A siguron raportim konfidencial?
- Sa është efektive?

Politika dhe procedura të tilla duhet të rishikohen rregullisht, dhe është praktikë e mirë përfshirja e anëtarëve të stafit nga prejardhje të ndryshme dhe/ose me nevoja të ndryshme në procesin e rishikimit.<sup>22</sup>

Është e rëndësishme që ju të kuptoni se shakatë ose talljet për gratë, LGBTQI, personat me aftësi të kufizuara dhe grupet e tjera mund të jenë po aq të dëmshme për mjedisin tuaj të punës sa sjelljet fizike ose të seksualizuara.<sup>23</sup>

Një organizatë policore me përgjegjësi gjinore është ajo që i përgjigjet komuniteteve, të jashtme dhe të brendshme në një mënyrë të ndjeshme ndaj gjinisë. Fatkeqësisht, realiteti është se disa institucione, siç është policia në të vërtetë 'kolegët e punës' në disa raste bëjnë përpjekje të mëdha për të fajësuar viktimën/të mbijetuarin. Kjo mund të krijojë një mjedis armiqësor të punës duke dëmtuar ekipin dhe performancën individuale, duke rritur të keqen, gjë që përfundimisht rezulton në ofrimin e shërbimeve policore më pak efektive për komunitetet lokale.

Hulumtimi gjatë shumë viteve ka gjetur se viktimat/të mbijetuarit e ngacmimit seksual vuajnë nga një sërë problemesh, duke përfshirë ankthin, depresionin, çrregullimet e të ngrënit, abuzimin me drogën dhe alkoolin, qarkullimin e punës dhe stresin post-traumatik.<sup>24</sup>

Një qasje e zakonshme e njohur ndërkombëtarisht për parandalimin e ngacmimeve seksuale dhe formave të tjera është përmes edukimit dhe ngritjes së vetëdijes, veçanërisht kur synohet të meshkujt dhe djemtë. Trajnimi i ndërhyrjes së shikuesve po kuptohet gjerësisht si një formë efektive e ndërgjegjësimit dhe rritjes së llogaridhënies. Kalimtarët, përfshirë punonjësit, kolegët e punës dhe studentët në të gjitha nivelet e arsimit, pritet të flasin kur të jenë dëshmitarë ose të bëhen të vetëdijshëm për ngacmimet, madje të paraqesin ankesat e tyre kur janë dëshmitarë të ngacmimeve seksuale ku përfshihen të tjerët. Një shembull i mirë i një qasjeje

22 Pietsch, N (2015), 'Ngacmimi Seksual dhe Mësimi i Shkurtër i Hapësirës Publike' (27) Londër, Ontario: Rrjeti i të Mësuarit, Qendra për Kërkim dhe Edukim mbi Dhunën kundër Grave dhe Fëmijëve.

23 Po aty.

24 Smith B. L (2018), 'Çfarë duhet vërtet për të ndaluar ngacmimet seksuale', Shoqata Psikologjike Amerikane, Vëllimi 49 (Nr.2).

të tillë vëzhguese mund të gjendet në Kapitullin 9: 'Komunikimet'.<sup>25</sup>

## MBAJTJA E GRAVE DHE VAJZAVE TË SIGURTA NGA NGACMIMET PËRFSHIN SIGURINË E OFICERËVE FEMRA POLICIE

Oficerët e policisë të të gjitha gradave pritet të luajnë një rol transformues në policimin gjinor. Punonjësit femra të policisë luajnë një rol të rëndësishëm pasi ato sjellin cilësi të veçanta të nevojshme që organizata policore të konsiderohet një ofrues thelbësor legjitim dhe përfaqësues i shërbimit. Sidoqoftë, nëse të njëjtat police femra nuk mund të mbrohen në mjedisin e tyre të punës, do të jetë e pamundur që policia të ofrojë shërbime thelbësore për gratë dhe vajzat.

**“Qëndrimi ynë është që nëse nuk mund t’i mbronni gratë në polici, si mund ta përmirësoni situatën për gratë në komunitet?”**

Shoqata Ndërkombëtare e Grave Presidente të Policisë Jane Townsley (2014)

Siç u diskutua në Kapitullin 10: *Ndërtimi i Institucioneve për një Përgjigje Efektive dhe Llogaridhënëse ndaj DHGV*, një politikë 'Zero-Tolerancë' ndaj ngacmimit seksual do të jetë kritike për transformimin drejt një organizate policore të përgjegjshme ndaj gjinisë. Një politikë e tillë duhet të sigurojë që zyrtarët ekzekutivë dhe menaxherët të kenë mjetet për të përforcuar tolerancën zero ndaj çdo ngacmimi seksual dhe krimeve të tjera të lidhura me DHGV brenda organizatës, me theks në rolin e tyre në mbajtjen përgjegjëse të njerëzve në komandën e tyre.

Mjete të tilla përfshijnë masa mbrojtëse për ankuesit dhe sinjalizuesit, të cilat duhet të mbështeten me mesazhe të forta nga udhëheqja për një proces që është i drejtë dhe i përafuar me vlerat institucionale. Në këtë mënyrë raportimi i ngacmimit seksual konsiderohet si forcim i strukturës së organizatës sesa të shkojë kundër një kulture të heshtjes të perceptuar

25 Qasja e shikuesit. Graham Goulden për Kultivimin e Mendjeve në Mbretërinë e Bashkuar.

në mënyrë të rreme si ruajtje e lidhjeve kolegjiale. Kjo përfshin një qëndrim të fortë të mbajtur nga drejtuesit e lartë dhe ekzekutivë të policisë për zero tolerancë ndaj çdo akti hakmarrjeje; nuk është e pazakontë që ankesat për ngacmim seksual të përballen me hakmarrje nga ata që ata kanë akuzuar dhe nuk janë pushuar nga puna, duke e bërë jetën e tyre në vendin e punës aq të vështirë sa që përfundimisht heqin dorë nga puna.

Në avancimin e vizionit të 'tolerancës zero' të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, dhe agjendës prioritare për të adresuar ngacmimet seksuale në vendin e punës, një Kod Model i Sjelljes u zhvillua në vitin 2019 për të parandaluar ngacmimin, përfshirë ngacmimin seksual, në ngjarjet e sistemit të OKB-së. E rëndësishmja, Kodi Model i Sjelljes ishte rezultat i një Task Force të nivelit të lartë për ngacmimin seksual që u përfshi në një proces të gjerë konsultimi që përfshinte të gjithë sistemin e OKB-së në zhvillimin e Kodit.<sup>26</sup>

Kodi Model i Sjelljes i OKB-së jep përkufizime të qarta të ngacmimit dhe ngacmimit seksual:

- **Ngacmimi** është çdo sjellje e papërshtatshme ose e padëshiruar që në mënyrë të arsyeshme mund të pritet ose të perceptohet se shkakton fyerje ose poshtërim ndaj një personi tjetër. Ngacmimi në çfarëdo forme për shkak të gjinisë, identitetit dhe shprehjes gjinore, orientimit seksual, aftësisë fizike, pamjes fizike, përkatësisë etnike, racës, origjinës kombëtare, përkatësisë politike, moshës, fesë ose ndonjë arsye tjetër është i ndaluar në ngjarjet e sistemit të OKB-së.
- **Ngacmimi seksual** është një lloj i veçantë i sjelljes së ndaluar. Ngacmimi seksual është çdo sjellje e padëshiruar e një natyre seksuale që në mënyrë të arsyeshme mund të pritet ose të perceptohet se shkakton ofendim ose poshtërim. Ngacmimi seksual mund të përfshijë çdo sjellje të një natyre verbale, joverbale ose fizike, përfshirë komunikimet me shkrim dhe elektronike, dhe mund të ndodhë midis personave të gjinive të njëjta ose të ndryshme.

26 Përfundimi i ngacmimit seksual në ngjarjet e OKB -së (2019). Departamenti i Kombeve të Bashkuara për Strategji, Politika dhe Pajtueshmëri.

### “Zbatimi i mekanizmave të besuar të raportimit është një element kyç në sigurimin e një vendi të sigurt për viktimat për të raportuar sjelljen e keqe.”

Rishikim i pavarur i politikave dhe procedurave të UN Women për trajtimin e Shfrytëzimit dhe Abuzimit Seksual (ShAS) dhe Ngacmimit Seksual (NS). Raporti Përfundimtar 2019.

Kodi Model i Sjelljes i OKB-së gjithashtu përshkruan procesin e ankesës duke përfshirë kërkesën e organizatorit të ngjarjeve të sistemit të OKB-së për të ndërmarrë veprimet e duhura në përputhje me politikën, rregulloret dhe rregullat e tij në fuqi.<sup>27</sup> Veprimet e duhura të rekomanduara nga Kodi Model i Sjelljes i OKB-së përfshijnë:

- Ndërmarrja e një ushtrimi për gjetjen e fakteve;
- Duke kërkuar që autori të ndalojë menjëherë sjelljen fyese;
- Pezullimi ose ndërprerja e qasjes së autorit në ngjarjen e sistemit të OKB-së ose refuzimi i regjistrimit në ngjarjet e ardhshme të sistemit të OKB-së, ose të dyja;
- Dorëzimi i ankesës tek një autoritet hetimor ose disiplinor me juridiksion mbi personin e akuzuar për ngacmim;
- Dërgimi i një raporti tek punëdhënësi ose subjekti me juridiksion mbi personin e akuzuar për ngacmim për veprimet e duhura përcjellëse.

Pajisja e viktimës/të mbijetuarit me një zgjedhje të opsioneve të raportimit, përfshirë raportimin anonim dhe opsionin për të mos raportuar, si dhe opsionet joformale/formale për zgjidhjen në rastet e ngacmimit seksual, mund të ndihmojë në përforcimin se viktimat/të mbijetuarit trajtohen me një qasje të përqendruar tek viktima. Për më tepër, politikën e ngacmimit seksual duhet të përfshijnë mekanizma për të siguruar komunikim të vazhdueshëm për përparimin e rasteve tek viktimat/të mbijetuarit, përfshirë përditësime të shkurtra të statusit në baza të rregullta dhe pas përfundimit të hetimit, pa e penguar procesin hetimor, në

27 Kodi i Sjelljes i OKB -së për Parandalimin e Ngacmimeve, Përfshirë Ngacmimet Seksuale, NGA NGJARJET E SISTEMIT T UN OKB -së



mënyrë që të përforcohet besimi në proces dhe sistemin e brendshëm.<sup>28</sup>

Procesi i konsultimit i ndërmarrë nga Task Force i nivelit të lartë për ngacmimin seksual ishte një pjesë vitale e legjitimitetit të Kodit Model të Sjelljes të OKB-së, pasi sinjalizoi pronësinë e OKB-së ndaj problemit dhe përpjekjet për t'iu përmbajtur parimeve të transparencës në proces.

Policia që kërkon të krijojë politika të ngjashme dhe mekanizma të ndërlidhur mund të përfitojë shumë nga konsultimi i gjerë dhe në mënyrë transparente për zhvillimin e tij. Kutia 5 jep një shembull të një rishikimi të ngacmimit në vendin e punës në Policinë e Kalorsisë Mbretërore Kanadeze (PKMK).

#### Kutia 5

##### Raportimi për ngacmimet në vendin e punës në PKMK



Në vitin 2016, Ministri i Sigurisë Publike, kërkoi që Komisioni Civil i Rishikimit dhe Ankesave të ndërmarrë një rishikim gjithëpërfshirës të politikave dhe procedurave të PKMK për ngacmimin në vendin e punës, dhe në mënyrë specifike të ekzaminojë dhe vlerësojë zbatimin e rekomandimeve të bëra në Raportin e tij të Hetimit të Interesit Publik 2013 rreth Ngacmimit në vendin e punës në PKMK. Raporti konfirmoi se ngacmimi në vendin e punës vazhdon të jetë një problem serioz në PKMK. Në gjetjet e tij, Komisioni ka gjetur se ndërsa udhëheqësit e lartë në PKMK kanë bërë përpjekje për të parandaluar ngacmimet - veçanërisht në nivelin e divizioneeve - këto nisma kanë qenë të kufizuara, ad-hoc dhe nuk kanë marrë mbështetjen e nevojshme nga Shtabi Kombëtar. Raporti identifikoi disa boshllëqe të vazhdueshme në përpjekjet e PKMK për të parandaluar ngacmimet në vendin e punës. Më poshtë janë shembuj emblematikë të boshllëqeve të tilla:

- Pamundësia për të zbatuar reformën është e rrënjosur në tiparet kryesore të kulturës dhe strukturës organizative të PKMK;
- PKMK nuk ka arritur të nxisë një kulturë udhëheqjeje. Ndërsa mund të ketë udhëheqës të shumtë shembullorë në PKMK, organizata bën pak për të promovuar një kulturë udhëheqjeje midis menaxherëve, mbikëqyrësve dhe zyrtarëve ekzekutivë në tërësi;
- Një standard artificialisht i lartë për gjetjen e ngacmimit;
- Zyrtarët Komandues të Divizionit nuk marrin pothuajse asnjë trajnim për vendimmarrjen në ankesat e ngacmimit;
- Ngacmimi, bullizmi, kanosja dhe ngacmimi seksual në vendin e punës mund të shkaktojnë dëme të konsiderueshme për anëtarët dhe punonjësit individualë të PKMK, në disa raste duke dëmtuar karrierën dhe duke shkaktuar dëm serioz emocional dhe fizik. Ai gjithashtu mund të ndikojë në efektivitetin operacional të PKMK, duke përfshirë përkeqësimin e problemeve kronike të mungesës së stafit.
- Ngacmimi në vendin e punës ka një ndikim negativ në besimin e publikut kanadez, i cili po pyet nëse problemet e brendshme të PKMK janë 'filtruar jashtë' dhe kanë ndikuar në trajtimin e anëtarëve të publikut.

Raporti siguroi shumë rekomandime për PKMK. Lista e mëposhtme janë shembuj emblematikë të rekomandimeve në raport:

- Nxitja e një kulture lidhësi duke futur kritere promovuese që njohin aftësitë menaxhuese, dhe duke krijuar programe më rigorozë, të detyrueshme të zhvillimit të lidhësit për të gjithë mbikëqyrësit, menaxherët dhe zyrtarët ekzekutiv ekzistues dhe të sapoemëruar, përfshirë kurset e duhura të nivelit universitar;
- Hartimi i dokumenteve të qarta dhe të thjeshta të politikave të ngacmimit, në gjuhë të thjeshtë, dhe që ato të jenë të disponueshme në faqen e saj të jashtme të internetit;

<sup>28</sup> Rishikim i pavarur i politikave dhe procedurave të UN Women për trajtimin e Shfrytëzimit dhe Abuzimit Seksual (SHAS) dhe Ngacmimit Seksual (NS). Raporti Përfundimtar - 24 Maj 2019, Kopenhagen.

- Instituti i trajnimit të ngacmimit personal, i kryer nga ekspertë të trajnuar dhe të kualifikuar, në baza të rregullta. Trajnimi i specializuar gjithashtu duhet të jetë i detyrueshëm për të gjithë mbikëqyrësit, menaxherët dhe zyrtarët ekzekutiv ekzistues si dhe të sapoemëruar, në mënyrë të vazhdueshme;
- Mbajtja e hetuesve të aftë, kompetent dhe të përkushtuar administrativ (jo anëtarë me uniformë), të cilët janë të pavarur nga zinxhiri i komandës, për të kryer hetime ngacmimi;
- Të ndryshojë politikat dhe procedurat e tij të ngacmimit për të mandatuar hetuesin të bëjë gjetje në lidhje me çështjet e besueshmërisë dhe nëse politikat e ngacmimit janë shkelur apo jo, dhe t'i raportojë këto gjetje tek vendimmarrësi; dhe të mandatojë vendimmarrësin të vendosë nëse do të pranojë apo jo gjetjet e hetuesit dhe të marrë vendime në lidhje me atë se a duhet të shqiptohet ndonjë masë përmirësuese dhe/ose disiplinore;
- Duhet siguruar që Oficerët Komandues të Divizionit të marrin trajnime të vazhdueshme, të bazuara në klasë për vendimmarrjen, veçanërisht në lidhje me vlerësimin e ankesave të ngacmimit në vendin e punës, përfshirë në lidhje me testet e duhura ligjore që do të aplikohen, dhe stereotipet në lidhje me sjelljen e viktimave të ngacmimit.

Burimi: Raportimi për ngacmimin në vendin e punës në PKMK (Qeveria e Kanadasë, 2017).

## DHGV E LIDHUR ME KONFLIKTIN

  57. Udhëzimet e Terminologjisë për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual. Miratuar nga Grupi Punues Ndërinstitucional në Luksemburg, 28 Janar 2016. Projekti i Terminologjisë dhe Semantikës Ndër agjencore mbi Shfrytëzimin Seksual dhe Abuzimin Seksual të Fëmijëve & ECPAT International, në: <http://luxembourgguidelines.org/>
  58. Thakur, Dhanaraj (2018) Si e ndërmjetëson TIK-u dhunën me bazë gjinore në Xhamajka ?, ne aspektin Gjinator dhe Zhvillimor, 26: 2.
  59. Raporti i Analizës së Peizazhit Global mbi Dhunën kundër Grave dhe Vajzave Online dhe të lehtësuar nga TIK-u (UN Women, 2021), botim i ardhshëm.





# EMERGENCAT E SHËNDETIT PUBLIK DHE KRIZAT HUMANITARE JO-KONFLIKTUALE

*“COVID-19 prek gratë dhe burrat në mënyra të ndryshme. Pandemia i përkeqëson pabarazitë ekzistuese për gratë dhe vajzat, si dhe diskriminimin e grupeve të tjera të marginalizuara, siç janë personat me aftësi të kufizuara dhe ata në varfëri ekstreme dhe rrezikon të pengojë realizimin e të drejtave të njeriut për gratë dhe vajzat. Pjesëmarrja, mbrojtja dhe potenciali i të gjitha grave dhe vajzave duhet të jetë në qendër të përpjekjeve të reagimit. Këto përpjekje duhet të jenë të përgjegjshme për gjininë dhe të marrin parasysh ndikimet e ndryshme që lidhen me zbulimin, diagnostikimin dhe qasjen në trajtim për të gjitha gratë dhe burrat.”*

**Mbrojtja e shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese dhe promovimi i re-agushmërisë gjinore në krizën COVID-19, Deklarata e përbashkët globale për shtyp (6 maj, 2020)<sup>2</sup>**

<sup>2</sup> Ministrat e Afrikës së Jugut, Suedisë, Argjentinës, Australisë, Shqipërisë, Belgjikës, Bolivisë, Bosnje-Hercegovinës, Cabo Verdes, Kanadasë, Qipros, Republikës Çeke, Danimarkës, Finlandës, Fihit, Francës, Gjermanisë, Greqisë, Guineas, Italisë, Letonisë, Libanit, Liberisë, Lihtenshtajnit, Luksemburgut, Madagaskarit, Malit të Zi, Holandës, Maqedonisë së Veriut, Namibisë, Zelandës së Re, Norvegjisë, Portugalisë, Rumanisë, Serbisë, Spanjës, Zvicrës dhe Mbretërisë së Bashkuar, janë të nderuar të lëshojnë këtë deklaratë të përbashkët në emër të popujve dhe qeverive të 59 shteteve: Shqipërisë, Argjentinës, Armenisë, Australisë, Austrisë, Belgjikës, Bolivisë, Bosnje-Hercegovinës, Bullgarisë, Kanadasë, Cabo Verdes, Kosta Rikës, Kroacisë, Qipros, Republikës Çeke, Danimarkës, Ekuadorit, Estonisë, Fihit, Finlandës, Francës, Gjeorgjisë, Gjermanisë, Greqisë, Guineas, Irlandës, Islandës, Italisë, Japonisë, Letonisë, Libanit, Liberisë, Lihtenshtajnit, Lituanisë, Luksemburgut, Madagaskarit, Meksikës, Moldavisë, Malit të Zi, Namibisë, Holandës, Maqedonisë së Veriut, Zelandës së Re, Norvegjisë, Perusë, Portugalisë, Republikës së Koresë, Rumanisë, Serbisë, Afrikës së Jugut, Sllovenisë, Spanjës, Suedisë, Tunizisë, Tuvalit, Zvicrës, Mbretërisë së Bashkuar, Ukrainës dhe Uruguait.

---

# QËLLIMET E KAPITULLIT

---

**Synon të sigurojë udhëzime sesi policimi i përgjegjshëm gjinor mund të përshtatet me krizat publike të shëndetit dhe/ose fatkeqësitë humanitare të konflikteve të paarmatosura.**

---

## **Mesazhet kryesore dhe pikat mësimore:**

- krizat dhe emergjencat i përkeqësojnë pabarazitë ekzistuese, duke rezultuar në një rritje të mbizotërimit të DNGV, veçanërisht dhunës ndërpersonale;
- gjatë kohës së krizave, planet ekzistuese të reagimit ndaj DNGV-së duhet të rishikohen dhe rivlerësohen për të siguruar që siguria dhe mbrojtja janë në thelb të çdo vendimmarrjeje, planifikimi dhe realizmit të tyre;
- partneritetet e krijuara më parë midis policisë dhe hisedarëve kryesorë vendorë do të luajnë një rol kyç në zvogëlimin e ndikimit të sfidave të rënduara në kohë krizash;
- para-planifikimi para çdo situatë krize do të ndihmojë në identifikimin e rreziqeve, sanimeve dhe kontigjencave ndaj përgjigjeve ekzistuese të koordinuara;
- organizatat policore me qasje të vazhdueshme në burime të qëndrueshme dhe të besueshme të informacionit dhe të dhëna ndërlidhëse mbi popullatat “në rrezik” do të pozicionohen më mirë për t’iu përgjigjur DNGV-së;
- mësimet e mësuara të dokumentuara nga policia duhet të futen në një analizë të përtërirë të dhënave që e merr parasysh kontekstin specifik dhe modelet ndërlidhëse të diskriminimit me bazë gjinore.



## HYRJJE

Më 31 dhjetor 2019, autoritetet kineze informuan Organizatën Botërore të Shëndetësisë (OBSh) se pneumonia nga një shkaktar i panjohur po përhapej me shpejtësi në tërë Kinën, që buronte posaçërisht nga qyteti Wuhan, kryeqyteti i provincës Hubei.

Fotografi kortezije nga UN Women/Ploy Phutpheng (Tajlandë)

Menjëherë pas kësaj risia COVID-19<sup>2</sup> ishte identifikuar (fillimisht i emërtuar “2019-nCoV”) nga ekspertët vendor, autoritetet lokale urdhëruan popullsinë në karantinë të detyrueshme në përpjekje për ta kontrolluar shpërthimin e COVID-19 dhe të parandalojë vdekjet, si dhe shembjen e sistemeve shëndetësore.

Vendet fqinje të Kinës filluan të raportojnë raste, të cilat u përsëritën në vende të tjera menjëherë pas kësaj, në rajone të ndryshme të botës. Prej 11 mars 2020, OBSh e klasifikoi COVID-19 si një pandemi dhe i njoftoi Shtetet Anëtare se ishte thëllësisht e shqetësuar si nga nivelet alarmante të përhapjes dhe ashpërsisë, ashtu edhe nga nivelet alarmante të mosveprimit. Vendet në të

gjithë botën filluan të zbatojnë karantina të ngjashme të detyrueshme, lëvizje të kufizuara dhe masat për distancimin shoqëror. Prej muajit mars 2020, afro gjysma e popullsisë së botës ishte në mbyllje.

OKB, duke pasur përvojë në përballimin e shpërthimeve të sëmundjeve infektive siç është Ebola<sup>3</sup> në Afrikën Perëndimore, Zika në Amerikën Latine dhe SARS në Azi, shprehu shqetësim për ndikimin që kishin masat e reagimit ndaj COVID-19 në popullatat e cenushme, të tilla si ato në konflikt dhe /rajonet humanitare dhe si ato mund të ndikojnë në natyrën e dhunës së ushtruar ndaj grave dhe vajzave.

2 Koronaviruset (CoV) janë një familje e madhe virusesh që shkaktojnë sëmundje duke filluar nga ftohja e zakonshme deri tek sëmundjet më të rënda. Një koronavirus i ri (nCoV) është një lloj i ri që nuk është identifikuar më parë te njerëzit. Shih: Përhapja e sëmundjes koronavirus (COVID-19) (2020), Zyra regjionale e OBSh për Evropë, në: <http://www.euro.who.int/en/health-topics/health-emergencies/coronavirus-covid-19/novel-coronavirus-2019-ncov>

3 Sëmundja e virusit Ebola (SVE) është një sëmundje e rrallë, por e rëndë, shpesh fatale tek njerëzit. Virusi transmetohet te njerëzit nga kafshët e egra dhe përhapet në popullatën njerëzore përmes transmetimit nga njeriu te njeriu. Shkalla mesatare e vdekshmërisë së rasteve SVE është rreth 50%. Shkalla e vdekshmërisë së rasteve ka ndryshuar nga 25% në 90% në shpërthimet e kaluara. Sëmundja e virusit Ebola: Faktet kryesore (OBSh, 2020), në: <https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/ebola-virus-disease>



Shqetësimi i OKB -së buronte nga dëshmitë e dokumentuara nga shpërthimet më të fundit të Ebola dhe Zika<sup>4</sup>, i cili tregoi se stresi social-ekonomik, konfliktet civile dhe emergjencat e shëndetit publik përkeqësojnë pabarazitë ekzistuese. Kjo nga ana tjetër çoi në rritjen e mbizotërimit të DHNGV-së, veçanërisht DPV dhe shtatzënie të hershme tek vajzat e reja.<sup>5</sup>

Duke njohur ndikimin e DHNGV-së si të rëndë në situata emergjente dhe kontekste me sisteme shëndetësore të dobëta, sundim të dobët të ligjit dhe nivele të larta të pabarazisë gjinore, Sekretari i Përgjithshëm i OKB -së, Antonio Guterres, u bëri thirrje të gjitha qeverive të bëjnë parandalimin dhe korrigjimin të VAWG si pjesë kryesore e planeve të tyre kombëtare të reagimit për COVID-19.<sup>6</sup>

4 Komiteti i Përhershëm Ndër Agjencia (Mars 2020). Udhëzime të përkohshme; paralajmërimi gjinor për shpërthimin e COVID-19, në: <https://interagencystandingcommittee.org/inter-agency-standing-committee/interim-guidance-gender-alert-covid-19-outbreak-developed-iasc>

5 CARE (mars 2020). Një dokument politikash mbi implikimet gjinore të COVID-19, në: <https://www.care.org/newsroom/press/press-releases/covid-19s-gender-implications-examined-in-policy-brief-care>

6 Video mesazhi i Sekretarit të Përgjithshëm mbi dhunën me bazë gjinore dhe COVID-19. Kombet e Bashkuara, 5 prill 2020, në: <https://www.un.org/sg/en/content/sg/state-ment/2020-04-05/secretary-generals-video-message-gender-based-violence-and-covid-19-scroll-down-for-french>

Në mënyrë të ngjashme dhe në njohjen e mbizotërimit global të DHNGV-së, e cila tashmë është shumë e lartë<sup>7</sup>, UN Women i karakterizoi ndikimet negative jo-proporcionale me të cilat po ballafaqohen gratë dhe vajzat si rezultat i pandemisë COVID-19 si një **“Pandemi në hije”**.<sup>8</sup>

Ky doracak i referohet përkufizimit të një pandemie që dhënë nga OBSH-ja (2010) e cila e karakterizon **pandeminë si përhapje e një sëmundjeje të re në mbarë botën e cila identifikohet më parë nga shkalla dhe shtrirja e saj gjeografike (dhe kur shumica e njerëzve nuk kanë imunitet), se sa nga ashpërsia e sëmundjes**.<sup>10</sup>

Ky kapitull fokusohet në ndikimin e krizave humanitare jo-konfliktuale në DHNGV-ë, me vëmendje të posaçme që i është dhënë pandemisë së fundit globale të COVID-19 dhe paraleleve me shpërthimet e sëmundjeve të tjera infektive siç është Ebola që shkakton ose përkeqëson krizën rajonale tashmë ekzistuese. Ndonëse kriza aktuale e shëndetit publik COVID-19 është shumë e ndryshme nga shpërthimet e tjera të sëmundjeve infektive, ka shumë sfida të zakonshme me të cilat përballen organizatat policore dhe partnerët e tyre të shërbimit themelor në mënyrat e referimit për viktimat/të mbijetuarat e DHNGV-së. Ky kapitull do të diskutojë këto sfida të zakonshme të shkaktuara nga rrethana të tilla të jashtëzakonshme me qëllim të ofrimit të udhëzimeve të informuara për policimin gjinor në këto kohë të vështira.

Për të ndihmuar organizatat policore që të zbusin rreziqet e një reagimi joefektiv ndaj DHNGV gjatë krizës, pjesa në vijim do të japë udhëzime të formës kolegu- kolegut

7 Gender-related killing of women and girls (UNODC, 2018), atSipas statistikave të OKB -së, 1 në 3 gra në nivel global ka përjetuar dhunë fizike ose seksuale në një moment të jetës së tyre dhe pothuajse gjashtë nga çdo dhjetë gra të vrara qëllimisht në mbarë botën të vrara nga një partner intim ose anëtar tjetër i familjes. Shih: Studimi global i UNODC mbi vrasjen: Vrasjet e grave dhe vajzave në aspekt gjinor (UNODC, 2018), në: [https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/GSH2018/GSH18\\_Gender-related\\_killing\\_of\\_women\\_and\\_girls.pdf](https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/GSH2018/GSH18_Gender-related_killing_of_women_and_girls.pdf)

8 UN Women (2020), ‘COVID-19 dhe dhënia fund dhunës ndaj grave dhe vajzave’, në: <https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/04/issue-brief-covid-19-and-ending-violence-against-women-and-girls>

9 Gatishmëria e emergjencave, reagimi. Çfarë është pandemia? (OBSH, 24 shkurt 2020)

10 Po aty.



**Figura 1**

**Paketa e Shërbimeve Thelbësore: Diagrami i Përgjithshëm i Kornizës**

Parimet	një përjasje e bazuar në te drejtë	avancimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave	E ndjeshme nga ana kulturore dhe e përshtatshme për moshën
	Qasja me në qendër të viktimës/të mbijetuarit	siguria është parësore	përgjegjësia e autorit
Karakteristikat e përbashkëta	përgjegjësia e autorit vlefshmëri	aksesueshmërisë	
	përshtatshmëria	përshtatshmërisë	
	jepni prioritet sigurisë	miratim i informuar dhe konfidencialiteti	
	mbledhjen e të dhënave dhe menaxhimin e informacionit	Komunikim efektiv	
	lidhjen me sektorë dhe agjenci të tjera nëpërmjet referimit dhe koordinimit		

bazuar në kornizën e parimeve të Paketës së Shërbimit Thelbësore (PSHTH) dhe karakteristikave të përbashkëta për reagimin e koordinuar viktimë/i mbijetuar.

## UDHËZIMI KOLEGU-KOLEGUT

Gjatë kohëve të krizave të shëndetit publik ose humanitar, mënyra se si i përgjigjemi thirrjeve për shërbime duhet të rishikohet për të siguruar që ne mund t'i përgjigjemi krizës, por gjithashtu të vazhdojmë të ofrojmë shërbime policore për komunitetet lokale, duke pranuar se aftësia jonë për të mbajtur 'biznesin si zakonisht' mund të komprometohet. Për sa i përket DHNGV-së, aftësia jonë për t'iu përgjigjur viktimave/të mbijetuarve duhet të mbetet sa më efektive që të jetë e mundur në mënyrë që të mund të vazhdojmë t'u ofrojmë atyre siguri dhe mbrojtje, ndërsa në të njëjtën kohë të pranojmë se ne kemi për detyrë të kujdesemi për personelin tonë dhe bashkësisë më të gjerë.

Udhëzimet e dhëna brenda kapitujve të këtij doracaku janë po aq relevante gjatë kohës së krizës sikurse edhe gjatë 'normalitetit' çfarëdo që të duket në kontekstin në të cilin punoni. Aspekte të ndryshme të udhëzimit mund të kenë një rëndësi më të madhe gjatë krizave dhe pa dyshim që do të keni nevojë t'i jepni përparësi përgjigjes suaj ndaj një sërë sfidash.

Si udhëheqës policie, ju do të jeni përgjegjës dhe llogaridhënës për ofrimin e sigurisë dhe mbrojtjes për komunitetet tuaja lokale edhe në kohë krize, por gjithashtu keni detyrë të kujdeseni për personelin/njësinë tuaj policore për të siguruar që ata të mund të vazhdojnë të ofrojnë shërbime efektive. Ka shumë të ngjarë që llojet e krimit të ndryshojnë gjatë krizës, veçanërisht nëse vendosen kufizime në lëvizje siç janë përjetuar gjatë pandemisë COVID-19. Përderisa plaçkitjet, vjedhjet në rrugë dhe krimet e dhunshme mund të zvogëlohen, përvoja na tregon se DNVG, veçanërisht dhuna në familje ose nga partneri intim, po rritet, kështu që ju duhet të rishikoni vazhdimisht shërbimet tuaja/planet operative në përputhje me rrethanat.



Fotografi kortezi e UN MONUSCO (RD Kongo)



Fotografi korteziqe MINUSTAH/Logan Abassi (Haiti)

Krizat zakonisht sjellin me vete presion të paparë mbi burimet tuaja të cilat, në shumë raste, shtrihen pa sfida shtesë e që mund të sjellë një krizë shëndetësore ose humanitare. Prandaj është me rëndësi jetike që të mbështeteni në disponueshmërinë e personelit tuaj, duke zbutur rreziqet që ata t'i nënshtrohen ndonjë çështjeje shëndetësore, për shembull, duke zvogëluar kështu burimet që keni në dispozicion.

Ka të ngjarë që personelit do t'i kërkohet të punojë me orë të gjata, shpesh në rrethana shumë të vështira duke zvogëluar periudhat e pushimit dhe kohën me familjet e tyre. Pra, nëse edhe ata vetë nuk i nënshtrohen asnjë infeksioni apo sëmundjeje, nevoja që ju të merrni parasysh shëndetin dhe mirëqenien e tyre mendore bëhet edhe më e rëndësishme gjatë një krize. Kjo është koha kur udhëheqja e dukshme do të bëjë një ndryshim të vërtetë për personelin tuaj, duke ndihmuar në ruajtjen e moralit të tyre dhe duke i fuqizuar ata me vlerësimin tuaj. Duke thënë thjesht ‘faleminderit’ nuk kushton asgjë, por do të thotë shumë.

## Vazhdimësia e biznesit, kontingjenca dhe planifikimi emergjent

Si zyrtarë policor, ne jemi mësuar të merremi me situata emergjente që kërkojnë detyra të drejtpërdrejta dhe zbatim të planeve operacionale dhe emergjente, por krizat e shëndetit publik dhe humanitar mund të vazhdojnë për një kohë të konsiderueshme me ndikime të

rënda në jetën e përditshme, prandaj qëndrueshmëria e reagimit të policisë bëhet një sfidë e vërtetë.

Ashtu siç kemi përjetuar gjatë pandemisë COVID-19, organizatave policore përgjatë globit u është dashur të identifikojnë mënyra të reja të punës, disa janë me fat që kanë qasje në teknologjitë e reja për ndihmë, ndërsa të tjerat mund të mos kenë. Pavarësisht nga burimet që keni në dispozicion, ju duhet t'i përdorni ato në mënyrë efektive dhe gjithashtu duhet të demonstroi udhëheqje inovative duke identifikuar mënyra të reja të punës.

Ne gjithmonë mund të mësojmë nëse kthejmë kokën prapa, por nëse nuk keni plane emergjente ose kontingjente për fushën tuaj të përgjegjësive, për t'iu mundësuar që të përballeni në mënyrë efektive me krizën gjersa i mirëmbani këto shërbime, ju duhet t'i krijoni ato. Edhe nëse gjendeni në mes të krizës, ju mund të zhvilloni takime informuese me personelin, duke reflektuar mbi veprimet tuaja dhe duke filluar të sistemoni mësimet e mësuara, ashtu që të hartoni plane të tilla të gatishmërisë për ngjarje të ngjashme, duke përfshirë për shembull, valët pasuese të ndonjë sëmundjeje.


**Figura 2** është ‘Ciklet e Townsley’, një mjet që mund të përdoret për vendimmarrje, planifikim dhe zgjidhje operacionale të përgjigjeve ndaj DVGJ-së gjatë kohës së krizave. Ai është i projektuar të jetë një proces ciklik me sigurinë dhe mbrojtjen në thelbin e tij. Mund të përdoret për të rishikuar planet ekzistuese të përgjigjes për të siguruar që ato janë “të përshtatshme për qëllim” gjatë kohës së krizës ose për të zhvilluar plane gjatë një krize. Preferohet që ai të përdoret si mjet para-planifikimi për të zhvilluar një përgjigje emergjente ndaj DVGJ-së nëse ndodh një krizë e ardhshme. Mund të përdoret gjithashtu për vendimmarrje dinamike nga zyrtarët përgjegjës.

Për më shumë informacion dhe udhëzime mbi përdorimin e Cikleve të Townsley për Planifikim të Përgjigjshëm Gjinnor dhe Ofrimin e Përgjigjes së Policisë ndaj DVGJ-së gjatë krizës së shëndetit publik (pandemisë/epidemisë) ose krizave humanitare, **shih shtojcën 1.**

Nëse keni plane ekzistuese, atëherë duhet t'i rishikoni vazhdimisht gjatë krizës për t'u siguruar që ato janë ‘të

**Figura 2**

**Ciklet Townsley për Planifikimin e Përgjegjshëm Gjinator dhe ofrimin e reagimit të Policisë ndaj DNGV-së gjatë kohës së krizave.**



përshtatshme për qëllimin' duke bërë rregullime aty ku është e nevojshme.

Pavarësisht nëse keni plane ose po i zhvilloni ato, duhet të merrni parasysh një numër pyetjesh kryesore, këto përfshijnë:

- ku ruhet plani?
- kush duhet të dijë dhe kuptojë përmbajtjen e tij dhe a konsiderohen ata përgjegjës për të mësuar përmbajtjen e tij?
- a janë përcaktuar qartë rolet dhe përgjegjësitë brenda planit bashkë me llogaridhënien?
- çfarë trajnimi kërkohet në plan?
- sa rregullisht testohet?
- kur është testuar për herë të fundit?
- si monitorohet, rishikohet dhe përditësohet?

- a janë përfshirë mësimet e mësuara brenda tij? (Këto mund të jenë nga burime vendore, kombëtare ose ndërkombëtare)
- sa janë të rregullta takimet udhëzuese dhe informuese të hartuara në zbatim të planit?

Pyetjet e mësipërme janë vetëm disa shembuj të asaj që duhet të keni parasysh, planifikimin kontingjent, “Çka nëse?” e tërë planifikimit operacional që tashmë duhet të bëni çdo ditë, qoftë për incidente të para-planifikuara apo spontane.

Plani i vazhdimësisë së biznesit është paksa i ndryshëm pasi është dizajnuar për të siguruar që ju mund të mbani, aq sa është e mundur, “biznesin si zakonisht”, ose funksionet themelore të biznesi tuaj të sigurta në kohë krize. Kjo është po aq e rëndësishme për t’iu përgjigjur DHNGV-së sa për çdo çështje tjetër që ka të ngjarë të thirrreni për t’iu përgjigjur. Ju duhet të merrni parasysh atë që keni në dispozicion për t’iu përgjigjur viktimave/të mbijetuarve të DHNGV-së dhe si

mund të ruhet kjo kur burimet tuaja janë ngushtuar, qasja në objekte është e kufizuar dhe qasja në ankuesit dhe dëshmitarët është në vetvete një rrezik për shkak të infektionit të mundshëm. Ju duhet të mbani një qasje të përqendruar te viktima/të mbijetuarit dhe një hetim të fokusuar tek kryerësi (shih Kapitullin 5: 'Hetimi'). Duke menduar për gjëra të tilla kur nuk jeni në krizë dhe zhvillimi i planeve në përputhje me rrethanat do të jetë jashtëzakonisht i dobishëm për ju kur ju kërkohet të merrni vendime të qarta në një situatë stresuese.

## SIGURIA DHE MBROJTJA

Siguria dhe mbrojtja (shih kapitullin 6 'Siguria dhe Mbrojtja') është një pjesë vitale e çdo reagimi të policisë ndaj VAWG, por është edhe më shumë gjatë kohës së krizave kur duhet të jetë qendrore për tërë planifikimin dhe vendimmarrjen. Ju dhe personeli juaj duhet t'i merrni parasysh të gjitha rreziqet e përfshira për viktimën/të mbijetuarin dhe vetë

personelin tuaj duke kryer një vlerësim të rrezikut bazuar në rrethanat e veçanta që kanë të bëjnë me atë kohë. Personeli juaj mund të jetë i frikësuar nëse ata janë vetë në rrezik, kështu që ju duhet t'i sigurori dhe inkurajoni ata, mos marrja pjesë nuk është një opsion pasi jeta e dikujt mund të varet nga ajo, kështu që ju do të keni nevojë për të zbutur rreziqet për personelin. Një mënyrë është pajisja e tyre me PMP të përshtatshme, të cilat, mund të jenë në mungesë gjatë kohës së krizës dhe ri-theksojnë nevojën për planifikim emergjent dhe kontingjent.

Thjesht vetë publikimi i PMB -ve në vetvete nuk zvogëlon rrezikun nëse personeli nuk është informuar për përdorimin, ruajtjen dhe asgjësimin e tij të saktë. Gjithashtu është e rëndësishme të siguroheni që pajisjet mbrojtëse të publikuara janë të përshtatshme në mënyrë të përshtatshme për anëtarët meshkuj dhe femra të qasshme pa diskriminim. Kutia 1 jep një shembull të udhëzimeve

### Kutia 1

#### Udhëzimi operacional për Pajisje personale mbrojtëse (PMP) të MB-së



Gjatë reagimit ndaj COVID-19, shërbimet e policisë në tërë Mbretërinë e Bashkuar u siguruan me udhëzime operacionale nga Këshilli i Shefave të Policisë Kombëtare (NPCC) dhe Kolegji i Policisë mbi përdorimin e PMP-së. Udhëzimi gjithashtu përfshiu skenarë operacionale për të ndihmuar stafin të kuptojë përdorimin e saktë të PMP-së. Disa shembuj të përshtatur nga udhëzimi janë dhënë më poshtë. Ky udhëzim mund të përsëritet ose përshtatet për urgjencat e tjera të shëndetit publik.

- të gjithë zyrtarët duhet të kenë si minimum maskë kirurgjike rezistente ndaj lëngjeve dhe doreza (jo të gomës) në dispozicion dhe sigurisht aty ku zyrtarët janë vendosur në patrulla me ekuipazh të dyfishtë ose në transportues personeli. PMP -ja duhet të jetë e disponueshme për personin zyrtar për të mundësuar vendosjen e shpejtë kur është e nevojshme.
- marrësit e thirrjeve dhe dispeçerët duhet të përcaktojnë nëse dyshohen ose konfirmohen raste të COVID-19 për të mundësuar që zyrtarët që përgjigjen të paralajmërohen në mënyrë që ata të mund të japin PMP-të e duhura.
- gjatë hyrjes në ambiente, zyrtarët duhet të jenë të vetëdijshëm se disa banorë mund të mos e dinë se janë të infektuar, kështu që duhet të kryejnë vazhdimisht vlerësime dinamike të rrezikut.
- aty ku distancimi shoqëror nuk është i mundur dhe prandaj ka të ngjarë të ketë "kontakt të ngushtë" me publikun, atëherë zyrtarët duhet të vendosin maska kirurgjike rezistente ndaj lëngjeve dhe doreza (jo të gomës), nëse personi është simptomatik atëherë përdorimi i syzeve dhe përparës mbrojtëse duhet të jetë pjesë e vlerësimit të rrezikut.

Burimi: [Personal Protective Equipment \(PPE\) operational guidance](#) (8 prill, 2020). Kolegji i Policisë, MB.



Fotografia është bërë nga Departamenti për marrëdhënie me forcat policore të Nigerisë

**“ Ashtu si personeli mjekësor, zyratrët e policisë nuk mund të telekomunikojnë, kështu që ata janë gjithashtu në vijën e parë. Përgjegjësia jonë e parë është të qëndrojmë të shëndetshëm dhe të sigurt, kështu që ne duhet të kemi, jo vetëm pajisjet, por edhe qëndrimin për të mbrojtur veten.**

**“Kjo ndodh sepse, duke mbrojtur veten, ne mund të mbrojmë të tjerët. Ne duhet të sigurohemi që nuk po i infektojmë të tjerët dhe se po mbrojmë më të cenueshmit së bashku me forcën policore mikëpritëse.”**

Këshilltari aktual i Policisë i OKB -së dhe ish komisioneri i policisë së Misionit të OKB -së në Republikën e Afrikës Qendrore (MINUSCA, komisioneri Luis Carrilho

operacionale nga Këshilli i Shefave të Policisë Kombëtare (NPCC) dhe Kolegji i Policisë mbi përdorimin e PMP-së.

## PARANDALIMI

Gjatë kohëve sfiduese kur burimet e policisë tashmë janë të shtyrë duke u përballur me një krizë, angazhimi i komunitetit është edhe më i rëndësishëm për të mbrojtur komunitetin tuaj lokal nga ndikimet e krizës, por edhe në ruajtjen e prioriteteve të tjera të policisë. Edukimi dhe ngritja e vetëdijes së komunitetit mbi atë që ata duhet të bëjnë për të mbrojtur veten nga ndikimet e krizës gjithashtu ofron një mundësi për të ngritur vetëdijesimin e tyre për DHNGV-së, çfarë të kërkojnë dhe si të mbështesin viktimat/të mbijetuarit dhe të lehtësojnë raportimin. Ju do të mbështeteni shumë në faktin se komuniteti është “sytë dhe veshët” tuaj në terren, veçanërisht gjatë kohës së distancimit shoqëror ose kufizimeve në lëvizje.

Gjatë njoftimit të stafit tuaj mbi detyrat e tyre në lidhje me krizën sigurohuni që ata i kuptojnë cenueshmëritë shtesë ndaj DHNGV-së që mund të paraqiten, si mungesa e ushqimit bazë dhe nevojat e tjera të mbijetesës të cilat mund të çojnë në shfrytëzim dhe rritje të stresit. Përkujtojeni personelit tuaj se ata kanë përgjegjësi dhe llogaridhënie



Fotografi kortezije Departamenti i Marrëdhënieve me Forcat Policore të Nigerisë

personale për të 'mos bërë dëm', të kryejnë detyrën siç kërkohet për publikun dhe kolegët e tyre dhe për të parë dhe dalluar shenjat e dhunës ose abuzimit, të cilat nuk janë gjithmonë të dukshme (**shih Kapitullin 5: "Hetimi"**).

Angazhimi juaj me komunitetin gjatë krizës mund qoftë të ndërtojë ose shkatërrojë besimin dhe konfidencën e tyre në shërbimin policor që ju dhe personeli juaj i ofroni. Nëse për shembull, zyrtarët tuaj abuzojnë me autoritetin e tyre në zbatimin e ndonjë kufizimi të imponuar nga qeveria, kjo do të ketë implikime të gjera për marrëdhëniet me komunitetin shumë kohë pasi kriza të ketë përfunduar, duke e bërë punën tuaj në të ardhmen shumë më të vështirë. Në mënyrë alternative, duke u angazhuar me komunitetin në kapacitetin edukativ dhe të ngritjes së vetëdijes, duke përdorur bindjen në vend të metodave jo-proporcionale të zbatimit, do të përmirësoni besimin dhe konfidencën duke iu mundësuar të korrni benefitet sapo të përfundojë kriza e tanishme.

Angazhimi me sektorë të caktuar të komunitetit mund të ndihmojë në mbrojtjen e viktimave/të mbijetuarve nga dhuna ose abuzimi i vazhdueshëm, (shih kutinë 8 mbi partneritetet civile të policisë për shembuj të veçantë). Për shembull, farmacitë mund të jenë në gjendje të ofrojnë dhomat e tyre të konsultimit si vende të sigurta për viktimat/të mbijetuarit për të raportuar dhunën ose abuzimin, personeli i dyqaneve ushqimore mund të edukohet se çfarë të kërkojnë për të identifi-

kuar viktimat/të mbijetuarit në mesin e klientëve të tyre dhe si e rëndësishme, si të ofrohet mbështetja e duhur e cila mund të jetë thjesht vënie e kontaktit në emër të tyre me policinë ose ofruesit e tjerë të shërbimeve.

Në Australi, gjatë pandemisë COVID-19, policia ishte pro-aktive në identifikimin e grave të cenueshme, veçanërisht ato që kishin raportuar dhunën ose abuzimim më parë dhe bënte vizita të rregullta për të kontrolluar sigurinë e tyre. Kjo duhet të menaxhohet me kujdes për të shmangur krijimin e rrezikut shtesë për gra të tilla.

Sigurohuni që i është bërë plotësisht e qartë personelit tuaj se ata duhet të merren menjëherë dhe në mënyrë efektive me DHNGV-së jo për shkak të saj, por përkundër krizës aktuale - efektiviteti i reagimit duhet të mbështetet përmes dhe përtej situatës së krizës së tanishme.

**Shih Kapitullin 3 për më shumë informacion mbi parandalimin e DAVG-së.**

## KONTAKTI FILLESTAR

Për të ruajtur distancimin shoqëror, mund t'ju duhet të merrni parasysh alternativat për "kontaktin e afërt" duke menduar mënyra të reja që viktimat/të mbijetuarit të raportojnë ose të kërkojnë mbrojtje nga dhuna ose abuzimi, veçanërisht nëse ato janë të izoluar për shkak të kufizimeve të lëvizjes që mund të jenë vendosur. Promovoni përdorimin e linjave të ndihmës dhe nëse ato drejtohen nga policia, merrni parasysh rritjen e niveleve të personelit për të pranuar dhe trajtuar telefonatat.

Zhvilloni ose forconi marrëveshjet me agjencitë/ofruesit e shërbimeve të tjera, sektorin joformal të drejtësisë, grupet e komunitetit dhe komunitetin më të gjerë si fqinjët, miqtë, mbajtësit e dyqaneve, etj, për të lehtësuar mundësitë e raportimit për viktimat/të mbijetuarit. Personeli i vendosur për testimin dhe gjurmimin e rroleve të çdo sëmundjeje infektive mund të sigurojë një lidhje kryesore midis viktimave/të mbijetuarve dhe qasjes së tyre në drejtësi dhe mbështetje, duke e pasur të dhënë që ata janë të informuar siç duhet. Prioriteti juaj numër

një duhet të jetë siguria dhe mbrojtja e viktimës/të mbijetuarit dhe ndonjë prej vartësve të familjes.

Sigurohuni që personeli juaj të jetë plotësisht i informuar për shenjat e dhunës ose abuzimit dhe të jeni vigjilentë për ato gjatë trajtimit me publikun të çështjeve të tjera që nuk lidhen me DHNGV-së.

**Shih Kapitullin 4 për më shumë informacion mbi kontaktin fillestar (qasja në drejtësi)**

## HETIMI

Merrni parasysh metodat alternative të mbledhjes së dëshmive të cilat mund të ndihmojnë në ruajtjen e distancës sociale siç janë zgjidhjet përmes teknologjisë së internetit, ku ju keni qasje në to. Përdorimi i kamerave të trupit me anë të cilave mund të regjistrohet raporti i një viktime/të mbijetuarit, së bashku me dëshmitë e vendit të ngjarjes dhe çdo dëmtim mund të zvogëlojë nevojën për kontakt të afërt. Mos harroni se privatësia dhe konfidencialiteti i viktimës/të mbijetuarit nevojitet ende të ruhet, prandaj merrni parasysh mjedisin edhe kur përdorni zgjidhje teknologjike. Kur nuk keni qasje në burime të tilla, atëherë rreziqet duhet të zbuten sa më shumë që të jetë e mundur duke u mbështetur në PMP-të dhe çdo masë distancimi shoqëror që mund t'i mbështetet asaj.

Do të ishte e dobishme të merret parasysh paraprakisht se ku personeli juaj mund të flasë me një viktimë/të mbijetuar që siguron një 'hapësirë të sigurt' në aspektin e të qenit miqësor ndaj viktimeve/të mbijetuarve, duke siguruar privatësi dhe duke iu mundësuar atyre dhe zyrtarit hetues të zbusin çdo rrezik shëndetësor ndaj njeri tjetrit. Ta keni parasysh ndikimin e traumave, duke shmangur sa më shumë që të jetë e mundur e cila shtohet si rezultat i masave shtesë të ndërmarra si rezultat i krizës në të cilën ju gjendeni.

Nëse një viktimë/i mbijetuar ose kryerësi duhet të transportohet në një automjet policie, atëherë merrni parasysh dezinfektimin e automjetit pastaj, por jo para mbledhjes së ndonjë dëshmie mjekoligjore ose dëshmi tjetër e mundshme prej tij. Si praktikë e mirë është që të pastrohen tërësisht të gjitha automjetet e policisë

në fillim dhe në fund të çdo ndërrimi ose në ndërrimin e përdoruesve të automjeteve gjatë krizës së shëndetit publik, në varësi të rrezikut të asaj krize të veçantë.

**Shih Kapitullin 5 për më shumë informacion mbi hetimin e DHNGV-së**

## MBËSHTETJA DHE NDIHMA

Puna bashkëpunuese është thelbësore gjatë kohës së krizës, kështu që ju duhet të merrni parasysh se si ndonjë nga partneritetet tuaja ekzistuese mund të vazhdojnë të funksionojnë në mënyrë të sigurt ose që vërtetë i zbusin sa më shumë rreziqe të jetë e mundur. Për shkak të distancimit shoqëror, kufizimeve të lëvizjes dhe masave të karantinës ju nevojiten të kërkonit mënyra të tjera për të kontaktuar viktimat/të mbijetuarit dhe për të lehtësuar mekanizmat më pak formal të raportimit për ta, me shumë gjasë përmes agjencive të tjera dhe ofruesve të shërbimeve etj. **Shih Studimin e Rastit në fund të ky kapitull.**

Bashkëpunimi me partnerët e rinj do të kërkojë ngritjen e vetëdijesimit të tyre për shenjat e abuzimit dhe atë që ata duhet të bëjnë për të mbrojtur viktimat/të mbijetuarit, madje edhe ngritjen e nivelit të tyre të vetëdijes se çfarë nuk duhet të bëjnë për të parandaluar infektimin, shkatërrimin ose humbjen e dëshmive do të mbështesë viktimën /të mbijetuarin në afat më të gjatë.

Përcaktoni në një fazë të hershme, mundësisht gjatë çdo procesi të planifikimit të emergjencave ose kontigjencave, se cilat burime ose shërbime të tjera mund të jenë në dispozicion të viktimeve/të mbijetuarve kur aftësia juaj për t'i mbështetur dhe ndihmuar ata mund të komprometohet për shkak të krizës. Për shembull, duhet të supozoni se çdo strehimore ose strehë refugjates ka të ngjarë të ketë kapacitet, kështu që çfarë jeni në gjendje të identifikoni në bashkëpunim me të tjerët në mënyrë të sigurohen vende të sigurta për viktimat/të mbijetuarit. Mendimi dhe planifikimi për raste të tilla do të lehtësojë presionin mbi ju kur jeni në mes të një situatë krize, duke ofruar gjithashtu siguri dhe mbrojtje për ata në nevojë.

**Shih Kapitullin 7 për më shumë informacion mbi Mbështetjen dhe Ndhimën.**

## KOORDINIMI NDËRMJET AGJENCIVE TË DREJTËSISË

Ju duhet të rishikoni dhe aty ku është e përshtatshme të ndryshoni çdo memorandum mirëkuptimi (MM) ose marrëveshje mbi praktikën e punës që mund të kenë me agjencitë e tjera të drejtësisë të cilat, sikurse ju, do të përballen me sfidat e imponuara nga kriza. Si mund të vazhdoni të punoni së bashku për të ofruar shërbime efektive dhe të qasshme të drejtësisë?

Nëse nuk keni ndonjë marrëveshje para-dalëse, mund t'ju duhet të konsideroni krijimin e praktikave urgjente të punës lokale ose të ngrini çështjen në mënyrë minimale përmes zinxhirit tuaj të komandës që të konsiderohet në një nivel strategjik. Nëse nuk keni ndonjë marrëveshje paraprake, mund t'ju duhet të merrni parasysh krijimin e praktikave emergjente të punës lokale ose si minimum të ngritni çështjen përmes zinxhirit tuaj të komandës për tu marrë parasysh në nivelin strategjik.

Qëllimi përfundimtar për ju dhe agjencitë e tjera të drejtësisë edhe më tutje duhet të jetë arritja e drejtësisë për viktimat/të mbijetuarit, kështu që ju duhet të diskutoni dhe të dakordoheni mbi përparësitë për tejkalimin e krizës së tanishme dhe sesi do t'i përshtateni përsëri normalitetit edhe nëse ky është një normalitet i ri atëherë kur të kaluar më e keqja e krizës.

**Shih Kapitullin 8 për më shumë informacion për koordinimin me agjencitë e drejtësisë.**

## KOMUNIKIMET

Mesazhi i qartë, konciz dhe i qëndrueshëm është crucial në çdo kohë, por bëhet **vendimtar** gjatë kohës së krizës. Mbajtja e të gjithëve të informuar është jetike për të siguruar pajtueshmërinë me çdo udhëzim, kufizim ose këshillë sigurie, gjithashtu mund të ndikojë në besimin e komuniteteve lokale në aftësinë e autoriteteve për t'u marrë me krizën. Dhënia e informacionit të saktë dhe të rëndësishëm mund të përmirësojë llogaridhënien dhe qëndrueshmërinë.



Fotografi kortezi e UN Women/Louie Pacardo (Filipine)

Dërgimi i mesazhit duhet të jenë konsistent në të gjithë sektorët dhe kur komunikoni për krizën e jep një mundësi për të siguruar informacion mbi DHNGV-së, duke ngritur vetëdijësimin për rreziqet e rritura dhe duke e bërë të qartë se nuk do të tolerohen edhe gjatë trajtimit të vetë krizës. Po ashtu siguron një mundësi për t'u drejtuar drejtpërdrejt anëtarëve të gjitha komuniteteve për ndihmën e tyre në mbrojtjen e personave të cenueshëm.

Pamjet janë një mënyrë e shkëlqyer për të përcjellë mesazhe përtej së bashku me sloganet, për shembull, në Mbretërinë e Bashkuar gjatë pandemisë COVID-19 #YouAreNotAlone ( ju nuk jeni vetëm)ishin drejtuar viktimave/të mbijetuarve të abuzimit në familje dhe DPI, veçanërisht gjatë kufizimeve të vendosura në lëvizje, ndërsa #NoExcuseForAbuse ( nuk ka arsye për abuzim) kryerësit e shënjestruar. Policia e Kosovës dhe partnerët e tyre (shih rastin studimor) përdorën slogane për efekt të mirë gjithashtu, "Së bashku kundër dhunës në familje" dhe "Familja nuk është një gjë e rëndësishme – por është GJITHÇKA".

Ndani informacionin se cila ndihmë është në dispozicion për viktimat/të mbijetuarit dhe si ta përdorni atë sa më gjerë që të jetë e mundur dhe me mjete të ndryshme, kini kujdes nga çdo mesazh direkt derë më derë pasi mund ta paralajmërojë kryerësin e krimit. Megjithatë, vizita e atyre që janë identifikuar si të cenueshëm, ose kanë qenë viktime të mëparshme të dhunës ose abuzimit dhe tani janë



ribashkuar ose qëndruar me kryerësin e krimit mund të dërgojë një mesazh të fortë se kriza nuk po shpërqendron përgjegjësitë tuaja të sigurisë dhe mbrojtjes, duke parandaluar potencialisht kryerësin nga kryerja e abuzimit të mëtejshëm. Kjo taktikë duhet të trajtohet me shumë kujdes, në mënyrë që të mos vihet personi i pambrojtur në rrezik shtesë në pajtim me parimin 'mos bëj dëm'.

Dërgimi i mesazhit jo vetëm që duhet të jenë konsistent, por po ashtu duhet të jenë i qëndrueshëm gjatë gjithë krizës dhe pas saj, mos lejoni që personeli juaj të heqë 'vëmendjen' kur kriza e tanishme të ketë mbaruar. Ne e dimë nga përvoja se dhuna dhe abuzimi nuk ndalen vetëm sepse situata mund të ketë ndryshuar (shih pjesën për DHNGV të lidhura me konfliktin në Kapitullin 13).

### Shih Kapitullin 9 për më shumë informacion mbi komunikimin.

Policimi gjatë kohëve të krizave mund të sjellë sfida shtesë për ne, disa prej të cilave mund të mos i kemi hasur më parë.

- si do të gjeni një ekuilibër midis sigurimit të pajtueshmërisë me çdo këshillë, udhëzim ose kufizim të qeverisë dhe vazhdimin të zhvillimit dhe/ose ruajtjes së besimit dhe konfidencës së komunitetit lokal?
- si do ta mbani personelin tuaj përgjegjës për çdo abuzim të pretenduar të autoritetit?
- a jeni siguruar që i gjithë personeli juaj të jetë i vetëdijshëm për ndikimet e mundshme afatgjate në ndonjë prej abuzimeve të autoriteteve?
- si do të siguroheni që publiku të ketë akoma qasje në mekanizmat e ankesave, veçanërisht gjatë çdo udhëzimi të lëvizjes që mund të jetë imponuar?
- a e keni bërë tërë personelin tuaj të vetëdijshëm për pritjet dhe standardet tuaja të shërbimit të kërkuara së bashku me përgjegjësinë e tyre individuale për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe për t'iu përfaqësuar ju dhe organizatën tuaj policore me profesionalizëm dhe integritet?

Mos prisni që një krizë të bëhet realitet para se ta merrni parasysh dhe ta planifikoni përgjigjen tuaj, suksesi juaj do të varet nga ajo.

## PANDEMIA (COVID-19)

Të dhënat e mbledhura nga sistemi i OKB-së nga tremujori i parë i vitit 2020 japin dëshmi konkrete se ndikimi i pandemisë COVID-19 ka implikime shumëdimensionale në përhapjen e DNVG-së. Implikimet afatshkurtra lidhen me masat e menjëhershme dhe të detyrueshme të karantinës të obliguara për popullatën si një mjet për të kontrolluar përhapjen vdekjeprurëse të COVID-19 dhe për të minimizuar ndikimin në shërbimet shëndetësore emergjente. Këto masa kanë çuar në nivele më të larta të stresit në marrëdhëniet ndërnjerëzore brenda familjeve dhe ekonomive familjare të cilat janë zhvilluar me veprime të intensifikuara të DNVG-së.

### Kutia 2

Në fund të vitit 2020, UNODC publikoi përmbledhjen kërkimore si më poshtë, e cila siguron një analizë sistematike të dhënave sasiore të drejtësisë penale dhe shërbimit të emergjencës gjatë fazave të hershme të krizës COVID-19. Më poshtë janë disa nga gjetjet kryesore të saj:

- raportimi i përdhunimit dhe sulmit seksual tek autoritetet u zvogëluar, duke sugjeruar një reduktim të raportimit të dhunës në institucionet e drejtësisë penale dhe një rënie të mundshme të numrit të incidenteve jashtë sferës familjare. Megjithatë, dhuna e raportuar u kthye në nivelet e mëparshme pasi masat e izolimit u lehtësuan.
- më shumë gra iu drejtuan linjave të ndihmës. Rritja e thirrjeve ishte më e madhe aty ku masat ishin më të rrepta. Në disa vende, megjithatë, nuk ka pasur ndryshime të rëndësishme në numrin e grave që kërkojnë ndihmë.
- në përgjithësi, ndikimi ishin të ndryshme përgjatë vendeve. Aty ku ndryshimet ishin të identifikueshme gjatë mbylljes, situata u kthye me shpejtësi në nivelin e saj alarmant para-pandemisë atëherë kur masat u lehtësuan.

Për familjet me anëtarë me aftësi të kufizuara, masat e detyrueshme të karantinës mund të çojnë në stres të shtuar si rezultat i një humbje të përkohshme të një

ofruesi ose shërbimi të jashtëm të kujdesit ose sepse ata nuk mund të përballojnë më të paguajnë për ndihmë shtesë për shkak të ndikimit ekonomik të shkaktuar nga COVID-19.

Viktimat/të mbijetuarit e DHNGV-së e gjejnë veten të izoluar nga njerëzit dhe burimet që i ndihmojnë ata dhe/ose kanë parandaluar shfaqjen ose rishfaqjen e dhunës. Për shembull, në mars 2020, UN Women kanë dokumentuar një rritje të raportimit të dhunës në familje që kur urdhrat e tyre përkatës të mbylljes u komunikuan në Francë (30%), Argjentinë (25%), Qipro (30%) dhe Singapor (33%).<sup>11</sup> Për më tepër, vende të tilla si Kanadaja, Gjermania, Spanja, Britania e Madhe dhe SHBA kanë raportuar një rritje të rasteve të dhunës në familje, si dhe kërkesa për strehimore emergjente.<sup>12</sup>

Anasjelltas, masat e mbylljes dhe kufizimet në lëvizje gjithashtu mund të ndikojnë në aftësinë e viktimave/të mbijetuarve të DHNGV-së për të raportuar raste ose për t'i shpëtuar përkohësisht partnerëve abuzivë. Për shembull, një linjë ndihme për dhunën në familje në Itali raportoi se kishte marrë 55% më pak telefonata në dy javët e para në mars sepse shumë viktimat/të mbijetuar e kishin të vështirë të kërkonin ndihmë gjatë mbylljes.<sup>13</sup> Abuzuesit janë në gjendje të kontrollojnë dhe izolojnë viktimat e tyre shumë më lehtë në disa raste. Skenarë të tillë japin një pamje të pasaktë të mbizotërimit aktual të DHNGV-së gjatë masave të reagimit ndaj COVID-19, të cilat mund të ndikojnë në mënyrën se si policia dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve thelbësore menaxhojnë prioritetet e krizës dhe ndajnë burimet.

## Ngjashmëritë midis krizës së shëndetit publik dhe ndikimit të tyre të menjëhershëm në policim

Bazuar në dëshmitë e shumta nga përvoja aktuale e COVID-19, e kombinuar me informacionin nga krizat humanitare nga e kaluara dhe e tashmja, të tilla si konf-

11 COVID-19 and Ending Violence Against Women and Girls. UN Women Issue Brief April 2020, at: <https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/04/issue-brief-covid-19-and-ending-violence-against-women-and-girls>

12 Po aty.

13 Po aty.

**“Epidemitë e kaluara janë shoqëruar me rritje të dhunës me bazë gjinore (GBV), duke sugjeruar që modele të ngjashme mund të ndodhin tani. Sipas dokumentit punues të Qendrës për Zhvillimin Global (QZHG), shpërthimet e Ebola (në Afrikën Perëndimore dhe RDK), Kolera (në Jemen) dhe Zika (në Karaibe, Amerikën Qendrore dhe Jugore) lidhen me rritjen e DPI-së dhe dhunës seksuale ndaj së pari respondentëve dhe punonjësve e kujdesit shëndetësor, veçanërisht grave infermiere.”**

Drejtësi për Gratë në kohën e COVID-19  
(publikim i UN Women, 2020).

liktet e armatosura, fatkeqësitë natyrore dhe/ose krizat e shëndetit publik (të tilla si shpërthimi i Ebola), rritjet e kimit dhe dhuna është veçanërisht e vërtetë për DHNGV.<sup>14</sup> Për shembull, Peterman, A. et al (2020) dokumentuan se dy vjet pas tërmetit të Haitit në vitin 2010, gratë që jetonin në zona me shkatërrim më të madh nga tërmeti kishin raportuar nivele më të larta të DPI-së fizike dhe seksuale, duke cituar faktorë të mundshëm ekonomikë dhe social.<sup>15</sup>

Kur kërkohet zbatimi i masave të detyrueshme të mbylljes dhe kufizime të jashtëzakonshme në lëvizjen publike përfshirë kufijtë kombëtar ose rajonal, më i shpeshtë është rasti ku roli i policisë gjatë rrethanave të tilla të mos jetë i përcaktuar mirë dhe/ose i përcaktuar në PSO -të ekzistuese. Kjo e bën të vështirë trajnimin dhe përgatitjen paraprakisht, që do të thotë se disa organizata policore në kohë krize mund të mos jenë të përgatitura për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive një rritje të rrezikut të DHNGV-së. Për më tepër,

14 Shih Weitzman, A., and J.A. Behrman (2016): ‘Disaster, Disruption to Family Life and Intimate Partner Violence: Rasti i tërmetit të vitit 2010 në Haiti’. *Sociological Science*, 3: 167-189 në Pandemitë dhe Dhunën ndaj Grave dhe Fëmijëve (2020). Peterman, A., Potts, A., O'Donnell, M., Thompson, K., Shah, N., Oertelt-Prigione, S., dhe van Gelder, N., Qendra për Zhvillimin Global, në: <https://www.cgdev.org/publication/pandemics-and-violence-against-women-and-children>

15 COVID-19 dhe dhënia fund dhunës ndaj grave dhe vajzave. (Punim i publikuar nga UN Women,) prill 2020, në: <https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/04/issue-brief-covid-19-and-ending-violence-against-women-and-girls>

ndikimi në aftësinë e tyre për të siguruar që ndihma dhe format e pjesëmarrjes nuk janë diskriminuese në bazë të faktorëve ndërthurës siç janë etnia dhe aftësia e kufizuar.

Policia dhe aktorët e sektorit të drejtësisë të kombinuar me trendet e tjera të krimit në zhvillim, mund të jenë te ngulfatura kur reagojnë ndaj trazirave publike dhe krimeve të tjera veçanërisht atyre që rezultojnë nga pasojat ekonomike dhe sociale të krizës. Kapaciteti i zgjeruar i shërbimeve të reagimit ka të ngjarë të dobësojë mbrojtjen dhe mbështetjen në dispozicion për viktimat/të mbijetuarat e DHNGV-së dhe format e tjera të krimit dhe dhunës, duke kontribuar në perceptimin e shtuar të pandëshkueshmërisë midis kryerësve.<sup>16</sup>

Në rastin e krizës së shëndetit publik që rezulton nga shpërthimi i një sëmundjeje infektive, kur policia dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve thelbësore reagon ndaj DHNGV-së ata duhet të marrin parasysh rekomandimet për distancimin shoqëror. Kjo do të sfidojë policinë dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve thelbësore për të reaguar në mënyrë efektive ndaj veprimeve të raportuara të DHNGV-së (shih udhëzuesin kolegu-kolegut për informacion të detajuar). Për shembull, policia reaguese do të jetë natyrisht e kujdesshme për të hyrë në shtëpitë që kanë raportuar DPI nga shqetësimi për kontraktimin e sëmundjes infektive ose virusi.

Zyrtarët reagues mund t'i anashkalojnë protokollet duke përfshirë vlerësimet e detyrueshme (viktimat pretenduese) të rrezikut ose të mos reagojnë fare në mënyrë që të minimizojnë çdo kontakt të mëtejshëm ndërpersonale. Ky mund të jetë rasti i mundshëm kur organizata policore nuk është në gjendje të sigurojë zyrtarët e vijës së parë me format e duhura të pajisjeve mbrojtëse personale ose PMP.

Sipas UNDP (2015), zyrtarët e policisë kishin më pak gjasa të vlerësonin rastet e DPI-së si prioritet të lartë për arrestimin dhe ndalimin gjatë shpërthimit të



Fotografi kortezi e UNMEER/Samuel Shilajiru (Liberi)

Ebolas në Afrikën Perëndimore, veçanërisht pasi zyrtarët e policisë hezituan të hynin në shtëpi dhe të kryenin hetime të plota pa rrezik të ekspozimit ndaj sëmundjes dhe përhapjes së infektimit tek anëtarët e familjes.<sup>17</sup>

Qendrat e burgimit, ato korrektuese dhe objektet e paraburgimit të gjitha do të bëhen zona me shqetësim të lartë për autoritetet, duke pasur parasysh mbipopullimin e tyre dhe shëndetin e dobët të burgosurve në shumë vende. Kjo mund të rezultojë në norma më të ulëta të bindjes si një mjet për të mos rritur madhësinë e numrit të burgosurve.

Në disa raste, kryerësit e DHNGV-së madje mund të lirohen si pjesë e masave të krizës emergjente të cilat, në fund, i vënë gratë dhe fëmijët në rrezik më të madh të dhunës. Në raste të tilla, UNODC u bën thirrje shteteve që të vlerësojnë dhe adresojnë rreziqet e sigurisë së viktimave/të mbijetuarve në vendimet në lidhje me lirimimin dhe masat e tjera jo të ndalimit, siç janë lirimi me kaucion, lirimi i përkohshëm, lirimi alternativ, veçanërisht kur kemi të bëjmë me shkelësit përsëritës dhe të rrezikshëm, si dhe sigurojnë të

<sup>16</sup> Dimensionet Gjinore të Pandemisë COVID-19 (Grupi i Bankës Botërore, 2020), në: <http://documents.worldbank.org/curated/en/618731587147227244/Gender-Dimensions-of-the-COVID-19-Pandemic>

<sup>17</sup> Pandemitë dhe Dhuna ndaj Grave dhe Fëmijëve (2020). Peterman, A., Potts, A., O'Donnell, M., Thompson, K., Shah, N., Oerfelt-Prigione, S., dhe van Gelder, N., Qendra për Zhvillimin Global, në: <https://www.cgdev.org/publication/pandemics-and-violence-against-women-and-children>

drejtën e viktimave për t'u informuar për lirimin e agresorit nga paraburgimi ose burgimi.<sup>18</sup>

sNë këtë drejtim, zyrtareve të lirit të përshoshëm mund t'u kërkohet të japin prioritet distancimit shoqëror dhe të komunikojnë përmes thirrjes me zë ose me video, gjë që mund të kufizojë aftësinë e tyre për të vlerësuar plotësisht gjasat e recidivizmit, duke përfshirë ato që mund t'i vënë viktimat/të mbijetuarit në rrezik të shtuar.<sup>19</sup>

Për më tepër, mbyllja e shkollave të cilat mund të jenë burime të zbulimit rutinor dhe referime për abuzim dhe keqtrajtim të mundshëm të fëmijëve, do të kufizojë aftësinë e policisë për të llogaritur në rrjetet arsimore dhe ato të komunitetit për të reaguar ndaj DHNGV-së. Në Afrikën Perëndimore, mbyllja e shkollave për shpërthimin e Ebolës i ekspozoi vajzat ndaj shfrytëzimit seksual dhe dhunës dhe çoi në një 'rritje të mprehtë' të shtatzënive adoleshente dhe martesave të hershme në disa zona të cënueshme, për shkak të rritjes së shkallës së braktisjes së shkollës nga vajzat.<sup>20</sup>

**“Për herë të parë, IDMC ka vlerësuar numrin e përafërt të njerëzve që mbeten të zhvendosur brenda vendit si rezultat i fatkeqësive në 95 vende: 5.1 milion deri më 31 dhjetor 2019. “**

- Qendra e Monitorimit të Zhvendosjes së Brendshme (2020)

Në mënyrë të ngjashme, ndikimi financiar i krizave shëndetësore ose humanitare do të ndikojë gjithashtu në kapacitetin e organizatave të grave lokale, shpesh partnerë kryesorë për strategjitë parandaluese të politikës DHNGV-së për të ofruar shërbime për viktimat/të

mbijetuarat në një afat të gjatë. Organizatat vendore të grave luajnë role kyçe në identifikimin e ndryshimeve të shpejta në normat gjinore të cilat mund të nxisin forma të ndryshme të DHNGV-së, të tilla si rritja e martesës së detyruar dhe/ose fëmijëve dhe shkalla e DPI-së përfshirë dhunimin martesor në kushte krize.<sup>21</sup>

Në rastin e martesës së hershme ose të dhunshme, dëshmitë nga konteksti emergjent dhe humanitar, tregojnë se ndërsa rrjetet sociale bëhen jo të shëndosha, familjet dhe komunitetet mund të demonstrojnë një dëshirë të shtuar për të kontrolluar seksualitetin e vajzave dhe për të mbrojtur “nderin” e tyre. Si rezultat, martesë shihet shpesh për të mbrojtur vajzat dhe familjet e tyre nga stigma sociale që mund të rezultojë nga përjetimi i përdhunimit ose sulmit seksual.<sup>22</sup> Në krizat humanitare që vijnë nga konflikti i armatosur, kampet e refugjatëve/zhvendosjes dhe zonat e ndihmës humanitare janë shpesh zona të vështira për policim, veçanërisht kur zbatohen strategjitë e parandalimit të krimit që kërkojnë partneritet me komunitetet dhe ndërtimin e besimit. Në mjedise të tilla, dëshmitë e forta tregojnë se normat e DHNGV-së rriten sa më gjatë që anëtarët e familjes janë në afërsi në kushtet e detyrimit.<sup>23</sup>

Në kombinim me krizën e shëndetit publik që buron nga shpërthimi i një sëmundjeje infektive dhe vështirësitë e saj ekonomike, rreziku i dhunës me të cilin përballen gratë dhe vajzat që jetojnë në situata tashmë të pasigurta duhet të bëhet një përparësi për policinë dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve thelbësore. Kjo do të kërkojë që policia (dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve thelbësore) të përshtatin me të shpejt strategjitë e ndërhyrjes për të siguruar një reagim efektiv me protokollat e respektuara

18 Reagimi ndaj sëmundjes së koronavirusit (COVID-19) – UNODC Përmbledhje tematike mbi dhunën me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave (UNODC, 2020), në: [https://www.unodc.org/documents/Advocacy-Section/GBVAW\\_and\\_UNODC\\_in\\_COVID19\\_final\\_7Apr2020.pdf](https://www.unodc.org/documents/Advocacy-Section/GBVAW_and_UNODC_in_COVID19_final_7Apr2020.pdf)

19 Pandemitë dhe Dhuna ndaj Grave dhe Fëmijëve (2020). Peterman, A., Potts, A., O'Donnell, M., Thompson, K., Shah, N., Oertelt-Prigione, S., dhe van Gelder, N., Qendra për Zhvillimin Global, në: <https://www.cgdev.org/publication/pandemics-and-violence-against-women-and-children>

20 Ndikimi i Pandemisë COVID-19 në Dhunën ndaj Grave dhe Vajzave (2020), Fraser, E. (2020) for UKAid, WAG Raporti humlues i tavolinës ndihmëse, në: <https://www.dmeformpeace.org/peaceexchange/wp-content/uploads/2020/04/vawg-helpdesk-284-covid-19-and-vawg.pdf>

21 Në vijën e parë të COVID-19, Organizatat e Grave ofrojnë shërbime vitale si reaguese të para si dhuna kundër grave (UN Women, 2020), në: <https://www.unwomen.org/en/news/stories/2020/5/feature-womens-organizations-provide-vital-services-as-violence-against-women-spikes>

22 COVID-19 dhe Fëmija, Martesa e Hershme dhe e Detyruar: Axfenda për Veprim (Vajzat Jo nuse, Partneriteti Global për t'i dhënë fund martesës së fëmijëve 2020), në: [https://www.girlsnotbrides.org/wp-content/uploads/2020/04/COVID-19-and-child-early-and-forced-marriage\\_FINAL-4.pdf](https://www.girlsnotbrides.org/wp-content/uploads/2020/04/COVID-19-and-child-early-and-forced-marriage_FINAL-4.pdf)

23 Pandemitë dhe Dhuna ndaj Grave dhe Fëmijëve (2020), Peterman, A., Potts, A., O'Donnell, M., Thompson, K., Shah, N., Oertelt-Prigione, S., dhe van Gelder, N., Qendra për Zhvillimin Global, në: <https://www.cgdev.org/publication/pandemics-and-violence-against-women-and-children>

pa diskriminim, duke siguruar në të njëjtën kohë masa të sigurisë personale për oficerët reagues.

Përshtatja e strategjive të ndërhyrjes gjithashtu nënkupton përshtatjen e masave të llogaridhënies dhe transparencës. Zbatimi i **analizës gjinore** në zhvillimin dhe planifikimin e strategjive të reja të ndërhyrjes do të jetë me rëndësi vendimtare për të marrë parasysh ndikimin diferencial që ato mund të kenë te gratë, burrat, djemtë dhe vajzat. Lidhur me këtë, mekanizmat e raportimit për sjelljen e keqe të policisë dhe keqpërdorimin e forcës gjithashtu duhet të përshtaten për të siguruar që ato të vazhdojnë të jenë të arritshme dhe të disponueshme për popullatën pa diskriminim gjatë zbatimit të masave qeveritare të krizës së shëndetit publik dhe/ose krizës humanitare.



Analiza gjinore është një ekzaminim vendimtar se si ndryshimet në rolet, aktivitetet, nevojat, mundësitë dhe të drejtat/titujt ndikojnë tek burrat, gratë, vajzat dhe djemtë në situata ose kontekste të caktuara.

Përvoja e pandemisë COVID-19 ka bërë të qartë cenueshmëritë që janë të përbashkëta dhe të ndara nga të gjithë, pavarësisht vendbanimit, kundër një krize globale të shëndetit publik. Peterman, A. et al (2020) siguron që ekspertët të parashikojnë që sëmundjet zoonotike<sup>24</sup> dhe shpërthimet do të vazhdojnë të shfaqen si rezultat i rritjes së shkallës së rritjes dhe ndërlikohjes së popullsisë globale dhe konsumit dhe cenimit që rezultojnë në mjedis.<sup>25</sup> Peterman, A. et al, shton se bazuar në përvojat e kaluara, shpërthimet e sëmundjeve infektive si COVID-19, Ebola ose Zika çojnë në një rritje të stigmës, ksenofobisë dhe diskriminimit. Këta faktorë pa dyshim do të zvogëlojnë dhe/ose do të minojnë ndjeshëm përp-

24 Gati 75 përqind e sëmundjeve që shfaqen, përfshirë ato që shkaktojnë shumicën e pandemisë, kanë origjinën nga kafshët dhe transmetohen tek njerëzit (të referuara si sëmundje zoonotike). Shih Jones, K.E., Patel, N., Levy, M., Storeygard, A., Balk, D., Gittleman, J.L. et al. (2008). Tendencat globale në shfaqjen e sëmundjeve infektive. *Natyra* 451: 990-94.

25 Pandemitë dhe Dhuna ndaj Grave dhe Fëmijëve (2020), Peterman, A., Potts, A., O'Donnell, M., Thompson, K., Shah, N., Oertelt-Prigione, S., and van Gelder, N., Qendra për Zhvillim Global. në: <https://www.cgdev.org/publication/pandemics-and-violence-against-women-and-children>

jekjet për parandalimin dhe ndërhyrjen e DHNGV-së (shih Kapitullin 2: 'Parandalimi' për udhëzim).

Informacioni narrativ sugjeron që gratë nuk kanë qenë në gjendje të kenë qasje të sigurt në ndihmë- në thirrjen e policisë ose qasje në mbështetjen e specialistëve për shkak të vetë-izolimit nga një shpërthim infektiv me kryerësin (it). Në fakt, Peterman, A. et al, raportojnë se gratë në përgjithësi kanë më pak gjasa të kërkojnë shërbime për shërbimet shëndetësore të nënave dhe të porsalindurve nga frika e infeksionit dhe potencialit për transmetimin e virusit tek familjet e tyre.<sup>26</sup>

Në mënyrë të ngjashme, gratë nuk mund të raportojnë partnerët e tyre intim abuziv nga frika se çdo formë e ndalimit do të rrisë rrezikun e infektimit për të, atë dhe fëmijët e tyre.

## RËNDËSIA E DORACAKUT TË GRAVE POLICE DHE ESP

Doracaku inkurajon organizatat policore që të fillojnë transformimin e tyre drejt një ofruesi të shërbimeve thelbësore drejt çështjeve gjinore, duke vendosur **një kuptim të të informuarit të mirë<sup>27</sup> të natyrës të VAWG, arsyt dhe pasojat të cilat ndikojnë në mënyrë të ndryshme dhe disproporcionale te gratë dhe vajzat** në tërë organizatën.

**Shih Kapitullin 10: "Ndërtimi i institucioneve për një përgjigje Efektive dhe të Përgjegjshme ndaj VAWG" dhe Kapitulli 11' Sfidat dhe Strategjitë për Zbatimin e Policisë me Përgjegjësi ndaj Çështjeve Gjinore 'mbi udhëzimin për vendosjen e një mirëkuptimi të përbashkët.**

Vendosja e një kuptimi të përbashkët e VAWG brenda një organizate policore do ta pozicionojë atë që t'i përg-

26Pandemitë dhe Dhuna ndaj Grave dhe Fëmijëve (2020). Peterman, A., Potts, A., O'Donnell, M., Thompson, K., Shah, N., Oertelt-Prigione, S., dhe van Gelder, N., Qendra për Zhvillim Global, në: <https://www.cgdev.org/publication/pandemics-and-violence-against-women-and-children>

27 Për qëllimet e Doracakut, mjetet e nformimit të mirë do të thotë se është kontekstualisht i rëndësishëm dhe me kontribut të rregullt i përbërë nga të dhënat cilësore dhe sasore të siguruar nga ekspertët e policisë dhe akterët e jashtëm, si ofrues të shërbimeve thelbësore dhe/ose organizatave të shoqërisë civile.



Foto e çastit UN Women/Louie Pacardo (Filipine)

jigjet dhunës dhe një krimi të tillë në mënyrë më efektive, madje edhe gjatë krizave. Në të kundërtën, mungesa e një kuptimi të tillë në mënyrë tipike kufizon aftësinë e

oficerëve të cilët përgjigjen për të kuptuar madhësinë e problemit gjatë krizave dhe të bien në grackën e mos vërejtjes të përgjigjeve nga ana e VAWG si shpëtimtare. Gjatë krizave humanitare dhe atyre të shëndetit publik, ndikimi negativ i këtij kufizimi është shumëfishuar.

Në rast të masave të izolimit dhe karantinës të miratuara nga Qeveritë, si përgjigje ndaj një pandemie/epidemie, si COVID-19 ose Ebola për shembull, instrumentet e praktikuara dhe të mirënjohura si Rrota e Fuqisë dhe e Kontrollit<sup>28</sup> mund të miratohen për të ndihmuar policinë dhe partnerët e tyre të shërbimit esencjal për t'i analizuar dinamikat e reja të dhunës të cilat ndikojnë te gratë dhe vajzat. Rrota e Fuqisë dhe e Kontrollit i lejon ekspertët e shërbimeve esenciale duke përfshirë Policinë, që t'i kuptojnë taktikat të cilat i përdorin kryerësit për të marr fuqinë dhe kontrollin mbi viktimat/të mbijetuarit e tyre.

**Kutia 3**

**Rrota e parë e Fuqisë dhe Kontrollit**



**Rrota e Fuqisë dhe Kontrollit e Përshtatur për Emigrantë**



Burimi: Rrota të Marra nga Modeli : Rrota e Fuqisë dhe Kontrollit. Qendra Kombëtare për Dhunë në Familje dhe Seksuale.

28 Fillimisht, zhvilluar nga Programet e Ndërhyrjes ndaj Dhunës në Familje në Duluth, MN (SHBA), por aktualisht përdoret nga ofruesit e shërbimeve esenciale në nivel global Gjinor. Në këtë Doracak për më shumë informata shih Kapitullin 11: 'Sfidat dhe Strategjitë për Zbatimin e Policimit.

Ky instrument është i pranueshëm dhe tanimë është shëndrruar në “rrota” të shumta në mënyrë për t’i kuptuar më mirë situatat e ndryshme të cenueshmërisë ndaj grave dhe vajzave<sup>29</sup>. Për shembull, instrumenti është pranuar për të kuptuar mënyrën se si veprojnë kryerësit e dhunës ndaj grave dhe vajzave emigrante (shih më poshtë Kutinë 3) dhe personat me aftësi të kufizuara dhe kujdestarët e tyre.<sup>30</sup>

Duke i përshtatur në mënyrë aktive mjetet e tilla si Rrota e Fuqisë dhe Kontrollit në kontekstin e tyre lokal me përvojë në kriza humanitare/shëndetësore publike, Policia do të ketë më shumë mundësi t’i identifikojë modelet e reja të VAWG lidhur me ata shkaktarë si pasigurisat e shtuar ekonomike, papunësia e papritur ose e vazhduar ndërmjet grave dhe burrave, dhe strategjitë negative të ballafaqimit të cilat burojnë nga masat e karantinës (për shembull).

Duke e përshtatur kuptimin e saj të përbashkët për VAWG në kontekstin e ri që buron nga krizat, një organizatë e Policisë do të pozicionohet më mirë për të zbatuar një përgjigje efektive dhe proporcionale ndaj rreziqeve dhe nevojave. Kutia 4 (më poshtë) paraqet disa shembuj të proaktivitetit të policisë për t’iu përgjigjur VAWG-së gjatë masave të detyrueshme të karantinës të COVID-19.

#### Kutia 4

##### Veprim Proaktiv nga Policia Gjatë ‘Mbylljeve’ - Evropë

Policia **Irlandeze** dhe Shërbimi i Sigurisë ose An Garda Síochána ka shtuar përpjekjet përmes Operacionit të tyre Faoiseamh për t’i siguruar viktimat/të mbijetuarit se “incidentet e keqtrajtimit në familje, duke përfshirë kontrollin e detyruar, do të vazhdojnë të marrin përgjigjen prioritarë më të lartë për shërbimin”. Operacioni Faoiseamh, si përgjigje e angazhimit të

<sup>29</sup> Shih ‘Rrotat’ e Miratuara nga Modeli Rrota e Fuqisë dhe Kontrollit. Qendra Kombëtare për Dhunë në Familje dhe Seksuale, në: [http://209.198.129.131/publications\\_wheel.html](http://209.198.129.131/publications_wheel.html)

<sup>30</sup> Shih “Rrota e Fuqisë dhe Kontrollit: Personat me Aftësi të Kufizuara dhe Kujdestarët e tyre” Marr nga Modeli Rrota e Fuqisë dhe Kontrollit. Qendra Kombëtare për Dhunë në Familje dhe Seksuale. <http://www.ncdsv.org/images/DisabledCaregiverP-Cwheel.pdf>

komunitetit ndaj COVID-19, filloi më 1 prill 2020. Qëllimi i Operacionit është që të parandalojë humbjen e jetëve dhe të sigurojë që viktimat/të mbijetuarit e dhunës në familje të mbështeten dhe mbrohen gjatë masave të detyrueshme të karantinës. Organizatat lokale për mbështetjen e viktimave dhe bamirësitë e mirëpritën nismëm, veçanërisht vazhdimësinë e qasjes dhe disponueshmërinë e Policisë në Zyrën e Shërbimeve për Viktima në mbarë vendin për t’i mundësuar kontaktet telefonike me viktimat/të mbijetuarat e mëparshme të dhunës në familje, për të konstatuar ndonjë çështje ekzistuese shqetësuese.

Në **Francë**, Kompania e Xhandarmërisë Lille i ka rihapur të gjitha rastet e dhunës në familje në muajt e fundit (përfshirë ato që janë trajtuar nga sistemi i drejtësisë penale). Njësitë e përkushtuara të Policisë i kontaktojnë me telefon personat si një mjet për të kontaktuar me viktimat/të mbijetuarat e VAWG të cilat ndihen të paafta për të kërkuar ndihmë. Në rast të dyshimit si hezitimi me telefon ose mungesa e përgjigjes ndaj pyetjeve, një ekip policor shkon në shtëpinë e viktimës/të mbijetuarës. Nëse oficerët përgjegjës gjejnë dëshmi të dhunës fizike gjatë vizitës, rasti trajtohet shumë shpejt.

Në **Belgjikë**, disa Policë vendor, përmes shërbimit të tyre të ndihmës për viktimat, i kontaktojnë në mënyrë aktive viktimat/të mbijetuarit të cilët kanë paraqitur një ankesë në stacionin policor gjatë tre muajve të fundit në lidhje me veprimet e dhunës në familje. Kjo i lejon policisë vendore që të monitorojë zhvillimin e situatës të tyre kur masat e karantinës mund të monitorohen. Në të njëjtën kohë, Policia i drejtohet në mënyrë aktive shoqatave të ndryshme të përfshira në dhunë në familje për t’i informuar ata mbi planet e tyre të vazhdimësisë të veprimtarisë.

## ANALIZA E TË DHËNAVE DHE E NDIKIMIT PËR NJË PËRGJIGJE EFEKTIVE DHE PROPORCIONALE NDAJ VAWG:

Policia dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve esenciale duhet të përgatisin dhe miratojnë strategjitë e tyre për t'iu përgjigjur VAWG në njohjen e ndikimeve të dëmshme të masave të karantinës dhe izolimit social, siç janë urdhrat për qëndrim në shtëpi ose “mbyllja” që mund të kenë konsideratë të veçantë për grupet shumë të cenueshme, si fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara.

**“Është e rëndësishme që të pranohet se fëmijët të cilët e dëshmojnë keqtrajtimin janë vetë viktimat e dhunës.”**

Përgjigja ndaj Sëmundjes Coronavirus (COVID-19)-Përmbledhje Tematike e UNODC mbi dhunën në bazë gjinore kundër grave dhe vajzave (2020).

Konsideratë e veçantë për grupin shumë të cenueshëm të grave dhe vajzave duhet të faktojë se gratë dhe vajzat nuk janë një grup homogjen dhe se si të tilla ato nuk mund të grupohen të gjitha së bashku kur bëhet fjalë për parandalimin ose trajtimin e dhunës. Kjo vlen njësoj edhe për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara ose pjesëtare të komunitetit LGBTQI

Këto janë aspekte të rëndësishme që Policia duhet të ketë parasysh kur ndërvepron drejtpërdrejtë me gratë dhe vajzat nga komunitetet pakicë, si ato me aftësi të kufizuara ose komunitetin LGBTQI, si dhe me organizatat e tyre përfaqësuese të avokimit.

Prandaj, këto strategji duhet të sigurojnë që thelbi i çdo ndërhyrjeje të bazohet në informim të mirë, qasje të përgjegjshme gjinore, gjithëpërfshirëse dhe ndërlidhëse. Pjesëmarrja kuptimplote e avokatëve që përfaqësojnë të drejtat dhe nevojat e grave dhe vajzave me prejardhje të shumëllojshme dhe aftësive fizike/mendore për ta njoftuar agjendën e sektorit të sigurisë nga e cila janë ndërtuar strategjitë, do të luajë një rol përcaktues.

Pjesëmarrja kuptimplote kërkon që personat të kenë të drejtë të marrin pjesë në vendimet të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë te ata, përfshirë në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e ndërhyrjeve (OBSH, 2019).



Kjo fillon me njohjen e përgjigjeve të VAWG si shpëtimtare me përpjekjet parandaluese të prioritizuara brenda përgjigjeve të krizave të shëndetit publik që në fillim, në mënyrë që të ekzistojnë hapësira të sigurta për të gjitha gratë dhe vajzat, pa diskriminim. Kështu që, është thelbësore që organizatat policore të kenë qasje në burime të qëndrueshme dhe të besueshme të informatave dhe të dhënave mbi atë se cilat popullata janë më të rrezikuara ndaj rritjes së dhunës dhe se si cenohen dobësitë ekzistuese ndërmjet grave dhe vajzave së bashku me rritjen e pabarazive ekonomike ose sociale (përfshirë gjininë, moshën, përkatësinë etnike/racën, paaftësinë, statusin ekonomik, ndër të tjera) të shkaktuara nga krizat.

Më poshtë është lista e elementeve e cila duhet të përfshihet në analizën e ndikimit kur kontekstualizohen përpjekjet dhe shërbimet parandaluese në planet e reagimit të VAWG në shpërthimin e sëmundjeve infektive dhe krizave humanitare:

### Komunikimi i Zgjeruar i Jashtëm i Disponueshëm në Modalitete të Ndryshme

- Derisa qeveritë do të synojnë t'i informojnë komunitetet mbi masat e sigurisë të shëndetit publik dhe për të ndërtuar ndërgjegjësimin në situatë të krizave, modalitetet e ndryshme do të përdoren për të siguruar arritjen maksimale. Kjo mund të shtrijë një gamë nga fushat kibernetike (kur është e duhur)<sup>31</sup>, transme-

31 Kalimi në mbështetjen online sjell sfida, jo më pak duke trajtuar ndarjen e madhe globale teknologjike dixhitale. Përfshirja dixhitale i bazuar në çështje gjinore përmban shumë arsye. Pengesat për qasje, përballueshmëri, (mungesën) e arsimit dhe aftësive dhe shkrim-leximin teknologjik, dhe paragjykimet e natyrshme gjinore dhe normat socio-kulturore, janë në rrënjë të përfshirjes dixhitale të bazuar në gjini. Qasja e zgjeruar, më e sigurtë dhe më e përballueshme në mjetet digjitale është kritike, siç janë ndërhyrjet e politikave të cilat i adresojnë paragjykimet strukturore afatgjata. Shih: <http://www.oecd.org/internet/bridging-the-digital-gender-divide.pdf>



## Kutia 5

### UNICEF: Jo vetëm linjat telefonike direkte dhe telefonat mobil: Ofrimi i Shërbimit DhBGj gjatë COVID-19



Përderisa pronësia dhe qasja në telefon mobil është rritur globalisht, veçanërisht në mjedise me të ardhura më të ulëta, gratë kanë akoma më pak gjasa se burrat të posedojnë një telefon. Është vlerësuar se janë 443 milion gra të moshës madhore “të shkëputura” nga bota.

UNICEF përcakton një numër të pikave alternative të hyrjes për t’u ofruar viktimave/të mbijetuarve që janë pa telefon, të dobëta ose pa teknologji fare për t’i paralajmëruar palët e interesuara të besueshme për nevojën e tyre për shërbime të dhunës në bazë gjinore (DhBGj) duke pasur parasysh kufizimet në lëvizje, si rezultat i COVID-19. Ato përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- **Pranimin e hapësirave ekzistuese fizike të sigurta për gratë dhe vajzat në stacionet e kabinave të telefonisë për DhBGj.** Stacionet e tilla mund të veprojnë si hapësira të sigurta kur ato janë të pajisura me një seri kablnash/ telefoni private të ndërtuara thjesht ku viktimat/të mbijetuarit mund të thërrasin ofruesit e shërbimeve esenciale, përfshirë policinë, të cilët janë në gatishmëri në oraret e caktuara dhe pranojnë mbështetje. Ato mund të vendosen në zona të kongregacionit siç janë tregjet dhe dyqanet;
- **Krijimin e pikave dhe sistemeve hyrëse ku viktimat/të mbijetuarit mund të kenë qasje ose mund të sinjalizojnë një nevojë për mbështetje duke aktivizuar një ‘zinxhir alarmimi’.** Këto mund të përfshijnë ndihmën ‘pop-up’ në zonat e lejuara ose shërbimet e hapura - p.sh. farmacitë, dyqanet ushqimore/tregjet ushqimore/pikat e shpërndarjes të ushqimit/stacionet e pompave të ujit, etj. ku të mbijetuarat mund të lajmërojnë Policinë në terren dhe ofruesit e tyre të shërbimeve thelbësore për mbështetje;
- **Promovimin** mbi vigjilencë të sinjalit të teknologjisë së ulët. Veçanërisht e dobishme në mjediset humanitare/me të ardhura të ulëta, ku një objekt alarmi (p.sh. një pëlhurë me ngjyrë për veshje) mund të përfshihet në kostumet e dinjitetshme që marrin gratë dhe vajzat nëse shpërndarjet janë duke vazhduar. Sinjalizimet e ulëta të teknologjisë mund të përfshijnë gjithashtu fjalë me kode, sinjalizues/alarme, vendosjen e objekteve të padëmshme jashtë shtëpisë p.sh. një leckë/kovë të caktuar me ngjyra, etj. e cila mund të paralajmërojë policinë lokale, organizatat e grave/anëtarët kryesorë të komunitetit për mbështetje.

#### **Konsiderata të rëndësishme të zbatueshme për policinë kur veprojnë në kontekste me opsione të ulëta ose pa teknologji:**

- Shqyrtimi me kujdes, përzgjedhja, trajnimi i punonjësve të policisë që përgjigjen/punonjësve të tjerë kryesorë që menaxhojnë shërbimin, përfshirë çdo ndryshim në funksionimin e rrugës së referimit të DhBGj për të siguruar koordinim efektiv me ofruesit e ekspertëve, siç janë ata në ofrimin/këshillimin e strehimit emergjent;
- Viktimat/të mbijetuarit nuk duhet të detyrohen të bëjnë një kallëzim penal kundër abuzuesit të tyre si kusht për mbështetje të vazhdueshme nëse shërbimi shoqërohet me policinë ose shërbimet zyrtare të sigurisë;
- Planifikimi me kujdes i vendosjes dhe shpërndarjes/promovimit të shërbimeve që balancojnë arritjen e numrit më të madh të të mbijetuarve, kundër rrezikut që kryerësit të jenë në gjendje të përdorin njohuritë e sistemit për të penguar më tej qasjen e viktimave/të mbijetuarve në të. Një shembull mund të jetë promovimi i sistemit të gratë dhe vajzat kur bëni shpërndarje të artikujve të tillë vetëm për grate, si pajisje ushqimi ose kostume të dinjitetshme;

- Mbrojtja e fuqishme e të dhënave dhe politikat dhe proceset e privatësisë;
- Koordinimi me ‘qarqet e Komunitetit’ të anëtarëve të besueshëm të komunitetit të njohur nga viktimat/të mbijetuarit ‘ose zyrtarët ndërlidhës’ nëse përdorni sistemin e alarmit të heshtur të teknologjisë së ulët për vendosjen e objekteve të alarmit jashtë shtëpisë, etj. Gjatë mbylljes këta mund të jenë anëtarë dhe zyrtarë të lejuar që lëvizin relativisht lirshëm në mënyrë që të vënë re alarmin dhe të bëhen rekomandimet për mbështetje.

Burimi: **Jo vetëm linjat telefonike direkte dhe telefonat mobil: Ofrimi i Shërbimit DhBGJ gjatë COVID-19** (2020). Erskine, D. për UNICEF dhe *Analiza e Shpejtë Gjinore Globale mbi Komitetin Ndërkombëtar të Shpëtimit COVID-19* (2020) dhe Komiteti Ndërkombëtar i Shpëtimit dhe *CARE International*

### **“Porositë duhet të përfshihen në materialet më të mëdha të informatave për parandalimin e COVID-19 në mënyrë që të mos tërheqin vëmendjen te burimet e të mbijetuarve”.**

Nga Koordinimi Global në Strategjitë Lokale Një Qasje Praktike për Parandalimin, Adresimin dhe Dokumentimin e Dhunës në Familje nën Dokumentin Përmbledhës të COVID-19 (2020)

timi në radio dhe TV, materialet në formë të shtypur të shtrirjes<sup>32</sup>, nënshkrimin e tabelave ose njoftimet me altoparantë në hapësirat publike. Organizatat policore mund të jenë partnere me këto përpjekje qeveritare të komunikimit për të ngritur dukshmëria e VAWG. Në mënyrë të veçantë, Policia mund të punojë për të siguruar që porositë të përpilohen kolektivisht me një kuptim të qartë se VAWG nuk është një fenomen i ri dhe se kur të ndodhin veprimet e dhunës do të merren seriozisht;

- Në tërë botën, pengesat ekonomike, sociale dhe kulturore parandalojnë ose kufizojnë qasjen e grave në, përdorimin dhe përfitimet nga teknologjia e informatave dhe komunikimit ose ICTs,<sup>33</sup> ky fenomen quhet ndarje gjinore dixhitale. Në shumë vende,

<sup>32</sup> Materialet e shtypura duhet të marrin një sërë formatesh, përfshirë atë Braille, dhe të përdorin gjuhë dhe fotografi të thjeshta aty ku është e mundur.

<sup>33</sup> Mënyrat për të tejkaluar ndarjen dixhitale gjinore nga perspektiva e të Drejtave të Njeriut (2016). Parahetresa nga Projekti për të Drejtat e Njeriut, Të Dhënat e Mëdha dhe Teknologjia në Qendrën për të Drejtat e Njeriut të Universitetit Essex, Financuar nga Këshilli për Kërkime Ekonomike dhe Sociale në [https://www.ohchr.org/Documents/Issues/Women/WRGS/GenderDigital/HRBDT\\_submission.pdf](https://www.ohchr.org/Documents/Issues/Women/WRGS/GenderDigital/HRBDT_submission.pdf). Gjithashtu shih Fondacionin World Wide Web, ‘Të Drejtat e Grave Online. Përkthimi i Qasjes në Fuqizim’ (2015), në dispozicion në <http://webfoundation.org/docs/2015/10/womens-rights-online21102015.pdf>.

veçanërisht ato që përballen me forma të shumta të diskriminimit, gratë dhe vajzat mund të mos kenë qasje në një telefon mobil, kompjuter ose internet për të hyrë në shërbime ose të jenë në gjendje t’i përdorin ato në shtëpi në mënyrë të sigurtë, pasi ato mund të monitorohen nga afër nga abuzuesi dhe anëtarët e tjerë të familjes. Shih Kutinë 5 për rekomandimet e UNICEF -it për opsionet e pakëta/ jo teknologjike të cilat mund të mundësojnë raportimin nga viktimat/të mbijetuarit e VAWG.

### **Shërbimet Thelbësore**

- Sistemet shëndetësore të cilat zakonisht ofrojnë shërbime për viktimat/të mbijetuarit e VAWG mund të jenë nën kërcënimin e kolapsit, gjë që do të ndikojë në secilin mekanizëm të koordinuar të përgjigjes ndërmjet sektorëve të ndryshëm, d.m.th., shëndetësisë, policisë dhe drejtësisë dhe përgjigjeve të shërbimeve sociale;
- Në skenarin më të mirë, strehimoret e dhunës në familje/IPV do të jenë duke e arritur kapacitetin ose e kanë arritur kapacitetin e plotë (gjatë periudhave të zakonshme në shumë kontekste strehimoret shpesh duhet t’i kthejnë prapa viktimat/të mbijetuarit dhe fëmijët e tyre që kërkojnë mbrojtje për shkak të mungesës të hapësirës);
- Vonesat në lëshimin e urdhrave kufizues, procedurat e ndarjes dhe shkurorëzimit dhe seancat e kujdestarisë të fëmijëve, përfshirë ato në të cilat mbijetuesit e IPV mbështeten për të lehtësuar distancën



Foto e çastit nga UN Women/Pathumporn Thongking (Tajlandë)

ose largimin nga partnerët abuzues.<sup>34</sup> Policia e cila përgjigjet do të duhet t'i faktojë vonesat e tilla në vlerësimet e tyre të rrezikut dhe rekomandimet e mëvonshme për llojin dhe shtrirjen e urdhrat (ave) mbi mbrojtjen e kërkuar.<sup>35</sup>

## JUSTICE CONTINUUM (DREJTËSI E VAZHDUAR) – SHEMBUJ TË NDIKIMEVE DHE NDRYSHIMEVE TË KËRKUARA

### Gjatë Krizave të Shëndetit Publik

34 Pandemitë dhe Dhuna ndaj Grave dhe Fëmijëve (2020). Peterman, A., Potts, A., O'Donnell, M., Thompson, K., Shah, N., Oertelt-Prigione, S., dhe van Gelder, N., Qendra për Zhvillimin Global, në: <https://www.cgdev.org/publication/pandemics-and-violence-against-women-and-children>

35 Varet shumë nga faktorët e tillë si dhe kush mund të lëshojë një urdhër (policia apo gjykata), nëse urdhrat për mbrojtje janë pjesë e një çështjeje penale ose civile, nëse kërkohet seancë dëgjimore, kohëzgjatja e urdhrat, mbrojtje të veçanta të ofruara, se kush mund të ketë qasje në një urdhër për mbrojtje (bashkëshorti ose partnerë të tjerë të afërm, anëtarët e familjes, shokët e dhomës, etj) dhe si zbatohet urdhri, dhe nëse ka pasoja penale për shkelje. Shih Përgjigjen e Gjykatës mbi Dhunës ndaj Grave Gjatë COVID-19.

Seritë Webinar: Pranimi i Përgjigjeve Ligjore dhe Sistemike Gjatë COVID-19 Adresimi i Dhunës ndaj Grave, 3 prill 2020. Të Drejtat Globale për Gratë, në: [https://globalrightsforwomen.org/wp-content/uploads/2020/04/Court-Response-to-Violence-Against-Women-During-COVID-19-Powerpoint\\_compressed.pdf](https://globalrightsforwomen.org/wp-content/uploads/2020/04/Court-Response-to-Violence-Against-Women-During-COVID-19-Powerpoint_compressed.pdf)

- Për të parandaluar përhapjen e COVID-19, gjykatat po i vonojnë shqyrtimet gjyqësore, duke i minimizuar ato dhe madje edhe duke u mbyllur përkohësisht. Kjo kishte pasur ndikim në dhënien e urdhrave përfundimtare të gjykatës për mbrojtje të cilat e ndalojnë një kryerës të VAWG të ketë disa lloje të caktuara të kontaktit me viktimën/të mbijetuarën, një rritje e rasteve të mbetura dhe numrin dhe/ose kohën për personat në paraburgim. Si rezultat, organizatat policore, së bashku me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit (si stafi i qendrës të paraburgimit) duhet të kërkojnë takime të jashtëzakonshme koordinimi me zyrtarët e gjykatës për t'i identifikuar rreziqet e infektimit dhe strategjitë lehtësuese siç janë procedurat e shqyrtimit dhe testimit,



• “Parimi Mos Lëndo” kërkon një vlerësim të duhur të dinamikës gjinore dhe normave kulturore të cilat mund të rezultojnë që viktimat/ të mbijetuarit dhe dëshmitarët të ekspozohen ndaj dëmtimeve të mëtejme, përfshirë traumatizimin e sërsishëm ose stigmën, dhunën dhe marginalizimin nga duart e kryerësve të supozuar ose viktimave, familjet dhe komunitetet (UNHCHR 2018).

si dhe cilat raste do të shqyrtohen si “urgjente” ose me “përparësi të lartë”, duke u mundësuar atyre t’i anashkalojnë masat e bllokimit/karantinës;

- Organizatat policore, së bashku me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit duhet gjithashtu të marrin parasysh sigurimin e takimeve të jashtëzakonshme koordinuese me ekspertët mbështetës të drejtësisë, si p.sh. mjekët ligjor dhe ekspertët psiko-socialë për të siguruar qasshmërinë dhe disponueshmërinë e tyre. Raportet e fundit të sponsorizuara nga OKB-ja dokumentuan dëshmitë nga viktimat/të mbijetuarit e VAWG që paraqesin se ata nuk ishin në gjendje të kërkonin kompensim ligjor kundër kryerësve të tyre, sepse mjekët ligjor nuk mundën ose nuk donin të ekzaminonin keqtrajtimin fizik të viktimave/të mbijetuarve në stacionet e policisë nga frika e përhapjes të COVID-19.<sup>36</sup>
- Si rezultat i masave të karantinës/mbylljes të shkakuar nga pandemia COVID-19, qendrat e paraburgimit dhe shërbimet e prokurorisë mund të detyrohen që t’i balancojnë veprimet kriminale/të dhunshme të një kryerësi dhe përsëritjen e mundshme me rrezikun e infektimit me të cilin mund të përballen në paraburgim dhe çfarë do të thotë kjo për kryerësin, veçanërisht kur

<sup>36</sup> Raporti i përbashkët i OKB-së “Drejtësia për Gratë në mes të COVID-19” (2020). UN Women, IDLO, UNDP, UNODC, WB dhe Krugëtuesit e Drejtësisë [https://www.idlo.int/sites/default/files/pdfs/publications/Justice-for-Women\\_Full-Report-English.pdf](https://www.idlo.int/sites/default/files/pdfs/publications/Justice-for-Women_Full-Report-English.pdf). Gjithashtu, shih Komisionin Kombëtar për Gratë Libaneze, UN Women, WHO, UNFPA, 2020. Paralajmërimi Gjinor për COVID-19, Liban. Në Fokus: Qasje në Drejtësi dhe Dhuna në Bazë Gjinore. 10 prill 2020. Botimi Nr. 1. [https://globalrightsforwomen.org/wp-content/uploads/2020/04/Court-Response-to-Violence-Against-Women-During-COVID-19-Powerpoint\\_compressed.pdf](https://globalrightsforwomen.org/wp-content/uploads/2020/04/Court-Response-to-Violence-Against-Women-During-COVID-19-Powerpoint_compressed.pdf)

merren parasysh kushtet mjekësore ekzistuese dhe moshën në mesin e faktorëve të tjerë. Një vendim për mos vendosjen e një kryerësi të VAWG në paraburgim pas një analize të tillë mund të përfundojë duke e vënë viktimën/të mbijetuarën (dhe anëtarët e familjes) në rrezik të mëtejshëm. Kryerja e një hetimi të plotë me informata mbi traumat (përdorimi i instrumenteve të tilla si Rrota e Fuqisë dhe e Kontrollit), është fokusuar në kryerësin për të siguruar se asnjë dëm (i mëtejshëm) nuk është bërë e që do të kishte rëndësi thelbësore.

### Shih Kapitullin 5 ‘Hetim’ për më shumë informata rreth njoftimit për kryerjen e një traume dhe kryerësi i përqëndruar në hetimin brenda VAWG.

- Përkundër raportimit të shtuar të VAWG në shtetet e ndryshme, kontekste të caktuara mund të vërejnë se shërbimet mbështetëse si strehimoret, qendrat e mbrojtjes të viktimave/të mbijetuarve dhe kërkesat për urdhra për mbrojtje nuk janë në rritje ose nuk janë të qasshme siç priten. Në disa raste, kërkesat për mbështetje të shërbimit madje mund të zvogëlohen gjatë masave të infektimit të krizës së shëndetit publik. Arsye për këtë fenomen mund të ndryshojnë, por policia duhet të marrë parasysh se si izolimi social, mungesa e hapësirave të sigurta për të mundur që të kenë qasje në shërbimet thelbësore si rezultat i masave të bllokimit, kërkesave për seancë gjyqësore në person, ose kërkesë për mundësimin e kujdestarisë për fëmijët dhe mungesa e opsioneve të kujdesit për fëmijët (përfshirë vetë gjykatat) janë faktorë ndikues.

### Shembuj të Ndryshimeve të Kërkuara

- Rritja e porosive publike të përbashkëta me agjencitë e drejtësisë mbi disponueshmërinë dhe qasshmërinë e shërbimeve thelbësore në vazhdimësinë e drejtësisë, në mënyrë që njerëzit të jenë të vetëdijshëm për orët dhe proceset e hapjes gjatë krizës të shëndetit publik. Për më tepër, një porosi e tillë publike do të shoqërohet me një komunikim të ripërtërirë mbi angazhimin e policisë për t’iu përgjigjur VAWG dhe pasojat e shkeljeve të urdhrave për mbrojtje, ndër të tjera.

- Zhvillimi i PSO -ve dhe trajnimi përkatës<sup>37</sup> për menaxherët e policisë dhe stafin e vijës së parë të cilët punojnë së bashku me masat e vazhdueshme të drejtësisë ndërmjetësuese, siç janë sallat e gjykimeve virtuale në distancë ose në internet, ose procedurat ku mund të vendosen teknologjitë për video-konferenca dhe procese të duhura dhe aranzhimet e sigurisë. Prezantimi i atyre modaliteteve në distancë duhet të konsiderohet jo vetëm si një përgjigje e menjëhershme ndaj pasojave të aftësisë së zvogëluar të gjykatave për t'i kryer funksionet e tyre të rregullta për shkak të krizave të tilla si pandemia COVID-19, por edhe në kontekstin afatmesëm dhe afatgjatë të planifikimit. Kjo mund të përfshijë rritjen e sigurisë dhe shërbimeve për viktimat/të mbijetuarve rreth gjykatave ose kutive postare të raportimit të VAWG ku kontakti personal kërkohet deri në një masë.

## Grupet e Cenueshme dhe Komunitetet Pakicë

- Krizat e tilla si shpërthimi i një sëmundjeje infektive mund të shpien në një rritje të stigmës, ksenofobisë dhe diskriminimit lidhur me racën, gjininë, orientimin seksual dhe statusin e emigrimit siç shpaloset nga përvojat e kaluara të shpërthimeve virale;<sup>38</sup>
- Situata e popullatave më të rrezikuara do të duhet të rivlerësohet si rezultat i një krize të madhe humanitare/shëndetit publik. Kjo përfshin segmente të popullsisë të cilat varen shumë nga ekonomia joformale; komunitetet me qasje joadekuata në shërbimet shoqërore ose ndikimin politik dhe kanë kapacitete dhe mundësi të kufizuara për të përballuar dhe për-

shtatur, përfshirë qasjen e kufizuar ose atë fare në teknologji. Në këtë drejtim, UNOHCA, OBSH dhe Federata Ndërkombëtare e Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe ofrojnë udhëzime<sup>39</sup> për agjencitë reaguese që punojnë nën masat COVID-19 (shih Kutinë 6);

**“Personat që identifikohen si lezbik, homoseksualë, biseksualë, transgjnorë, të çuditshëm, apo interseksualë (LGBTQI) shpesh janë në rrezik të shtuar të diskriminimit, stigmës dhe dhunës seksuale dhe fizike ”**

Doracaku Sphere (2018)

- Përvoja e mëparshme në komunitetet e prekura paraqet se gratë dhe vajzat ishin kryesisht të kufizuara në rolet tradicionale të gjinisë femërore si nëna ose kujdestare dhe ishin përjashtuar kryesisht nga hapësirat e komunitetit ku u morën vendime mbi planifikimin dhe organizimin e ndihmës urgjente.<sup>40</sup> Si rrjedhojë, nevojat specifike të grave për sigurinë dhe çështje të tjera nuk u morën parasysh pasi u paraqit gjendja emergjente<sup>41</sup>. Fuqia e angazhimit të policisë për gra dhe vajza në komunitete do të testohet në mënyrë të konsiderueshme në këto rrethana, me raporte pozitive duke bërë një ndryshim të rëndësishëm në natyrën e përgjigjes nga shërbimet esenciale.

37 Kjo mund të përfshijë trajnime mbi përdorimin e pajisjeve dhe softuerit të nevojshëm për të mbajtur seanca në distancë nga të gjithë pjesëmarrësit, përfshirë stafin e gjykatës dhe pjesëtarët e gjyqësorit. Shihni: Dëgjimet në Distancë në Gjykatë dhe Proceset Gjyqësore në Përgjigje të COVID-19 në Mision dhe Shërbimeve të tjera të Brishta të Drejtësisë dhe asaj Korrektuese. Zyra e OKB -së për Sundimin e Ligjit dhe Institucionet e Sigurisë (OROLSI)/Departamenti i Operacioneve të Paqes (DPO), 13 prill 2020 në: <https://www.cgdev.org/publication/pandemics-and-violence-against-women-and-children>

38 Trendet globale në paraqitjen e sëmundjeve infektive. Jones, K.E., Patel, N., Levy, M., Storeygard, A., Balk, D., Gittleman, J.L. et al. (2008). Natyra 451: 990-94, shih: <https://www.cgdev.org/publication/pandemics-and-violence-against-women-and-children>

39 COVID-19: Si të përfshihen personat e marginalizuar dhe të cenueshëm në komunikim me rrezikshmëri dhe angazhimin e komunitetit (2020). Federata Ndërkombëtare e Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës të Kuqe, Zyra e OKB -së për Koordinimin e Çështjeve Humanitare dhe Organizata Botërore e Shëndetit, në: <https://reliefweb.int/report/world/covid-19-how-include-marginalized-and-vulnerable-people-risk-communication-and>

40 Studimi i Rastit i të Shtetit Ekuador. Ligji dhe politika në fuqi mbi Barazinë Gjinore dhe Mbrojtjen nga Dhuna Seksuale dhe të Bazuar në Gjini Gjatë Fatkeqësive (2020). Federata Ndërkombëtare e Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës të Kuqe (IFRC), në: <https://media.ifrc.org/ifrc/document/effective-law-policy-gender-equality-protection-sexual-gender-based-violence-disasters-ecuador/>

41 Studimi i Rastit të Shtetit të Ekuadorit. Ligji në fuqi mbi politikën e barazisë gjinore dhe mbrojtjen nga dhuna seksuale dhe gjinore gjatë fatkeqësive (2020). Federata Ndërkombëtare e Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës të Kuqe (IFRC), në: <https://media.ifrc.org/ifrc/document/effective-law-policy-gender-equality-protection-sexual-gender-based-violence-disasters-ecuador/>

- Dëshmitë e COVID-19 paraqesin se një ndodhi pandemie, sikur krizat e tjera të shëndetit publik, përkeqësojnë rritjen e rrezikut të grave punëtore emigrante ndaj VAWG në të gjitha fazat e migrimit<sup>42</sup>. Kjo është veçanërisht e saktë për gratë emigrante me status të migrimit jo të rregullt ose pakica gjinore dhe seksuale dhe të cilët kanë më pak gjasa të raportojnë se i nënshtrohen dhunës për shkak të diskriminimit ose frikës nga arrestimi ose dëbimi<sup>43</sup>. Ato gra dhe vajza shpesh luftojnë për të pasur qasje në kujdes shëndetësor dhe shërbime mbështetëse thelbësore për shkak të kufizimeve në lëvizje, klinikave të mbyllura dhe frikës nga infeksioni.<sup>44</sup>
- Gratë dhe vajzat në industrinë e seksit shpesh do të detyrohen të rrezikojnë duke i shkelur masat e karantinës ose të përballen me pasiguri të rëndë financiare dhe ushqimore. Në shumë raste, pamundësia për t'u përfshirë në një aktivitet të tillë do të ndikojë gjithashtu te secili fëmijë që mbështetet në ata. Në raste të tjera, gratë dhe vajzat do t'i nënshtrohen prostitucionit të detyruar duke kërkuar që ata t'i shkelin masat e karantinës. Gjatë angazhimit, këto viktimat/të mbijetuarat të VAWG, do të jetë e rëndësishme që policia të identifikojë natyrën e këtyre lidhjeve eksploatuese dhe të kërkojë që të sigurojë sigurinë dhe mbrojtjen e tyre. Në mënyrë të barabartë është e rëndësishme që organizatat policore të identifikojnë se këto gra dhe vajza janë shumë të cenueshme të abuzohen nga zyrtarët shtetërorë, përfshirë pjesëtarët e forcave të sigurisë.
- Për më tepër, policia duhet të marrë parasysh sesi dhuna ndaj grave mund të jetë një shteg drejt shkeljes dhe burgosjes të viktimës/të mbijetuarës. Sipas Raportuesit Special të OKB -së për dhunë ndaj grave, shkaqet dhe pasojat e saj, është një lidhje e fortë ndërmjet dhunës ndaj grave dhe grave të burgosura<sup>45</sup>. Në veçanti, mënyra në të cilën ekspozimi ndaj ngjarjeve ekstreme, traumatike mund të shkaktojë ose kontribuojë në një çrregullim të personalitetit kufitar të karakterizuar me ndryshime të rënda, çrregullimin e personalitetit antisocial, abuzim me substanca dhe simptomat e çrregullimit të stresit post-traumatik, të cilat janë drejtpërdrejtë përkatëse për sjelljet e dhunshme dhe shpesh shpien në burgim.<sup>46</sup> Shembull, në rastet e dhunës në familje dhe IPV, gratë mund të përdorin forcë kundër keqtrajtuesit të tyre nga frika për sigurinë e tyre dhe të fëmijëve të tyre.<sup>47</sup>

42 2019 Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së mbi dhunën ndaj grave punëtore emigrante (A/74/235)

43 Trajtimi i Ndikimeve të Pandemisë COVID-19 te Gratë Punëtore Emigrante (2020). Shënim Udhëzues UN Women, në: <https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/04/guidance-note-addressing-the-impacts-of-the-covid-19-pandemic-on-women-migrant-workers>

44 Ibid.

45 Raportuesi Special mbi dhunën ndaj grave finalizon misionin shtetëror në Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandën e Veriut dhe bën thirrje për veprime urgjente për të adresuar deficitin e llogaridhënies dhe ndikimet negative të ndryshimeve në financime dhe shërbime (2014), në: <https://www.ohchr.org/en/statements/2014/04/special-rapporteur-violence-against-women-finalizes-country-mission-united>

46 Kohërat e vështira: Rugëtimet e grave ndaj krimit dhe burgimit (2012). Artz, L., Hoffman-Wanderer, Y., dhe Moulton, K, në: [https://genderlinks.org.za/wp-content/uploads/imported/articles/attachments/18024\\_hard\\_times.pdf](https://genderlinks.org.za/wp-content/uploads/imported/articles/attachments/18024_hard_times.pdf)

47 Diskriminimi në Bazë Gjinore & Gratë në Kundërshtim me Ligjin (UNODC, 2020), në: <https://www.unodc.org/e4j/en/crime-prevention-criminal-justice/module-9/key-issues/1-gender-based-discrimination-and-women-in-conflict-with-the-law.html>

## Kutia 6



### COVID-19: Si të përfshihen personat e marginalizuar, të cenueshëm dhe të rrezikuar në komunikim dhe angazhohen brenda komunitetit

Federata Ndërkombëtare e Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës të Kuqe, Zyra e OKB -së mbi Koordinimin e Çështjeve Humanitare dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë

Fëmijët	Personat me Aftësi të Kufizuar	Viktimat/të Mbijetuarit e VAWG
<p>Të konsultohen fëmijët dhe adoleshentët, përfshirë fëmijët e vetëm dhe të ndarë, për t'i kuptuar shqetësimet, frikën dhe nevojat e tyre.</p> <p>Të hartohen informata dhe materiale komunikimi në një mënyrë miqësore për fëmijët.</p> <p>Avokim mbi shërbi- met këshilluese dhe mbështetëse për personat e prekur.</p> <p>Të merren parasysh nevojat e ndryshme bazuar në gjini, kontekst dhe komunitetet e marginalizuara.</p>	<p>Shpërndarje e informatave duke përdorur gjuhë të kuptueshme dhe të thjeshtë.</p> <p>Ofrim i informatave në formate të qasshme, si Braille, shkronja të mëdha.</p> <p>Ofrim i formave të shumta të komunikimit, si mbishkrime tekste ose video të firmosura, titra tekste për personat me dëgjim të dëmtuar, materiale online për personat që përdorin teknologji ndihmëse.</p> <p>Përfshirje e organizatave të personave me aftësi të kufizuar në konsultime dhe vendimmarrje.</p> <p>Ofrim i një qasjeje të përshtatur për t'i përmbushur nevojat individuale, për të punuar me kujdestarët personal dhe rrjetet e tjera të mbështetjes sociale.</p>	<p>Përditësim i rrugëtimit referues të DhBGj për t'i pasqyruar objektet e kujdesit shëndetësor primar dhe sekondar.</p> <p>Informomim i komuniteteve kyçe dhe të ofruesve të shërbi- meve lidhur me rrugëtimet e përditësuar.</p> <p>Të sigurohet që masat për zvogëlimin e masave të rrezikut të VAWG janë në përputhje me objektet e karantinës dhe proceset e evakuimit.</p> <p>Fuqizohen kapacitet mbështetëse siç është personeli për linjat telefonike të drejtëpërdrejta të reagimit emergjent.</p> <p>Shpërndarja e Kodeve të Mirësjelljes dhe masave të tjera mbrojtëse dhe sjellja në kujtesë e zyrtarëve për nevojën për t'u pajtuar me ata.</p>

## PARTNERITETET ME AKTERËT KOMUNITAR, PUSHTETIN LOKAL DHE ATË PRIVAT

- Mekanizmat e qeverisjes të sigurisë lokale siç janë këshilli për siguri komunale ose këshilli për siguri lokale i (KSKL) mund të aktivizohen sërish nga autoritetet

e qeverisjes vendore për të ndihmuar në koordinimin e përgjigjeve ndaj një krize, duke ia paraqitur policisë lokale një mundësi për t'i promovuar dhe fuqizuar partneritetet kyçe. Në shumë raste, KSKL -të nuk janë aktivizuara nga autoritetet e qeverisjes vendore komunale, pavarësisht se kanë mandat për ta bërë këtë ose janë të aktivizuara, por ato janë pasive. Në raste të

## Kutia 7

### Komitetet e Vëzhgimit ndaj Ebolës



Foto e çastit të Heart to Heart International (Liberi)

Burimi: COVID-19 Si të përfshihen personat e marginalizuar dhe të cenueshëm në komunikim me rrezik dhe angazhimin në komunitet (2020). Federata Ndërkombëtare e Shoqërive të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, Zyra e OKB -së mbi Koordinimin e Çështjeve Humanitare dhe Organizata Botërore Shëndetësore

tilla, kriza e shëndetit publik mund të frymëzojë dobishmërinë e tyre duke i siguruar policisë një forum kryesor për koordinimin dhe planifikimin strategjik mbi një llogaridhënie ndaj çështjeve gjinore dhe qasje të përgjegjshme ndaj policisë. Shihni studimin mbi rastin në këshillët e sigurisë lokale në Kongo, Ekuador dhe Meksikë në Kapitullin 2 “Parandalimi”, shembull.

- Nën masat e karantinës, komuniteti, religjiozët dhe personat me ndikim mund të jenë akoma partnerë kritikë për një organizatë policore kur i përgjigjen VAWG, veçanërisht mbi ngritjen e vetëdijes për faktorët e rrezikut të cilat nxisin dhe e rëndojnë dhunën gjatë dhe pas krizës. ICT online platformat si Facetime ose Skype mund të përdoren për porosi të përbashkëta në mbështetje të viktimave/të mbijetuarve të VAWG të shoqëruara me informata ekzistuese mbi mekanizmat e reja të raportimit. Për më tepër, porositë e përbashkëta përmes mjeteve jo-dixhitale ose *off-line* mund të vazhdojnë përmes fjalës së thënë zëshëm edhe përmes aktiviteteve grupore të kryera në një distancë të sigurtë;<sup>48</sup>

48 Nga Koordinimi Global në Strategjitë Lokale Një Qasje Praktike për Parandalimin, Adresimin dhe Dokumentimin e Dhunës në Familje sipas Dokumentit Përmbledhës COVID-19 (2020). MADRE, Media Matters for Women, MenEngage Alliance, Nobel Women Initiative, OutRight Action International, Women Enabled International dhe Women’s International League for Peace and Freedom (WILPF), në: [https://www.wilpf.org/wp-content/uploads/2020/04/MADRE-Domestic-Violence-Under-COVID-19-Briefing-Paper\\_4.21.20.pdf](https://www.wilpf.org/wp-content/uploads/2020/04/MADRE-Domestic-Violence-Under-COVID-19-Briefing-Paper_4.21.20.pdf)

Bazuar në përvojat në Afrikën Perëndimore gjatë shpërthimit me Ebola, organizatat vendore bazike ishin të rëndësishme në krijimin e komiteteve të vëzhgimit me Ebola në fshat, të udhëhequr nga gratë vendore dhe udhëheqës fetar për të ngritur reagimin lokal dhe punën së bashku me përpjekjet kombëtare.

- Kur pajisen me materiale komunikimi miqësore për lexuesit dhe të qasshme për parandalimin e VAWG, ndihma humanitare lokale, ofruesit e kujdesit shëndetësor dhe mediat lokale mund të jenë partnerë kyç për policinë kur kërkojnë të kenë qasje në familjet ku ka vështirësi në qasje. Kjo mund të përfshijë ndihmën në shpërndarjen e broshurave, të shkruara dhe ato grafike dhe në forma të ndryshme të arritshme, me informata të cilat e pengojnë sjelljen e dhunshme në shtëpi dhe ofron numra telefonike ndihmë ose burime të tjera për viktimat/të mbijetuar që t’i udhëzojnë më mirë ata drejt burimeve të cilat përputhen me nevojat e tyre;<sup>49</sup>
- Partneritetet me kompanitë dhe klinikat mjekësore për t’i përfshirë punonjësit esencjal të vijës së parë<sup>50</sup> në përgjigje të VAWG në situatat e krizave të shëndetit publik kërkojnë angazhim bashkëpunues nga policia për t’u ofruar këtyre punonjësve udhëzime dhe trajnime mbi rolet e vëzhguesve.<sup>51</sup> Vëzhguesit kryesor në

49 COVID-19: Si të përfshihen personat e marginalizuar dhe të cenueshëm në komunikimin me rrezik dhe angazhimin e komunitetit (2020). Federata Ndërkombëtare e Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, Zyra e OKB -së mbi Koordinimin e Çështjeve Humanitare dhe Organizata Botërore Shëndetësore në: [https://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/COVID-19\\_CommunityEngagement\\_130320.pdf](https://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/COVID-19_CommunityEngagement_130320.pdf)

50 Në varësi të kontekstit, punëtorët esencjal mund të përfshijnë farmacistët, punonjësit e dyqaneve ushqimore, infermierë, receptionistët të klinikave mjekësore, ndër të tjera.

51 Shihni Qasjen e Vëzhguesit. Graham Goulden mbi Kultivimin e Mendjeve MeB, në: <https://grahamgoulden.com/cultivating-minds-uk/about/>



**“Formimi i partneriteteve të sektorit privat dhe publik gjatë pandemisë mund të sigurojë që të gjitha gratë të kenë qasje në telefonat mobil. Sistemet e drejtësisë nuk mund të jenë statike: ne duhet të fillojmë të eksplorojmë mënyra më të qëndrueshme të ofrimit të drejtësisë, siç është për shembull, optimizimi i urdhrave të përkohshëm për të parandaluar shkeljen e të drejtave.”**

Drejtor Ekzekutiv i UN Women,  
Phumzile Mlambo- Ngcuka (2020)

pikat e hyrjes për identifikimin e viktimave/të mbijetuarve të VAWG mund të paraqiten gjatë ndërhyrjeve në tërë popullsinë, për shembull, në stacionet e testimit dhe gjurmimit të COVID-19. Sidoqoftë, një iniciativë e tillë do të duhet t'i japë përparësi parimit “*mos dëmto*” në çdo metodë të aplikuar për identifikimin e viktimave (siç është brenda një pyetësi). Në të njëjtën kohë, stacionet e testimit dhe gjurmimit mund të jenë të rëndësishme për ndërgjegjësimin dhe informimin e VAWG në lidhje me mekanizmat e raportimit;

- Ndjekja e partneriteteve më të fuqishme me kompanitë e ICT -ut ose ndërmjetësit e internetit mund të jetë shumë e dobishme për policinë. Për shembull, mbështetja për prezantimin e dhunës në familje/aplikacionet IPV për telefonin mobil për të plotësuar linjat online të ndihmës do të jetë një alternativë e mirë për viktimat/të mbijetuarit e mbyllur në shtëpi gjatë gjithë ditës me abuzuesin. Mundësi të tjera të partneritetit mund të përfshijnë bashkëpunimin për ndarjen e këshillave të sigurisë në internet përmes faqeve të mediave sociale, GPS, telefonave, etj. për gratë, të rinjtë dhe fëmijët dhe/ose sigurimin e procedurave të arritshme dhe transparente të raportimit dhe ankesave për internetin dhe mundësimin e ICT-ut VAWG;<sup>52</sup>

- Duke pasur parasysh ndikimet afatgjata të një pandemie/epidemie në zotësinë e gjykatave formale për t'u

52 Online dhe ICT\* dhuna e mundësuar kundër grave dhe vajzave gjatë COVID-19 (2020) Përmbledhje e UN Woman, në: <https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/04/brief-online-and-ict-facilitated-violence-against-women-and-girls-during-covid-19>

përgjigjur nevojave të drejtësisë së grave të kombinuara me paarritshmërinë e perceptuar të mekanizmit të drejtësisë gjatë krizës, viktimat/të mbijetuarat e VAWG mund të kërkojnë gjithnjë e më shumë sisteme zakonore dhe joformale të drejtësisë për mbrojtje dhe dëmtshpërbllim.<sup>53</sup> Si rezultat, organizatat policore duhet të parashohin dhe japin llogari se si ky trend i mundshëm mund të ndikojë në raportimin në rajonet e caktuara dhe të zgjerohet ose fuqizohet partneritetet me akterët e sistemit të drejtësisë joformale ose zakonore në proces.<sup>54</sup>

## Kutia 8

### COVID-19 Përgjigje: Policia - Partneritetet Civile

Në **Brazil**, një numër Aplikacionesh, p.sh. ‘SOS Mulher’ në shtetin e São Paulo, janë duke u zhvilluar në një partneritet të përbashkët ndërmjet policisë dhe shoqërisë civile, për raportimin e incidenteve të dhunës në familje gjatë izolimit shoqëror, si dhe incidenteve të mosrespektimit të masave mbrojtëse urgjente të vendosura mbi kryerësin, i cili mund të rezultojë në ndalimin parandalues dhe fillimin e procedurës penale.

Në **MeB**, Policia Cumbria iu ka bërë thirrje punonjësve të postës, shoferëve shpërndarës, kompanive të shpërndarjes të ushqimit dhe çdo punonjësi esencial që vizitojnë shtëpitë për të parë shenjat e keqtrajtimit dhe t'i raportojnë ato në departamentin e policisë.

Policia e Italisë është duke e përdorur një aplikacion “YouPol”, e krijuar fillimisht për t'i ndihmuar të rinjtë në raportimin e ngacmimit dhe shpërndarjes të drogës, por tani është pranuar për të dhënë të mbijetuarve një mënyrë në të cilën i dërgojnë policisë porosi pa dijeninë e partnerit të tyre. Rrjeti kombëtar i strehimoreve të dhunës në familje në **Itali** (“DiRe”) hapi telefonata urgjente dhe thirrje Skype për të siguruar mbështetje, dhe afërsisht dy të tretat e organizatave Italiane për dhunë në familje kanë linja telefonike emergjente.

53 Drejtësi për gratë në mes COVID-19 (2020), Përmbledhje e UN Woman në: <https://www.unwomen.org/-/media/headquarters/attachments/sections/library/publications/2020/justice-for-women-amidst-covid-19-en.pdf?la=en&vs=4857>

54 Drejtësi për gratë në mes COVID-19 (2020), Përmbledhje e UN Woman në: <https://www.unwomen.org/-/media/headquarters/attachments/sections/library/publications/2020/justice-for-women-amidst-covid-19-en.pdf?la=en&vs=4857>

Në shtetin e **Indisë**, Maharashtra, policia e shtetit së bashku me OJQ -në lokale Akshara dhe Departamentin për Zhvillimin e Grave dhe Fëmijëve dhe Qelinë Speciale për Gra dhe Fëmijë (TISS) (me bazë në stacionet policore), për të nisur një fushatë mbi shpërndarjen e informatave mbi numrin emergjent 100 të policisë [jo zakonisht i lidhur me dhunën në familje] për ankesa dhe mbështetje gjatë mbylljes. Për të siguruar një mbulim dhe shtrirje të gjerë, nisma u bëri thirrje personave të njohur dhe agjencive të tjera qeveritare. Personave të njohur siç janë aktorët kryesor të Bollywood dhe nga sportistët u kërkua që të ngrisin zërin e tyre për t'i kërkuar grave që të "Raportojnë Dhunën në Familje" pasi raportimi vepron si një parandalues dhe gjithashtu e përforcon atë si një krim.

Burimet: [COVID-19 dhe Sigurimi i Shërbimeve Esenciale për të Mbituarit nga Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave](#) (2020). Përmbledhje e UN Woman dhe [Drejtësi për gratë gjatë COVID-19](#) (2020). Përmbledhje e UN Woman dhe [Dhuna në Familje në Mbyllje](#) (2020). Qendra Akshara

## Platforma Online dhe ICT-lehtësoi VAWG

- Sipas EUROPOL<sup>55</sup>, gjatë COVID-19 dhe kufizimeve në lëvizje u regjistrua një rritje e numrit të përpjekjeve për të hyrë në platforma të kundërligjshme në internet që paraqesin materiale të keqtrajtimin seksual të fëmijëve dhe në aktivitetet e atyre që kërkojnë të mbajnë të rinjtë në situata eksploatuese. Ky fenomen në zhvillim kërkon që organizatat policore të fuqizojnë protokollet dhe kodet e sjelljes të specializuara, të qarta dhe efikase, të brendshme dhe të jashtme për zyrtarët e zbatimit të ligjit të cilat online i drejtohen o VAWG -së gjatë situates emergjente.<sup>56</sup>
- Raportuesi Special për shitjen dhe shfrytëzimin seksual të fëmijëve raporton se kufizimet e ud-

55 Mbyllja nga koronavirusi rrit rrezikun e abuzimit të fëmijëve në internet, thonë bamirësitë. The Guardian (2020), në: <https://www.theguardian.com/world/2020/apr/02/coronavirus-lockdown-raises-risk-of-online-child-abuse-charity-says>

56 Platforma Online dhe ICT\* dhuna e mundësuar kundër grave dhe vajzave gjatë COVID-19 (2020) Përmbledhje e UN Woman në: <https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/04/brief-online-and-ict-facilitated-violence-against-women-and-girls-during-covid-19>

hëtimit nga COVID-19 kanë krijuar forma të reja të shfrytëzimit dhe keqtrajtimin seksual të fëmijëve, duke përfshirë përpjekjet për të krijuar një shërbim "shpërndarjeje" ose "ngasjeje- përmes" shfrytëzimit seksual të fëmijëve.<sup>57</sup>

- Ndërsa miliona gra dhe vajza janë duke u mbështetur në video-konferencat për të punuar dhe studiuar, ka pasur një rritje të formave të ndryshme të dhunës on-line duke filluar nga përndjekja, ngacmimi, ngacmimi seksual dhe kërkues të seksit. Në disa raste të raportuara, disa anëtare të organizatave të të drejtave të grave janë bombarduar me video pornografike të dhëna, derisa po telefononin në një ngjarje shoqërore përmes një dhome chati virtuale.<sup>58</sup> Shih Kutinë 9 (më poshtë) të një shembulli.

### Kutia 9

#### Bombardimi me Zoom- dhe Dëmi për Shoqërinë Civile

Si një OJQ e drejtuar nga gratë, dhe e bazuar në të drejtat e grave që funksionon për të fuqizuar bazën e dëshmimeve dhe për të ndërtuar kapacitetin mbi dhunën ndaj grave dhe dhunën ndaj fëmijëve në nivelin global, Iniciativa për Kërkimin e Dhunës Seksuale (SVRI) sprovoi këtë keqtrajtim nga dora e parë. Një webinar i kohëve të fundit mbi avancimin e kërkimeve për të parandaluar dhunën ndaj grave u 'bombardua me Zoom'. Takimi u hakua me material racional dhe të qartë seksual. Kjo formë e dhunës e shkaktuar ndaj pjesëmarrësve, duke prezantuar dhe organizuar ngjarjen mund të ketë pasoja të mëdha, për mirëqenien e atyre të cilët e përjetuan atë, dhe që SVRI të sigurojë ngjarje të ardhshme të hapura, gjithëpërfshirëse dhe të qasshme për të gjithë.

Burimi: [Siguria në Internet në një Botë në Ndryshim-COVID-19 dhe Dhuna Kibernetike](#)(2020). Iniciativa për Kërkimin e Dhunës Seksuale.

57 COVID-19: Nevojë urgjente për shërbime të mbrojtjes të fëmijëve për të zvogëluar rrezikun e abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve në tërë botën (2020). Mama Fatima Singhateh, Raportuese Speciale për shitjen dhe shfrytëzimin seksual të fëmijëve, në: <https://www.ohchr.org/EN/NewsEvents/Pages/DisplayNews.aspx?NewsID=25865&LangID=E>

58 Rreziku i kërkimit të seksit në internet rritet pasi koronavirusi nxiti punën nga shtëpia. Reuters (2020), në: <https://www.reuters.com/article/us-women-rights-cyberflashing-trfn-idUSKB-2153HG>

## Marrëdhëniet Shfrytëzuese

- Rënia ekonomike e prituri si rezultat i masave të detyruara të karantinës mund të pritet që të diskriminojë gratë dhe vajzat në mënyrë disproporcionale në aspektin e dhunës dhe vështirësive ekonomike, mes çështjeve të tjera. Kjo mund të vijë nga mbyllja e shkollave ose familjeve të cilat i largojnë vajzat nga shkollat për të punuar, ndoshta duke shpjer në punë të detyruar, përfshirë shfrytëzimin seksual.<sup>59</sup> Për më tepër, pasiguria ushqimore ose varësia më e madhe nga ndihma për mbijetesë do dhe ka hapur derën për nënshtrimin e grave dhe vajzave ndaj shfrytëzimit seksual dhe abuzimit ose punës të detyruar nga punonjësit për ndihmë dhe zyrtarët shtetëror<sup>60</sup> në të gjitha kapacitetet.

## VAWG në Zhvillim

- Në disa raste, adoleshentët përfshihen në sjellje të dhunshme në shtëpi, gratë (nënat) shënjestrohen në mënyrë disproporcionale nga kjo dhunë. Pavarësisht mbizotërimit të kësaj forme të dhunës, ajo nuk pranohet çdo herë nga sistemi i drejtësisë penale. Rreziqet për sigurinë e grave ka të ngjarë të rriten shumë nga

një kontekst në të cilin një fëmijë adoleshent i dhunshëm është në izolim të detyruar në shtëpi,<sup>61</sup>

- Ekzistojnë gjithashtu rreziqe të rritura të dhunës dhe ngacmimit ndaj punonjeseve femra të shëndetit në vijë të parë. Raportet nga Singapori dhe Kina vërtet paraqesin nivele të larta të frikësimit dhe agresionit ndaj profesionistëve të shëndetit femra, veçanërisht infermiereve, gjatë krizës pandemike me COVID-19.<sup>62</sup>
- Prezantimi i mundshëm i stafit ushtarak në zonat civile mund të rrisë rrezikun e keqtrajtimit të të drejtave të njeriut ndaj grave dhe fëmijëve, përfshirë marrëdhëniet shfrytëzuese. Menaxhimi i rrezikut të policisë dhe analiza gjinore e ndërlydhur duhet të synojnë që të sigurojnë masa lehtësuese siç janë PSO -të dhe kodet e mirësjelljes për t'i adresuar rreziqet e të drejtave të njeriut të faktuara dhe të diskutuara me komandën ushtarake, kështu që strategjitë parandaluese janë të koordinuara dhe të synuara në përputhje me rrethanat.

## Grumbullimi i të dhënave

- Marrja e informatave mbi të gjitha format e VAWG do të thellojë kuptimin e përbashkët se si funksionon dhuna dhe do të ndihmojë në identifikimin se kur nevojitet një përgjigje më e duhur.<sup>63</sup> Duke pasur një sistem tanimë të vendosur i cili gjurmon dhe i analizon trendet në përhapjen e VAWG do t'i identifikojë tendencat e reja siç shfaqen gjatë shëndetit publik dhe/ose krizës humanitare.

59 Në Afrikën Perëndimore, mbyllja e shkollave për shkak të epidemisë Ebola i ekspozoi vajzat ndaj shfrytëzimit seksual dhe dhunës dhe shpui në një 'rritje të thekshme' adoleshenteve shtatzëna dhe martesave të hershme në disa zona të prekura, për shkak të rritjes të shkallës së braktisjes të shkollës nga vajzat. Fraser, E. (2020). Ndikimi i Pandemisë COVID-19 në Dhunën ndaj Grave dhe Vajzave. Ndihma e MB, WAG Shërbimi i ndihmës Raporti mbi Hulimtim në Bankën Botërore. 2020. *Dimensionet Gjinore të Pandemisë COVID-19, Washington, D.C.*: Grupi i Bankës Botërore, në: <http://documents.worldbank.org/curated/en/618731587147227244/Gender-Dimensions-of-the-COVID-19-Pandemic>

60 Raportet nga kriza me Ebola në Sierra Leone dhe Republikën Demokratike të Kongos paraqesin se shfrytëzimi seksual ishte i zakonshëm nga zyrtarët shtetëror dhe anëtarët e komunitetit përgjegjës për zbatimin e karantinës. Shih 60 *Dimensionet Gjinore të Pandemisë COVID-19, Washington, D.C.* Grupi i Bankës Botërore 2020, në: <http://documents.worldbank.org/curated/en/618731587147227244/Gender-Dimensions-of-the-COVID-19-Pandemic> and Fraser, E. (2020). Ndikimi i Pandemisë COVID-19 mbi Dhunën ndaj Grave dhe Vajzave. UKAid, Raporti i Kërkimit të Ndihmës së WAG -së, Ndikimi i Pandemisë COVID-19 në Dhunën ndaj Grave dhe Vajzave. Ndihma e MB, WAG Shërbimi i ndihmës Raporti mbi Hulimtim në Bankën Botërore, në: <http://www.sddirect.org.uk/media/1881/vawg-helpdesk-284-covid-19-and-vawg.pdf>

61 Përgjigje ndaj Sëmundjeve të Koronavirusit (COVID-19)-Përmbledhje Tematike e UNODC mbi dhunën në bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave (2020). UNODC.

62 Shih Fraser, E. (2020). Ndikimi i Pandemisë COVID-19 në Dhunën ndaj Grave dhe Vajzave. Ndihma e MB, WAG Shërbimi i ndihmës Raporti mbi Hulimtim në Bankën Botërore Grupi, në: <http://documents.worldbank.org/curated/en/618731587147227244/Gender-Dimensions-of-the-COVID-19-Pandemic>

63 Nga Koordinimi Global në Strategjitë Lokale Një Qasje Praktike për Parandalimin, Adresimin dhe Dokumentimin e Dhunës në Familje nën Dokumentin Përmbledhës të COVID-19 (2020). MADRE, Media Matters for Women, MenEngage Alliance, Nobel Women Initiative, OutRight Action International, Women Enabled International dhe Women's International League for Peace and Freedom (WILPF), në: [https://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/COVID-19\\_CommunityEngagement\\_130320.pdf](https://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/COVID-19_CommunityEngagement_130320.pdf)



Ju nuk mund të menaxhoni atë që nuk mund të matni ose atë që nuk matni.

- Qëndrimi vigjilent në adresimin e modeleve të reja dhe përhapja në zhvillimin e VAWG duhet të përfshijë sisteme për të gjetur sasinë dhe natyrën e kërkimit për ndihmë;
- Masat e krizës të tilla si ato të zbatuara gjatë pandemisë COVID-19 ose shpërthimit të Ebolas e kanë bërë interpretimin e të dhënave të VAWG më sfiduese. Për shembull, në disa vende, raportimi, telefonatat dhe përdorimi i shërbimit janë zvogëluar gjatë karantinës pasi që gratë dhe vajzat e gjejnë veten të paaftë për të dalë nga shtëpia ose nga frika se mos përrëgjohen në telefon nga një partner keqtrajtues. Kjo krijon një mospërputhje kur bëhet interpretimi i VAWG, në veçanti IPV, duke
- Manuali Sphere (2018) rekomandon ndarjen e të dhënave në masën e mundshme dhe me kategoritë e përshtatshme për kontekstin për t'i kuptuar dallimet në bazë të gjinisë, seksit, moshës, paaftësisë, gjeografisë, përkatësisë etnike, fesë, kastës ose ndonjë faktori tjetër që mund të kufizojë qasjen në ndihmën e paanshme;<sup>64</sup>
- Mos dëmto. Siguria, privatësia dhe konfidencialiteti i grave dhe vajzave të intervistuar duhet të respektohen në çdo kohë pasi matja e dhunës është një përpjekje e ndjeshme në çdo rrethanë. Grumbullimi i të dhënave nuk duhet të ketë përparësi mbi sigurinë personale.

#### Kutia 10

#### Pse Grumbullimi i të Dhënave Gjatë Krizave të Shëndetit Publik është i Rëndësishëm

Të dhënat janë një mjet thelbësor për të kuptuar se si dhe pse pandemitë si COVID-19 mund të rezultojnë në një rritje të VAWG. Mund të ndihmojnë në identifikimin e faktorëve të rrezikut; si ndikohet disponueshmëria e shërbimeve për gratë viktime/të mbijetuarat të cilat i nënshtrohen dhunës; si ndikohet qasja e grave në shërbime të tilla dhe kërkimi i ndihmës nga burimet formale dhe joformale; çfarë nevojash të reja afatshkurtra dhe afatmesme lindin. Këto të dhëna janë kritike për hartimin e strategjive të bazuara në dëshmi që i përgjigjen nevojave të grave, zvogëlojnë rreziqet dhe zbusin efektet negative gjatë dhe pas pandemisë. Këto të dhëna gjithashtu mund të ofrojnë njohuri të rëndësishme dhe të informojnë mbi zhvillimin e ndërhyrjeve të përshtatura të cilat mund të jenë veçanërisht efektive në parandalimin e VAWG gjatë emergjencave dhe krizave të shëndetit publik në të ardhmen.

Burimi: [Grumbullimi i të dhënave mbi Dhunën kundër Grave dhe Vajzave gjatë COVID-19](#) (UN Women dhe OBSH, 2020).



Foto e çastit ILO/Jennifer A. Patterson (Côte d'Ivoire)

64 'A është bërë shumë e rrezikshme të masësh dhunën ndaj grave?' Kelli Rogers, 06 maj 2020, në: <https://asiapacific.unfpa.org/en/news/covid-19-has-it-become-too-dangerous-measure-violence-against-women-devex>

65 Shoqata Sphere. Doracaku Sphere: Karta Humanitare dhe Standardet Minimale në Përgjigje Humanitare, botimi i katërt, Gjenevë, Zvicër, 2018.

## LEHTËSIMI I MBYLLJES: REFLEKTIMI DHE MËSIMI

Pandemia e COVID-19 ka rezultuar me një realitet të ri global që në kohën e shkrimit, nuk dihet kur dhe nëse do të ketë një kthim në atë që më parë konsiderohej normale.

Përderisa vendet fillojnë t'i lehtësojnë masat e detyrueshme të mbylljes/karantinës dhe ekonomitë fillojnë të hapen ngadalë, shtetet e tjera po shohin rritje të numrit të rasteve me COVID-19 dhe të vdekjeve lidhur me ato. Në të njëjtën kohë, disa vende po përjetojnë valë të dytë, megjithëse më të vogla në këtë pikë, të pandemisë pas lehtësimit të masave fillestare.

Për vendet të cilat mund të kontrollojnë me sukses përhapjen e një pandemie aq sa të jenë në gjendje të mbajnë ekonomitë e hapura duke parandaluar stresin tejet të madh në sistemin shëndetësor kombëtar, sistemi i drejtësisë mund të fillojë të kthehet në aktivitetet normale, megjithëse duke i respektuar masat më të buta të shëndetit publik. Për të gjithë ofruesit e shërbimeve esenciale në vazhdimësinë e drejtësisë, lehtësimi i masave sjell mundësi të reja për reflektim dhe mësim.

Shembull, pavarësisht sfidave dhe rezultateve negative të pandemisë COVID-19, ajo gjithashtu vuri në qendër të vëmendjes rolin e “shërbimit publik” të policisë lokale, përfshirë rolin thelbësor që ata mund të luajnë gjatë një situatë të krizës të shëndetit publik, në krahasim me një autoritet rol të shkëputur nga kërkesat e shumicës të të cenuarve dhe minoritarëve. Disa organizata policore mund pësojnë mbështetje të paparë publike për punën e tyre, përfshirë njohjen e rrezikut të shtuar ndaj të cilit ata dhe familjet e tyre ishin të ekspozuar

Te merret parasysh roli i organizatave të grave në planet e rimëkëmbjes dhe zgjidhjet afatgjata për të adresuar rritjen e VAWG gjatë COVID-19.



çdo ditë gjatë kulmit të pandemisë.

Disa organizata policore mund të kenë qenë në gjendje të krijojnë marrëdhënie më të fuqishme me agjencitë mbështetëse ndaj viktimave/të mbijetuarve dhe organizatat e shoqërisë civile ose së paku të mbjellin partneritete të ardhshme duke u përballur me një problem të zakonshëm gjatë krizave.

Sidoqoftë, reflektimi nuk do të jetë i mjaftueshëm për të përfituar nga secili pozitivitet i cili mund të shpëtohet nga përvoja e përgjigjes ndaj COVID-19. Që partneritetet kryesore të ruhen në mënyrë që të kenë ndikim kur i përgjigjen VAWG, policia gjithashtu duhet të demonstrojë përkushtimin e tyre për të mësuar në mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse.

Më konkretisht, organizatat policore duhet të marrin në konsideratë ngritjen e çdo solidariteti të fituar duke i angazhuar në mënyrë aktive ofruesit e tjerë të shërbimeve esenciale, përfshirë organizatat e shoqërisë civile dhe ekspertët akademikë në rishikimin e veprimeve të tyre të ndërmarra gjatë masave të pandemisë/epidemisë, veçanërisht kur i përgjigjen VAWG. Rekomandimet nga çdo rishikim i brendshëm dhe i jashtëm i veprimit të policisë gjatë mbylljes/karantinës së COVID-19 duhet të informojnë mbi strategjitë dhe veprimet e reja për t'iu përgjigjur VAWG në të ardhmen, në realitetin tonë të ri, duke përfshirë trajnimin dhe edukimin e nevojshëm për një organizatë policore kompetente për çështje gjinore. Kutitë 17 dhe 18 (më poshtë) japin shembuj të analizës së pavarur të përgjigjes ndaj shpërthimit të Ebola -s në Afrikën Perëndimore nga forcat përkatëse.

## Kutia 11

### Mësimet dhe Rekomandime për Sektorin e Sigurisë nga Sëmundja e Virusit Ebola në Afrikën Perëndimore (2014–2015)<sup>66</sup>

Në vitin 2017, DCAF - Qendra për Qeverisjen e Sektorit të Sigurisë në Gjenevë (atë kohë Qendra për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura të Gjenevës) dha raportin *“Roli i Sektorit të Sigurisë në Përgjigje ndaj Krizave Shëndetësore. Mësimet nga Epidemia Ebola 2014–2015 dhe Rekomandime për Unionin e Lumit Mano dhe Shteteve Anëtare të tij”*. Më shumë se dy vite më vonë dokumenti do të bëhej veçanërisht i rëndësishëm si rezultat i pandemisë globale COVID-19 dhe pasojës për forcat e sigurisë në tërë botën.

Raportet përfshinin akterët e mëposhtëm të sektorit të sigurisë si pjesëmarrës në përgjigje: forcat e armatosura kombëtare; shërbimet e inteligjencës; shërbimet e policisë/xhandarmërisë; rojet kufitare dhe menaxhimin e kufirit; akterët e sigurisë lokale, përfshirë policët; aranzhimet ndërkombëtare të sigurisë; qeveritë kombëtare; akterët e shoqërisë civile (mediat, grupet e studimit, etj.); organizatat qeveritare rajonale dhe ndërkombëtare, përfshirë Kombet e Bashkuara (OKB); dhe autoritetet ligjore dhe parlamentare.

Raporti përqendrohet kryesisht në shpërthimin e virusit Ebola (EVD) në 2014–2015 në Guinea, Liberi dhe Sierra Leone, e cila rezultoi në më shumë se 28,000 raste dhe mbi 11,000 vdekje. Raporti dokumenton disa zbrazëtira në përgjigjen e forcave të sigurisë ndaj shpërthimit me Ebola, të cilat në përgjithësi u ndanë nga shtetet e fokusit:

- Zbatimi i akteve nënligjore dhe rregulloreve shëndetësore është bërë më sfidues, veçanërisht ato të cilat lidhen me ruajtjen e të drejtave të njeriut gjatë zbatimit të rregulloreve dhe mbrojtjen e jetës dhe pronës;
- Ka pasur një mungesë të përgjithshme të kornizave të qarta të roleve dhe përgjegjësi gjatë shpërthimit fillestar me bashkëpunimin ndërmjet stafit të sigurisë dhe mjekësisë, i cili ishte i dobët;
- Kapaciteti i qendrave korrektuese për të parandaluar ose kontrolluar shpërthimet e Ebola -s dhe sëmundjeve të tjera infektive ishte shumë i papërshtatshëm;
- Sektorit të sigurisë i mungonte kapaciteti për menaxhimin efektiv të turmës dhe mbrojtjen e shtëpive dhe qendrave të trajtimit në karantinë;
- Sektorit të sigurisë i mungonte kapaciteti i të punësuarve në pikat e kalimit kufitar i cili ishte i pamjaftueshëm. Më shumë staf (të sigurisë) kërkohet për detyrat të cilat lidheshin me emigrim dhe logjistikë;



<sup>66</sup> Roli i Sektorit të Sigurisë në Përgjigjen ndaj Krizave Shëndetësore. Mësimet e nxjerra nga Epidemia me Ebola 2014–2015 dhe Rekomandimet për Unionin e Lumit Mano dhe Shteteve Anëtare të tij (2017), Sandy, J., Schnabel, A., Sovula, H., Trepp, U., dhe Zumsteg, R. Qendra për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF) në Gjenevë, në: <https://www.dcaf.ch/security-sectors-role-responding-health-crises-lessons-2014-2015-ebola-epidemic>

- Në një rast, kur ishte i qartë trajnimi joadekuat dhe mungesa e përgatitjes për policët kombëtarë që merreshin me EVD, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (ICRC) filloi t'i trajnonte ata se si të kujdeseshin për stafin policor të ekspozuar ndaj Ebolas;
- Shpesh, spitalet ushtarake që ishin caktuar për të trajtuar stafin ushtarak në vijën e parë të shpërthimit me Ebola nuk ishin të pajisur aq sa duhet e as mjaftueshëm;
- Ka pasur një bashkëpunim rajonal joefektiv të veprimeve të policisë në kontekstin e krizës dhe shkëmbimit të informatave dhe mësimëve të nxjerra në tërë vendet, që ishte në rastin më të mirë minimal, nëse do të ndodhte fare;
- Përfshirje e ulët e grave në angazhimin e komunitetit në fazat fillestare të shpërthimit ishte me përfshirjen e komunitetit, në përgjithësi, jo e kërkuar në fillim të epidemisë;
- Përpjekjet për mbylljen e kufijve nuk ishin efektive në kontrollin e lëvizjes së lirë të njerëzve, pasi kufijtë natyrorë të vendeve në rajon prirën të jenë shumë tërheqës.

However, as the response to the Ebola outbreak progressed, collaboration between the community, the police and military improved with the involvement of the armed forces being highly beneficial for tackling the epidemic.

Sidoqoftë, derisa përgjigja ndaj shpërthimit me Ebola përparonte, bashkëpunimi ndërmjet komunitetit, policisë dhe ushtrisë u përmirësua me përfshirjen e forcave të armatosura të cilat ishin shumë të dobishme për trajtimin e epidemisë.

Raporti siguron një sërë rekomandimesh për sektorin e sigurisë si rezultat i analizës së reagimit të tyre kolektiv. Në vijim janë rekomandimet për forcat e policisë:

- Përfshirja e menaxhimit të krizës në programet e trajnimit të të gjitha forcave policore në rajon;
- Përmirësimi i marrëdhënieve me akterët e shoqërisë civile përmes angazhimit konstruktiv;
- Rritja e kapacitetit të forcave policore në përgjegjësinë e tyre për të mbrojtur publikun;
- Trajnimin e policisë në procedurat e duhura të shqyrtimit mjekësor gjatë urgjencave të shëndetit publik;
- Përforsimi i konceptit dhe praktikës të policimit në komunitet;
- Vendosja e udhëzimeve të qarta të sigurisë shëndetësore për stafin e sigurisë;
- Vendosja e PSO -ve për të mundësuar përfshirjen konstruktive të policisë në parandalimin dhe menaxhimin e krizave shëndetësore;
- Ofrimin e trajnimeve mbi interpretimin dhe zbatimin e akteve nënligjore vendore për t'i shmangur keqkuptimet;
- Ofrimin e ngritjes të kapaciteteve të zyrtarëve për menaxhimin e kufirit.

## Kutia 12

### UNDP: Vlerësimi i Dhunës Seksuale dhe Gjinore (VDhSGj) gjatë Krizës Ebola në Sierra Leone

Në vitin 2016, Programi i UNDP -së për Qasje në Drejtësi mandatoi një studim mbi prevalencën e VDhSGj para dhe gjatë shpërthimit të Ebola-s në Rajonin Lindor të Sierra Leones. Studimi gjithashtu u përpoq të hidhte dritë mbi llojet specifike të dhunës që ishin më të zakonshme gjatë shpërthimit dhe masën e shërbimeve për viktimat/të mbi-jetuarit ishin, ose nuk ishin, të disponueshme gjatë krizës.

Studimi përfshiu një fokus në punën e Njësisë për Mbështetjen e Familjes (FSU) të Policisë së Sierra Leones (SLP) dhe partnerëve të tyre të shërbimit thelbësor, përfshirë ata në sektorin e drejtësisë. FSU trajton rastet e dhunës në familje dhe abuzimit të fëmijëve. Disa gjetje kryesore nga studimi përfshijnë:

- Ndryshe nga statistikat zyrtare të VAWG të përpiluara nga akterët vendor të shërbimeve esenciale të cilat treguan një rënie të lehtë të rasteve të VDhSGj gjatë krizës në krahasim me gjysmën e parë të vitit, informata cilësore e arritur përmes intervistimit zbuloi një rritje aktuale të shfaqjes së pesë kategorive në pesëmbëdhjetë forma të VAWG. Këto përfshinin depërtimin seksual të fëmijëve, dhunën në familje, ngacmimet seksuale dhe braktisjen / neglizhimin;
- Disa komunitete madje raportuan një rritje prej 40-60% të adoleshenteve shtatzënë gjatë të njëjtës periudhë. Në të kundërtën, statistikat zyrtare të menaxhuara nga FSU treguan luhatje në numrin e rasteve të raportuara të përfshirjes seksuale të fëmijëve gjatë vitit 2014;
- Qasja dhe disponueshmëria e shërbimeve esenciale duke i përfshirë gjykatat kontribuoi në një praktikë të shtuar të ndërmjetësimit të rasteve të VDhSGj përmes policisë dhe udhëheqësve lokalë. Kjo me gjasë nxiti një rritje të mosndëshkimit të kryerësve të pretenduar;
- Gratë dhe vajzat e varfra si dhe vejshat u veçuan veçanërisht për rrezik të shtuar për shkak të rritjes së cenueshmërisë ekonomike si rezultat i shpërthimit;



Foto e çastitundp/anne kennedy (sierra leone)



- Kryerësit më të shpeshtë të pretenduar jashtë mjedisit të shtëpisë, veçanërisht të përfshirjes seksuale të fëmijëve nën 18 vjeç, ishin burrat në pozita të autoritetit dhe/ose pozitive të besimit, përfshirë Shefat, udhëheqësit fetar, punonjësit e OJQ -ve dhe personat e biznesit;
- Për vajzat e moshës 13 deri në 17 vjeçare, mësuesit u identifikuan gjithashtu si kryerës të vazhdueshëm të përfshirë në kryerje të marrëdhënieve seksuale me studentet e tyre për arsye të kalamit të notave ose të notave të mira, veçanërisht rreth periudhës të provi-



meve;

Studimi rekomandoi veprimet e mëposhtme të zbatueshme për SLP si rezultat i përvojës me Ebola:

- angazhimin e udhëheqësve të komunitetit për të siguruar që rastet penale të VDhSGj të mos ndërmyetësohen, por të trajtohen përmes sistemit zyrtar të drejtësisë;
- urgjentisht të rrisë kapacitetin operacional të FSU -së në mënyrë që t'i përgjigjet rasteve në mënyrë adekuate;
- të ngrit kapacitetin teknik të stafit të FSU lidhur me menaxhimin e rasteve të VDhSGj dhe grumbullimin e të dhënave;
- të mbështetet në zbatimin aktual të moratoriumit për FGM për të ndihmuar drejt zvogëlimit/braktisjes së përgjithshme të praktikës. Kjo duhet të përfshijë angazhimin strategjik me komunitetet dhe Soweis. Ruajtja e praktikave tradicionale por pa u shkurtuar, duhet inkurajuar nëse nuk zbatohet.
- Përpyekjet primare parandaluese të përqëndruara në ngritjen e statusit të grave përmes angazhimit të burave dhe grave duhet të shkallëzohet. Ky rekomandim duhet të zbatohet edhe brenda SLP;
- Rritja e numrit të objekteve të ngjashme me Qendrat Rainbow/dyqanet one-stop-shop për të mbijetuarit e VDhSGj dhe sigurimi i qasjes, përmes CSO-ve dhe organeve të tjera lokale, për gra edhe në zona shumë të largëta. Në raste të tilla, SLP duhet të planifikojë shpërndarjen adekuate të burimeve njerëzore brenda dyqaneve one-stop-shops.
- Financimi i qeverisë për FSU të ngritet në mënyrë që të lejojë funksionimin e duhur të institucionit;
- Partnerët e CSO të cilët punojnë mbi çështjet VDhSGj duhet të pajisen me trajnime të mëtejme të kapaciteteve për t'i përmirësuar aftësitë e tyre në ofrimin e shërbimeve, avokimin dhe dokumentimin. Në një rast të tillë, SLP duhet të jetë partnere aktive për të siguruar koordinim efektiv me CSO.



Foto e çastit UNMEER/Martine Perret (Sierra Leone)

Burimi: [Vlerësimi i Dhunës Seksuale dhe Gjimore gjatë Krizës me Ebola në Sierra Leone](#) (UNDP dhe Irish Aid (Ndihma Irlandeze), 2015).

## STUDIM I RASTIT

# PËRGJIGJA BASHKËPUNUESE E KOSOVËS NDAJ RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE TË RAPORTUARA GJATË MASAVE TË COVID-19

### Pjesa I: Projekti ‘Parandalimi i Dhunës në Familje’ Policia e Kosovës Rajoni i Mitrovicës Jugore

*Nga Kolonel Afërdita Mikullovc, Drejtori Rajonal i Policisë - Rajoni i Mitrovicës Jugore*

Më 29 prill, pas analizimit të disa statistikave mbi dhunën në familje gjatë pandemisë COVID-19, udhëheqja e lartë për Policinë Rajonale për Mitrovicën e Jugut filloi hapat shtesë për parandalimin e dhunës në familje (DhF).

Nisma kryesore ishte e njoftuar me një projekt shumë-dimensional i titulluar ‘Parandalimi i Dhunës në Familje’, i cili do të mbështetej në përkrahjen e OJQ-ve lokale që merren kryesisht me të drejtat e grave, të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore në rajonin e Mitrovicës (në Jug dhe Veri). Përgjigja nga OJQ -të vendase ishte jashtëzakonisht pozitive dhe shpui në krijimin e motos të projektit: “Së bashku kundër Dhunës në Familje” të shoqëruar me një porosi të qartë se ‘Familja nuk është një gjë e rëndësishme - Është GJITHÇKA”.

Partnerët dhe përfituesit e projektit të përfshirë:

- Policia e Kosovës
- Prokurori për rasteve e DhF
- Përfaqësues fetar (islamik dhe të Krishterë)
- Zyrtarët për Mbrojtjen e Viktimave
- Zyra për barazinë Gjinore brenda Komunës të Mitrovicës
- Nxënësit e shkollave të mesme
- Nxënësit nga shkolla fillore
- OJQ ‘Sindroma Down’
- OJQ ‘Little people of Kosova’
- OJQ “DIAKONIA” – Traumacenter në Mitrovicë
- OJQ ‘Mundesia’ (Opportunity)
- OJQ ‘Zenska Pravo’ (të Drejtat e Grave) –Mitrovica Veriore
- OJQ ‘REC’ (Bashkërendimi Fuqizues i Komuniteteve)
- OJQ ‘MWAHR’ (Gruaja Mitrovicase dhe të Drejtat e Njeriut)
- OJQ ‘CBM’ (Ndërtimi i Komunitetit Mitrovicë)



Foto e çastit Policia e Kosovës

Muajin pasues, dhe si rezultat i bashkëpunimit aktiv i të gjithë partnerëve dhe përfituesve, projekti ka mundur t'i zbatonte aktivitetet si më poshtë:

- Ligjërata online me nxënës të shkollave të mesme të moderuar nga Policia e Kosovës dhe psikologë, mbi temën DhF dhe pasojat nga ky fenomen negativ. Kjo bëri që studentët të bashkëpunojnë me Policinë e Kosovës dhe partnerët e OJQ -ve të projektit për të shpërndarë thënie/citime të ndryshme mbi dhunën në familje dhe atë gjinore. Për më tepër, studentët dolën me thëniet/citimet e tyre dhe fotografitë që i shpërndanin çdo ditë për një muaj rresht;
- Viktimat/të mbijetuarit e DhF janë kontaktuar me telefon nga Policia e Kosovës, duke treguar interes për mirëqenien e tyre dhe duke i njoftuar ata për qasjen te psikologët nga qendra lokale e traumave në rast nevojë. Kjo përfshin sigurimin e numrave të kontaktit të psikologëve për viktimat/të mbijetuarit, të cilët i raportojnë kontaktet me këto viktimat/të mbijetuarit;
- Kontakti me përfaqësuesit fetar (islamik dhe të krishterë) në mënyrë që ata të trajtojnë temën e DhF dhe pasojat e saj gjatë takimeve të tyre online me komunitetet dhe kontaktet e tyre me mediat sociale;



Promovimi i Projektit së Bashku kundër Dhunës.  
Foto e çastit e Policisë të Kosovës

- Promovimi i materialeve në të dy gjuhët zyrtare (Shqipe dhe Serbe) si pankarta, fletore, fletëpalosje, bluza, lapsa që përmbajnë moton dhe mesazhin “Së bashku kundër Dhunës në Familje”-“Familja nuk është një gjë e rëndësishme-është GJITHÇKA” Ky material promovues u mbështet dhe u shpërnda në Mitrovicën Jugore dhe Veriore nga Policia e Kosovës. Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë apo EULEX<sup>67</sup> gjithashtu e mbështeti nismën duke i shtypur materialet;



<sup>67</sup> EULEX Kosova u lansua në vitin 2008 si misioni më i madh civil nën Politikën e Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes të Bashkimit Evropian. Misioni i përgjithshëm i EULEX -it është që t'i ndihmojë autoritetet e Kosovës në krijimin e institucioneve të qëndrueshme dhe të pavarura të sundimit të ligjit. Shih për EULEX-in <https://www.eulex-kosovo.eu/?page=2,60>

- Një video<sup>68</sup> e titulluar Së Bashku kundër Dhunës (Së Bashku kundër Dhunës) është përgatitur duke përmbytur porosi shumë të rëndësishme nga partnerët kryesorë, si përfaqësuesi i Policisë të Kosovës, Prokurori i Shtetit, përfaqësuesi Islamik dhe i Krishterë, avokatët e viktimave, përfaqësues nga rrjeti i OJQ -ve për të drejtat e grave dhe ekspertët për mbështetjen e viktimave, si dhe piktura dhe poema nga fëmijët mbi mirëqenien e familjes

Suksesi i këtij projekti bashkëpunues ishte falë përkushtimit të oficerëve të Policisë të Kosovës në çështje dhe, të cilët tanimë kishin punuar jashtëzakonisht më shumë orë pune si rezultat i pandemisë COVID-19, të kombinuar me një sërë akterësh të motivuar nga qeveria dhe shoqëria civile. Veçanërisht e rëndësishme ishte ndjenja e bashkëpunimit ndërmjet organizatave dhe institucioneve të ndryshme dhe nacionaliteteve të ndryshme të tyre (Shqiptarë, Serbë, Boshnjakë, etj).

## Pjesa II: Mbështetja Ndërkombëtare për t'iu Përgjigjur VAWG gjatë Pandemisë COVID-19

Nga UN Women Kosovë

Dy rastet e para të COVID-19 në Kosovë u identifikuan në mes të muajit mars, kur filluan edhe masat e izolimit. Si kudo në botë, kjo kishte implikime për të mbijetuarit e dhunës në familje (DhF)/dhunë ndër-personale. Që nga fillimi i masave të izolimit nën koordinimin e Koordinatorit të OKB -së për Zhvillim në bashkëpunim me Agjencinë për Barazi Gjinore dhe Ministrinë e Drejtësisë, UN Women ka qenë në kontakt të përditshëm me tetë strehimoret DhF/Dhuna në Bazë Gjinore (DhGJ) në tërë Kosovën. UN Women mblodhi kërkesat e menjëhershme nga strehimoret dhe koordinoj përgjigjen e Agjencive të OKB -së, ku UNFPA, UNDP, UNHCR dhe UNICEF shpërndanë në strehimore ushqime, pajisje higjienike dhe PPE.

Si rezultat i përpjekjeve të përbashkëta të UNKT -së, në dy javët e para të masave të izolimit rreth 550 grave të mbijetuara të DhF -së në strehimore u janë siguruar furnizime të tilla si ushqim dhe pajisje higjienike

<sup>68</sup> Së Bashku kundër Dhunës (Together against Violence). Kanali Zyrtar i Policisë të Kosovës, në: [https://www.youtube.com/watch?v=LSnomZVgD\\_w](https://www.youtube.com/watch?v=LSnomZVgD_w)



UN Women Sigurimi i Kamerave të Trupit për Policinë e Kosovës (13 maj, 2020). Foto e çastit, UN Women Kosovë

nike. UN Women monitoroi situatën e të mbijetuarve nga DhF/ DhGJ nga komunitetet jo-shumicë dhe ishte në kontakt me organizatat e grave dhe mekanizmat koordinues në komunat jo-shumicë. Artikujt u shpërndanë në një strehimore të minoriteteve në Novobrdë përmes përpjekjeve të përbashkëta me UNKT.

Për më tepër, për të mundësuar procesin e mësimit online për fëmijët në strehimore në Kosovë, UN Women e mbështetur nga Misioni i OKB -së në Kosovë dhuruan pajisje teknike si televizorë, kompjuterë laptopë dhe printerë. Donacionet gjithashtu përbëheshin nga gjësende të tilla si çarçaf krevati, jastëkë, batanije, peshqir, pizhame, ndërresa të brendshme dhe gjëra të tjera. Ato gjëra iu siguruan gjithashtu strehimores për fëmijë dhe strehimores për të mbijetuarit e trafikimit me qenie njerëzore.

UN Women së bashku me UNFPA ndihmuan Ministrinë e Drejtësisë në zhvillimin e një protokollit emergjent për trajtimin e rasteve të DhF gjatë pandemisë. Gjithashtu, UN Women dhe UNFPA dorëzuan pako higjienike, roba, çarçafe krevati, peshqira dhe gjëra të tjera në objektet e përkohshme të karantinës për rastet e DhF para se të pranohen në strehimore. Krijimi i mjediseve të përkohshme të karantinës u bë e mundur përmes një dialogu disa sektorial, të inicuar nga UNFPA, duke i përfshirë akterët si Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Agjencia për Barazi Gjinore/Zyra e Kryeministrit.

UN Women ka qenë në kontakt të ngushtë me Policinë e Kosovës që nga fillimi i pandemisë, duke monitoruar situatën e VAWG. Dyzet kamera trupore iu dhuruan Policisë të Kosovës- Njërive të Dhunës në Familje, me



UN Women, Duke siguruar Furnizime dhe Pajisje (29 prill 2020). Foto e çastit, UN Women Kosovë

qëllim që të ngrisin sigurinë si të personave në vijë të parë në përgjigje ashtu edhe të viktimave/të mbijetuarve nga DhF përmes teknologjive të fundit.

Me qëllim të ngritjes të vetëdijes dhe inkurajimit të raportimit të rasteve të DhF, në muajin mars 2020, UN Women lansoi një fushatë të ndërgjegjësimit e cila përfshiu video mesazhe në tri gjuhë nga



UN Women Sigurimi i Ndhmës të Strehimit (29 prill 2020). Foto e çastit, UN Women Kosovë

Kryeministri i Kosovës, Kryeparlamentarja, Ministri i Drejtësisë, Ministri i Shëndetësisë, Ministri i Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës, Koordinatorit i OKB-së për Zhvillim dhe Zyra e UN Women, dhe duke ndarë në ekran numrat tuaj të telefonit të ofruar nga institucionet e Kosovës në dispozicion online 24/7. Fushata, u publikua në kanalet televizive lokale dhe mediat sociale, me qëllim që të sigurojë që viktimat/të mbijetuarit e DhF të marrin mbështetjen e nevojshme nga institucionet. Në dy javët e para fushata bëri më shumë se një milion individë.

# SHTOJCA 1

## RRATHËT TOWNSLEY

### Planifikimi dhe Reagimi me Përgjegjësi Gjinore e Policisë ndaj VAWG gjatë Shëndetit Publik ose Krizës Humanitare

#### 1. Analiza e të Dhënave

- VAWG të dhënat para dhe gjatë krizës
- Krahasimi i kujdesshëm i të dhënave \*
- Të dhënat lidhur me krizën (çfarë na thotë shkenca?)
  - Informata - Udhëzime/kufizimet e qeverisë
- Inteligjenca - trendet e krimit, profilet e viktimave/kryerësve, etj
- Rishikoni procedurat standarde ekzistuese të operimit (PSO), politikat, etj

\* Numri më i ulët i raporteve të VAWG gjatë mbylljes ose kufizimeve të lëvizjes nuk do të thotë domosdoshmërisht se ka më pak incidente, ose llojet e krimit mund të kenë ndryshuar, ose viktimat/të mbijetuarit nuk janë

#### 2. Analiza e Ndikimit

- Vlerësimi i rrezikut
- Vlerësimi i Gjinisë/Diversitetit
- Vlerësimi i Vazhdimësisë të Biznesit \*\*
- Vlerësimi i Ndikimit në Komunitet

\*\* Vlerësimi i vazhdimësisë të biznesit të lidhet me aftësinë për të mbajtur një përgjigje efektive të Policisë ndaj VAWG during a crisis.

#### 6. Rishikimi & Mësimi

- Përmbledhje
- A ishin ndërhyrjet ‘e përshtatshme për qëllimin’?
- Asnjë nuk është lënë prapa, a ishin përcaktuar saktë prioritetet?
  - Llogaridhënia
  - Mbikëqyrja
  - Lidershipi Inovativ
  - Mësimet e mësuara
  - Planet e rishikuara
  - Trajnim/Brifing

#### 5. Zbatimi

- Planet ekzistuese, të reja ose të rishikuara
- Qasje e përqëndruar në viktimitë
  - Hetimi i fokusuar në kryerësin
    - Mos dëmto
  - Komunikimi i planeve/ndërhyrjeve, konsistenca e porosisë në organizata dhe komunitet Briefing – clear and consistent

#### Siguria & Mbrojtja

#### 4. Kontigjencat & Lehtësirat

- Identifikoni opsionet për t’u kujdesur për “çfarë nëse”
- Bashkëpunimi me - shërbime të tjera esenciale, agjencitë e drejtësisë, komunitetin më të gjerë si udhëheqësit fetar, lagjet, mediat, etj.
  - Hapësira të Sigurta për viktimat/të mbijetuarit që të kenë qasje në drejtësi;
  - Identifikimi i shërbimeve/mundësive të tjera të disponueshme gjatë krizës, siç janë dyqanet, punonjësit e postës, farmacistët, etj
- Protokolle/praktika të reja pune ndërmjet ofruesve të tjerë të shërbimeve dhe/ose agjencive të drejtësisë;
- Pajisjet Mbrojtëse Personale (PPE)

#### 3. Planifikimi

- Identifikoni Strategjitë dhe planet
- A janë planet e zbatimit ekzistues apo të rinj ‘të përshtatshëm për qëllimin’?
- Vazhdimësia e Biznesit - si të sigurohet një përgjigje ‘biznesi e zakonshme’ ndaj VAWG
- Rishikoni Planet emergjente ekzistuese ose zhvilloni plane të reja ose të zgjeruara në varësi të analizës të ndikimit
  - Mekanizmat e Qeverisjes dhe Llogaridhënies

## PLANIFIKIMI DHE REAGIMI ME PËRGJEGJËSI GJINORE I POLICISË NDAJ VAWG GJATË SHËNDETIT PUBLIK OSE KRIZËS HUMANITARE

Modeli është një proces ciklik dhe mund të përdoret për përgjigje të para-planifikuara dhe spontane. Mund të zbatohet për një ndodhi/krizë të çdo madhësie dhe është mjaft fleksibël për ta ngritur atë ndërsa zhvillohet një krizë, ose poshtë kur kulmi i krizës ka kaluar dhe kur filloni të ktheheni në normalitet, edhe nëse kjo është një normalitet i ri. Në thelbin e procesit, ju duhet të mendoni për masat e sigurisë dhe mbrojtjes dhe kjo duhet të merret parasysh në çdo fazë të procesit.

**1. Analiza e të Dhënave** – Kjo ndodh gjithmonë në fillimin e procesit dhe është vendi ku mblidhen informatat dhe intelijenca për të identifikuar se çfarë problemi po përpiqeni që të trajtoni. Është e rëndësishme që të sigurohet që të dhënat të mos keqinterpretohen si rezultat i ndikimit të krizës. Për shembull, një numër më i ulët i raporteve të VAWG gjatë mbylljes ose kufizimeve të lëvizjes nuk do të thotë domosdoshmërisht se ka më pak incidente, mund të nënkuptojë që ose llojet e krimit kanë ndryshuar, ose viktimat/të mbijetuarit nuk mund të kenë qasje në mekanizmat e zakonshëm të raportimit

**2. Analiza e Ndikimit** – Analiza e të dhënave ndihmon në identifikimin e ndikimeve të mundshme të krizës, kërkohet më shumë se një lloj vlerësimi dhe jepen disa shembuj për secilin lloj të *Vlerësimit të Ndikimit*, por këto nuk janë ekskluzive. Ndikimet e identifikuar mund të jenë të ndryshme në kontekste të ndryshme dhe ka të ngjarë të ndryshojnë me kalimin e kohës, prandaj ajo është pjesë e procesit të vazhdueshëm të përcaktuar nga modeli.

### *Vlerësimi i Rrezikut*

- Rreziku i shtuar i VAWG
- Rritja e llojeve të dhunës/keqtrajtimit
- Zvogëlimi i mbështetjes të rjetit
- Siguria personale për policinë e vijës të parë dhe mungesa e PPE

### *Vlerësimi i Gjinisë/Diversitetit*

- Shkeljet e të drejtave të njeriut
- Si mund t'i prekin gratë dhe vajzat, veçanërisht planet ose ndryshimet e propozuara, përfshirë ato me aftësi të kufizuara dhe/ose nevoja të tjera
- Çdo ndikim joproporcional i krizës në cenueshmërinë e grave dhe vajzave

### *Vlerësimi i Vazhdimësisë të Biznesit*

- Aftësia për të dhënë përgjigje të zakonshme ndaj VAWG
- Mirëqenia dhe disponueshmëria e stafit
- Qasja në qendër për viktimat/të mbijetuarit
- Hetimi i përqëndruar në kryerësin
- Ms dëmto
- Qëndrueshmëria

### *Vlerësimi i Ndikimit në Komunitet*

- A ka të ngjarë që disa komunitete të preken në mënyrë disproporcionale nga çdo ndryshim i përgjigjeve të policisë ndaj VAWG -së?
- Çfarë ndikimi do të ketë përgjigja ndaj VAWG në besimin dhe besueshmërinë e
- komuniteteve gjatë dhe përtej krizës?
- Ku duhet të zbatohet angazhimi i synuar i komunitetit?

**3. Planifikimi** – Kjo është faza kur planet e reja zhvillohen dhe çdo plan para-ekzistues ose emergjent rishikohet bazuar në analizën e të dhënave dhe vlerësimet e ndikimit për të siguruar se ato janë 'të përshtatshme për qëllimin'. Qëllimi i planit duhet të jetë që të sigurojë një qasje të përqëndruar në viktimën/të mbijetuarit me një hetim të fokusuar tek kryerësi i krimit duke siguruar që çdo përgjigje të jetë në përputhje me konceptin 'mos dëmto.'

**4. Kontigjencat dhe Lehtësirat** – Është e rëndësishme të identifikoni se çfarë mund të jetë e nevojshme nëse disa gjëra ndodhin pasi që plani juaj të zbatohet. Ndërsa kontigjencat dhe lehtësirat ecin paralelisht me planifikimin, ato gjithashtu mund të jenë një pjesë e veçantë e procesit. Gjatë fazës të planifikimit, ju tanimë duhet

të keni parasysh “çfarë nëse?” dhe ta vazhdoni këtë deri në zbatim.

**5. Zbatimi** – Filloni shpërndarjen e planeve, të cilat mund të jenë përgatitur si plane të pëtgjigjes emergjente paraprakisht, një plan të ri ose plane ekzistuese të cilat janë përshtatur në varësi të rezultateve nga 3 hapat e mëparshme të procesit. Komunikimi është një pjesë kryesore e zbatimit me njoftime të qarta dhe të qëndrueshme, dhe qëndrueshmëri të porosive për burimet e jashtme dhe organizatat dhe komunitetet.

**6. Rishikimi dhe Mësimi** - Kjo duhet të vijë gjithmonë e fundit dhe informojë analizën e të dhënave derisa procesi të vazhdon, cikli duhet të jetë në vazhdim derisa çfarëdo çështje specifike që po trajtoni të ketë pushuar. Përmbledhja duhet të fillojë sapo të bëhet zbatimi për të mundësuar që gjetjet të përfshihen në këtë fazë përfundimtare, patjetër kur të bëhet një rishikim më formal pasi të ketë përfunduar kriza e drejtëpërdrejtë.

**Reathanat ka të ngjarë të ndryshojnë vazhdimisht gjatë një ngjarjeje/krize; kjo është arsyeja pse procesi është projektuar të jetë një cikël i vazhdueshëm. Në situata dinamike, secila fazë mund të ketë nevojë që të përfundojë në një kohë akoma më të shpejtë.**



## SHËNIMET DHE LEXIM I SYGJERUAR

1. Deklaratë e përbashkët për shtyp Mbrojtja e shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese dhe promovimi i reagimit gjinor në krizën COVID-19 (2020). Zyrat Qeveritare të Suedisë, në: <https://www.government.se/statements/2020/05/joint-press-statement-protecting-sexual-and-reproductive-health-and-rights-and-promoting-gender-responsiveness-in-the-covid-19-crisis/>
2. Përhapja e sëmundjes koronavirus (COVID-19) (2020), Zyra regionale e OBSH për Evropë, në: <http://www.euro.who.int/en/health-topics/health-emergencies/coronavirus-covid-19/novel-coronavirus-2019-ncov>
3. Sëmundja e virusit Ebola: Faktet kryesore (OBSH, 2020), në: <https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/ebola-virus-disease>
4. Komiteti i Përhershëm Ndër Agjencia (Mars 2020). Udhëzime të përkohshme; paralajmërimi gjinor për shpërthimin e COVID-19, në: <https://interagencystandingcommittee.org/inter-agency-standing-committee/interim-guidance-gender-alert-covid-19-outbreak-developed-iasc>
5. CARE (mars 2020). Një dokument politikash mbi implikimet gjinore të COVID-19, në: <https://www.care.org/newsroom/press/press-releases/covid-19s-gender-implications-examined-in-policy-brief-care>
6. Video mesazhi i Sekretarit të Përgjithshëm mbi dhunën me bazë gjinore dhe COVID-19. Kombet e Bashkuara, 5 prill 2020, në: <https://www.un.org/sg/en/content/sg/statement/2020-04-05/secretary-generals-video-message-gender-based-violence-and-covid-19-scroll-down-for-french>
